A N K I M

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **1)** Ankim kundër vendimit përfundimtar nr. 604, datë 21.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është disponuar shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit, duke u disponuar në mënyrë alternative:
a. Prishja e këtij vendimi dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në KPK, me tjetër trup gjykues:
ose
b. Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë publike dhe në përfundim të shqyrtimit të saj, ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin tim në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2) A. Ankim ***kundër mospërgjigjes*** në asnjë moment të kohëzgjatjes së procedurës së rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mbi kërkesën time procedurale të parashtruar me emailin e datës 05.12.2022, në rrugë elektronike, në adresën elektronike te komisioneres relatore Genta Bungo, lidhur me sa më poshtë:
- Faktin nëse vendimet dhe veprimet administrative të kryera nga Komisioneri relator i mëparshëm Roland Ilia dhe Komisionerja anëtare Etleda Çiftja, që janë përjashtuar nga gjykimi për shkak të konfliktit të interesit, janë konsideruar të vlefshme apo të pavlefshme, tërësisht apo pjesërisht,
- Cilat veprime/vendime të ndërmjetme janë konsideruar të vlefshme? Cila është baza ligjore referuar të cilës janë konsideruar të vlefshme këto veprime/vendime administrative të ndërmjetme,
- Cilat veprime janë konsideruar të pavlefshme. Cila është baza ligjore referuar të cilës këto veprime janë konsideruar të pavlefshme.
- A janë konsideruar të përdorshme apo të papërdorshme, rezultatet/provat/të dhënat/faktet që janë rrjedhojë (pasojë) e veprimeve/vendimeve administrative ku kanë marrë pjesë Komisioneri relator Roland Ilia dhe Komisionerja Etleda Çiftja, të përjashtuar nga gjykimi për shkak se janë konstatuar se kanë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe nëse janë konsideruar të përdorshme, - A bie ndesh kjo vendimarrje e KPK me ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe ligjin për "Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike".

B. Zgjidhjen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit **të pasojave juridike të kësaj pjese të ankimit**, pra të pasojave juridike të veprimtarisë së

komisionerit Roland Ilia dhe komisioneres Etleda Çiftja, në kushtet e konfliktit të interesit, si më poshtë:

I. Duke konsideruar si absolutisht të pavlefshme, **të gjitha (çdo) veprim/vendim të ndërmjetëm administrativ**, ku kanë marrë pjesë këta komisionerë, për shkak të veprimit të tyre në kushtet e konfliktit të interesit.

II. Duke konstatuar **papërdorshmërinë e të gjitha (çdo) prove/rezultati/të dhëne** që është rrjedhojë e kësaj veprimtarie administrative të ushtruar në kushtet e konfliktit të interesit, **duke përfshire, por jo vetëm**, të gjitha përgjigjet që i kam dhënë unë përmes korrespondencës elektronike trupit gjykues të KPK, në kohën kur në këtë trup gjykues, ku kanë bërë pjesë komisionerët Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

III. Konstatimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, të pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është disponuar shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit, për shkak se **ato pjesë të tij, në të cilat është bërë referencë, në provat/të dhënat/rezultatet/faktet e papërdorshme (për shkak të pavlefshmërisë absolute të sipërtreguar)**, janë të tilla, pra aq të rëndësishme, sa që pa këto pjesë të vendimit, ky vendim konsiderohet i paarsyetuar dhe i kundërligjshëm.

IV. Në kushtet e mosveprimit të KPK, i kërkoj Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, **të përsërisë të gjitha (çdo) veprim administrativ** hetimor që është absolutisht i pavlefshëm, për shkakun e mësipërm, me qëllim për të vlerësuar Kolegji nëse gjendja e faktit është ashtu sikurse ka rezultuar nga këto veprime administrative hetimore absolutisht të pavlefshme.

3) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 2346/8 prot, datë 15.06.2022, me të cilin është disponuar "*Pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisionerit Roland Ilia nga procesi i tij i rivlerësimit*", duke u kryer nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit veprimet e mëposhtme:

a. Hetimin në themel **të të gjitha shkaqeve që kam ngritur unë** për përjashtimin e këtij Komisioneri, në seancë gjyqësore publike në KPA, (dhe jo vetëm të një pjese të tyre sikurse ka vepruar KPK).

b. Konstatimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit se motivet e përjashtimit të këtij Komisioneri nga procesi im i rivlerësimit, **përveç** atyre të shprehura në përmbajtjen e këtij vendimi të ankimuar, (që

kanë të bëjnë me konstatimin nga vetë KPK të ekzistencës së konfliktit të dukje dhe të konfliktit të mundshëm të interesit), duhet të jenë edhe konstatimi i konfliktit faktik dhe konfliktit të vazhdueshëm të interesit të këtij komisioneri, në ushtrimin e detyrës së tij, në raport me mua.

c. Zgjidhjen e pasojave ligjore nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, të ushtrimit të detyrës nga Komisioneri Roland Ilia, në kushtet e ekzistencës së konfliktit faktik, konfliktit të vazhdueshëm, konfiktit në dukje dhe konfliktit të mundshëm të interesit të këtij, në raport me mua, duke u disponuar pavlefshmëria e të gjitha veprimeve administrative të kryera nga ky zyrtar, (në cilësinë e komisionerit relator të trupit gjykues të KPK), papërdorshmëria e të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi, **sikurse përshkruhet në pikën 2 të pjesës hyrëse të këtij ankimi**.

ç. Konstatimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ekzistencës së shkaqeve për fillimin e procedimit disiplinor ndaj këtij Komisioneri, për ushtrimin e detyrës zyrtare në kushtet e ekzistencës flagrante të konfliktit të interesit ne raport me mua.

4) Ankim kundër vendimeve të ndërmjetve të marra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për rrëzimin e kërkesave të mia të parashtruara me shkrim, për të thirrur si persona të tretë në procedurën administrative të procesit tim të rivlerësimit, të shtetasve të mëposhtëm:
a. Ajola Prençi (Ymeri), që është motra ime, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë.
b. Faik Fetah Ymeri, që është babai im.
c. Elvira Ymeri, që është nëna ime.
ç. Gerti Ymeri, që është vëllai im.
d. Fahri Fetah Ymeri, që është xhaxhai im dhe njëkohësisht është huadhënës i një shume prej 2.000.000 (dymilion) lekë, në vitin 2006, tek babai im Faik Ymeri.
dh. Xheladin Cuf Thana, që është bashkëshorti i hallës time, (kunati i babait tim), dhe që njëkohësisht është është huadhënës i një shume prej 1.500.000 (njëmilion e pesëqind) lekë, në vitin 2006, tek babai im Faik Ymeri.
e. Shefqet Geci, me banim në fshatin Trush Shkodër, tek i cili babai im ka dhënë një sipërfaqe toke bujqësore me qera në vitet 2004-2007.
ë. Lulzim Karini, avokat në Dhomën e Avokatisë Shkodër, (me të cilin unë sipas KPK, kam ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit, në të paktën 6 raste).
f. Nexhat Maliqi, (ky shtetas sipas KPK, ka perfituar favore gjyqësore nga unë në cilësinë e gjyqtarit, në kohën kur kam gjykuar çështjen

paditës: Nexhat Maliqi, etj, e paditur Kurum International sh.p.k). g. Roland Ilia, me detyrë Komisioner në KPK. (Kërkesa për thirrjen e këtij individi me cilësinë e personit të tretë në procesin tim të rivlerësimit, u parashtrua pas përjashtimit të tij nga procesi im i rivlerësimit, me qëllim për të vërtetuar ushtrimin prej tij të detyrës së komisionerit relator, në kushtet e ekzistencës së gjendjes flagrante të konfliktit të interesit përmes një procedure gjyqësore ballafaquese ndërmjet tij dhe meje).

5) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4915/5 prot, datë 12.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Genta Bungo, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres relatore e trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

6) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4897/3 prot, datë 09.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Pamela Qirko, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres kryesuese e trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

7) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4915/3 prot, datë 12.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Firdes Shuli, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve

administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres anëtare e trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

8) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4966/7 prot, datë 15.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Genta Bungo, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres relatore të trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

9) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4966/3 prot, datë 15.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Pamela Qirko, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres kryesuese të trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

10) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4966/9 prot, datë 16.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisionereve Pamela Qirko, Genta Bungo dhe Firdes Shuli, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatëse përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga këta zyrtarë, papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

11) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4966/11 prot, datë 16.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Firdes Shuli, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres anëtare e trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

12) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4897/5 prot, datë 09.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres Firdes Shuli, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga kjo zyrtare, (në cilësinë e komisioneres anëtare e trupit gjykues të KPK), papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

13) Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 4966/13 prot, datë 16.12.2022, me të cilin është disponuar "Mosp*ranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisionereve Pamela Qirko, Genta Bungo dhe Firdes Shuli, nga procesi i tij i rivlerësimit, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova*", duke u shqyrtuar në themel nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kërkesa ime për përjashtim lidhur me shkaqet e saj, duke u gjetur e bazuar kjo kërkese përjashtimi si dhe duke u zgjidhur pasojat ligjore përkatese përmes konstatimit të pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve administrative të kryera nga këta zyrtarë, papërdorshmërisë të të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi.

14) Ankim kundër mosmarrjes fare vendim të ndërmjetëm nga trupa gjykuese kompetente e Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, (pra, mosmarrjes në shqyrtim), lidhur me kërkesën time me objekt

"*Përjashtimin e Komisionereve* <u>*Pamela Qirko, Genta Bungo dhe Firdes Shuli, nga procesi im i rivlerësimit*</u> ", (**që i është paraqitur nga unë KPK, në adresë elektronike, përmes emailit në datën 19.12.2022, ora 3:35 PM si dhe në rrugë postare**), duke u disponuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mënyrë alternative si më poshtë:

a. Prishjen e vendimit përfundimtar të KPK dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në KPK me tjetër trup gjykues, (ndër të tjera, edhe për këtë shkak, që konsiston në mosshqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e Komisionerëve).

ose

b. shqyrtimin në themel të kësaj kërkese nga vetë Kolegji i Posaçëm i Apelimit, duke më mundësuar si marrjen e provave mbështetëse ashtu edhe shqyrtimin në seancë publike të kësaj kërkese.

15) A. Ankim kundër movveprimit të trupit gjykues të KPK, për të shqyrtuar me vendim paraprak dhe të arsyetuar, kërkesën time procedurale me objekt "**Pezullimin e procesit tim të rivlerësimit, deri në shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese të kërkesës që kam paraqitur në këtë gjykatë, me datën 19.12.2022, me objekt** "**1.** *Konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në standartin kushtetues "Gjykatë e krijuar me ligj" për shkak të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të shtetasve Genta Bungo, Firdes Shuli, Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi, Suela Zhegu dhe Alma Faskaj.* ***2.*** *Shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ne nr 82/2017, për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 "për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e shqipërisë" përsa i përket të zgjedhurve në në institucionet e rivlerësimit kë komisionerve Genta Bungo, Firdes Shuli, Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi, Suela Zhegu dhe Alma Faskaj.* ***3.*** *Marrjen e masës së përkohshme të pezullimit të vijimit të shqyrtimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i procesit të rivlersimit kalimtar të gjyqtarit Andri Ymeri, deri në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor me vendim përfundimtar të formës së prerë.* ***4.*** *Përcaktimi nga Gjykata Kushtetuese përmes pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të vendimit të saj, të faktit se cili organ shtetëror ka juridiksion dhe/apo kompetencë ligjore për të shqyrtuar cështjen në themelin e saj, duke patur parasysh edbe vendimet e GJEDNJ, në cështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë dhe Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë.*

B. Zgjidhjen e pasojave të kësaj pjese të ankimit, nga vetë Kolegji i Posaçëm i Apelimit duke u shprehur për këtë kërkesë, (*që ia kam paraqitur edhe vetë Kolegjit me datën 19.12.2021 përmes shërbimit postar, por akoma nuk jam njohur me vendimin përkatës të Tij, lidhur*

me këtë kërkesë).

Si dhe

Në rast se Kolegji vendos t'a shqyrtojë vetë këtë kërkesë, i kërkoj paraprakisht që të vendosë masën e përkohshme të pezullimit të fuqisë juridike të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022 të KPK, deri në shqyrtimin e kësaj kërkese nga vetë Kolegji i Posaçëm i Apelimit si dhe të më njoftojë vendimin e ndërmjetëm përkatës lidhur me kërkimin për masën e përkohshme, përpara gjykimit të çështjes në themel.

16) Ankim ndaj mosveprimit të KPK, të shprehur përmes vendimeve nr. 4915/5 prot, datë 12.12.2022, nr. 4897/3 prot, datë 09.12.2022, nr. 4915/3 prot, datë 12.12.2022, nr. 4966/7 prot, datë 15.12.2022, nr. 4966/3 prot, datë 15.12.2022, nr. 4966/9 prot, datë 16.12.2022, nr. 4966/11 prot, datë 16.12.2022, nr. 4897/5 prot, datë 09.12.2022, nr. 4966/13 prot, datë 16.12.2022, duke u shprehur Kolegji i Posaçëm i Apelimit posaçërisht nëse anëtarët e trupit gjykues të KPK, (Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo), **që ka dhënë vendimin përfundimtar** nr. 604, datë 21.12.2022 për shkarkimin tim nga detyra e gjyqtarit, e plotësojnë apo jo standartin kushtetues të "Gjykatës së krijuar me ligj", duke patur parasysh edhe vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Besnik Cani Kundër Shqipërisë.

17) Ankim ndaj mosveprimit të KPK, të shprehur përmes vendimeve nr. 4915/5 prot, datë 12.12.2022, nr. 4897/3 prot, datë 09.12.2022, nr. 4915/3 prot, datë 12.12.2022, nr. 4966/7 prot, datë 15.12.2022, nr. 4966/3 prot, datë 15.12.2022, nr. 4966/9 prot, datë 16.12.2022, nr. 4966/11 prot, datë 16.12.2022, nr. 4897/5 prot, datë 09.12.2022, nr. 4966/13 prot, datë 16.12.2022, duke u shprehur Kolegji i Posaçëm i Apelimit posaçërisht nëse anëtarët e trupit gjykues të KPK, (Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo), **që ka dhënë vendimin përfundimtar** nr. 604, datë 21.12.2022 për shkarkimin tim nga detyra e gjyqtarit, e plotësojnë apo jo standartin kushtetues të "*Gjykatës së drejtë*", duke patur parasysh edhe vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë, lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit përsa i përket kriterit të pasurisë si dhe në këndvështrimin se sa është barra e provës që duhet t'i ngarkohet subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e pasurisë në rastin e "personave të tjerë të lidhur" me subjektin e rivlerësimit.

18) Ankim ndaj veprimit të KPK që ka konsideruar huadhënësit Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri si "persona të tjerë të lidhur" me personin tim, ndërkohë që ata huatë ia kanë dhënë babait tim Faik Ymeri dhe jo mua, pra për zgjerimin e barrës së provës në

kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit

19) Ankim ndaj pjesmarrjes në trupat gjykues të KPK, që kanë dhënë vendimet nr. 4915/5 prot, datë 12.12.2022, nr. 4897/3 prot, datë 09.12.2022, nr. 4915/3 prot, datë 12.12.2022, nr. 4966/7 prot, datë 15.12.2022, nr. 4966/3 prot, datë 15.12.2022, nr. 4966/9 prot, datë 16.12.2022, nr. 4966/11 prot, datë 16.12.2022, nr. 4897/5 prot, datë 09.12.2022, nr. 4966/13 prot, datë 16.12.2022, të komisionereve të KPK, Alma Faskaj, Brunilda Bekteshi, Suela Zhegu dhe Valbona Sanxhaktari), pasi këta komisionerë **që kanë dhënë/marrë pjesë në vendimet e ndërmjetme** me të cilat janë shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga unë për përjashtimin e komisionerëve që janë përfshirë në trupin gjykues të KPK që e ka marrë në shqyrtim në themel, procesin tim të rivlerësimit, nuk e plotësojnë standartin kushtetues të "*Gjykatës së krijuar me ligj*", duke patur parasysh edhe vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë.

20) Ankim ndaj pjesmarrjes se komisionereve Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu, në trupat gjykues të KPK, që kanë dhënë vendimet për përjashtimin e Komisionerëve Roland Ilia, Etleda Çiftja, Pamela Qirko, Genta Tafa, pasi komisionerët që i kanë shqyrtuar këto kërkesa përjashtimi, nuk e plotësojnë standartin kushtetues të "*Gjykatës së paanshme*", përderisa ata kanë dhënë mendim për figurën dhe pasurinë time, përmes dhënies së vendimit për subjektin e rivlerësimit Ajola Prençi, që është motra ime.

21) Ankim për shkeljen nga trupat gjykues të KPK që kanë shqyrtuar kërkesat e mia për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues që kanë shqyrtuar në themel procesin tim të rivlerësimit, të standarteve kushtetuese të "*Gjykatës së paanshme dhe të Gjykatës së drejtë*", standarte këto që janë shkelur për shkak se nga KPK, shqyrtimi i të gjitha (11) kërkesave për përjashtimin e komisionerëve nga trupi gjykues, që kam paraqitur, dhe marrja e vendimeve të ndërmjetme përkatëse lidhur me këto kërkesa përjashtimi, është realizuar **pa m'u njoftuar mua paraprakisht se kush janë komisionerët e angazhuar me shqyrtimin e këtyre kërkesave për përjashtim si dhe pa m'u respektuar afati 3 ditor për paraqitjen me shkrim të shkaqeve të përjashtimit dhe provave përkatëse**, i parashikuar nga neni 75 i KPC, ndonëse unë kam kërkuar vazhdimisht, në mënyrë të përsëritur, me shkrim dhe me gojë (në seancat dëgjimore), respektimin e këtyre të drejtave të mija procedurale.

22) Ankim për shkeljen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit,

gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, **të të drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues**, e parashikuar në nenin 3 të KEDNj dhe 17/2 të Kushtetutës, në rastet e mëposhtme:

a. Kur ndonëse i kam bërë me dije Komisionerit relator Roland Ilia si dhe komisionerëve Pamela Qirko dhe Etleda Çiftja, se kam qënë në pamundësi për t'iu përgjigjur pyetësorit të dytë që më kanë nisur, brënda afatit që më kanë përcaktuar, pasi kam patur vajzën (e mitur-5 vjeç), të sëmurë në rrezik jete, (duke i dërguar dokumentacionin mjekësor përkatës të vajzës si dhe fotografi, me email), kërkesa ime për 2-3 ditë kohë shtesë, është shpërfillur duke u detyruar të punoj në një tension mendor dhe vuajtje shpirtërore të jashtëzakonshme. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky **trajtim ç'njerëzor** si dhe për t'u shprehur se a kanë fuqi provuese të dhënat/provat/rezultatet qoftë të favorshme qoftë të disfavorshme për mua, por që janë përftuar nga veprimtaria hetimore e KPK, që është shtrirë në kohë, po aq kohë ka zgjatur ky trajtim ç'njerëzor i pretenduar prej meje).

b. Kur ndonëse i kam bërë me dije Komisionerit relator Roland Ilia si dhe komisionerëve Pamela Qirko dhe Etleda Çiftja, me emailin e datës 21.01.2022 se kam qënë në pamundësi për t'iu përgjigjur pyetësorit të tretë, brënda afatit që më kanë përcaktuar, pasi unë kam qënë i sëmurë rëndë dhe i jam nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në vesh, (duke i dërguar dokumentacionin mjekësor përkatës të timin si dhe fotografi të padyshimta, me email), kërkesa ime për 4-5 ditë kohë shtesë, është shpërfilluar duke u detyruar të punoj në një gjendje fizike pothuajse në kushtet e pamundësisë objektive si dhe në një tension mendor dhe vuajtje fizike të jashtëzakonshme. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky **trajtim ç'njerëzor**si dhe për t'u shprehur se a kanë fuqi provuese të dhënat/provat/rezultatet qoftë të favorshme qoftë të disfavorshme për mua, por që janë përftuar nga veprimtaria hetimore e KPK, që është shtrirë në kohë, po aq kohë ka zgjatur ky trajtim ç'njerëzor i pretenduar prej meje).

c. Kur KPK, raportin për rezultatet e hetimit administrativ, m'a ka komunikuar me email në datën 31.10.2022, në orën 11:00 të natës, ditë e premte. Pse duhej ora 11 e natës? A u bë kjo qëllimisht për të më shqetësuar mua dhe familjen time. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky **trajtim ç'njerëzor** si dhe për t'u shprehur se a është e arsyeshme të supozohet dhe vlerësohet se nga vlerësimi i këtij episodi në sintezë edhe me episodet e mëparshme (si dhe ato që do të përshkruhen në pjesën përmbajtësore të ankimit), KPK në procesin tim të rivlerësimit, duke

më trajtuar në mënyrë ç'njerëzore dhe/apo poshtëruese, ka patur qëllim të më provokojë paligjshmërisht që unë të mos bashkëpunoj në procesin tim të rivlerësimit ose të më shkurarojë në guximin tim për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes).

ç. Kur ndonëse me datën 25.11.2022, i kërkova Komisioneres relatore Genta Bungo si dhe komisionerëve Pamela Qirko dhe Firdes Shuli, kohë shtesë përtej datës 27.11.2022, për të dorëzuar mbrojtjen time lidhur me rezultatet e hetimit, pasi jo vetëm që kjo mbrojtje ishte tepër voluminoze por ndër të tjera kisha nënën me ishemi cerebrale që i kishte ndodhur me datën 25.11.2022, (duke i dërguar dokumentacionin mjekësor përkatës të nënës si dhe fotografi të padyshimta), **Komisioni bëri gjoja se më dha kohë, deri me datën 30.11.2022,** ndërkohë që faktikisht i bie që kërkesa për kohë m'u refuzua, pasi datat 27, 28, 29, 30.11.2022, kanë qënë ditë pushimi dhe vetë KPK nuk punonte në këto ditë. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky **trajtim ç'njerëzor** dhe **a është kjo në pajtim me parimin e gjykimit të drejtë** dhe detyrimin që kanë gjykatat që përmes veprimtarisë së tyre, t'i frymëzojnë palëve dhe publikut, besim në ushtrimin e funksionit të dhënies së drejtësisë).

d. Kur në seancën dëgjimore të datës 12.12.2022, teksa unë po ushtroja të drejtën time të mbrojtjes pranë KPK, nga kryesuesja Pamela Qirko, m'u tha, **"këto mund t'i shkruash në ankim".** (I kërkoj Kolegjit të shprehet a mund të konsiderohet kjo përveçse si paragjykim, **edhe trajtim poshtërues** nga ai që të gjykon?

dh. Kur në seancën dëgjimore të datës 13.12.2022, teksa unë po ushtroja të drejtën time të mbrojtjes pranë KPK, në përfundim të seancës, nga kryesuesja Pamela Qirko, m'u tha, ***"tani meqë u mbyll seanca, po shkoj të shoh një film".*** (I kërkoj Kolegjit të shprehet a mund të konsiderohet kjo përveçse si paragjykim, **edhe trajtim ç'njerëzor** dhe **poshtërues** nga ai që të gjykon.

e. A është në vetvete trajtim ç'njerëzor dhe poshtërues kur KPK në vendimin objekt ankimi, shprehet se nuk kam qënë bashkëpunues dhe kjo është një ndër shkaqet se përse më ka shkarkuar nga detyra, **ndërkohë** që jo vetëm nuk përputhet me dinjitetin dhe madhështinë e funksionit të gjyqtarit të Republikës por as edhe kujtdo, që të ushtrojë një funksion publik, ndërkohë që vuan nga sindromi i Stokholmit, (të biesh në dashuri me atë që të dhunon)?

ë. **Lidhur me këtë pjesë të ankimit**, i kërkoj Kolegjit të verifikojë nëse tërësia e sjelljeve të mësipërme, (që nuk janë të vetme), të konsumuara nga komisionerët e KPK, janë apo jo të bazuara, dhe në

vijim të shprehet se -a mund të konsiderohen fyese, poshtëruese dhe ç'njerëzore sjelljet e lartëpërmëndura të KPK, për çdo subjekt që ka nevojë për shërbimin publik të marrjes së drejtësisë, sipas Parimeve të Bangalores?

23) Ankim për shkeljen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit **të të drejtës për të mos iu nënshtruar diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë**, e parashikuar në nenin 14 të KEDNj dhe 17/2 të Kushtetutës, në raport me të gjitha vendimet e subjekteve të rivlerësimit që kam përmëndur në memon e titullur "Memo-KPK-Shkodra" të dorëzuar me email në adresën elektronike të KPK, me datën 29.11.2022 dhe në Memon e titulluar "Memo, mbrojtja për rezultatet e hetimit, nëntor 2022", të dorëzuar me email në adresën elektronike të KPK, me datën 18.12.2022", veçanarisht lidhur me subjektet e rivlerësimit Ilir Toska, Elisabeta Ymeraj, Arben Dosti, Astrit Kalaja, Fuat Vjerdha, Arbër Çela, Armida Hamiti (Moçka), Mariola Mërtiri, Marsida Frashëri, Riselda Fishta, Artan Çupi dhe Dritan Hallunej.

24) Ankim për shkeljen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit të të drejtës për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 6/1 të KEDNj dhe 17/2 të Kushtetutës, **në standartin e arsyetueshmërisë të vendimit përfundimtar**, në aspektet e mëposhtme:

- Lidhur me kriterin e pasurisë, pjesët më të rëndësishme të prapësimeve të mia, jo vetëm nuk argumentohet se përse konsiderohen si prapësime të pabazuara, ***por madje nuk përmënden fare***, (shih p.sh prapësimet se përse babai im meqënëse ka qënë shitës ambulant fruta perimesh për vitet 2004, 2005, 2006, nuk ka qënë i detyruar nga ligji të paguaajë tatime, pjesa lidhur me depoziten prej 1.000.000 lekësh e krijuar në vitin 2008 tek Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortes time, pjesa lidhur me shpenzimet e mobilimit, si dhe pjesë të tjera shumë të rëndësishme).

- Lidhur me kriteret e figurës dhe profesionalizmit, pothuajse të gjitha shpjegimet e mia, në pjesët e tyre thelbësore dhe më të rëndësishme, ***as nuk përmenden fare*** në vendimin e KPK të arsyetuar ose paraqiten të deformuara/shtrembëruara/të mangëta dhe aq më pak argumentohet në referencë të ligjit se përse këto qëndrime të mia të dhëna gjatë ushtrimit të të drejtës së mbrojtjes, janë të pabazuara.

25) Ankim për shkeljen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit të të drejtës për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 6/1 të KEDNj dhe 17/2 të Kushtetutës, "**në standartin e gjykatës se paanshme**", e konsumuar

përmes moskthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të paraqitura prej meje në mënyrë të përsëritur, katër herë me shkrim dhe dy herë me gojë, as nga trupi gjykues i KPK, as nga Kryetarja e KPK Pamela Qirko dhe as nga ONM, lidhur me të drejtën time për t'u informuar "*mbi faktin se cila është arsyeja/arsyet objektive se përse emri im dhe gjithashtu ai i motrës time Ajola Prençi, janë përfshirë në shortin special të datës 15.12.2019, duke n'a vënë në pozitë të pabarabartë me subjektet e tjera të rivlerësimit, që janë ndodhur në rrethana të njëjta sikurse ne të dy*".

Zgjidhjen e pasojave të kësaj pjese të ankimit, duke më informuar Kolegji i Posaçëm i Apelimit mbi arsyen/arsyet e përfshirjes time dhe të motrës time në këtë short special nga KPK, **dhe** në vijim, vlerësimin nga Kolegji nëse mosdhënia e informacionit nga KPK, **a është tregues** se procesi im i rivlerësimit i zhvilluar nga KPK, (por edhe ai i motrës time), kanë qënë të pandershëm, të padrejtë, paragjykues, të porosituara/sponsorizuara si dhe vlerësimin nga Kolegji, nëse është e arsyeshme të shkarkohem unë nga detyra, me arsyetimin, ndër të tjera, që unë nuk kam bashkëpunuar në kryerjen e procesit të rivlerësimit, (edhe nëse kjo merret si e vërtetë, por që në fakt nuk është e vërtetë), me komisionerë të pandershëm, të padrejtë, paragjykues, të porosituar/sponsorizuar dhe për rrjedhojë të paligjshëm.

26) Kërkesë procedurale për marrjen dhe administrimin nga Kolegji të provave bashkëngjitur këtij ankimi, provave të kërkuara në ankim, si dhe provave të reja që mund të dalin pas paraqitjes së këtij ankimi ose që nuk kanë qënë në dijeninë time apo unë kam qënë në pamundësi për t'i siguruar.

27) Kërkesë procedurale që pas mbërritjes së dosjes administrative të KPK në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, mbi bazën e këtij ankimi, gjithmonë përpara fillimit të gjykimit, të më mundësohet të njihem me inventarin e dosjes/akteve si dhe akteve të përcjella, duke përfshirë por jo vetëm, edhe korrespondencën elektronike të realizuar ndërmjet meje me KPK, gjatë procesit tim të rivlerësimit, pasi ***meqënëse*** në vlerësimin tim, komisionerët Pamela Qirko, Firdes Shuli, Genta Bungo, Roland Ilia dhe Alma Faskaj, nuk plotësojnë njëherazi, secilin prej standarteve kushtetuese të "Gjykatës së krijuar me ligj", "Gjykatës së pavarur", "Gjykatës së paanshme" dhe "Gjykatës së drejtë", ***mua më lind dyshimi serioz*** dhe i përligjur se mund të tentohet që dosja administrative e KPK, mund të dorëzohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, me mangësi ose të meta thelbësore dhe serioze.

BAZA LIGJORE: -Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, *nenet 4, 15, 17, 18, 30, 42,*

53, 54, 179/b, pika 2 e 5. Aneksi i Kushtetutës, nenet A, Ç, D, DH dhe F.
- Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese.
-Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, *nenet 1, 3, 6, 7, 13, 14.*
-Ligji nr. 84/2016 "*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", *nenet 62 - 66.*
-Ligj nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nenet, 4, 12, 13, 14, 17.*
-Ligji nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", *nenet 47, 51.*
- Kodi Civil.
- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Ligji mbi informimin publik.
-Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.

PËRPARA: KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

PËR DIJENI:
- Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Institucionit të Komisionerëve Publik

TË NDERUAR ANËTARË TË KOLEGJIT TË APELIMIT!

I/E NDERUAR PËRFAQËSUES I ONM!

I NDERUAR PËRFAQËSUES I KOMISIONERIT PUBLIK!

Me vendimin 604, datë 21.12.2022 të KPK, Komisioni Pavarur i Kualifikimit, ka disponuar:

➢ *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

Pas njoftimit të vendimit të arsyetuar me datë **datë 04.02.2023,** duke mos qenë dakord me këtë vendim, brenda afatit ligjor, bazuar në nenin 63 të ligjit 84/2016, paraqes ankim kundër këtij vendimi.

KONSIDERATA PARAPRAKE

Sikurse vihet re nga pjesa hyrëse e këtij ankimi, kam paraqitur ankim edhe kundër disa vendimeve të ndërmjetme të marra në procesin tim të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si dhe mosveprimeve të paligjshme të Komisionit, për të marrë vendime ose për t'i kthyer përgjigje disa kërkesave të mia të ligjshme.

Gjithashtu, kam paraqitur edhe dy kërkesa procedurale që në vlerësimin tim, duhet të zgjidhen përpara marrjes së vendimit përfundimar nga Kolegji i Posaçëm të Apelimit, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

Përpara se të shtjelloj në mënyrë të detajuar shkaqet e këtij ankimi si dhe objektin e tij, e vlerësoj me vend të evidentoj dy fakte të rëndësishme, me natyre të përgjithshme, dhe për secilin prej tyre, të jap po në mënyrë të përgjithshme, konsideratat e mia përkatëse.

Fakti i parë: Unë kam ndjesinë se jam kërcënuar në mënyrë të nënkuptuar përmes vendimit të Komisionit, që unë po ankimoj, përmes fillimit ndaj meje të ndonjë hetimi penal. (Shiko për këtë paragrafin 96.2, të faqes 127 të vendimit.)

Lidhur me këtë kërcënim, nëse e kam perceptuar dhe kuptuar drejtë, kam për të thënë se hamendësoj se ai sigurisht është bërë me qëllim për të shkurajuar zellin tim për t'u mbrojtur.

Meqënëse ky ankim paraqitet në KPK, sipas ligjit 84/2016, atëherë nuk përjashtohet mundësia që të lexohet, qoftë edhe pjesërisht.

Meqënëse mund të lexohet nga vetë KPK, atëherë po po tregoj një të vërtetë.

Kur unë kam filluar të përgatitem për të ushtruar të drejtën time të mbrojtjes, ashtu sikurse kam ditur, (dhe me sa më kanë thënë, në publik është perceptuar si mbrojtje me kurajo ekzemplare), unë i kam marrë mendim bashkësortes time lidhur me faktin nëse do duhej apo jo, sipas saj, t'i jepja udhë dëshirës time të padyshimtë, që të mbrohem duke mos ceduar as një qime floku nga qënia dinjitoz.

Po ashtu, kam pyetur edhe prindërit, vëllain dhe motrën time.

Nga përgjigjet e tyre, m'u çlirua gadishmëria ime e pakufijshme, për të realizuar një mbrojtje dinjitoze, të ligjshme, të pandikuar nga asnjë lloj kërcënimi apo shantazhi.
Sikurse i kam thënë Komisionit, në mënyrë të përsëritur në seancat dëgjimore, në vlerësimin tim, liria e një qënie njerëzore me dinjitet, dimensionin më të rëndësishëm, ka atë shpirtëror, pastaj atë mendor dhe në fund fare, atë fizik.

Në vlerësimin tim, vetëm ky rend i përcaktimit të dimensioneve të lirisë, përkon me dinjitetin sublim të qënies njerëzore.

Dhe unë këtë dinjitet sublim, padiskutim e kam të pacënuar.

Për rrjedhojë, kjo luftë që unë po bëj për mbrojtjen e dinjitetit, do bëhet nga ana ime, me të njëjtën furi, vendosmëri për sakrificë dhe guxim, sikurse beteja e Stalingradit.

Në këtë beteje, mbrojtësit të qytetit, kishin të shkruar në zemër dhe në mëndje një parullë.

NO ONE STEP BACK.

Edhe unë e kam të shkruar këtë parullë në mendjen dhe zemren time.

Prandaj jam sypatrëmbur, ndaj çdo lloj Ballukisti, Gonigalisti apo Doshisti, që pavarësisht se më ka bërë keq, shpreson apo në mënyrë naive beson se mund të më shantazhojë, duke më bërë akoma më shumë keq. Nëse ky besim ekziston, iu them, vetëm një fjalë, "pfff...".

Kaq, përsa i përket kërcënimit.

Fakti i dytë: Vendimin e lexova relativisht shpejt. Pasi e lexova m'u krijua krahas zemërimit, zhgënjimit, ndjesisë që është ky vendim është i padrejtë, i paligjshëm, arbitrar, që përshkruhet nga një fill i dukshëm urrejtjeje përkundrejt meje, edhe një ndjesi tjetër, me karakter tragjiko-komik, të cilën po e shpreh, duke thirrur në ndihmë një shkrimtar të njohur surealist, që quhet Franc Kafka. Ky shkrimtar, në veprën (esenë) e tij, "Mbretëria e kafshëve të pyllit", përshkruan një situatë të ngjashme me sa më poshtë :

Në pyll, meqënëse vendoste monarkia, ku mbretëronte luani, nga bota e njerëzve iu tha luanit që organizimin shoqëror dhe rendi i gjërave duhet medeomos të demokratizohej dhe të mos bëhej si t'i tekej atij.

Meqënëse luani, si kafshë që ishte refuzoi, njerëzit e hoqën qafe luanin dhe morën përsipër vetë t'a demokratizonin jetën e banorëve të pyllit. Si fillim, për t'a bërë këtë, nxorrën një urdhëresë që rekrutimi në të gjitha fuksionet vendimarrëse apo zbatuese në pyll, do të bëhej me konkurs.

Një nga konkurset që u zhvillua, ishte ai për të punuar si lepur. Në këtë konkurs, mori pjesë vetëm një ari i papunë, dhe meqënëse ishte kandidaturë e vetme, ai e fitoi konkursin.

Pak, me vonë, u bë një konkurs tjetër, për të punuar si ari. Në këtë konkurs, meqënëse kriteret ishin shumë "të rrepta", mori pjesë vetëm një lepur, dhe meqënëse edhe ky ishte kandidaturë e vetme, ai e fitoi konkursin.

Një ditë, lepuri po i thoshte ariut, që kam rrogë të madhe pasi unë jam lepur dhe paguhem si ari. Duke qënë se ariu u indinjua kur e mori vesh, vendosi t'i drejtohej gjykatës për t'u ankuar.

Pas njohjes me ankesën e ariut, u mblodh trupi gjykues i përbërë nga tre leopardë dhe ftuan në seancë dëgjimore ariun edhe lepurin.

I pari, mori fjalën ariu, i cili tha shkurt. Unë jam ari dhe paguhem si lepur, ndërkohë lepuri paguhet si ari ndërkohë që është lepur. I kërkoj gjykatës t'a zgjidhë këtë punë.

Pastaj mori fjalën lepuri, i cili bëri një parashtrim të gjatë, që si bosht kryesor kishte premisën se një shoqëri demokratike ka si bazë të saj, rekrutimin e punonjësve me konkurs. Ai kishte marrë pjesë në konkursin për ari dhe kishte fituar në mënyrë të ligjshme. Për rrjedhojë, ishte e drejta e tij, që të vijonte të paguhej si ari.

Trupi gjykues, me tre leopardë, u tërhoq për të marrë vendim. Meqënëse çështja paraqitej disi e komplikuar, e panë të udhës të kërkojnë një mendim amicus quria nga një këshilltar prej botës së njerëzve.

Këshilltari nga bota e njerëzve, me shumë elegancë dhe kompetencë, iu tha leopardëve.

Të nderuar, ju takon juve të merrni vendimin, jo mua pasi në të kundërt do dhunohej parimi i dhënies së drejtësisë vetëm nga Gjykata. Megjithatë, por t'iu ndihmuar, po iu tregoj se në vija të trasha, në botën e njerëzve, ekzistojnë dy rryma të filozofisë të së drejtës, që janë:

1. Teoria formalo juridike e themeluar nga Aristoteli, Hegeli, etj, sipas të cilës norma e ligjit është koncept elitar dhe nuk është detyrë e gjyqtarit për t'a intepretuar atë, edhe në rastet kur zbatimi i saj shkon kundër rregullave të arsyes. Kjo teori, kritikohet pasi në popull shumica nuk është elitë dhe për rrjedhojë, zbatimi i normës, mbart rrezikun të mos kuptohet madje të konsiderohet si arbitraritet. Po kjo teori, ka ca që e lavdërojnë, me arsyetimin se një shoqëri nuk zhvillohet nga tërësia e anëtarëve të saj, por vetëm nga elita e saj. Për rrjedhojë, është e drejtë dhe detyrë e elitës që të përcaktojë përmes normave juridike, këmishën e forcës të cilës duhet t'i binden padiskutim, të gjithë pjestarët e shoqërisë, pavarësisht nëse janë apo jo elitë.

2. Teoria e pozitivizmit ligjor, e themeluar nga Kelzeni, Hobs, Kant, etj, sipas të cilës, norma nuk duhet zbatuar kur bie ndesh me rregullat e arsyes të gjithpranuar nga shumica e anëtarëve të shoqërisë ku zbatohet. Kjo pasi norma buron në thelbin e saj nga morali, dhe meqënëse morali ka në themel të tij, parimin e drejtësisë që jo vetëm jepet por edhe duhet te duket se po jepet, i bie që për rrjedhojë drejtësia të mos jetë vetëm laë por edhe ius, pra, jo vetëm normë, por edhe e drejtë. Edhe kjo teori ka ca që e kritikojnë, kryesisht anëtarët e elitës, me argumentin që janë vetëm ata dhe jo shumica e anëtarëve të shoqërisë, që kanë domenin e progresit shoqëror. Sipas tyre, progresi shoqëror mund të dëmtohet nga zbatimi i kësaj teorie, pasi i bie që elita të jetë e detyruar t'i nënshtrohet vullnetit të shumicës dhe për rrjedhoje elitës mund t'i kufizohet hapësira e veprimit që mund t'a ketë të nevojshme për të zhvilluar shoqërinë.

Në përfundim, këshilltari nga bota e njerëzve, i tha tre leopardëve, - ju përket juve që përmes vendimit që do jepni, të zgjidhni nëse do t'a zhvilloni shoqërinë duke dhënë drejtësi si elitë, apo do t'a zhvilloni shoqërinë sipas mendimit që keni lidhur me moralitetin dhe drejtësinë që do perceptojnë shumica e anëtarëve të shoqërisë, lidhur me vendimin tuaj. Kjo zgjedhje, ka të bëjë me integritetin tuaj të nderuar gjyqtarë, tha këshilltari nga bota e njerëzve.

Tre leopardët, nuk është se e morën vesh krejt ç'ka tha këshilltari, por dëgjuan dhe kuptuan vetëm që ai iu tha atyre "elitë". Për rrjedhojë, me pamje të vetkënaqur, <u>pasi më parë kishin parë një film</u>, dhe pa ndonjë empati për vuajtjet që do shkaktonte vendimi që do shpallnin, madje me krenari që buronte nga ndjesia e omnipotencës të qënies elitë, vendosën që lepuri do vijonte të paguhej si ari dhe ariu si lepur.

Ariu doli jashtë sallës, me pamje të përvuajtur dhe gjithashtu i tronditur. Një shok i tha, po si nuk fole më shumë, lepuri foli më shumë dhe ndoshta prandaj fitoi.

Ariu i ktheu përgjigje, - mua m'u duk se fola gjatë. Jam penduar që fola aq gjatë pasi tre gjyqtarët në fakt nuk ishin leopardë, por vetëm kanë fituar konkursin për të punuar si leopardë. Ata në fakt, ishin .... Normal që do duhej të fitonte lepuri.

PJESA E PARË:

SHKAQET E ANKIMIT

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ju lutem, kini parasysh se unë jo më kot e tregova fabulën e mësipërme. Qëllimi i parë se përse e tregova, ka të bëjë me nevojën time si njeri për t'u mos u trajtuar si ariu i fabulës, pra sikurse jam trajtuar nga Komisioni.

Për t'a shmangur këtë, ju lutem të shqyrtoni dhe jepni vendim të shprehur, nëse komisionerët që kam përmëndur në pjesën hyrëse të këtij ankimi, në rubrikën objekti, e kanë përmbushur apo jo standartin "Gjykatë e krijuar me ligj". Gjithashtu, kërkoj që në dhënien e opinionin Tuaj lidhur me këtë pikë, të zbatoni pozitivizmin ligjor dhe jo teorinë formale juridike që kanë zbatuar trupat gjykuese të KPK, (duke u ndodhur vetë ata në konflikt interesi), kur kanë shqyrtuar nëse komisionerët Pamela Qirko, Genta Tafa dhe Firdes Shuli, kanë plotësuar apo jo standartin "Gjykatë e krijuar me ligj".

Une kam bindjen se edhe Ju, sikurse unë, jemi qytetarë të lirë të një shoqërie QË FORMALISHT SUPOZOHET se është demokratike. Për rrjedhojë, as Ju dhe as unë, nuk kemi nevojë për "këmishën e forcës" të "elitës", për të dhënë kontributin tonë në progresin shoqëror të Atdheut tonë.

Tek e fundit, edhe jurisprudenca e GJEDNj në çështjen Cani kundër Shqipërisë, vë theksin se respektimi i standartit "Gjykatë e krijuar me ligj", është domosdoshmëri për respektimin e procesit të rregullt ligjor. Pra, tashmë, edhe po të zbatohet teoria formalo-juridike, që bazohet në konceptin e drejtësisë elitare, prapë se prapë, përfundimi nuk ndryshon. Kjo pasi nuk ka Elitë më të lartë në rendin juridik dhe kushtetues të Republikës Tonë, në fushën e dhënies së drejtësisë, sesa Gjykata Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Unë kam bindjen se përmes procesit që ju do të udhëhiqni, do vërtetohet që komisionerja Pamela Qirko, e ka patur mesataren 7.14 në studimet universitare që ka mbaruar në një pjesë me korrespondencë, (duke përfshirë në këtë mesatare edhe dy nota 10 në fiskulurë, që janë të vetmet nota 10, ndonëse është e dyshimtë se si korrespondenca paska patur si lëndë fiskulturën).

Po ashtu, do vërtetohet se komisionerja Firdes Shuli, ka marrë masa disiplinore për veprime që bien ndesh me rregullat e moralit shoqëror dhe madje duke u ndodhur nën trysninë e rrezikut të ndëshkimit dhe demaskimit, ka dhënë dorëheqje si gjyqtare, me qëllim për t'i shpëtuar të paktën formalisht, nderin e saj.

Gjithashtu, do vërtetohet se Alma Faskaj, është ish gjyqtare e shkarkuar.

Po ashtu do vërtetohet se edhe të gjithë Komisionerët e tjerë, të përmëndur me emër në pjesën hyrëse të këtij ankimi, sipas nenit 6 të Ligjit 84/2016, jo vetëm nuk i kanë përmbushur kriteret e zgjedhshmërisë si komisionerë, (pra kanë vepruar në kushtet e cënimit të standartit të Gjykatës së krijuar me ligj, në procesin tim të rivlerësimit), por gjithashtu, kanë vepruar edhe në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tyre, kur kanë rrëzuar kërkesat e mia për

përjashtimin e komisionerëve, mbi shkakun e mosplotësimit të standartit Gjykatë e krijuar me ligj. Kjo pasi as ata vetë nuk kanë qënë leopardët që përshkruan neni 6 i ligjit 84/2016.

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit,

Qëllimi i dytë se përse e tregova fabulën e mësipërme, ka të bëjë me faktin se komisionerët e trupit gjykues të KPK, që më kanë shkarkuar nga detyra e gjyqtarit, në vlerësimin e secilit prej tre kritereve, përdorin jo vetëm sofizma (*që është edhe e keqja më e vogël në arsyetimin e një vendimi të drejtë*) por përdorin gjithashtu edhe shtrëmbërime të të vërtetës, nuk pasyrojnë drejt rrethanat e faktit, vendosin premisa të rreme si bazë fillestare të arsyetimit, përdorin metodën e arsyetimit induktiv të vendimit[1], (*që është e gabua*r), shmangin pothuajse tërësisht metodën e arsyetimit deduktiv[2], (*që është e drejta*), dhe në përmbledhje, të gjithë këtë arsyetim, e bëjnë me qëllimin dashakeq për të treguar se ata janë elita e fabulës, pra janë ata që kanë domenin ekskluziv dhe omnipotent të intepretimit të ligjit, dhe këtë nuk e kanë gjyqtarët.

Për të qënë më konkret, po jap disa shkaqet e ankimit që parashtroj përpara Kolegjit si më poshtë:

Së pari: Sikurse jam shprehur gjatë hetimit administrativ në KPK, babai im Faik Ymeri, ka realizuar të ardhura në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, si shitës ambulant fruta perimesh, duke realizuar për këto vite, fitime ***më të ulëta apo të përafërta*** me pagën mujore në shkallë vendi, po të merret për bazë INSTAT. Kjo rezulton e vërtetuar nga një sërë provat shkresore dhe fotografi, për të cilat do shprehem më hollësisht më poshtë, kur të trajtoj pjesën përmbajtësore të ankimit tim lidhur me kriterin e pasurisë (Kujtoj se ka qenë pikërisht kjo punë e babait tim, të dalë në pension që në vitin 1992 burimi i të ardhurave me të cilat ai ka rritur dhe shkolluar në arsim e lartë tre fëmijë, rrethana këto që natyrisht nuk janë marrë në asnjë moment në konsideratë nga Komisioni).

Kjo punë e babait tim, absolutisht e provuar gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni nuk njihet se ka prodhuar të ardhura. Kjo me argumentin e përmbledhur se 1. Babai im nuk ka qënë i

[1] Sipas induksionit, arritja e përfundimit mbi një çështje të caktuar, realizohet përmes analizimit të fakteve të shkëputura dhe të veçanta, duke tentuar përgjithësimin e tyre. *P.sh.1. Të pasurit jetojnë në vila në periferi të Tiranës. 2. Një vilë e tillë, ka pishinë. 3. Altini ka një vilë të tillë me pishinë. 4. (Përfundimi), Përderisa Altini ka pishinë, me siguri ai e di notin*. Kjo metode arsyetimi nuk përdoret për vlerësimin e provave pasi ka rrezik të lartë të të çojë në konkluzione të gabuara. Ajo përdoret vetëm përjashtimisht, kur nuk ka prova, por vetëm indicie por edhe në këtë rast, rregullat e mendimit të shëndoshë juridik, kërkojnë që përpara se të përdoret kjo mënyrë arsyetimi, paraprakisht, si hap i parë, duhet arsyetuar se përse është e pamundur të përdoret arsyetimi me deduksion, dhe si hap i dytë, për të rritur nivelin e garancisë se nuk do të ndodhin gabime, duhet që indiciet të jenë të shumta, të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën. Shih psh, neni 152/2 të Kodit të Procedurës Penale, se si ekzistenca e një fakti mund të nxirret nga indiciet.

[2] Sipas deduksionit, (që është metoda kryesore e arsyetimit të një arsyetimi të shëndoshë logjik), përfundimi mbi një çështje të caktuar, arrihet duke arsyetuar duke filluar nga një ose më shumë premisa (fakte), të vlerësuara në tërësinë e tyre duke përjashtuar hipotezat që nuk janë përfundime logjike të fakteve të vlerësuara. *P.sh. 1. Toka është planet. 2. Planetet bëjnë pjesë në sistemin diellor. 3 (Përfundimi): Toka bën pjesë në sistemin diellor*. Kjo është metoda e drejtë dhe primare e një arsyetimi të shëndoshë juridik, pasi nuk mbështetet në hamendësime.

rregjistruar si shitës ambulant. 2. Nuk provohet qarkullimi ekonomik. 3. Nuk janë paguar tatimet dhe taksat në kohën e duhur. 4. Tatimet e taksat, janë paguar me vonesë, në vitin 2022, gjatë kohës që procesi im i rivlerësimit, ka qënë në zhvillim e sipër.

Paratë e fituara nga babai im, si më sipër, janë përdorur, krahas të ardhurave të tjera, për të financuar blerjen e një apartamenti në vitin 2006, që aktualisht, nga viti 2008 e në vijim, përdoret nga unë, (por që nuk është në pronësinë time).

Sipas Komisionit, unë jam shkarkuar nga detyra, pasi kam qënë i paaftë të vërtetoj që babai im ka qënë i rregjistruar, sa ka qënë volumi i qarkullimit dhe fitimi si ambulant pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, që janë paguar tatimet, etj.

Kjo ndonëse unë kam argumentuar që vërtetohet se babai im ka punuar, se ai nuk ka patur detyrim sipas ligjit, për të paguar taksa dhe tatime si shitës ambulant pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, se fitimet i ka deklaruar në ILDKPKI, vetë babai im, duke shkruar me dorën e tij në vitet 2005, 2006 dhe 2007, DPV e mia, (pra me shkrimin e tij), ndonëse nuk ka qënë i detyruar për të bërë deklarime, sipas ligjit, etj.

Në vendim Komisioni, nuk arsyeton aspak se përse është i pabazuar argumentimi im që babai im ka punuar, nuk arsyeton aspak se përse është i pabazuar argumentimi im se babai im nuk ka patur detyrim për të paguar taksa dhe tatime sipas legjislacionit fiskal të kohës, pasi ka qënë shitës ambulant pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, etj.
Heshtje totale nga Komisioni në vendimin e tij, lidhur me këtë pjesë të argumentimit tim, (shih përgjigjet e pyetësoreve dhe mbrojtjet që kam dorëzuar pasi jam njohur me rezurtatet e hetimit administrativ).

I gjithë arsyetimi i paligjshëm i Komisionit, lidhur me këto të ardhura të babait tim, është akoma më i dobët se argumentimi i tre leopardëve të fabulës. Kjo pasi të paktën këta kishin si argument ligjshmërinë e konkursit për të arsyetuar vendimin nën favor tën lepurit. Në rastin e punës dhe të ardhurave të babait tim, nuk ka asnjë argument, vetëm heshtje dhe mospërmëndje në vendim, të argumentimit tim lidhur me këto të ardhura.
Qëllimi është i qartë, ndonëse i nënkuptuar. Sipas Komisionit, fëmijët e njerëzve të varfër, që kanë qënë shitës ambulant pa vënd fiks të ushtrimit të aktivitetit, por që kanë punuar me nder dhe nuk kanë vjedhur apo bërë veprime imorale, nuk mund të jenë magjistratë, pra nuk mund të jenë elitë. Elitë mund të jenë vetëm fëmijët e leopardëve të konkursit, të cilët zënë vende punë po me konkurse në BKH apo nuset e fëmijëve të të cilëve fitojnë magjistraturën.

Janë këta fëmijë të elitës që meqënëse prindërit i kanë të pasur apo që punojnë në shtet në detyra të rëndësishme dhe influente, apo kanë prindër ose të afërm që janë bisnesmenë të rëndësishëm, të vetmit që kanë mundësi të vërtetojnë të ardhurat e prindërve të tyre.

Nëse ka ndonjë fëmijë populli të thjeshtë që është magjistrat, ai duhet te largohet nga sistemi pasi nuk mund të vërtetojë të ardhurat e prindit apo që prindi nuk ka paguar tatime, ndonëse sipas ligjit tatime nuk duhet të paguhen, pasi janë zero.

Tek e fundit, sipas Komisionit, kjo i shërben drejtësisë pasi duhen hapur vende të lira në sistem dhe besimin publik tek organet e drejtësisë, nuk mund t'a frymëzojnë fëmijët e popullit, të njerëzve të varfër, por vetëm fëmijët e elitës së fabulës, apo vetë anëtarët e kësaj elite.

Po e njëjta heshtje (duke mos u përmëndur argumentimet e mia fare) si në rastin e veprimtarisë si tregtar ambulant të babait tim, duket në vendimin e Komisionit edhe me të ardhurat e fituara nga babai im nga veprimtaria e legalizimit të dokumenteve parakonsullore, për vitet 2004-2007, nga të ardhurat e vëllait tim për vitet 2004 – 2007, nga dhënia me qera e tokës bujqësore nga babai im po për vitet 2004-2007, etj.

Vetëm nga heshtja në fjalë, është rënduar pa asnjë argument ligjor, madje as duke i përmendur në vendim argumentet e mia, bilanci financiar i familjes time të origjinës për vitet 2003-2007, (pra në kohën që unë kam qënë beqar), me rreth 2.100.000 (dymilion e njëqindmijë) lekë, nga rreth 2.700.000 (dymilion e shtatëqindmijë) gjithsejt, që ka konstatuar Komisioni për këtë periudhë kohë.

<u>Së dyti</u>: Komisioni në vendimin e ti, përsëri hesht duke mos e përmendur fare dhe aq më pak të arsyetojë kundër argumentimit tim se sipas parimit të proporcionalitetit, shuma prej rreth 2.700.000 lekë që është konsideruar si bilanc negativ për vitet 2003-2007, (pra ne kohën kur kam qënë beqar), nuk më përket mua, por tërësisë së anëtarëve të familjes time të origjinës. Për rrjedhojë, nuk duhet të më llogaritet e gjitha mua.

Kjo familje deri në vitin 2004 ka patur 5 anëtarë madhorë (babai, nëna, unë, motra vëllai) dhe pas marteses së motrës në vitin 2004, ka patur 4 anëtarë madhorë, (babai, nëna, unë, vëllai). Në vitin 2008 unë jam martuar dhe jam larguar nga familja ime e origjinës.

Kjo heshtje në vendimin e Komisionit, nuk bëhet pa qëllim. Kjo pasi Komisioni e di se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në paragrafin 96 të vendimit Antoneta Sevdari Kundër Shqipërisë, (*këtë vendim ia kam dërguar unë Komisionit, me email në datën 13.12.2022, vetëm një orë pasi është publikuar në faqen zyrtare të GJEDNj*), vendos një standart për zbatimin e parimit të proporcionalitetit lidhur me kriterin e pasurisë. Sipas këtij standarti, një bilanc negativ prej 32.000 USD, i një familje me dy persona, i shtrirë në disa vite, në vetvete, nuk mjafton për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra lidhur me kriterin e pasurisë. Kjo pasi GJEDNj ka njohur se për shkak të informalitetit të marrëdhënieve ekonomike, të kalimit të një kohe të largët, etj, do ishte kundër parimit të proporcionalitetit dhe drejtësisë, shkarkimi i subjektit të rivlerësimit.

Duke patur parasysh këtë standart, në rastin tim i bie që unë të jem në pozitë më të favorshme se subjekti i rivlerësimit Antoneta Sevdari. Kjo pasi 2.700.000 lekë :4 ≤ 32.000 USD / 2.

KPK, nuk mund të thuhet se nuk e ka ditur standartin në fjalë të GJEDNj lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Kjo pasi në vendimin e dhënë nga KPK për subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka), vendimi nr. 605, datë 21.12.2022, (**pra në të njëjtën datë me vendimin tim**), dhe ku në përbërje të trupit gjykues ka qënë komisionerja Pamela Qirko, (**që po ashtu ka qënë në përbërje të trupit gjykues të KPK, edhe në rastin tim**), Komisioni shprehet: *25.44..... Ky konkluzion i trupit gjykues, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe*

objektivitetit, është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, ku në paragrafin 96, citohet: "...gjykata vlerëson se në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave të veçanta të çështjes, shkarkimi i kërkueses, bazuar në thelb në faktin se ajo nuk ishte në gjendje të provonte se burri i saj kishte paguar tatimin mbi disa nga të ardhurat e tij nga aktivitetet e ligjshme në dy dekadat e mëparshme dhe në mungesë të ndonjë treguesi për keqbesim ose shkelje të qëllimshme nga vetë aplikanti, ishin në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura nga procesi i verifikimit".

<u>Së katërti</u>: Në vendimin e tij, Komisioni përdor metodën e arsyetimit induktiv, (që sikurse u tha është e gabuar), për të argumentuar se për apartamentin e banimit të blerë nga babai im në vitin 2006, ngrihen dyshime se është pasuri e fshehur e imja. Konkretisht, në paragrafin Komisioni shprehet:
35.5. Nga hetimi, Komisioni ka konstatuar se: (i) prindërit e subjektit kanë pasur një apartament tjetër dhe kanë kryer një shtesë kati mbi këtë apartament në vitin 2008; (ii) ky apartament është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës që subjekti ka kryer detyrën e gjyqtarit; (iii) subjekti ka dhënë kontributin e tij financiar për krijimin e kësaj pasurie; (iv) subjekti dhe bashkëshortja kanë banuar në këtë apartament nga momenti i martesës e në vijim, ndërsa familjarët e tij nuk kanë banuar asnjëherë në të; (v) pamundësi financiare të subjektit për të mbuluar me të ardhurat e tij blerjen e këtij apartamenti.
35.6. Në vlerësimin e këtyre fakteve Komisioni është ndriçuar edhe nga jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në mënyrë specifike në paragrafin 14.15 të vendimit nr. 10/2022. → Për pasojë, Komisioni ka ngritur dyshimet për fshehjen e pasurisë apartament nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke i kaluar barrën e provës.

Ky arsyetim në vendimin e Komisionit, ngjan me shëmbullin e arsyetimit induktiv që unë dhashë më sipër. *1. Të pasurit jetojnë në vila në periferi të Tiranës. 2. Një vilë e tillë, ka pishinë. 3. Altini ka një vilë të tillë me pishinë. 4. (Përfundimi), Përderisa Altini ka pishinë, me siguri ai e di notin*.

Kjo metode arsyetimi nuk përdoret për vlerësimin e provave pasi ka rrezik të lartë të të çojë në konkluzione të gabuara. Ajo përdoret vetëm përjashtimisht, kur nuk ka prova, por vetëm indicie por edhe në këtë rast, rregullat e mendimit të shëndoshë juridik, kërkojnë që përpara se të përdoret kjo mënyrë arsyetimi, paraprakisht, **si hap i parë**, duhet arsyetuar se përse është e pamundur të përdoret arsyetimi me deduksion, **dhe si hap i dytë**, për të rritur nivelin e garancisë se nuk do të ndodhin gabime, <u>duhet që indiciet të jenë të shumta, të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën</u>. Shih psh, neni 152/2 të Kodit të Procedurës Penale, se si ekzistenca e një fakti mund të nxirret nga indiciet.

Kjo metodë arsyetimi me induksion, është e gabuar për shkak se në rastin tim, **së pari**, kam paraqitur prova të qarta se është e pamundur të përjashtohet arsyetimi me deduksion që të çon në konkluzionin se apartamenti në fjalë, nuk është pasuri e fshehur e imja. **Gjithashtu**, këto prova, minimalisht, <u>janë më të rëndësishme</u> po të vlerësohen me logjikë, <u>se</u> "faktet" që konsideron prova Komisioni për të arritur në përfundimin e apartamenti në fjalë, është pasuri e fshehur e imja.

<u>Konkretisht, po të arsyetohej me deduksion, do vlerësoheshin si prova që apartamenti në fjalë, nuk është pasuri e fshehur e imja, faktet e mëposhtme:</u>

1. Unë e kam deklaruar këtë apartament, në kohë reale, pra në DPV 2006 dhe në vijimësi, e kam deklaruar kur jam pyetur ngha ILDKPKI në vitet 2009, 2011, 2015, në dekleratën veting, në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, ***pra gjithmonë***. Unë kam dhënë gjithmonë llogari për këtë pasuri, duke mos synuar në asnjë moment të fsheh të dhëna as lidhur me krijimin e saj dhe as me burimet që kanë shërbyer për blerjen e saj, që janë kontributet e përbashkëta të të gjithë anëtarëve të familjes time të origjinës.

2. DPV 2006, në të cilën është deklaruar për herë të parë krijimi i kësaj pasurie dhe burimet e krijimit të saj, DPV 2005, DPV 2007, 2008, janë shkruajtur me shkrimin e dorës së babait tim, (*këtë ia kam vërtetuar Komisionit, por Komisioni nuk e përmend në vendimin e tij*). Kjo tregon se babai im përmes plotësimit të DPV 2006 dhe të gjithave DPV në fjalë, me shkrimin e tij, ***indirekt dëshmon*** se përmbajtja e deklarimit tim, lidhur me këtë pasuri është e vërtetë. ***Kjo dëshmi e babai tim është bërë në kohë reale, pra ne vitet 2005 dhe 2006, pra 10 vjet përpara se të miratohej legjilacioni për procesin e vetingut dhe 15 vjet përpara se të zhvillohej procesi im i rivlerësimit***.

3. Kam paraqitur prova të qarta lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, si dy huadhënie (që rezultojnë nga akte noteriale të kohës së hartimit), të ardhurat nga aktiviteti i babait, paga ime, nënës time, dhënia me qera e tokës bujqësore, etj. Këto prova nuk janë prodhuar gjatë kohëzgjatjes së procesit të rivlerësimit, por në kohën e krijimit të pasurisë, ose edhe përpara kësaj kohe. (Në vijim të këtij ankimi do shprehem më hollësisht).

4. Këto prova i kam paraqitur edhe në ILDKPKI kur jam pyetur në vitet 2009, 2011 dhe 2015.

5. Kam paraqitur deklerata noteriale të babait, nënës, vëllait, huadhënësve, etj, që konfirmojnë të dhënat që rezultojnë nga provat e mësipërme.

6. Vendimet e KPA tek të cilat bën referencë Komisioni në vendimin e tij, lidhur me subjektet e rivlerësimit Alfred Gjoni dhe Arjan Balliu, nuk kanë bazë krahasimi me rastin tim. Kjo pasi unë në ndryshim prej tyre, duke filluar nga viti 2006 (koha që është krijuar pasuria) dhe në vijim, gjithmonë, sa herë jam pyetur, e kam deklaruar apartamentin në fjalë dhe burimet e tij, ndërsa ata nuk e kanë deklaruar në kohë reale por vetëm kur i është zbuluar me denoncime anonime ose kur janë pyetur nga Komisioni, ose në lidhje me këto pasuri kanë bërë deklarime që bien ndesh me të dhënat e deklaruara nga ata në gjendjen civile më parë.

7. Familja ime e origjinës, ndryshe nga arsyeton Komisioni, ka patur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

8. Dashuria prindërore dhe vëllazërore, (që janë fakte të ditura), e shndërron në diçka të mirëkuptueshme dhe të ditur, faktin që apartamenti i banimit që është blerë me kontributet e të gjithë anëtarëve të familjes time të origjinës, më është lënë mua për banim nga prindërit dhe vëllai, duke filluar nga viti 2008, pasi kam krijuar familjen time të re. Kjo pasi anëtarët e një familjeje kanë solidaritet me njëri tjetrin, se prandaj janë familje, prandaj janë ndër njerëzit me të

dashur, babai, nëna, fëmija, vëllai. (Prandaj, unë p.sh i kam dhënë hua vëllait tim, pa interes, pa ia kërkuar kurrë të mi kthente një shumë të madhe parash, kur ai ka patur nevojë, prej 2.200.000 (dymilion e dyqindmijë) lekë në vitet 2014, 2015, gjë që është gjetur si e ligjshme nga hetimi i vetë Komisionit).

9. Unë duke filluar nga DPV 2006 dhe deri në procesin tim të rivlerësimit, gjithmonë e kam bërë të qartë se kontributi im për blerjen e apartamentit në vitin 2006, ***përfaqësohet vetëm nga kursimet e pagës time***. Nuk ka asnjë të dhënë që unë të kem as pretendime dhe aq më pak ndonjë titull juridik, që të mos ketë proporcionalitet me masën e kontributit tim në krijimin e kësaj pasurie. P.sh, kontributi të jetë 10 lekë ndërsa pjesa ideale e pretenduar të jetë 15 lekë.

10. Ndryshe nga sa pretendon Komisioni në vendimin e tij, unë nuk jam sjelle ndonjëherë si pronar i vetëm i kësaj pasurie. Kjo pasi vetë fakti i kalimit të 16 vjetëve nga blerja e apartamentit, (që është e pamohueshme se është kohë shumë e gjatë), kohë në të cilën nuk kam ushtruar ndonjë të drejtë, që mund të konsiderohet si e drejtë disponimi mbi këtë apartament, (*të tillë si servitut real, dhënie me qera, rivlerësim pasurie, ndryshime strukturore të apartamentit, (p.sh prishje muresh të brëndshme, heqje/ndryshime/vendosje pllakash apo pajisjesh që mund të konsiderohen pjesë përbërëse e apartamentit, si dritare, punimesh gipsi, etj), lidhje të kontratës së furnizimit të apartamentit me energji elektrike ose të furnizimit me ujë apo shërbim telefonik/internet, në emrin tim*), është tregues i qartë se nuk jam sjellë ndonjëherë si pronar i këtij apartamenti. Në vendimin e tij, Komisioni bën e dashje të padituri, duke mos bërë dallimin se e drejta e posedimit dhe/apo përdorimit të sendit, (që unë e ushtroj mbi apartamentin), konsiderohet si e drejtë pronësie, ***vetëm kur ka tregues se mbi këtë send, mbajtësi ka ushtruar për gjatë rrjedhës së kohës, ndonjë të drejtë reale, që ka tiparet e të drejtës së disponimit***. Kjo pasi është pikërisht ekzistenca e tagrit të disponimit, që e dallon pronarin e sendit nga poseduesi apo mbajtësi. (shih Kodin Civil).

11. Ndryshe nga sa pretendon Komisioni, nuk është e vërtetë që e kam përdorur vetëm unë apartamentin. Kjo pasi gjatë rrjedhës së kohës, ka patur periudha të gjata kohe që këtë apartament e kanë përdorur edhe prindërit e mi, po natyrisht bëria e këtij fakti publik nga ana jonë nuk është vlerësuar i nevojshëm. Këtë e kam vërtetuar me deklerata noteriale dhe me shpjegimet që kam dhënë por do shprehem më hollësisht në vijim.

Të gjitha faktet e mësipërme, <u>që Komisioni nuk i përmënd në vendimin e tij në pjesën më të madhe të tyre</u>, po të vlerësohen në sintezë, e bëjnë të qartë se përse me arsyetim deduktiv hidhet poshtë konkluzioni i Komisionit se ky apartament, është pasuri e fshehur e imja.

Madje, edhe po të përdoret arsyetimi induktiv që përdor në vendimin e tij Komisioni, (i tipit p.sh *1. Të pasurit jetojnë në vila në periferi të Tiranës. 2. Një vilë e tillë, ka pishinë. 3. Altini ka një vilë të tillë me pishinë. 4. (Përfundimi), Përderisa Altini ka pishinë, me siguri ai e di notin*), për vlerësimin e këtyre fakteve, përsëri përfundimi nuk ndryshon.

Kjo pasi faktet e mësipërme, (që do t'i shtjelloj më hollësisht tek kriteri i pasurisë), edhe po të konsiderohen si indicie, në funksion të mbështetjes se konkluzionit se nuk ka fshehje pasurie, <u>përsëri dhe qartësisht, janë më të shumta, më të rëndësishme dhe lidhen më mirë me njëra tjetrën,</u>

se faktet që përdor si indicie Komisioni për të argumentuar se kam fshehur pasuri lidhur me apartamentin në fjalë.

Së pesti: Në arsyetimin e vendimit të tij, Komisioni përdor sofizma[3] me qëllim për të arritur në rezultatin e dëshiruar. Konkretisht, për të më nxjerrë me bilanc negativ në shumën rreth 2.700.00 lekë në kohën që kam qënë beqar, (vitet 2003-2007), përdor si premisë fillestare bazë, premisën e rreme se apartamenti i blerë në vitin 2006, me kontributet e familjes time të origjinës, në fakt është pasuri e fshehur e imja. Për rrjedhojë, të gjithë bilancin negativ të nxjerrë për blerjen e apartamentit, (që sikurse do shihet në vijim të arsyetimit të këtij ankimi, as ai nuk qëndron), m'a faturon mua, dhe në përmbyllje arrin në konkluzionin se duhet të shkarkohem se nuk justifikoj pasurinë me burime të ligjshme.

Përse vendos Komisioni në arsyetim, premisën e rreme, se apartamenti është pasuria e imja e fshehur !!

Kjo është e qartë. Kjo pasi në të kundërt, nëse do konsiderohet se nuk është pasuri e fshehur, (ashtu sikurse është e vërteta), atëherë Komisioni do detyrohej të zbatonte parimin e proporcionalitetit, njësoj si në vendimin e GJEDNj Antoneta Sevdari Kundër Shqipërisë, apo vendimin nr. 605, datë 21.12.2022 për subjektin Armida Hamiti (Moçka), ku ka qënë anëtare edhe komisionerja Pamela Qirko dhe që për më tepër është marrë në të njëjtën datë me vendimin tim, që unë po ankimoj.

Sipas këtij parimi proporcionaliteti, vlera e pasurisë së apartamentit, do duhej pjestuar me 4 (babai, nëna, unë dhe vëllai), dhe qartësisht vlera e rezultuar si bilanc proporcional në ngarkimin tim, nuk do të ishte e mjaftueshme që ndaj meje të merrej masa e shkarkimit nga detyra. Pra, nuk do konsiderohej rasti im i ndryshëm nga rasti i subjektit Armida Hamiti, që në të njëjtën ditë që unë u shkarkova nga Komisionerja Pamela Qirko, po kjo Komisionere, e konfirmoi këtë subjekt. Kjo ndonëse pozita e saj, në krahasim me mua ishte më e keqe, pasi vlerat e bilancit negativ, ishin shumë më të mëdha, dhe përveç kësaj, ajo, ndryshe nga unë, e kishte të rregjistruar apartamentin në emër të saj, si pronësi e vetme e saj, në rregjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, (rregjistrim ky që përbën akt zyrtar me fuqi të plotë provuese).

Së gjashti: Për peridhën 2008-2016, (periudha pasi jam martuar) që sipas Komisionit (por jo sipas meje) unë rezultoj me bilanc negativ kumulativ në shumën rreth 1.800.000 (njëmilion e tetëqindmijë) lekë, Komisioni deformon të vërtetën duke prodhuar në mënyrë voluntariste, bilance negative fiktive. Konkretisht:

1. Në vitin 2008 nuk më llogarit si burim të ardhurash, duke më zbritur nga shuma prej 600.000 lekësh, pas asnjë shpjegim të ligjshëm, një shumë prej 150.000 lekësh të përfituara nga dhuratat e dasmës dhe lindjes së djalit. Kjo ndonëse në raportin për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ, të prillit 2016, m'a kishte njohur më parë. Kjo edhe ndonëse unë e kam deklaruar

[3] Sofizmi është një mënyrë arsyetimi që përdor një premisë të rreme fillestare por që në pamje të parë duke e drejtë, si bazë të arsyetimit, dhe në vijim e pason këtë premisë fillestare të rreme, me premise të tjera që është mund të jenë të drejta, por konkluzioni i arsyetimit del i gabuar*: p.sh. Çdo njeri e ka atë që nuk e ka humbur/njeriu nuk ka humbur brirët/njeriu ka brirë.* Ky arsyetim ka premisën fillstare të rreme, pasi njeriu nuk e ka humbur atë që nuk e ka patur kurrë.

në DPV 2008 dhe në shpjegimet më shkrim të dhëna në ILDKPKI në vitet 2011 dhe 2015 këtë të ardhur, si dhe gjithashtu e kam deklaruar në dekleratën veting dhe në përgjigjet e pyetësorëve. Komisioni shprehet në vendim se lidhur me këtë shumë, meqënëse është ricelur hetimi administrativ, me kërkesën time, atëherë, nga hetimi i ri (ndonëse nuk është marrë asnjë prove e re në raport me hetimin e mëparshëm) del se kjo shumë duhet të më zbritet nga shuma prej 600.000 lekë, por pa më thënë përse. *Kësaj i thonë, si ajo barcoleta e gjithëditur, e ujkut me lepurin: me filtër, pa filtër, ku e ke kapelen*.

2. Komisioni nuk më njeh dhuratën e vjehrrës me rastin e dasmës në shumën 150.000 lekë, që në fakt është pjesë e pajës së nuses time. Kjo pa asnjë arsyetim dhe kundër ligjit pasi sjellja e pajës nga ana e nuses përbën fakt të njohur botërisht. Kjo edhe pse provohet që unë e kam deklaruar këtë dhuratë që DPV 2008, në shpjegimet me shkrim në ILDKPKI, në dekleratën veting, në përgjigjet e pyetësorëve, në një dekleratë noteriale të vjehrrës time, etj. Gjatë procesit, Komisioni refuzoi t'a pyeste si dëshmitare vjehrrën, me arsyetimin se pyetja e saj është e panevojshme. Komisioni nuk ma njohu këtë të ardhur, pa më bërë me dije asnjë analizë që vjehrra ime kishte bilanc negativ dhe për rrjedhojë e kishte të pamundur të ma'a dhuronte këtë shumë. (Për këtë do të shprehem në vijim të këtij ankimi më hollësisht).

3. Komisioni nuk më njeh dhuratën e babait tim në rastin e martesës në shumën 300.000 lekë, pa arsyetim të ligjshëm. (Edhe për këtë do të shprehem në vijim të këtij ankimi më hollësisht).

4. Komisioni, më rrit në mënyrë artificiale shpenzimet e mobilimit, duke më përjashtuar mobiljet që i kam patur dhuratë, duke më shkaktuar kësisoj një bilanc negativ në vitin 2008 dhe 2009, rreth 600.000 lekë. Edhe kjo do shtjellohet më hollësisht në vijim të këtij ankimi.

Në përmbledhje, të indikatorëve të mësipërm, komisioni në vendimin e tij dhe analizën financiare që ka kryer, shkakton një bilanc fiktiv negativ, mbi 1.200.000 (njëmilion e dyqindmijë) lekë për periudhën 2008-2016. Evidentoj se Komisioni gjithsejt për këtë periudhë, ka nxjerrë gjithsejt nga 1.800.000 (njëmilion e tetëqindmijë) lekë bilanc negativ. Nga tërësia e këtij bilanci total për këtë periudhë kohe, mbi 2/3 është tërësisht fiktiv, e nxjerrë mbi bazë subjektivizmash, pa asnjë arsyetim logjik të shëndoshë, dhe madje duke rënë shpeshherë në kundërshtim më njëri tjetrin dy analizat financiare që ka bërë vetë Komisioni. (Edhe për këtë do shprehem në vijim më hollësisht).

<u>Së shtati</u>: Edhe për pjesën tjetër të bilancit negativ kumulativ për vitet 2008-2016, që unë e kam pranuar, por duke shpjeguar përmes provave dhe fakteve, se ai nuk është i tillë në vetvete por ka ardhur si pasojë e pasaktësive në deklarim/raportim, Komisioni në vendimin e tij shprehet përmbledhtas se "*Komisioni nuk krijon bindjen se pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pjesë të bilancit negativ, është i bazuar. Kjo pasi gjatë procesit subjekti manifestoi si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë gjykimit, aftësi të qartë për të kuptuar se si bëhet vlerësimi i pasurisë në procesin e rivlerësimit*". Pra, sipas Komisionit, meqënëse ai ka konstatuar se nuk jam i pazgjuar, atëherë përjashtohet mundësia që në dy vitet kur rezultoj me bilanc negativ, të kem gabuar pa dashje në plotësimin e DPV-ve përkatëse.

Hajde arsyetim hajde. Dmth, sipas Komisionit njeriu lind i zgjuar dhe nevojat që ai ka përgjatë rrjedhës së kohës, nuk kanë asnjë kontribut në rritjen e nivelit të diturisë së tij.

Megjithatë, pavarësisht vlerësimit në dukje të shkallës së zhvillimit tim mendor, që më është bërë nga leopardët e fabulës, unë e përçmoj këtë lloj vlerësimi. Kjo edhe nën dritën e ditur të motivit që e ka shtyrë Komisionit që të bëjë këtë vlerësim.

Së teti: Lidhur me mundësinë e krijimit të bonove të thesarit për vitet 2009-2016, Komisioni paligjshmërisht, përmes lojrave të fjalëve, shtrëmbërimit të fuqisë provuese të provave apo moscitimit të fakteve dhe provave, nuk më ka njohur si burime të ligjshme sa më poshtë:

-1.000.000 (njëmilion) lekë depozita që ka tërhequr bashkëshortja ime nga Raiffeisen bank në vitin 2009.
- Kredine 1.500.000 (njëmilion e pesëqindmijë) lekë të marrë në Tirana Bank në vitin 2012.
- Kredine 800.000 (tetëqindmijë) lekë të marrë në Procredit Bank në vitin 2012.
- Huate nga babai në shumën 400.000 lekë.
Huate nga babai në shumën 400.000 lekë.
-5000 Euro borxh nga djali im i xhaxhait Olsi Ymeri ndonëse nga analiza financiare që ka bërë vetë Komisioni rezulton që ai ka patur të ardhura të mjaftueshme për të m'a dhënë huanë në fjalë.

Kësisoj, Komisioni më ka krijuar fiktivisht, (në kundërshtim me të vërtetën dhe provat e paraqitura prej meje), gropa financiare joreale në mundësitë e mia për blerjen e bonove të thesarit për këtë periudhë kohe. Për këtë pjesë, do shprehem më hollësisht, në atë pjesë të ankimit, ku do të trajtoj kriterin e pasurisë.

Së nënti: Komisioni, duke shkelur haptazi parimin e barazisë, në kundërshtim me standartin identik të vendosur nga Kolegji për subjektin e rivlerësimit Astrit Kalaja, një shumë prej 1.850.000 lekë të depozituar nga babai im në Tirana Bank, si depozitë me afat 2 vjeçar, në vitin 2009, (pra, pasi unë jam larguar që në vitin 2008, për shkak martese, nga njësia familjare e origjinës), m'a ka konsideruar si pasuri se ngrihen dyshime se është pasuri e fshehur e imja.

Kjo me arsyetimin përmbledhtas se: *1. Kjo depozitë është lënë kolateral nga babai im për të garantuar një kredi në shumën 1.500.000 lekë, që unë kam marrë pas pak ditësh nga data që babai ka depozituar shumën në fjalë. 2. Sipas Komisionit kjo nuk ka logjike ekonomike, (duke u lënë të nënkuptohet se unë nuk kisha përse të merrja kredinë, pasi mund t'i merrja borxh babait). 3. Familja e babait nuk ka patur burime për të krijuar depozitën*.

Ky arsyetim i Komisionit, (që nuk mund të klasifikohet ndonëse i ngjason arsyetimit induktiv të sipërpërmëndur), faktikisht, përfaqëson një shtrëmbërim të së vërtetës. Kjo pasi:

1. Sikurse do shihet në vijim të këtij ankimi, kur të trajtohet në mënyrë të hollësishme kjo problematikë, familja e babait tim, e përbërë nga babai pensionist, nëna pensioniste, vëllai im avokat, nusja e vëllait mësuese, kanë patur burime të ligjshme për t'a kursyer shumën në fjalë. Kjo edhe po t'iu shtohen burimeve të të ardhurave të tyre, një dëmshpërblim mbi 800.000 lekë të përfituar nga nëna ime si pasojë e një largimi të padrejtë nga puna.

2. Babai, vëllai, nëna, bashkëshortja e vëllait, nuk kanë qënë ndonjëherë subjekte dekleraruese në ILDKPKI si dhe procesi i rivlerësimit nuk shtrihet ndaj tyre. Për rrjedhojë, sipas juriprudencës së konsoliduar të Kolegjit, lidhur me persona të tjerë të lidhur, analiza e burimeve financiare të tyre duhet kufizuar brënda shumës që përbën objektin material të marrëdhënies ekonomike që kanë këta persona më subjektin e rivlerësimit. Kjo pasi, sipas Kolegjit, personat e tjerë të lidhur, nuk duhen barazuar në status me vetë subjektin e rivlerësimit.

3. Transaksioni, që sipas komisionit nuk ka logjikë ekonomike, në të vërtetë ka. Kjo pasi babai do përfitonte interesa bankare nga depozita, dhe unë nuk mund t'i kërkoja që ai të prishte depozitën. Nga ana tjetër, marrëdhënia e afërt familjare, do t'a përjashtonte mundësinë që babai të m'i jepte hua, paratë që unë kam marrë kredi, me interes, sikurse banka.

4. Nuk ka asnjë provë/fakt/indicie/të dhënë, që shumën e depozitës prej 1.850.000 lekë që figuron në emër të babait tim, në vitin 2009, pas tërheqjes nga babai im, t'a kem përdorur unë apo persona të lidhur me mua, apo unë të kem përfituar ndonjë dobi prej saj përveç faktit që babai im e ka lënë kolateral në bankë për të garantuar kthimin e një kredie që unë kam marrë në rrethanat e lartëpërmëndura.

5. Pavarësisht se unë në mënyrë të përsëritur i kërkova komisionit të lejohem t'i thërras si dëshmitarë, babain, nënën, vëllain, kjo gjë m'u refuzua pasi u vlerësua e panevojshme. Atëherë kërkova që të thirren si persona të tretë, që e kanë të përbashkët çështjen me mua, dhe prapë kjo m'u refuzua, (ndonëse ky vendim i ndërmjetëm për thirrjen e personave të tretë, sikurse do të shihet në vijim të ankimit, është i paligjshëm).

Atëherë - a mund të më thuhet nga Kolegji, nëse Komisioni m'a ka ngarkuar me të drejtë barrën e provës për të vërtetuar se depozita në fjalë nuk është pasuri e fshehur e imja, apo në mënyrë të padrejtë. Po ashtu, të më thuhet, si mund t'a përmbush unë të kundërtën e barrën e provës, kur nuk më vlerësohen si duhet provat dhe faktet e favorshme të lartëpërmëndura, kur nuk lejohem të pyes dëshmitarë, nuk lejohem të thërras persona të tretë, ***pra pengohem në të gjitha mundësitë faktike që ekzistojnë për t'a përmbysur barrën e provës***. Në vlerësimin tim, ky është veprim keqdashës i Komisionit.

<u>Së dhjeti</u>: Në vendimin e tij Komisioni, shprehet se dyshohet që një automjet Ford Fokus, i vitit 2001, është pasuri e fshehur e imja. Në vendim nuk jepet asnjë lloj argumentimi logjik ku është mbështetur Komisioni në arritjen e këtij përfundimi, përveç konstatimeve se ky automjet përdoret nga krahas vëllait tim, edhe nga bashkëshortja ime.

Këtë gjë si unë ashtu edhe bashkëshortja ime e kemi deklaruar që në DPV përkatëse, në të gjitha DPV pasuese, në dekleratën veting, në përgjigjet e pyetësorëve që i kam dërguar Komisionit, në materialet e mbrojtjes time përpara Komisionit, etj. Pra kam qënë konseguent në deklarimin që me lejen e vëllait tim, bashkëshortja ime e përdor ndonjëherë këtë automjet).

Sipas vendimit të Komisionit, meqënëse nga verifikimi i policave të sigurimit, në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, ka rezultuar që një policë sigurimi, për vitin 2016, figuron në emër të bashkëshorteës time, atëherë Komisionit i krijohet bindja se kjo është pasuri e fshehur e imja.

Komisioni në arritjen e këtij konkluzioni, qartësisht fsheh provat, ose i shtrëmbëron ato: Konkretisht:

1. Provohet nga analiza financiare e vitit 2014, që familja e origjinës së vëllait tim, ka patur burime të ligjshme për të blerë automjetin, fakt i cili në përfundim pranohet edhe nga vetë Komisioni.

2. Unë nuk kam patur automjet tjetër në pronësi në kohën kur është blerë ky automjet dhe prandaj vëllai im, meqënëse kishte dy të tilla, ia la në përdorim bashklëshortes time. Në vijim të ankimit do evidentohen edhe një herë rrethanat që ia kam shpjeguar Komisionit por që prej tij në mënyrë abuzive konsiderohen si jo bindëse.

3. Unë kam patur burime të ligjshme për t'a blerë këtë automjet, dhe për rrjedhojë, nuk do të kisha asnjë arsye për t'a fshehur këtë fakt.

4. Të gjitha policat e sigurimit ndër vite figurojnë në emër të vëllait tim dhe po ashtu, i gjithë dokumentacioni ndër vite i automjetit.

Më poshtë, do ndalem hollësisht në këtë pasuri të vëllait tim, por tani e evidentova, vetëm në mënyrë të përgjithshme dhe shumë të përmbledhur.

Kjo me qëllim për të nxjerrë në pah se deri ku shkon keqdashja e Komisionit në interpretimin e ligjit dhe të fakteve. Kjo me qëllimin e vetëm, për të krijuar kakofoni, për të hedhur baltë sa më shumë mbi mua dhe duke shpresuar se sa më shumë baltë hidhet mbi mua, unë prapë do mbetem pis, sado që të përpiqem të lahem.

Shpifjet dhe abuzimi i Komisionit në vendimin e tij, dalin akoma më shumë në pah, po të krahasohet pozita ime lidhur me këtë automjet, në raport me pozitën e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, që po ashtu sikurse unë, është gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ky subjekt rivlerësimi, ka deklaruar se ka blerë një automjet luksoz që 4000 euro, pra më shumë se automjeti në vlerë 350.000 lekë që ka blerë vëllai im në vitin 2014. Subjekti Arbër Çela, automjetin e ka blerë në vitin 2016. Nga procesi i hetimit të rrethanave të rivlerësimit të këtij subjekti, ka rezultuar se ai ka dalë 10 herë jashtë shtetit me automjetin që ka blerë, përpara kohës kur e ka blerë.

Në kohën kur ka udhëtuar 10 herë jashtë shtetit subjekti Arbër Çela me këtë automjet, pronari zyrtar i automjetit ka udhëtuar vetëm një herë, por edhe këtë herë, nën shoqërinë e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela.

Në dallim nga unë, subjekti Arbër Çela, nuk e ka deklaruar ndonjëherë në ILDKPKI përdorimin e këtij automjeti. Ai ka dhënë shpjegime vetëm kur është pyetur nga Komisioni.

Po në dallim nga unë, në kohën që ka bërë udhëtimet, subjekti Arbër Çela, nuk ka patur mundësi financiare t'a deklaronte të blerë këtë automjet. Këtë fakt e ka deklaruar, vetëm pasi i është krijuar mundësia financiare.

Tani, vendimi për konfirmimin në detyrë të subjektit Arbër Çela, është marrë me datën 07.12.2022, pra 14 ditë përpara se të merrej vendimi nr. 604, datë 21.12.2022, me të cilin unë jam shkarkuar nga KPK.

Atij nuk i është quajtur pasuri e fshehur ky automjet. Mua më quhet pasuri e fshehur. Si në rastin tim ashtu edhe në rastin e tij, anëtare e trupit gjykues ka qënë komisionerja Genta Bungo.

Ka një dallim tjetër ndërmjet dy rasteve. Unë nuk e kam vëllanë drejtues të Prokurorisë pranë Shkallës së Parë Tiranë dhe as bashkëshorten e vëllait gjyqtare në Gjykatë të Lartë. Ndoshta, kjo rrethanë e justifikon trajtimin e ndryshëm ndërmjet dy rasteve, ndonëse rrethanat e mia janë ku e ku më të favorshme të rrethanat e subjektit të rivlerësimit në fjalë.

Se harrova, ka edhe dy dallime të tjetëra. Unë jam shkodran, pra verior, ndërsa Arbri është nga Lushnja. Është fakt i ditur botërisht se Komisionerja Genta Bungo, (që vetë është nga zona e parë operative), është bërë barcaletë jo vetëm në rrjetet sociale por edhe në një dosje që është në hetim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, (prokuror Drini Pali), lidhur me respektin që ajo ka për veriorët.

Dallimi tjetër ndërmet dy rateve ka të bëjë me faktin se unë, ndryshe nga Arbri, guxova të demaskoj ballas, sy më sy, komisioneret Genta Bungo, Pamela Qirko dhe Firdes Shuli, se ata janë zgjedhur në detyrë në kundërshtim flagrant me nenin 6 të ligjit 84/206, pasi njëra nuk plotëson vjetërsinë në punë për t'u konsideruar juriste e shquar, (dhe ka dyshim serioz se ka marra masa disiplinore), tjetra ka mesatare 7.14 të studimeve universitare (dhe madje ka dyshim serioz se edhe kjo mesatare nuk është e vërtetë pasi ka marrë dy nota 10 në fiskulturë ndërkohë që fakultetin e ka mbaruar me korrespondence), ndërsa e fundit përbën një personazh anekdotik pasi ka marrë masa disiplinore ndërkohë që ka qënë gjyqtare dhe ka dhënë dorëheqjen nga detyra nga frika dhe nevoja për t'i shpëtuar demaskimit për kryerjen prej saj të veprimeve flagrante që bien ndesh me moralin shoqëror. Pra, që të tre këta komisionerë janë fiks si ata leopardët e fabulës që përshkrova më sipër.

Janë këta komisionerë që për hakmarrje, kanë marrë vendimin që unë po ankimoj. Janë këta komisionerë që nuk kanë turp të veprojnë me dy, tre apo më shumë standarte,

P.sh, në rastin e subjektit të ri rivlerësimit Arbër Çela, komisionerja Genta Bungo, blerjen e apartamentit nga ky subjekt rivlerësimi, së bashku me një shtetase tjetër, në raportin 1/2 secili, e heton dhe vlerëson ndryshe nga rasti im kur unë apartamenti i vitit 2006 është blerë me kontributet e përbashkëta të miat, babait, nënës dhe vëllait. Kjo komisionere subjektit Arbër Çela i ngarkon barrë prove dhe e vlerëson vetëm për një të dytën e vlerës së apartamentit, dhe kjo ndonëse provohet se bashkë investitorja tjetër nuk ka patur absolutisht fare burime për blerjen e "pjesës së saj takuese".

Po kjo komisionere, huanë që subjekti i rivlerësimit Arbër Çela e ka deklaruar vetëm kur është pyetur gjatë hetimit administrativ, (*ndryshe nga unë që i kam deklaruar dy huatë e shtetasve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, që ka marrë babai im për blerjen e apartamentit, gjithmonë*), e

konsideron veprim jo të ndëshkueshëm, (prapë ndryshe nga unë që më penalizon pa ndonjë arsyetim bindës dhe të qartë por vetëm me lojra fjalësh).

Po kjo komisionere, këtë hua që ka marrë subjekti i rivlerësimit vetë personalisht, (*ndryshe nga unë që jam detyruar që të jap shpjegime për dy hua që nuk e kam marrë unë por babai*), pavarësisht se provohet se huadhënësi nuk ka patur burime të ligjshme, nuk e konsideron si fakt penalizues, ndryshe nga unë që ndëshkohem për dy hua që ka marrë babai dhe për më tepër, në kundërshtim me ligjin 84/2016, pasi huadhënësit e babait tim, qartësisht nuk konsiderohen si "persona të tjerë të lidhur" me personin tim. Kjo pasi asnjëri prej tyre nuk është përfshirë drejtëpërdrejtë, në ndonjë marrëdhënie juridike me mua, si hua, dhurim, etj.

Dhe qershia mbi tortë. Komisionerja Genta Bungo vendimin konfirmues për subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, e merr me datën 07.12.2022, pra para dy javësh (14 ditë), nga data që po e njëjta komisionere merr vendimin për shkarkimin tim nga detyra, se bashku me dy koleget e saj. Unë mendoj se çdo njeri normal vlerëson se dy javë janë shumë pak për të arritur në përfundimin se Komisionerja Genta Bungo ka përjetuar ndonjë gjendje amnezie. Për rrjedhojë, dy janë mundësitë, ose më ka ndëshkuar mua paligjshmërisht, ose ka favorizuar subjektin Arbër Çela paligjshmërisht. Veprimi arbitrar diskriminues, ka dy anë të medaljes, ose i jep një tjetri privilegje të padrejta ose i mohon tjetrit të drejta të ligjshme. Unë mendoj se Komisioni në vendimin tij, mua më ka mohuar të drejta të ligjshme.

Komisionerja Pamela Qirko në vendimin e saj për subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti, (*që është nga Vlora ndryshe nga unë që jam krenar që jam Shkodran*), i marrë në të njëjtën ditë me vendimin tim, i njeh këtij subjekti rivlerësimi si të ardhura të ligjshme, mbi 50.000 euro që babai i saj i kishte fituar nga vjelja e ullinjve, (ndryshe nga mua që nuk më njeh një vlerë më pak se 1/5 e këtij subjekti, që ka fituar babai im si shitës ambulant fruta perimesh, etj).

Po kjo komisionere, për subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti, e zbaton parimin e proporcionalitetit që përmëndet në paragrafin 96 të vendimit të GJEDNj Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë. Tek unë, nuk e zbaton. Lind pyetja: -mos vallë edhe kjo komisionere vuan nga amnezia, ndonëse vendimi për subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti është shpallur vetëm 15 minuta pasi është shpallur vendimi im.

Po komisionerja Pamela Qirko ka votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri, 30 minuta pasi ka shpallur vendimin për shkarkimin tim nga detyra, pra të dy vendimet janë marrë me datën 21.12.2022. Tek subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri, njihen si të ardhura të ligjshme, hua, dhurata apo paga mujore të bashkkëshortit të kësaj subjekti rivlerësimi, pagesa udhëtimesh në Vjenë, etj, që e kanë burimin nga pagesat e inceneratorëve (Fier, Tiranë, Elbasan), të përfituara nga shtetasit Mirel Mërtiri dhe Stela Gugallja, (persona të shpallur në kërkim ndërkombëtar për afera qindra miliona euro), përkatësisht kunati dhe bashkëshortja e kunatit të këtij subjekti rivlerësimi.

Mua nuk më njihen të ardhurat e përfituara nga babai si shitës ambulant fruta perimesh për vitet 2005 dhe 2006, në një vlerë 600.000 lekë, pra shumë shumë më pak se vlerat e sipërpërmëndura që i janë njohur subjektit të rivlerësimit Mariola Mërtiri nga Komisionerja Pamela Qirko.

Veprimi me dy standarte, ka motive të qarta..!!! (Për etikë po them vetëm tre)., 1. Subjekti i rivlerësimit Mariola Mërtiri, nuk ka ngritur as pretenduar kushtet e pazgjedhshmërisë së komisioneres Pamela Qirko. 2. Ndryshe nga unë, motra e komisioneres Pamela Qirko, ministrja Belinda Balluku, nuk ka ndonjë armiqësi as me subjektin e rivlerësimit Mariola Mërtiri dhe as më të afërmit e saj. Madje, përkundrazi, në media flitet ndryshe. 3. Edhe ky subjekt është nga Jugu i Shqipërisë.

Ja pra, kjo është drejtësia e leopardëve të fabulës.

Këto pretendime (shkaqe ankimi) i ngre si diskriminim për motive të dallimit krahinor, për motive hakmarrjeje, për motive të nevojës që kanë patur komisioneret Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo për të fshehur konfliktit e interesit, etj.

Vlerësoj se përket Kolegjit të Posaçëm të Apelimit detyrimi, që duke patur parasysh dispozitat e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mënyrën se si përcaktohet në këtë ligj, mënyra e shpërndarjes së barrës së provës, t'i kërkojë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shpjegimet përkatëse për të vërtetuar se nuk ka ndodhur diskriminim. Po ashtu, i kërkoj Kolegjit që të tërheqë kopje të akteve nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, prokurori Drini Pali. (*Bëhet fjalë për procedimin që ka filluar me kallzimin e paraqitur nga Komisionerja Pamela Qirko ndaj një punonjësve të KPK për nxerrje të sekretit dhe humbje të fashikullit, në rastin e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina. Për më tepër sqarime mund të më pyesni dhe unë kam gadishmërinë t'iu jap shpjegimet përkatëse*).

Së njëmbëdhjeti: Në vendimin e komisionit, familja ime e origjinës nxirret me bilanc negativ edhe përsa i përket apartamentit të blerë nga babai im në vitin 2004. Ky bilanc, përfshihet në bilancin negativ kumulativ prej rreth 2.700.000 (dymilion e shtatëqindmijë) lekë, të nxjerrë nga Komisioni për vitet 2003-2007, (dhe që sikurse do t'a shpegoj më hollësisht në vijim të ankimit, nuk ekziston në asnjë zë të tij).

Ky bilanc negativ rreth 383.000 lekë, lidhur me banesën e prindërve të mi, më ngarkohet mua padrejtësisht. Kjo ndonëse unë përmbledhtas, kam argumentuar që prinderit e mi kanë patur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie pasi në familjen time në vitin 2004 ishin 5 anëtarë të gjithë madhorë, dhe konkretisht unë, me pagë gjyqtari, motra me pagë prokuroreje (deri në kohën që është martuar), babai pensionist, nëna mësuese, vëllai student, etj. Nga ana e Komisionit sikurse do shihet hollësisht më poshtë, nuk janë llogaritur në analizën financiare tërësia e burimeve të anëtarëve të familjes.

Një argument i vetëm përmëndet në vendimin e komisionit lidhur me këtë mosllogaritje. Ai sipas të cilit, në DPV 2003, unë kam deklaruar kursime në shumën 200.000 lekë. Sipas Komisionit, këto janë kursimet e të gjithë familjes. Komisioni nuk përmënd dhe as nuk argumenton as duke iu referuar ligjit dhe as logjikës se përse është i pabazuar pretendimi im se këto kursime të deklaruara prej meje, janë vetëm të mijat për vitin 2003 dhe jo të anëtarëve të tjerë të familjes, qëndrim të cilin Komisioni e ka mbajtur për subjekte të tjerë rivlersimi (vendimi për subjektin Valbona Vata). Kjo pasi as babai, as nëna, as vëllai, nuk kanë patur detyrim ligjor për të deklaruar në ILDKPKI.

Sipas Komisionit, përderisa unë kam deklaruar edhe të ardhurat e prindërve dhe vëllait në DPV 2004 - 2007, i bie që shuma e deklaruar prej meje si kursim në DPV 2003 është e gjithë familjes.

Ky lloj arsyetimi është jo i drejtë. Kjo pasi DPV e vitit 2003, ka qënë e para që është plotësuar nga unë. Formulari i kësaj DPV-je, ka qënë i ndryshëm nga formulari i nxjerrë nga ILDKPKI për vitet 2004-2007.

Përveç kësaj, në 2003 familja ime nuk ka blerë ndonjë pasuri, prandaj nuk kam patur arsye që të deklaroj kursimet e anëtarëve të tjerë të familjes sikurse kam bërë në vitet 2004 dhe 2006, ku në këto vitet janë blerë përkatësisht, apartamenti ku jetojnë prindërit e mi dhe apartamenti ku unë jetoj aktualisht me familjen time duke filluar nga viti 2008.

Nga ana tjetër sikurse e thashë prindërit nuk kanë patur detyrim për të deklaruar pasurinë në ILDKPKI.

Për më tepër, vetëm nga shitja e banesës në Bushat Shkodër, në shumën 430.000 lekë, pa llogaritur burimet e tjera të të ardhurave (si pagat e mia dhe të motrës si studentë në magjistraturë për vitet 2001, 2002 dhe 2003), pensioni i babait, paga e nënës si mësuese, etj, është e qartë se kjo balancë negative që nxjerr Komisioni për vitin 2003, jo vetëm që mbulohet, por duket qartë se është fiktive dhe e nxjerrë me qëllim dashakeq. Po ashtu, vetëm nga paga e motrës si prokurore, që ka qënë e barabartë me gjyqtarit, (shih ligjin), mbulohet balanca negative, ku këtu kujtoj se motra ka jetuar me ne deri në shtator te vitit 2004. Deri në datën e blerjes së apartamentit shumatorja e pages së marrë nga ana e saj e tejkalon vlerën e bilancit negativ. Kjo shumë edhe pse përmendet nga komisioni si e përfshirë në analizën financiare, te kjo e fundit evidentohet qartë se nuk është përfshirë, pasi në lidhje me motren time për vitin 2004 shënohen 0 të ardhura (shih analizën financiare të blerjes së këtij apartamenti fq 67 e raportit).

Lidhur me këtë bilanc negativ, komisioni bën lojë fjalësh, merr të shkëputura pjesë nga deklarimet e mia që i bashkon në mënyrë mekanike duke mos i cituar deklarimet e mia të plota. Në përfundim, edhe vetë Komisioni, duke qënë se e di që argumentimi i tij lidhur me këtë bilanc negativ fiktiv, fut ujë dhe është i paqartë dhe i pasaktë, shprehet (përmbledhtas) se kjo mungesë financiare nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra, por merret parasysh në raport me gjetjet e tjera. (*Pra shto miell dhe shto ujë për të bërë bukën*).

Vetë paqartësia ekstreme, karakteri i sforcuar dhe mekanik e kësaj pjese të arsyetimit të vendimit të Komisionit, moscitimi i plotë dhe madje marrja e pjesëve të shkëputura nga deklarimet e mia, lojrat e fjalëve në këtë pjesë të arsyetimit të vendimit, e bëjnë më se të dukshme dhe përbëjnë provë të qartë se procesi im i rivlerësimit në KPK, as nuk ka qënë i ndershëm, as i drejtë, as objektiv dhe për rrjedhojë, është i paligjshëm.

Ky fenomen në arsyetimin e vendimit ka ndodhur pothuajse në çdo pjesë të arsyetimit të vendimit, veçanarisht kur merret në analizë kriteri i pasurisë. Gjithsesi, në pjesët e mëposhtme të ankimit do shprehem hollësisht për çdo pasuri që kam në pronësi, që kam patur në përdorim, për çdo të ardhur dhe shpenzim, duke shpresuar që arsyetimin e qëllimtë mish mash në vendimin e komisionit, t'a hedh poshtë duke ia bërë të ditur tërësisht Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjendjen time pasurore për vitet 2003-2016 që mbulojnë periudhën e rivlerësimit.

Së dymbëdhjeti: Në përfundim të parashtrimit të përmbledhur të shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e pasurise, që i kam ekspozuar përmes dhënies së konsideratave të përgjithshme si më sipër, ngre si pretendim edhe faktin që sipas ligjit 84/2016, unë do duhet të vlerësohesha për kriterin e pasurisë që kam patur në pronësi dhe përdorim, në kohën e përpilimit të dekleratës veting.

Kjo nuk është bërë pasi hetimi, në një pjesë të tij, ka kapërcyer qëllimin e ligjit.

Jam hetuar për pasuri të prindërve të mi me të cilat në kohën e përpilimit të dekleratës veting, nuk kam patur asnjë lloj lidhjeje. P.sh. për apartamentin e vitit 2004 të blerë nga prindërit, kursimet e realizuara nga familja ime e origjinës në vitin 2007, etj.

Sqaroj Kolegjin se pas martese, në gjysmën e dytë të janarit 2008, unë jam shkëputur nga familja ime e origjinës dhe nuk kam patur më as në pronësi dhe as në përdorim ndonjë pjesë të pasurisë të familjes time të origjinës, (me përjashtim të dhuratave që kam marrë me lindjen e martesës që do t'i përshkruaj në vijim si dhe marrjes në përdorim, për qëllime banimi, të apartamentit të blerë me kontributet e përbashkëta të familjes time të origjinës, në vitin 2006).

Komisioni e ka ditur këtë fakt tepër të rëndësishëm dhe ka vepruar me keqbesim.

Kjo pasi për vitet 2008-2016, më ka nxjerrë me një bilanc negativ kumulativ rreth 1.800.000 (njëmilion e tetëqindmijë) lekë, por që sipas meje dhe provave që kam paraqitur, nuk ekziston, (për këtë disi u shpreha më sipër, por gjithsesi do të shprehem hollësisht në vijim të ankimit).

Duke e ditur se ky bilanc negativ kumulativ, fut ujë, është abuziv, haptazi subjektiv, qartësisht në kundërshtim me provat, dhe që gjithsesi, nuk mjafton për të më shkakruar mua nga detyra sipas parimit të proporcionalitetit, atëherë komisioni është kujdesur që të hetojë mënyrën e fitimit të pasurisë nga familja ime e origjinës, të nxjerrë analizën financiare të saj me 2.700.00 lekë të tjera bilanc negativ, të cilin m'a vesh të gjithin mua në kundërshtim me provat, parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, ligjshmërisë, humanizmit, barazisë, mosdiskriminimit, etj.

Këtë gjë Komisioni nuk duhet t'a bënte pasi qartësisht ka kapërcyer qëllimin e ligjit. Në atë pjesë të ankimit të titulluar "Kriteri i pasurisë", do shprehem më hollësisht pasi do shpreh qëndrimin tim për çdo pasuri si dhe çdo argument të përdorur nga komisioni për rivlerësimin tim lidhur me kriterin e pasurisë.

Së trembëdhjeti: Tek kriteri i figurës, në vendimin e tij Komisioni arrin në konkluzionin (përmbledhtaz) se *gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nuk mjaftojnë që të konsiderohem i papërshtatshëm referuar këtij kriteri, por meqënëse ngrihen dyshime për favorizime dhe janë konstatuar shumë mangësi, këto do të merren në konsideratë në kuadër të kriterit të profesionalizmit si dhe në kuadrin e vlerësimit në tërësi të procedurave*. Lidhur me këtë vlerësim të Komisionit, unë kam qëndrimin se jo vetëm ai nuk mbështetet në prova dhe në parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, por ca më keq, ky lloj vlerësimi është tregues i qartë i njëanshmërisë së Komisionit në kryerjen e procesit tim të rivlerësimit. Në pjesën e ankimit të

titulluar “kriteri i figurës” unë do shprehem hollësisht, por tani në mënyrë të përmbledhur ngre në mënyrë të përgjithshme shkaqet e ankimit të mëposhtme:

1. Edhe po të merret e mirëqënë se mangësitë janë të vërteta, (që kurrsesi sipas vlerësimit tim nuk janë të tilla), një pjesë e tyre nuk mundet që sipas ligjit 84/2016 të vlerësohen në kuadër të kriterit të profesionalizmit dhe vlerësimit në tërësi të procedurave. Kjo pasi sipas ligjit 84/2016, vlerësimi profesional mbulon periudhën nga data 1 janar 2006 e në vazhdim, jo përpara. Komisioni ka vlerësuar në kuadër të profesionalizimit, dy cështje. Të tilla janë çështjet e përmëndura në paragrafin 67 dhe paragrafin 70 të vendimit të Komisionit.

2. Të gjitha gjetjet dhe mangësitë e konstatuara sipas Komisionit, i referohen një miqësie të supozuar që sipas Komisionit (por jo sipas meje) unë kam me avokatin Lulzim Karini. Kjo gjë sipas meje nuk është e vërtetë. Komisioni me keqdashje më atribuon mua një gjendje konflikti interesi, pa argumetuar aspak në referim të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, se ku ekziston ajo. Për më tepër Komisioni, nuk citon në vendim të plota por vetëm në mënyrë të cunguar shpjegimet që kam dhënë unë për të argumentuar se kjo gjendje konflikti interesi nuk ekziston. Ky citim i mangët i argumenteve që unë kam dhënë, bëhet për dy qëllime që janë:

a. Të krijohet kakofoni dhe paqartësi tek lexuesi i vendimit dhe pikërisht nga kjo paqartësi të mos mund të përjashtohet supozimi se ky konflikt interesi, pra miqësi e supozuar ekziston.

b. Argumentet e mia nuk citohen të plota pasi synohet të fshihet nga sytë e publikut konflikti real i shumëfishtë i interesit (jo fiktiv si në rastin tim) që sipas nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit, kanë të tre komisionerët që kanë dhënë vendimin që unë po ankimoj (dhe që unë e kam ekspozuar në seancë me prova). Konkretisht,

- Për komisioneren Genta Bungo i kam dorëzuar një video ku ajo del duke u puthur dhe përqafuar me subjektin e rivlerësimit Dritan Hallunaj, për të cilin ajo ka ushtruar funksionin e komisioneres relatore të trupit gjykues që ka kryer rivlerësimin kalimtar të këtij subjekti.

Kujtoj Kolegjin se ky subjekt rivlerësimi ka favorizuar shtetasin Arben Froku, vëllain e ish deputetit Mark Frroku, që është vrasësi i komisarit të policisë Dritaj Lamaj. (Shtetasi Arben Frroku aktualisht është i dënuar me burgim të përjetshëm pasi Gjykata e Apelit e Kriveve të Rënda e ndryshoi vendimin e pafajësisë së dhënë nga subjekti i rivlerësimit Dritan Hallunej, dhe vendimi i Gjykatës së Apelit, në vijim u la në fuqi nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut).

Mangësitë e këtij subjekti rivlerësimi ***referuar këtij rasti***, që është pakrahasimisht më i rëndë se mangësitë që më atribuohen mua në kriterin e figurës, (dhe që janë sikurse do t’a agumentoj në vijim, absolutisht të padrejta), nuk janë evidentuar fare as në procesin e rivlerësimit dhe as në vendimin e konfirmimit në detyrë të tij, të dhënë nga komisionerja Genta Bungo, që puthet dhe përqafohet si adoleshente me subjektin që ajo ka gjykuar.

Kjo qartësisht përbën trajtim të pabarabartë të rastit tim me rastin e këtij subjekti. Madje më keq. Kjo pasi referuar këtij subjekti, tek çdo vëzhgues i jashtëm, do krijohet bindja se ai është favorizuar, ndërsa unë tek çdo vëzhgues i jashtëm do të krijohej bindja se më është ngrënë e drejta.

- Po për komisioneren Genta Bungo i kam dërguar në rrugë elektronike me email, në datën 19.12.2022, një fotografi, që tregon shokët e klasës që ajo ka patur në fakultet. Kjo fotografi ka rëndësi pasi rezulton se Genta Bungo ka gjykuar subjektet e rivlerësimit Besa Nikhasani, Bujar Musta, ka për gjykim subjektin Agron Bushati, Mirela Kapo, etj, që i ka patur shokë klase në fakultet.

Në këto rrethana, nuk mund të ngrihet supozimi se meqënëse unë shtetasin Lulzim Karini e kam patur shok fakulteti, (jo në të njëjtin kurs), unë është dashur të dorëhiqem nga çështjet ku ka marrë pjesë ai si avokat, apo nga 5 çështje ku ka marrë pjesë babai i tij.

Për Komisioneren Pamela Qirko kam dorëzuar si prova disa vendime gjyqësore që vërtetojnë se motra e saj Ministrja Belinda Balluku, ndodhet në konflikt gjyqësor personalisht me mua, se po motra e saj apo vartësit e kontrolluar prej saj, ndodhen ne konflikt gjyqësor me kunatin tim Ardit Halluni, me vëllain tim Gerti Ymeri, me babain tim Faik Ymeri, me nënën time Elvira Ymeri.

Për komisioneren Firdes Shuli kam dorëzuar prova që vërtetojnë se ajo, që përpara se të caktohej në përbërje të trupit tim gjykues, është kallzuar penalisht për fallsifikim dhe vjedhje në bashkëpunim, me anë të mashtrimit nga tre avoketërit e mi, që më kanë përfaqësuar në proces, av. Gerti Ymeri, (që është edhe vëllai im), av. Arben Llangozi, av. Orgesa Serani si dhe studio ligjore jurisprudenca. Komisionerja e ka ditur këtë fakt që përpara se të përfshihej në trupin gjykues të Komisionit që ka dhënë vendimin që unë po ankimoj përpara Jush. Kjo pasi është pyetur për kallzimin e bërë nga oficeri i Policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rethit Gjirokastër. Madje, është njohur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe të Gjykatës së Apelit Gjirokastër që kanë urdhëruar Prokurorinë që të vazhdojë hetimet.

Pretendimet e mia për të vërtetuar konfliktin e interesit të të tre komisionerëve si dhe as provat dhe shpjegimet që kam dorëzuar në Komision, nuk përmënden në vendim. Kjo pasi është e qartë se komisionerët do të demaskoheshin.

I kërkoj Kolegjit ***që të citojë në vendim të plota shpjegimet e mia për të vërtetuar mosekzistencën e konfliktit të interesit***, (të cilat për lehtësi të Kolegjit si dhe nga frika se mund të mos paraqiten të plota nga Komisioni në Kolegj, por i shkruaj edhe një herë në këtë ankim).

Veçanarisht i kërkoj Kolegjit të shprehet nëse unë jam trajtuar apo jo në mënyrë të pabarabartë në raport me subjektin e rivlerësimit Ilir Toska, që është konfirmuar në detyrë nga Komisioni, ndonëse ka patur një situatë jo të ngjashme por pakrahasueshmërisht më pak të favorshme se marrëdhënia ime me avokatin Lulzim Karini, të cilin e kam patur vetëm shok fakulteti si dhe me të cilin kam udhetuar 6 herë nga Shkodra në Mal të Zi, në vitet 2007-2013, kohë në të cilën ai nuk ka qënë avokat, dhe me të cilin unë përveç një përshëndetjeje të zakonshme dhe etike, nuk kam patur dhe as kam ndonjë marrëdhënie tjetër.

Veçanarisht, i kërkoj Kolegjit të shprehet mbi pretendimin tim, që po e parashtroj si shkak ankimi se unë jam trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me subjektin e rivlerësimit Ilir Toska, duke m'u shkelur kështu e drejta për të mos u diskriminuar në marrëdhëniet e punësimit, e parashikuar në nenin 14 të KEDNJ dhe ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo për dy shkaqe diskriminimi që janë:
I. Fakti që unë jam verior, pra shkodran, ndërsa subjekti Ilir Toska është vlonjat, pra motiv dallimi krahinor. Kjo duke u marrë parasysh edhe lidhjet që kanë me zonën e parë operative, (Vlorë-Tepelenë-Gjirokasër) që të treja komisioneret e Komisionit.
II. Motivi i hakmarrjes pasi as subjekti Ilir Toska dhe as subjekti Dritan Hallunej, ndryshe nga unë nuk i ka demaskuar komisioneret duke pretenduar se ato nuk plotësojnë standartin "Gjykatë e krijuar me ligj", pra që janë si ato leopardët e fabulës që tregova më sipër.

3. Mangësitë e supozuara padrejtësisht nga Kmomisioni në kriterin e figurës, (shih paragrafët 98.1, pika "vi", "vii", "viiii"), nuk janë të rëndësishme sipas parimit të proporcionalitetit dhe parimit të objektivitetit, për të vënë në dyshim as figurën dhe aq më pak profesionalizmin tim. Kjo pasi:

a. Nuk argumentohet në vendim (tek kriteri i figurës) ardhja e asnjë pasojë që do të mund të interpretohej si cënim i besimit publik në veprimtarinë time gjyqësore. Të gjitha vendimet (me përjashtim të dy vendimeve) janë të formëes së prerë. Pra, nuk ka pasoja. <u>Pa pasoja nuk ka dënim</u>.

b. Çështjet që përmenden tek kriteri i figurës (përveç dy çështjeve) në vetvete janë çështje pa pikën e sensibilitetit publik, dhe konkretisht, 1 sigurim prove (gjykim civil), 1 urdhër ekzekutimi, 28 vërtetime gjyqësore pa palë kundërshtare, (26 pensione kooperative + 2 vërtetime fakti), 12 gjykime me palë kundërshtare me objekt njohje vjetërsie në punë për efekt pensioni (në marrëdhenie pune me kooperativën bujqësore, që është pensioni minimal) . Si mund të cënohet besimi i publikut në këto lloj çështjesh, pa sensibilitet publik, kur vendimet që kam dhënë nuk janë cënuar në gjykatat më të larta, vetëm keqdashja e Komisionit me di. Kjo aq më shumë kur nuk rezulton të jetë ankuar askush nga palët, si gjyqfituese si gjyqhumbëse, (as në rrugë disiplinore dhe as në rrugë gjyqësore).

c. Komisioni në shumicën e këtyre çështjeve, më atribuon si mangësi mosgjëndjen në dosje të njoftimeve të palëve paditëse. Unë kam sqaruar (sikurse do shihet më hollësisht në vijim), se nuk është përgjegjësi e imja por e sekretares, e cila rezulton se i ka njoftuar paditësit me gojë kur janë paraqitur përpara saj për t'u interesuar për datën e gjykimit, ose me telefon, por nuk ka dokumentuar veprimin procedural të njoftimit. Gjithsesi, nuk ka patur pasoja pasi palët janë paraqitur në ditën e gjykimit dhe seancat nuk janë shtyrë për shkak të mungesës së njoftimeve. Pra mungon pasoja e paligjshme. Pa pasojë nuk ka ndëshkim, sikurse e thashë.

ç. Komisioni në gjetjet e tij referuar kriterit të figurës, ndër të tjera shprehet (kryesisht tek pensionet e kooperativës që janë vërtetime gjyqësore fakti pa palë kundërshtare), *se nuk kam rrespektuar afatin e parashikuar në nenin 155/2 të Kodit të Procedurës Civile pasi seancën e parë përgatitore/gjyqësore e kam caktuar pa u plotësuar afati 10 ditor i parashikuar nga dispozita*. Unë në parashtrimet e mia jam mbrojtur se gjykimet e vërtetimet të faktit, janë gjykime gracioze, pa palë. Ky afat zbatohet për gjykimet kontencioze pasi ratioja e tij ka për

qëllim garantimin e kontradiktoritetit dhe të drejtës efektive të mbrojtjes apo përfaqësimit/aksesit në Gjykatë.

Komisioni në vendimin e tij shprehet se *në nenin 155 të KPC, nuk parashikohen përjashtime për rrjedhojë ky afat do duhej zbatuar*. Unë jam mbrojtur se ky afat është në thelbin e tij në dobi të palëve dhe për sa kohë askush nuk është ankuar, madje nuk ka patur pasoja negative të çfarëdoshme për procesin, nuk mund të penalizohem, aq më shumë përsa i përket kriterit të figurës, tek i cili ngrihen këto problematika.

Komisioni në vendimin e tij, nuk merr parasysh asnjë nga argumentet e mia, (që do t'i trajtoj në vijim hollësisht, çështje për çështje), por thjesht mjaftohet se është shkelur dispozita ligjore përsa i përket afatit 10 ditor dhe mbi bazën e kësaj shkeljeje (që ai e quan të tillë), ngre supozimin dashakeqës, tek kriteri i figurës, se nga këto shkelje krijohet dyshimi i arsyeshëm se kam favorizuar palët. Për rrjedhojë, sipas Komisionit, kam cënuar besimin publik në veprimtarinë time gjyqësore.

Në vlerësimin tim kjo mënyrë e të vlerësuarit, jo vetëm është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (rëndësisë së shkeljes) por edhe parimin e objektivitetit. Kjo pasi unë kam bindjen se kam të drejtë, pasi afati ligjor në fjalë, është në dobi të palës, dhe kur pala e kërkon ose kur jep pëlqim dhe një gjë e tillë nuk bie ndesh me interesat e drejtësisë, Gjykata nuk ka arsye që të mos e pranojë.

Përveç kësaj ky afat ligjor është i zbatueshëm referuar ratios së tij vetëm në gjykimet kontencioze dhe jo gracioze. Gjithashtu kam bindjen se në vlerësimin e tij Komisioni ka shkelur edhe parimin e ligjshmërisë. Kjo pasi dhënia e vlerësimit nga Komisioni për mënyrën se si e intepretoj unë ligjin, qartësisht është në kapërcim të kompetencave që ka çdo vlerësues, sipas neneve 3 dhe 72 të Ligjit 96/2016. Kjo pasi *gjyqtarët janë të pavarur në intepretimin e fakteve dhe të ligjit dhe nuk duhet të ndikohen nga asnjë shkak apo arsye*. Veprimtaria e gjyqtarëve korigjohet vetëm në rrugët e ankimit gjyqësor.

d. Komisioni ka shkelur ligjin duke kapërcyer kompetencat jo vetëm kur merr përsipër të më ngarkojë me përgjegjësi se në disa raste kam shkelur (sipas tij) afatin ligjor 10 ditor të parashikuar në nenin 155 të KPC, por çuditërisht, në disa çështje merr përsipër edhe të më ngarkojë me përgjegjësi pasi sipas tij nuk e kam zgjidhur çështjen mirë, (dy rastet e kërkuesit Shefqet Molla dhe rasti i Hysen Temali dhe Hasan Temali). Kjo është e gabuar. Kjo pasi Komisioni ka marrë përsipër dhënien e opinionit lidhur me këto çështje, pra ka marrë rolin e Gjykatave më të larta në kundërshtim si me praktikën e KPA ashtu edhe me nenet 3 dhe 72 të Ligjit 96/2016.

dh. Për dy çështjet që mund të thuhet se kanë sensibilitet publik (njëra mesatar ndërsa tjetra të lartë), unë kam votuar kundër shumicës.

- Për çështjen penale që i referohet të pandehurit Vuksan Cubi, nuk është gjetur shkelje (pavarësisht nga dëshira) as nga vetë komisioni.

- Tek çështja civile, që unë kam votuar në pakicë, me palë paditëse Izet Karini, palë të paditur Bashkia Shkodër, komisioni shtrëmbëron të vërtetën kur shprehet (përmbledhtaz) në vendim se "*është e dyshimtë që unë kam votuar në pakicë. Duket sikur dokumenti është prodhuar pas njohjes së subjektit me rezultatet e hetimit. Kjo pasi në vendimin origjinal të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk shënohet fjala "kundër" nga ana e subjektit. Për rrjedhojë procesverbali i pakicës së sjellë nga subjekti nuk do të merret në konsideratë. Po ashtu as dokumenti "dispozitiv vendimi", në të cilin subjekti ka firmosur kundër, dhe që përmban nënshkrimet e trë gjyqtarëve*". Ky konkluzion i Komisionit minimalisht është i gabuar dhe maksimalisht është tregues i keqdashjes së tij. Kjo për arsyet e mëposhtme:

I. Në dosjen origjinale, që nga interesimi im ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në vendimin origjinal të qepur të dosje, ndodhet shënimi im "në pakicë", krahas nënshkrimit tim dhe dy kolegëve.

II. Në arritjen e konkuzionit Komisioni nuk ka parë dosjen fare por i është referuar vetëm një kopjeje të vendimit (që ai gabimisht e quan origjinale), që i është dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ajo kopje vendimi nuk ka shënimin tim në pakicë. Kjo kopje vendimi që i është dërguar komisionit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, është në vetvete riprodhim i kopjes së marrë nga kodekset e gjykatës ***por nuk është vendimi origjinal***. ***Vendimi origjinal, është vendimi që ndodhet i shkruar me shkrim korsiv dhe që ndodhet i qepur në dosjen gjyqësore***. Bëj me dije Kolegjin se ka qënë praktikë e gjykatës që gjyqtari që votonte në pakicë, shënonte në vendimin e qepur në dosje fjalën kundër ose në pakicë, sipas nenit 322 të KPC, dhe kur e çmonte, hartonte një procesverbal që pasqyronte qëndrimin e tij, të cilin e fuste në zarf të mbyllur dhe e depozitonte në kasafortën sekrete të Gjykatës. Në zarf, varësisht nga zgjedhja e gjyqtarit kryesues, krahas procesverbalit, mund të përfshihej dispozitivi i vendimit të marrë nga trupi gjykues në dhomën e këshillimit, i nënshkruar nga tre gjyqtarët, ku ndodhej shënimi i gjyqtarit në pakicë, ose nuk përfshihej fare kopja e dispozitivit të nënshkruar në dhomën e këshillimit por hartoj një procesverbal i mbetjes në pakicë, i nënshkruar nga të tre gjyqtarët.

III. Për të vërtetuar se unë kam qënë në pakicë, unë i kam dërguar komisionit proceverbalin e marrë nga kasaforta e gjykatës, i titulluar "procesverbal i mbetjes në pakicë", procesverbalin e hapjes se kasafortës se gjykatës në prani të kancelares, kryesekretares dhe sekretares rregjistruese dhe kopjen e dispozitivit të vendimit me nënshkrimet e tre gjyqtarëve që ka shënimin tim "në pakicë".

IV. Komisioni me keqdashje nuk më ka pyetur asnjëherë për këtë dyshim të tij. Aq më pak më ka ngarkuar barrë prove për të vërtetuar të kundërtën e dyshimit se dokumenti mund të ishte i fallsifikuar apo i prodhuar për nevoja të procesit tim të rivlerësimit. ***Për herë të parë këtë problematike e kam marrë vesh në vendimin e zbardhur të Komisionit, qëndrim i cili është në kundërshtim me praktikën e KPA (përmend vendimin për subjektin e rivlersimit Arqile Koca)***. Pra, Komisioni i ka lejuar vetes në mënyrë të turpshme, që të shkaktoje "efekt surprizë" në vendimin e tij. Kjo është e palejueshme, është e parregullt, është arbitrare dhe tregon keqdashjen e komisionit. Kjo pasi procesi duhet të jetë kontradiktor. Mua duhet të më jepej mundësia për të shprehur qëndrimin tim për çdo dyshim, paqartësi që mund të kishte Komisioni. ***Duke mos m'u ngarkuar barrë prove lidhur me këtë dyshim dhe duke e konsideruar fakt këtë dyshim në vendimin e arsyetuar, mua më është cënuar e drejta kushtetuese e mbrojtjes. Kjo tregon***

paragjykimin dhe keqdashjen e Komisionit si dhe dëshirën e tij që me çdo kusht të më shkarkonte nga detyra.

V. Bëj me dije Kolegjin se ndryshe nga të gjithë subjektet e tjerë të rivlerësimit që i janë nënshtruar vlerësimit për të tre kriteret, mua asnjëherë Komisioni nuk më ka dërguar pyetje apo më ka kërkuar sqarime. Pra në asnjë moment nuk më ka dhënë mundësi të barabarta me subjektet e tjerë për t'u vetëkorrigjuar ose përmes përgjigjeve të pyetjeve të shuaja ndonjë dyshim apo paqartësi.

Me ka dërguar vetëm raportin me rezultatet e hetimit administrativ dhe sikurse shihet edhe në këtë raport, ***ka ruajtur efekte surprizë, me të cilat më ka njohur vetëm me vendimin përfundimtar***, (sikurse është psh, atribuimi i faktit se kam paraqitur një dokument të mbetjes në pakicë, që duket se është i fallsifikuar).

Hajde Drejtësi Hajde. ***Të bëj gjyqin, të dënoj dhe vetëm pastaj të them përse të dënova***, pa të dhënë asnjë mundësi për t'u mbrojtur, për t'u dëgjuar zëri apo për të paraqitur prova pse nuk duhet të dënohesh.

Unë e di pse e ka bërë këtë Komisioni. Për t'u hakmarrë. Gjithsesi, prapë nuk tërhiqem.

Po të më pyeste Komisioni ose po të më ngarkonte barrë prove të qartë, do i kërkoja atë që po i kërkoj Kolegjit përmes këtij ankimi. Konkretisht:

I. Kërkoj të merrej një kopje e dosjes që në dijeninë time ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ose të kqyret ajo. Unë nuk kam kohë fizike t'a paraqes vetë sepse jam duke shkruar ankimin. Kam vetëm 15 ditë kohë dhe kam frikë se paturpësia e Komisionit do të shkojë deri aty sa të më bëjë ndonjë lojë me afatet me qëllim që t'a deklarojë ankimin e papranueshëm. Ose, në të kundërt, i parashtroj si kërkesë procedurale Kolegjit që të më lejojë që t'a paraqes në një moment të dytë kopjen origjinale të vendimit me shënimin në pakicë, ***atë me shkrim korsiv***.

II. Unë kam qënë kryesues i trupit gjykues që ka dhënë vendimin. Vendimin e ka arsyetuar gjyqtari anëtar Emiljano Ruli. Kërkoj të bëhet një ekspertim sintaktik dhe leksikor për t'a vërtetuar këtë. Kjo pasi fakti që vendimin e ka arsyetuar një nga gjyqtarët që ka formuar shumicën dhe jo unë që e kam patur për detyrë, indirekt tregon që kam qënë në pakicë, ose të paktën shkon të favor të pranimit të kësaj hipoteze. Po kështu mund të bëhet edhe një ekspertim grafik i shkrimit për të përcaktuar vjetërsinë e shkrimit në procesverbalin e pakicës të cilin ia kam dërguar Komisionit.

III. Kërkoj të pyetet sekretarja e seancës gjyqësore Suela Çela si dëshmitare mbi faktin se a kam dalë në pakicë apo jo dhe a është ajo që e ka depozituar zarfin në kasafortën e gjykatës dhe kur e ka bërë këtë gjë. Kjo për të hedhur poshtë pretendimin e Komisionit se ka dyshim që dokumenti është hartuar pasi jam njohur me barrën e provës në procesin e rivlerësimit. Po ashtu kërkoj të pyeten si dëshmitare edhe dy gjyqtarët Aleks Nikolli dhe Emiljano Ruli, kancelarja Blenda Behri dhe të gjithë nënshkruesit e procesverbalit të hapjes së kasafortës.

IV. Kërkoj të bëhet një kqyrje e kompjuterit tim të zyrës me ekspert IT, për të vërtetuar kohën kur është hartuar dokumenti procesverbal i mbetjes në pakicë. Padiskutim, kompjuterin e zyrës do t'a ruaj deri në kohën kur ankimi im të merret në shqyrtim nga Kolegji.

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit, vërtetimi i faktit që unë kam votuar si gjyqtar në pakicë në çështjen e babait të shtetasit Lulzim Karini, ka shumë rëndësi. Kjo pasi nëse ky fakt vërtetohet, atëherë logjikisht bie gjithë ngrehina se unë kam qënë në konflikt interesi me shtetasin Lulzim Karini, sikurse shkruan padrejtësisht Komisioni në vendimin e arsyetuar të tij. Kjo pasi nëse unë kam votuar për rrëzimin e padisë së ngritur nga babai i tij, si mundet të supozohet se kam patur lidhje miqësore me këtë shtetas në kohën kur kam shqyrtuar çështjet e pensioneve në të cilat ai ka qënë avokat i ndonjërës prej palëve.

Së katërmbëdhjeti: Në përmbledhje të shkaqeve të ankimit që kam ngritur si më sipër lidhur me kriterin e figurës, ju bëj me dije të nderuar gjyqtarë, se në pjesën përmbajtësore të ankimit do pasqyroj çështje për çështje, mendimin tim lidhur me bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të vendimit të Komisionit, referuar këtij kriteri. Këtë do t'a bëj që ju të keni mundësi të konstatoni drejtë, qartë dhe saktë gjendjen e fakteve që sipas meje duhet të keni parasysh në marrjen e vendimit përfundimtar.

Së pesëmbëdhjeti: Në lidhje me kriterin e profesionalizmit Komisioni në vendimin e tij, arrin në përfundimin si më poshtë:

96.1. Komisioni, në dosjet e trajtuara më lart, në kriterin e vlerësimit të figurës ka konstatuar: - në 41 raste mungesë të njoftimit të palëve në gjykim/në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i palëve; - në 40 raste nuk është respektuar afati i parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile; - në 6 raste subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit; - në një rast subjekti ka kryer gabime thelbësore dhe serioze; - në 5 raste vendimi gjyqësor nuk është i argumentuar.

96.2. Të gjitha këto të meta të konstatuara, përveçse kanë çuar në favorizim të palëve, në kushtet e një hetimi administrativ nuk mund të çmohen për më shumë, si në një proces penal. Gjithsesi, Komisioni i ka vlerësuar për aq sa ligji nr. 84/2016 e lejon, duke i konsideruar si mangësi në: (i) aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016; (ii) aspektin e aftësive organizative, parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016; si dhe (iii) aspektin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

97. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, dosjeve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e figurës së subjektit, si dhe denoncimeve të depozituara në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit , konstaton gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar në disa raste të drejtat e palëve, si dhe në disa raste ngrihen dyshime për favorizim të palëve në gjykim.

97.1. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

97.2. Komisioni konkludon se në vlerësimin e aftësive profesionale subjekti Andri Ymeri është i papërshtatshëm, në kuptim të germës "c" të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

Sikurse shihet, komisioni në vendimin e tij referuar kriterit të profesionalizmit, ndër të tjera, bazohet në gjetjet e vlerësimet e tij në kriterin e figurës. Konkretisht përsa i përket:

i. Konfliktit të interesit me shtetasin Lulzim Karini në 6 raste, (që u shpreha më sipër, por do të shprehem më hollësisht edhe në vijim se nuk ekziston).
ii. Gabimeve serioze dhe thelbësore në një rast, (lidhur me një dëshmi trashëgimie që po vetë komisioni shprehet se sipas parimit të proporcionalitetit ky rast nuk mund të cillte në mënyrë autonome penalizimin e subjektit).
iii. 41 raste mungesë të njoftimit të palëve në gjykim/në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i palëve, (për të cilën u shpreha më sipër, (por do shprehem në mënyrë më të detajuar në vijim të ankimit), se nuk ka qënë përgjegjësi primare e imja por e sekretares por që gjithsesi kjo lloj mangësie e imja nuk ka sjellë në asnjë rast asnjë pasojë, pasi asnjë seancë e vetme nuk është shtyrë për mungesë të njoftimit, pasi paditësit/kërkuesit (për të cilët mungon njoftimi) janë paraqitur dhe seanca është zhvilluar normnalisht. Pa pasojë nuk ka dënim. Në këto 41 raste bëhet fjalë për gjykime me sensibilitet të ulët publik, gjykime me objekt vërtetime fakti për vjetërsi në punë, në të cilat paditësit/kërkuesit pasi hidhej shorti, paraqiteshin personalisht dhe merrnin kontakt me sekretaren e gjyqtarit për të marrë dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Sekretarja i ka njoftuar por veprimin e njoftimin për shkak të ngarkesës së punë nuk e ka dokumentuar. Po në këto raste, përfshihen edhe raste kur njoftimet për shkak të ngarkeses së punës sekretarja i ka bërë njoftimet me telefon. E ritheksoj se Komisioni nuk ka mundur në këto 41 raste që përmënd, të evidentojë **një rast të vetëm** në të cilën seanca të jetë shtyrë për shkak të mungesës së njoftimit dhe aq më pak ka mundur të vërtetojë që vendimi i dhënë nga unë në përfundim të këtyre proceseve, të jetë prishur nga gjykatat më të larta për shkak të pavlefshmërisë së njoftimit).
iv. në 40 raste nuk është respektuar afati i parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, (pra afati 10 ditor për caktimin e seancës së parë gjyqësore/përgatitore për të cilën u shpreha më sipër, por do të shprehem edhe në vijim).

Komisioni shprehet se të metat e mësipërme, "kanë çuar në favorizim të palëve". Unë vlerësoj se ky qëndrim i Komisionit minimalisht është i gabuar dhe padyshim është subjektiv dhe voluntarist.

Për të arritur në përfundimin se "*ka patur favorizim referuar këtyre mangësive*", minimalisht si ***hap i parë***, do të duhej që komisioni të analizonte në rrafsh krahasimor këto gjykime, referuar kritereve të cilësisë së tyre dhe/apo kohëzgjatjes së tyre, në raport me gjykime të tjera të të njëjtës natyrë të përfunduara nga unë.

Pra, në thelb, të bëntë të njëjtën gjë që kam bërë unë kur kam analizuar si më sipër, (*por edhe do vijoj t'a bëj në vijim të ankimit*), se përse komisioneret Genta Bungo dhe Pamela Qirko, kanë

mbajtur standarte të dyfishta apo të shumëfishta po të krahasohet vendimi im i shkarkimit nga detyra me vendimet e konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, (***vendim i shpallur 14 ditë para vendimit tim***), Mariola Mërtiri, (***vendim i shpallur po atë ditë që është shpallur vendimi im***), Armida Hamiti (Moçka) (***vendim i shpallur po atë ditë që është shpallur vendimi im***), dhe në rastet e dhjetëra subjekteve të tjerë të rivlerësimit të gjykuara nga këto dy komisionere.

Pasi të analizonte në rrafsh krahasimor natyrën e gjetjeve në rastet e mësipërme (referuar kriterit të cilësisë së gjykimeve dhe kohëzgjatjes së tyre) në raport me gjykime të tjera të së njëjtës natyre, (gjë që do t'a lejonte Komisionin për të vlerësuar me objektivitet nëse ka dallime të dukshme ndërmjet rasteve), Komisioni, ***si hap të dytë*** për të hetuar nëse ka patur apo jo favorizime, referuar këtyre rasteve, do duhej të analizonte sipas parimit të proporcionalitetit, peshën, rëndësinë e dallimeve të mundshme, nëse do të konstatonte të tilla.

Në vijim, për të hetuar me objektivitet nëse ka patur apo jo favorizime, Komisioni do të duhej që nëse ka konstatuar dallime/diferencime të cilat në pamje të parë duken si favorizime, ***si hap të tretë*** të hetonte pasojat juridike të këtyre dallimeve/diferencimeve.

Si hap të katërt, Komisioni do duhet të hetonte nëse ekziston lidhja shkakësore ndërmjet këtyre "dallimeve/diferencimeve të mundshme", me pasojat e ardhura, në këndvështrimin se veprimet arbitrare kanë dy anë të medaljes që janë "dhënia e privilegjeve të padrejta por edhe mohimi i të drejtës". Pra, Komisioni duhet të individualizonte të paktën një apo disa subjekte që kam gjykuar të cilëve t'iu jetë cënuar parimi i trajtimit të barabartë, nga ana ime, në raport krahasimor me rastet të cilave iu referohet Komisionisi më sipër, dhe të cilat i konsideron si mangësi të mia në aspektin profesional.

Vetëm nga përmbledhta e rezultateve të katër hapave hetimorë të sipërpërshkruar, do të ishte e mundur, sipas parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit, të arrihej në ndonjë përfundim të logjikshëm dhe jo subjektiv apo me voluntarizëm dashakeqës, që në këto raste ka patur favorizime.

Komisioni, në vendimin e tij, nuk argumenton drejtëpërdrejtë apo qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar "*në funksion të mbështetjes së konkluzionit të tij se ka patur favorizime, referuar rasteve të mësipërme*", nëse ka kryer ndonjë veprimtari hetimore sipas katër hapave të sipërpërmëndur, dhe cilat kanë qënë rezultatet e veprimtarisë hetimore referuar secilit hap.

Në këtë këndvështrim, vendimi i komisionit, për këtë pjesë është absolutisht i paarsyetuar, pra bie ndesh me parimin e ligjshmërisë.

Vendimi i Komisionit është gjithashtu edhe në kundërshtim më parimin e objektivitetit.

Kjo pasi sikurse thashë edhe më sipër:
I. Unë nuk kam patur përgjegjësi primare për dokumentimin e njoftimeve të paditësve/kërkuesve pasi e ka patur sekretarja dhe/apo nëpunësi gjyqësor.
II. Detyrimi për respektimin e afatit 10 ditor të njoftimit, i parashikuar në nënin 155 të KPC, nuk vlen për gjykimet gracioze, pa palë kundërshtare.

III. Nuk ka patur asnjë pasojë juridike as nga shkelja e supozuar ne nenit 155 të KPC (edhe nëse merret e mirëqënë) dhe as nga mosdokumentimi i njoftimeve.
IV. Për sa kohë nuk ka asnjë subjekt që të ketë paraqitur ankesa gjyqësore dhe as disiplinore referuar këtyre rasteve, është e pamundur të argumentohet se si është cënuar konkretisht besimi publik referuar këtyre rasteve. Kjo pasi besimi publik nuk është konvencion voluntarist mendoro-shpirtëror i Komisionit por buron nga populli, nga njerëzit. ***Komisioni nuk do të duhej të shprehej se ka patur favorizime, me argumentim abstrakt, stereotip dhe për përgjithshëm, por konkret, të qartë, të individualizuar***. Pra do duhej të më tregonte se cilën janë subjektet konkret, me emër dhe mbiemër, të cilët unë i kam vënë në një pozitë më pak të favorshme, në krahasim më subjektet për të cilët Komisioni shprehet se i kam favorizuar. ***Përderisa asnjë pjestar qoftë edhe i vetëm i popullit, shoqërisë*** nuk është ndjerë i cënuar/keqtrajtuar apo disfavorizuar nga veprimtaria ime gjyqësore referuar këtyre rasteve, është e pamundur të argumentohet me objektivitet se përse kam cënuar besimin publik referuar këtyre rasteve (praktikë kjo e vendosur me vendimin e KPA ku përmend vendimin për subjektin e rivlersimit Fuat Vjerdha).

Vendimi i Komisionit është gjithashtu edhe në kundërshtim më parimin e proporcionalitetit.

Kjo pasi si natyra e çështjeve tek të cilat Komisioni më atribuon si mangësi mosdokumentimin e njoftimeve dhe shkeljen e afatit ligjor 10 ditor të parashikuar nga neni 155 i KPC (që sikurse e thashë nuk ka fare ose ka sensibilitet publik tejet minimal) ashtu edhe natyra e këtyre të ashtuquajtura gabime dhe mangësi, nuk mund të shërbejnë si indikatorë për të matur besimin publik në veprimtarinë gjyqësore.

Kjo pasi një qytetar i Shkodrës, Durrësit, Tiranës, Korçës, etj, qartësisht do t'a konsideronte fare, po fare të parëndësishme, faktin që gjykimi i një, dy apo më shumë çështjeve civile, për pensione kooperative, apo vërtetime fakti ose dëmshi trashëgimie apo zgjidhje martese (në një rast) është bërë në kushtet kur në dosjen gjyqësore mungon dokumentimi i njoftimit apo që seanca e parë gjyqësore është bërë më shpejt se duhet (sipas komisionit).

Aaa po, - lajm që do të ndikonte në perceptimin publik të dhënies së drejtësisë do ishte mënyra, koha dhe cilësia e veprimit të magjistratëve ndaj vrasësve, përdhunuesve, shpërdoruesve të fondeve publike, korrupsionit, marrjes së padrejtë të provës private apo publike, etj.

Në rastin tim duket qartë nga paragrafët 96.1 - 97.2 të vendimit të Komisionit se ai duke qënë i ndërgjegjshëm ***edhe vetë*** se këto gabime apo mangësi nuk kanë pothuajse fare peshë në këndvështrim të realizimit të qëllimit që ka patur kushtetubërësi dhe ligjvënësi kur ka miratuar legjislacionin për reformën në drejtësi, ***është përpjekur*** të evidentojë numra si 41 gabime mosdokumentim njoftimesh, 40 shkelje të afatit ligjor 10 ditor, për të krijuar përshypjen e rreme, se unë jam i paaftë të bëj punën e gjyqtarit dhe për rrjedhojë kam cënuar besimin publik në dhënien e drejtësisë. Kjo meqënëse gabimet, sipas komisionit qënkan shumë, (40+41=81), unë qënkam i pamundur të kuptoj dhe vetkorigjohem që në të ardhmen të mos i bëj prapë këto të ashtuquajtura gabime dhe mangësi.

Në vlerësimin tim, ky arsyetim i vendimit, në këtë pjesë të tij, meriton vetëm një cilësor, atë "***mjeran***". Kjo pasi besimi publik në dhënien e drejtësisë nuk është koncept vetëm sasior por

njëkohësisht edhe cilësor. Po të ishtë vetëm sasior, atëherë komisioni nuk do të kishte nevojë të lodhej kaq shumë për të më shkarkuar nga detyra. Mund të bënte këtë gjë. Meqënëse unë kam dhënë mbi 13.000 (trembëdhjetëmijë) vendime gjyqësore, atëherë mund të kërkonte kopjet e tyre dhe të shikonte se në sa prej tyre kam bërë gabime ortografike. Jam i sigurtë se do të gjente më shumë se 200 ose 300, madje edhe 500. Pastaj, mbi bazën e kësaj gjetjeje, mund t'a arsyetonte vendimin e shkarkimit tim nga detyra, me arsyetimin se kam bërë ***shuuuumë*** gabime ortografike.

Proporcionalitet nuk ka qartësisht edhe për një arsye tjetër veç sa më sipër. Kjo pasi shihet qartë se në kriterin profesional unë jam konsideruar përgjegjës, ***jo për vendimin përfundimtar,që përbën interesin më të rëndësishëm të një procesi gjyqësor***. Jam konsideruar përgjegjës ***për vendime të ndërmjetme***. Në asnjë rast të vetëm Komisioni nuk ka konstatuar se kam shkelur ligjin në dhënien e vendimit përfundimtar, që përbën edhe pasojën juridike që synojnë dhe dëshirojnë palët nga një gjykim civil, (shih vendimet nr. 6/2009, nr. 3/2012 dhe nr. 5/2012 të KBGJL).

Këtu theksoj se edhe gjetjet e komisionit që ***1.*** *unë kamë dhënë vendim me ekzekutim të përkohshëm në 3 rast*e si dhe ***2.*** *nuk kam pezulluar gjykimin civil deri sa të mbarojë gjykimi penal, në 5 raste*, (për të cilat unë do ndalem më hollësisht në vijim të këtij ankimi me qëllim për të shpjeguar se përse janë të pabazuara), nuk mund të konsiderohen si gjetje që i referohen cilësisë së vendimit përfundimtar. Kjo pasi si vendimi për mospezullimin e gjykimit civil ashtu edhe vendimi për dhënien e vendimit përfundimtar me ekzekutim të përkohshëm, referuar Kodit të Procedurës Civile, (nenit 126), nuk janë vendime përfundimtare por janë vendime të ndërmjetme (neni 125) të cilat merren me qëllim për të siguruar mbarëvajtjen e gjykimit, por që nuk e zgjidhin çështjen në themelin e saj.

Të ndëshkohem kaq ashpër, për vendime të ndërmjetme, kjo qartësisht nuk ka proporcionalitet. Kjo pasi për t'u ndëshkuar për vendime të ndërmjetme, Komisioni do duhej të evidentonte të gjithë setin e vendimeve të ndërmjetme që kam marrë gjatë këtyre gjykimeve dhe të jepte vlerësimin tij se sa janë të rregullta dhe sa janë të parregullta, çfarë pasojash kanë dhënë në dëm të interesave të palëve, vendimet e ndërmjetme të parregullta, a janë korigjuar këto pasoja gjatë kohëvazhdimit të gjykimit, etj. Kjo nuk është bërë në vendimin e arsyetuar të Komisionit, dhe çfarë është më e rëndësishme, nuk është bërë me qëllim dashakeq, për të arritur në përfundimin e dëshiruar të procesit tim të rivlerësimit, që ka qënë paraprakisht, shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit.

Vendimi i Komisionit është gjithashtu edhe në kundërshtim më parimin e barazisë dhe mosdiskriminimitt.

Kjo pasi mjafton të vlerësohet në rrafsh krahasimor, pesha, rëndësia, natyra e këtyre "gjoja gabimeve që më artibuon komisioni referuar rasteve të mësipërme", në raport me rastet e mëposhtme:
I- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Dritan Hallunaj**, (që i ka dhënë pafajësi të paligjshme vrasësit të një komisari policie, që u përmënd më sipër), i konfirmuar në detyrë nga Komisionerja Genta Bungo që në seancë, ballas, sy më sy, ia kam provuar me video që ka

marrëdhënie shoqërore dhe intime me të, aq sa del duke u puthur dhe përqafuar pa teklif rrugëve të Tiranës.
II- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Ilir Toska**, (që u përmënd më sipër por do përmëndet edhe në vijim të ankimit, duke e marrë si shëmbull, lidhur me konflikin e interesit), i konfirmuar në detyrë nga Komisionerja Genta Bungo.
III- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Niko Rrapi**, (i konfirmuar në detyrë me vendim të KPA që nuk e gjeti të bazuar gjendjen e konfliktit të interesit që i kishte atribuar padrejtësisht KPK si dhe nuk u penalizua se kishte dhënë një vendim për shpërblim dëmi për një padi që duhej rrëzuar).
IV- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Arbër Çela**, (i konfirmuar në detyrë me vendim të KPK, shiko gjetjet tek kriteri i figurës dhe profesionalizmit).
V- Rasti i subjektit të rivlerësimit **Armida Hamiti**, (i konfirmuar në detyrë me vendim të KPK, shiko gjetjet lidhur me konfliktin e interesit).
VI- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Gjergji Tako**, (është dërguar në shkollën e magjistraturës me vendim të KPK, për zvarritje hetimesh penale në disa çështje, duke sjellë pasoja për procedimin penal).
VII- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Elvin Gogaj**, (i konfirmuar në detyrë me vendim të KPK dhe të KPA, pavarësisht se kishte shfaqur mangësi të dukje në vlerësimin dhe ndjekjen e disa procedimeve penale, duke sjelle pasoja në fatin e këtyre procedimeve penale).
VIII- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Gentian Medja**, (i konfirmuar në detyrë me vendim të KPK dhe të KPA, pavarësisht se kishte shfaqur mangësi të dukje të ngjashme me të miat, (por me pasoja dhe më të rëndësishme).
IX- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Riselda Fishta**, (e konfirmuar në detyrë me vendim të KPK pavarësisht se me mosveprimet e saj kishte shkatërruar dhe sjellë pasoja të parikuperueshme në fatin e dhjetëra procedimeve penale).
X- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Marsida Frashëri**, (e konfirmuar në detyrë me vendim të KPK pavarësisht se me mosveprimet e saj kishte shkatërruar dhe sjellë pasoja të parikuperueshme në fatin e dhjetëra procedimeve penale).
XI- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Artan Çupi**, (i konfirmuar në detyrë me vendim të KPK pavarësisht se me mosveprimet e saj kishte sjellë pasoja që cënojnë besimin publik në gjykimin e disa çështjeve penale).
XII- Rastin e subjektit të rivlerësimit **Irida Kacerja**, (e konfirmuar në detyrë me vendim të KPK pavarësisht se me mosveprimet e saj kishte sjellë pasoja që cënojnë besimin publik në gjykimin e disa çështjeve civile, si humbja tërësisht e procesverbalit gjyqësor, që është akti më i rëndësishëm i procesit civil pas vendimit përfundimtar, zvarritje gjykimi, etj).

Përveç këtyre rasteve ka me dhjetëra raste të tjera, por që besoj se KPA i di vetë. Në rastin tim, pesha dhe rëndësia e këtyre gabimeve është fryrë me qëllim keqdashës. Absolutisht jam diskriminuar. Kjo për motive hakmarrjeje, pasi kam guxuar sikurse e thashë dhe më sipër ***të demaskoj ballas, sy më sy, në seancat dëgjimore*** se Komisioneret Genta Bungo, Firdes Shuli dhe veçanarisht Pamela Qirko, ishin si puna e atyre leopardëve të fabulës që tregova më sipër. Ata nga mllefi dhe tërbimi, kanë bërë këtë që kanë bërë në vlerësimin e kriterit tim profesional.

Përveç sa më sipër, lidhur me gjetjet ne kriterin profesional që përmënd si shkelje në vendimin tij Komisioni, bëj me dije Kolegjin se Komisioni në procesin tim të rivlerësimit, ka shkelur haptazi parimin e barazisë edhe në një aspekt tjetër.

Konkretisht, Komisioni ka tërhequr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër mbi 1400 vendime gjyqësore të dhëna nga unë përgjatë viteve 2003-2022. Asnjë subjekt tjetër rivlerësimi nuk është hetuar për një periudhë kaq të gjatë kohore dhe aq më pak të jetë kontrolluar nga KPK, mbi 1400 vendime të dhëna prej tij. Vetë numri mbi 1400 i vendimeve të tërhequra dhe kohëzgjatja e periudhës në të cilën është shtrirë hetimi 2003-2022, tregon më së miri se procesi im ka qënë i paragjykuar, pra që Komisioni medeomos ka dashur të gjejë gjilpërën në kashtë.

Dhe çfarë ka gjetur !!! ***sipas meje asgjë fare***. Sipasi tij (Komisioni), ka gjetur se kam shkelur ligjin përsa i përket afatit 10 ditor të sipërpërmëndur të parashikuar nga neni 155 i KPC dhe/apo mosdokumentimi i njoftimeve të paditësve/kërkuesve për seancën e parë, në ***41 çështje, shumica dërrmuese gjykime pa palë,*** (që më sipër e kam shpjeguar se nuk ekzistojnë, por edhe në vijim të ankimit do t'a bëj në mënyrë më të detajuar shtjellimin e tyre), ***ka gjetur që kam gjykuar 6 raste në konflikt të supozuar interesi***, gjithmonë sipas tij, por që sipas meje konflikti i interesit nuk ekziston, (*raste këto që përbëhen nga 1 urdhër ekzekutimi (), 1 dëshmi trashëgimie, 1 sigurim prove, 1 pjestim gjyqëësor i lënë në fuqi deri në Gjykatën e lartë, (faza e dytë e pjestimit), por që nuk mund të merret në konsideratë në kuadrin e kriterit profesional, pasi i përket vitit 2004, pra jashtë periudhës së vlerësimit, 1 vendim që unë kam dalë në pakicë që i referohet babait të shtetasit Lulzim Karini, (që e shpjegova më sipër dhe në vijim të ankimit do t'a shpjegoj më hollësisht) dhe 1 pjestim gjyqësor ku zoti Lulzim Karini ka qënë përfaqësues i njërës prej palëve por që asnjë palë nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit përfundimtar të dhënë nga unë, duke mos e vënë në dyshim drejtësinë e dhënë nga unë në cilësinë e gjyqtarit*), ***5 raste që sipas tij kam dhënë vendime të ndërmjetme të gabuara***, për mospezullim gjykimi dhe/apo dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm .

Pra, 41+6+5= 62 çështje. Po të shikohet numri 62 çështje në raport me numrin ***1400 të vendimeve*** që ka hetuar Komisioni, 62/1400=***4,42%*** që sipas Komisionit janë gjetur mangësi.

Shtrohet pyetja: - Përderisa Komisioni në ***95,58%*** (= 100-4,42), nuk ka gjetur shkelje, dhe madje edhe shkeljet që ka gjetur janë të natyrës së sipërpërshkruar, - A është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, barazisë, ligjshmërisë, objektivitetit, penalizimi im me masën e shkarkimit nga detyra, referuar kriterit të profesionalizmit. Përgjigjja është e qartë, JO. Madje, nëse nxjerrja e të dhënave të mësipërme do të bëhej jo në kuadrin e procesit të rivlerësimit por në kuadrin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional nga KLGj, unë do meritoja vlerësimin minimalisht ***shumë mirë*** dhe me shumë mundësi ***shkëlqyeshëm***. Kjo po të kishte dhe të ketë drejtësi. Megjithatë, nuk kam pritur këtë ankim për të dhënë vlerësimin tim që në procesin tim të rivlerësimit, kam patur të bëj me drejtësi nga ajo e leopardëve të fabulës. Këtë ia kam bërë me dije Komisionit, ballas, sy më sy, në seancat dëgjimore.

Unë në këtë pikë i kërkoj Kolegjit, po atë që i kam kërkuar Komisionit dhe nuk e ka marrë parasysh dhe as përmëndur në vendimin e tij. Më gjeni një gjyqtar në Republikën e Shqipërisë, që po t'i kontrollohen mbi 1400 vendime të dhëna prej tij, si në rastin tim, dhe po nuk rezultoi me po ato shkelje, po aq në numër apo më shumë, nga ato që më atribuon Komisioni mua në vendimin që po ankimoj, atëhere dhe unë jam dakort që Komisioni ka patur të drejtë. ***Më gjeni një të vetëm***.

Po nuk u gjet asnjë dhe unë jam i sigurtë se nuk ka asnjë, atëherë vetë ky fakt negativ, është provë e faktit se unë nuk jam trajtuar në mënyrë të barabartë me subjektet e tjerë të rivlerësimit.

Së gjashtëmbëdhjeti: Në vendimin e Komisionit, referuar kriterit të profesionalizmit, Komisoni shprehet se kam dhënë vendim me ekzekutim të përkohshëm në ***tre raste*** në kundërshtim me ligjin.
Në lidhje me këto kontatime dhe vlerësime të shprehura në vendimin e Komisionit, do të shprehem në mënyrë të hollësishme, kur të analizoj çështje për çështje, rastet në fjalë, në atë pjesë të ankimit ku do të trajtoj kriterin e profesionalizmit. Megjithatë, meqënëse në këtë pjesë të ankimit po jap në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit, përmes dhënies së konsideratave me natyrë të përgjithshme, atëherë e vlerësoj me vend që shkurtimisht dhe përmbledhtas lidhur me keto ***tre raste***, të ngre shkaqet e ankimit si më poshtë:

a. Këto tre raste janë inspektuar edhe nga ILD (*në dy raste vendimi i ILD nuk është ankimuar dhe në një rast është ankimuar por është lënë në fuqi nga KLGj*), dhe ky insitucion nuk ka gjetur shkelje. Sipas ILD dhe KLGJ (përmbledhtas) ankesat mund të zgjidhet vetëm në rrugën e ankimit gjyqësor, në Gjykatat më të larta. Natyra e ankesave të parashtruara nuk bën pjesë në kompetencën e organeve të mbikqyrjes disiplinore, pasi kjo do të binte ndesh me nenin 3 të Ligjit 96/2016 që parashikon se gjyqtarët janë të pavarur në interpretimin e ligjit dhe të fakteve nga çdo shkak dhe për çdo arsye.

Komisioni ndonëse ka shqyrtuar si prova këto qëndrime të organeve të mbikqyrjes disiplinore të zakonshme të veprimtarisë së magjistratëve, nuk i merr në konsideratë këto qëndrime dhe merr përsipër të japë opinionin e tij, që është kundër mendimit tim dhe të ILD. Unë vlerësoj se ky qëndrim i komisionit bie ndesh si me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si me ligjin 96/2016 ashtu edhe me qëndrimin e unifikuar në praktikën e KPA në rastin e subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha, etj.

b. Komisioni, në vendimin e tij nuk citon në mënyrë të plotë, por të deformuar, të mangët dhe të cunguar shpjegimet e mia në lidhje me këto tre raste. Kjo bëhet me qëllim që të krijohet paqartësi tek lexuesi dhe për rrjedhojë tek ky i fundit të krijohet në mënyrë të rreme përshtypja se Komisioni ka të drejtë në qëndrimin e tij.

Ky efekt në dukje që synohet të arrihet përmes mospërshkrimit të plotë në vendimin e Komisionit të arsyetimevet të dhëna nga unë lidhur me tre rastet e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, niset nga premisa fillestare manipulative se po u përshkruan me mangësi, të cunguara dhe me paqartësi arsyetimet e mia se përse i kam dhënë vendimet e ekzekutim të përkohshëm, atëherë lexuesi do të paaftësohet të bëjë përmes krahasimit të qëndrimeve, dallimin e të rremes nga e vërteta, e qëndrimit të bazuar nga ai jo i bazuar në logjikë dhe/apo ligj.

c. Arsyetimet që kam përdorur për dhënien e vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, jo vetëm që janë të bazuara në fakte dhe në lig,j (sipas intepretimit që i bëj unë si gjyqtar, në mënyrë të pavarur ligjit dhe fakteve), por janë të shkëlqyera. Unë mendoj se nuk mund të jetë pjesë e fajësisë time që Komisioni bën sikur nuk i kupton nivelin e lartë të këtyre arsyetimeve apo ka qëndrim të kundërt në intepretimin e ligjit, në raport me qëndrimin tim.

Në thelb, qasja e ndryshme që kemi unë dhe Komisioni në intepretimin e nenit 317 të KPC, lidhur me ekzekutimin e përkohshëm të vendimit, konsiston në faktin se Komisioni i bën një intepretim "gjoja" gjuhësor (literal) përmbajtjes së normës, duke i trajtuar tre rastet e parashikuara nga paragrafi i parë i normës, (*i.* detyrimi për ushqim, *ii*. shpërblimi nga puna dhe *iii.* rivendosja në vend i baneses bashkëshortore), si raste të mbyllura, taksative dhe kategorike, se kur mund të jepet vendimi me ekzekutim të përkohshëm.

Unë ndryshe nga Komisioni, në arsyetimet e mia të vendimeve që kritikohen nga Komisioni, nuk kam bërë vetëm një intepretim gjuhësor të normës por gjithashtu edhe teleologjik, krahasimor dhe sintetik, me qëllim për të nxjerrë kuptimin e drejtë të saj, *ration* e ekzistencës së saj.

Ky intepretim shumëplanësh më ka çuar në kuptimin e normës që parashikohet në nenin 317 paragrafi i parë të KPC, si dispozitë me raste jo të mbyllura dhe taksative por me raste të hapura, orientuese, treguese dhe ilustruese përmes shëmbullit se si Gjykata duhet të zbatojë paragrafin e dytë po të nenit 317 të KPC. Në shpjegimet që i kam dhënë Komisionit për të përmbysur barrën e provës në këtë aspekt, (përmbledhtas), jam shprehur se ky lloj intepretimi i normave juridike as nuk është shpikur nga unë dhe as është zbatuar për herë të parë nga unë. Kam dhënë si shembull intepretimin që Gjykata e Lartë i ka bërë nenit 625 të Kodit Civil, që flet për dëmin jopasuror, që në pamje duket se është normë me raste të mbyllura por referuar ratios të kësaj norme, Gjykata e Lartë e ka intepretuar si normë me raste të hapura, treguese, orientuese përmes shëmbullit se kur mund të kërkohet shpërblimi i dëmit jopasuror.

Mesa konstatoj Komisioni ose nuk e ka kuptuar ose nuk ka dashur t'a kuptojë shëmbullin interpretativ që kam dhënë si më sipër.

Në këto rrethana po i jap Kolegjit (tashmë), një shëmbull të dytë që nuk jam unë ai që e kam zbatuar për herë të parë këtë lloj intepretimi (sipas ratios) të normave juridike.

Konkretisht, në nenin 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", në paragrafin e dytë të normës, ndodhet togjalëshi "***jo më pak se 8***". Kuptimi gjuhësor i normës që përfshin këtë togfjalësh, e vendos komisioneren Pamela Qirko në kushtet e pazgjedhshmërisë si anëtare (komisionere) e organeve të rivlerësimit. Kjo pasi kuptimi gjuhësor i cilësorit "jo më pak" tregon përjashtim, lënie jashtë, skualifikim.

Megjithatë ajo është zgjedhur në këtë funksion përmes një intepretimi të normës që duke u shprehur pozitivisht po them se është i ngjashëm me intepretimin që i kam bërë unë nenit 317 të KPC, (*në fakt nuk është i ngjashëm por shumë shumë shumë më i dobët dhe ndryshe nga intepretimi im, ka nuanca të forta sforcimi logjik dhe abuziviteti subjektiv në nxjerrjen e ratios së normës*).

Sipas këtij intepretimi "sipas ratios së normës" është arritur në kuptimin e normës se përdorimi i togfajëshit "jo më pak se 8", nuk është kusht kualifikues por vetëm "kriter dallues/diferencues brënda garës, pra që shërben jo për të kualifikuar por për të përzgjedhur ndërmjet kandidaturave".

Këtë intepretim të normës e ka bërë Avokati i Popullit, ONM dhe Kuvendi.

A nuk shërben vetë ***lartësia e këtyre institucioneve*** që kanë bërë intepretimin e normës "sipas ratios" që u përshkruar më sipër, si provë dhe fakt për të treguar që në kuptim të parimit të barazitë, të objektivitetit dhe të ligjshmërisë, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, ***ka qënë e drejta ime të intepretoj nenin 317 të KPC ashtu sikurse e kam kuptuar***.

ç. Veç sa më sipër, ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit se komisionerja Pamela Qirko ka qënë në kushte identike si ato të leopardëve të fabulës që tregova më sipër, kur ka vlerësuar se nuk kam intepretuar drejtë përmbajtjen e nenit 317 të KPC lidhur me rastet se kur jepet vendimi me ekzekutim të përkohshëm.

Konkretisht, në dhënien e opinioneve që unë kam shkelur ligjin kur kam dhënë vendimet me ekzekutim të përkohshëm, komisionerja Pamela Qirko, ***ka qënë në konflikt interesi***. Kjo pasi ndryshe nga sa rezulton nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, (ku ky pretendim që i kam parashtruar unë komisionit nuk përmëndet ose kamuflohen të dhënat e siguruara gjatë hetimit administrativ), motra e komisioneres në fjalë, ministria Belinda Balluku dhe apo vartësit e saj në shoqërinë OSHEE group sh.a, janë ankuar në Spak, KPK, ILD, etj, ndaj veprimtarisë time gjyqësore pikërisht për këto qëndrime.
Sipas nenit 30 të Ligjit 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative nëpunësi administrativ do duhej të dorëhiqej nga vendimarrja kur persona të afërm të tij, (p.sh motra), *i. kanë interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në çështjen në shqyrtim ose ii. Në çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim*. Unë kam kërkuar përjashtimin e Komisioneres për këtë shkak por më është refuzuar paligjshmërisht kërkesa e përjashtimit. (***Për këtë pikë do të shprehem në vijim të ankimit, më hollësisht duke paraqitur dhe/ose kërkuar marrjen e provave përkatëse mbështetëse***).

d. Unë ngre si shkak ankimi faktin që Komisioni ka shkelur ligjin 84/2016 si dhe ligjin 96/2016 (neni 72) pasi çdo vlerësues, nuk mund të shqyrtojë meritat e vendimarrjes gjyqësore. (shih vendimin e KPA për rastin Fuat Vjerdha, etj).

dh. Unë ngre si shkak ankimi se Komisioni ka shkelur parimin e barazisë në trajtim. Kjo pasi ndryshe nga rasti i subjektit të rivleresimit Ramiz Lala, që u konfirmua në detyrë si nga KPK ashtu edhe nga KPA, ndonëse kishte dhënë dy vendime me ekzekutim për përkohshëm, unë po ndëshkohem. Kjo pavarësisht se niveli i arsyetimeve të mia për dhënien e vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, është shumë më i lartë se rasti krahasimor në fjalë, dhe ndryshe prej këtij rasti, vendimarrjet e mia, në vlerësimin tim janë të bazuara në si në ligj ashtu dhe në prova e fakte të dala gjatë këtyre gjykimeve.

Së shtatëmbëdhjeti: Në vendimin e Komisionit, po referuar kriterit të profesionalizmit, Komisoni shprehet se në kundërshtium me ligjin, nuk kam pezulluar gjykimin e çështjes civile deri sa të zgjidhet çështja penale në **6 raste**, (brënda të cilave ku përfshihen edhe 3 rastet në të cilat kam dhënë vendimin me ekzekutim të përkohshëm që trajtova më sipër). Në vijim të ankimit do të shprehem më hollësisht për çdo çështje të veçantë nga këto 6 raste, megjithatë tani me vlerësoj me vend që të ngre në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit të mëposhtme:

a. Për një rast ankesa ime është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. (Rasti i ankuesit Mark Kulla dhe Nadire Kullolli). Ky fakt ka rëndësi pasi sipas ligjit 96/2016, përgjegjësia e magjistratit mund të lindë vetëm për shkelje të cilat pasi i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, konstatohen si të tilla nga gjykatat më të larta. Unë i kam dërguar si provë KPK vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Apelit Shkodër për t'a vërtetuar këtë fakt. Fakti që vendimi im kam dalë i pacënuar nga kontrolli gjyqësor, e bën gjetjen dhe konstatimin e komisionit lidhur me këtë vendim, absolutisht të parëndësishëm sipas parimeve të objektivitetit, proporcionalitetit dhe ligjshmërisë.

b. Lidhur me intepretimin e nenit 297 shkronja "a" të KPC, (që parashikon se gjykata mund ta pezulloje gjykimin e një çështjeje kur çmon se nuk mund të zgjidhet pa u zgjidhur një çështje tjetër penale, civile apo administrative), mesa duket unë dhe Komisioni kemi qasje të ndryshme në intepretimin e normës. Konkretisht, unë kam qëndrimin se norma ka karakter diskrecial, pra i lë hapësirë gjyqtarit të vlerësojë nëse mund t'a zgjidhë çështjen edhe pa u zgjidhur çështja tjetër penale, civile apo administrative, ***gjë që sipas meje duket qartë nga folja "mund"***. Komisioni e intepreton dispozitën në kuptimin se pezullimi duhet bërë në mënyrë të detyrueshme dhe automatike. Unë them se Komisioni e ka gabim. Megjithatë, besoj se Kolegji e di se ekziston shprehja "dy juristë tre mendime". Fakti se komisioni mendon se unë e kam gabim intepretimin e normës, nuk i i ka dhënë të drejtë të drejtë të më ndëshkojë. Kjo pasi një gjë e tillë ndalohet nga neni 3 i ligjit 96/2016, që sikurse u tha parashikon se gjyqtarët janë të lirë në interpretimin e ligjit dhe të fakteve pa u kushtëzuar nga asnjë shkak dhe ndonjë arsye. I kërkoj Kolegjit t'a riparojë këtë cënim gjë i është bërë nga komisioni hapësirës së pavarësisë së vlerësimit që më ka dhënë mua si magjistrat ligji, në intepretimin e ligjit dhe të pakteve. Kjo pasi një gjë e tillë është edhe jurisprudencë e konsoliduar e KPA, (shih vendimin e KPA për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha).

c. Edhe për konstatimet e kësaj natyre, unë ngre si shkak ankimi faktin që Komisioni ka shkelur ligjin 84/2016 si dhe ligjin 96/2016 (neni 72) pasi çdo vlerësues, nuk mund të shqyrtojë meritat e vendimarrjes gjyqësore. (shih vendimin e KPA për rastin Fuat Vjerdha, etj).

ç. Po ashtu, në dhënien e opinioneve të kësaj natyre, pra që do duhej të pezulloja gjykimin derisa të zgjidhej çështja penale me vendim të formës së prerë, ngre si shkak ankimi pretendimin se komisionerja Pamela Qirko, ka qënë në konflikt interesi. Kjo pasi ndryshe nga sa rezulton nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, (ku ky pretendim që i kam parashtruar unë komisionit nuk përmëndet ose kamuflohen të dhënat e siguruara gjatë hetimit administrativ), motra e komisioneres në fjalë, ministrja Belinda Balluku dhe apo vartësit e saj në shoqërinë OSHEE group sh.a, janë ankuar në Spak, KPK, ILD, etj, ndaj veprimtarisë time gjyqësore pikërisht për këto qëndrime. Sipas nenit 30 të Ligjit 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative nëpunësi administrativ do duhej të dorëhiqej nga vendimarrja kur persona të afërm të tij, (p.sh motra), *i. kanë interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në çështjen në shqyrtim ose ii. Në çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim*. Unë kam kërkuar përjashtimin e Komisioneres për këtë shkak por më është refuzuar paligjshmërisht kërkesa e përjashtimit. (***Për këtë pikë do të shprehem në vijim të ankimit, më hollësisht duke paraqitur dhe/ose kërkuar marrjen e provave përkatëse mbështetëse***).

d. Gjithashtu, ngre si shkak ankimi edhe faktin që në konflikt interesi lidhur me konstatimet e kësaj natyre, janë edhe të tre anëtarët e trupit gjykues të KPK që kanë dhënë vendimin. Kjo pasi sikurse përshkruhet në vetë vendimin e Komisionit, unë kam kërkuar pezullimin e procesit tim të rivlerësimit, (duke kërkuar të zbatohen rregullat e parashikuara si në Kodit e Procedurës Civile, si në Kodin e Procedurave Administrative ashtu edhe në ligjin për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative), deri sa të zgjidheshin çështjet e mëposhtme:

I. Kallzimi në SPAK që unë kam paraqitur ndaj të tre komisionerëve për ushtrimin prej tyre të detyrës në kushtet e pazgjedhshmërisë dhe paligjshmërisë, konkretisht për komisioneren Firdes Shuli se ka kryer veprën penale të fallsifikimit të dokumenteve pasi ka mbajtur të fshehtë faktin se ka patur masa disiplinore, etj, (për këtë do shprehem më hollësisht në vijim të ankimit), për komisioneren Pamela Qirko, se gjithashtu është në kushtet e pazgjedhshmërisë pasi nuk ka mesataren e notave të kërkuar nga neni 6 i ligjit 84/2016 dhe ka dyshime se ka fallsifikuar listën e notave, (edhe për këtë do shprehem më hollësisht në vijim të ankimit), për komisioneren Genta Tafa (ka shpërdoruar detyrën dhe nuk ka vjetërsinë në punë). Një kopje të kallzimit ia kam dorëzuar si provë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. Për komisioneren Firdes Shuli, kanë paraqitur kallzim mbrojtësit e mi av. Arben Llangozi dhe Av. Orgesa Serani, për fallsifikim dokumentesh kur ka kryer detyrën e noteres, fakt për të cilin kjo komisionere ka patur dijeni që përpara se të përfshihej në trupin tim gjykues, (ndryshe nga sa pretendon në vendim komisioni). Edhe praktikën e plotë të marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, ia kam dorëzuar si provë Komisionit. (Edhe për këtë kallzim do të shprehem më hollësisht në vijim të ankimit).

III. Ankesa në Gjykatën Kushtetuese si dhe në KPA, që kam paraqitur me emailin e datës 19.12.2022 si dhe me postë, përmes të cilës kam kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kuvendit për miratimin e listës në bllok për anëtarët e organeve të rivlerësimit, Pamela Qirko, Firdes Shuli, Alma Faskaj, etj.

Komisioni, sikurse e përshkruan vetë në vendim, ka disponuar mospranimin e kërkesave për ***pezullimin e gjykimit*** administrativ të procesit tim të rivlerësimit.

Por kjo vendimarrje për mospezullimin, - ***a nuk është e njëjta gjë apo minimalisht e ngjashme***, me vendimarrjen time në 6 rastet objekt analize, kur unë kam disponuar me vendim të ndërmjetëm mospezullimin e gjykimit ? Qartësisht PO.

Ateherë i bie që të tre komisionerët do të duhet të largoheshin nga gjykimi sipas nenit 30 të Ligjit 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative që parashikon se nëpunësi administrativ do duhej të dorëhiqej nga vendimarrja kur ai ose persona të afërm të tij, *i. kanë interes të drejtëpërdrejtë ose* ***jo të drejtëpërdrejtë*** *në çështjen në shqyrtim ose ii. Në çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim*.

dh. Vetë tre vendimet e ndërmjetme që mori KPK, për mospezullimin e procesit tim të rivlerësimit, - a nuk janë në vetvete prova që vërtetojnë pretendimin tim se norma e parashikuar në nenin 297 shkonja "a" të KPC, që sipas ligjit 84/2016, zbatohet edhe në gjykimin nga organet

e rivlerësimit, ka karakter diskrecial, pra i lë hapësirë gjyqtarit (apo komisionerëve) të vlerësojë/në nëse mund t'a zgjidhë/in çështjen edhe pa u zgjidhur çështja tjetër penale, civile apo administrative, gjë që sipas meje duket qartë nga folja "mund". Pra, pezullimi nuk është automatik dhe i detyrueshëm sikurse shprehet Komisioni në vendimin e tij dhe kjo duket qartë nga sjellja e vetë komisionit.

Pra, komisioni në gjetjet referuar mospezullimit të gjykimit, nga vetë sjellja që ai ka shfaqur në gjykimin tim administrativ prej tij, është sjellë me keqbesim dhe pandershmëri. Kjo pasi vepron me dy standarte në kundërshtim me parimin e barazisë. ***Ajo që mund të bëhet prej tij, nuk mund të bëhet prej meje***, pa dhënë në vendim asnjë arsyetim se ky ndryshojnë sjellja ime që quhet e paligjshme nga Komisioni, në krahasim me sjelljen e vetë Komisionit.

Së tetëmbëdhjeti: Në vendimin e Komisionit në disa raste vendimet e dhëna prej meje kritikohen përsa i përket nivelit të arsyetimit duke u shprehur Komisioni se arsyetimi është ***i mangët*** (*tre raste, konkretisht vendimi lidhur me çështjen Hysen dhe Hasan Temali, dy vendimet për shtetasin Shefqet Molla, të përmëndura te kriteri i figurës*) ***ose i gabuar*** (*tre rastet e dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm dhe një rast që përmënden tek kriteri i profesionalizmit, konkretisht rasti i Kurum International përsa i përket arsyetimit të përcaktimit të masës së dëshpërblimit si dhe një rast që përmëndet tek kriteri i figurës, që është dëshmia e trashegimisë së shtetasit Izet Karini*). Pra gjithsejt 8 raste.

Lidhur me këto konstatime dhe vlerësime të Komisionit ngre si shkak të përgjithshëm ankimi se qartësisht Komisoni ka kapërcyer kompetencat duke shkelur kësisoj ligjin 84/2016, ligjin 96/2016 si dhe praktikën e konsoliduar të KPA që përmbledhtaz përcakton se organet e rivlerësimit, nuk mund të shqyrtojnë meritat e zgjidhjes së çështjes nga magjistratët si dhe në dhënien e konsideratave të tyre nuk mund të zëvendësojnë opinionin (arsyetimin) e përdorur nga magjistrati në zgjidhjen e çështjes, me arsyetimin që ka vetë vlerësuesi për zgjidhjen e çështjes.

Gjithashtu, ngre si shkak ankimi edhe faktin se në dhënien e opinioneve/vlerësimeve të mësipërme, (në të gjitha rastet), Komisioni ka vepruar në kundërshtim në opinionet e ish Inspektoriatit të KLD, të ILD dhe KLGj, që i kanë shqyrtuar më parë këto raste, mbi bazën e ankesave disiplinore që subjektet e interesuara kanë paraqitur ndaj veprimtarisë time gjyqësore, dhe nuk është gjetur asnjë shkelje.

Unë këto qëndrime të këtyre organeve të mbikqyrjes disiplinore të veprimtarisë time gjyqësore ia kam paraqitur si prova Komisionit, për të vërtetuar se cili është opinioni/vlerësimi i një vëzhguesi të jashtëm lidhur me "problematikat" e konstatuara, por këto prova nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, ***pa ndonjë arsyetim logjik, të shëndoshë dhe të bazuar***, duke përdorur Komisioni lojra fjalësh apo intepretim gjuhësor të gabuaar të normës për të hedhur poshtë prapësimet e mia dhe fuqinë provuese të këtyre provave, (shih.psh paragrafin 85.10 të vendimit të Komisionit), ***ose*** duke përdorur komisioni ***shprehje të përgjithshme, abstrakte, stereotipe, pra jo konkrete*** se përse praësimet e mia janë të pabazuara.

Përveç sa më sipër, ngre si shkak ankimi, edhe faktin se në vendimin e Komisionit nuk pasqyrohen të plota argumentimet, prapësimet që kam dhënë unë por ato ose nuk pasqyrohen fare, (p.sh arsyetimet e mia se përse i kam dhënë vendimet me ekzekutim të përkohshëm), ose

pasqyrohen në mënyrë fragmetare, të shkëputur, pa kohezion, (të gjitha rastet e tjera), në mënyrë që të krijojnë tek lexuesi i vendimit fillimisht paqartësi në kuptimin e këtyre argumenteve dhe prapësimeve të mia dhe në fund, ***për shkak të moszbatimit efektiv të parimit të kontradiktoritetit përmes krahasimit të qëndrimeve të mia me ato të Komisionit***, tek lexuesi të krijohet bindja e rreme se qëndrimi i Komisionit është i drejtë.

I Kërkoj Kolegjit që të gjitha arsyetimet e mia për të cilat Komisioni ka shprehur kritikat e tij, t'i shkruaj në vendim të plota në mënyrë që të zbatohet efektivisht parimi i kontradiktoritetit dhe për rrjedhojë edhe parimi i gjykimit të drejtë dhe të barabartë.

Në lidhje me sa më sipër, ngre si shkak ankimi edhe faktin se arsyetimet e mia të përdorura në vendimet që kritikon Komisioni, ***ose nuk kanë sjellë ose as mund të sillnin apo nuk mund të thuhet akoma se kanë sjellë ndonjë pasojë të kundërligjshme***. Kjo pasi vendimet në fjalë të dhëna nga unë, ose kanë dalë të pacënuara nga kontrolli gjyqësor i Gjykatave më të larta apo kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar ose vazhdojnë akoma të përbëjnë objekt kontrolli gjyqësor në Gjykatat më të larta, që janë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm apo Gjykata e Lartë. Pa pasoja të paligjshme, nuk ka dënim/ndëshkim, pasi në të kundërt do veprohej në kundërshtim me parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit. ***Pa pasoja të paligjshme, nuk mund të argumentohet logjikisht cënimi i besimit publik nga veprimtaria ime gjyqësore***. Kjo pasi nëse askush nuk është dëmtuar konkretisht dhe individualisht nga unë si gjyqtar paligjshmërisht, atëherë si mundet logjikisht të argumentohet konkretisht dhe/apo në përgjithësi cënimi i besimit publik nga veprimtaria ime gjyqësore. Nëse veprohet në të kundërt, pra sikurse ka vepruar Komisioni, kjo të kujton atë shprehjen sarkastike "*o popull - sa gjëra janë bërë në emrin tënd*".

Për të kundërshtuar qëndrimin e Komisionit si më sipër, i evidentoj Kolegjit faktin se unë i kam kërkuar Komisionit në mënyrë të përsëritur, me shkrim dhe me gojë (në seancat dëgjimore), pezullimin e procesit tim të rivlerësimit deri në kohën që Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe/apo Gjykata e Lartë, të kontrollojë në rrugë gjyqësore vendimet e mia që kritikohen nga komisioni dhe për të cilat ai gjatë hetimit administrativ më pati ngarkuar barrën e provës. Këto kërkesa i referova duke përdorur si bazë ligjore nenin 297 shkronja "a" të KPC që bën fjalë për pezullimin e gjykimit deri sa të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile apo administrative.

Të gjitha kërkesat mia në fjalë, u refuzuan nga Komisioni, pa ndonjë arsyetim të ligjshëm dhe të kuptueshëm. Komisioni duke vepruar kësisoj, ***qartazi veproi me dy standarte***. Kjo pasi ***nga njëra anë***, (sikurse u shpreha në pjesët e mësipërme të ankimit), mua më ngarkoi barrë prove për të vërtetuar se vendimet e mia për mospezullimin e gjykimit të disa çështjeve, ishin të ligjshme, (gjë që u pasua me faktin se komisioni shprehet në vendimin objekt ankimi se vendimet e mia për mospezullimin e gjykimit, nuk ishin të ligjshme, gjë që e përshkrova më sipër), ***ndërsa nga ana tjetër***, vetë Komisioni nuk pezulloi gjykimin administrativ, për të pritur qëndrimin e Gjykatave më të larta. (Këtu evidentoj edhe faktin se Komisioni shkeli edhe nenin 36 të KPC që parashikon se *asnjë juridiksion tjetër nuk mund të shqyrtojë ose të japë vendim për një çështje që po shqyrtohet nga Gjykata*).

A nuk është ***ky qëndrim me dy standarte i vetë Komisionit***, (veç sa jam shprehur më sipër kur trajtova problematikën e pezullimit të disa gjykimeve që ka ngritur Komisioni), provë dhe fakt se unë kam patur të drejtë në pretendimin tim (të lartëpërmëndur) se norma e parashikuar në nenin 297 shkonja "a" të KPC, (*që sipas ligjit 84/2016, zbatohet edhe në gjykimin nga organet e rivlerësimit*), ***ka karakter diskrecial***, pra i lë hapësirë gjyqtarit (apo komisionerëve) të vlerësojë/në nëse mund t'a zgjidhë/in çështjen edhe pa u zgjidhur çështja tjetër penale, civile apo administrative, gjë që sipas meje duket qartë nga folja "mund". Pra, - a nuk është ky qëndrim me dy standarte i vetë Komisionit tregues i pandershmërisë së tij në trajtimin e procesit tim të rivlerësimit, i paragjykimit të tij, i vënies në jetë nga vetë Komisioni të proverbit dystopik "*bëj çfarë të them unë por mos bëj çfarë bëj unë*".

Në lidhje me sa më sipër, së fundi ngre si shkak ankimi, se të gjitha arsyetimet e mia për të cilat kam qëndrim të kundërt me atë të Komisionit, në këndvështrimin tim, ***janë ligjore*** dhe të bazuara në bindjen time të brëndshme që kam krijuar nga intepretimi që i kam bërë ***në mënyrë të pavarur*** ligjit dhe fakteve të rezultuara gjatë gjykimit, pa u kushtëzuar nga asnjë shkak apo arsye jashtë proceseve gjyqësore ku kam dhënë këto vendime.

Pa dashur të bie në përsëritje, pasi më sipër jam shprehur disi në mënyrë të përgjithshme, bëj me dije Kolegjin se lidhur me këtë qëndrim timin, do të shprehem më hollësisht në atë pjesë të ankimit ku do të shpreh qëndrimin tim çështje për çështje, në veçanti.

Së nëntëmbëdhjeti: Në paragrafët 93-93.5 të vendimit të Komisionit, kritikohem dhe ndëshkohem pasi kam gjykuar një çështje e cila sipas vlerësimit të Komisionit ka qënë në kushtet e litispendences, pra në kushtet e parashikuara në nenin 58 të Kodit të procedurës Civile, në raport me një çështje tjetër që ishte për shqyrtim, mbi bazë ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë. Lidhur me këtë çështje kam dhënë shpegimet e mia por që nuk janë konsideruar bindëse nga Komisioni.

Lidhur me këtë çështje ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit, (*në mënyrë të përmbledhur pasi në vijim të ankimit do shprehem më hollësisht kur të analizoj çështjen konkrete*), sa më poshtë:
a. Qëndrimi që kam mbajtur në gjykimin e kësaj çështjeje është ligjor dhe në pajtim të plotë me interesat e drejtësisë. Po ashtu i qëndroj edhe shpjegimeve që kam mbajtur përpara Komisionit. Unë vlerësoj se sipas nenit 100 të KPC, palët janë të detyruara që të sillen me mirëbesim dhe ndershmëri. Ata e kanë të ndaluar që të përdorin mjete procedurale për të zvarritur procesin gjyqësor si dhe e kanë të ndaluar që këto mjete procedurale t'i përdorin pa patur nevojë për të mbrojtur ndonjë të drejtë apo interes material të ligjshëm. Aq më shumë e kanë të ndaluar që këto mjete procedurale (*ankime në gjykatat më të larta, kërkesa për përjashtim gjyqtarësh, kërkesa për përjashtim eksperti, kërkesa për shtyrje seancash gjyqësore, etj*), t'i përdorin kundër parimeve themelore të dhënies së drejtësisë, sikurse p.sh me qëllim që të shkaktojnë rënien në parashrim shues të së drejtës së të dëmtuarit për të kërkuar dëmshpërblim, me qëllim për të përzgjedhur gjykatën përmes kërkesave të pabazuara për përjashtimin e gjyqtarëve të veçantë, me qëllim për të vënë nën presion apo ndikuar jo drejtësisht Gjykatën në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, etj. Palët janë të detyruara sipas vlerësimit tim që të përdorin mjetet procedurale që parashikon ligji për të garantuar aksesin e tyre në shërbimin gjyqësor vetëm kur kanë nevojë reale për të mbrojtur ndonjë të drejtë subjektive apo interes material të ligjshëm.

Çdo mjet procedural i përdorur në kundërshtim me këto parime themelore të dhënies së drejtësisë, në vlerësimin tim si gjyqtar, përbën një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm dhe si i tillë, përveçse duhet konsideruar i papranueshëm proceduralisht, pikërisht për shkak të qënies së tij veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, ai nuk sjell asnje pasojë që në kohën kur është kryer dhe ky nulitet mund të konstatohet dhe konsiderohet nga ***kushdo***, pra edhe nga Gjykatat të cilat ***vetëm*** në pamje, dukje, formë, nuk kanë kompetencë për të trajtuar rastin.

Si shëmbull për këtë vlerësim timin mund të sjell vendimin e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë që e konsideroi si akt absolutisht të pavlefshëm Dekretin e Presidentit të Republikës për anullimin e zgjedhjeve lokale të vitit 2019. Në këtë rast, kjo gjykatë, në pamje, në dukje, në formë, nuk kishte për objekt gjykimi, ndonjë kërkim gjyqësor për anullimin e këtij dekreti. Gjyqtarët Gentian Medja, Astrit Kalaja, etj, që kanë dhënë këtë vendim, e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Unë nuk ka ndonjë arsye fakti apo ligji që të diferencohem në raport me t'a në trajtimin e rastit objekt analize. Kjo pasi në të kundërt do shkelej parimi i barazisë në trajtim që është një nga parimet themelore të drejtësisë. Aq më shumë që vendimi që po sjell si shëmbull, qartësisht ka patur sensibilitet ***shuuumë*** më të lartë publik se rasti gjyqësor objekt analize për të cilin unë po ankimoj qëndrimin e Komisionit.

b. Trupi gjykues i Komisionit që ka trajtuar rastin, pra që ka dhënë vendimin objekt i ankimit tim, qartazi ka vepruar me dy standarte, duke zbatuar atë proverbin dystopik që thashë më sipër, "*bëj çfarë të them unë por mos bëj çfarë bëj unë*". Kjo pasi ndërsa kërkesën për përjashtimin e tre komisionerëve të këtij trupi gjykues, që unë e paraqita edhe me postë por edhe me email në datën 19.12.2022, nuk e përcolli për gjykim tek një trup tjetër gjykues i KPK, (gjë që në pamje, formë, dukje, është shkelje e ligjit procedural), ***me arsyetimin se kjo kërkesë përjashtimi është abuzive***, po ky trup gjykues, kur shprehet në vendim, në paragrafët 93 - 93.5, jep vlerësimin se "***unë kam shkelur nenin 58 të KPC pasi nuk është dashur të shprehem për vlefshmërinë e ankimit të paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, pasi nuk kam patur kompetencë***". Ky qëndrim me dy standarte i Komisionit, është tregues në vetvete i pandershmërisë së tij në procesin tim të rivlerësimit. I Kërkoj Kolegjit që të riparojë parregullsinë në fjalë të veprimit të Komisionit duke respektuar parimin e barazisë në trajtim, duke e trajtuar çështjen time në seancë publike, (jo në dhomë këshillimi), qoftë edhe për këtë shkak.

c. Komisioni ka vepruar me "dy standarte" edhe kur shprehet në paragrafin 93.5 si më poshtë:
omissis... Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti gjatë gjithë parashtrimeve të tij në lidhje me vlerësimin profesional, shprehet se asnjë institucion shtetëror nuk mund të shprehet për meritat, themelin e çështjes, përpara se të shprehet gjykata kompetente. Kjo, pasi çdo veprim në të kundërt vlerëson se cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Ndërkohë, nga ana e tij në këtë vendim gjyqësor është analizuar ankimi i paraqitur nga pala në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra që nuk ka qenë në kompetencë të subjektit për t'u analizuar.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka vijuar gjykimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile, duke shqyrtuar një çështje e cila ishte duke u gjykuar në

një gjykatë më të lartë. Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor në kuptim të nenit 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

Pra sikurse shihet nga pjesa e nënvizuar në këtë paragraf të vendimit të Komisionit, ai kur shprehet se unë nuk kam patur të kompetencë për të gjykuar rastin, bie në kundërshtim me vetveten pasi as Komisioni dhe as Kolegji, në këndvështrim të zbatimit të nenit 36 të KPC, nuk mund të shprehen për rastin pa u shprehur më parë gjykata kompetente që aktualisht është Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Pra prapë, Komisioni ka zbatuar shprehjen "*bëj çfarë të them unë por mos bëj çfarë bëj unë*". Madje kontradikta thellohet pasi kjo kontradiktë ***nuk është karakteristike vetëm për këtë rast***, por edhe për të gjitha rastet e tjera të analizuara më sipër, për të cilat Komisioni ka dhënë vlerësimin e tij, pa u shprehur akoma Gjykata e Apelit dhe/apo Gjykata e Lartë, (bëhet fjalë për rastet e përmëndura më sipër, për të cilat unë i kam kërkuar Komisionit pezullimin e procesit të rivlerësimit dhe/apo mospërfshirjen e tyre në vlerësimin tim profesional, deri sa këto raste të përfundojnë së shqyrtuari në rrugët e ankimit gjyqësor me vendim përfundimtar dhe të formës së prerë).

ç. Edhe për këtë rast, nuk mund të thuhet (pa përfunduar gjykimi në gjykatat më të larta) se vendimarrja ime ka sjellë pasoja të paligjshme. Kjo pasi pa pasoja të paligjshme nuk ka as dënim dhe as ndëshkim. Veprimi në të kundërt do binte ndesh me parimin e ligjshmërisë. Për më tepër veprimi në të kundërt do të dhunonte në mënyrë flagrante edhe një nga parimet themelore të drejtësisë, që është ai i "mosgjykimit pa u dëgjuar". Kjo pasi po të quhet i ligjshëm veprimi i Komisionit që është shprehur për këto raste objekt analize, atëherë për shkak të autoritetit që ka Kolegji i Posaçëm i Apelimit në sistemin gjyqësor, (***pasi ky institucion është dhomë e Gjykatës Kushtetuese***), do të krijohej një opinion formalo-juridik për zgjidhjen e këtyre çështjeve që rrezikon në dukje por edhe në substancë që t'a shndërrojë në formalitet dhe iluzion angazhmin ***me pavarësi*** të gjykatave që po i trajtojnë aktualisht rastet objekt analize.

d. I kërkoj Kolegjit që trajtimin e këtij rasti t'a bëjë duke patur parasysh veç sa më sipër edhe parimin e proporcionalitetit.

<u>Së njëzeti</u>: Ngre si shkak ankimi diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë që kam patur në procesin tim të rivlerësimit të kryer nga Komisioni, në raport me subjektet e rivlerësimit të përmëndur në këtë ankim dhe veçanarisht subjektet e rivlerësimit Ilir Toska, Arben Dosti, Astrit Kalaja, Fuat Vjerdha, Arens Çela, Arbër Çela, Armida Hamiti (Moçka), Mariola Mërtiri, Marsida Frashëri, Riselda Fishta, Artan Çupi dhe Dritan Hallunej. Sikurse e përshkruajta edhe më sipër, diskriminimi dhe trajtimi im i pabarabartë, ka ardhur për një grup shkaqesh (motivesh) diskriminuese që janë si më poshtë:

1. <u>Motivi i hakmarrjes</u>. Kjo pasi kam guxuar që të demaskoj sy më sy, ballas, në seancat dëgjimore, **si** komisionerët e trupit gjykues që kanë dhënë vendimin që më ka shkarkuar nga detyra **ashtu** një pjesë të komisionerëve që kanë shqyrtuar 11 kërkesat e përjashtimit të anëtarëve të trupit gjykues që kam paraqitur unë, lidhur me faktin që këta komisionerë nuk plotësojnë standartin kushtetues të "Gjykatës së krijuar me ligj", pra janë zgjedhur në funksionit e anëtarëve

të organeve të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 të Ligjit 84/2016. (*Lidhur me arsyet e veçanta të pazgjedhshmërisë, jam shprehur në mënyrë të përgjithshme më sipër, por në vijim, do shprehem më hollësisht në pjesën e ankimit ku do trajtoj 11 kërkesat e përjashtimit të komisionerëve, që sipas meje janë trajtuar jo sipas ligjit*).

2. Motivi i parë i hakmarrjes se Komisioneres Pamela Qirko. Ky motiv hakmarrjeje është i qartë pasi kam guxuar të ekspozoj konfliktin e interesit që kjo komisionere ka patur në procesin tim të rivlerësimit. Kjo pasi ndryshe nga sa është shprehur në vendimin e Komisionit, ka prova të qarta se motra e Komisioneres në fjalë, ministri dhe njëkohësisht zëvendëskryeministrja Belinda Balluku dhe/apo vartësit e kësaj të fundit në shoqëritë aksionere publike OSHEE Group sh.a, OST sh.a dhe KESH sh.a, kanë paraqitur në SPAK, KPK, ILD, ankesa ndaj veprimtarisë time gjyqësore. Njëherazi, këto shoqëri tregtare por edhe Ministria e Energjitikës dhe Infrastrukturës e drejtuar nga motra e Komisioneres, janë palë kundështare në disa procese gjyqësore, si me mua personalisht, si me vëllain tim Gerti Ymeri, si me babain tim Faik Ymeri, si me nënën time Elvira Ymeri si me vëllain e bashkëshortes time Ardit Hallunovi. Për këtë i kam paraqitur prova Komisionit por nuk janë marrë parasysh. Veç tyre do të paraqes në Kolegj edhe prova të tjera mbështetëse. (*Edhe lidhur me motivin e konfliktit të interesit do shprehem në vijim të ankimit më hollësisht, në pjesën ku do të trajtoj qëndrimin tim se përse është i gabuar qëndrimi i shprehur në vendimin e Komisionit, lidhur me kriterin profesional*).

3. Motivi i hakmarrjes që ka patur Komisioneri Roland Ilia (i përjashtuar nga gjykimi me kërkesën time) në raport me mua. Ky komisioner deri në kohën që është pranuar kërkesa ime për përjashtimin e tij, ka ushtruar funksionin e komisionerit relator të trupit gjykues. Pra është ai që më ka hetuar mua.
Ky komisioner, në shpërdorim të qartë të detyrës, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, faktik, të vazhdueshëm, në dukje dhe të mundshëm me mua, por ka vijuar të më hetojë dhe të më gjykojë. Kjo ndonëse ai ka qënë në procedim penal të paktën 3 herë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vepra penale të ndryshme si korrupsioni pasiv, shpërdorimi i detyrës, fallsifikimi i kryer në bashkëpunim, etj, veprime këto të dyshuara se janë kryer në kohën kur ka qënë pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër. Në kuadrin e këtyre procedimeve penale ai është vënë në përgjim telefonik, ambiental, ndaj tij janë marrë masa sigurimi personal me karakter shtrëngues, etj.

Gjatë kohëvazhdimit të këtyre procedimeve penale ai është përpjekur disa herë të më kontaktojë dhe takojë por unë e kam shpërfillur gjithmonë pasi kam menduar që qëllimi i tij ka qënë për të siguruar favore gjyqësore të paligjshme.

Po ashtu, ky komisioner ka marrë pjesë si avokat në disa gjykime civile ku unë kam qënë gjyqtar, të cilat të gjitha, përveç një rasti të vetëm, kanë përfunduar në mënyrë jo të suksesshme për këtë ish avokat.

Të dhënat/provat/faktet e mbedhura nga ky komisioner, në pjesën më të madhe të tyre, (***sikurse janë p.sh përgjigjet e dy pyetësorëve, provat dokumentare, etj***), pavarësisht se në vetvete janë rrjedhojë/pasojë e veprimtarisë së tij absolutisht të pavlefshme, pasi ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, ***nuk janë konsideruar të papërdorshme*** nga trupi gjykues i formuar pas përjashtimit të tij nga gjykimi, me kërkesën time. Madje në kundërshtim me ligjin, ***trupi i ri***

gjykues nuk ka disponuar as përsëritjen e veprimeve administrative për mbledhjen e provave të papërdorshme në fjalë, të cilat, për më tepër i citon dhe i referohet si të përdorshme edhe në vendimin që unë po ankimoj.

Ky komisioner, për t'u hakmarrë ndaj meje, i rekomandoi trupit gjykues të Komisionit përpara se ai të largohej nga gjykimi, që procesi im i rivlerësimit të bëhej vetëm me një kriter, atë të pasurisë, (gjë që nënkuptonte qartë shkarkimin tim nga detyra).

Veç kësaj ai referuar kriterit të pasurisë, më bëri një analizë financiare qartësisht fallco dhe fiktive, duke më nxjerrë me bilanc negativ rreth 6.600.000 (gjashtëmilion e gjashtëqindmijë) lekë, analizë kjo që në vijim u vërtetua se nuk ishte e bazuar në ligj dhe në prova. Kjo duke marrë në konsideratë qoftë edhe vetëm analizën financiare që shprehet në vendimin e Komisionit që unë po ankimoj përpara Kolegjit, që ka dalë 4.500.000 (katërmilion e pesëqindmijë) lekë, (as me të cilën sikurse e thashë nuk jam dakort).

Edhe pasi u përjashtua nga gjykimi, komisioneri Roland Ilia, gjeti një mekanizëm tjetër, për t'u hakmarrë, duke përdorur miken e tij Komisioneren Pamela Qirko:

4. Motivi i dytë i hakmarrjes së komisioneres Pamela Qirko, për shkak se kam guxuar të ekspozoj përmes paraqitjes së kërkesës përkatëse të përjashtimit, figurën morale, integritetin profesional si dhe kushtet e pazgjedhshmërisë si dhe konfliktin e interesit që ka patur në raport me mua, ***miku i komisioneres Pamela Qirko, dhe konkretisht Komisioneri Roland Ilia***. (*Edhe për këtë motiv do shprehem më hollësisht në vijim të ankimit, në pjesën ku do të trajtoj përmes paralelizimit se përse nuk qëndron dhe është i pabazuar vlerësimi i Komisionit se unë dhe shtetasi Lulzim Karini kemi lidhje miqësore dhe familjare*).

5. Motivi i parë i hakmarrjes së komisioneres Firdes Shuli, Lidhur me këtë motiv, bëj me dije Kolegjin se unë gjatë gjykimit përmes prokurës së posaçme noteriale përkatëse, kam autorizuar për të më përfaqësuar dhe mbrojtur në gjykim, me datën 24.06.2022, av. Arben Llangozi dhe Av.Gerti Ymeri.

Av. Arben Llangozi është legjitimuar si mbrojtës i imi në bazë të vendimarrjes së trupit gjykues të Komisionit, në seancën dëgjimore të datës 27.06.2022 ndërsa av. Gerti Ymeri është legjitimuar si mbrojtës i imi në seancën dëgjimore të datës 13.07.2022.

Komisionerja Firdes Shuli është përfshirë në trupin gjykues timin me datën 19.07.2022, pas përjashtimit të Komisioneres Etleda Çiftja.

Pra sikurse shihet, av. Arben Langozi dhe av. Gerti Ymeri, janë legjitimuar si mbrojtës të mi përpara se të përfshihej në trupin gjykues, Komisionerja Firdes Shuli.

Kjo e fundit në mënyrë të paligjshme nuk ka deklaruar konfliktit e interesit me mbrojtësit e mi. Kjo pasi ajo është kallzuar nga studio ligjore Jurisprudenca, për kryerjen e veprës penale të fallsifikimit të dokumenteve, në kohën kur ka kryer detyrën e noteres në qytetin e Gjirokastrës.

Aktualisht, për procedimin penal të filluar mbi bazë të këtij kallzimi, Gjykata e Apelit Gjirokastër, (gjyqtari Sokol Pina), ka urdhëruar Prokurorinë të vijojë hetimet. (*shih për më hollësi dy kërkesat e përjashtimit që do përmënden në vijim të përmbajtjes së ankimit*).

Kallzimi është përgatitur nga tre avokatë dhe konkretisht, av. Arben Llangozi që është ortak i vetëm i shoqërisë Jurisprudenca sh.p.k, av. Gerti Ymeri (që njëkohësisht është edhe vëllai im) dhe av. Orgesa Serani, që është administratore e shoqërisë Jurisprudenca sh.p.k. Edhe kjo avokate është legjitimuar si përfaqësuese dhe mbrojtëse e imja në seancën degjimore të datës 14.12.2022.

Komisionerja Firdes Shuli ka patur dijeni të plotë për kallzimin e lartëpërmëdur pasi kjo provohet se ajo është pyetur nga oficeri i Policisë gjyqësore i Prokurorisë së Rrethit Gjirokastës, përpara se ajo të përfshihej në trupin tim gjykues në funksionin e Komisioneres. (*Shih materialet e procedimit penal që ka filluar mbi bazën e kallzimit të lartëpërmendur, të dorëzuar nga mbrojtësit e mi si prova mbështetëse për njërën nga kërkesat për përjashtimin e Komisioneres Firdes Shuli dhe vendimet e gjykatave*).

Pavarësisht nga sa më sipër, Komisionerja në kundërshtim me nenin 72 të KPC dhe nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe në kundërshtim me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit dhe as ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi, për shkak se është në konflikt gjyqësor me mbrojtësit e mi, ***madje që përpara se të angazhohej në përbërje të trupit gjykues të Komisionit***.

Unë nuk kam ditur asgjë për konfliktin e mësipërm që Komisionerja ka patur me t'a. Kjo pasi nuk më është thënë më parë nga mbrojtësit e mi ndonjë gjë konkrete dhe e saktë lidhur me këtë konflikt. Kam pasë dëgjuar se kjo komisionere kur ka qënë notere ka bërë ca fallsifikime në Gjirokastër lidhur me çështje pronash, por jo se kam ditur ndonjë gjë konkrete. Nga ana tjetër, për shkak të ngarkesës së punës që kam patur si gjyqtar nuk kam patur as kohë dhe as interes për të parë dhe/apo ditur më shumë.
Një gjë e tillë më është thënë përmes komunikimit telefonik, nga av. Arben Llangozi, vetëm me datën 05.12.2022, pasi i kam treguar paraprakisht për një email të kësaj date që Komisioni më kishte dërguar, përmes të cilit më akuzonte padrejtësisht që kisha përdorur një gjuhë fyese dhe kërcënuese ndaj komisionit si dhe më njoftonte datën e parë seancës dëgjimore pas riçeljes së hetimit administrativ, që do ishte data 09.12.2022.

(*Ky pretendim i Komisionit për përdorimin nga unë të një gjuhe fyese dhe kërcënuese përkundrejt tij, nuk është i vërtetë. Këtë gjë do t'a shtjelloj në vijim të përmbajtjes së ankimit por këtu po mjaftohem t'i them Kolegjit të shohë përmbajtjen e emailit që më ka dërguar Komisioni me datën 05.12.2022, si dhe të shohë përgjigjen e këtij emaili që i kam dërguar unë Komisionit po me email me datën 07.12.2022, së bashku me një kërkesë për përjashtim për komisioneren Firdes Shuli*).

Menjëherë sa kam marrë dijeni nga avokati Arben Llangozi lidhur me konfliktin e interesit që kishte Komisionerja Firdes Shuli me mbrojtësit e mi, kam paraqitur një kërkesë përjashtimi, me emailin e datës 07.12.2022, që nuk është pranuar nga një trupë tjetër gjykuese e Komisionit.

(*Paligjshmërinë e mospranimit të kësaj kërkese do t'a shtjelloj në vijim të përmbajtjes msë ankimit*).

Komisionerja Firdes Shuli, duke qënë e nxitur nga motivi i hakmarrjes përkundrejt mbrojtësve të mi ***dhe*** duke qënë e nxitur edhe nga motivi i hakmarrjes sepse guxova t'i ekspozoj konfliktin e interesit që ajo nuk e kishte deklaruar në raport me mua, ***si dhe gjithashtu*** guxova t'a ekspozoj si një njeri që në të shkuarën ka qënë subjekt i dyshuar për veprimtari kriminale, më ka trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë në procesin tim të rivlerësimit, në raport me subjeket e tjerë të rivlerësimit të përmëndur më sipër por përveç tyre edhe subjekte të tjerë shtesë, që do të përmënden në vijim të përmbajtjes së këtij ankimi.

5. Motivi i dytë hakmarrjes së komisioneres Firdes Shuli. Sikurse e përshkruajtja më sipër, fillimisht Komisioni ka çmuar që procesi im i rivlerësimit të përfundonte vetëm referuar kriterit të pasurisë (që nënkuptonte shkarkimin tim nga detyra). Vetëm pas përjashtimit të Komisionerëve Roland Ilia dhe Etleda Çiftja, trupi i ri gjykues vendosi çeljen e hetimit me tre kriteret, kërkesë kjo që më ishte refuzuar më parë nga trupi i mëparshëm gjykues në përbërje të të cilit ishte edhe Komisionerja Pamela Qirko.

Përpara se të përjashtoheshin dy Komisionerët, unë në materialin e mbrojtjes që i kam dërguar trupit gjykues të Komisionit, pra që në atë kohë përbëhej nga Komisionerët Roland Ilia - relator, PamelaQirko - kryesuese, Etleda Çiftja - anëtare, (dërguar me email në datën ***23.05.2022, ora 12:57 PM***, dhe i titulluar *"**Mbrojtja lidhur me raportin e vetingut (Andri Ymeri)***", në faqet 18 - 20, jam shprehur si më poshtë:

*Omissis... **Së nëntëmbëdhjeti**: Paracaktimi i vendimarrjes në drejtim të personit tim evidentohet jo vetëm nëpërmjet rrethanave të sipërcituara nga ana ime, por edhe nëpërmjet të gjithë procedurës që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (si institucion) ka kryer **edhe** në drejtim të motrës time, prokurore Ajola Prenci, ku trajtimi i figurës time përbënte një pjesë të konsiderueshme të vlersimit të figurës së saj, dhe praktikisht ishte një prej shkaqeve të vendimarrjes në dëm të saj.*

Ky kontatim i imi lidhet me faktin se në procesin e rivlersimit të motrës time padrejtësisht jepen të dhëna për figurën time, me aktin "Rezultate te hetimit administrativ", trajtimin publikisht të tyre në seancën gjyqësore dhe nëpërmjet pasqyrimit të këtyre të dhënave në vendimin e motrës time Ajola Prenci.

Më konkretisht rezulton se nga trupa gjykuese e KPK që ka kryer procesin e rivlersimit te motrës time është trajtuar, madje publikisht shkresa e DSIK me numër 6233 prot, të datës 01.07.2021 me këtë përmbajtje: "Për subjektin e rivlersimit Ajola Faik Prençi nuk disponohen të dhëna dhe nuk ka sinjalizime ku informojnë përfshirje në veprimtari kundraligjshme. Të dhënat e përcjella nga autoritet verifikuese flasin vetëm për vëllain e Znj. Prençi ku informojnë për përfshirje në veprimtari të kundraligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës..... Sqarojmë se vëllai është vetë subjekt rivlersimi dhe do të shqyrtohet si i tillë".

Kjo procedurë e paligjshme ka vijuar me administrimin me vendim të ndërmjetëm të Komisionit që ka kryer procesin e rivlersimit të motrës time, të akteve të marra nga dosja ime, e

administruar nga ana Juaj, ku konkretisht është marrë deklarata e plotësuar nga ana ime për llogari të kontrollit të kriterit të figurës. Në lidhje me të dhënat që rezultojnë nga këto akte të marra nga dosja ime, motra ime jo vetëm që është ngarkuar me barrë prove, por padrejtësisht konsideratat negative të dhëna nga trupa e saj, në dëm të personit tim, kanë ndikuar ndjeshëm në vendimarrjen e tyre ndaj saj. Kjo nëpërmjet:

1) *Trajtimit dhe dhënies së këtyre konsideratave negative në dëm të personit tim, në procesin e rivlersimit të motrës time, nga një trupë e cila për më tepër nuk kishte asnjë kompetencë ligjore t'a bëntë këtë gjë dhe*
2) *Nga ana tjetër zhvillimi i procesit tim të rivlersimit nga ana Juaj vetëm në një kriter, duke shmangur vlerësimin e figurës, <u>në thelb ka sjellë si pasojë heqjen e cdo mundësie nga ana ime që të shprehem dhe mbrohem për fakte dhe rrethana që padrejtësisht më atribuohen, duke cënuar dukshëm të drejtën time për një proces të rregullt ligjor bazuar në nenit 6 të KEDNJ si ndaj meje, po ashtu dhe ndaj motrës time subjekt rivlerësimi.</u>*

Do të isha naiv të mendoja se trupa gjykuese që kryen procesin tim të rivlersimit nuk ka dijeni për rrethanat në dëm të personit tim të cilave i referohem. Kjo ndodhur në kushtet që të dhënat në ngarkim të personit tim janë bërë pjesë e procedurës së rivlersimit të motrës time me vullnetin, dëshirën dhe veprimin e trupës time gjykuese.

Në vlerësimin tim, lejimi nga ana Juaj i ekspozimit të të dhënave të figurës time në procesin e rivlersimit të motrës time <u>dhe për më tepër lejimi i përdorimit dashakeq të këtyre të dhënave</u>, është pasqyrë jo vetëm e cënimit të procesit të rregullt ligjor, por edhe e cënimit dukshëm të parimit "Gjykatë e paanshme".

***Duke u marrë nëpër gojë figura ime në procesin e rivlerësimit të motrës time, dhe në vendimin e marrë nga KPK-ja, me këtë rast, tre individet** <u>Brunilda Bekteshi, (që nga burime të hapura në internet del se për vite të tëra ka jetuar me 8000 lekë në muaj shpenzim për konsum familjar)</u>, **Firdes Shuli (e cila është nën hetim për ca punë në Gjirokastër që ajo i di vetë**), <u>apo Suela Zhegu, (bashkeshortja e Idi Zhegut)</u>, **më kanë fye**r. Kjo pasi kanë lejuar "krijimin e opinionit në publikun e gjërë se figura ime është negative, pa më krijuar as më të voglën mundësi as të shprehem dhe as të mbrohem".*

Jo vetëm kaq, por këta tre individë, pa m'u dhënë e drejta për t'u shprehur/mbrojtur paraprakisht, kanë lejuar padrejtësisht përmes veprimtarisë së tyre, pa asnjë shkak të ligjshëm, "<u>krijimin e opinionit publik se motra ime është shkarkuar për fajin tim</u>".

Kjo veprimtari e tyre, më ka shkelur mua personalisht të drejtën e prezumimit të pafajesisë/ndershmërisë, që i njihet kujdo qënie njerëzore, për sa kohë pafajesia/ndershmëria e tjetrit përbën lëndë shqyrtimi nga organi shtetëror kompetent si dhe për sa kohë ky organ shtetëror, nuk e ka përmbyllur procedurën me vendim të formës së prerë.

Shkaku për të cilën unë referoj këtë problematikë lidhet si me faktin se unë nuk i trembem sqarimit të asnjë rrethane që ka të bëjë me personin tim, ashtu edhe më faktin se unë vlerësoj që është tërësisht e padrejtë, e paligjshme dhe antikushtetuese të më mohohet e drejta e fjalës dhe e

mbrojtjes time dhe aq më keq nëpërmjet mohimit të ketyre të drejtave të ndëshkohemi njëkohsisht si unë ashtu edhe motra ime.

Theksoj se do të ishte në nderin e këtij trupi gjykues të hapë procesin e rivlersimit të personit tim për të gjitha kriteret, vecanarsisht atë të figurës, në mënyrë që:

- *Nga njëra anë të më jepet mundësia e mbrojtjes së personit tim në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor,*
- *Shkarkimit të figurës së motrës time për rrethana të pavërteta të familjarëve të saj, mbi të cilat asnjëri prej nesh nuk ka asnjë mundësi objektive shpjegimi dhe mbrojtje.*

Cdo qëndrim i kundërt i trupës time gjykuese do të ishte pasqyrë e paracaktimit të vendimarrjes në dëm të personit tim, shfaqje e vullnetit të tij për të mbuluar gabimet procedurale te kryera nga trupa gjykuese e motrës time si dhe do të ishte dëshmi e qartë e bashkëpunimit ndërmjet dy trupave gjykuese, (pra trupit tim gjykues, me trupin gjykues të mortës time), për të nxitur në opinionin publik, një klimë të rreme negative për figurën time, pa m'u respektuar mua e drejta ligjore për të m'u dëgjuar zëri dhe për t'u mbrojtur, lidhur me këtë sulm të padrejtë që më është bërë. ***Kjo nuk do ishte drejtësi, por kjo është pak të thuhet se do ishte poshtërsi***.

Ajo që është më e keqja, nëse trupa ime e nderuar gjykuese do të vepronte kësisoj, (gjë që unë nuk dëshiroj t'a besoj), kjo do të pasqyronte atë për të cilin si unë dhe motra kemi dyshuar gjithmonë, që nga koha që u përfshimë në "shortin special", se "seancat e caktuara nga Komisionit janë vetëm farsa në funksion të kryerjes së gjyqit popullor për subjekte rivlersimi të cilët më parë kanë qenë të paracaktuar për t'u shkarkuar, pra këto séanca nuk kanë për qëllim dhënien e drejtësisë, por konsistojnë në një lloj shfaqjeje publike, të ngjashme me ato që zhvilloheshin në Revolucionin Kulturor Kinez, me qëllim linçimin publik të zyrtarëve të padëshiruar".

Ky dyshim i yni mbështetet edhe në informacionin që rezulton nga burime të hapura se "në procesin e rivlersimit ka një listë të paracaktuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që duhen shkarkuar si dhe një listë që duhen promovuar ***dhe kjo është arsyeja e zbatimit të shortit special****".*

Në kohën që unë i kam dërguar Komisionit konsideratat e mësipërme, ***pra që me datën 23.05.2022***, konsiderata këto që nuk mund të mohohet se shprehin zemërimin dhe indinjatën time, ndaj veprimtarisë së paligjshme që kishte ushtruar komisionerja Firdes Shuli (së bashku me dy komisioneret e tjera) në procesin e rivlerësimit të motrës time, ***unë as nuk e dija dhe nuk kisha se si t'a dija se më vonë, kjo komisionere do të përfshihej edhe në procesin tim të rivlerësimit***. Këtë përfshirje kjo komisionere e realizoi ne dy momente:

i. Në kohën kur u përfshi në trupin gjykues që shqyrtoi dhe pranoi kërkesën time për përjashtimin e komisionerit Roland Ilia, (gjë që për mua ishte ***edhe kjo*** e paligjshme, pasi komisionerja Firdes Shuli, më kishte paragjykuar më parë përmes procesit të motrës time dhe për rrjedhojë nuk do duhet të përfshihej në prodhimin e asnjë akti/vendimi të ndërmjetëm dhe/apo përfundimtar në procesin tim të rivlerësimit, qoftë me pasoja pozitive qoftë me pasoja negative për mua, ***gjë që ëdhe këtë e ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit***). Sikurse do t'a shpegoj në

vijim, vetë koha tregoi se votimin në favor të përjashtimit të kolegut të saj komisionerja Firdes Shuli nuk e bëri për shkak të interesave të dhënies së drejtësisë, por për shkak se synonte të përfshihej vetë në trupin tim gjykues dhe kësisoj të hakmerrej.

ii. Përmes përfshirjes së saj në trupin gjykues që dha vendimin përfundimtar përmes të cilit Komisioni më shkarkoi nga detyra e gjyqtarit.

Përmes perifrazimit të asaj që kam shkruar si më sipër, ***pra që më datën 23.05.2022***, ftoj Kolegjin të vlerësojë nivelin e mospëlqimit/reagimit/mosrespektit/moskonsideratës/paragjykimit që unë i kam shprehur Komisionit, për komisioneren Firdes Shuli, që përpara se ajo të përfshihej në trupin gjykues që ka përfunduar procesin tim të rivlerësimit. – A nuk do mjaftonte qoftë edhe ky nivel mospëlqimi/reagimi/zemërimi tek çdo vëzhgues i jashtëm për të arritur në konkluzionin se komisionerja Firdes Shuli nuk duhej të përfshihej në procesin tim të rivlerësimit !!!?

Gjithashtu, ftoj Kolegjin të përqëendrohet edhe një herë tek fjalët "…***Duke u marrë nëpër gojë figura ime në procesin e rivlerësimit të motrës time, dhe në vendimin e marrë nga KPK-ja, me këtë rast, tre individet*** *Brunilda Bekteshi, (që nga burime të hapura në internet del se për vite të tëra ka jetuar me 8000 lekë në muaj shpenzim për konsum familjar),* ***Firdes Shuli (e cila është nën hetim për ca punë në Gjirokastër që ajo i di vetë)****, apo Suela Zhegu, (bashkeshortja e Idi Zhegut),* ***<u>më kanë fyer</u>****. Kjo pasi kanë lejuar "krijimin e opinionit në publikun e gjërë se figura ime është negative, pa më krijuar as më të voglën mundësi as të shprehem dhe as të mbrohem….".*

Duke patur parasysh këto fjalë – ***A do duhej që komisionerja Firdes Shuli të përfshihej në procesin tim të rivlerësimit !!!?***

Komisionerja Firdes Shuli e ka ditur paraprakisht qëndrimin tim të mësipërm përkundrejt saj. ***Kjo minimalisht duke filluar nga data 21.06.2022***. Kjo konfirmohet nga vendimi i ndërmjetëm nr. 5, datë 21.05.2022, "për riçeljen e hetimit administrativ në të tre kriteret". Kjo pasi komisionerja duke votuar për riçeljen e hetimit administrativ, prezumohet se e ka lexuar materialin tim të mbrojtjes të dërguar me email në datën ***23.05.2022, ora 12:57 PM***, dhe i titulluar "Mbrojtja lidhur me raportin e vetingut (Andri Ymeri)", në faqet 18 - 20, ku jam shprehur sikurse e përshkruajta më sipër.

Pavarësisht nga kjo dijeni që ka patur komisionerja për mospëlqimin/zemërimin/indinjatën time përkundrejt saj si dhe faktit që unë jam ndjerë i fyer dhe i cënuar padrejtësisht prej saj, ajo nuk ka deklaruar konfliktin e interesit. Përse nuk e ka bërë këtë !! Pikërisht se kam guxuar dhe i kam përmëndur atë punën e Gjirokastrës, kur ka qënë notere. <u>Për t'u hakmarrë. Kjo është arsyeja</u>.

Sqaroj edhe një herë se me datën 23.05.2022 unë nuk kam patur as prova dhe as kam ditur gjë konkrete por vetëm thashetheme se çfarë kishte bërë kjo komisionere në Gjirokastër, ndërkohë që kishte qënë notere.

Kjo mosdijeni e imja duket qartë edhe nga emaili i datës 21.06.2022, që i kam dërguar komisionit në përgjigje të pyetjes që më shtroi me emailin që më dërgoi po me datën 21.06.2022

– Ju lutem deklaroni nëse keni konflikt interesi lidhur me dy anëtarët e trupit gjykues Firdes Shuli dhe Genta Bungo ?.

Përgjigjja ime e kthyer me emailin e datës 21.06.2022 ishte " *Te nderuar: mora dijeni per njoftimin tuaj. Une e ka objektivisht te pamundur t'iu kthej pergjigjen qe ju kerkoni brenda dates 23.06.2022. Kjo pasi: Se pari: nuk jam njohur me dy vendimet e perjashtimit te dy komisionereve te meparshem. Meqenese dy anetaret zevendesues (mos gaboj) kane qene njekohesisht edhe anetare te dy trupave gjykuese qe kane perjashtuar dy komisioneret e meparshem, njohja me keto vendime, nuk konsiderohet nga ana ime si fakt i parendesishem, ne funksion te qellimit te pyetjes (kerkeses tuaj).*
Se dyti: sikurse jeni ne dijeni, une mbrohem ne gjykim nga dy mbrojtes, qe jane av. Arben llangozi, i cili nga komunikimi telefonik me tha qe ndodhet ne gjykaten e rrethit gjyqesor gjirokaster, ku ka gjyqe me gjytaret arben dosti dhe blerta cibuku ***dhe medeomos duhet te me keshilloje dhe me jape informacione te vlefshme, perpara se t'i kthej pergjigje kerkeses tuaj****. Nderkaq mbrojtesi tjeter, av. Gerti ymeri, anetar i dhomes se avokatise shkoder, eshte ne greve, (fakt ky i njohur botërisht) dhe edhe ai me porositi qe te mos shprehem pa u keshilluar me te pasi edhe ai ka disa informacione te vlefshme.*

Nderkaq, te dy avokatet me keshilluan qe tiu drejtohem me kerkese per te administruar rregjistrimet audio te seancave te datave 27.05.2022 dhe 13.06.2022, dhe te na krijohet mundesia qe deri me daten 04.07.2022, ose te pakten 3-4 dite nga data qe ju te na beni më dije rregjistrimet audio te siperpermendura, dy vendimet e arsyetuara, si dhe procesverbalet e shortit (dokumentacionin përkates), te caktimit te anetareve zevendesues, ne te percaktojme qendrimin tone lidhur me ***TRE****, anetaret e trupit gjykues. Me nderim dhe konsiderate te vecante per punen tuaj, gjyqtari Andri Ymeri.*

Ftoj Kolegjin që të vlerësojë si dhe të përqëndrohet veçanarisht tek fjala TRE, që ia kam shkruajtur Komisionit me shkronja kapitale në përgjigjen e mësipërme që i kam dërguar me email.

Ndërsa në emailin që i kam dërguar Komisionit me datën 23.06.2022, pasi prapë jam pyetur për të deklaruar nëse kam konflikt interesi me anëtarët e trupës, ndër të tjera, jam shprehur si më poshtë:

...Se pesti: Sipas nenit 47 te kodit te procedurave administrative, i kerkoj trupes se re gjykuese vendimin e ndermjetem te arsyetur te dates 21.06.2022, per riceljen e hetimit me tre kritere. Ky vendim eshte detyrim te me vihet ne dispozicion jo vetem per te realizuar mbrojtjen time, por edhe per tu aftesuar, ne kthimin e pergjigjes time nese mendoj qe TRE anetaret e trupes gjykuese te re, jane apo jo (sipas mendimit tim) ne konflikt interesi. Gjithsesi, absolutisht ju shfaq ne kete drejtim, duke ua perseritur, konsideraten time te deritanishme qe dy vendimarrjet e perjashtumit te komisionereve te meparshem, jane burim frymezimi per mua se procesi im i rivleresimit, ka gjasa te arsyeshme per te supozuar, se do jete i drejte.

Edhe në këtë email ftoj Kolegjin që të përqëndrohet tek fjala TRE, e shkruajtur me shkronja kapitale.

Po të vlerësohet **si** i. përmbajtja e këtyre email-eve, **si** ii. fakti që unë asnjëherë nuk jam shprehur dakort me pjesmarrjen e komisioneres Firdes Shuli (dhe të dy kolegeve të saj në trupin gjykues), **si** iii. fjala TRE, e shkruar me shkronja kapitale në të dy email-et, ashtu edhe iv. përmbajtja e emailit të datës 23.05.2022, që u përmënd më sipër, (dhe që komisionerja Firdes Shuli e ka lexuar përderisa votoi për riçeljen e jetimit gjyqësor),

- A nuk është e qartë se unë kam patur mospëlqim/mosdakortësi për pjesmarrjen e kësaj komisionereje në trupin tim gjykues !!!?

- (Madje është e qartë se shkrimi i fjalës TRE me shkronja kapitale, (ndërkohë që komisioni më pyeti për dy komisioneret Firdes Shuli dhe Genta Bungo), nuk është gjë tjetër veçse formë elegante për të shprehur mosdakortësinë që kam patur edhe për komisioneren Pamela Qirko, përderisa ajo fillimisht votoi për përfundimin e procesit tim të rivlerësimit me një kriter, pastaj refuzoi se bashku me kolegët e saj të përjashtuar kërkesën time për riçeljen e hetimit për të tre kriteret dhe vetëm pasi u përjashtuan dy kolegët për konflikt interesi, ***pa marrë asnjë provë e re***, votoi për pranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit për të treja kriteret. Vijimi i pjesmarrjes së Komisioneres Pamela Qirko në trupin gjykues bjen ndesh me nenin 30 të K.Prc.Administrative, pasi në këto rrethana fakti i bie që ajo ka dhënë mendim për çështjen përpara se të shprehet me vendim përfundimtar. Edhe këtë ia shtroj si shkak ankimi Kolegjit).

Duke u rikthyer tek problematika objekt analize e Komisioneres Firdes Shuli, lindin pyetjet:

Përse ajo nuk e ka deklaruar vetë konfliktin e interest !!!? Ky është detyrim i gjyqtarit/komisionerit, jo e drejtë e tij.

Përgjigjja është e qartë, është ajo që thashë më sipër, *pikërisht se kam guxuar dhe i kam përmëndur atë punën e Gjirokastrës, kur ka qënë notere. Për t'u hakmarrë. Kjo është arsyeja*.

6. Motivi i dallimit krahinor nga komisionerja Genta Bungo. Këtë motiv diskriminimi dhe trajtimi të pabarabartë e përmënda edhe më sipër duke e krahasuar procesin tim të rivlerësimit me atë të shumë subjekteve të tjerë që me prejardhje janë nga Vlora, Lushja, Korça, Gjirokastra, pra në përgjithësi jugu i Shqipërisë, ndërsa unë jam shkodran, pra verior.

Kjo komisionere në ambientet e punës por edhe në jetën e përditshme për veriorët në përgjithësi, përdor cilësorin pezhorativ "Malok". Kjo ka dalë si në media ashtu edhe në materialet e transkriptuara të përgjimeve të një dosjeje penale që ndodhet aktualisht në hetim në Prokurorinë e Rrethit Durrës, (prokurori Drini Pali), dhe që ka filluar mbi bazën e një kallzimi që kryerja e KPK Pamela Qirko ka bërë ndaj një punonjëseje të KPK për humbje të fashikullit (për humbjen e një kërkese për përjashtim që kishte paraqitur subjekti i rivlerësimit Dritan Gina), si dhe të shpërdorimit të detyrës, (nxerrjen e sekretit të veprimtarisë hetimore administrative të KPK). Tek këto materiale të transkriptuara përmënden edhe subjekte të tjerë rivlerësimi lidhur me mënyrën se si do të përfundojë procesi i tyre i rivlerësimit, si p.sh Arens Çela, Arbena Ahmeti, (përkatësisht i vëllai dhe kunata e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela), etj.

I kërkoj KPA, që t'ë kqyrë dhe marrë aktet e këtij procedimi penal për nevoja të verifikimit të këtij pretendimi që unë po parashtroj, pasi unë nuk kam akte origjinale por vetëm disa prej tyre që kanë rrjedhur në media.

Së njëzetë e një: Të nderuar gjyqatarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

Motivet diskriminuese të përmëndura më sipër, që kanë shtyrë komisioneret Pamela Qirko, Genta Bungo, Firdes Shuli dhe Roland Ilia, për të më diskriminuar si në hetimin administrativ ashtu edhe në gjykimin administrativ të procesit tim të rivlerësimit, ***i kam ngritur si shkak ankimi*** përpara Jush pavarësisht se nuk përjashtohet mundësia që Ju në arsyetimin e vendimit Tuaj, të shpreheni se "është praktikë e Kolegjit që vendimarrjet e Komisionit i shqyrton në mënyrë individuale, rast pas rasti".

Unë nuk e kundërshtoj këtë arsyetim Tuajin eventual në këndvështrimin e nevojës/dëshirës që kam për t'u rikthyer në ushtrimin e detyrës së magjistratit. Madje po të ishte ky qëllimi i vetëm i këtij shkaku ankimi, do të isha dakort me arsyetimin Tuaj eventual të mësipërm. Unë në ngritjen e shkaqeve të ankimit që i referohen grupit të sipërcituar të motiveve diskriminuese, ndjek njëherazi edhe katër qëllime të tjera **një prej të cilave shkon përtej nevojës/dëshirës që kam për t'u rikthyer në ushtrimin e detyrës së magjistratit**.

Këto katër qëllime të tjera janë:

1. Qëllimi i parë material/substancial: E drejta për punësim (ku përfshihet edhe e drejta ime për të punuar si magjistrat) dhe e drejta për të mos iu nënshtruar diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë, janë që të dyja të drejta kushtetuese por njëherazi edhe të drejta subjektive civile. Këto dy të drejta marrin pjesë në mënyrë të pavarur nga njëra - tjetra ne rendin ligjor në kuptimin që cënimi i njërës të drejtë jo domosdoshmërisht sjell si pasojë automatike edhe cënimin e të drejtës tjetër.

Që të shprehem konkretisht, mund të qëllojë që shkarkimi im nga detyra e magjistratit të ketë qënë i drejtë në themel (gjë që unë e përjashtoj), por njëkohësisht kjo nuk do të thotë se unë nuk jam diskriminuar në procesin tim të rivlerësimit nga KPK në raport me subjekte të tjerë rivlerësimi që unë kam përmëndur në këtë ankim që kanë qënë në të njëjtat rrethana me mua apo më të këqia por pavarësisht tyre janë trajtuar ndryshe nga komisionerët Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo.

Trajtimi i pabarabartë i imi nga ana e Komisionit, ka dy anë të medaljes që ***njësoj*** shkaktojnë dhimbje shpirtërore tek unë që jam viktimë e këtij trajtimi të pabarabartë. Këto dy anë të medaljes janë ose dhënia e privilegjeve të padrejta/pamerituara ose mohimi/cënimi i të drejtës.

Askush nuk ka të drejtë që të të shkaktojë dhimbje shpirtërore dhe vuajtje mendore përmes përdorimit të këtyre dy anëve të medaljes, pra përmes cënimit të parimit të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Prandaj unë përmes ngritjes së këtij shkaku ankimi përpara Kolegjit shpreh njëherazi edhe protestën time ndaj sjelljes me dy standarte të Komisionit.

Unë mendoj se në rastin e procesit tim të rivlerësimit, në raport me subjektet e rivlerësimit që kam përmëndur si shëmbull krahasues, Komisioni më ka cënuar njëkohësisht në të dyja anët e medaljes.

Për rrjedhojë, është e drejta ime për t'u kompensuar për këtë dhimbje të paligjshme dhe të pamerituar, pavarësisht nga fakti nëse shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit do konsiderohet apo jo i ligjshëm nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Për t'u kompensuar unë për këtë dhimbje shpirtërore, është e nevojshme që të shqyrtohet në meritë (në themel) pretendimi im për diskriminim dhe trajtim të pabarabartë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në raport me subjektet e tjerë të rivlerësimit që kam përmëndur në pjesën hyrëse të këtij ankimi.

Pikërisht për këtë shkak, e kam ngritur përpara Kolegjit shkakun e ankimit që i referohet diskriminimit.

Shpresoj që Kolegji në trajtimin e rastit t'i referohet edhe ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, veçanarisht rregullimit të parashikuar në ligj lidhur me faktin se si shpërndahet barra e provës ndërmjet palëve kundërshtare për të vërtetuar apo hedhur poshtë pretendimin për diskriminim, (pra ndërmjet meje dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit). Këto unë nuk po i përmend në ankim pasi kam nderim për Kolegjin dhe vlerësoj se Ai i di vetë.

I lutem Kolegjit të ketë parasysh se sipas ligjit 84/2016 dhe aneksit të Kushtetutës, si dhe në tërësi legjislacionit procedural që është në fuqi në R.Sh, unë nuk kam asnjë organ tjetër tek i cili të ankohem për problematikën e sipërpërmëndur të diskriminimit në procesin tim të rivlerësimit përveçse në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Vetëm nëse Kolegji e shqyrton në meritë këtë pretendim timin përkundrejt Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, atëherë unë mund t'i drejtohem Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, me padinë përkatëse për shpërblimin e dëmit jopasuror.

3. Qëllimi i dytë material/substancial: ka të bëjë me nevojën time për të hedhur poshtë një nga shkaqet që përshkruhet në vendimin e Komisionit se përse jam shkarkuar nga detyra. Konkretisht, në lidhje me argumentimin e Komisionit të shprehur në kuadrin e vlerësimit tërësor të procedurave të rivlerësimit, se unë nuk jam treguar bashkëpunues me komisionin gjatë kohëvazhdimit të procesit tim të rivlerësimit. Ky është një nga shkaqet që është patur parasysh nga Komisioni në parag. 98.1 të vendimit.

Unë e ndjek qëllimin në fjalë përmes ngritjes së diskriminit si shkak ankimi pasi është jashtë çdo logjike njerëzore apo ligjore që t'i kërkosh llogari dhe aq më shumë t'a ndëshkosh viktimën e diskriminimit se përse nuk bashkëpunoi në dhunuesin e dinjitetit dhe personalitetit të tij. Nëse do të veprohej kështu, do të përligjej Tirania, do të pengohej e drejta e revoltës dhe e reagimit ndaj padrejtësisë/cënimit të dinjitetit njerëzor, do të dhunohej në palcë nocioni i lirisë së një qënieje njerëzore me personalitet, do të shkatërrohej autoriteti dhe nderimi që magjistrati/gjyqtari me sjelljen e tij, duhet t'i frymëzojë publikut lidhur me Lartësinë e pushtetit gjyqësor.

(*Megjithatë, pavarësisht kësaj, unë me durim dhe përulësi, prapë kam bashkëpunuar me komisionin në procesin tim të rivlerësimit. Komisioni nuk thotë të vërtetën në vendim lidhur me bashkëpunimin tim. Këtë do t'a sqaroj në pjesën e ankimit që shprehet pikërisht për problematikën e bashkëpunimit*).

3. Qëllimi i parë procedural/instrumental: Ngritja e shkakut të ankimit që lidhet me diskriminimin ka të bëjë me faktin se nëse pretendimet e mia gjenden të bazuara nga Kolegji, atëherë i bie të vërtetohet se Komisioni nuk ka qënë për mua gjykatë e paanshme dhe e drejtë. Kjo pasi vetëm një gjykatë e barabartë mund të jetë gjykatë e paanshme dhe e drejtë. Gjykimi i paanshëm dhe gjykimi i drejtë janë standarte kushtetuese që përfshihen në të drejtën për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 6/1 i KEDNj dhe nenet 17/2 dhe 42 të Kushtetutës.

4. Qëllim i dytë procedural/instrumental: Ngritja e shkakut të ankimit që lidhet me diskriminimin ka të bëjë me faktin se nëse pretendimet e mia gjenden të bazuara nga Kolegji, sipas ligjit 84/2016, Kolegjit i lind detyrimi që shqyrtimin e ankimit tim të mos e bëjë në dhomë këshillimi por në seancë gjyqësore publike. Kjo pasi vetëm në këtë mënyrë mund të ndreqen efektivisht pasojat e shkeljeve procedurale që ka bërë Komisioni në procesin tim të rivlerësimit.

Si prova të diskriminimit që kam pësuar i kërkoj Kolegjit të konsiderojë/marrë/vlerësojë sa më poshtë:

I. Rekomandimet e ONM drejtuar komisionerit publik për të bërë ankim për vendimarrjet e KPK për subjektet e rivlerësimit, Arbër Çela, Elisabeta Ymeraj, Armida Hamidi (Moçka), Gentian Osmani, Arben Dosti, Mariola Mërtiri, Erjon Shehaj. (Këto mund të aksesohen në faqen ëeb të Institucionit të Komisionerëve publik).

II. Vendimet e KPK për të gjithë subjektet që përmënden në pikën 23 të rubrikës "objekti" të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij ankimi si dhe për subjektet e rivlerësimit Elisabeta Ymeraj, Gentian Osmani, Arben Dosti, Mariola Mërtiri, Arben Nika, Erjon Shehaj. (Këto mund të aksesohen në faqen ëeb të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit).

III. Vendimet e marra apo të pritshme të KPA për të gjithë subjektet e rivlerësimit të përmëndur në dy pikat e mësipërme.

IV. Të gjithë korrespondencën elektronike të realizuar gjatë procesit tim të rivlerësimit me KPK.

V. Të gjithë dosjen time të rivlerësimit që përmban shpjegimet që kam dhënë, 11 kërkesat e përjashtimit, 11 vendimet e trupave gjykuese të KPK lidhur me këto kërkesa përjashtimi, etj.

VI. Marrjen nga Kolegji të një mendimi me shkrim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi lidhur me faktin nëse ka patur apo jo diskriminim nga Komisioni në procesin tim të rivlerësimit. Marrja e këtij mendimi me shkrim të Komisioneri, ***është detyrim*** i Kolegjit gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes prej tij, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 36[4] dhe të paragrafit 2 të nenit 37[5] Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (i ndryshuar).

[4] Në nenin 36 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se:

VII. Marrjen nga Kolegji të një mendimi me shkrim nga ILDKPKI. Marrja e këtij mendimi me shkrim të këtij institucioni është e nevoshme në mënyrë që Kolegji të konsultohet me organin shtetëror të specializuar për të kontrolluar dhe mbikqyrur mënyrën e zbatimit të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, në procesin tim të rivlerësimit, nga komisionerët Roland Ilia, Genta Bungo, ***veçanarisht nga komisionerët Pamela Qirko dhe Firdes Shuli,*** si dhe komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi, që kanë marrë pjesë në procesin tim të rivlerësimit përmes shqyrtimit të një pjese të 11 kërkesave të përjashtimit që unë kam paraqitur për kolegët e tyre. Ky mendim i specializuar me shkrim unë vlerësoj se i nevojitet kolegjit në mënyrë që ky i fundit, të vlerësojë me objektivitet shkaqet e ankimit të ngritura nga unë përpara Tij, lidhur me konfliktin e interesit që kanë patur këta komisionerë.

VIII. Prova të tjera që mund të dalin të nevojshme gjatë shqyrtimit të ankesës time në KPA dhe që për momentin nuk janë në disponimin tim.

<u>Së njëzetë e dy</u>: Sikurse e kam përshkruar në pikën 22 të objektit të ankimit, (të përmëndur në pjesën hyrëse të këtij ankimi), unë gjatë procesit të rivlerësimit, jam ekspozuar ndaj një trajtimi të përsëritur ç'njerëzor dhe/apo poshtërues. Konkretisht, kam parashtruar si si objekt dhe shkak ankimi sa më poshtë:

*22. Ankim për shkeljen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, **të të drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues**, e parashikuar në nenin 3 të KEDNj dhe 17/2 të Kushtetutës, në rastet e mëposhtme:*

---

1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje.

2. I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë.

3. <u>Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim</u>.

4. <u>Gjykata mund t'i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen</u>.

5. Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështjetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese.

6. Pasi paditësi paraqet fakte, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.

[5] Në nenin 37 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se:

1. Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit.

2. <u>Vendimi i gjykatës u komunikohet të gjitha palëve të interesuara, përfshirë komisionerin</u>.

3. <u>Vendosja e masave, sipas këtij ligji, nuk përjashton vendosjen e masave sipas ligjeve të tjera</u>.

a. Kur ndonëse i kam bërë me dije Komisionerit relator Roland Ilia si dhe komisionerëve Pamela Qirko dhe Etleda Çiftja, se kam qënë në pamundësi për t'iu përgjigjur pyetësorit të dytë që më kanë nisur, brënda afatit që më kanë përcaktuar, pasi kam patur vajzën (e mitur-5 vjeç), të sëmurë në rrezik jete, (duke i dërguar dokumentacionin mjekësor përkatës të vajzës si dhe fotografi, me email), kërkesa ime për 2-3 ditë kohë shtesë, është shpërfillur duke u detyruar të punoj në një tension mendor dhe vuajtje shpirtërore të jashtëzakonshme. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky ***trajtim ç'njerëzor*** *si dhe për t'u shprehur se a kanë fuqi provuese të dhënat/provat/rezultatet qoftë të favorshme qoftë të disfavorshme për mua, por që janë përftuar nga veprimtaria hetimore e KPK, që është shtrirë në kohë, po aq kohë ka zgjatur ky trajtim ç'njerëzor i pretenduar prej meje).*

b. Kur ndonëse i kam bërë me dije Komisionerit relator Roland Ilia si dhe komisionerëve Pamela Qirko dhe Etleda Çiftja, me emailin e datës 21.01.2022 se kam qënë në pamundësi për t'iu përgjigjur pyetësorit të tretë, brënda afatit që më kanë përcaktuar, pasi unë kam qënë i sëmurë rëndë dhe i jam nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në vesh, (duke i dërguar dokumentacionin mjekësor përkatës të timin si dhe fotografi të padyshimta, me email), kërkesa ime për 2-3 ditë kohë shtesë, është shpërfilluar duke u detyruar të punoj në një gjendje fizike pothuajse në kushtet e pamundësisë objektive si dhe në një tension mendor dhe vuajtje fizike të jashtëzakonshme. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky ***trajtim ç'njerëzor****si dhe për t'u shprehur se a kanë fuqi provuese të dhënat/provat/rezultatet qoftë të favorshme qoftë të disfavorshme për mua, por që janë përftuar nga veprimtaria hetimore e KPK, që është shtrirë në kohë, po aq kohë ka zgjatur ky trajtim ç'njerëzor i pretenduar prej meje).*

c. Kur KPK, raportin për rezultatet e hetimit administrativ, m'a ka komunikuar me email në datën 31.10.2022, në orën 11:00 të natës, ditë e premte. Pse duhej ora 11 e natës? A u bë kjo qëllimisht për të më shqetësuar mua dhe familjen time. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky ***trajtim ç'njerëzor*** *si dhe për t'u shprehur se a është e arsyeshme të supozohet dhe vlerësohet se nga vlerësimi i këtij episodi në sintezë edhe me episodet e mëparshme (si dhe ato që do të përshkruhen në pjesën përmbajtësore të ankimit), KPK në procesin tim të rivlerësimit, duke më trajtuar në mënyrë ç'njerëzore dhe/apo poshtëruese, ka patur qëllim të më provokojë paligjshmërisht që unë të mos bashkëpunoj në procesin tim të rivlerësimit ose të më shkurajojë në guximin tim për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes).*

ç. Kur ndonëse me datën 25.11.2022, i kërkova Komisioneres relatore Genta Bungo si dhe komisionerëve Pamela Qirko dhe Firdes Shuli, kohë shtesë përtej datës 27.11.2022, për të dorëzuar mbrojtjen time lidhur me rezultatet e hetimit, pasi jo vetëm që kjo mbrojtje ishte tepër voluminoze por ndër të tjera kisha nënën me ishemi cerebrale që i kishte ndodhur me datën 25.11.2022, (duke i dërguar dokumentacionin mjekësor përkatës të nënës si dhe fotografi të padyshimta), ***Komisioni bëri gjoja se më dha kohë, deri me datën 30.11.2022,*** *ndërkohë që faktikisht i bie që kërkesa për kohë m'u refuzua, pasi datat 27, 28, 29, 30.11.2022, kanë qënë ditë pushimi dhe vetë KPK nuk punonte në këto ditë. (I kërkoj Kolegjit që lidhur me këtë pikë të ankimit, të shprehet nëse është ky* ***trajtim ç'njerëzor*** *dhe* ***a është kjo në pajtim me parimin e gjykimit të drejtë*** *dhe detyrimin që kanë gjykatat që përmes veprimtarisë së tyre, t'i frymëzojnë palëve dhe publikut, besim në ushtrimin e funksionit të dhënies së drejtësisë).*

d. Kur në seancën dëgjimore të datës 12.12.2022, teksa unë po ushtroja të drejtën time të mbrojtjes pranë KPK, nga kryesuesja Pamela Qirko, m'u tha, "këto mund t'i shkruash në ankim". (I kërkoj Kolegjit të shprehet a mund të konsiderohet kjo përveçse si paragjykim, ***edhe trajtim poshtërues*** *nga ai që të gjykon.*

dh. Kur në seancën dëgjimore të datës 13.12.2022, teksa unë po ushtroja të drejtën time të mbrojtjes pranë KPK, në përfundim të seancës, nga kryesuesja Pamela Qirko, m'u tha, "tani meqë u mbyll seanca, po shkoj të shoh një film". (I kërkoj Kolegjit të shprehet a mund të konsiderohet kjo përveçse si paragjykim, ***edhe trajtim ç'njerëzor*** *dhe* ***poshtërues*** *nga ai që të gjykon.*

e. A është në vetvete trajtim ç'njerëzor dhe poshtërues kur KPK në vendimin objekt ankimi, shprehet se nuk kam qënë bashkëpunues dhe kjo është një ndër shkaqet se përse më ka shkarkuar nga detyra, ***ndërkohë*** *që jo vetëm nuk përputhet me dinjitetin dhe madhështinë e funksionit të gjyqtarit të Republikës por as edhe kujtdo, që të ushtrojë një funksion publik, ndërkohë që vuan nga sindromi i Stokholmit, (të biesh në dashuri me atë që të dhunon).*

ë. ***Lidhur me këtë pjesë të ankimit****, i kërkoj Kolegjit të verifikojë nëse tërësia e sjelljeve të mësipërme, (që nuk janë të vetme), të konsumuara nga komisionerët e KPK, janë apo jo të bazuara, dhe në vijim të shprehet se -a mund të konsiderohen fyese, poshtëruese dhe ç'njerëzore sjelljet e lartëpërmëndura të KPK, për çdo subjekt që ka nevojë për shërbimin publik të marrjes së drejtësisë, sipas Parimeve të Bangalores.*

Pretendimeve të mësipërme për trajtimin ç'njerëzor dhe/apo poshtërues iu shtroj si shkak ankimi përpara Kolegjit edhe pretendimet (pyetjet) e mëposhtme:
I- A ka qënë ***trajtim ç'njerëzor*** vendosja ime nga Komisioni dhe veçanarisht nga kryesyesja e trupit gjykues Pamela Qirko, ***në kushtet e një gjendjeje sfilitjeje fizike, shpirtërore dhe mendore*** përmes urdhërimit tim që kërkesat për përjashtimin e saj si dhe disa prej komisionerëve të tjerë të trupës, për shkaqe të lindura në seancat dëgjimore të datave 13.06.2022[6], 12.12.2022[7], 13.12.2022[8], t'i paraqisja me shkrim brënda ditës së nesërme, nga mbyllja e seancave dëgjimore

[6] Dy kërkesat për përjashtimin e Komisionerëve Roland Iliad he Etleda Çiftja. (*Për më hollësisht shih përmbajtjen e këtyre dy kërkesave për përjashtim*).

[7] Shkak si p.sh. kërkesa ime për përjashtim e bazuar në thëniet e Komisioneres Pamela Qirko teksa unë po ushtroja të drejtën e mbrojtjes në këtë seancë, që "*këto që po thua mund t'i shkruash në ankim*", teksa procedura gjyqësore ishte akoma në zhvillim dhe akoma Komisioni nuk ishte tërhequr për vendim përfundimtar. (*Për më hollësisht, shih procesverbalin e seancës dëgjimore të kësaj date si dhe përmbajtjen e kërkesës për përjashtim të ngritur prej meje bazuar në këtë shkak*).

Shkak përjashtimi si p.sh referuar komisioneres Genta Bungo, që në cilësinë e komisioneres relatore, sapo Komisionerja Pamela Qirko më tha fjalët paragjykuese të mësipërme, për të n'a hedhur hi syve mua dhe mbrojtësve të mi, që reaguam ndaj këtyre fjalëve, u përpoq të justifikonte përdorimin e këtyre fjalëve nga kolegia e saj si dhe n'a tha "ne jemi një". (*Për më hollësisht, shih procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 12.12.2022 si dhe përmbajtjen e kërkesës për përjashtim të ngritur prej meje bazuar në këtë shkak*).

[8] Shkaku i përjashtimit i bazuar në thëniet e komisioneres Pamela Qirko në seancën e kësaj datë, pasi ajo në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues në mbarim të seancës m'u drejtua me fjalët paragjykuese "*tani po shkoj të shoh një film*". Pra mbrojtja ime/jeta ime sipas komisioneres, kishte po aq rëndësi sikurse të shihte një film.

të këtyre datave[9], pra brënda një afati që efektivisht ishte jo më shumë se disa orë, ndërkohë që neni 74 i KPC më jep afat ligjor 3 ditor për për paraqitur me shkrim kërkesat e përjashtimit, për shkaqe që lindin në seancë !!!!?

Kjo pavarësisht se unë ia bëra me dije komisionerëve ***si dhe vetë ata e dinin se*** unë banoja nga në qytetin e Shkodrës, dhe vetëm rruga vajtje ardhje Tiranë-Shkodër-Tiranë, ishte 4 orë, nevoja ime fiziologjike për ushqim dhe pushim e kishte të njevojshme shpenzimin jo me pak se 8 orë, dhe që koha që më ngelej efektivisht për të përpiluar me shkrim kërkesat e përjashtimit, ishte efektivisht, jo më shumë se 1 apo 2 orë, dhe se ky afat i përcaktuar prej tyre, cënonte kësisoj afatin ligjor 3 ditor të përcaktuar nga neni 74 i KPC !!!?

Kjo edhe pse vetë ***ata e dinin se*** unë jam baba i tre fëmijëve të mitur (ndër të cilët dy vajzat binjakë 6 vjeç) dhe për rrjedhojë, e kisha të nevojshme që çdo ditë të ushtroja përkundrejt tyre përkujdesjen prindërore/atërore[10] !!?

II. A ka qënë ***trajtim poshtërues,*** përveçse edhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, objektivitetit dhe të ligjshmërisë, fakti që Komisioni gjatë hetimit administrativ më ngarkoi mua barrën e provës për të sjellë dhjetëra fotokopje fashikujsh gjyqësor, (pra mijëra faqe)[11], ndërkohë që ai përmes korrespondencës zyrtare institucionale, mund t'i merrte këto dokumente vetë, ndërkohë që Komisioni prezumohet ***se e dinte që*** sipas ligjit 96/2016, gjyqtarët e kanë të ndaluar që të punojnë si korrier, hamall dhe madje çfarëdolloj pune me përjashtim të asaj që ka përputhje me madhështinë e dinjitetit dhe personalitetit të gjyqtarit, që është mësimdhënia !!?

Cila ishte arsya e përligjur dhe objektive mbi të cilën Komisioni gjatë hetimit administrativ, m'a ngarkoi mua barrën e provës për t'u bërë fotokopjues, hamall, korrier, etj !!?

Cila ishte arsya e përligjur dhe objektive mbi të cilën Komisioni gjatë hetimit administrativ, m'a ngarkoi mua barrën e provës për të bërë shpenzime të shumta financiare ndërkohë që Komisioni dokumentacionin përkatës mund t'a siguronte vetë, pa pagesë !!!?

III. A ka qënë ***trajtim poshtërues*** vendosja ime nga Komisioni në pozicionin e detyruar të lypësit/lutësit/thyerjes së ligjit për të siguruar referuar kriterit të pasurisë, dokumentacionin financiar tatimor/pronësor/bankar të shtetasve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, (këta të dy

---

[9] Shiko kohën (orën) kur u mbyllën seancat e këtyre datave, (*referohu në procesverbalet e këtyre seancave*).

[10] Shiko nenin 2 të Kodit të Familjes:*"Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës."*

Shiko nenin 3 të Kodit të Familjes: "*Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese*.
Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes".

Shiko paragrafin 32 të "Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës": *"Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese*.

[11] Shih barrën e provës që më ngarkohet nga Komisioni në kriteret e figurës dhe profesionalizmit në raportin që më është njoftuar për "Rezultatet e hetimit administrativ".

huadhënës të babait tim tim në vitin 2006), ***ndërkohë që Komisionit ia bëra me dije që në përgjigjet e pyetësorit të parë*** se kam vështirësi për t'i siguruar vetë këto të dhëna (për të cilat po informoja Komisionin si dhe po ia kërkoja që Komisioni t'i merrte vetë), pasi ato janë të dhëna konfidenciale dhe për rrjedhojë janë të mbrojtura nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale..!!?

Cila ishte pengesa e faktit/ligjit që e detyroi Komisionin që të ma ngarkonte mua si barrë prove në hetimin administrativ, sigurimin e të dhënave në fjalë, ndërkohë që Komisioni mund t'a bënte vetë këtë gjë, sipas ligjit 84/2016, duke kërkuar informacionin dhe dokumentacionin zyrtar përkatës (mbi bazën e informacioneve të referuara nga unë dhe/apo ato që i ka çmuar si të nevojshme vetë Komisioni), nga organet shtetërore kompetente !!?

Cila është garancia që ky dokumentacion financiar tatimor/pronësor/bankar të shtetasve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri është i plotë dhe shterues, në kushtet kur për shkak të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, unë qartësisht kam patur pengesa ligjore për t'a siguruar të plotë këtë dokumentacion !!?

Pra, cila është garancia që pikërisht për shkak të veprimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, dokumentacioni në fjalë, mund të mos merret/të jetë administruar i plotë dhe për rrjedhojë i bie që unë të jem ndëshkuar pa faj në procesin tim të rivlerësimit !!?

Cila ka qënë arsyeja që Komisioni më detyroi mua t'a sjell këtë dokumentacion përmes shpenzimit të shumave të konsiderueshme financiare, ndërkohë që ai mund t'a siguronte këtë dokumentacion vetë, pa pagesë, përmes korrespondencës zyrtare institucionale !!?

E njëjta gjë sikurse për shtetasit Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, vlen edhe për informacionin/dokumentacionin me natyrë pasurore të "personave të tjerë të lidhur me mua", që përmënden në kriterin tim të pasurisë, të analizuar në procesin tim të rivlerësimit.

IV. Cila është garancia që unë jam gjykuar nga Komisioni sipas parimit të "gjykimit të drejtë", ndërkohë që kam qënë objekt dhune, pra trajtimi ç'njerëzor dhe/apo poshtërues prej tij në procesin tim të rivlerësimit !!?

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

Pretendimet e mësipërme të ngritura si objekt dhe shkak ankimi lidhur me cënimin që i është bërë nga Komisioni, të drejtës time të parashikuar nga neni 3 i KEDNj si dhe nenet 17/2 dhe 42 të Kushtetutës, për të mos iu nënshtruar trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues, pasqyrojnë ndjekjen njëherazi të pesë qëllimeve, që janë si më poshtë:

1. Qëllimi i parë: E drejta për punësim (ku përfshihet edhe e drejta ime për të punuar si magjistrat) dhe e drejta për të mos iu trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues, janë që të dyja të drejta kushtetuese por njëherazi edhe të drejta subjektive civile. Këto dy të drejta marrin pjesë në mënyrë të pavarur nga njëra - tjetra ne rendin ligjor në kuptimin që cënimi i njërës të drejtë jo domosdoshmërisht sjell si pasojë automatike edhe cënimin e të drejtës tjetër.

Pra, mundet që shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit të ketë qënë i drejtë (gjë që unë e përjashtoj), por njëkohësisht kjo nuk do të thotë se unë nuk i jam nënshtruar trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues nga Komisioni në procesin tim të rivlerësimit.

Askush nuk ka të drejtë që të të shkaktojë dhimbje shpirtërore dhe vuajtje mendore apo fizike përmes trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues. Prandaj unë përmes ngritjes së këtij shkaku ankimi përpara Kolegjit shpreh njëherazi edhe protestën time ndaj kësaj sjelljej të Komisionit.

Për rrjedhojë, është e drejta ime për t'u kompensuar për këtë dhimbje të paligjshme dhe të pameritуar, pavarësisht nga fakti nëse shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit do konsiderohet apo jo i ligjshëm nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Për t'u kompensuar unë për këtë dhimbje shpirtërore, është e nevojshme që të shqyrtohet në meritë (në themel) pretendimi im për trajtim ç'njerëzor apo poshtërues nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

I lutem Kolegjit të ketë parasysh se sipas ligjit 84/2016 dhe aneksit të Kushtetutës, si dhe në tërësi legjislacionit procedural që është në fuqi në R.Sh, unë nuk kam asnjë organ tjetër tek i cili të ankohem për problematikën e sipërpërmëndur të trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues nga Komisioni përveçse në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Vetëm nëse Kolegji e shqyrton në meritë këtë pretendim timin përkundrejt Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, atëherë unë mund t'i drejtohem Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, me padinë përkatëse për shpërblimin e dëmit jopasuror.

3. Qëllimi i dytë: ka të bëjë me nevojën time për të hedhur poshtë një nga shkaqet që përshkruhet në vendimin e Komisionit se përse jam shkarkuar nga detyra. Konkretisht, në lidhje me argumentimin e Komisionit të shprehur në kuadrin e vlerësimit tërësor të procedurave të rivlerësimit, se unë nuk jam treguar bashkëpunues me komisionin gjatë kohëvazhdimit të procesit tim të rivlerësimit. Ky është një nga shkaqet që është patur parasysh nga Komisioni në parag. 98.1 të vendimit.

Unë e ndjek qëllimin në fjalë përmes ngritjes së trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues si shkak ankimi pasi është jashtë çdo logjike njerëzore apo ligjore që t'i kërkosh llogari dhe aq më shumë t'a ndëshkosh viktimën e dhunimit se përse nuk bashkëpunoi në dhunuesin e fizikut, dinjitetit dhe personalitetit të tij.

Këtu vlen po ajo që u shpreha më sipër, në rastin e pretendimit për diskriminim, pra nëse do të veprohej kështu, do të përligjej Tirania, do të dhunohej nocioni i lirisë së një qënieje njerëzore, do të shkatërrohej autoriteti dhe nderimi që magjistrati/gjyqtari me sjelljen e tij, duhet t'i frymëzojë publikut lidhur me Madhështinë dhe Lartësinë e pushtetit gjyqësor.

(Edhe lidhur me këtë shkak ankimi, njësoj si për diskriminimin, shprehem se m*egjithatë, pavarësisht dhunimit tim, unë me durim dhe përulësi, prapë kam bashkëpunuar me komisionin në procesin tim të rivlerësimit. Komisioni nuk thotë të vërtetën në vendim lidhur me bashkëpunimin tim. Këtë do t'a sqaroj në pjesën e ankimit që shprehet pikërisht për problematikën e bashkëpunimit*).

3. Qëllimi i tretë: Ngritja e shkakut të ankimit që lidhet me trajtimin ç'njerëzor apo poshtërues ka të bëjë me faktin se nëse pretendimet e mia gjenden të bazuara nga Kolegji, atëherë i bie të vërtetohet se Komisioni nuk ka qënë për mua gjykatë e paanshme dhe e drejtë. Kjo pasi vetëm një gjykatë humane, njerëzore, mund të jetë gjykatë e paanshme dhe e drejtë. Gjykimi i paanshëm dhe gjykimi i drejtë janë standarte kushtetuese që përfshihen në të drejtën për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 6/1 i KEDNj dhe nenet 17/2 dhe 42 të Kushtetutës.

4. Qëllim i katërt: Ngritja e shkakut të ankimit që lidhet me trajtimin ç'njerëzor apo poshtërues ka të bëjë me faktin se nëse pretendimet e mia gjenden të bazuara nga Kolegji, sipas ligjit 84/2016, Kolegjit i lind detyrimi që shqyrtimin e ankimit tim të mos e bëjë në dhomë këshillimi por në seancë gjyqësore publike. Kjo pasi vetëm në këtë mënyrë mund të ndreqen efektivisht pasojat e shkeljeve procedurale që ka bërë Komisioni në procesin tim të rivlerësimit.

5. Qëllim i pestë: Ngritja e shkakut të ankimit që lidhet me trajtimin ç'njerëzor apo poshtërues ka të bëjë me faktin se nëse pretendimet e mia gjenden të bazuara nga Kolegji, atëherë i bie që Komisioni ka dështuar në procesin tim të rivlerësimit të më ketë respektuar parimet themelore të drejtësisë sikurse janë barazia e armëve, mbrojtja efektive, siguria juridike, e drejta e aksesit në informacionin gjyqësor mbi të cilin ti po gjykohesh/ndëshkohesh, etj.

Së njëzetë e tre: Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në vendimin e tij Komisioni shprehet se një ndër shkaqet se përse më ka shkarkuar nga detyra e gjyqtarit, i marrë parasysh në kuadrin e vlerësimit të përgjithshëm të procedurave, është edhe mosqënia ime bashkëpunues me Komisionin në kryerjen e procesit të rivlerësimit. ***Unë e kundërshtoj duke e ngritur si shkak ankimi këtë qëndrim të Komisionit***. Kjo për arsyet e mëposhtme:
I. Fakti që unë kam paraqitur 11 kërkesa për përjashtimin e Komisionerëve, (që konsiderohet si indikator mosbashkëpunimi nga ana e Komisionit), nuk është gjë tjetër veçse ushtrim nga ana ime i një të drejte kushtetuese që është e drejta për të m'u dëgjuar zëri në paraqitjen e kritikave të mia lidhur me mospërmbushjen nga an e komisionerëve të standarteve të "Gjykatës së krijuar me ligj", "Gjykatës së paanshme", "Gjykatës së drejtë", "Gjykatës së pavarur". Të gjitha këto standarte janë shkelur nga Komisioni në procesin tim të rivlerësimit, (*gjë për të cilën deri diku jam shprehur më sipër por do shprehem më hollësisht në vijim të përmbajtjes së ankimit, në pjesët ku kam ngritur si shkaqe ankimi vendet e ndërmjetme të trupave gjykues që i kanë rrezuar këto kërkesa*).

II. Komisioni shprehet në vendim se fakti që nga 11 kërkesa përjashtimi vetëm 2 janë pranuar ndërsa 9 janë rrëzuar, tregon se unë kam abuzuar me të drejtën e mbrojtjes me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit. Ky qëndrim i Komisionit është i gabuar. Kjo pasi po të kisha abuzuar me të drejtën e mbrojtjes sikurse shprehet Komisioni, trupat gjykues të Komisionit që kanë shqyrtuar 9 kërkesat e përjashtimit dhe që i kanë rrëzuar ato, ***do të më ndëshkonin me gjobë***, sipas ligjit 84/2016. Fakti që nuk jam gjobitur asnjëherë tregon se kërko kërkesa nuk kanë patur elementë abuzivë po kanë qënë shprehje të nevojës si dhe të të drejtës time për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes në procesin e rivlerësimit.

III. Ndryshe nga sa pretendon Komisioni, zvarritjen e procesit të rivlerësimit, nuk e kam shkaktuar unë ***por vetë Komisioni***. Kjo pasi janë pikërisht punonjësit e Komisionit dhe konkretisht komisionerët Roland Ilia dhe Etleda Çiftja, që përmes mosdeklarimit prej tyre të konfliktit të interesit, si dhe hetimit sipërfaqësor të kriterit të pasurisë në procesin tim të rivlerësimit, shkaktuan zvarritjen e këtij procesi nga data 13.06.222 dhe deri në datën 09.12.2022, (pra mbi 6 muaj), duke bërë kështu të nevojshme paraqitjen prej meje në datën 14.06.2022 të dy kërkesave për përjashtimin e dy komisionerëve për konflikt interesi si dhe të një kërkese për riçelje të hetimit gjyqësor në të tre kriteret. Provë për këtë janë dy vendimet për përjashtimin e komisionerëve të datave 14.06.2022 dhe 19.06.2022 si dhe vendimi për pranimin e kërkesës time për riçeljen e hetimit gjyqësor në të tre kriteret e datës 21.06.2022.

IV. Fakti që nuk kam paraqitur kërkesat procedurale në seancën dëgjimore të datës 09.12.2022, të grupuara si dhe menjëherë (pra, të gjitha njëherësh), sapo filloi kjo seancë kur m'u tha/u ftova[12] nga nga komisionerja Pamela Qirko në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, ***nuk është tregues mosbashkëpunimi*** sikurse shprehet në vendim Komisioni. Kjo pasi: ***i.*** Arsyeja e parë është se nga pikpamja procedurale procesi nuk drejtohet nga kryesuesi me ftesa, (mospranimi i ftesës nuk sjell pasoja). ***ii.*** Arsyeja e dytë është se përfshihej në të drejtën time të disponibilitetit ekskluziv zgjedhja e mënyrës se si do t'i paraqisja kërkesat procedurale paraprake të gjykimit administrativ. Unë zgjodha mënyrën një e nga një pasi vlerësova se njohja me vendimin e ndërmjetëm të komisionit për kërkesën paraprake paraardhëse do të ishte parakusht për mua për të vendosur nëse do duhej apo jo t'a paraqisja kërkesën paraprake pasardhëse. ***iii.*** Arsyeja e tretë ishte disi emocionale dhe subjektive. Kjo pasi m'u duk fyese për dinjitetin tim që të pranoja ftesën nga komisionerja Pamela Qirko për të më mësuar/diktuar kur, si, cilat kërkesa paraprake do të duheshin paraqitur në seancën e datës 09.12.2022, për më tepër edhe duke e ditur që ajo ka mbaruar fakultetin me mesatare 7.14, me korrespondencë, (ndërsa unë me 9.72, ditën, dhe kam mbaruar edhe Shkollën e Magjistraturës), si dhe ajo ka marrë dy nota dhjeta vetëm në fiskulturë, pra që kjo komisionere nuk plotëson standartin e Gjykatës së krijuar me ligj sipas nenit 6 të ligjit 84/2016.

V. Fakti që kam paraqitur kërkesat procedurale që kam patur në përmbyllje të hetimit administrativ, në një dokument të unifikuar dhe të integruar në përmbajtjen e materialit tim të mbrojtjes, që i kam dërguar Komisionit me datën 29.11.2022, në rrugë elektronike, (i titulluar Memo-KPK-Shkodra), ndonëse nga Komisioni më është kërkuar hartimi i një dokumenti apo disa dokumenteve të ndara ku të paraqiteshin këto kërkesa procedurale, veçmas nga materiali i im mbrojtjes[13], nuk është tregues i mosbashkëpunimit tim me Komisionin. Kjo as nuk tregon dhe aq më pak mjafton për të treguar se unë kam patur për qëllim zvarritjen e procesit. Thjesht paraqitja e një dokumenti të vetëm të integruar, që përmbante krahas shpjegimeve të mia edhe

[12] Nga komisionerja m'u tha fjalë për fjalë "*Ju ftojmë në mënyrë dashamirëse që t'i paraqisni tani të gjitha kërkesat procedurale që keni*". Unë e pyeta shprehimisht "*kjo është ftesë apo urdhër, nëse është urdhër jam i detyruar t'i bindem por nëse është ftesë është në vullnetin tim të zgjedh nëse do e pranoj ftesën*". Nga komisionerja Pamela Qirko m'u tha në përgjigje "*është ftesë dashamirëse*". Unë u përgjigja "*atëherë nuk e pranoj ftesën por dua t'i paraqes kërkesat procedurale një nga një*". (Dëgjo procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 09.12.2022).

[13] Shih emailin që më ka dërguar komisioni në datën 01.12.2022, ku më ka kërkuar këtë gjë.

kërkesat procedurale të mia, ishte ushtrim i të drejtës time të mbrojtjes në mënyrë të pavarur, të pandikuar apo diktuar nga kushdo qoftë edhe vetë Komisioni[14].
Veç kësaj, arsyet që unë i kam treguaar Komisionit se përse nuk kam pranuar ftesën e tij si më sipër janë të gjitha të ligjshme[15].

VI. Fakti që avokati im Arben Llangozi përmes emailit që i ka dërguar Komisionit me datën 01.12.2022 ka kërkuar 10 ditë kohë për t'u njohur si avokat me mbrojtjen time dhe dokumentacionin përkatës, ***pasi mbrojtja ka qënë voluminoze***, nuk tregon dhe aq më pak mjafton për të treguar vullnetin tim për të zvarritur procesin e rivlerësimit. Kjo pasi paraqitja e kësaj kërkese ka qënë e drejtë e avoaktit dhe për më tepër, vetë sjellja ime që nuk kam paraqitur ndonjë kundërshtim ndaj vendimit të Komisionit për t'a pranuar vetëm pjesërisht kërkesën e avokatit për kohë, (5 ditë nga 10 të kërkuara), tregon se nuk kam patur për qëllim zvarritjen e procesit. Për më tepër, 10 ditë kohë shtesë që ka kërkuar avokati me emailin e datës 01.12.2022, ***nuk kanë proporcionalitet*** me mbi 6 muaj kohë që e zvarriti procesin tim të rivlerësimit vetë Komisioni, përmes mosveprimit të komisionerëve Roland Ilia dhe Etleda Çiftja, që përmes mosdeklarimit prej tyre të konfliktit të interesit si dhe hetimit sipërfaqësor të kriterit të pasurisë në procesin tim të rivlerësimit, që shkaktuan zvarritjen e këtij procesi nga data 13.06.222 dhe deri në datën 09.12.2022, (gjë për të cilën u shpreha më sipër).

VII. Argumentimi në vendim nga Komisioni dhe i shprehur edhe në emailin që më ka dërguar me datën 05.12.2022 se "*më emailin që i kam dërguar komisionit në datën 05.12.2022, kam përdorur një gjuhë fyese dhe kërcënuese për komisionin*", nuk qëndron. Kjo pasi po të shihet mirë emaili im tek i cili referon komisioni, ***nuk ka asgjë të vërtetë nga ato që pretendon Komisioni***. Gjithashtu, i kërkoj Kolegjit që të lexojë edhe emailin që i kam dërguar Komisionit me datën 07.12.2022, lidhur me këtë problematikë përmes të cilit (përmbledhtaz) i parashtroj se ka pasqyruar fakte të rreme, të pavërteta si dhe pikërisht ky pasqyrim i deformuar i të vërtetës përbën një nga shkaqet për të cilin krahas shkaqeve të tjera, kërkoj përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli. (*Shkaqet e tjera për përjashtimin e Komisioneres Firdes Shuli, parashtrohen në një kërkesë për përjashtim që ia dërgova komisionit së bashku me emailin e datës 07.12.2022, por që do t'a evidentoj edhe në vijim të përmbajtjes së këtij ankimi*).

VIII. Argumentimi në vendim nga Komisioni dhe i shprehur edhe në emailin që më ka dërguar me datën 05.12.2022 se "*kam abuzuar me afatin që më është dhënë nga komisioni për të paraqitur kërkesat procedurale, afat ky që më është komunikuar me emailin e datës 01.12.2022*", nuk qëndron. Kjo pasi po të shihet emaili i datës 05.12.2022, që i kam dërguar Komisionit në përgjigje të emailit që më ka dërguar me datën 01.12.2022, duket qartë se jo vetëm që faktikisht ia ka dërguar kërkesat procedurale të hetimit me një dokument të vetëm, të ndarë nga pjesa tjetër e mbrojtjes, (sikurse Komisioni më ka ftuar), por madje i kam përcaktuar edhe radhën që duhet të ndiqte Komisioni, sipas vlerësimit tim, të trajtimin me vendime të ndërmjetme të këtyre kërkesave.

[14] Shih përgjigjen me email që i kam dërguar Komisionit me datën 05.12.2022 ku i bëj me dije arsyet e mia se përse e shoh të panevojshme dhe kundër interesave të mia të mbrojtjes paraqitjen e kërkesave procedurale përmes dokumenteve të ndara nga pjesa tjetër e materialit tim të mbrojtjes që i kam dërguar komisionit me emailin e datës 29.11.2022, të titulluar MEMO-KPK-SHKODRA.

[15] Për më tepër shih emailin që i kam dërguar komisionit në datën 01.12.2022 dhe veçanarisht në datat 05.12.2022 dhe 07.12.2022.

IX. Unë jam përpjekur t'i përgjigjem gjithmonë në afatin e përcaktuar nga Komisioni, dy pyetësorëve të vetëm që më ka dërguar pas dërgimit të pyetësorit standart, (ndryshe nga të gjithë subjektet e tjerë të rivlerësimit që i ka dërguar disa të tillë). Edhe nëse kam dalë pak jashtë afatit, i kam dërguar kërkesë paraprake komisionit për zgjatjen e afatit që më ishte caktuar për t'u përgjigjur duke i shprejuar arsyet objektive përkatëse si dhe duke i mbështetur këto arsye në prova të qarta dhe të pakundërshtueshme që tregonin ekzistencën reale të këtyre arsyeve objektive.

X. Edhe nëse jashtë dëshirës time ka patur ndonjë element fragmetar, të shkëputur dhe për rrjedhojë të parëndësishëm në vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit tim me Komisionin në kryerjen e procesit tim të rivlerësimit, ***unë këtë e kam bërë duke u ndodhur ose në gjendjen e mbrojtjes së nevojshme ose nën ndjesinë e të qënit i provokuar nga cënimi i disa prej të drejtave të mia themelore kushtetuese si qënie njerëzore nga vetë Komisioni***. Këtu i kujtoj edhe një herë Kolegjit qëndrimin tim të mësipërm të ngritur edhe si shkak ankimi se është jashtë çdo logjike njerëzore apo ligjore që t'i kërkosh llogari dhe aq më shumë t'a ndëshkosh ***viktimën e diskriminimit dhe trajtimit të barabartë, viktimën e trajtimit ç'njerëzor dhe poshtërues*** se përse nuk bashkëpunoi në dhunuesin e dinjitetit dhe personalitetit apo fizikut të tij. Nëse do të veprohej kështu, ***do të përligjej Tirania***, do të pengohej e drejta e revoltës dhe e reagimit ndaj padrejtësisë/cënimit të dinjitetit njerëzor, do të dhunohej në palcë nocioni i lirisë së një qënieje njerëzore me personalitet, do të shkatërrohej autoriteti dhe nderimi që magjistrati/gjyqtari me sjelljen e tij, duhet t'i frymëzojë publikut lidhur me Lartësinë dhe Madhështinë e pushtetit gjyqësor.

Në thellim të argumentit të mësipërm, i lutem Kolegjit t'a mirëkuptojë dëshirën time për t'a paralelizuar situatën time lidhur me mënyrën e ushtrimit të të drejtës time të mbrojtjes përpara Komisionit (dhe nivelit tim të bashkëpunimit me të) me disa shëmbuj të mëposhtëm:

Ne veprën "Apologjia" të Sokratit (filozof i Athinës së Lashtë) përshkruhet se ndërsa Sokrati ishte akuzuar me të padrejtë nga Tirani me akuzën e tradhtisë ndaj Atdheut, ndërmjet Sokratit dhe mikut të tij Kritonit zhvillohet (përmbledhtaz) biseda e mëposhtme:

Kritoni: *Nesër ke gjyqin. Rrezikon të dënohesh me vdekje. Të lutem kij kujdes dhe shprehu në atë formë që t'i shkaktosht gjyqtarëve ndjesinë e mëshirës për ty si dhe bëj një kundërofertë të arsyeshme, pra prano ekzilin në vënd të dënimit me vdekje. Ke fëmijë që do mbeten në mëshirën e fatit pa ty, ke shokë dhe miq që të duan dhe kanë nevojë për ty, mos j'i egoist e as budalla*.

Sokrati: *Po t'a bëj këtë që thua, nuk do të kem mundësinë që të tregoj që akuza është e padrejtë, që gjykata përbëhet edhe nga të paditur edhe të ligj. Nuk do të kem mundësi t'a ekspozoj të keqen, nuk do të kem mundësi t'i shërbej nderit tim, nderit të fëmijëve të mi dhe të mirës së Atdheut duke u përpjekur të bëj sa mundem për t'i treguar popullit të keqen. Për rrjedhojë, populli duke mos e parë të keqen nuk do ketë arsye të përpiqet dhe të gjejë forca për t'a luftuar atë. Kështu, Tirani do triumfojë, njerëzit e popullit tim do vijojnë të vuajnë dhe madje e keqja që ka kapluar Atdheun do thellohet*".

Edhe Martin Luter King, që sikurse dihet ishte udhëheqësi kryesor i Lëvizjes jo të dhunshme të të Drejtave Civile në SHBA, në "Letër nga burgu i Birminghamit", 16 prill 1963, (përmbledhtas) shprehet:

Padrejtësia është një kërcënim për drejtësinë kudo. Është detyra jonë t'a ekspozojmë padrejtësinë. Kështu zemërimi ndaj saj me kalimin e kohës do rritet mes njerëzve. Do vijë padyshim çasti kur ky zemërim do shndërrohet në një forcë të papërballueshme që do të ngadhënjejë mbi padrejtësinë dhe do arrihet më në fund qëllimi i triumfimit të drejtësisë.

Edhe një femër e jashtëzakonshme, (jo si ato tre leopardët e fabulës) që quhet Hanah Arendt dhe që është një nga mendimtaret më të shquara të etikës politike moderne shprehet si më poshtë.

Përpjekja me vetmohim civil, me kurajo paqësore për t'a detyruar padrejtësinë për të ushtruar dhunë, shënon fillimin e fundit të kësaj. Kjo pasi ushtrimi i dhunës provokon reagimin e njerëzve të cilët për natyrë kanë nevojë të jenë të lirë dhe të zgjedhin të mirën përkundrejt të keqes.

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
Unë, me kurajo civile, etikë qytetare dhe me vetmohim, në mbrojtjen time përpara Komisionit, kam përzgjedhur të mos i përulem dhunuesit të të drejtave të mia kushtetuese. Kjo edhe pse e kam ditur se në betejën me Padrejtësinë, Drejtësia mund të ketë dëshmorët e saj.

Këtë zgjedhje për të mos u përulur nuk e kam bërë vetëm kur jam detyruar që në procesin tim të rivlerësimit, t'i përgjigjem komisionerëve të paligjshëm, të njëanshëm, të padrejtë, arbitrarë dhe dhunues që përbënin trupin tim gjykues të Komisionit.

Këtë zgjedhje për të mos u përulur, e kam bërë gjatë gjithë karierës time 19 vjeçare si gjyqtar i Republikës së Shqipërisë.

- Për shembull e kam bërë edhe kur ndonëse kisha dy vjet punë, u kërcënova me vdekje nga kriminelë që donin të më frikësonin në gjykimin tim lidhur me çështjen penale që unë kam dalë në pakicë duke votuar që i pandehuri të dënohej me 20 vjet burgim dhe që përmëndet në kriterin e figurës, (duke u detyruar që mbi dy vjet të lëviz me pistoletë në xhep).

- E kam bërë edhe kur me datën 25.11.2019, për hakmarrje nga sekuestrimi i një pasurie mbi 3 milion euro, më dogjën automjetin e parkuar në parkimin publik poshtë banesës time, (kjo në një përpjekje të qartë për të më frikësuar).

- E kam bërë edhe kur rreth dy-tre javë pas ngjarjes terroriste të mësipërme, (të pazbuluar akoma), unë me datën 15.12.2019, së bashku me motrën time, prokuroren Ajola Prençi (Ymeri), u përfshimë në të ashtuquajturin "Short special" të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (*dhe për të cilin ndonëse kërkova disa herë me shkrim dhe me gojë sqarime, nuk m'u dha asnjëherë shpjegim se mbi cilat arsye/fakte/të dhëna objektive unë dhe motra ime u përfshimë në këtë short special*).

- E kam bërë edhe kur gjatë shkruajtjes së vendimit në çështjen e ankesës së shtetases Daria Damidova (që përmëndet në paragrafin 85 të vendimit të Komisionit), kam sjellë ndër mënd

dorën e përgjakur dhe me gishta të prerë nga ingranazhet e makinerisë të punëtorit, teksa ai m'a tundte këtë dorë në sallën e gjyqit duke më shpjeguar kushtet e mjerueshme, tërësisht jashtë rregullave të sigurimit teknik dhe skllavëruese në të cilat nevoja për të siguruar bukën e fëmijëve e kishte detyruar të punonte. Po ashtu kur teksa shkruaja vendimin, sillja ndër mënd shprehjen e fytyrës së punëtorit që dukej se vuante teksa më shpjegonte se për shkak të gjymtimit, pala e paditur e kishte pushuar nga puna dhe se ai meqënëse ishte pothuajse pa dorë, nuk kishte mundur të gjente punë tjetër dhe për rrjedhojë nuk kishte të ardhura për të ushqyer fëmijët.

- E kam bërë edhe kur gjatë shkruajtjes së vendimit në çështjen e ankesës së Kurum International sh.a, (që përmëndet në paragrafin 90 të vendimit të Komisionit), kam sjellë ndër mënd ndjesinë e vuajtjes së të pafuqishmit dhe të dobëtit dinjiteti dhe personaliteti i të cilit është marrë nëpër këmbë dhe dhunuar në mënyrë të përsëritur nga punëdhënësi i tij, përmes diskriminimit, viktimizimit dhe keqtrajtimit.

- E kam bërë edhe kur gjatë shkruajtjes së vendimit në çështjen e ankesës së Intersig Ëienna Insurance Group sh.a, (që përmëndet në paragrafin 91 të vendimit të Komisionit), kam sjellë ndër mënd sjelljen e përfaqësueses së palës ankuese në KPK ndaj meje që përmes gjoja artificave procedurale, kishte për qëllim të shmangte/asgjësonte/zvogëlonte apo shtynte në kohë, detyrimin për të dëmshpërblyer të dëmtuarën.

- E kam bërë edhe kur gjatë shkruajtjes së vendimit në çështjen e ankesës së OSHEE sh.a, (që përmëndet në paragrafin 94 të vendimit të Komisionit), kam sjellë ndër mënd lotët e fëmijëve, kujën e nënës, gjëmën e britmat e të atit e vëllait, të shkaktuara nga vdekja e të dashurit të tyre ndërkohë që pala dëmsjellëse në vend që të paguante për shpërblimin e dëmit këto para gjaku, planifikonte t'i mbante ato pasi mbase i duheshin për t'i shpenzuar duke ngrënë biftek special tek Nustreti në Dubai. Këtë nuk e kam bërë vetëm në rastin që përmëndet në raport por edhe në raste të tjera për të cilat, sikurse e përmënda më sipër, motra e Komisioneres Pamela Qirko, ministrja Belinda Balluku dhe/apo vartësit e saj në OSHEE sh.a, janë ankuar ndaj veprimtarisë time gjyqësore në SPAK, ILD apo edhe vetë në KPK . Këtë e kam bërë pasi e kërkonin interesat e drejtësisë, pavarësisht se e dija që do ekspozohesha ndaj hakmarrjes.

E kam bërë edhe në shumë e shumë raste të tjera në ushtrimin e detyrës time si gjyqtar në Republikën e Shqipërisë, për mbi 19 vjet, pa u frikësuar as nga kërcënimet e kriminelëve as nga pozita shtetërore e lartë e atyre që kanë në dorë të të bëjnë padrejtësi. Nuk jam stepur e as tërhequr as kur më kanë hequr gruan nga puna, as kur më kanë hequr vëllain nga puna, as kur më kanë hequr kunatin nga puna, dhe as kur Firdes Shuli me koleget e saj më shkarkoi motrën time binjake prokuroren Ajola Prençi (Ymeri) absolutisht padrejtësisht nga puna.

Nuk jam stepur edhe pse e kam ditur që motra e ministres që është ankuar ndaj meje, do më shkarkojë edhe mua padrejtësisht.

Nuk stepem as tani që po shkruaj këtë ankim. Kjo pasi nderi si qytetar, dashuria për Atdheun dhe respekti për madhështinë e dinjitetit të gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë, më japin kurajon e duhur për të përballuar çdo sakrificë, çdo vështirësi dhe duke i përçmuar dhe përbuzur të padrejtët.

XI. Teksa po e përfundoj së shprehuri në ankim qëndrimin tim lidhur me argumentimin e Komisionit se duhem shkarkuar nga detyra edhe për shkak se "nuk paskam bashkëpunuar me Komisionin në procesin e rivlerësimit", po kujtohem se sipas ligjit 84/2016, për arsyetimin e vendimit të trupit gjykues të Komisionit, ka qënë përgjegjëse komisionerja relatore, pra Komisionerja Genta Bungo.

Meqënëse prezumohet që është ajo që e ka arsyetuar vendimin lidhur me problematikën e nivelit tim të bashkëpunimit, atëherë si shkodran që jam, pra jo nga Jugu i Shqipërisë, më vjen ndër mend një pjesë nga poezia e një poeti që nuk po ia them emrin pasi besoj të gjithë e njohin dhe që është nga qyteti im.

Ai në një pjesë nga poezia e tij "Na t'birt e shekullit të ri", jo vetëm stigmatizon vogëlsinë shpirtërore të dhunuesve që janë pjellë e Paligjshmërisë dhe Padrejtësisë por edhe shpreh mosdorëzimin, mosnënshtrimin dhe zellin luftarak të vegjëlisë ndaj tyre, të cilët ndonëse e dinë edhe vetë vanitetin e tyre moral, mendor dhe shpirtëror, për t'a fshehur këtë, nuk hezitojnë të përdorin dhunë për të imponuar sjelljen përkundrejt tyre me respekt të madhërishëm.

Poeti në këtë poezi, ndër të tjera, shkruan se:

....jo! jo! s'i duem humbjet prore
duem ngadhnim!
ngadhnim, ndërgjegje dhe mendimi të lirë!
S'duem, për hir
të kalbsinave të vjetra, që kërkojnë "shejtnim",
të zhytemi prap në pellgun e mjerimit
që të vajtojmë prap kangën e trishtimit,
kangën monotone, pa shpirt, të sklavnis
të jem' një thumb i ngulun ndër trutë e njerzis.
Na të birtë e shekullit të ri,
me hovin ton e të ndezun peshë,
ndër luftra të reja kemi m'u ndeshë
dhe për fitore kem' me ra fli.

Së njëzetë e katërti: Në lidhje me objektin e ankimit të përmëndur të pikat 2 dhe 3 të pjesës hyrëse të këtij ankimi, në rubrikën objekti, **ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit** edhe faktin që pas përjashtimit të komisionerëve Roland Ilia dhe Etleda Çiftja nga trupi gjykues, trupi i ri gjykues ka konsideruar të vlefshme veprime administrative të kryera nga këto të fundit, si:
i. dërgimin e pyetjeve me formularin standart,
ii. dërgimin e pyetjeve me pyetësorin e parë ,
iii. dërgimin e pyetjeve me pyetësorin e dytë[16].

[16] I lutem Kolegjit të vlerësojë si tregues të pabarazisë në trajtimin tim nga Komisioni edhe faktin që mua në dallim nga të gjithë subjektet e tjerë të rivlerësimit, Komisioni më ka dërguar vetëm dy pyetësore shtesë në lidhje me pasurinë, (edhe këto mi ka dërguar koisioneri relator Roland Ilia, që më pas u përfjashtua nga gjykimi për shkak të konfliktit të interesit). Nuk më është dërguar asnjë pyetësor në lidhje me kriterin e figurës dhe as profesionalizimit. Pas këtyre dy pyetësorëve të vetëm që më janë dërguar, jam njoftuar për seancën e parë dëgjimore të datës 27.05.2022, gjë që tregon urgjencën kohore me të cilën ka vepruar Komisioni për të përmbyllur procesin tim të rivlerësimit. Vetë fakti i kësaj urgjence, në thelb tregon paragjykimin tim nga Komisioni.

iv. pjesërisht të vlefshëm raportin për përfundimin e hetimit administrativ të datës 24.04.2022. Duke i konsideruar të vlefshme aktet e mësipërme, pa ndonjë vendimarrje të arsyetuar, Komisioni ka konsideruar ***si të përdorshme*** të dhënat/pohimet e mia/faktet/rezultatet që përbëjnë pasojë juridike të këtyre veprimeve administrative të kryera nga trupi gjykues i mëparshëm i komisionit, në përbërje të të cilit ishin dy komisionerët e përjashtuar nga gjykimi, për shkak të konfliktit të interesit.

Veprimtaria e vësipërme e Komisionit, bie në kundërshtim të hapur si me parashikimet e ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të R.SH" ashtu edhe me parashikimet e ligjit nr .9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesisit në ushtrimet publike"[17].
Kjo pasi meqënëse komisionerët Roland Ilia dhe Etleda Çiftja janë përjashtuar për shkak të konfliktit të interesit, të gjitha (çdo) veprim administrativ i kryer prej tyre kmonsiderohet si absolutisht i pavlefshëm dhe si i tillë nuk sjell asnjë pasojë juridike.

Për rrjedhojë, janë të papërdorshme të gjitha (çdo) të dhënat/provat/shpegimet/rezultatet që janë marrë duke u përdorur si instrument veprimet absolutisht të pavlefshme në fjalë.

Unë ***e kam ngritur*** pavlefshmërinë e këtyre veprimeve dhe papërdorshmërinë e provave të marra si rezultat i tyre, (*në kohën e duhur, pra kur kam marrë dijeni se këto veprime janë konsideruar të vlefshshme dhe provat që janë pasojeë e tyre, janë konsideruar të përdorshme, nga trupi i ri gjykues*), duke i dërguar një email të posaçëm Komisionit lidhur me këtë problematikë. Konkretisht i kam dërguar Komisionit email-in e datës 05.12.2022, por nuk kam marrë përgjigje të shprehur, as pozitive dhe as negative, lidhur me kërkesën time procedurale për të riparuar dhe zgjidhur këtë problematikë.

Madje, me datën 05.12.2022, Komisioni në përgjigjë të emailit që unë i adresoja lidhur me problematikën e mësipërme, më ktheu përgjigje së, për problematikën në fjalë "*do shprehet së bashku me vendimin përfundimtar*".

---

[17] Neni 40 Pavlefshmëria e akteve dhe pasojat:
1. Aktet dhe kontratat administrative të çdo institucioni publik dhe ankimimi ndaj tyre, të nxjerra në kushtet e konfliktit faktik ose në dukje të interesave, **janë të pavlefshme**, sipas kuptimit të këtij termi dhe parimeve e procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Çdo kontratë civile, e lidhur në kundërshtim me pikat 1, 2, 3 e 6 të nenit 21 dhe pikën 3 të nenit 24 të këtij ligji, ose në çdo rast tjetër, kur ajo është lidhur në praninë e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nuk krijon asnjë pasojë juridike.
3. Aktet e përcaktuara në shkronjën "a", "ii" të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të nxjerra në praninë e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, rishihen dhe rrëzohen për këtë shkak nga organi përkatës, në përputhje me kompetencat e tij për të vendosur në lidhje me këtë çështje, sipas përcaktimeve dhe sipas rastit, në Kodin e Procedurës Civile ose në Kodin e Procedurës Penale apo në ligje të tjera, që rregullojnë regjimin e këtyre akteve.
4. Aktet e përcaktuara në shkronjën "a" "iii" të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të nxjerra në praninë e konfliktit faktik të interesit, janë relativisht të pavlefshme, sipas të njëjtit kuptim të përdorur për aktet administrative në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Konflikti në dukje i interesit nuk përbën shkak për pavlefshmëri, sipas pikave 1 e 3 të këtij neni, vetëm nëse ai shfaqet në kushtet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 37 të këtij ligji.

Nga vendimi përfundimtar, "*nuk rezulton të jetë shprehur fa*re".

Thënë shkurt,
I bie që pas përpilimit të dekleratës veting nga Komisioni, unë të mos jem pyetur asnjëherë. Kjo pasi pyetësori standart, 2 pyetësorët e tjerë, raporti për ngarkimin e barrës së provës, përbëjnë akte të pavlefshme. Për rrjedhojë, edhe përgjigjet e mia janë të papërdorshme në funksion të procesit të rivlerësimit.

Duke qënë të papërdorshme këto prova, i bie që edhe vendimi i Komisionit është i paligjshëm, të paktën në ato pjesë të tyre ku iu referohet këtyre provave. P.sh në pjesët kur shprehet se "trupi gjykues konstaton kontradikta ndërmjet deklarimeve[18], ..bla..bla..bla"**. Kjo pasi një apo disa deklarime nuk mund të jenë në kontradiktë me asgjë-në/nulitetin/zeron (=pavlefshmërinë/papërdorshmërinë)**.

Ky arsyetim sjell zi pasojë zingjir, që vendimi i Komisionit që unë kundërshtoj përmes këtij ankimi, **të jetë i paarsyetuar edhe për këtë shkak**.

Pikërisht lidhur me sa më sipër unë përmes pikave 2 dhe 3 të këtij ankimi, kërkoj nga Kolegji që të pranojë kundërshtimet e mia lidhur me mosveprimin e Komisionit për të ndrequr shkeljet procedurale, pra, i kërkoj Kolegjit të pranojë ankimin tim dhe zgjidhjen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit **të pasojave juridike të kësaj pjese të ankimit**, pra të pasojave juridike të veprimtarisë së komisionerit Roland Ilia dhe komisioneres Etleda Çiftja, në kushtet e konfliktit të interesit, si më poshtë:

I. Duke konsideruar si absolutisht të pavlefshme, **të gjitha (çdo) veprim/vendim të ndërmjetëm administrativ**, ku kanë marrë pjesë këta komisionerë, për shkak të veprimit të tyre në kushtet e konfliktit të interesit.

II. Duke konstatuar **papërdorshmërinë e të gjitha (çdo) prove/rezultati/të dhëne** që është rrjedhojë e kësaj veprimtarie administrative të ushtruar në kushtet e konfliktit të interesit, **duke përfshire, por jo vetëm**, të gjitha përgjigjet që i kam dhënë unë përmes korrespondencës elektronike trupit gjykues të KPK, në kohën kur në këtë trup gjykues, ku kanë bërë pjesë komisionerët Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

III. Konstatimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, të pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është disponuar shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit, për shkak se **ato pjesë të tij, në të cilat është bërë referencë, në provat/të dhënat/rezultatet/faktet e papërdorshme (për shkak të pavlefshmërisë absolute të sipërtreguar)**, janë të tilla, pra aq të rëndësishme, sa që pa këto pjesë të vendimit, ky vendim konsiderohet i paarsyetuar dhe i kundërligjshëm.

IV. Në kushtet e mosveprimit të KPK, i kërkoj Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, **të përsërisë të gjitha (çdo) veprim administrativ** hetimor që është absolutisht i pavlefshëm, për shkakun e

[18] Sipas meje nuk ka kontradikta por vetëm koherencë të plotë. Megjithatë edhe sikur të abstragojmë se të konsiderojmë se ka kontradikta ndërmjet deklarimeve të mia, i bie që proceduralisht nuk mund të ndëshkohem duke iu referuar atyre. Kjo pasi një deklarim nuk mund të jetë në kontradiktë me nulitetin.

mësipërm, me qëllim për të vlerësuar Kolegji nëse gjendja e faktit është ashtu sikurse ka rezultuar nga këto veprime administrative hetimore absolutisht të pavlefshme.

V. Faktin që unë përmes emailit të datës 05.12.2022, i kam kërkuar Komisionit riparimin e parregullsive në fjalë, i kërkoj Kolegjit që t'a konsiderojë si tregues të përpjekjes time për të patur bashkëpunim me Komisionin në kryerjen e procesit tim të rivlerësimit.

Së njëzetë e pesti: Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit të gjitha shkaqet për të cilat kam kërkuar përjashtimin e komisionerëve të trupës gjykuese të Komisionit që ka dhënë vendimin që unë po ankimoj. Për të mos e zgjatur shumë përmbajtjen e këtij ankimi (që gjithsesi është i gjatë dhe për rrjedhojë edhe disi i lodhshëm), po citoj vetëm një pjesë të këtyre shkaqeve, në mënyrë të grupuar:

1. ***Ngrej si shkak ankimi që secili prej tre komisionerët e trupës, nuk plotëson standartin Gjykatë e krijuar me ligj***. Kjo duke patur parasysh edhe standartin e vendosur nga GJEDNj në vendimin Besnik Cani kundër Shqipërisë. Konkretisht,
a. Nga ana ime është kallzuar në SPAK fakti se shtetasja Pamela Qirko ka kryer veprën penale të "Fallsifikimit të dokumenteve" dhe "Fallsifikimit të vulave, stampave apo formularëve" të parashikuar nga nenet 186 dhe 190 të K.Penal. Kryerja e këtyre veprave nga ana e kësaj shtetase, sikurse do t'a pasqyroj më poshtë, është realizuar në formën e paraqitjes së të dhënave të rreme në dokumentet e aplikimit për t'u zgjedhur anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me mesataren e saj të notave, ku kjo shtetase nuk rezulton të ketë një mesatare mbi 8, si studente e Fakultetit te Drejtësisë, siç dhe e kërkon neni 6, paragrafi i 2, pika "d" e ligjit numër 84/2016 "Për rivlersimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.SH". Ajo ka një mesatare 7,14, por edhe kjo mesatare notash është e dyshimtë pasi ajo ka mbaruar studimet me korrespondencë dhe ka dy nota 10-ta në fiskulturë.
b. Nga ana ime është kallzuar në Spak fakti se shtetasja Genta Bungo ka kryer veprat penale të "Fallsifikimit të dokumenteve" dhe "Fallsifikimit të vulave, stampave apo formularëve" të parashikuar nga nenet 186 dhe 190 të K.Penal. Kryerja e këtyre veprave penale nga kjo shtetase është realizuar nëpërmjet pasqyrimit të të dhënave të rreme në dokumentet e aplikimit për t'u zgjedhur anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me vjetërsinë e saj në punë dhe masat disiplinore të marra ndaj saj, siç dhe e kërkon neni 6, paragrafi i 1, pika "dh" e ligjit numër 84/2016 "Për rivlersimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.SH." masa këto që kjo shtetase nuk i ka bërë të ditura në këto akte shkresore.
c. Nga ana ime është kallëzuar në Spak fakti se shtetasja Firdes Shuli ka kryer veprat penale të "Fallsifikimit të dokumenteve" dhe "Fallsifikimit të vulave, stampave apo formularëve" të parashikuar nga nenet 186 dhe 190 të K.Penal. Kryerja e këtyre veprave penale nga kjo shtetase është realizuar nëpërmjet pasqyrimit të të dhënave të rreme në dokumentet e aplikimit për t'u zgjedhur anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me masat disiplinore të marra ndaj saj, siç dhe e kërkon neni 6, paragrafi i 1, pika "dh" e ligjit numër 84/2016 "Për rivlersimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.SH.", masa këto që kjo shtetase nuk i ka bërë të ditura në këto akte shkresore.

Faktet e kallzuara në SPAK si më sipër, i kam ngritur përpara Komisionit edhe si shkaqe përjashtimi përmes 9 kërkesave për përjashtim të paraqitura dhe që më janë refuzuar me arsyetimin e paligjshëm se Komisioni nuk ka kompetencë juridiksionale që të shprehet për to.

Për rrjedhojë, sipas vendimit Besnik Cani kundër Shqipërisë, këto shkaqë përjashtimi, po ia referoj tashmë si shkaqe ankimi, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Lidhur me to bëj arsyetimin e mëposhtëm:

Në nenin 6 i ligjit 84/2016 parashikohet:

1. Anëtar i Komisionit dhe gjyqtar i Kolegjit të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:
a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
b) të ketë përvojë pune ***jo më pak se 15 vjet*** *si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës,* ***nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues*** *(*Genta Bungo-shënim i imi[19]*) ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;*
c) ***të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral të tij, nëse u është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme****; (*Firdes Shuli-shënim i imi[20]*).*
ç) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit;
d) ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose të mos ketë qenë subjekt i ndalimeve të parashikuara në ligjin "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
dh) ***ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit****,* (Alma Faskaj-shënim i imi)*;*
e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë";
ë) nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit;
f) nuk ka qenë anëtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, ose ekspert i caktuar nga partitë politike, si dhe Ministri i Drejtësisë;
g) nuk është më shumë se 65 vjeç;
gj) zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

2. Përmbushja e kritereve të mësipërme vlerësohet duke marrë në konsideratë ***në veçanti*** *të dhënat si më poshtë:*
a) titujt shkencorë në fushën e së drejtës;
b) përvojë të veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës;
c) vjetërsinë në profesion;
ç) përvojën studimore dhe profesionale jashtë shtetit shqiptar;
d) notën mesatare ***jo më pak se 8****, (*Pamela Qirko-shënim i imi[21]*), nëse ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri, ose*

[19] Nuk e plotëson.
[20] Nuk e plotëson.

studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

Në vlerësimin tim, bazuar në interpretimet që doktrina i njeh normës juridike, atë gjuhësor, sistematik, teleologjik, logjik etj, kuptimi i paragrafit të dytë të kësaj dispozite nuk nënkupton që kushtet dhe kriteret e kërkuara nëpërmjet këtij paragrafi të jenë orientuese, (ose të paktën kushti i mesatares së notave, qartazi (pika d e paragrafit 2) nuk ka karakter orientues). Kuptimi i kësaj dispozite lidhet me faktin se këto kushte dhe kritere janë përcaktuese, që do të thotë se ato përbëjnë shkak për kualifikimin apo skualifikimin e aplikuesit/kandidatit.

Pikërisht për shkak të rëndësisë të vecantë që kanë këto kushte dhe kritere për përzgjedhjen e kandidatëve, ato janë të parashikuara në listën e dokumenteve (formularin standart) që kanë dorëzuar aplikuesit përpara Avokatit të Popullit, me emërtimin "Vërtetim".

Bazuar edhe në interpretimin teleologjik (qëllimor të normës juridike) nuk mund të pranohet kurrsesi që ligjvënësi ka patur si qëllim mundësinë e përzgjedhjes së anëtarëve të Institucioneve të Rivlersimit me aftësi profesionale apo të integritetit më të vogël se ato të vetë subjekteve që ato duhet të kontrollojnë. Kjo për shkak se mungesa e këtyre aftësive mund të sjellë (sikurse ka sjellë në rastin e procesit tim të rivlerësimit) pasoja në mundësinë e ushtrimit të detyrës nga ana e komisionerëve në përputhje me qëllimin për të cilin këto organe janë krijuar.

Neni 6 i ligjit 84/2016 dhe vetë ky ligj nuk mund të interpretohet i ndarë nga ndryshimet e legjislacionit të miratuara nëpërmjet reformës në drejtësi (interpretimi sistematik) dhe duke vlerësuar të gjitha këto ndryshime, që në thelb kishin përmirësimin e performancës së organeve të drejtësisë, ***është tërësisht e paarsyeshme të mendohet se vendosja e kritereve të përzgjedhjes së organeve të rivlersimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, krijon premisa për përfshirjen në to të individëve që nuk kanë aftësitë e nevojshme profesionale apo ingritetin personal për realizimin e detyrës së tyre***.

Theksoj se pavarsisht faktit se akti i emërimit të anëtarëve të Institucioneve të Rivlersimit është një vendim i Kuvendit të R.SH, ai nuk imunizon kandidatët e përzgjedhur apo personat e ngarkuar me rekrutimin e tyre nga përgjegjësia penale, për ndonjë vepër penale të kryer gjatë këtij procesi.

Në këtë drejtim evidentoj faktin se në jo pak raste aktet e aplikimit të kandidatëve kanë pasqyruar të dhëna të pavërteta, sic evidentohet me Komisioneret Bungo, Qirko dhe Shuli dhe po kështu në disa raste të dhënat e tyre nuk kanë qenë fare objekt verifikimi, ndryshe nga sa ligji ka ngakuar organet rekrutuese, sic ka ndodhur në rastin e Komisioneres Pamela Qirko.

Bazuar në nenin 6/2, pika "d" të ligjit 84/2016 komisionerja Pamela Qirko, si aplikuese, kishte detyrimin që krahas diplomës së shkollës së lartë (fakultetit) të dorëzonte edhe listën e notave, nëpërmjet së cilës do të ishte e mundur të verifikohej perfomanca e saj gjatë studimeve universitare dhe rrjedhimisht aftësia e saj profesionale, jo vetëm në drejtim të ekzistencës së mesatares mbi 8 por edhe në drejtim të vlerësimit të kriterit "juriste e shquar".

[21] Nuk e plotëson.

Kujtojmë se ftesës së Presidentit të Republikës për të bërë pjesë në Institucionet e Rivlersimit i janë përgjigjur shumë juristë, madje duke tejkaluar disa herë numrin e pranimeve, gjë që i ka dhënë mundësinë organeve të ngarkuar me përzgjedhjen e tyre për të kualifikuar kandidatët më të mirë profesionalisht dhe në drejtim të integritetit personal.
Natyrisht është e qartë që një kandidate me mesatare 7,4 ***edhe kjo e dalë pasi është llogaritur dy herë lënda e fiskulturës, ku ka marrë 10***, nuk ka asnjë llogjikë të shëndoshë matematikore dhe juridike të mund të konsiderohet si aplikuesja më e kualifikuar profesionalisht. Kjo për shkak se jam i bindur se përpara saj ishin plot e plot kandidatë që ia kalonin disa herë mesatares së komisioneres Qirko.

Vlerësuar në këtë këndvështrim duket e cuditshme sesi kjo kandidate është përzgjedhur, madje edhe pa dorëzuar dokumentin "listën e notave", ndërkohë që paraqitja e këtij akti ishte detyrim në bazë të ligjit dhe formularëve të aplikimit. Madje në lidhje me këtë fakt kjo Komisionere nuk është pyetur fare nga Komisioni Ad-Hoc, mosveprim jo i pa qëllimtë në cmuarjen time.

Kjo çudi duket edhe më e madhe nëse kihet në konsideratë fakti se noterizimi i akteve të aplikimit të Komisioneres Qirko është bërë nga noterja Ritvana Ruçi, person në një lidhje shumë të afërt gjinie me ish Kryetarin e Kuvendit, i cili çuditerisht përzgjodhi, në kundështim me ligjin aplikuesen Qirko, (pra të motrën e ministres/zëvendëskryeministres/deputetes Belinda Balluku), si anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, aktualisht drejtuese të këtij organi.

Nuk duhet të harrohet se aplikimi i kandidatëve ka kaluar në disa filtra, ku përpara votimit të tyre në Kuvendin e R.SH. pa debat, kushtet dhe kriteret formale të tyre duhet të ishin të verifikuara imtësisht.

Kujtojmë se Komisionet Ad-Hoc ku bënin pjesë deputete si Eduart Halimi, Vasilika Hysi, etj, kishin jo vetëm detyrimin e verifikimit të këtyre kritereve formale, por edhe mundësinë që për shkak të përvojës së gjatë në fushën e drejtësisë, të mundësonin përzgjedhjen e atyre kandidatëve që ishin më të mirët dhe të cilët nuk do të linin shkak për ngritjen e pretendimeve për profesionalizimin dhe integritetin nga subjektet të cilët ata duhet të vlerësonin.

Fakti i evidentuar më lart, pra ai i faktit se Komisionerja Pamela Qirko nuk kishte dorëzuar listën e notave dhe ajo nuk ishte verifikuar asnjëherë nga Komisionet përgjegjëse, pasqyron faktin se kanë qenë pikërisht anëtarët e këtyre komisioneve që nuk kanë ushtruar sic duhet detyrën me të cilën ata ishin ngarkuar, mosveprim ky që qartazi përmban elementë të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Këto të dhëna, që rezultojnë nga një analizë e përciptë e akteve të aplikimit të Komisioneres Qirko, duhet të analizohen dhe vlerësohen. Kjo jo vetëm për të konkluduar nëse komisionerja në fjalë, kishte fallsifikuar apo përdorur ndonjë dokument të fallsifikuar (të cilin do ta trajtoj më poshtë), por edhe në drejtim të faktit nëse ndonjë aktor tjetër i përfshirë në procesin e përzgjedhjes së kësaj shtetase ka kryer apo jo ndonjë vepër penale.

Nëse i referohemi akteve të plotësuara nga Komisionerja Qirko si aplikuese për t'u bërë anëtare e Institucioneve të Rivlersimit, evidentohet qartë se kjo shtetase ka deklaruar të dhëna të pavërteta. ***Më konkretisht në aktin e titulluar "Shprehje e interesit për pozicionet e anëtarëve të***

institucioneve të rivlersimit" fq e parë e këtij akti, kjo shtetase ka deklaruar se plotëson kushtet e parashikuara në nenin 6 të ligjit 84/2016 për t'u zgjedhur si pjesë e këtyre organeve, fakt ky që qartësisht rezulton se është i pavërtetë. Në vijim kjo shtetase nuk ka dorëzuar listën e notave dhe në bashkëpunim edhe me punonjës të Avokatit të Popullit dhe anëtarë të Komisioneve Ad-Hoc, që kishin për detyrë verifikimin e kushteve formale të aplikuesve, ka mundësuar përzgjedhjen e saj, në kundërshtim të hapur me parashikimet e kësaj dispozite. Ritheksoj se pasja e mesatares së notave mbi 8 përbën një kusht të përzgjedhjes dhe kualifikimit, pa të cilin kurrsesi asnje kandidat nuk mund të përzgjidhej.

Krahas këtij fakti gjej me vend të evidentoj edhe një fakt tjetër për të cilin jam vënë në dieni pas ushtrimit të kallzimit dhe kërkesës për përjashtim. Ky fakt lidhet me aktin "Diplomë" bashkalidhur me listën e notave që rezulton në emër të kësaj shtetase.
Më konkretisht shpjegoj se nga informacionet e marra online, të njohura për publikun e gjerë, jam njohur me një aktin "Vërtetim i notave" që rezulton në emrin e shtetases Pamela Qirko, të cilin do ia bashkangjis këtij ankimi. Ajo që më rezulton e çuditshme në lidhje me këtë akt është fakti se Komisionerja Qirko ka mbaruar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Tiranë për një periudhe 5 vjecare, pa shkëputje nga puna, fakt i cili nuk ishte bërë i ditur më parë nga ana e saj, në dokumentet e aplikimit, si "juriste e shquar" që e ka pretenduar veten, dhe për më tepër ka marrë dy nota 10-ta në fiskulturë, ndërkohë që korrespondenca nuk ka patur fare lëndë fikskulture. Duke vlerësuar këtë të dhënë, nga e cila hidhen dyshime për rregullshmërinë e vetë diplomës së Komisioneres Qirko, mbrojtësit e mi kanë tentuar që të bëjnë një verifikim të saj nëpërmjet informacioneve që kanë kërkuar pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Tiranë, i cili edhe në këtë moment nuk ka kthyer asnjë përgjigje. Duke vlerësuar këtë dyshim mendoj se Kolegji i Posaçëm i Apelimit duhet të marrë prova përmes korrespondencës me Universitetin e Tiranës, edhe në drejtim të dyshimit që unë tashmë e ngre në lidhje me faktin se "Diploma" e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (përdorur në aplikim) në emër të Komisionerës Qirko, apo "Vërtetimi i Notave" mund të jenë akte të fallsifikuara.

Nëse i referohemi akteve të plotësuara nga Komisionerja Bungo si aplikuese për t'u bërë anëtare e Institucioneve të Rivlersimit evidentohet qartë se kjo shtetase ka deklaruar të dhëna të pavërteta ose të paplota. Konkretisht, kualifikimi i saj, **duke u provuar plotësimi i kushteve me vetdeklarim,** është bërë në kundërshtim me nenin 7/4 të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë dispozitë parashikohet:
4. Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Në rast se kandidati nuk ka përcaktuar asnjë preferencë për vendin vakant, konsiderohet që ai aplikon për të gjithë vendet vakante. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 2 kopje të dokumenteve të mëposhtme:
a) jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
b) kopje të noterizuara ose të njësuara të diplomës nga organi përkatës;
c) kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;

ç) një dokument të nënshkruar prej tij, me të cilin aplikuesi pranon kufizimet e posaçme për fshehtësinë në komunikimet elektronike gjatë kohëzgjatjes së mandatit si anëtar i institucioneve të rivlerësimit, sipas shtojcës 1 të këtij ligji.

Nga sa rezulton nga kjo dispozitë, paraqitja e akteve të mësipërme *(që nuk ka masë disiplinore në fuqi; mos ushtrimit të funksioneve politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit; se nuk ka qenë anëtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, ose ekspert i caktuar nga partitë politike, si dhe Ministri i Drejtësisë, nuk ka nisur një hetim penal)* ka qenë një detyrim jo vetëm për kandidaten, por edhe për vetë organe pranuese dhe verifikuese të saj dhe vërtetimi i këtyre rrethanave kurrsesi nuk mund të pranohej me vetëdeklarimin e kësaj shtetase.

Nga verifikimi i akteve të aplikimit të Komisioneres Genta Tafa rezulton qartë se kjo shtetase nuk ka provuar vjetërsinë në punë prej 15 vjetësh sipas nenit C/5 të Kushtetutës. Të gjitha vitet e punës me kohë të plotë të pretenduar nga Znj. Tafa janë 20 vjet e 9 muaj.

- Vjetërsia në punë si administratore e shoqerisë përmbarimore "Speed solution" shpk është e provuar me dokumente, por nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë që kërkon neni C/5 i Aneksit të Kushtetutës dhe kjo vjetërsi pune nuk përfshihet në vjetërsinë e kërkuar. Vjetërsia si përmbaruese gjyqësore rezulton e provuar data e fillimit dhe nuk ka asnjë të dhënë se është është ushtruar kjo detyrë. Vetëm data e fillimit të saj në librezën e punës nuk është e dhënë e mjaftueshme të provojë punën e kryer për 3 vjet e 7 muaj të pretenduar**.** Si rrjedhim vjetërsia e pretenduar për 3 vjet e 7 muaj nuk është e provuar.
- Nga Znj. Tafa vjetërsia prej 7 vjet e 7 muaj e 15 dite është pretenduar si lektore në Universitetin e Tiranës. Të vetmen provë që ka paraqitur ajo për të provuar punën si lektore në Universitetin e Tiranës është libreza e punës në të cilën rezulton se **ajo në Universitetin e Tiranës ka qenë asistent/pedagoge.** Titulli asistent pedagoge nuk përbën një vjetërsi si lektore e së drejtës dhe si rrjedhim nuk mund të llogaritet në shumatoren e viteve të punës për llogari të kandidimit. Si rrjedhim kjo vjetërsi e pretenduar prej 7 vjet e 7 muaj e 15 dite nuk është e provuar.
- Për periudhën 1.7.2012-16.7.2013 Z. Tafa ka punuar në shoqërinë përmbarimore Debit Collection (1 vit e 15 ditë). **Ajo *figuron juriste* sipas librezës së punës e cila është i vetmi dokument që provon llojin e punës së saj në këtë shoqëri përmbarimore. Kjo lloj përvoje pune nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë e kërkuara nga neni C/5 i Aneksit të Kushtetutës. Si rrjedhim kjo vjetërsi e pretenduar prej 1 vit e 15 ditë nuk është e provuar.**
- Për periudhën 16.11.1993-16.1.1996 sipas librezës së punës rezulton se Znj. Tafa ka punuar si *specialiste* për këtë periudhë. Libreza është i vetmi dokument që provon vjetërsinë e pretenduar. Puna e saj si specialiste nuk tregon asnjë kategori pune sipas nenit C/5 të Aneksit të Kushtetutës, apo nenit 6/1/b të ligjit nr. 84/2016**. Në këto kushte vjetërsia prej me 2 vjet e 2 muaj e pretenduar nuk provohet.**
- **Në këto kushte Z. Tafa ka një vjetërsi pune të provuar për vendin që ka konkurruar në masën 6 vjet e 4 muaj** shumë larg vjetërsisë prej 15 vjetësh të kërkuar nga neni C/5 I Aneksit të Kushtetutës.Nga ana tjetër nuk ka asnjë arsyetim nga Avokati i Popullit dhe ONM se si i ka plotësuar kriterin e vjetërsisë Znj. Tafa. Si është provuar vjetërsia në punë e pretenduar prej saj?
- **Zgjedhja nga Kuvendi i Genta Tafa bërë në kundërshtim me ligjin material** Zgjedhja e anëtarit KPK Zj. **Genta Tafa** është bërë në kundërshtim me nenin C(5) i Aneksit të Kushtetutës,

nenit 6(1)(b) të Ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka plotësuar vjetërsisë në punë prej 15 vjet.Nuk ka vjetërsinë në punë prej 15 vjetësh.

- Znj. Tafa referuar jetëshkrimit të saj të dorëzuar te Avokati i Popullit të datës 7.2.2017, për përzgjedhjen e anëtarëve të vettingut, rezulton se ka deklaruar këtë vjetërsi pune: nga 16.11.1993-16.1.1996 juriste ne Drejtorinë Juridike e konsullore në Ministrinë e Jashtme (me 2 vjet e 2 muaj); ku ndaj saj është marrë një masë disiplonore shkarkim nga detyra **e pa deklaruar prej saj. Nga data** 1.2.1996-15.9.2003 lektore në Universitetitn e Tiranës (7 vjet e 7 muaj e 15 dite**) ku në të cilën ka marrë masë disiplinore shkarkim nga detyra e pa deklaruar. Nga data** 16.9.2003-30.6.2004 pergjegjëse e sektorit juridik në Ministri e Pushtetit Vendor (9 muaj e 15 dite); nga data 1.7.2004-23.12.2006 Drejtore Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Pushtetit Vendor (2 vjet e 5 muaj 15 dite); nga data 1.1.2009-29.2.2012 Pedagoge në Universitetin Justiniani i I (3 vjet e 1 muaj); nga data 1.7.2012-16.7.2013 këshillare ligjore në shoqërinë përmbarimore debit collection (1 vit e 15 ditë); nga data 13.7.2013 administratore e shoqerisë përmbarimore "Speed Solution" shpk dhe përmbaruese (3 vjet e 7 muaj).
- Për periudhën 16.11.1993-16.1.1996 Z.nj Tafa ka punuar si juriste ne Drejtorinë Juridike e Konsullore në Ministrinë e Jashtme, sipas pretendimit të saj. Sipas librezës së punës rezulton **se ka punuar specialiste në këtë drejtori dhe jo juriste, por nga ana tjetër e reklamon në CV të saj në faqen zyrtare të KPK si drejtoreshë juridike dhe konsullore, fakt ky fiktiv**. Për të sheshuar këtë kontraditë ju drejtova Ministrisë së Punëve të Jashtme me një kërkesë se cfarë pune ka bërë Znj. Tafa në këtë periudhë. Sipas përgjigjes nr. 3468/2 prot datë 5.4.2022 rezulton se Znj. Tafa ka punuar si specialiste dhe nuk ka asnjë të dhënë tjetër. Pra vet ministria nuk ka asnjë të dhënë se Znj. Tafa ka punuar si juriste, atëherë si e ka vlerësuar këtë fakt si vjetërsi për organet e vettingut Avokati i Popullit dhe ONM? Kurrësesi kjo vjetërsi nuk përbën vjetërsi të vlefshme. Nga ana tjetër sipas përgjigjes kjo vjetërsi klasifikohet në ligjin nr. 152/2013 si kategori ekzekutive. Pra nuk plotëson as kriterin e nivelit të lartë të administratës publike apo të nivelit drejtues që parashikon ligji nr. 84/2016.
- Për periudhën 1.2.1996-15.9.2003 e pretenduar si lektore në Universitetin e Tiranës (7 vjet e 7 muaj e 15 dite). Këto vite prej 7 vjet e 7 muaj e 15 dite si lektore në Universitetin e Tiranës nuk mund të llogaritet si vjetërsi e kërkuar nga neni 6/1/b ligji nr. 84/2016. Ligji ka vendosur si kriter të jesh *profesor i së drejtës* dhe Z. Tafa në këtë kohë nuk pretendon dhe nuk ka qenë profesore. Ligji është i ndërtuar keq dhe vjen në kundërshtim me nenin C/5 të Kushtetutës i cili kërkon si kusht të jesh lektor i së drejtës dhe dallimi midis dy termave është shumë i madh dhe i përcaktuar qartë në ligjin e kohës nenin 25[22] i ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 "Për arsimin e lartë" dhe në nenin 59[23] ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas ligjit të vjetër termi pedagog është zëvendësuar me termin lektor në ligjin e ri, por gjithësesi nuk ka asnjë lidhje apo ekuivalentim me titullin profesor. Megjithatë nëse zbatojmë drejtpërdrejtë Kushtetutën Z. Tafa i duhet të ishte për këtë

[22] *1. Personeli i shkollave të larta përbëhet nga: a) punonjësit mësimorë-shkencorë (**profesorë**, asistentë profesor, **pedagogë,** asistentë etj.)*

[23] *2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimorshkencor. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:*
*a) **profesorë**;*
*b**) lektorë;***
c) asistentlektorë.

vite punë *lektore e së drejtës* ashtu sic edhe ka pretenduar. Në fakt nga libreza e punës rezulton se ajo në Universitetin e Tiranës ka qenë asistent pedagoge. Titulli asistent pedagoge nuk përbën një vjetërsi si lektore e së drejtës dhe si rrjedhim nuk mund të llogaritet në shumatoren e viteve të punës për llogari të kandidimit. Për të konfirmuar faktin në se Z. Tafa ka ushtruar apo jo në këtë periudhë detyrën e lektores ju drejtova Fakultetit të Drejtësisë Tiranë për informacion. Nga përgjigja e Universitetit të Tiranës Nr. 1174/5 datë 4.5.2022 rezulton se Znj. Tafa ka filluar punë si asistentë pedagoge në datën 1.2.1996 me kontratë për një vit deri në datën 1.2.1997, sipas urdhrit të emërimit nr. 186 prot datë 7.2.1996 të Fakultetit të Drejtësisë Universitetit të Tiranës. Në datën 12.9.2003 Z. Tafa ka paraqitur kërkesë për ndërprerje të marrëdhënies së punës si pedagoge. Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës me vendimin nr. 586 prot datë 12.9.2003 ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës si pedagoge të Znj. Tafa. Nga këto dokumente ka një mospërputhje pasi ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në cilësinë e pedagoges ndërkohë që nuk ka asnjë dokument mbi emërimin esaj si e tillë megjithëse unë i kam kërkuar në kërkesë të konfirmohet fakti se a ka punuar apo jo pedagoge Z. Tafa. Në mungesë të dokumentit të emërimit si pedagoge të Znj. Tafa dhe të ekzistencës së dokumentit që ajo ka filluar punë si asistente rezulton se e gjithë periudha e punës në Fakultetin e Drejtësisë prej 7 vjet e 7 muaj e 15 dite për mua vlerësohet se ka qenë në cilësinë e asistentes dhe jo të pedagoges, vjetërsi e cila nuk plotëson kriteret e nenit C/5 të Aneksit të Kushtetutës.

- Për periudhën 1.7.2012-16.7.2013 Z. Tafa ka punuar në shoqërinë përmbarimore debit collection (1 vit e 15 ditë). Ajo pretendon se ka qenë këshilltare ligjore dhe po e trajtojmë si të vërtetë këtë fakt. Kjo lloj përvoje pune nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë e kërkuara nga neni C/5 i Aneksit të Kushtetutës. Vjetërsia në punë si administratore e shoqerisë përmbarimere "Speed solution" shpk është e provuar me ekstaktin e regjistrimit në QKB të këtij subjekti juridik. Por, kjo vjetërsi pune nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë që kërkon neni C/5 i Aneksit të Kushtetutës dhe kjo vjetërsi pune nuk përfshihet në vjetërsinë e kërkuar. Nga libreza e punës ajo rezulton edhe përmbaruese gjyqësore me datë fillimi 13.7.2013 që ka qenë edhe administratore e shoqerisë përmbarimere "Speed solution" shpk dhe nuk ka shënim në librezën e punës për periudhën qe e ka kryer këtë detyrë. Po marrim të vërtetë jetëshkrimin e saj se ka punuar edhe përmbaruese gjyqësore. Ky profesion nuk mund të përfshihet në nenin C/5 të Aneksit të Kushtetutës *si profesion ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë.*Përmbaruesi ka një rol të kufizuar në zbatimin e ligjit vetëm në një ligj dhe në një kapitull të Kodit të Procedurës Civile dhe kjo përvojë punë nuk mundet kurrësesi tëshërbej për të gjykuar gjyqtarët e gjykatës Kushtetuese nga ana profesionale e tyre.
- Të gjitha vitet e punës me kohë të plotë të pretenduar nga Z. Tafa në jetëshkrimin e saj rezultojnë në total 20 vjet e 9 muaj. Nga këto vitë nuk plotësojnë kriteret e nenit C/5 të Aneksit të Kushtetutës juriste ne Drejtorinë juridike e konsullore në Ministrinë e Jashtme(me 2 vjet e 2 muaj); Asistente lektore në Universitetitn e Tiranës (7 vjet e 7 muaj e 15 dite);këshillare ligjore në shoqërinë përmbarimore debit collection(1vit e 15 ditë);administratore e shoqerisë përmbarimere "Speed Solution" shpk dhe përmbaruese (3 vjet e 7 muaj) dhe mbeten të vlefshme vitet e punës prej 6 vjet e 4 muaj pergjegjëse e sektorit juridik në Ministri e Pushtetit Vendor(9 muaj e 15 dite); drejtore drejtorisë juridike në Ministri e Pushtetit Vendor(2 vjet e 5 muaj 15 dite); Pedagoge në Universitetin Justiniani i I(3 vjet e 1 muaj.**Në këto kushte Z. Tafa ka një vjetërsi pune të vlefshëm për vendin që ka konkurruar në masën 6 vjet e 4 muaj** shumë larg vjetërsisë prej 15 vjetësh të kërkuar nga neni C/5 I aneksit të Kushtetutës.Nga ana tjetër nuk ka asnjë arsyetim nga Avokati i Popullit dhe ONM se si i ka plotësuar kriterin e vjetërsisë Znj. Tafa.

Cilat nga punët e kryera plotësojnë kriteret ligjore dhe cilat jo. Si është provuar vjetërsia në punë e pretenduar prej tij?

Në vlerësimin tim ky qëndrim, ashtu sic e trajtova edhe në lidhje me Komisioneren Qirko duhet të vlerësohet edhe në drejtim të verifikimit të faktit nëse pjesmarrësit në organet miratuese dhe përzgjedhëse të këtyre Komisionerëve kanë kryer apo jo veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Në vlerësimin tim vetë fakti i kalimit të kandidaturës së Komisioneres Bungo për miratim në Kuvend, pavarsisht se qartazi kjo shtetase nuk plotësonte kriteret formale të kërkuara nga neni 6, paragrafi i parë i ligjit 84/2016, kjo shtetase nuk plotësonte kushtin e vjetërsisë në punë prej 15 vitesh, pasqyron paligjshmërinë e veprimit të personave pjesmarrës në organet që formalisht duhet të verifikonin këto kritere, ku përfshihen punonjës së Avokatit të Popullit dhe Kuvendit të R.SH. (këta të fundit deputete pjesmarrës në Komisionet Ad-Hoc).

Bazuar në këtë arsyetim mendoj se anashkalimi i këtyre rrethanave është bërë me qëllim, në funksion të shmangjes nga përgjegjësi penale të këtyre personave, për veprimet apo mosveprimet e paligjshme, me dashje të kryera nga ata.

Komisionerja Firdes Shuli duket se ka kryer veprat penale të "Fallsifikimit të dokumentave" dhe "Fallsifikimit të formularëve, vulave dhe stampave" të parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të K.Penale. Njo pasi nëse i referohemi akteve të plotësuara nga Komisionerja Shuli si aplikuese/kandidate për t'u bërë anëtare e Institucioneve të Rivlersimit evidentohet qartë se kjo shtetase ka deklaruar të dhëna të pavërteta. **Më konkretisht kjo Komisionere në aktin e titulluar "Kërkesë" të cilën Komisionerja Shuli e ka dorëzuar bashkalidhur me aplikimin nuk rezulton që kjo shtetase të ketë deklaruara masat disiplinore të marra ndaj saj nga KLD në kohën që ushtronte funksionet e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.** Në këtë akt Komisionerja Shuli në lidhje me ushtrimin nga ana e saj të funksioneve si gjyqtare ka deklaruar vetëm:

Nga data 22.11.1988 deri në 01.07.1992 kam qenë gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjirokastër.
Nga data 01.07.1992 deri më 12.03.1995 kam qenë Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjirokastër.
Në muajim mars 1995 jam emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tepelenës.
Me datën 12.04.1995 jam liruar me kërkesën time si gjyqtare në Tepelenë.

Pasqyrimi i këtyre rrethanave nga Komisionerja Shuli nuk evidenton të vërtetën e historikut të punësimit të saj si gjyqtare dhe Kryetare e Gjykatës Gjirokastër dhe nuk evidenton masat disiplinore që KLD e kohës ka marrë ndaj saj.

Nga shkresa me numër 5779/3, të datës 01.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor të marrë mbi bazën e kërkesës për informacion të mbrojtësve të mi jam informuar sa më poshtë:

- *Znj. Firdes Galanxhi, me vendim nr. 7, datë 01.07.1992 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetare në Gjykatën së Rrethit Gjirokastër.*
- *Znj. Firdes Galanxhi, me vendim nr. 17, datë 30.12.1992 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë* ***pezullohet nga detyra.***
- *Znj. Firdes Galanxhi, me vendim nr. 3, datë 23.02.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i hiqet masa e pezullimit dhe rifillon detyrën si Kryetare në Gjykatën së Rrethit Gjirokastër.*

- *Znj. Firdes Galanxhi (Shuli), me vendim nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë* ***transferohet për 1 (një) vit gjyqtare ne Gjykatën e Rrethit Tepelenë.***
- *Znj. Firdes Shuli, me vendim nr. 2, datë 12.04.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lirohet nga detyra me kërkesën e saj.*

Nisur sa më sipër rezulton qartë, nga përmbajtja e këtyre akteve se Komisionerja Shuli nuk ka deklaruar masat disiplinore të marra ndaj saj dhe pikërisht atë që lidhet me pezullimin nga detyra e gjyqtares dhe në vijim atë të shkarkimit nga detyra e Kryetares së Gjykatës Gjirokastër, nëpërmjet transferimit të saj në Gjykatën Tepelenë.

Shtoj gjithashtu se nëse do të administrohet nga Kolegji e gjithë praktika e këtyre ecurive disiplinore te Komisioneres Firdes Shuli nga KLD i kohës, do të konstatohet se ndaj kësaj shtetase jo vetëm janë marrë këto masa disiplinore, **por edhe shkakun e marrjes së tyre, që në thelb lidhet me mungesën e integritetin moral personal të kësaj Komisionereje, shkak i cili bazuar në nenin 6, paragrafi i parë, pika "c" të ligjit 84/2016 përbën një shkak pa zgjedhshmërie të saj.**

Mbi këtë bazë i kërkoj Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe ONM që për verifikimin e korrektësisë së plotësimit të akteve të aplikimit të Komisioneres Firdes Shuli, të administrojë të gjithë praktikën e KLD për ecurinë disiplore të saj, të viteve 1992-1995. Pas administrimit të këtyre akteve që në dijeninë time ndodhen në Presidencë, organ të cilit i jam drejtuar por nuk më ka kthyer përgjigje, qartësisht do vërtetohet se Firdes Shuli as ka patur ndonjëherë dhe as ka aktualisht integritet moral për të qënë anëtare e organeve të rivlerësimit.

Nisur sa më sipër, meqënëse unë kam vështirësi për si siguruar informacion plotësues-shterues, i kërkoj Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që krahas dokumentacionit të mësipërm të evidntuar nga unë, të kërkojë informacion si më poshtë:

I. Të kërkohet informacion për përbërjen e grupeve të punës pranë Avokatit të Popullit dhe Komisioneve At-Hoc që kanë verifikuar kriteret formale të komisoneret Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo.

II. Të administrohen akte të mbajtura nga këto organe gjatë kryerjes së veprimeve për verifikimin e kritereve formale të tilla si rekomandime, mendime me shkrim, shkresa, kërkesa për infomacion, pyetje të këtyre shtetaseve në seancat dëgjimore etj.
III. Të pyeten të gjithë personat që rezultojnë të kenë miratuar përmbushjen e kushteve formale të zgjedhjes nga komisioneret Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo, ndër të tjera dhe në lidhje me:

- faktin nëse kanë konstatuar mungesë dokumentacioni në aplikimet e këtyre shtetaseve,
- nëse po cfare veprimesh kanë kryer për këtë fakt,
- si e shpjegojnë mosparaqitjen e dokumentave që provojnë kushtet formale për Komisioneret Qirko dhe Bungo,
- si i kanë verifikuar këto kushte formale në këto rrethana,
- pse nuk kanë pyetur Komisioneren Qirko për mungesën e listës së notave,
- a e kanë verifikuar këte listë dhe a janë në dieni të faktit se kjo komisionere nuk ka mesataren mbi 8, sic kërkon ligji,

- a ka patur raste të tjera që kandidatë aplikues janë miratuar pa paraqitur këtë listë notash dhe nëse po kush?
- a ka patur aplikues me mesatare mbi 8 dhe përse është nuk janë zgjedhur ata ndërkohë që është zgjedhur Komisionerja Pamela Qirko etj?

IV. Të kërkohet pranë Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës Diploma, si dhe Vërtetimi i notave dhe këto akte të krahasohen me aktin "Diplomë" të paraqitur nga Komisionerja Qirko në aplikimin pranë Avokatit të Popullit dhe Vërtetimin e Notave të paraqitur bashkalidhur me këtë ankim.
V. Të kërkohet informacion pranë Ministrisë Për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Fakultetin e Drejtësisë të Univeristetit të Tiranës në lidhje me faktin nëse ndaj Komisioneres Genta Bungo janë marrë masa disiplinore apo të largimit nga detyra.
VI. Të administrohet nga KLGJ praktika e plotë e ecurisë disiplinore të KLD ndaj Komisioneres Firdes Shuli, për të evidentuar shkakun e marrjes së masave disiplinore ndaj saj.

- ***Të pyeten vetë këto Komisionere për faktet e e sipërtreguara***.

Nëse Kolegji e çmon të papërshtatshme të kryejë veprimtarinë hetimore të mësipërme, të më japë kohën e nevojshme pasi këto prova dhe informacione, do ia paraqes vetë unë.

2. ***Ngrej si shkak ankimi përpara Kolegjit, që anëtarët e trupës time të Komisionit, më kanë shkelur më shumë se një herë standartin kushtetues të Gjykatës së paanshme dhe të Gjykatës së drejtë***. Lidhur me këtë nuk po zgjatem pasi kaloj në përsëritje të panevojshme pasi jam shprehur më sipër si dhe do shprehem edhe në vijim të përmbajtjes së këtij ankimi[24].

Së njëzetë e gjashti: Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit faktin që një pjesë e anëtarëve të trupave gjykuese të Komisionit që kanë shqyrtuar 11 kërkesat për përjashtimin e komisionerëve, edhe vetë nuk plotësojnë standaritn "gjykatë e krijuar me ligj", sipas jurisprudencës së GJEDNj në çështjet Besnik Cani Kundër Shqipërsisë, Gudmundur Andri Astradson kundër Islandës, etj.

P.sh. Komisionerja Alma Faskaj, rezulton të jetë një ish gjyqtare e shkarkuar "*për shkelje të ligjit dhe për paaftësi*", me vendimin nr. 8, datë 23.08.1996 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kjo e vë këtë komisikonere në kushtet e pengesës ligjore për t'u kualifikuar sipas pikës "dh" paragrafi 1 të nenit 6 të ligjit 84.2016. Ky fakt rezulton i provuar nga vërtetimi 2056/1, datë 03.05.2020, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të cilin po ia bashkangjes si provë këtij ankimi.

Komisionerja Alma Faskaj duke marrë pjesë në marrjen e disa prej vendimeve me të cilat nuk janë pranuar kërkesat e mia për përjashtimin e koimisionerëve të trupës gjykuese, i bie të këtë cënuar në procesin tim të rivlerësimit, edhe ndalimin e konfliktit të interesit. ***Kjo pasi dukë mos pranuar kjo komisionere kërkesat e mia për përjashtim, mbi shkakun se komisioneret Pamela Qirko, Genta Tafa dhe Firdes Shuli, janë zgjedhur si komisionere në shkelje të nenit 6 të ligjit 84/2016, i bie që komisionerja Alma Faskaj ka mbrojtur vetveten***.

[24] Referohu në 9 kërkesat për përjashtim. I kërkoj Kolegjit që t'i marrë në shqyrtim këto kërkesa në meritën e tyre, pra në themel, pasi i konsideroj si shkaqe ankimi. Unë vlerësoj se Komisioni ka gabuar në trajtimin e këtyre kërkesave, pasi ka shkelur ligjin. Kjo pasi shkaqet e përjashtimit, janë që të gjitha të bazuara në ligj dhe në prova.

Kjo pasi i bie që ajo ka marrë pjesë në prodhimin e akteve me rëndësi thelbësore dhe përcaktuese në procesin tim të rivlerësimit.

Akti procedural me të cilin përcaktohet ose mund të përcaktohet se "*përbërja nominale e gjykatës që të gjykon*", përbën një fakt juridik me rëndësi vendimtare, thelbësore dhe përcaktuese të fatit të çdo procesi të rregullt ligjor. Kësisoj akti procedural ku ka marrë pjesë komisionerja Alma Faskaj, bie në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar), konkretisht, shih nenin 4 pika 2 që parashikon se fushën e zbatimit të ligjit: *2. Për qëllimet e këtij ligji:*
a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit;
c) një zyrtar'" ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

E njëjta gjë si për komisioneren Alma Faskaj, mund të thuhet edhe për komisioneret Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu, por për to ka një shkak përjashtimi akoma tjetër për të cilin po shprehem në vijim[25].

Së njëzetë e shtati: ***Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit edhe faktin se disa nga kërkesat e përjashtimit që kam paraqitur ndaj Komisioneres Firdes Shuli janë shqyrtuar nga Komisioneret Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu***. Duke marrë pjesë këto komisionere në vendimet e ndërmjetme me të cilat Komisioni ka vendosur mospranimin e kërkesave të mia për përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli, Komisioni më ka shkekur standartin kushtetues të Gjykatës së paanshme. Kjo pasi këto dy komisionere kanë qënë në rrethana objektivisht të njëjta fakti sikurse rrethanat (shkaku) për të cilin unë, ndër të tjera, kam kërkuar përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli.

Kjo bie në kundërshtim ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave administrative të R.Sh" që parashikon se: Neni 30, Pengesat ligjore: *Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: a) ..; b)..; c).. nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën "b", të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim; .....*

[25] Këto dy komisionere janë pjesë e kërkesës që kam paraqitur në Gjykatën Kushtetuese me datën 19.12.2022, të cilën ia kam dërguar me email Komisionit me datën 19.12.2022, si dhe po ashtu përmes shërbimit postar. (Po ashtu, këtë kërkesë e kam paraqitur edhe në KPA por nuk kam marrë përgjigje nga ky insitucion).

Kjo kërkesë kushtetuese ka qënë provë mbështetëse e kërkesës që i kam paraqitur Komisionit për pezullimin e procesit të rivlerësimit deri sa të shprehet Gjykata Kushtetuese dhe/apo KPA.

Këtë kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe KPA, ashtu sikurse shprehem në pikën 15 të pjesës hyrëse të këtij ankimi, në rubrikën "objekti", i kërkoj KPA, që t'a konsiderojë si pjesë përmbajtësore edhe të këtij ankimi.

.....g) <u>nëpunësi publik</u> ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën "b", të këtij, neni kanë marrëdhënie të tilla, <u>të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim</u>; ....

Konkretisht, unë kam kërkuar përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli, me arsyetimin e mëposhtëm:

Ommisis "*.....1) Komisionerja Firdes Shuli ka qenë pjesë e trupës gjykuese që ka shqyrtuar procesin e rivlersimit të motrës time (binjake) Ajola Prençi (Ymeri), e cila me vendimin me numër 470, datë 01.11.2021 është shkarkuar nga detyra e prokurores.*

Gjatë ushtrimit të detyrës së saj si pjesë e trupës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në procesin e rivlersimit të motrës time, që në atë kohë por edhe aktualisht kam konstatuar se Komisionerja Firdes Shuli ka shfaqur mendim për cështje të përbashkëta të miat dhe të motrës time. Këto mendime të pasqyruara në vijim me vendimarrje, janë shfaqur për dy kritere dhe konkretisht në lidhje me kriterin e pasurisë dhe atë të figurës.

Në lidhje me kriterin e pasurisë gjatë procesit të rivlersimit të motrës time Komisionerja Firdes Shuli ka hetuar dhe ka dalë me vendim mbi mundësinë financiare të huadhënësit Xheladin Thana për të na dhënë hua, fillimisht motrës time në nëntor të vitit 2004 dhe në vijim babait tim në vitin 2006, për blerjen e apartamentit ku unë jetoj (Natyrisht shpjegoj se dhënia e kësaj huaje babait tim nga bashkëshorti i hallës është bërë pasi motra ime ia ka kthyer shumën e marrë hua prej 1.500.000 lekë).
Ashtu si dhe me motrën time, edhe me mua Komisionerja Firdes Shuli ka konkluduar sehuadhënësi Xheladin Thana nuk ka patur burime të ligjshme të ardhurash për të na i dhënë këto hua, edhe pse gjatë procesit të rivlersimit tim unë kam cuar prova shtesë, krahas atyre të cuara nga motra ime, ku në total pasqyrohej fakti se përpara dhënies së kësaj huaje huadhësi kishte realizuar shitje të pasurive të paluajtshme që tejkalonin vlerën 4 milion lekë, shumë e cila e mbulonte madje tejkalonte shumën e dhënë hua 1.500.000 lekë.

Shfaqja e mendimit paraprak tnga ana e Komisioneres Firdes Shuli në procesin e rivlersimit të motrës time, në cmuarjen time cënon standartin e "gjykatës së paanshme", ku për këtë shkak kjo komisionere nuk mund të jetë pjesë e procesit tim të rivlersimit kalimtar, ndodhur në kushtet kur ajo ka dhënë më parë vendim për cështjen që tashmë është objekt gjykimi dhe vlerësimi prej saj.

Në nenin 72 të "Kodit të Procedurës Civile", sipas të cilit: "Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur: ....4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit".

Në rastin konkret rezulton qartë se për të njëjtën cështje identitike, me të njëjtat palë dhe për të njëjtin huadhënës, Komisionerja Firdes Shuli ka marrë më parë vendim, i cili e bën të paragjykuar vendimarrjen e saj edhe në lidhje me mua në këtë moment.

2) Në procesin e rivlersimit të motrës time Komisionerja Firdes Shuli ka marrë kompetenca për t'u shprehur edhe për figurën time, duke bërë pjesë të trajtimit të figurës së motrës time

vlerësimet që DSIK kishte ndaj meje. Trajtimi i këtyre të dhënave në procesin e rivlersimit të motrës time u bë që më aktin "Relacion mbi rezultatet e hetimit administrativ", ku motra ime u ngarkua me barrë prove për të dhënë shpjegime për figurën time. Në vijimsi, në seancën dëgjimore të motrës time ajo nuk u lejua të shprehej në lidhje me këtë barrë prove, pavarsisht faktit që trajtimi i figurës së personit tim u bë edhe publikisht nga ky komision, ku bënte pjesë edhe Komisionerja Firdes Shuli. Po kështu ky komision bëri publike të njëjtat të dhëna që "helmonin" figurën time, në vendimin për shkarkimin e motrës time, duke e bërë në thelb figurën time një nga shkaqet e shkarkimit të saj, gjë që më ka shkaktuar jo vetëm dëm në aspektin professional dhe personal, por që edhe më ka ngarkuar më barrë morale përkarshi motrës time, të cilës pa dashje i shkaktova dëm.

Që në atë kohë unë dhe po ashtu motra ime kemi protestuar përkundrejt një qëndrimi të tillë antikushtetues dhe në shkelje të hapur të procesit të rregullt ligjor, bazuar në nenet 6 të K.E.D.NJ. dhe 42 të Kushtetutës, pasi ky veprim jo vetëm që përbënte një tejkalim kompetencash për trajtimin e figurës time nga një trupë e cila nuk kishte asnje kompetencë ligjore për t'a bërë një gjë të tillë, por edhe bazuar në faktin që në thelb një trajtim i tillë përbënte një cënim të të drejtës së mbrojtjes, si për personin tim ashtu dhe për motrën time.

Cënimi i të drejtës së mbrojtjes shfaqet në faktin se unë u gjykova dhe dënova pa u dëgjuar nga një trupë gjykuese që nuk kishte asnjë kompetencë ligjore ta kryej këtë veprim dhe po kështu motra ime e kishte jo vetëm të pamundur objektivisht të mbronte të drejtat e mia, por edhe pse ajo u mundua t'a bënte një gjë të tillë nuk u lejua nga trupa gjykuese dhe posacarësht nga Kryesuesja Firdes Shuli, e cila e ndaloi të jepte shpjegime në lidhje me këtë barrë prove.

Nëpërmjet ekzpozimit që në atë kohë të këtyre të dhënave të DSIK në drejtim të personit tim, pa mu dhënë e drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t'u dëgjuar, Komisionerja Firdes Shuli ka "helmuar" edhe publikisht figurën time si gjyqtar dhe si individ, madje pa filluar ende procesi im i rivlersimit, veprim i cili mendoj se ka krijuar perceptimin publik negativ për personin tim që në atë moment dhe ka shkaktuar pasoja të pakthyeshme në procesin tim të rivlersimit.

Ndodhur në këto kushte mendoj se prania e Komisioneres Firdes Shuli në trupën time të rivlersimit kalimtar përbën shkeljen më të rëndë të standartit "gjykatë e paanshme".
Për shkak të qëndrimit që kjo Komisionere ka mbajtur në raport me personin tim, si në procesin e rivlersimit të motrës time ashtu dhe timin, unë kam reaguar si me mbrojtjen që i kam dërguar Komisionit për relacionin e datës 19.04.2022, ashtu dhe me mbrojtjen për relacionin e datës 31.10.2022. Unë nuk jam shprehur asnjëherë dakort për praninë e kësaj Komisionere në trupën time gjykuese, të cilën e konsideroj në "marrëdhënie armiqsore" me personin tim, për shkaqe që as unë dhe as motra ime nuk i njohim, por për të cilat Komisionerja mund të jetë më mirë në dieni dhe mund t'ju japë më hollësisht shpjegime.

Mbi këtë arsyetim mendoj se Komisionerja Firdes Shuli nuk duhet të jetë pjesë e procesit tim të rivlersimit, bazuar kjo ligjërisht edhe në parashikimet e nenit 72 të "Kodit të Procedurës Civile", sipas të cilit: "Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje kur: ....4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit". Bazuar në qëndrimin që ajo ka mbajtur për figurën time në procesin e rivlersimit të motrës time, duke më bërë një prej shkaqeve të

shkarkimit të padrejtë të saj, unë mendoj se kjo komisionere ka dhënë vendim i cili e pengon atë të japë vendim sërisht për të njëjtën cështje.

Qëndrimi i Komisioneres Firdes Shuli, e cila merr përsipër të gjykojë figurën timë dy here, është e njëjtë me cështjen Allenet de Ribemont v Francë, Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që ka konstatuar shkelje të nenit 6 dhe 2 të K.E.DNJ për shkak të faktit se gjykata duket se ka nisur procesin me paragjykim ndaj të pandehurit, pasi ka mbledhur të dhëna për të, i ka evidentuar dhe përshkruar ato në aktet ligjore të përdorura dhe prodhuara jashtë procedurës ligjore në të cilën ajo po gjykonte të pandehurin. Kësisoj gjykata ka krijuar pritshmëri tek publiku, përmes këtyre akteve të marra jashtë procesit, që përpara fillimit të procesit që fati i të pandehurit është paracaktuar përpara fillimit të gjykimit. GJEDNJ, në këtë vendim të saj, ndër të tjera shprehet: "prezumimi i pafajsisë të parashikuar në paragrafin 2 të nenit 6 të KEDNJ-së është një ndër elementët e një procesi penal, siç kërkohet nga paragrafi i parë. Ky parim shkelet nëse një vendim gjyqësor lidhur me një person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, pasqyron një mendim paraprak se ai është fajtor, kur fajësia e tij ende nuk është provuar sipas ligjit. Madje edhe nëse nuk ka ende një konstatim formal, ka shkelje, dhe kur gjatë arsyetimit del se gjyqtari e konsideron të pandehurin fajtor".

Theksoj se në vlerësimin tim në lidhje me këtë kërkesë nuk mund të aplikohet "parimi i funksionalitetit" sic i përdor nga Kolegji i Posacëm i Apelimit në cështjen e subjektit të rivlersimit Rilinda Selimi. Kjo pasi në ndryshim me personin tim Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ende Komisionerë që mund të zëvëndësojnë Komisioneren Firdes Shuli, ndryshe nga situata në të cilën ndodhej Kolegji në lidhje me subjektin në fjalë, ku nuk kishte komisioner zëvëndësues.

Së treti me emailin e datës 05.12.2022 unë i kam parashtruar Komisionit kërkesa proceduriale, ndër të cilat: 1) Kërkesën për thirrjen si person të tretë të motrës time, si person me të cilin e kam cështjen të përbashkët, bazuar në parashikimet e nenit 192 të K.Pr.Civile, 2) Pezullimin e shqyrtimit administrativ për personin tim derisa të përfundojë shqyrtimi në Kolegjin e Posacëm të Apelimit të ankimit të paraqitur nga motra ime kundër vendimit me numër 470, datë 01.11.2021.

Shpjegoj se të dy këto kërkesa proceduriale janë rrjedhojë e shkeljeve të kryera më parë nga Komisioni, ku ka bërë pjesë Komisionerja Firdes Shuli, i cili ka kryer procesin e rivlersimit të motrës time, duke përfshirë padrejtësisht figurën time në vlerësimin përfundimtar që bënë për të.

Po me emailin e datës 05.12.2022 Komisioni im i rivlersimit, ku bën pjesë Komisionerja Firdes Shuli ka rrëzuar kërkimet e mia proceduriale, natyrisht dhe si gjithmonë pa ndonjë vendim të arsyetuar, duke bërë thjesht të ditur faktin se aktet që lidhen me procesin e rivlersimit të motrës time u bënë pjesë e procesit tim të rivlersimit dhe për to do të shprehen me vendim përfundimtar.

Në cmuarjen time nëpërmjet kësaj vendimarrje Komisionerja Firdes Shuli po na cënon sërish në të drejtën tonë (motër e vëlla) për t'u dëgjuar dhe mbrojtur dhe rrjedhimisht po na shkakton një process të parregullt ligjor. Cënimi i të drejtës tonë në këtë drejtim shfaqet në faktin se ndërsa unë u gjykova dhe u dënova nga Firdes Shuli në procesin e rivlersimit të motrës time, pa u dëgjuar dhe mbrojtur, moslejimi i

motrës time për të qenë pjesë e procesit tim të rivlersimit, në funksion të mbrojtjes së interesave të saj të shkelura padrejtësisht nga Komisionerja Shuli, shkakton rigjykim të saj pa ia dhënë të drejtën për t'a degjuar dhe mbrojtur, ashtu sic bënë edhe me personin tim.

Parë në këndvështrim mendoj se prania e Komisioneres Firdes Shuli në procesin tim të rivlersimit, si pjesë e trupës gjykuese cënon haptazi standartin e gjykatës së paanshme, pjesë e pandarë e procesit të rregullt ligjor, bazuar në nenin 6 të K.E.D.NJ. dhe 42 të Kushtetutës.

Së katërti, nëpërmjet pjesmarrjes në procesin tim të rivlersimit Komisionerja Firdes Shuli po merr kompetenca që me ligj nuk i përkasin. Kjo për shkak se vendimarrja e mëparshme e saj, për figurën time në procesin e rivlersimit të motrës time, tashmë është objekt ankimi dhe në lidhje me këtë vendim mund të shprehet vetëm Kolegji i Posacëm i Apelimit.

Ndodhur në këto kushte mendoj se prania e kësaj komisionere në trupen time të rivlersimit kalimtar bie ndesh me parashikimet e nenit 30/e të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon: "Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: .... e) çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marrë nga nëpunësi publik ose nga personat e parashikuar në shkronjën "b" të këtij neni;

Bazuar në këtë dispozitë qartësisht Komisionerja Firdes Shuli nuk mund të jetë pjesë e procesit tim të rivlersimit.
.....
Bazuar në këto dispozita duket qartësisht se prania e Komisioneres Firdes Shuli ne procesin tim të
rivlersimit është tërësisht e papranueshme dhe e paligjshme.
.....
Vendimarrja e Komisioneres në lidhje me këtë cështje bie ndesh me parashimet e nenit 30/c të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon: "Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: ....c) nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën "b", të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim";

Kujtoj se këtë qëndrim ka mbajtur edhe vetë Komisionerja Firdes Shuli me vendimin e saj për përjashtimin e Komisioneres Etleda Ciftja nga procesi im i rivlersimit, duke cmuar se përsa kohë kjo komisionere e kishte cështjen të ngjashme me personin tim nuk mund të përfshihej në shqyrtimin e procedurës administrative në lidhje me mua.

Bazuar në këtë shkak, i cili gjen mbështetje në ligj mendoj se prania e Komisioneres Firdes Shuli në procesin tim të rivlersimit është e paligjshme.

Në nenin 27 të ligjit 84/2016 "Për rivlersimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.SH." parashikohet: "1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit". Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes,

përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji. 2. Në rast se anëtari i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përjashtimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short. 3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short."

Me vendimin me numër 2, datë 22.01.2014 Gjykata Kushtetuese e R.SH. shprehet: "Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet.....

Bazuar në shkaqet e mësipërme mendoj se do të ishte në nderin e Komisioneres Firdes Shuli të paraqesë menjëherë dorëheqjen nga trupa gjykuese që kryen procesin tim të rivlersimit, pasi çdo qëndrim i kundërt i saj mendoj se jo vetëm është haptazi shkeljen e procesit të rregullt ligjor në drejtim të personit tim, bazuar në nenin 6 të KEDNJ dhe nenit 42 të Kushtetutës të R.S.H, por njëkohsisht është shkak për përgjegjësi disiplinore nga ana e saj, bazuar në nenin 16 të ligjit 84/2016.

Mbi bazën e fakteve të cituara më lart kërkoj përjashtimin e Komisioneres Firdes Shuli nga trupa gjykuese që kryen procesin tim të rivlersimit kalimtar, në zbatim të ligjit 84/2016.
Provat që vërtetojnë pretendimet e mia për përjashtimin e Komisioneres i kam paraqitur me datën 30.11.2022, si dhe janë pjesë e procedurës të zhvilluar deri në këtë moment nga Komisioni iPavarur i Kualifikimit gjatë gjithë kohëvazhdimit të procedurave për rivlersimin kalimtar të personit tim.....".

Dy Komisioneret Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu, që kanë rrëzuar kërkesat e mia për përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli, kanë qënë se bashku me këtë të fundit anëtare të trupës gjykuese që ka shkarkuar padrejtësisht motrën time si dhe më ka paragjykuar mua pa më dhënë të drejtën të dëgjohem lidhur me kriterin e figurës.

Kësisoj, ata duke gjykuar kërkesën time për përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli, nuk kanë bërë gjë tjetër veçse "kanë gjykuar vetveten". Përfundimi i procesit të gjykimit të vetvetes, dihet kush është.

Pra, kemi qartësisht të bëjmë me shkelje të standarit të gjykatës së paanshme në procesin tim të rivlerësimit, të shkaktuar nga pjesmarrja e komisionereve Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu, në prodhimin e akteve me rëndësi thelbësore dhe përcaktuese në procesin tim të rivlerësimit.

Kjo pasi akti procedural më të cilin përcaktohet ose mund të përcaktohet se "*përbërja nominale e gjykatës që të gjykon*", përbën një fakt juridik me rëndësi vendimtare, thelbësore dhe përcaktuese të fatit të çdo procesi të rregullt ligjor.

Kësisoj ky akti procedural bie në fushën e zbatimit të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar), dhe konkretisht, shih nenin 4 pika 2 që parashikon se fushën e zbatimit të ligjit:

2. Për qëllimet e këtij ligji:
a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit;
c) një zyrtar'" ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

Së njëzetë e teti: Përpara Kolegjit ngre si shkak ankimi edhe vendimin e ndërmjetëm të Komisionit, për të mos më lejuar që të thërras si persona të tretë në procesin e rivlerësimit, subjektet që përmënden në pjesën hyrëse të ankimit. Konkretisht i ka kërkuar Komisionit, thirrjen e me cilësinë e personave të tretë të shtetasve të mëposhtëm:

a. Ajola Prençi (Ymeri), që është motra ime, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kjo shtetase u thirr me cilësinë e personit të tretë nga ana ime, me qëllim për të vërtetuar faktin që apartamenti i blerë nga prindërit e mi në vitin 2004, është blerë me burime të ligjshme ndër të cilat përfshihet edhe paga e saj si prokurore deri në kohën që është martuar. Po ashtu, që DPV 2003 e plotësuar nga unë nuk ka pasyruar kursimet e saj. Në këtë këndvështrim, unë dhe motra ime e kishim të përbashkët çështjen në fjalë, si nga pikpamja e ligjit ashtu edhe e faktit. Kërkesa ime për thirrjen e saj si person i tretë u motivua edhe nga nevoja ime për të vërtetuar paragjykimin që i ka bërë komisionerja Firdes Shuli, në procesin e rivlerësimit të motrës time, figurës time. Edhe kjo çështje ishte e përbashkët për të dy ne si nga pikpamja e faktit ashtu edhe nga ajo e ligjit. Kjo pasi komisionerja Firdes Shuli ka qënë anëtare e trupës gjykuese në procesin e rivlerësimit të të dyve ne. Gjithashtu, arsyeja tjetër përse kërkova thirrjen si person i treëtë të motrës është edhe vlerësimi i ndryshëm që ka bërë komisionerja Firdes Shuli, në të dy proceset, timin dhe të motrës time, gjendjes pasurore të shtetasit Xheladin Thana, që në procesin e rivlerësimit paraqitet si huadhënës i motrës time ndërsa në procesin tim të rivlerësimit paraqitet si huadhënës i babait tim në vitin 2006.

b. Faik Fetah Ymeri, Kërkesa për thirrjen e këtij shtetasi në procesin tim të rivlerësim it, u parashtrua prej meje pasi si ai edhe unë, në vitet 2001-2007 kemi jetuar në të njëjtën njësi familjare. Për rrjedhojë analiza e pasurisë së fituar nga familja ime e origjinës për këtë periudhë kohe, si dhe burimeve të saj, qartësisht prek edhe interesat e babait tim.
c. Elvira Ymeri, që është nëna ime. Kjo u kërkua të thirrej si person i tretë për të njëjtën arsye si babai im Faik Ymeri.

ç. Gerti Ymeri, që është vëllai im. Ky u kërkua të thirrej si person i tretë për të njëjtën arsye si babai im Faik Ymeri.
d. Fahri Fetah Ymeri, që është xhaxhai im dhe njëkohësisht është huadhënës i një shume prej 2.000.000 (dymilion) lekë, në vitin 2006, tek babai im Faik Ymeri. Ky paraqitet si huadhënës i babait tim në vitin 2006. Meqënësi Komisioni ka marrë në analizë pasurinë e këtij shtetasi, burimet e krijimit të saj si dhe shpenzimet për jetesë, në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së deklarimeve që kam bërë unë në procesin tim të rivlerësimit, është e qartë se unë kam interes përbashkues me të. Një arsye tjetër përse kam kërkuar thirrjen e këtij shtetasi si person i tretë ka të bëjë me faktin se duke marrë pjesë ai si person i tretë në procedimin administrativ, ai do të ishte palë. Për rrjedhojë, nuk do të kishte më pengesa sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, për të siguruar të plotë informacionin dhe dokumentacionin për gjendjen e tij pasurore/tatimore/bankare. Unë nuk kam patur mundësi që t'a siguroj të plotë këtë informacion pikërisht për shkak të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga ana tjetër nuk kam ndeshur 100% në bashkëpunimin e shtetasit në fjalë, pasi ai ka patur rezervat e tij (për arsye që nuk m'i ka shpjeguar mua), për të më treguar në masën 100% të dhënat pasurore të tij. (këto konflite mkryesisht kanë patur të bëjnë me trashëgiminë që ai ka patur me babain tim lidhur me pasurinë trashëgimore të prindërve të tyre).
dh. Xheladin Cuf Thana, që është bashkëshorti i hallës time, (kunati i babait tim), dhe që njëkohësisht është është huadhënës i një shume prej 1.500.000 (njëmilion e pesëqind) lekë, në vitin 2006, tek babai im Faik Ymeri. që është xhaxhai im dhe njëkohësisht është huadhënës i një shume prej 2.000.000 (dymilion) lekë, në vitin 2006, tek babai im Faik Ymeri. Ky paraqitet si huadhënës i babait tim në vitin 2006. Meqënësi Komisioni ka marrë në analizë pasurinë e këtij shtetasi, burimet e krijimit të saj si dhe shpenzimet për jetesë, në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së deklarimeve që kam bërë unë në procesin tim të rivlerësimit, është e qartë se unë kam interes përbashkues me të. Një arsye tjetër përse kam kërkuar thirrjen e këtij shtetasi si person i tretë ka të bëjë me faktin se duke marrë pjesë ai si person i tretë në procedimin administrativ, ai do të ishte palë. Për rrjedhojë, nuk do të kishte më pengesa sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, për të siguruar të plotë informacionin dhe dokumentacionin për gjendjen e tij pasurore/tatimore/bankare. Unë nuk kam patur mundësi që t'a siguroj të plotë këtë informacion pikërisht për shkak të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga ana tjetër nuk kam ndeshur 100% në bashkëpunimin e shtetasit në fjalë, pasi ai ka patur rezervat e tij (për arsye që nuk m'i ka shpjeguar mua), për të më treguar në masën 100% të dhënat pasurore të tij. veçanarisht lidhur me mënyrën se si i kishte ndarë të ardhurat e përfituara mga shitja e tokës, përkundrejt vëllait të tij[26].
e. Shefqet Geci, me banim në fshatin Trush Shkodër, tek i cili babai im ka dhënë një sipërfaqe toke bujqësore me qera në vitet 2004-2007. Arsyeja e thirrjes si person i tretë të këtij shtetasi

[26] Në analizën financiare që Komisioni i ka bërë Huadhënësit Xheladin Thana, në vendim, është shprehur se meqënëse toka ka qënë në bashkëpronësi 2/3 Xheladin Thana dhe 1/3 vëllai i tij, shuma e përfituar nga Xheladin Thana nga shitja e tokës, është përpjestuar po në këto raporte. Pra, Komisioni ka marrë përsipër të bëjë pjestim pasurie ndërkohë që pjestimin e pasurisë e bëjnë sipas neneve 202 e vijues të Kodit Civil ose bashkëpronarët me marrëveshje noteriale mes tyre ose në rrugë gjyqësore. Veç kësaj, mënyra se si ka vepruar Komisioni nuk përputhet me të vërtetën. Kjo pasi kjo shumë është marrë e gjitha nga Xheladin Thana, sipas deklarimit që ai i ka bërë babait tim. Komisioni, theksoj se nuk më ka parashtruar pyetje ndonjëherë lidhur me këtë fak, pra se si është ndarë shuma e përfituar nga shitja e tokës ndërmjet Xheladin Thanës dhe vëllait të tij. Kjo mënyrë veprimi e komisionit është e gabuar pasi nuk më ka dhënë mundësi të sqaroja problematikën duke sjellë si pasojë analizë financiare të gabuar të shtetasit Xheladin Thana.

kishte të bënte me barrën e provës që më ngarkoi komisioni lidhur me të ardhurat e tokës bujqësore të përfituara nga familja ime e origjinës në kohën kur kam jetuar me ta.
ë. Lulzim Karini, avokat në Dhomën e Avokatisë Shkodër, (me të cilin unë sipas KPK, kam ushtruar detyrën e gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit, në të paktën 6 raste). Arsyeja që kërkova thirrjen e këtij shtetasi si person i tretë kishte të bënte me faktin se përderisa në procesin tim të rivlerësimit ai po paraqitej si person që kishte bashkëpunuar me mua në dhënie/marrje favoresh gjyqësore, ai qartësisht kishte interes përbashkues me mua. Pikërisht mënyra se si ai do t'a mbronte veten e tij lidhur me këto akuza, do të shërbente si mjet provues për mua për të përmbushur barrën e provës që më kishte ngarkuar Komisioni.
f. Nexhat Maliqi, (ky shtetas sipas KPK, ka perfituar favore gjyqësore nga unë në cilësinë e gjyqtarit, në kohën kur kam gjykuar çështjen paditës: Nexhat Maliqi, etj, e paditur Kurum International sh.p.k). Edhe për këtë shtetas vlen arsyeja e mësipërme që përmënda në rastin e shtetasit Lulzim Karini, se përse kërkova t'a thërras si person i tretë.
g. Roland Ilia, me detyrë Komisioner në KPK. (Kërkesa për thirrjen e tij me cilësinë e personit të tretë në procesin tim të rivlerësimit, u parashtrua pas përjashtimit të tij nga procesi im i rivlerësimit, me qëllim për të vërtetuar ushtrimin prej tij të detyrës së komisionerit relator, në kushtet e ekzistencës së gjendjes flagrante të konfliktit të interesit përmes një procedure gjyqësore ballafaquese ndërmjet tij dhe meje).
Lidhur me këtë shtetas, i ngre gjithashtu si shkak ankimi Kolegjit që ashtu sikurse e kam përcaktuar në objektin e ankimit, (në pikën 3 të pjesës hyrëse të ankimit, në rubrikën objekti), të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kulifikimit, nr. 2346/8 prot, datë 15.06.2022, me të cilin është disponuar "*Pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisionerit Roland Ilia nga procesi i tij i rivlerësimit*", duke u kryer nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit veprimet e mëposhtme:

a. Hetimin në themel **të të gjitha shkaqeve që kam ngritur unë** për përjashtimin e këtij Komisioneri, në seancë gjyqësore publike në KPA, (dhe jo vetëm të një pjese të tyre sikurse ka vepruar KPK).

b. Konstatimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit se motivet e përjashtimit të këtij Komisioneri nga procesi im i rivlerësimit, **përveç** atyre të shprehura në përmbajtjen e këtij vendimi të ankimuar, (që kanë të bëjnë me konstatimin nga vetë KPK të ekzistencës së konfliktit të dukje dhe të konfliktit të mundshëm të interesit), duhet të jenë edhe konstatimi i konfliktit faktik dhe konfliktit të vazhdueshëm të interesit të këtij komisioneri, në ushtrimin e detyrës së tij, në raport me mua.

c. Zgjidhjen e pasojave ligjore nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, të ushtrimit të detyrës nga Komisioneri Roland Ilia, në kushtet e ekzistencës së konfliktit faktik, konfliktit të vazhdueshëm, konfiktit në dukje dhe konfliktit të mundshëm të interesit të këtij, në raport me mua, duke u disponuar pavlefshmëria e të gjitha veprimeve administrative të kryera nga ky zyrtar, (në cilësinë e komisionerit relator të trupit gjykues të KPK), papërdorshmëria e të gjitha rezultateve/të dhënave/provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve administrative si dhe përsëritja e tyre nga fillimi, **sikurse përshkruhet në pikën 2 të pjesës hyrëse të këtij ankimi**.

ç. Konstatimin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ekzistencës së shkaqeve për fillimin e procedimit disiplinor ndaj këtij Komisioneri, për ushtrimin e detyrës zyrtare në kushtet e ekzistencës flagrante të konfliktit të interesit ne raport me mua.

Kërkesa ime për thirrjen e personave të tretë të mësipër, kishte si bazë ligjore nenin 192 të KPC që parashikon si më poshtë:

Secila palë mund të thërresë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.
Personi i tretë thirret me kërkesë të shkruar që paraqitet në seancën përgatitore ose në sekretarinë gjyqësore kur ka filluar shqyrtimi i padisë.
Kërkesa i njoftohet menjëherë gjyqtarit i cili urdhëron që t'i njoftohet personit të tretë, mundësisht pa shtyrë seancën gjyqësore të caktuar. Thirrja e personit të tretë lejohet kur ai ka banim të ditur brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe derisa nuk ka përfunduar gjykimi i çështjes në shkallë të parë.

Kërkesa për thirrjen e personave të tretë të mësipërm, u bë me shkrim dhe iu dorëzua Komisionit me aktin MEMO-KPK-SHKODRA, me datën 29.11.2022.

Nga Komisioni m'u kthyer përgjigje me vendimin e ndërmjetëm të datës 05.12.2022 si vijon: "kërkesa për thirrjen e personave të tretë vlerësohet si e papranueshme pasi procesi i rivlerësimit është vetëm për ju.

Si bazë ligjore Komisioni referoi nenin 49, pika 6, shkronja "a" të ligjit 84/2016 që parashikon se: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme*;

Në vendimin përfundimtar Komisioni shprehet se kërkesa për thirrjen e personave të tretë u vlerësua si e papranueshme pasi u vlerësua se është bërë nga subjekti i rivlerësimit për të zvarritur procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë u vlerësua si abuzive.

Unë e ngre si shkak ankimi vendimin e ndërmjetëm të Komisionit si dhe kësaj pjese të vendimit përfundimar lidhur me personat e tretë për arsyet e mëposhtme:
1. E drejta për thirrjen e personave të tretë sipas nenit 192 të KPC përfshihet në të drejtën ekskluzive të mbrojtjes. Për t'a ushtruar këtë të drejtë, sipas përmbajtjes së dispozitës mjafton që unë të mendoj se e kam të përbashkët çështjen me subjektin e thirrur si person i tretë apo të mund të kërkoj prej tij garanci ose shpërblim" si dhe t'i jap gjykatës një argument faktik të mjaftueshëm se përse e kam të përbashkët çështjen me personin e tretë apo mund të kërkoj prej tyre garanci ose shpërblim.
Këto kushte padyshim i plotësova në kërkesën me shkrim që i parashtrova Komisionit, pasi i paraqita argumente të mjaftueshme nga pikpamja faktike që u përshkruan më sipër.

2. Referenca ligjore e e përdorur nga Komisioni për refuzimin e kërkesës time procedurale për thirrjen e personave të tretë, është e gabuar. Kjo pasi neni 49, pika 6, shkronja "a" të ligjit

84/2016 flet për të drejtën e Komisionit për të refuzuar provat, jo të drejtën e Koimisionit për të refuzuar kërkesën time procedurale për thirrjen e personave të tretë.

3. Vetë përdorimi nga Komisioni i shprehjes që "u refuzua pasi u konsiderua si abuzim me të drejtën e mbrojtjes me qëllim për të zvarritur procesin", tregon paragjykimin që ka patur Komisioni, të paktën nga data 05.12.2022, kur m'a ka njoftuar vendimin e ndërmjetëm në fjalë. Një proces i nisur me paragjykim, qartazi nuk plotësoj as standartet e gjykatës së paanshme dhe as standartet e gjykatës së drejtë. Për më tepër që Komisioni nuk administronte akoma në datën 05.12.2022 të dhëna që unë synoja të zvarrisja procesin "edhe po të merret si i mirëqënë ky argumentim i pabazuar i tij".

4. Përmes refuzimit për thirrjen e personave të tretë Ajola Prençi dhe Roland Ilia, komisionerët Firdes Shuli (për Ajola prençin) dhe Pamela Qirko (për Roland Ilian), qartësisht treguan dhe vërtetuan se janë në konflikt interesi në procesin tim të rivlerësimit për arsyet që i thashë më sipër, (shih fq të ankimit 55-63 të ankimit) dhe për rrjedhojë nuk po kaloj në përsëritje[27].

5. Në përmbyllje të analizës lidhur me personat e tretë, shpresoj se do të jetë e qartë për kolegjin se Komisioni më ka penguar në ushtrimin e të drejtës time të mbrojtjes, pa arsyetim të ligjshëm si dhe vetë vendimi t tij ku shprehet se nuk pranohet kërkesa procedurale në fjalë, pasi konsiderohet abuzive, në vetvetë tregon paragjykimin e Komisionit në procesin tim të rivlerësimit.

Për t'u zgjidhur pasojat e kësaj pjese të ankimit, i kërkoj Kolegjit që të kalojë çështjen në seancë publike, të thërrasë të gjithë shtetasit që unë kam kërkuar si persona të tretë, (pra duke e pranuar kërkesën time procedurale që është refuzuar nga Komisioni).

Së njëzetë e nënti: Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit edhe faktin që në seancat e datave 12.12.2022, 13.12.2022 dhe 14.12.2022, kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit, komisionerja Pamela Qirko, ka përdorur ndaj meje një fjalor jo të denjë me etikën, paragjykues, jo ligjor si dhe vulgar. Konkretisht:

1. Nëse seancën e datës 12.12.2022, ndërsa unë po lexoja mbrojtjen time, në atë pjesë të saj ku po ekspozoja konfliktin e interesit që kishte komisionerja Pamela Qirko me mua në kryerjen e procesit tim të rivlerësimit, ajo m'u drejtua me fjalët, "*këtë muand t'i shkruash edhe në ankim*[28]". Pikërisht përdorimi i këtyre fjalëve paragjykuese nga komisionerja në fjalë, ishte një nga shkaqet se përse unë kërkova përjashtimin e saj nga gjykimi, pasi përmes përdorimit të tyre u bë përfundimisht e qartë se si to t'ë votonte kjo komisionere në vendimin përfundimtar që do të merrte Komisioni në procesin tim të rivlerësimit. (Lidhur me kërkesën e përjashtimit do shprehem në vijim të përmbajtjes së ankimit).

[27] Komisionerja Pamela Qirko e ka mik shtetasin Roland Iliad he nuk ka dashur që ky i fundit të demaskohet. Komisionerja Firdes Shuli më ka paragjykuar mua në procesin e rivlerësimit të motrës time dhe nuk ka dashur që ky fakt të ekspozohet duke qënë motra ime palë pasi ka patrur frikën e ndonjë kërkese përjashtimi që mund të bënte motra ime, gjë që do ishte plotësisht e ligjshme.

[28] Shiko procesverbalin e transkriptuar të seancës së datës 12.12.2022.

2. Në seancën e datës 13.12.2022, në mbarim të seancës, pasi unë kisha lexuar mbrojtjen time lidhur me kriterin e figurës, Komisionerja Pamela Qirko tha, "*tani po shkoj dhe shoj një film*". Pra jeta ime, mbrojtja ime, sipas komisioneres qënkan të barazvlefshme me një film. Këto fjalë të thëna prej saj si dhe kjo mënyrë sjellje, përveçse tregon paragjykim të përfundimit të procesit, edhe më kanë poshtëtuar thellësisht si dhe më kanë provokuar paligjshmërisht.

3. Në seancën e datës 14.12.2022, ndërsa unë po i nënshtrohesha pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar dhe komisionerëve të trupës, komisionerja Pamela Qirko tha: "unë kam vetëm një pyetje: - *të ardhurat nga qëraja e tokës bujqësore, në vitet 2004, 2005, 2006, i ke marrë ti apo babai*". Unë u përgjigja: "*nuk i kam marrë unë*". Në vijim, komisionerja tha "*pra, ato kanë hyrë në thesin e familjes*". Unë iu përgjigja: "*ju lutem, mos thoni thesin*".

Tani, unë e kuptoj që komisionerja, ndoshta ka persona të afërt në familje dhe/apo në rrethin e saj familjar, që fitojnë para "me thes", por as unë dhe as babai im dhe asnjë prej rrethit tim familjar as nuk kemi fituar ndonjëherë dhe as fitojmë para me thes. Po ashtu, nuk jemi mësuar që duke pirë gjakun e popullit, t'i shpejzojmë këto para p.sh duke ngrënë biftek me vlerë 1000 Euro tek Nustreti në Dubai.

Gjithashtu, përdorimi në procesin tim të rivlerësimit, të fjalëve "***thes***, vagon, kontenier", etj, me të cilat ndoshta mund të jetë mësuar komisionerja për të cilësuar procesin e fitimit apo kursimit të parave nga individët apo familjet, nuk është në përputhje, sipas vlerësimit tim, me cilësimin juridik dhe etik të të ardhurave financiare, për të cilat mund të përdoren fjalët e përshtatshme dhe të bukura të gjuhës shqipe, "të hyra", "zë të ardhurash", "kursime", etj.

Unë në ngritjen e këtij shkaku ankimi përpara Kolegjit ndjek njëherësh tre qëllimet e mëposhtme:

Qëllimi i parë: Për t'i treguar Kolegjit se deri ku ka arritur niveli i paragjykimit nga Komisionerja Pamela Qirko në procesin tim të rivlerësimit. Po ashtu, për t'i treguar Kolegjit, bagazhin leksikor të kësaj komisionereje, që dukshëm nuk është në pajtim as me standartin e "gjykatës së ditur" dhe as atë të "gjykatës së ndershme", dy standarte këto që janë pjesë përbërëse kumulative e standartit kushtetues "gjykim i drejtë". Gjykimi i drejtë është pjesë përbërëse e të drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 6/1 i KEDNj dhe nenet 17/2 dhe 42 të Kushtetutës.

Qëllimi i dytë: Për t'i treguar Kolegjit dëshirën që ka patur komisionerja Pamela Qirko për të më poshtëruar gjatë seancave dëgjimore, përmes përdorimit të fjalëve të papërshtatshme, jo etike dhe vulgare, si dhe për të më provokuar paligjshmërisht në mënyrë që unë të reagoja në gjendje afekti psikologjik të shkaktuar nga poshtërimi përmes provokimit. Unë reagova natyrisht, por sipas ligjit, përmes paraqitjesë së kërkesave përkatëse me objekt përjashtimin e komisioneres. Pikërisht, faktet juridike të paraqitjes së këtyre kërkesave, që përveç konsiderimit si shkak të tyre, të përdorimit nga Komisionerja Pamela Qirko të fjalëve jo etike, të padrejta dhe provokative të mësipërme, kishin edhe shkaqe të tjera, Komisioni në vendimin përfundimtar që unë po ankimoj, i cilëson si "*tentativa për të zvarritur gjykimit*", "*abuzim me të drejtën e mbrojtjes*" dhe në analizë të fundit, si "*tregues të mosbashkëpunimit tim me Komisionin në kryerjen e procesit të rivlerësimit, gjë që është marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave*". Pra, sipas

Komisionit, unë do duhej të duroja provokimet, "mbrojtjen bëje me ankim", "mbrojtja jote vlen sa një film" dhe "fiton para me thes".

I kërkojë Kolegjit që të zgjidhë shprehimisht, pasojat e këtij shkaku ankimi si më poshtë:

a. Përmes arsyetimit të vendimit, t'i tërheqë vëmëndjen komisioneres Qirko për përdorimin e fjalëve të papërshtatshme të mësipërme.

b. Të konsiderojë se edhe nëse unë kam shfaqur ndonjë element të mungesës së etikës në seancat dëgjimore të lartëpërmëndura, (gjë që në dijeninë time nuk e kam bërë), ky element është fragmetar, i parëndësishëm dhe për rrjedhojë sipas parimit të proporcionalitetit nuk duhet të merret në konsideratë, në vlerësimin e nivelit tim të bashkëpunimit me Komisionin, në kryerjen e procesit tim të rivlerësimit. Kjo edhe pasi qartë duket se unë jam provokuar padrejtësisht me qëllim që të detyrohesha të paraqisja si shkak përjashtimi të Komisioneres Pamela Qirko, rrethanat e sipërpërmëndura, në disa prej kërkesave të përjashtimit[29]. Pastaj, nuk është as faji im dhe as pjesë e përgjegjësisë time, rëndësia dhe natyra e fjalëve që ka nxjerrë nga goja komisionerja Pamela Qirko, në seancat dëgjimore të zhvilluara gjatë procesit tim të rivlerësimit nga Komisioni. Aq më pak mmund të ngarkohem unë me përgjegjësi apo të dënohem për reagimin ndaj tyre, sikurse ka lënë të nënkuptohet Komisioni në vendimin e tij përmes të cilit më ka shkarkuar nga detyra. Nëse do veprohej kështu, do të përligjej hakmarrja që Komisioni ka bërë ndaj meje si dhe për rrjedhojë, edhe konflikti i interesit që ka patur komisionerja Pamela Qirko ku përmes vendimit që ajo ka marrë ndaj meje, e ka vënë në jetë dhe e ka zbatuar këtë hakmarrje.

Qëllimi i tretë: I lutem Kolegjit që rrethanat dhe fjalët e sipërmërmendura të Komisioneres Pamela Qirko, të mos i vlerësojë si fakte të shkëputura, por t'i vlerësojë në sintezë, pra së bashku me gjendjen e konfliktit të interesit që ka patur kjo komisionere në procesin tim të rivlerësimit, për të cilën u shpreha në pjesën e mësipërme të ankimit, (*shih shkakun e ankimit të titulluar "së njëzeti", veçanarisht shih fq, 55, 56 dhe 57, si dhe shih shkakun e ankimit të titulluar "së njëzetë e treti,", veçanarisht shih fq, 73, 74 dhe 75),* si dhe në vijim, i lutem Kolegjit që të arrijë në përfundimin se gjykimi im nga komisionerja në fjalë, ka qënë në kundërshtim me standartet e gjykatës së paanshme dhe gjykatës së drejtë.

Veç sa më sipër, parashtroj si shkak ankimi përpara Kolegjit edhe faktin se komisionerja Pamela Qirko, në procesin tim të rivlerësimit e ka vendosur vetën në kushtet e pengesës ligjore për të marrë vendimin përfundimtar. Kjo pasi sikurse e përshkruajta më sipër, fillimisht trupi gjykues i Komisionit, përbëhej nga komisionerët Roland Ilia-relator, Pamela Qirko-kryesuese, Etleda Çiftja-anëtare. Ky trup gjykues më dërgoi/njoftoi raportin për përfundimin e hetimit administrativ vetëm me një kriter, atë të pasurisë, në datën 23 prill 2022. Po ashtu, ky trup gjykues zhvilloi dy seanca dëgjimore, përkatësisht në datat 27.05.2022 dhe 13.06.2022. Përpara seancës së datës 13.06.2022 por edhe gjatë kohëvazhdimit të seancës dëgjmore të kësaj date, unë kam paraqitur me shkrim kërkesën procedurale për marrjen e provave shtesë si dhe riçeljen e hetimit me të tre kriteret e vlerësimit. Ky trup gjykues, me vendimin e ndërmjetëm, (që m'a

[29] Këtu sqaroj se asnjë prej kërkesave të përjashtimit të paraqitura nga unë, nuk ka patur si shkak të vetëm dhe ekskluziv, rrethanat e lartëpërmëndura, por krahas tyre, secila nga kërkesat e përjashtimit, ka patur të radhitur si shkaqe përjashtimi kumulative edhe rrethana të tjera.

komunikoi me email me datën 30.05.2022), por edhe me vendimin e ndërmjetëm që m'a komunikoi verbalisht në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, refuzoi riçeljen e hetimit me tre kriteret, (gjë që nënkuptonte se unë isha i shkarkuar si gjyqtar dhe se mbrojtja ime ishte e kohë). Në këto dy vendime të ndërmjetëme, komisionerja Pamela Qirko, ka votuar si dy kolegët e saj, pra vendimet janë marrë me unanimitet.

Pas pranimit të kërkesave të mia, për përjashtimin e komisionerëve Roland Ilia dhe Etleda Çiftja për shkak se u konstatua gjendja e konfliktit të interesit, u formua trupi i ri gjykues, me përbërje komisionerët Genta Bungo-relatore, Pamela Qirko-kryesuese, Firdes Shuli-anëtare.

Ky trup gjykues, me vendim të ndërmjetëm të datës 21.06.2022, vendosi riçeljen e hetimit administrativ në tre kriteret. Kjo ***pa ndryshuar asnjë rrethanë objektive në raport me rrethanat që kishin ekzistuar në kohën kur trupi gjykues i mëparshëm, refuzoi kërkesën time për të bërë pikërisht këtë gjë***. Edhe në këtë vendim të ndërmjetëm komisionerja Pamela Qirko, ka votuar si dy kolegët e saj, pra vendimi është marrë me unanimitet.

Këtu lindin pyetjet: - pse ndryshoi qëndrim komisionerja Pamela Qirko !!?? A ishte kjo për fasadë, bojatisje pa përmbajtje, apo ca më keq, për të më vlerësuar kriterin e pasurisë në përkeqësim me vlerësimin e mëparshëm për të cilën ajo më parë më kishte ngarkuar barrën e provës[30] !!!? A është e ligjshme vlerësimi në përkeqësim, për më tepër p'a të dhënë mundësi të mbrohesh duke të kërkuar shpjegime shtesë !!?
Unë i parashtroj si shkak ankimi Kolegjit se rrethanat e mësipërme, e bëjnë katërcipërisht të qartë se komisionerja Pamela Qirko, pas vlerësimit të mëparshëm të dhënë prej saj në kuadrin e trupit të mëparshëm gjykues, nuk mund të jepje vlerësim të ri mbi të njëjtat rrethana. Kjo pasi ka shkelur nenin 72, pika 4 të Kodit të Procedurës Civle", që parashikon se: *Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: 1..2..3.. 4. ka dhënë këshilla ose ka*

[30] Shih p.sh, si tregues i vlerësimit në përkeqësim, të faktit që trupi gjykues i mëparshëm, më ka njohur si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruara nga unë në vitin 2008 nga dhuratat e dasmës dhe në lindjes së djalit, në vlerën 600.000 (gjashtëqindmijë) lekë, ndërsa trupi i ri gjykues, i njeh vetëm në vlerën 450.000 (lekë) lekë, (pa asnjë lloj arsyetimi se çfarë ndryshoi në raport me vlerësimin e mëparshëm).

Po ashtu, shih p.sh, si tregues i vlerësimit në përkeqësim, të faktit që trupi gjykues i mëparshëm, më ka njohur si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruara nga unë në vitin 2008, nga dhurata me rastin e dasmës, që më janë bërë nga vjehrra ime Flutur Hallunovi, në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, ndërsa trupi i ri gjykues, nuk i njeh fare, (pa asnjë lloj arsyetimi se çfarë ndryshoi në raport me vlerësimin e mëparshëm).

Gjithashtu, shih p.sh, si tregues i vlerësimit në përkeqësim, të faktit që trupi gjykues i mëparshëm, më ka njohur si të besueshëm faktin që depozita prej 1.000.000 (njëmilion) lekë tek Raiffeissen bank, e deklaruar në DPV 2008, e vendosur nga bashkëshortja ime në prill 2008, kishte si burime të ligjshme, të ardhurat e familjes së saj të origjinës. Kjo pasi sipas vlerësimit të trupit gjykues të mëparshëm, nga analiza financiare e familjes së origjinës së bashkëshortes time, rezulton se kjo familje kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme.

Trupi i ri gjykues, pa asnjë arsyetim, pa asnjë shpjegim dhe pa bërë referencë në asnjë fakt apo rrethanë ligji, nuk i konsideron të besueshme këto deklarime. Madje në vendimin përfundimtar, nuk shprehet fare nëse i ka bërë analizë financiare familjes së bashkëshortes time, çfarë rezulton nga kjo analizë financiare, përse nuk janë vlerësuar si të besueshme shpjegimet e mia dhe provat që kam paraqitur. Përse nuk më ka bërë trupi i ri gjykues pyetje shtesë për t'a qartësuar situatën nëse deklarimi im është vlerësuar si i pamjaftueshëm në këtë drejtim. Përse nuk më ka dhënë mundësi objektive për të paraqitur ndonjë provë shtesë, nëse ka patur nevojë për të tilla, etj.

shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërës apo tjetrës palë ;

Zbatimi i kësaj dispozite ligjore është në harmoni edhe me parashikimet e ligjit nr .9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar), dhe konkretisht, shih nenin 4 pika 2 që parashikon se fushën e zbatimit të ligjit:

2. Për qëllimet e këtij ligji:
a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit;
c) një zyrtar'" ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

Po ashtu, shih edhe nenin 3, paragrafi 3 të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar), ku parashikohet se: *2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.*

Intepretimi sistematik, teleologjik dhe gjuhësor i dispozitave ligjore të mësipërme, të çon në përfundimet e mëposhtme lidhur me pjesmarrjen e komisioneres Pamela Qirko në trupin gjykues të Komisionit në procesin tim të rivlerësimit:

a. Akti i vlerësimit i dhënë nga Komisionerja Pamela Qirko, në përfundim të hetimit administrativ vetëm me një kriter-atë të pasurisë, përpara se të përjashtoheshin dy komisionerët Roland Ilia dhe Etleda Çiftja, konsiderohet se quhet akt që bie në fushën e zbatimit të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike". Kjo pasi referuar natyrës së tij, ky akt-vlerësimi, është *thelbësisht i rëndësishëm dhe përcaktues për përmbajtjen përfundimtare të aktit të Komisionit për procesin tim të rivlerësimi, (neni 2, pika "b" e ligjit);*

b. Aktet/vendimet e ndërmjetme të marra nga komisionerja Pamela Qirko së bashku me komisionerët Roland Ilia dhe Etleda Çiftja, me datën 30.05.2022 dhe në seancën dëgjimore të datës 13.07.2022, për mospranimin e kërkesës time për marrjen e provave si dhe riçeljen e hetimit administrativ në të treja kriteret e vlerësimit, konsiderohet se bien në fushën e zbatimit të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike". Kjo pasi referuar natyrës së këtyre dy akteve/vendimeve të ndërmjetme, ato janë *thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit të Komisionit për procesin tim të rivlerësimit, (neni 2, pika "b" e ligjit);*

c. Aktet e mësipërme të përmëndura në pikat "a" dhe "b", konsiderohet se përfaqësojnë mendimin e komisioneres Pamela Qirko për çështjen e procesit tim të rivlerësimit. Këto akte janë marrë më ***përpara në kohë*** se trupi i ri gjykues të fillonte mbi bazën e vendimit të ndërmjetëm të datës 21.06.2022 hetimin administrativ të procesit tim të rivlerësimit. Pra, në vetvetë, kjo bie në fushën e zbatimit të nenit 72 pika 4 të Kodit të Procedurës Civile, që zbatohet nga organet e rivlerësimit së bashku me ligjin 84/2016 dhe ligjin 44/2015.

ç. Nëse ligje të ndryshme që janë njësoj të zbatueshme për anëtarët e organeve të rivlerësimit, parashikojnë rregulla të ndryshme në raport me njëri - tjetrin, për kufizimin dhe pjesmarrjen në trupat gjykuese të këtyre anëtarëve, atëherë, sipas nenin 3, paragrafi 3 të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar), *zbatohet kufizimi ligjor që është më i rreptë*. ***Ky kufizim më i rreptë është ai i parashikuar në nenin 72, pika 4 të Kodit të Procedurës Civile***.

d. Përfundimi, komisionerja Pamela Qirko, do duhej të largohej nga procesi im i rivlerësimit pasi i bie që ajo ka dhënë mendim për çështjen përpara se të fillonte hetimi administrativ nga trupi i ri gjykues dhe aq më shumë ajo nuk do duhej të merrte pjesë në vendimin gjyqësor përfundimtar.

I kërkoj Kolegjit që të zgjidhë pasojat e këtij shkaku ankimi ose duke e kthyer çështjen për rigjykim në komision me trup tjetër gjykues, (për shkak të pavlefshmërisë absolute të vendimit përfundimtar të Komisionit mbi shkakun e pjesmarrjes së paligjshme të Komisioneres Pamela Qirko në trupin gjykues që ka dhënë vendimi që unë po ankimoj),
Ose
Minimalisht, Kolegji, të ndreqë shkeljen procedurale, duke përsëritur veprimet hetimore të gjitha nga e para dhe t'a kalojë çështjen për shqyrtim në seancë publike.

Së tridhjeti: Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit edhe mosrespektimin nga Komisioni, të afatit 3 ditor të parashikuar në nenin 74 të Kodit të Procedurës Civile, për të paraqitur me shkrim kërkesat për përjashtimin e Komisionerëve Roland Ilia, Etleda Çiftja, Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Bungo, në seancat e datave 13.06.2022, 12.12.2022, 13.12.2022 dhe 14.12.2022 . Për këtë shkak ankimi u shpreha më sipër, kur trajtova problematikën e shkeljes nga Komisioni të të drejtës time për të mos iu nënshtruar një trajtimi ç'njerëzor, (shih shkakun e përjashtimit njëset e dy, veçanarisht fq. 69, 70, 71 të këtij ankimi). Për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme që të zgjatem më tej.

Së tridhjete e një: Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit mosmarrjen në shqyrtim nga Komisioni të dy kërkesave të përjashtimit të paraqitura përpara dhe në seancën dëgjimore të datës 19.12.2022.

Konkretisht, përpara seancës dëgjimore të datës 19.12.2012, në orën 13:12 min të kësaj datë unë i kam dërguar me email Komisionit një kërkesë me objekt përjashtimin nga trupi gjykues të Komisioneres Genta Bungo. Si provë mbështetëse të kësaj kërkese i kam dërguar një fotografi të vitit 2016 ku shfaqet komisionerja Genta Bungo së bashku me shokët që ka mbaruar fakultetin. Ndër këta shokë të komisioneres bëjnë pjesë disa subjekte rivlerësimi si Besa Nikhasani, Bujar Musta, Agron Bushati, Ledina Riza, Mirela Kapo, etj, të cilët janë gjykuar nga komisionerja Genta Bungo apo vazhdojnë të gjykohen prej saj (p.sh Agron Bushati).

Ky fakt ka rëndësi pasi komisionerja Genta Bungo, si relatore e trupit gjykues më kishte ngarkuar barrë prove në hetimin administrativ dhe po më gjykonte, ndër të tjera edhe për faktin që kisha gjykuar disa çështje me avokatin Lulzim Karini, të cilin e kisha patur shok shkolle në universitet, në kuptimin që ai ka qënë bashkëstudent me mua në të njëjtin kurs por në klasa të ndryshme. (Sipas Komisioneres kjo përbën konflikt interesi).

Komisionerja Genta Bungo, ndodhej në të njëjtat rrethana me mua dhe për rrjedhojë duhej të përjashtohej nga gjykimi referuar nenit 30 të ligjit 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të R.Sh" që parashikon se " Neni 30 Pengesat ligjore: *Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:*
a) ..; b)..; c).. nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën "b", të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim; .....
.....g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën "b", të këtij, neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim;
....

Komisionerja Genta Bungo qartësisht ndodhej në të njëjtat rrethana në raport me subjektet që ajo kishte gjykuar dhe ato që ka për gjykim dhe për të cilët nuk ka dhënë akoma dorëheqjen (p.sh. Agron Bushati), me ato që kisha unë me avokatin Lulzim Karini.

Madje këto rrethana ishin më të rënda pasi: 1. Ndryshe nga unë komisionerja kishte gjykuar jo një por shumë subjekte që kishte patur shokë shkolle, dhe 2. Vazhdonte të gjykonte akoma.

Për rrjedhojë, nëse do vlerësohej (sikurse është vlerësuar në vendimin që po ankimoj) se unë kam qënë në konflikt interesi me avokatin që e kam patur shok shkolle në kuptimin që ai ka qënë bashkëstudent me mua në të njëjtin kurs por në klasa të ndryshme, sipas parimit të barazisë, edhe komisionerja Genta Bungo do dcuhej përjashtuar nga gjykimi.

Kjo kërkesë përjashtimi, nuk iu përcoll për gjykim nga komisionerja Genta Bungo, një tjetër trupi gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

(Në vendimin që po ankimoj, thuhet se kjo u bë pasi vetë trupi gjykues në të cilën ishte pjesmarrëve komisionerja Genta Bungo, e vlerësoi këtë kërkesë si abuzive).

Në seancë dëgjimore të datës 19.12.2022, pasi unë kërkova informacion (shih procesverbalin) se çfarë ishte bërë me këtë kërkesë dhe kërkova që ajo së bashku me provën fotografike t'i përcillej për gjykim një tjetër trupi gjykues të Komisionit, u njoftova nga komisionerja kryesuese Pamela Qirko se kjo nuk lejohej. Kur pyeta përse dhe kërkova bazën ligjore tek e cila referohej komisioni, baza ligjore nuk m'u tregua dhe m'u shpjegua se "kishte kaluar koha e paraqitjes së kërkesave dhe provave të reja".

Mbi bazën e këtij qëndirmi, paraqita me gojë edhe kërkesën e dytë të përjashtimit duke kërkuar kohë t'a paraqes me shkrim sipas nenit 74 të KPC. Edhe kjo kërkesë m'u refuzuar.

Pas kësaj, duke qënë shkelja e të drejtave të mia ligjore shumë e qartë, fjalët e fundit që i thashë trupit gjykues të Komisionit në seancën e datës 19 dhjetor 2022 që ishte edhe e fundit, ishin "*më lejoni t'iu uroj gëzuar Krishlindjet dhe Vitin e Ri dhe se e mora vesh vendimin tuaj. Në seancën e datës 21.12.2022 që ju po më njoftoni se do të shpallni vendimin, nuk do të vi, pasi vendimi tashmë dihet*".

Nga fakti i sipërpërshkruar, që rezulton nga procesverbali i seancës së datës 19.12.2022 si dhe nga fotografia ku shfaqet Genta Bungo me shokët e saj të klasës (që do ia dorëzoj si provë Kolegjit), rezulton qartë se më janë cënuar:

1. E drejta e aksesit në Drejtësi, si pjesë e të drejtës për proces të rregullt ligjor. Kjo pasi e drejta e paraqitjes së kërkesave për përjashtim të gjyqtarit/komisionerit, si dhe e drejta për paraqitjen e provave, është shprehje e të drejtës së aksesit në shërbimin gjyqësor.

2. E drejta e gjykimit "nga një gjykatë e krijuar me ligj". Kjo pasi sipas ligjit 84/2016, kërkesat e përjashtimit nuk shqyrtohen vetë nga trupi gjykues që kërkohet të përjashtohet por nga një trup tjetër gjykues. Aq më shumë nuk lejohet që komisioneri/komisionerët për të cilët kërkohet përjashtrimi, t'a konsiderojnë vetë kërkesën për përjashtim "abuzive", sikurse kanë bërë në vendimin që po ankimoj, trupi gjykues i Komisionit, (ndonëse nuk tregojnë asnjë rrethanë fakti për këtë kërkesë, pasi është e qartë që edhe vetë turpërohen nga sjellja e tyre). Aq më shumë nuk lejohet që të shkarkohem nga dcetyra e gjyqtarit për shkak se kam guxuar të paraqes një kërkesë të tillë. Kjo nuk është gjë tjetër veçse tregues i hakmarrjes, pra njëanshmërisë së gjyqtarit/komisionerëve.

3. E drejta e gjykimit të paanshëm. Komisionerët nuk mund t'a quajnë sjellje abuzive me të drejtën e mbrojtjes, paraqitjen nga ana ime të dy kërkesave për përjashtim dhe provës fotografike të mësipërme. Kjo pasi për sa kohë që kjo kërkeseë nuk është shqyrtuar nga trupi gjykues kompetent, vetë komisionerët konsiderohen si palë në konflikt me mua.

4. E drejta e një gjykimi të drejtë. Kjo pasi është shumë e qartë se kërkesat ime për përjashtimin e Komisioneres Genta Bungo, është plotësisht e bazuar në ligj dhe në prova dhe për rrjedhojë, sigurisht që do të pranohej nga trupi gjykues kompetent i KPK-së. Për më tepër, që vetë komisionerja Genta Bungo, ka qënë ajo që ka pranuar kërkesën time për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja, në një situatë jo vetëm të ngjashme, por shumë më të rëndë për komisioneren Genta Bungo.

(*Shih vendimi për përjashtimin e Etleda Çiftja që i kërkoj Kolegjit t'a administrojë si provë. Nga ky vendim, po të shikohet shkaku se përse është përjashtuar Etleda Çiftja, duket se ajo është përjashtuar sipas nenit 30 "c" të ligjit 44/2015, kodi i Procedurave Administrative. Vendimin e përjashtimit e ka arsyetuar vetë Genta Bungo. Për rrjedhojë, provohet ana subjektive e kësaj të fundit, pra aftësia e saj për të parashikuar se cila do të ishte vendimarrja e trupit gjykues tjetër të KPK, për kërkesën për përjashtim, që ajo refuzoi t'ia përcjellë trupit gjykues kompetent në seancën dëgjimore të datës 19.12.2022*).

Po ashtu, e drejtë është edhe kërkesa ime për përjashtimin e të tre komisionerëve. Kjo mbi shkakun e ri të ndodhur në seancën e datës 19.12.2022, që të tre këta komisionerë, u solidarizuar me Komisioneren relatore Genta Bungo, për të mos ia përcjellë kërkesën për përjashtim, mbi shkaklun e mësipërm trrupit gjykues kompetent.

Për të vërtetuar sa më sipër, pra shkeljen e te drejtave të mia kushtetuese të përshkruara në këtë shkak të ankimit, i kërkoj Kolegjit të aministrojë si prova, veç fotografisë së mësipërme, edhe vendimet e dhëna nga KPK, për subjektet si dhe të kërkojë informacion zyrtar nga KPK nëse është apo jo në funksionin e komisioneres relatore të trupit gjykues të subjektit Agron Bushati kjo komisionere, si dhe a po e zvarrit mbi 4 vjet procesin e rivlereësimit të këtij të fundit, për t'a favorizuar meqënëse e ka patur shok shkolle në fakultet. (Flitet se ka marrë para por për sa kohë nuk kam akoma prova nuk po shprehem më tej, pra ka dyshime se po i bën favore të paligshme këtij subjekti meqënëse e ka patur shok shkolle. Me këtë rast, i kërkoj Kolegjit të vendosë në bazë krahasimi dyshimet se përse Genta Bungo po favorizon subjektin e rivlerësimit Agron Bushati të cilin e ka patur shok shkolle, duke i zvarritur procesin e rivlerësimit, me arsyetimin e po komisioneres Genta Bungo se unë e paskam favorizuar avokatin Lulzim Karini të cilin e kam patur shok shkolle, në universitet, në kuptimin që ai ka qënë bashkëstudent me mua në të njëjtin kurs por në klasa të ndryshme).

I parashtroj se shkak ankimi Kolegjit edhe faktin që në seancën e datës 19.12.2022, m'u mohua e drejta për t'u njohur me vendim paraprak dhe të arsyetuar lidhur me kërkesën procedurale për pezullimin e procesit tim të rivlerësimit deri në kohën që të gjykohej nga Gjykata Kushtetuese, **të kërkesës që kam paraqitur në këtë gjykatë, me datën 19.12.2022, (por edhe në KPA), me objekt:**

"**1.** *Konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në standartin kushtetues "Gjykatë e krijuar me ligj" për shkak të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të shtetasve Genta Bungo, Firdes Shuli, Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi, Suela Zhegu dhe Alma Faskaj.*
2. *Shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ne nr 82/2017, për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 "për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e shqipërisë" përsa i përket të zgjedhurve në në institucionet e rivlerësimit kë komisionerve Genta Bungo, Firdes Shuli, Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi, Suela Zhegu dhe Alma Faskaj.*
3. *Marrjen e masës së përkohshme të pezullimit të vijimit të shqyrtimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i procesit të rivlersimit kalimtar të gjyqtarit Andri Ymeri, deri në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor me vendim përfundimtar të formës së prerë.*
4. *Përcaktimi nga Gjykata Kushtetuese përmes pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të vendimit të saj, të faktit se cili organ shtetëror ka juridiksion dhe/apo kompetencë ligjore për të shqyrtuar cështjen në themelin e saj, duke patur parasysh edbe vendimet e GJEDNJ, në cështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë dhe Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë.*

Duke mos e pezulluar gjykimin mbi bazën e kësaj kërkese, trupi gjykues i Komisionit, jo vetëm që e vuri veten në gjendjen e konfliktit të interesit, por më refuzoi të drejtën e një vendimi të ardyetuar, që është pjesë përbërëse e standartit "gjykim i drejtë", të të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Mbi sa më sipër, i kërkoj Kolegjit zgjidhjen e pasojave të këtij shkaku ankimi, pra kërkoj nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit të shprehet vetë për këtë kërkesë, (*që ia kam paraqitur edhe vetë Kolegjit me datën 19.12.2021 përmes shërbimit postar, por akoma nuk jam njohur me vendimin përkatës të Tij, lidhur me këtë kërkesë*).

Si dhe

Në rast se Kolegji vendos t'a shqyrtojë vetë këtë kërkesë, i kërkoj paraprakisht që të vendosë masën e përkohshme të pezullimit të fuqisë juridike të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022 të KPK, deri në shqyrtimin e kësaj kërkese nga vetë Kolegji i Posaçëm i Apelimit si dhe të më njoftojë vendimin e ndërmjetëm përkatës lidhur me kërkimin për masën e përkohshme, përpara gjykimit të çështjes në themel.

<u>Veç sa më sipër, në këtë pjesë të ankimit, i parashtroj se shkak ankimi Kolegjit edhe faktin</u> në seancën e datës 19.12.2022, i vetmi arsyetim që m'u tha nga trupi gjykues i Komisionit lidhur me kërkesën time për t'u informuar se përse nuk po më merreshin në dorëzim kërkesat e pezullimit të gjykimit, dy kërkesat e përjashtimit si dhe provat përkatëse, ishin fjalët që m'i tha komisionerja Pamela Qirko "*t'a kemi bërë me dije në mbarim të seancës së datës 14.12.2022 se nuk do të merren më prova*". Unë i thashë "*janë kërkesa dhe nuk janë prova*", por nga trupa gjykuese nuk m'u dha sqarim i mëtejshëm.

Kjo mënyrë veprimi tregon sa më poshtë:

1. Padijeninë e trupit gjykues të komisionit për të bërë dallimin ndërmjet provave me kërkesat, (që janë akte procedurale dhe nuk janë prova). Standarti gjykim i drejtë nënkuton: I. Gjykatë të ditur, II. Gjykatë të ndershme. Nëse njëri kusht nuk zbatohet, nuk ka gjykim të drejtë.

2. Trajtimin e pabarabartë në raport me subjekte të tjerë rivlerësimi. Kjo pasi të gjithë këtyre iu janë marrë provat nga Komisioni, qoftë edhe pasi trupi gjykues i Komisionit ishte tërhequr për të marrë vendimin përfundimar. (Sjell si shembull rastin e subjektit të Rivlerësimit Dritan Hallunaj (me të cilin puthet dhe përqafohet komisionerja Genta Bungo), të cilit po komisionerja Genta Bungo, në cilësinë e Komisioneres relatore të trupit të tij gjykues, i mori si prova dokumentet që ishin paguar tatimet mbi disa të ardhura, në vlerë mbi 2 milion lekë, datën e seancës dëgjimore, dhe nga ku rezultonte se këto tatime ishin paguar 1 ditë para datës së seancës. Kjo lë shteg për dyshim favorizimi më shumë se puna e shokut të shkollës....).

3. Pandershmërinë e sjelljes së Komisionit pasi ndërsa mua më thotë nuk marrim më prova pas seancës dëgjimore të datës 14.12.2022, nga vetë përmbajtja e vendimit, provohet se prova janë marrë. Konkretisht, me datën 18.12.2022, unë i dërgova një email Komisionit të titulluar "Memo për raportin e vlerësimit nëntor 2022", që përmbante disa deklarime të mia shtesë në raport me materialin që i kisha çuar me email komisionit për mbrojtjen time në datën 29.11.2022, që titullohej "Memo -KPK-Shkondra". ***<u>Ky material, i titulluar "Memo për raportin e vlerësimit nëntor 2022", citohet në vendimin e komisionit që unë po ankimoj</u>***. Po ashtu edhe disa nga deklarimet shtesë. Pra, vërtetohet që prova janë marrë pas datës 14.12.2022. Pra, nuk qëndron dhe nuk është e vërtetë ajo që më tha komisioni se nuk marrim prova, pas datës 14.12.2022. vetë sjellja e komisionit e shprehur në vendim, tregon të kundërtën.

<u>Së tridhjetë e dy</u>: Duke u rikthyer tek vlerësimi si kriterit të pasurisë që është bërë nga Komisioni, (*pasi ky kriter mendoj se ka qënë më i rëndësishmi për të arritur në konkluzionin e shprehur në vendim*), ***i parashtroj si shkak ankimi Kolegjit edhe pretendimin tim se për periudhën 2008-1016***, (*kohë në të cilën Komisioni në analizën financiare më ka nxjerrë me bilanc negativ kumulativ rreth 1.800.000 (njëmilion e tëtëqindmijë) lekë*), ***analiza financiare e përllogaritjes së shpenzimeve është e gabuar***.

Konkretisht, në vendim Komisioni shprehet se në përllogaritjen e shpenzimeve për këtë periudhë kohe i është referuar standarit të vendosur nga KPA, në vendimin e subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj. Ky qëndrim i Komisionit është i gabuar pasi rasti im ka dallime thelbësore me rastin ku është vendosur standarti. Kjo për arsyet e mëposhtme:

I. Në vititin 2008 më ka lindur fëmija i parë, djali Enea Ymeri, i datëlindjes <u>18.09.2008</u>. Në analizën financiare të këtij viti shpenzimet familjare janë përllogaritur nga Komisioni për 9 muaj si familje me **dy** persona dhe për 3 muaj si familje me **tre** persona. Për këta tre muaj djali është konsideruar ***me shpenzime si i rritur***, ndërkohë ***që ka qënë bebe, që është ushqyer me gji*** duke mos patur fare shpenzime për ushqim[31] si dhe shpenzimet e tjera kanë qënë pothuajse të parëndësishme. Vetëm nga kjo analizë e gabuar më është rënduar padrejtësisht analiza financiare për vitin 2008 me rreth 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

Kjo vlen edhe për vitin 2009 (ndonëse sipas Komisionit dal me bilanc pozitiv këtë vit), duke m'u rënduar padrejtësisht analiza financiare mbi 100.000 (njëqindmijë lekë) lekë për këtë vit. Po ashtu edhe vitet e tjera në vazhdim, (2010, 2011, 2012, etj), ku shpenzimet me djalit kanë qënë qartësisht jo si i rritur.

Vetëm analiza e gabuar e shpenzimeve të djalit për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, m'a ka rënduar padrejtësisht analizën financiarë për këto vite të paktën rreth 150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë. Ky rëndim i padrejtë ka sjellë pasoja negative si në bilancin negativ kumulativ për vitet 2008-2016 ashtu edhe në bilancet negative të blerjeve të bonove të thesarit në këto vite.

I kërkoj Kolegjit të riparojë parregullsinë duke më përrllogaritur shpenzimet për të gjithë vitin 2008 si familje me dy persona ose të paktën me 2,5 persona për periudhën ndërmjet datave 18.09.2008 - 31.12.2008.

I kërkoj Kolegjit të riparojë parregullsinë duke bërë një analizë financiare të re në të cilën të bëjë përllogaritjen me formulën e drejtë, pra duke u marrë për bazë të dhënat e ***INSTAT 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, për përllogaritjen e shpenzimeve për fëmijët sipas grupmoshave***, si dhe të dhënat e përftuara të reflektohen në analizën time financiare.

Këto bilance negative duhen korrigjuar pasi 50.000 (2008) + 150.000 (2009-2012) = 200.000 (dyqindmijë) lekë, ndërkohë që i gjithë bilanci negativ kumulativ i nxjerrë nga Komisioni për periudhën 2008 - 2016 është rreth 1.800.000 (njëmilion e tetëqindmijë) lekë.

[31] Shpenzimet për ushqim sipas INSTAT janë jo më pak se 42% e shpenzimeve.

Vetëm nga korigjimi i analizës i analizës financiare si më sipër, kemi 1.800.000 – 200.000 = 1.600.000 (njëmilion e gjashtëqindmijë) lekë. Pra shumë afër standartit të vendosur nga jurisprudenca e konsoliduar e KPA për zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

Kjo edhe nëse nuk merren fare parasysh, argumentimet e mia se përse bilanci negativ kumulativ i nxjerrë nga Komisioni për vitet 2008 - 2016, nuk është i bazuar, i drejtë dhe i ligjshëm.

II. Në vitin 2016, më kanë lindur vajzat binjake Diora dhe Dania Ymeri, të datëlindjes 15.05.2016. Edhe në këtë vit (sikurse për vitin 2008) në analizën financiare të këtij viti shpenzimet familjare janë përllogaritur nga Komisioni për 4,5 muaj si familje me tre persona dhe për 7,5 muaj si familje me pesë persona. Edhe kjo formulë është e gabuar, pasi vajzat janë ushqyer me gji për vitin 2016 pjesën më të madhe të vitit dhe për rrjedhojë, nuk patur fare shpenzime për ushqim si dhe shpenzimet e tjera kanë qënë pothuajse të parëndësishme.

Për vitin 2016 në analizën financiare unë dal me bilanc pozitiv sipas Komisionit por jam nxjerrë me një bilanc negativ rreth 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë, lidhur me mundësinë për të blerë automjetin Mercedes Benz këtë vit.

Korigjimi i analizës financiare ka rëndësi pasi edhe po të mos merren fare parasysh argumentimet e mia pse ky bilanc negativ nuk qëndron, (*dhe që do t'i shpreh në vijim të ankimit, në pjesën e titulluar kriteri i pasurisë*), prapë se prapë mjafton bazueshmëria e shkakut të ankimit që unë po parashtroj përpara Kolegjit, për t'a zeruar fare këtë bilanc negativ që sipas Komisionit kam për blerjen e automjetit.

III. Në vendimin e Komisionit nuk jepet asnjë shpjegim i arsyetuar se përse në analizën financiare të vitit 2008 nuk janë gjetur të bazuara shpjegimet e mia se "*për këtë vit, për shkak të shtatzanisë së vështirë të bashkëshortes time si dhe pas lehonisë, ajo (së bashku me bebin), ka qëndruar periudha të gjata kohe në shtëpinë e nënës së saj, nën përkujdesjen e kësaj të fundit, pra shpenzimet (për ushqim) kanë qënë minimale*". Në këtë pikë konstatohet se ***mungon arsyetimi*** në vendimin e Komisionit, dhe për më tepër Komisioni si gjatë hetimit administrativ ashtu edhe në seancë dëgjimore, më ka pamundësuar edhe thirrjen e vjehrrës time si dëshmitare si dhe të dëshmitarëve të tjerë, (që kanë përgjegjësi për dëshmitë që do të jepnin pasi do të ishin nën betim), për t'a vërtetuar një fakt të tillë.

Vetëm nga një shkelje e tillë Komisioni më ka rënduar padrejtësisht analizën financiare të vitit 2008, me të paktën 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Pra procesi i rregullt ligjor është dëmtuar nga Komisioni, fillimisht përmes pamundësimit tim për të paraqitur prova me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimin dhe në vijim përmes hedhjes poshtë në vendim, të argumentimit tim, pa ndonjë arsyetim të shprehur. Kjo mënyrë veprimi nga Komisioni nuk është në pajtim me standartin e objektivitetit dhe është në kundërshtim me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në themel të të cilës qëndron standarti gjykim i drejtë. Për të patur gjykim të drejtë, duhen plotësuar në mënyrë kumulative dy kushte që janë, 1. Krijimi i mundësisë për të paraqitur prova. 2. Arsyetimi i vendimit lidhur me bazueshmërinë apo jo të pretendimit.

I kërkoj Kolegjit që në lidhje me këtë shkak ankimi ose të konsiderojë si të bazuar pretendimin tim pasi për këtë mund të shërbejnë si prova deklarimet që kam bërë në ILDKPKI në vitin 2015, (*shih memon dhe deklarimet e bëra në këtë vit prej meje në ILDKPKI sipas nenit 27 të ligjit Nr .9049, date 10.4.2003*[32]) dhe në përgjigjet e pyetësorëve, ose në rast se këto prova konsiderohen të pamjaftueshme të riçelë hetimin gjyqësor dhe të marrë prova me dëshmitarë nën betim (në seancë publike) duke pyetur vjehrrën time Flutura Hallunovi, kunatin tim Ardit Hallunovi, bashkëshorten time Arlinda Ymeri (Hallunovi).

IV. Në vendimin e Komisionit nuk jepet asnjë shpjegim i arsyetuar se përse në analizën financiare të vitit 2012 nuk janë gjetur të bazuara shpjegimet e mia se "*Lidhur me shpenzimet e udhëtimit në Itali në muajin prill 2012, ato janë mbuluar nga djali i xhaxhait tim Olsi Ymeri..., etj*[33]". Në këtë pikë konstatohet se ***mungon arsyetimi*** në vendimin e Komisionit. Edhe në këtë pikë, kjo mënyrë veprimi nga Komisioni nuk është në pajtim me standartin e objektivitetit dhe është në kundërshtim me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor lidhur me detyrimin e arsyetimit të vendimit.

I kërkoj Kolegjit që në lidhje me këtë shkak ankimi të korigjojë analizën financiare duke zbritur nga bilanci negativ vlerat favorizuese për mua, përkatësisht 500 euro që m'i ka dhuruar djali i djaxhait dhe shpenzimet e banimit dhe ushqimit për 4 ditë të mia dhe të bashkëshortes. Një gjë e tillë ka rëndësi jo vetëm për nxjerrjen e bilancit kumulativ vjetor por edhe për analizën e blerjes së bonos së thesarit të muajit korrik 2012.

Të gjitha shkeljet e mësipërme, e bëjnë të nevojshme riçeljen e hetimit gjyqësor nga Kolegji, kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, bërjen e një analize të re financiare nga Kolegji, njoftimin tim lidhur me të sipas rregullave të kontradiktoritetit, si dhe në përfundim reflektimin e rezultateve në vendimin përfundimtar që do të marrë Kolegji. Jam absolutisht i sigurtë që bilanci negativ akumulativ prej 1.800.000 (njëmilion e tëtëqindmijë) lekë që më ngarkon padrejtësisht Komisioni në vendimin e tij, do të zvogëlohet në mënyrë domethënëse ***goftë edhe vetëm nga riparimi i këtyre shkeljeve***, përveçse edhe nga marrja parasysh nga Kolegji edhe të shpjegimeve/shkaqeve/fakteve dhe provave të tjera të cilat do t'i pasqyroj më hollësisht në pjesën që vijon të ankimit ku do marr në analizë në mënyrë të hollësishme kriterin e pasurisë time.

Këtu dua të sqaroj një pavërtetësi tjetër që shkruan Komisioni në vendim.

Komisioni thotë të pavërtetën kur në paragrafin 60 të vendimit shprehet se unë e paskam pranuar vetë që për periudhën 2003-2016, paskam një bilanc negativ akumulativ prej 1,536,333 lekë. Këtu ***përfshihet*** edhe periudha 2008-2016, që sipas analizës time financiare ka një bilanc negativ rreth 700.000 lekë, (ndërsa sipas komisionit 1.800.000 lekë).

[32] Në nenin 27 të Ligjit 9094, datë 10.04.2003 (i ndryshuar), i titulluar "Korrigjimi i gabimeve në deklarim", parashikohet se: *Kur gjate kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë te sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Larte ose ai i ulet thërret subjektin për te dhënë shpjegime te hollësishme dhe argumentet përkatëse, te cilat paraqiten kurdoherë me shkrim.*

[33] Më hollësisht shih shpjegimet që kam parashtruar unë në materialin e titulluar Memo-KPK-Shkodra dhe në përgjigjen e pyetësorit të trete kur jam pyetur për bonot e thesarit.

Besoj se Kolegji e di që edhe gjysëm e vërteta është e pavërtetë. Komisioni nuk më citon plotësisht në vendim. Kjo bëhet me qëllim dashakeq për të krijuar paqartësi.

Për t'i shpjeguar shkurtimit Kolegjit të vërtetën e plotë, paraprakisht evidentoj se Komisioni e ka gjetur të drejtë pretendimin tim se analiza financiare e imja duhet bërë në dy periudha që janë:

i. 2003-2007, (kohë kur kam jetuar me familjen time të origjinës),
ii. 2008-2016 (kohë kur kam krijuar familjen time të re).

Në shpjegimet dhe analizat financiare që kam paraqitur gjatë hetimit administrativ, (në ëord dhe në exel), i kam shpjeguar qartë Komisionit se për periudhën 2003-2007, rezultoj me një bilanc negativ kumulativ rreth 800.000 lekë (e rrumbullakosur për lehtësi të shkrimit dhe arsyetimit) ndërsa për periudhën 2008-2016, rezultoj me një bilanc negativ kumulativ rreth 700.000 lekë, dhe të dyja periudhat bashkë bëjnë 1,536,333 lekë. Kjo sipas analizës së bërë nga unë vetë.

Por ky bilanc negativ akumulativ që rezulton nga analiza ime financiare nuk është real, (fakt që ia kam shpjeguar Komisionit), për shkaqet e mëposhtme:

Shkaku i parë. Balancat negative ndërmjet viteve (2007, 2010 dhe 2011) nuk janë rredhojë e mungesave të likuiditetit por janë shkaktuar nga pasaktësitë e mia në raportimet/deklarimet vjetore. (Kjo do sqarohet hollësisht në vijim të ankimit tek kriteri i pasurisë por përmbledhtas por shumë shkurt këtu sqaroj se:
i. *Për periudhëm 2003-2007, balanca negative sipas meje i referohet vetëm vitit 2007 por kjo ka ndodhur për shkak se në DPV 2007, kam deklaruar si të ardhur rreth 800.000 lekë që nëna ime i ka fituar si dëmshpërblim nga një vendim gjyqësor por këto të ardhura ajo nuk i ka fituar në vitin 2007 por në janar 2008, ndërkohë që unë DPV 2007 ku e kam bërë këtë deklarim, e kam plotësuar në mars 2008, pra gabimi im ka ardhur nga ngatërresa në kohën e deklarimit/raportimit,*
ndërsa
ii. *Për periudhën 2008-2016, balancat negative i referohen viteve 2010 dhe 2011, ku përsëri kam bërë gabime në deklarim pasi jam ngatërruar në johën deklarimin e kursimeve të mbaruara nga viti 2009 (që ka sjellë si pasojë balancën negative në vitin 2010) si dhe jam ngatërruar në deklarimin si të ardhur dhe kursim në shumën 750.000 lekë në DPV 2011, të një kredie 800.000 lekë që në fakt e kam marrë në janar 2012, ndërkohë që unë DPV 2011 ku e kam bërë këtë deklarim të gabuar, e kam plotësuar në mars 2012, pra gabimi im ka ardhur prapë (si në rastin e mësiupërm) nga ngatërresa në kohën e deklarimit/raportimit*.
iii. *Vetë fakti që dy vitet e vetme në periudhën 2008-2016 që rezultojnë këto balanca negative (në analizën e bërë nga unë), janë vitet 2010 dhe 2011, por këto vite rrethohen nga vite që kanë ndjeshëm balanca pozitive, (2009 dhe 2012), pra fakti që balanca pozitive e vitit 2009 e tejkalon balancën negative të vitit 2010, ndërsa balanca pozitive e vitit 2012 e tejkaloj balancën negative të vitit 2011, tregon se këto balanca negative nuk janë rrjedhojë e mangësive në likuiditet por janë rrjedhojë e pasaktësive dhe gabimeve kohore në deklarim/raportim*.

Shkaku i dytë. Për balancat negative të viteve 2003-2007 nuk mund të ngarkohem unë me përgjegjësi pasi: ***i.*** unë në kohën e përpilimit të dekleratës veting, në vitin 2016 nuk kam përfituar

në pronësi dhe as kam patur në përdorim, ndonjë pasuri nga familja ime e origjinës që të jetë fituar nga kjo e fundit në vitin 2007 vit në të cilin rezulton kjo balancë negative. ***ii***. Prindërit dhe vëllai im nuk kanë qënë ndonjëherë subjekte deklaruese dhe nuk mund të ngarkohem unë me përgjegjësi për balancën negative të vitit 2007, aq më tepër që nuk kam qënë unë kryefamiljar dhe të jem kujdesur unë për administrimin e të ardhurave të familjes në vitin 2007.

Shkaku i tretë dhe më i rëndësishmi: I kam shpjeguar Komisionit dhe po i shpjegoj edhe një herë Kolegjit se në analizat financiare që kam përgatitur vetë për periudhën 2008-2016, i kam marrë të mirëqëna për shkak të mungesës së kohës dhe mungesës së dijenive/aftësisë financiare të kuptoj/kontrolloj mënyrën se si ka llogaritur Komisioni shpenzimet.

Kjo nuk do të thotë se kam qënë dakort me këtë mënyrë përllogaritjeje për sa kohë kam dhënë shpjegime të qarta lidhur me se si do duhej të më llogariteshin shpenzimet familjare për vitin 2008, 2012 dhe 2016. Pra Komisioni ka patur detyrimin të m'i llogariste këto shpenzime drejtë duke patur parasysh ato që thashë më sipër dhe që e vlerësoj të panevojshme t'i përsëris. Në të kundërt, Komisioni ka patur detyrim që të arsyetonte në vendim se përse kjo mënyrë përllogaritje e pretenduar nga unë lidhur me shpenzimet është e pabazuar.

Tek e fundit, vetëm fakti që:
1- tjetër analizë financiare më është bërë nga ILDKPKI,
2- tjetër analizë financiare më është paraqitur nga komisioni në prill 2022,
3-tjetër analizë financiare më është paraqitur nga komisioni në 31.10.2022,
4-tjetër analizë financiare i kam paraqitur unë komisionit, por që edhe për këtë i jam shprehur komisionit dhe po i shprehem edhe Kolegjit se nuk i ka të llogaritura shpenzimet familjare si duhet, gjë që më penalizon/disfavorizon,
5. të gjitha këto analiza financiare ndryshojnë me njëra - tjetrën.
A nuk çon natyrshëm në përfundimin se Kolegji duhet të bëjë vetë një analizë financiare për të konstatuar drejtë gjendjen e fakteve.

E përsëris edhe një herë, po të marrë parasysh Kolegji shpjegimet e mia lidhur me mënyrën e përllogaritjes së shpenzimeve, analiza ime financiare për vitin 2008-2016 ndryshon në kahun favorizues për mua.

Për rrjedhojë, i kërkoj Kolegjit të ndreqë të gjitha shkeljet e mësipërme në analizën financiare 2008-2016 që më ka bërë Komisioni, lidhur me mosllogaritjen e saktë të tyre, mosarsyetimin e vendimit, etj, pra i kërkoj Kolegjit të riçelë hetimit gjyqësor me qëllim konstatimin e drejtë të fakteve dhe ndreqjen e shkeljeve, kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, bërjen e një analize të re financiare, njoftimin tim lidhur me të sipas rregullave të kontradiktoritetit, si dhe në përfundim reflektimin e rezultateve në vendimin përfundimtar që do të marrë Kolegji.

<u>Së tridhjetë e tre</u>: ***Ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit*** edhe cënimin nga Komisioni të të drejtës time për jetë private dhe familjare të parashikuar nga neni 7 i KEDNj dhe neni 17/2 i Kushtetutës.

Kjo ka ndodhur pasi duke më vlerësuar Komisioni për periudhën 2001-2007, kohë gjatë së cilës kam jetuar me familjen time të origjinës, të gjithë familjen e ka nxjerrë me një bilanc negativ

kumulativ rreth 2.700.000 (dymilion e shtatëqindmijë) lekë, ka bërë gjetjet e tjera lidhur me apartamentin e vitit 2006, etj, dukë dhënë në vendim Komisioni konkluzionet përkatëse.

(Se përse këto vlerësime janë të gabuara e shtjellova në mënyrë të përgjithshme më sipër dhe do t'a shtjelloj hollësisht edhe në vijim të përmbajtjes së ankimit, në pjesën e titulluar "kriteri i figurës").

Shkaku i ankimit lidhur me të drejtën për jetë private dhe familjare ka të bëjë me faktin se Komisioni të "***gjithë përgjegjësinë për bilancet negative referuar kësaj periudhe kohe, m'a ka ngarkuar mua, pa u kujdesur që të zbatojë minimalisht parimin e proporcionalitetit***, (*shih paragrafin 96 të vendimit të GJEDNj Antgoneta Sevdarfi Kundër Shqipërisë*)". Pra, mua më ka bërë përgjegjës edhe për prindërit e mi si dhe për vëllain tim.

Kjo mënyrë veprimi nga Komisioni, i ekspozon si prindërtit e mi dhe vëllain tim Gerti Ymeri ndaj ndjesisë së fajit që unë jam shkarkuar nga detyra e gjyqtarit minimalisht edhe për faj të tyre.

Për rrjedhojë, prindërit e mi dhe vëllai im ekspozohen në sytë e opinionit publik si persona që kanë dëmtuar përkatësisht, të birin e tyre apo vëllain, pra mua.

Kjo padiskutim, veç ndjesisë së fajit, dëmton edhe personalitetin, nderin dhe reputacionin e tyre si qënie njerëzore në sytë e gjithë opinionit publik. E gjitha kjo pa patur mundësi as prindërit dhe as vëllai im që zëri i tyre të dëgjohet si palë në procesin tim të rivlerësimit, pra në procedurën ligjore ku personaliteti, nderi dhe reputacioni i tyre është vënë në diskutim nga Komisioni.

Për shkak të lidhjeve të afërta të gjakut, dëmtimi i personalitetit, nderit dhe reputacionit të prindërve të mi dhe vëllait tim, si qënie njerëzore, më prek edhe mua. ***Veç kësaj ka dëmtuar thelbësisht natyrën e marrëdhënieve personale që si unë, si bashkëshortja ime, kemi me prindërit e mi dhe vëllain tim.*** Arsyeja dihet se përse. Njeriu nuk mund të shoqërizohet me atë që i ka bërë keq.

Ky cënim i padyshimtë i të drejtës time për jetë private dhe familjare, qartazi nuk ka balancë dhe as proporcionalitet me ndonjë qëllim të ligjshëm për realizimin e të cilit prindërit dhe vëllai im, mund të konsiderohen përgjegjës.

Për më tepër cënimi i të drejtës time dhe asaj të afërmve të mi për jetë private dhe familjare, e parashikuar nga neni 7 i GJEDNJ-së është i lidhur ngushtë dhe pazgjithshmërisht edhe me cënimin që n'a është bërë nga Komisioni të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i KEDNj.

Mbi bazën e shkakut të ankimit të ngritur si më sipër, i kërkoj Kolegjit të marrë masat e duhura për ndreqjen e shkeljes së së drejtës kushtetuese në fjalë si për mua ashtu edhe për prindërit dhe vëllain tim.

<u>Së tridhjetë e katërti</u>: Veç sa më sipër lidhur me cënimin nga Komisioni të të drejtës time për jetë private dhe familjare, ***ngre si shkak ankimi përpara Kolegjit***, cënimin e kësaj të drejtë kushtetuese edhe në një aspekt tjetër. Ky aspekt ka të bëjë me motrën time Ajola Prençi (Ymeri).

Sikurse e thashë më sipër, në procesin e rivlerësimit në drejtim të motrës time, prokurore Ajola Prenci, trajtimi i figurës time përbënte një pjesë të konsiderueshme të vlerësimit të figurës së saj, ***dhe praktikisht ishte një prej shkaqeve të vendimmarrjes në dëm të saj***.

Në trupin gjykues të Komisionit që ka kryer rivlerësimin e motrës time, ***komisionere relatore ka qënë Firdes Shuli, që njëkohësisht është anëtare edhe e trupit gjykues të Komisionit që ka kryer procesin tim të rivlerësimit***.

Në aktin "Rezultate te hetimit administrativ", që Komisionerja Firdes Shuli i ka dërguar motrës time[34], në trajtimin në seancën dëgjimore të motrës time, të dhënave që i referohen figurës time[35], si dhe nëpërmjet pasqyrimit të këtyre të dhënave lidhur me figurën time në vendimin e motrës time Ajola Prenci[36], komisionerja Firdes Shuli, (dhe dy koleget e saj Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu), nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë paragjykuar figurën time si dhe ***ç'ka është më e rëndësishmja, kanë krijuar në opinionin publik dhe në sytë e motrës time, perceptimin se unë jam fajtor për shkarkimin e saj nga detyra e prokurores***.

(Se përse kjo mënyrë veprimi është e gabuar dhe e paligjshme, e shtjellova në mënyrë të përgjithshme më sipër dhe do t'a shtjelloj më hollësisht edhe në vijim të përmbajtjes së ankimit, në pjesën e titulluar "ankimi lidhur me vendimin për mospranimin e kërkesës time për përjashtimin e komisioneres Firdes Shuli").

Duke më ekspozuar mua në sytë e në sytë e opinionit publik si person që ka dëmtuar të motrën, pra që unë jam fajtor për shkarkimin si prokurore të motrës time, komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu, kanë dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme të drejtën time për jetë private dhe familjare.

Kjo ka ndodhur pasi veç ndjesisë së fajit që më rëndon padrejtësisht në ndërgjegje përkundrejt motrës time[37], unë tashmë e kam të dëmtuar personalitetin, nderin dhe reputacionin e tim si qënie njerëzore në sytë e gjithë opinionit publik. E gjitha kjo pa patur unë mundësi që zëri i im të dëgjohet si palë në procesin tim të rivlerësimit të motrës time, pra në procedurën ligjore ku personaliteti, nderi dhe reputacioni i im u vu në diskutim nga Komisionerja Firdes Shuli.

---

[34] Këtë raport ia kam paraqitur si provë edhe Komisionit por nuk citohet në vendimin e tij që unë po ankimoj. Për rrjedhojë i kërkoj Kolegjit t'a shohë dhe ta vlerësojë si provë.

[35] I kërkoj koegjit të marrë dhe vlerësojë si provë procesverbalet e transkriptuara të seancës dëgjimore të motrës time Ajola Prrençi.

[36] Këtë raport ia kam paraqitur si provë Komisionit por nuk citohet në vendimin e tij që unë po ankimoj. Për rrjedhojë i kërkoj Kolegjit t'a shohë dhe ta vlerësojë si provë.

[37] Fakti që përmëndja e figurës time në procesin e motrës time, ishte e padrejtë, vërtetohet jo vetëm nga pikpamja procedurale, por gjithashtu edhe nga pikpamja material/substanciale. Kjo pasi sikurse rezultoi nga procesi im i rivlerësimit, unë nuk u shkarkova nga Komisioni referuar kriterit të figurës, pasi vetë Komisioni në vendimin e tij thotë se gjetjet referuar këtij kriteri janë të pamjaftueshme për penalizimin tim sipas ligjit 84/2016. Pra indirekt, provohet se komisionerja relatore Firdes Shuli (dhe koleget e saj Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu, kanë shpifur ndaj meje në procesin e motrës time Ajola Prençi.

Pas këtij dëmtimi fillestar, pjesmarrja e komisioneres Firdes Shuli edhe në procesin tim të rivlerësimit, përveçse përbënte haptaz tregues paragjykimi të saj përkundrejt meje, tregonte gjithashtu edhe që komisionere nuk e plotësonte tashmë standartin e gjykatës së paanshme.

Për shkak të lidhjeve të afërta të gjakut, që kam unë me motrën time, dëmtimi i personalitetit, nderit dhe reputacionit tim prek edhe atë si dhe anasjelltas.

Ky cënim i dyanshëm, i imi si dhe i motrës time, ka dëmtuar thelbësisht natyrën e marrëdhënieve personale që si unë dhe ajo kemi me njëri tjetrin.

Arsyeja dihet se përse. Njeriu nuk mund të shoqërizohet me atë që i ka bërë keq ose me atë përkundrejt të cilit ka në ndërgjegje, ndjesinë e fajit që i ka bërë keq.

Ky cënim i padyshimtë i të drejtës time për jetë private dhe familjare, qartazi nuk ka balancë dhe as proporcionalitet me ndonjë qëllim të ligjshëm për realizimin e të cilit unë mund të konsiderohen përgjegjës në procesin e rivlerësimit të motrës time Ajola Prençi.

Fakti që përmëndja e figurës time në procesin e rivlerësimit të motrës time, nuk kishte asnjë qëllim të ligjshëm dhe aq më pak objektiv dhe/apo proporcional, vërtetohet më së miri nga vendimi i marrë nga Komisioni në procesin e rivlerësimit të motrës time. Në këtë vendim vetë Komisioni shprehet se analizimi i figurës time në procesin e rivlerësimit të motrës time, "***ishte i panevojshëm, pasi subjekti Andri Ymeri është vetë subjekt rivlerësimi dhe për rrjedhojë do të përgjigjet vetë***".

Atëherë, përderisa përmëndja e figurës time në procesin e rivlerësimit të motrës time ***paska qënë fakt i panevojshëm***, gjë që e pranon vetë komisionerja Firdes Shuli, - ***përse u përmënda*** !!!?

<u>Përgjigjja dihet tashmë: Për të më diskretituar publikisht dhe paligjshmërisht, pa ekzistuar nevoja e asnjë qëllimi të ligjshëm që të ketë proporcionalitet me pasojën e ardhur</u>.

Pra, vërtetohet qartë se më është cënuar e drejta për jetë private dhe familjare, minimalisht nga Komisionerja Firdes Shuli (por edhe nga dy koleget e saj që përbënin trupin gjykues të procesit të rivlerësimit të motrës time).
Për më tepër cënimi i të drejtës time për jetë private dhe familjare, e parashikuar nga neni 7 i GJEDNJ-së, është i lidhur ngushtë dhe pazgjithshmërisht edhe me cënimin që më është bërë gjithashtu nga këta Komisionerë, në të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i KEDNj.

Kjo pasi jam gjykuar dhe ndëshkuar në procesin e motrës time, pa m'u dhënë e drejta as të mbrohem, as të dëgjohem dhe aq më pak të paraqes prova shfajësuese apo të jap opinionin tim lidhur me mënyrën se si do duhej të përfundonte procesi ligjor i rivlerësimit të motrës time, gjatë së cilit, në mënyrë të paautorizuar nga ligji dhe pa asnjë arsye objektive dhe qëllim proporcional, u vu në diskutim edhe personaliteti, nderi dhe reputacioni im.

Mbi bazën e shkakut të ankimit të ngritur si më sipër, i kërkoj Kolegjit të marrë masat e duhura për ndreqjen e shkeljes së së drejtës kushtetuese në fjalë si për mua ashtu edhe për motrën time.

Së tridhjetë e pesti: ***Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,***

Në përmbyllje dhe përmbledhje të shkaqeve të ankimit të evidentuara më sipër, vlerësoj se në procesin tim të rivlerësimit të kryer nga Komisioni, më janë shkekur njëherazi disa të drejta konventore dhe kushtetuese themelore që ka çdo qënie njerëzore. Këto të drejta themelore te njeriut janë si më poshtë:

1. E drejta për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ç'njerëzor apo poshtërues, (***neni 3 i KEDNj***).
2. E drejta për një proces të rregullt ligjor në standartet **i.** Gjykatë e krijuar me ligj. **ii.** Gjykatë e paanshme. **iii.** Gjykatë e pavarur[38]. **iv.** Gjykim i drejtë. **v.** Gjykim brënda një kohëzgjatjeje të arsyeshme[39], (***neni 6/1 i KEDNj***). Të gjitha këto standarte janë shkelur njëherazi edhe veç e veç edhe së bashku.
3. E drejta për jetë private dhe familjare, (***neni 7 i KEDNj***).
4. E drejta për një ankim efektiv[40], (***neni 13 i KEDNj***).
5. E drejta për të mos iu nënshtruar diskriminimit dhe trajtimit të barabartë, (***neni 14 i KEDNj***).

Është detyrë e Kolegjit që përmes vlerësimit të tij, të riparojë shkeljet e lartëpërmëndura që i janë bërë nga Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit të drejtave të mia themelore njerëzore.

[38] Ky standart kushtetues më është shkelur pasi sikurse pranohet nga vetë vendimi i Komisionit dhe sikurse do të vihet re në vijim të ankimit, në pjesën e titulluar "shorti special", unë jam përfshirë në shortin special të datës 15.12.2019 të KPK-së, (së bashku me motrën time Ajola Prençi). Pavarësisht se unë kërkova disa herë nga KPK, informacion nga KPK, mbi arsyet/shkaqet objektive përse unë isha diferencuar/dalluar nga subjektet e tjerë të rivlerësimit që nuk ishin përfshirë në këtë short special, duke u shortuar përpara këtyre të fundit dhe me përparësi, ky informacion nuk m'u treguas asnjëherë. Madje nuk m'u referuar as baza ligjore m'bi bazën e të cilës nuk më lejohej/kufizohej marrja e këtij informacioni. Kjo tregon se komisionerët që më kanë përfshirë në këtë short special (dhe veçanarisht komisionerja Genta Bungo që në kohën kur është zhvilluar shorti ka qënë Kryetare e KPK-së, dhe sikurse rezulton nga procesverbali i këtij shorti, është ajo që ka organizuar këtë short), nuk plotësojnë standartin e një Gjykatë të pavarur. Kjo pasi ata qartësisht janë nën ndikimin e subjekteve të jashtme të cilat përderisa kanë karakter misterioz, është e arsyeshme të supozohen se veprojnë me qëllim jo në përputhje me parimet e drejtësisë dhe ligjshmërisë. (*Kërkoj Nga Kolegji të shohë, administrojë dhe vlerësojë si provë në funksion të vërtetimit të shkeljes së pretenduar nga unë të standarit "gjykatë e pavarur", procesverbalin e KPK, të paraqitur si provë nga unë në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, bashkalidhur kërkesës me shkrim për të marrë informacion lidhur me të ashtuquajturin short special*).

[39] Ky standart kushtetues më është shkelur pasi sikurse rezulton nga procesverbalet e seancave 13.06.2022, 12.12.2022, 13.12.2022, nuk më është respektuar afati 3 ditor I parashikuar në nenit 74 të KPCivile, për të paraqitur me shkrim kërkesat për përjashtimin me shkrim të komisionerëve si dhe provat përkatëse.

[40] Kjo e drejtë kushtetuese më është shkelur nga KPK, pasi figura ime është gjykuar dhe dënuar në procesin e rivlerësimit të motrës time, pa m'u garantuar ndonjë e drejtë efektive për t'u ankuar ndaj gjykimit dhe dënimit në këtë proces. Për këtë shkelje është veçanarisht përgjegjëse komisionerja Firdes Shuli, që ka qënë komisionerja relatore e trupit gjykues të KPK në procesin e rivlerësimit të motrës time, pra ajo që ka hartuar raportin për rezultatet e hetimit administrativ që i është dërguar motrës time, që e ka lexuar këtë raport në seancën dëgjimore të motrës time si dhe komisionerja përgjegjëse për arsyetimin e vendimit të motrës time, ku në shkelje të ligjit është përmendur edhe figura e personit tim.

PJESA E DYTË

Kriteri i pasurisë.

Në lidhje me vlerësimet që Komisioni ka bërë për pasurinë, bazuar në nenet 30-33 të ligjit 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga ana e tij konkludohet se unë kam bërë deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me këto pasuri:

a. Apartament banimi, me sip.111 m2, me nr. pasurie 4/540+4-8, Zk 8593, vol. 23, fq. 193, me adresë: Njësia Administrative qyteti Shkodër, Bashkia Shkodër, L."Vasil Shanto", Rr. "At Gjergj Fishta", pallati pranë Kishës së Fretërve, kati i katërt, apartamenti nr.40, në pronësi të babait tim Faik Ymeri.
b. Toka bujqësore, në pronësi të anëtarëve te familjes bujqësore Faik, Elvira, Andri, Ajola dhe Gerti Ymeri, në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga dhënia me qera e saj.
c. Shpenzimet e mobilimit të apartamentit të sipërpermendur.
d. Automjeti me targë AA 993 NZ në pronësinë time dhe bashkëshortes.
e. Automjeti Autoveturë, Marka Ford Focus, me targa AA591, në pronësinë e vëllait tim Gerti Ymeri.
f. Bonot e thesarit për vitet 2009-2012, në pronësinë time dhe bashkëshortes.
g. Apartament banimit me adresë"L. "Vasil Shanto", Bulevardi "Zogu i Parë", Pall 968, Shkodër, në pronësi të babait tim Faik Ymeri.

Duke i konsideruar konkluzionet e Komisionit në lidhje me të gjitha këto pasuri të miat dhe familjarëve të mi, plotësisht të gabuara, rrjedhojë e mosnjohjes së burimeve të ligjshme të të ardhurave të mia dhe të afërmve të mi, në cënim të parimeve të objektivitetit, ligjshmërisë, barazisë, proporcionalitetit, Ju bëj me dije paraprakisht se unë nuk jam dakort me këto përfundime.

Më poshtë do të bëj trajtimin e vecantë të çdo konstatimi të Komisionit, për secilën nga këto pasuri dhe burimeve të ardhurash, duke evidentuar shkaqet ligjore dhe faktike mbi të cilat do të rezultojë qartë se konkluzionet e Komisionit janë jo të drejta dhe të aritura me qëllim justifikimin e një vendimarrje të paracaktuar më parë për personit tim, atë të shkarkimit tim nga detyra.

a. **Apartament banimi, me sip.111 m2, me nr. pasurie 4/540+4-8, Zk 8593, vol. 23, fq. 193, me adresë: Njësia Administrative qyteti Shkodër, Bashkia Shkodër, L."Vasil Shanto", Rr. "At Gjergj Fishta", pallati pranë Kishës së Fretërve, kati i katërt, apartamenti nr.40, në pronësi të babait tim Faik Ymeri.**

Shpjegoj se në lidhje me këtë pasuri unë kam dhënë vazhdimisht deklarime që fillojnë që me pasqyrimin e saj në DPV e vitit 2006, DPV në vijim, në memot e viteve 2009, 2011, 2015 që i kam dërguar ILDKPKI, në Deklaratën Vetting, si dhe në pergjigjet e pyetësorëve, gjatë procesit administrativ në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Në të gjithë këto akte kam shpjeguar se pasuria në fjalë është rregjistruar në pronësi të babait tim, si një pronë e blerë me kontributin e të gjithë anëtarëve të familjes time të origjinës, përpara se unë të martohesha (shpjegime më të hollësishme do të jap më poshtë). Kjo pasuri nuk është në

pronësinë time, pavarisht faktit se unë pretendoj të drejta bashkëpronësie në lidhje me të, për shkak të kontributit që kam dhënë në blerjen e saj dhe lidhjes në gjini me pronarin ligjor të saj.

Për blerjen e kësaj pasurie nga babai im ka lidhur dy kontrata me firmën sipërmarrëse dhe konkretisht:

- ***a-*** *Kontratën e sipërmarrjes, me nr. rep. 483, nr. kol 181, e redaktuar me datën 10.04.2006 përpara noteres Odeta Adnan Kërxhaliu, anëtare e Dhomës së Noterisë Shkodër, ndërmjet palëve: Sipërmarres shoqëria "SKY 05 construction" sh.p.k, me administrator shtetasin Leonard Lulaj, dhe porositës Faik Ymeri, me objekt, porositjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe tërësore 123 m², nga të cilat 111 m² sipërfaqe funksionale, ndërsa pjesa tjetër, ambiente të përbashkëta, (sipërfaqe oborri, shkallësh, ashensori, etj). Vlera që ka paguar porositësi për këtë apartament, ka qenë 3.936.000 leke dhe është likuiduar tërësisht në kohën e lidhjes së kontratës.*
- ***b-*** *Kontratë shitblerjeje, me nr. rep. 900, nr. kol 288, e redaktuar me datën 30.04.2007 përpara noteres Odeta Adnan Kërxhaliu, anëtare e Dhomës së Noterisë Shkodër, ndërmjet palëve: Shitës shoqëria "SKY 05 construction" sh.p.k, me administrator shtetasin Leonard Lulaj, dhe blerës Faik Ymeri, me objekt, blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe funksionale 111 m² sipërfaqe, pa u përmendur ambientet e përbashkëta, (sipërfaqe oborri, shkallësh, ashensori, etj). Vlera e sendit ne kontratë është përcaktuar 3.552.000 lekë dhe ka qenë e likuiduar që në kohën e e lidhjes se kontratës së sipërmarrjes. Aktualisht Faik Ymeri në bazë të kontratës së sipërmarrjes, është bashkëpronar edhe mbi sipërfaqen prej 12 m², sipërfaqe e përbashket sipërfaqe oborri, shkallësh, ashensori, etj), ndonëse pala sipërmarrese, akoma nuk ia ka rregjistruar bashkëpronesinë mbi këtë pjesë të pasurisë, por ne çmuarjen time, kjo bashkëpronesi prezumohet në baze të ligjit, pasi në këtë rast bëhet fjalë për "bashkëpronesi në tërësi"*

1. Në lidhje me cmimin e blerjes së këtij apartamentit Komisioni, në pikën 35.3 të vendimit arrin në këto konkluzione: ***"Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit Komisioni vlerëson se përgjigjet e tij në lidhje me gabimin e kryer nga noterja në përcaktimin e sipërfaqes së apartamentit në kontratë mbeten në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka arritur të shpjegojë binshëm arsyet e cmimeve të ndryshme në lidhje me këtë apartament. Komisioni cmon se subjekti nuk ka pasqyruar saktesisht cmimin e blerjes së kësaj pasurie, duke e vlerësuar këtë defekt në peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementët e tij".***

Arritja në një konkluzion të tillë nga ana e Komisionit është tërësisht e gabuar. Ashtu sic e shpjegova edhe më sipër, sqaruar kjo që në përgjigjet e pyetësorit të dytë, unë kam deklaruar se *"çmimi që është paguar për blerjen e apartamentit, është ai i shprehur në kontratën e sipërmarrjes dhe jo ai i shprehur në kontratën e shitjes. Mospërputhja në çmim, rezulton nga fakti se pala sipërmarrëse, për arsyet e saj, nuk ka përfshirë në çmim, vleftën e sipërfaqes së përbashkët, (ashtu sikurse ka vepruar edhe me vetë sipërfaqen e apartamentit, ku ndonëse në kontratën e sipërmarrjes, rezulton se pjesë e apartamentit dhe e vleftës së paguar, është edhe sipërfaqja e përbashkët, e shkallëve, ashensorit, pra ajo që sipas Kodit Civil, përfshihet në bashkëpronësinë në tërësi, në kontratën e shitblerjes, nuk ka një përcaktim të tillë).*

Këtu sqaroj se fakti që kjo shumë është paguar me një këst të vetëm, në prani të noterit, rezulton nga vetë përmbajtja e kontratës së sipërmarrjes, pika 3.1. Kjo kontratë noteriale është akt zyrtar me fuqi të plotë provuese sipas nenit 253 të KPC). Po kështu, kjo figuron edhe nga vetë kontrata e shitblerjes, në përmbajtjen e të cilës gjendet përcaktimi se çmimi është likuiduar më parë, jashtë kësaj zyre noteriale, pika 4.2. Po kjo provohet edhe nga fakti që është i njëti noter që ka redaktuar si kontratën e sipërmarrjes ashtu edhe atë të shitjes"

Nga këto shpjegime, të cilave u kam qëndruar gjatë gjithë procesit të rivlersimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, rezulton qartë se cmimi i blerjes së apartamentit nga babai im është 3.936.000 leke dhe se ndryshimi i këtij cmimi me atë të shënuar në kontratën e shitblerjes së datës 30.04.2007 është rrjedhojë e faktit se firma në kontratën e shitblerjes nuk ka përfshirë sipërfaqet e përbashkëta.

Ky pretendim i imi rezulton qartë edhe në ndryshimin që ka pasqyrimi i sipërfaqes së apartamentit në mes kontratave, ku në kontratën e sipërmarrjes kjo sipërfaqe është me e madhe, për shkak të përfshirjes së këtyre sipërfaqeve.

Shpjegoj gjithashtu se në aktin "Rezultatet e hetimit administrativ" Komisioni më ka ngarkuar barrë prove për të sqaruar ndryshimet e cmimeve në kontrata (gjë që e kisha bërë më parë) dhe njëkohsisht më ka kërkuar shpjegime në lidhje me konkluzionin e tij se cmimi i blerjes së apartamentit, bazuar në sipërfaqen e tij duhet të ishte 4,224,000 lekë.

Duke vlerësuar shpjegimet që unë kam dhënë në lidhje me këtë barrë prove, duke evidentuar edhe dy ndryshimet e cmimeve në kontratat e sipërmarrjes dhe shitblerjes, Komisioni është munduar të pasqyrojë si të pavërteta shpjegimet e mia, duke hedhur "hije dyshimi" mbi vlerën reale të cmimit të apartamentit të blerë nga babai im.

Mendoj se kjo linjë arsyetimi e ndjekur nga Komisionit është tërësisht e padrejtë dhe dashakeqe, e cila pasqyron qartazi qëllimin që kanë patur anëtaret e Komisionit për të krijuar bindjen se unë nuk kam treguar të vërtetën në lidhje me rrethanat që lidhen më pasuritë në pronësi apo në përdorimin tim, një prej të cilave sipas tyre është edhe cmimi i blerjes së apartamentit ku unë jetoj.

E vërteta është se unë në asnjë moment nuk kam deklaruar se cmimi i blerjes së apartamentit është 4,224,000 lekë. Në përgjigjet që kam dhënë në lidhje me këtë "barrë prove" me të cilën Komisioni më ngarkoi në përfundim të hetimit administrativ, kam shpjeguar se ky cmim, i cili theksoj se është rrjedhojë e vlerësimit të vetë Komisionit, mund te jetë rrjedhojë e *"Llogaritjes së cmimit nga raporti siperfaqe-cmim për m2 dhe i referohet sipërfaqes së apartamentit të shënuar në kontratën e sipërmarrjes të datë 10.04.2006, në nenin 1 të saj, ku gabimisht noterja ka shënuar si sipërfaqe të apartamentit sipërfaqen 132 m2. Ndërkohë sipërfaqja e banimit e apartamentit në fjalë është 123 m2 llogaritur me sipërfaqe të përbashkëta dhe 111 m2 sipërfaqe funksionale. Sic unë do t'a shpjegoj në vijim sipërfaqja për të cilën është bërë pagësa e blerjes nga babai im është ajo që përfshin edhe ambjentet e përbashkëta, me 123 m2.".*

Edhe në këto shpjegime unë kam ritheksuar dhe vijoj të ritheksoj se cmimi që është paguar për blerjen e apartamentit, është ai i shprehur në kontratën e sipërmarrjes 3.936.000 leke

dhe jo ai i shprehur në kontratën e shitjes 3.552.000 lekë dhe as cmimi që padrejtësisht ka tentuar të më atribuojë Komisioni është 4,224,000 lekë.

Duket qartë që nëpërmjet këtyre "lojrave fjalësh" Komisioni ka tentuar të hedhë hije dyshimi për vërtetësinë e deklarimeve të mia, duke shtuar në këtë drejtim faktin se vetë Komisioni në analizën financiare që më ka bërë ka llogaritur si cmim të blerjes së apartamentit atë që rezulton nga kontrata e sipërmarrjes 3.936.000 leke dhe nuk ka marrë në konsideratë cmimin e shënuar në kontratën e shitblerjes dhe as ndonjë cmim tjetër.

Theksoj se për sqarimin e paqartësive në këtë drejtim, ka qenë detyrë e Komisionit që në funksion të dhënies së një vendimit bazuar në parimet e objektivitetit dhe ligjshmërisë[41] të kryej verifikimet e nevojshme bazuar në detyrimet e përcaktuara me nenin 49 të ligjit 84/2016 i cili parashikon:

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelimit ka të drejtë:
a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2, të këtij ligji;
b) të mbledhë deklarata nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku;
c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj ose dokumenteve të marra nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
ç) të këqyrë dhe të kontrollojë sende të luajtshme ose të paluajtshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

Vlerësuar në këndvështrim të kësaj dispozite Komisioni kishte detyrim /të drejtën të bënte këqyrje në vend për të evidentuar se cila është sipërfaqja faktike e banesës ku unë jetoj, në bazë të kësaj sipërfaqe të nxirrte cmimin e apartamentit bazuar në raportin sipërfaqe-cmim për metër katror, dhe në këtë drejtim të sqarojë faktin nëse shpjegimet e mia ishin të vërteta apo jo.

Theksoj se në këtë drejtim Komisioni ka praktikë zbatimi, ku gjej me vend te evidentoj procedurën administrative që ai ka ndjekur në lidhje me motrën time, prokuroren Ajola Prenci në përbërjen e së cilës Komisioni kishte edhe një anëtare të Komisionit tim, Firdes Shuli, ku komisioni për të verifikuar vërtetësinë e shpjegimeve të saj për ekzistencën e një deklaratë noteriale ka bërë këqyrje ne vend dhe konkretisht në zyrën e noteres që kishte hartuar këtë akt (ku natyrisht rezultoi se shpjegimet e motrës time ishin të vërteta).

Vlerësuar në këtë këndvështrim, në zbatim të parimeve të përcaktuara në nenin 52 të ligjit 84.2014 Komisioni kishte detyrimin e verifikimit të pretendimeve të mia, për të mos lënë shteg për aludime, të cilat qartazi në thelb i shërbejnë vetëm qëllimeve të paligjshme të Komisioni.

Nëse Komisioni do të kryente këtë verifikim, pra konstatimin e sipërfaqes së objektit (përfshi dhe sipërfaqet e përbashkëta) të llogaritura në raport më cmimin për m2 që rezulton në akte 32.000 lekë m2, rezulton qartë se vlera e blerjes së apartamentit nga babai im është 3.936.000 leke dhe kurrsesi nuk mund te jetë vlera me të cilën Komisioni ka tentuar të më konfondojë 4,224,000 lekë.

[41] *Neni 52 i ligit 84/2016: " 1. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit.*

Nga ana tjetër për të sqaruar të gjitha pretendimet e mia, që në fillim të procedurave administrative në ngarkimin tim, por edhe në seancën dëgjimore unë kam kërkuar pyetjen me cilësinë e deshmitarit të administratorit të shoqërisë "SKY 05 Construksion" shpk, me të cilën babai im ka lidhur këto kontrata dhe konkretisht shtetasit Leonard Lulaj. Në lidhje me këtë pretendim timin Komisioni e ka konsideruar këtë provë si "të panevojshme" vendim që në vlerësimin tim duhet t'a bënte të ezauruar "barrën e provës" me të cilën më parë më kishte ngarkuar Komisioni.

Ky konkluzion me të cilën Komisioni del me vendim përfundimtar jo vetëm që është në kundërshtim të hapur me vendimarrjen e tij për mosmarrjen e kësaj prove, por vlersuar me të gjitha rrethanat që citova me lart është pasqyrë e hapur e përpjekjeve të Komisionit për të pasqyruar sa më shumë "fakte të dyshimta" në ngarkimin tim, të cilat do të legjitimonin vendimin që ata morën në vijim, në dëm të interesave të mia.

Shtoj gjithashtu se për të vërtetuar shpjegimet e mia në lidhje me cmimin e blerjes së apartamentit nga babai im, që me përgjigjet e pyetësorit të dytë, unë kam dërguar disa kontrata noteriale të lidhura nga e njëjta shoqëri sipërmarrëse me blerës të tjerë. Këto 7 apartamente, ndodhen në të njëjtin pallat ku ndodhet apartamenti ku unë jetoj. Çmimi për m² i secilit prej këtyre apartamenteve është fiks sa çmimi që unë kam deklaruar se babai im e ka blerë apartamentin në fjalë. Vetë ekzistenca e këtyre kontratave tregon se konstatimi i Komisionit në drejtim të personit tim është jo i drejtë.

Fakti që unë kam deklaruar të vërtetën rezulton edhe nga të dhënat që disponin EKB ku konstoja e shfrytëzimit në vitin 2006 (kohë e lidhje se kontratës së sipërmarrjes) është 29.835 lekë m2, që është vlerë më e ulët se 32.000 lekë m2 i blerë nga babai im.

<u>Në përfundim</u> theksoj se konkluzioni i Komisionit se unë nuk kam pasqyruar drejtë cmimin e blerjes së apartamentit nga babai im nuk qëndron dhe është tërësisht i padrejtë.

1.2 Në lidhje me konstatimin e Komisionit***: "Komisioni pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, bazuar në rrethanat faktike dhe nën dritën e përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore të cilat normojnë deklarimin e pasurive, duke marrë në konsideratë (i) analizën e mëposhtme financiare, sipas së cilës subjekti dhe prindërit e tij rezultojnë me pamundësi financiare për blerjen e apartamentit, (ii) të gjithë sjelljen e subjektit në raport me procesin e rivlersimit dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi të trajtuar në mënyrë të detajuar në lidhje me këtë apartament; (iii) sjelljen si pronar i vetëm i këtij apartamenti, përsa kohë e ka përdorur në mënyrë eksluzive, ka deklaruar të drejta bashkëpronësie dhe kontribuar në blerjen e tij, si dhe mbështetur ne jurisprudencën e konsoliduar të KPA, konkludon se subjekti nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas nenit D pikat 1 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, duke kryer fshehje të pasurisë",*** jap këto shpjegime:

Fillimisht sqaroj se pavarsisht konkluzioneve të gabuara të Komisionit, familja ime nuk rezulton në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie. Arritja e këtij konkluzioni nga ana e Komisionit është rrjedhojë e mosnjohjes së burimeve të ligjshme të të ardhurave të familjarëve të mi, të deklaruara nga ana ime që në kohën e plotësimit të DPV 2004, 2005 dhe 2006 dhe të

risqaruara gjatë procesit administrativ në KPK. Të tilla janë të ardhurat e realizuara nga puna si shitës ambulant e babait tim (tregtar me pakicë i fruta perimeve), puna e babait tim si personit fizik me objekt veprimtarie legalizim dokumentash pranë Ministrisë së Jashtme etj, puna si as/avokat dhe avokat e vëllait tim Gerti Ymeri, si dhe të ardhurat nga dhënia me qera e tokës bujqësore në bashkëpronësi të familjes sonë.

Ashtu sic do të shpjegoj edhe në vijim në trajtimin e këtyre burimeve të ligjshme të të ardhurave Komisioni, bën një trajtim të këtyre burimeve në mënyrë të përciptë, pa marrë në konsideratë provat rrethanore të paraqitura nga ana ime, si dhe faktin se këto burime të ardhurash unë i kam deklaruar dnë DPV e kohës, që në kohën e krijimit të tyre.

Po kështu Komisioni nuk i jep përgjigje argumentave të shtruara nga unë, se bazuar në legjislacionin tatimor, në lidhje me këto të ardhura nuk duhet të paguheshin detyrime tatimore. Në lidhje me këto veprimtari tregtare, ashtu sic do t'a trajtoj në vijim unë kam pretenduar dhe vijoj t'i qëndroj këtyre argumentave se për të ardhurat e realizuara nga ato nuk duhet të paguheshin detyrime tatimore. Kjo për shkak të mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë tregtare (shitës ambulant apo person i punësuar pranë një subjekti juridik).

Për më tepër vlerësimi i këtyre burime të ardhurash është bërë nga Komisioni në cënim të hapur të parimit të barazisë, duke trajtuar situatën time tërësisht ndryshe krahasuar me trajtimin që të njëjtët anëtarë të Komisionit kanë bërë me subjekte te tjerë rivlersimi (të cilat do t'i evidentoj më poshtë).

Në lidhje me argumentin e Komisionit se në arritjen e këtij konkluzioni është vlerësuar sjellja ime në raport me procesin e rivlersimit, mendoj se ky përfundim është jo vetëm qesharak por edhe i tillë që nuk mund t'i shërbejë qëllimit për të cilin është përdorur. Nuk e kuptoj se cfare sjellje i referohet Komisioni në momentin kur konkludon se ajo e ka ndihmuar apo ndikuar atë për të arritur në konkluzionin se unë paskam pasuri të fshehur. Natyrisht nuk mund të mendoj që Komisioni ka patur ndonjë pritshmëri se unë do të pranoj cdo tentativë të tij për të më përbaltur padrejtësisht, nëpërmjet pranimit të fakteve të pavërteta, vetëm e vetëm që ata të më konsiderojnë bashkëpunues e të sjellshëm.

Në lidhje me argumentin e Komisionit se unë jam sjellë si pronar në lidhje me këtë pasuri shpjegoj edhe një herë se ai është tërësisht i pavërtetë.

Unë rishpjegoj në mënyrë të përsëritur se apartamenti në fjalë i blerë nga babai im në vitin 2008 nuk është në pronësinë time, edhe pse unë pretendoj të drejta bashkëpronësie mbi këtë apartament, të drejta të cilat nuk i pretendoj në lidhje me pasurinë apartament që babai im ka blerë në vitin 2004. Të drejtat e mia të bashkëpronësisë mbi këtë apartament burojnë nga kontributi im financiar i dhënë për sigurimin e shumës monetare me të cilën është blerë ai. Ashtu sic e kam shpjeguar gjithnjë kjo shumë monetare është siguruar edhe me të ardhura të realizuara nga prindërit e mi dhe vëllai im Gerti Ymeri.

Në kohën e blerjes të këtij apartamenti familja ime e origjinës ishte e pandarë (vec motrës e cila ishte martuar në shtator të vitit 2004) ku në një familje jetonim prindërit e mi, unë dhe vëllai im. Ndodhur në këto kushte, për shkak edhe të ekonomisë të përbashkët dhe traditës për

administrimin e të gjitha të ardhurave monetare nga kryefamiljari, që ishte babai im, kjo pasuri është rregjistruar në emër të tij, pa bërë përcaktimin e pjesëve takuese të secilit kontribues në krijimin e kësaj pasurie.

Nëse ky apartament do të ishte në pronësinë time unë nuk do të kisha asnjë pengesë ligjore ta pasqyroja këtë fakt, përsa kohë unë kam dhënë shpjegime të hollësishme në lidhje me këtë pasuri, duke filluar nga momenti i fitimit të pronësisë nga babai im e në cdo fazë të dhënies të deklarimeve dhe shpjegimeve përpara ILDKPKI.
Kështu në lidhje me këtë pasuri unë kam dhënë shpjegime që më DPV e vitit 2006, ku kam deklaruar: "*Gjatë vitit 2006 janë shtuar të ardhura në para duke arritur shumën e përgjithshme prej 3,300,000 lekë. Kësaj shume i është shtuar dhe shuma prej 700,000 lekë, të cilat janë përdorur për të lidhur një kontratë sipërmarrje për përfitim apartamenti dhe vlera është përafërsisht 4,000,000 lekë. Apartamenti në fjalë do të jetë pasuri e gjithë familjes.....* në rubrikën *Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*, subjekti ka deklaruar; *Marrë borxh Xheladin Thanës 1,500,000 lekë nga Kryefamiljari. Detyrimi është marrë me qëllim blerjen e apartamentit. Afati i shlyerjes së kredisëështë 5 vjet. Shlyerja e detyrimit deri në 31 Dhjetor 2006 është në shumën prej 800,000 lekë dhe detyrimi i mbetur prej 700,000 lekë."*

Pra theksoj se pavarsisht sesi kjo pasuri është rregjistruar ne rregjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të babait tim, unë kam dhënë shpjegime ne lidhje me këtë pasuri, të përdorur nga familja ime, sikur ajo të ishte rregjistruar në pronësinë time, si përsa i përket mënyrës së fitimit të pronësisë ashtu dhe burimeve të krijimit të të ardhurave për blerjen e saj.

Në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni se kjo pasuri është në pronësinë time (ashtu si dhe për të gjitha pronat e familjarëve të mi) arsyetoj sa më poshtë:

Koha është një faktor objektiv, pasi koha është dukuri fizike e përcaktuar përmes shqisave, ndryshe nga dëshira që është kadegori subjektive që nuk perceptohet përmes shqisave. Vetë fakti i kalimit të një kohe prej 16 vitesh nga blerja e apartamentit, gjatë të cilës unë nuk kam kryer asnjë veprim juridik dhe faktik që tregon ushtrim prej meje të të drejtës të disponimit, përbën provë të qartë që unë nuk kam qenë pronar i këtij apartamenti, sikurse shprehet Komisioni. Përkundrazi "dëshira" e Komisionit për të më paraqitur si pronar i vetëm të pasurisë, që sikurse thashë është kadegori subjektive, nuk mbeshtetet në ndonjë provë të aftë për t'a shndërruar këtë dëshirë në një vlerësim objektiv që të jetë i aftë për ta bërë këtë dëshirë të Komisionit në përputhje me standartet e *"gjykimit të drejtë dhe të ndershëm".*

Konkretisht shpjegoj se gjatë 16 viteve nga koha e blerjes së kësaj banesë, nga ana ime nuk është bërë asnjë shtesë te kjo pasuri, nuk janë bërë ndryshme strukturore të brendshme si ndryshime muresh, heqje pllakash etj. Moskryerja e këtyre veprimeve tregon mësëmiri që unë nuk kam qenë pronar i pasurisë, pasi nuk kam ushtruar pushtet faktik disponimi.

Nga ana tjetër në lidhje me këtë pasuri unë nuk kam ushtruar asnjë pushtet juridik disponimi, fakt që rezulton qartësisht bazuar në faktet se: Unë nuk kam bërë asnjë rivlersim të pasurisë për efekt të përfitimit nga legjislacioni fiskal të kësaj pasurie, nuk rezulton që kjo pasuri përgjatë rrjedhës së kohës të jetë ngarkuar me barrë hipotekore, të ketë qenë objekt serivituri, uzufrukti,

nuk është ngarkuar me të të drejta të drejta reale nga të cilat unë mund të përfitoja ndonjë përfitim ekonomik, qoftë edhe indirekt.

Mungesa e këtyre veprimeve juridike pasqyron më së miri se unë nuk kam ushtruar pushtet juridik disponimi mbi këtë pasuri.

Në kushtet që unë nuk kam ushtruar as pushtet faktik dhe as juridik disponimi mbi këtë pronë përgjatë 16 viteve është e qartë që "konkluzioni" që më atribuon mua Komisioni, që kjo pasuri është në pronësinë time, është thjeshtë dëshirë e Komisionit për të hedhur baltë mbi mua, përmes gjetjeve të pabazuara dhe të paprovuara të kësaj natyre, duke patur si qëllim fundor që përmes atribuimit të sa më shumë gjetjeve të kësaj natyre të realizohet dëshira e Komisionit për të krijuar perceptimin e rremë se *"sado që unë të lahem përsëri unë mbetëm pis".*

Në lidhje me këtë konstatim evidentoj se në mënyrë të gabuar Komisionin parashtron disa rrethana, përmbledhja e të cilave sipas tij krijon dyshime se fakti i pretenduar nga unë me deklarime periodike, gjatë hetimit administrativ dhe me përgjigje të raportit përfundimtar, nuk është i vërtetë. Arritja në këtë konkluzion nga ana e Komisionit është e gabuar, pasi jo vetëm që rrethanat mbi të cilat ai bazohet nuk janë të vërteta, por edhe edhe sikur të pranohet se ato janë të vërteta, bashkimi i tyre nuk mundet që kurrsesi të mjaftojë në arritjen e një përfundimi të tillë dashakeqës dhe aspak të vërtetë, që ka si qëllim të "helmojë" figurën time dhe që nuk ka asnjë lidhje me objektivitetin në ushtrimin e detyrës nga ana e Komisionit.

Fakti se prindërit e mi kanë patur një apartament tjetër dhe kanë kryer një shtesë kati mbi këtë apartament në vitin 2008 nuk është një argument i mjaftueshëm për të konkluduar se apartamenti në fjalë është në pronësinë time. Rishpjegoj se në lidhje me këtë apartament unë pretendoj të drejta bashkëpronësie, por për shkak të lidhjes familjare nuk përjashtohet asnjë mundësi që këto pretendime t'i ketë vëllai, madje edhe motra ime, si fëmijë të prindërve të mi.

Po kështu nuk është i vërtetë konstatimi i Komisionit se në këtë apartament nuk kanë banuar familjarë të tjerë të mi, pasi sqaroj se në këtë apartament, në periudha të ndryshme kohe kanë jetuar dhe vijojnë të jetojnë prindërit e mi. Kjo ka ndodhur p.sh në periudhën e përmbytjeve të qytetit të Shkodrës, në vitin 2012, ku e gjithë familja ime (nëna, babai, vëllai dhe bashkëshortja e tij) janë shpërngulur dhe kanë jetuar disa muaj në këtë banesë, për shkak se kjo banesë ndodhet në një zonë të qytetit e cila nuk pati përmbytje. Po kështu prindërit e mi për shkak të nevojave të tyre si pleq dhe të sëmurë kronikë, qëndrojnë shpesh këtë banesë, në kushtet që apartamenti është më afër institucioneve shëndetësore dhe ka ashensor, që i ndihmon prindërit e mi të ngjiten më lehtë. Po kështu në periudha të ndryshme kohe që lidhen me rritjen e fëmijëve të mi dhe nevojës për ndihmë nëna dhe babai im kanë jetuar në këtë apartament, sic ka ndodhur pas lindjes së vajzave binjake të mia, rritja e të cilave ishte shumë e vështirë për ne, ku jemi ndihmuar për një kohë të gjatë nga nëna dhe babai, të cilët kishin eksperiencë të mëparshme të rritjes së fëmijëve binjakë.

Ritheksoj se për shkak të lidhjes shumë të ngushtë shpirtërore që ne kemi me njëri-tjetrin, traditës tonë si veriorë, respektit që kemi për prindërit tanë etj, nuk kemi patur asnjë shkak që ndarja e pasurisë të jetë argument i diskutimeve tona dhe aq më pak të bëjmë publike kohën kur prindërit tanë jetojnë me njërin apo tjetrin djalë.

Nga ana tjetër mendoj se përpjekja e Komisionit për t'a trajtuar rastin tim si të ngjashëm me atë të subjektit të rivlersimit Alfred Gjoni, të gjykuar nga KPA me vendimin me nuëmr 9/2010, e cila është marrë si referencë si praktikë, është tërësisht e gabuar dhe se ky vendim i kolegjit nuk ka asnje relevancë me personin tim.

Kjo për shkak se situata ime e deklarimit të kësaj pasurie është tërësisht e ndryshme nga ajo e subjektit në fjalë.

Kështu ndërsa unë e kam deklaruar në cdo kohë këtë pasuri subjekti i rivlersimit Alfred Gjoni nuk e ka deklaruar atë asnjëherë, as në DPV periodike, deklaratën Vetting dhe pyetësorin standart. Deklarimin e parë të kësaj pasurie ai e ka bërë gjatë përgjigjeve të pyetësorit të dytë, pas një denoncimi anonim dhe njohjes me informacionet që kishin dhënë në lidhje me këtë pasuri organet ligjzbatuese.

Ndërkohë unë e kam deklaruar gjithnjë këtë pasuri në përdorimin tim, që në kohën e krijimit të saj me DPV e vitit 2006, kam vijuar me DPV-të në vijim, e kam deklaruar atë si pasuri në përdorimin tim në deklaratën vetting dhe po kështu edhe gjatë gjithë procesit administrativ. Në pikën 13.10 të vendimit 9/2020 për subjektin A.GJ. Kolegji shprehet: *"**13.10.** Së pari, subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë vetting, në përputhje me detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, edhe atë ligjor të parashikuar në shtojcën nr. 1 të ligjit nr. 84/2016. Të njëjtin qëndrim subjekti ka mbajtur edhe në përgjigjet e pyetësorit të parë, të dërguar nga Komisioni me nisjen e hetimit administrativ në këtë proces. Ai ka mohuar fillimisht të ketë në përdorim apartamentin në fjalë dhe e ka pohuar përdorimin e tij vetëm në pyetësorët vijues të dërguar prej Komisionit, pasi i është bërë prezent që kjo rrethanë kishte dalë në hetim prej denoncimit publik dhe prej informacioneve të organeve ndihmëse."*

Nga ana tjetër shtoj faktin se ndërsa subjekti i rivlersimit Alfred Gjoni nuk kishte asnjë lidhje ekonomie të përbashkët me personin në emrin e të cilit rezultonte e rregjistruar prona, unë isha nën një ekonomi të njëjtë me babain, nënën dhe vëllain. Duke vlerësuar këtë fakt, shtuar këto edhe deklarimin në cdo moment të kësaj pasurie nga ana ime (si të ishte e imja), qartësisht duket se unë nuk kam patur asnjë shkak për të fshehur këtë pasuri, ndryshe nga sa Kolegji ka konkluduar për subjektin të i cili referon Komisioni, në përpjekje për t'a konsideruar rastin tim si të njëjtë me këtë subjekt.

Gjithashtu shtoj se koha e gjatë e përdorimit të kësaj pasurie nga ana ime nuk është një shkak për t'a konsideruar këtë pronë si timen. Në vlerësimin e kësaj kohëzgjatje duhet të kihen në konsideratë disa rrethana që janë: (i) lidhja ime shumë e afërt në gjini me pronarin e ligjshëm të pasurisë; (ii) kontributi që unë kam dhënë në krijimin e kësaj pasurie, që është më i madh se ai i pjestarëve të tjerë të familjes time të origjinës.

Bazuar në këto argumente mendoj se krahasimi i situatës time të deklarimit të kësaj pasurie me atë të subjektit të rivlersimit Alfred Gjoni, të cilit i është referuar Komisioni, është jo relevant.

Po kështu edhe krahasimi që Komisioni i bën personit tim me subjektin e rivlersimit A.B (Arjan Balliu) gjykuar nga KPA me vendimin me numër 32/2022 nuk është i saktë. Edhe ky subjekt nuk rezulton t'a ketë deklaruar apartamentin e përdorur nga ai në deklaratën vetting, me arsyetimin se kjo pasuri i përkiste babait dhe ky i fundit nuk bënte pjesë në rrethin e personave të lidhur. Ndryshe nga ky subjekt unë kam bërë në cdo moment deklarim të përdorimit të apartamentit ku unë banoj, pavarsisht faktit se kjo pronë është rregjistruar në emër të babait tim. Gjithashtu në lidhje me mua nuk ka deklarime kontradiktore në lidhje me deklarimin e adresës së banimit, kohës së deklarimit të kësaj adrese, si dhe nuk kam lidhur kontrata fiktive, sic rezulton në lidhje me subjektin në fjalë. Veprimet juridike që janë kryer në lidhje me këtë pasuri janë ato të deklaruara nga ana ime në cdo moment, që në kohën e krijimit të saj. Bazuar në këto argumente mendoj se krahasimi i situatës time të deklarimit të kësaj pasurie nuk mund të krahasohet me atë të subjektit Arjan Balliu, të cilit i është referuar Komisioni.

Qëllimi i Komisionit për t'a pasqyruar apartamentin në fjalë si pasuritë fshehur nga ana ime është bërë jo pa shkak të përcaktuar dhe dashakeq. Ky shkak ekziston në tre drejtime:

(i) Në përdorimin e këtij argumenti si shkak për shkarkimin tim bazuar në nenin 61/3 të ligjit 84/2016, duke pretenduar se unë nuk kam deklaruar të gjitha pasuritë në pronësinë time.

(ii) Në legjitimimin e tij për mos mbajtur të qëndrim të mbajtur me subjekte të tjera rivlersimi të gjetur në situata faktike të ngjashme me personin tim, në zbatim të parimit të barazisë,

(iii) Për të mos iu referuar praktikave të konsoliduara të vendosura me vendime të KPA dhe GJEDNJ për subjekte të tjera rivlersimi.

Nëse Komisioni nuk do të mbante qëndrimin e gabuar duke e vlerësuar apartamentin ku unë jetoj si "pasuri të fshehur" ai do të ishte i detyruar të merrte në konsideratë qëndrimin që ka mbajtur në raste të ngjashme, sic ka ndodhur në lidhje me subjektin e rivlersimit **Alma Bramo, e konfirmuar në detyrë me vendimin e formës së prerë me numër 536, datë 02.06.2022**.

Në këtë vendim Komisioni shprehet: *Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme financiare për të blerë këtë apartament. Pavarësisht këtij përfundimi,* ***Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për personin e lidhur, nënës së subjektit, në blerjen e këtij apartamenti nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, për arsyet si vijojnë:***

i) Në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme, krijimi dhe marrëdhënia financiare për pagimin e ***saj është provuar nga hetimi administrativ se subjekti nuk ka asnjë shfaqje të vullnetit të saj, duke u provuar se nuk ka asnjë nënshkrim të asnjë dokumenti ligjor për përfitimin e saj dhe asnjë pagim të kësteve për këtë pasuri****.*

ii) ***Pasuria është reqjistruar në reqjistrat publikë të reqjistrimit të pasurive të paluajtshme, në emër të nënës së subjektit.***

iii) ***Vetëm te pjesa takuese e babait të subjektit mbi këtë pasuri prej ½ si pjesë e pasurisë bashkëshortore, është pasuria ku subjekti tërheq të drejta pasurore si trashëgimtare ligjore e***

radhës së parë për 1/5 pjesë, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore sipas nenit 74 të Kodit të Familjes.

1.33 Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat lidhur me pasaktësinë e deklarimit dhe pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të nënës së saj për përfitimin e kësaj pasurie nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Duke iu referuar kësaj vendimarrje dhe shkaqeve për të cilat Komisioni zbatoi ndaj subjektit të rivlersimit Alma Bramo parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, qartësisht duket se situata ime është identike.

- Edhe në lidhje me apartamentin ku unë jetoj unë nuk kam asnjë shfaqje vullneti për blerjen e tij, pasi as nuk kam nënshkruar kontratat e sipërmarrjes dhe shitblerjes dhe as kam bërë kalim të ndonjë vlere monetare te firma sipërmarrëse.
- Pasuria ku unë jetoj është rregjistruar në rregjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të babait tim.
- Pjesa ime takuese në këtë pasuri prej ¼, vlerësuar në raport me bilancin negativ me të cilën më ngarkon Komisioni për këtë pasuri, nuk legjitimon shkarkimin tim, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit.

Bazuar edhe në qëndrimin që ka mbajtur Kolegji i Posacëm i Apelimit me vendimin me numër 17/2022 për subjektin e rivlersimit Marinela Osmani (Nuni) dhe në vendimarrjen e GJEDNJ në cështjen *Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë*, mendoj se vlera e bilancit negativ me të cilin rezulton familja ime për blerjen e apartamentit në vitin 2006, nuk përbën shkak për shkarkimin tim nga detyra bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit.

Bazuar në këto shkaqe i kërkoj Kolegjit të rivlerësojë situatën time të deklarimit të apartamentit të banimit ku unë jetoj si një pasuri e përbashkët e të gjithë familjes time të origjinës, përfshirë dhe personin tim dhe në këtë kontekst në vijim të bëjë edhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, në funksion të procesit tim të rivlersimit.

Edhe nëse i referohemi bilanci negativ me të cilin komisioni nxjerr familjen time për krijimin e kësaj pasurie prej 1,537,040 lekë, pjesa ime takuese si bashkëpronar prej ¼ rezulton të jetë në vlerën 384,260 lekë, e cila kurrsesi nuk legjitimon vendimarrjen për shkarkimin tim nga detyra (shih analizën që kam bërë më lart në lidhje me zbatimin e parimit të proporcionalitetit).

1.3 Në lidhje me konstatimin e Komisionit (pika 36.2 e vendimit***): "Subjekti nuk ka deklaruar në Deklaratën Vetting si burim për blerjen e këtij apartamenti huatë e marrë nga z. Xheladin Thana dhe z. Fahri Ymeri; Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e këtij apartamenti duke e bërë të pamundur evidentimin e burimeve për blerjen e tij; Subjekti nuk rezulton që huanë në shumën 2,000,000 lekë ta ketë deklaruar si burim në momentin e blerjes së apartamentit në DPV/2006, por dhe kur është pyetur nga ILDKPKI në vitin 2009. Kjo hua është deklaruar si burim vetëm në vitin 2015, kur atij nga ana e ILDKPKI-së i është vënë në dukje se rezulton me një bilanc negativ në shumën 1,537,040 lekë. Për rrjedhojë huaja në shumën 2,000,000 lekë nuk do të konsiderohet si burim për blerjen e këtij apartamenti."***

shpjegoj se këto konkluzione janë tërësisht të pasakta dhe nuk kanë marrë në konsideratë asnjë prej shpjegimeve të dhëna nga ana ime me DPV, shpjegime dhe memo përpara ILDKPKI, përgjigjet e pyetësorit standart, të dytë dhe të tretë, përgjigjet përfundimtare, shpjegimet ne seancën dëgjimore, ku kam sqaruar qartësisht burimin e blerjes së kësaj pasurie dhe shkaqet e mosdeklarimit të huasë marrë xhaxhait tim Fahri Ymeri,

Mendoj se shkaku i këtyre konkluzioneve është se në deklaratën Vetting unë kam deklaruar që burimi për blerjen e kësaj pasurie janë vetëm të ardhurat e realizuara nga anëtarët e familjes time të origjinës (pa përmendur huatë nga Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, që ka marrë babai im Faik Ymeri në vitin 2006), ndërsa në përgjigjet e pyetësorit standart, i kam përmendur edhe huatë si burim për krijimin e pasurisë.

Unë vlerësoj se ky konkluzion i Komisionit, që unë kam bërë deklarime të pasaktë dhe kontradiktor, nuk është i drejtë. Paraprakisht, vlerësoj se kategoritë e "deklarimit të ndryshëm", të "deklarimit të pasaktë" dhe të "deklarimit të paplotë", nuk kanë të njëjtin kuptim për qëllimet e procesit të rivlerësimit. Kjo pasi ana subjektive, pra momenti intelektual dhe momenti volitiv i subjektit të rivlerësimit, që bën njërën nga tre kategoritë në fjalë të deklarimeve, nuk është i njëjtë. Në rastin kur subjekti i rivlerësimit bën deklarim të paplotë në deklaratën vetting, por gjatë procesit të rivlerësimit, e provon se ky lloj deklarimi është rrjedhojë e mungesës së dëshirës së tij dhe/apo mangësisë ose të metave të momentit intelektual të tij për të kuptuar saktësisht dhe plotësisht mënyrën se si duhet të bëhet deklarim i plotë në deklaratën veting, atëherë pasojat që bien mbi subjektin e rivlerësimit nga deklarimi i paplotë, sipas parimit të proporcionalitetit, nuk mund të çojnë në marrjen ndaj tij të masës më ekstreme disiplinore.

Në përgjigjet e pyetësorit standart, unë e kam sqaruar me inisiativën time, pa më pyetur Komisioni, që kam bërë deklarim të paplotë në dekleratën vetting, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë - Apartament banimi me sip.111 m2, që është regjistruar në regjistrat publik të pasurive paluajtshme të ZVRPP Shkodër, me nr. pasurie 4/540+4-8, Zk 8593. Vetë fakti juridik që unë kam vepruar me inisiativën time, në përgjigjet e pyetësorit standart, për të riparuar gabimin e kryer, provon që kemi të bëjmë me deklarim të paplotë, por që është kryer nga unë si rrjedhojë e mangësisë që kam patur për të kuptuar, drejtë, plotësisht, saktësisht, mënyrën se si duhet të plotësohet deklarata vetting. Unë nuk kam patur asnjë lloj dëshire për t'a bërë këtë deklarim të paplotë, dhe kjo mungesë dëshire e imja vërtetohet, nga katër fakte juridike, që janë:

I. Unë kam vepruar me vetinisiativë, për riparimin e parregullsisë.

II. Është fakt i njohur botërisht se në proçesin e rivlerësimit, subjektet e rivlerësimit, kanë një ngarkesë emocionale shumë të lartë, gjë që padyshim e zvogëlon momentin intelektual të tyre për të vepruar saktësisht dhe plotësisht sikurse e kërkon ligji.

III. Vetë fakti që Komisioni më parashtron pyetje në shtesë të deklaratës vetting të plotësuar prej meje, provon se Komisioni është i ndërgjegjshëm që sipas parimit të proporcionalitetit, parimit të humanizmit, parimit të bashkëpunimit të organit publik me palën e interesuar në procedimin administrativ dhe parimit të ligjshmërisë, (*parime këto të parashikuara jo vetëm në Kodin e Procedurave Administrative në fuqi, por edhe në aneksin e Kushtetutës dhe ligjin veting*), subjektit të rivlerësimit, duhet t'i jepet mundësia që të korrigjojë përmes plotësimit, gabimet materiale ose deklarimet e paplota të kryera prej tij, në dekleratën veting, gjithmonë kur ai provon se këto deklarime nuk janë rrjedhojë e dëshirës së tij për të fshehur pasuri, nuk janë rrjedhojë e dëshirës së tij për të gënjyer në çfarëdolloj forme Komisionin, por janë rrjedhojë e

mungesës së dëshirës së tij dhe/apo mangësisë ose të metave të momentit intelektual të tij për të kuptuar saktësisht dhe plotësisht mënyrën se si duhet të bëhet deklarim i plotë në deklaratën veting.

Nëse Komisioni do t'a ndëshkonte subjektin e rivlerësimit edhe për gabimet e bëra pa dashjen e tij në plotësimin e dekleratës vetting – atëherë pse duhet që Komisioni të shpenzojë kohë më kot për të parashtruar pyetje shtesë? Sigurisht, mendoj që qëllimi i procesit të rivlerësimit i parashikuar në Aneksin e Kushtetutës dhe në ligj, nuk është që t'a autorizojë Komisionin që të veprojë kësisoj, pra në mënyrë arbitrare. Madje është e kundërta dhe pikërisht kjo është arsyeja që Komisioni bën pyetje në shtesë të dekleratës veting. Pra, në përmbledhje unë vlerësoj që është e drejta ime për të riparuar gabimet e bëra, pa dashje në lidhje me mënyrën e plotësimit të dekleratës veting. Gjithashtu vlerësoj se është detyrimi korrespondues i Komisionit për të më dëgjuar lidhur me riparimin e këtyre gabimeve si dhe në vijim për të hetuar nëse ato i kam kryer me apo pa dashjen time. Nëse kam gabuar pa dashje, dhe sipas vlerësimit tim, ky është rasti, atëherë unë nuk mund të ndëshkohem për këtë shkak.

Ky arsyetim i imi bazohet edhe ne praktikën e konsoliduar tashmë të KPK, të vendosur me vendimin e formës së prerë me numër 46, datë 4.07.2018, sipas të cilit: *"Komisioni vlerëson se kompetenca me të cilën Kushtetuta dhe ligji kanë ngarkuar këtë organ për të ushtruar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve,* ***nuk mund të kufizohet dhe të jetë vetëm gjetja e gabimeve ndër vite të subjekteve që hetohen dhe gjykohen.*** *Përkundrazi, Komisioni gjatë hulumtimit dhe zbatimit të detyrave funksionale duhet që këto pasaktësi t'i shoqërojë me konkluzionin se janë pikërisht ato mjetet me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj….* ***kjo do të thotë që nëse pasaktësia ose mospërputhja është e palidhur me fshehjen e pasurisë dhe është pasojë e një konteksti të caktuar të perceptimit të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit, atëherë kjo rrethanë nuk mundet kurrsesi të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore nga ana e organeve vendimarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar****".*

III. Fakti që kam gabuar pa dashje në plotësimin e dekleratës vetting, provohet edhe nga fakti që (*sikurse do të shprehem më hollësisht në vijim*), unë njërën nga huatë (*atë të marrë tek shtetasi Xheladin Thana*), e kam përshkruar në DPV 2006, ndërsa huanë tjetër, (*atë të marrë nga shtetasi Fahri Ymeri*), kam çmuar se nuk duhet t'a përmënd të DPV 2006, pasi deklarimi i këtij viti ka qënë periodik dhe sipas vlerësimit tim, nuk kam patur detyrim të përmend huatë e shlyera brenda vitit te deklarimit (ushtrimor).

IV. Madje, lidhur me këtë hua të marrë tek Fahri Ymeri, unë nuk e kam përmendur për herë të parë, vetëm në përgjigje të pyetësorit standart, (*gjë që lë të kuptohet në pyetjen e tij Komisioni*), por e kam përmëndur edhe përpara se të hynte në fuqi Aneksi i Kushtetutës dhe ligji vetting, pra në një kohë të mëparshme, në të cilën unë as e dija dhe as mund t'a dija që do t'i nënshtrohesha në të ardhmen proçesit të rivlerësimit.

Konkretisht, unë e kam përmendur këtë hua, në shpjegimet me shkrim, që kam dhënë në ILDKPKI, sipas nenit 27 të Ligjit 9049 (të ndryshuar). (Shih faqen 5, paragrafi i fundit dhe faqen 6, paragrafi 1 dhe 2 të memos së datës 13.02.2015, që i kam drejtuar ILDKPKI, ku shprehimisht shpjegoj "*… Për t'a blere kete apartament, me sa mbaj mend, im ate i ka marre borxh motres se tij dhe bashkeshortit te saj, nje shume prej 1.500.000 leke, (qe po ashtu eshte deklaruar dhe eshte vertetuar me nje deklerate noteriale te cilen e kam dorezuar ne ILDKP). Ndoshta kjo shume po te llogaritet si e ardhur neto, e shpjegon diferencen e pambuluar.*

Nuk jam i sigurte, por me duket se per blerjen e appartamentit, babai im i ka marre nje hua edhe vellait te tij, Fahri Ymeri, por nuk e di nese eshte shlyer brenda vitit apo jo. Nese po, - kjo hua

nuk eshte deklaruar. Nese jo- atehere eshte perfshire edhe kjo hua ne deklaretan periodike te vitit 2006 si e ardhur. Nese eshte perfshire, atehere me siguri qe bashkangjitur, duhet te jete edhe nje deklerate noteriale qe e verteton kete fakt.
Gjithsesi une duke mos mbajtur mend, detajet e mesiperme, rezervoj te drejten per te mos bere hamendesime ne pergjigjen e pyetjes, pa pare paraprakisht dekleraten periodike te vitit 2006 dhe dokumentacion shoqerues te saj, te dorezuar prej meje ne ILDKP….".

Ky arsyetim i imi gjen mbeshtetjen edhe në praktikën e KPK dhe konkretisht në lidhje me subjektin e rivlersimit Artan Çupi, **me vendimin e fomës së prerë me numër 444, datë 16.09.2021,** ku Komisioni konfirmoi në detyrë subjektin e rivlersimit dhe pranoi aktet noteriale të paraqitura nga ai në lidhje me pasurinë, **te cilat ai i kishte përmëndur gjatë hetimit nga ILDKPKI, madje hartuar dhe nënshkruar në këtë moment.** Kështu "***Subjekti i rivlersimit kishte blerë banesë në vitin 2007. Në vitin 2009 ILDKPKI ka evidentuar mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e kësaj banese në vlerën 2.063.594 lekë . Për të justifikuar burimin e të ardhurave subjekti në fjalë ka paraqitur, 10 ditë pas pyetjes nga inspektori i ILDKPKI dhe 2 vjet nga blerja e banesës, dy kontrata huadhënie, lëshuar nga babai dhe vëllai i tij"***. Edhe pse këto hua ishin të hartuara dhe nënshkruara shumë kohë pas fitimit të pasurisë, **jo në DPV konkrete,** por gjatë pyetjes nga ILDKPKI, KPK i pranoi ato për justifikimin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë. Theksoj se në lidhje me këtë subjekt rivlersimi kontratat e huasë janë hartuar në kohën e pyetjes nga ILDKPKI, ndërkohe që në rastin tim këto kontrata janë hartuar dhe nënshkruar përpara noterit në kohën e marrjes se huave dhe janë kontrata huaje dhe jo deklarata noteriale.
Ashtu si dhe subjekti i rivlersimit në fjalë unë kam dhënë shpjegime të hollësishme në lidhje me keto hua, gjatë hetimit nga ILDKPKI dhe deklarimet e dhëna nga ana ime në këtë kohë duhet të konsiderohen si pjesë e deklarimeve te mia në tërësi.
Theksoj se vendimi me numër 444, datë 16.09.2021 për subjektin e rivlersimit Artan Çupi është marrë me shumicë votash nga komisioneret Pamela Qirko dhe Genta Bungo, dy nga anëtaret e komisionit që kanë kryer procesin tim të rivlersimit. Bazuar në parimin e barazizë kam menduar se nga këto komisionere nuk mund të mbahet një qëndrimi ndryshëm në lidhje me personin tim në lidhje me këtë rrethanë, e cila është e njëjtë si më subjektin Çupi.

Po kështu edhe me vendimin me numër 37, datë 24.11.2021 të Kolegjit të Posacëm të Apelit, për subjektin e rivlersimit Sokol Ngresi është pranuar fakti se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlersimit gjatë procedurave administrative të verifikimit nga ILDKPKI duhet të konsiderohen si pjesë e shpjegimeve të subjektit dhe duhet të merren ne konsideratë nga Komisioni në drejtim të vlerësimit të deklarimeve të tij. Kështu në këtë vendim Kolegji shprehet: *"Ky fakt, përveçse si një deduksion i një analize logjike dhe ligjore të rrethanave të përmendura më lart, rezulton i pasqyruar edhe në shpjegimet që subjekti ka dhënë në përgjigje të pyetjeve të pasqyruara në procesverbalin e datës 17.11.2011 dhe të shtruara nga inspektorja e lartë e ILDKPKI-së, R. R.. Kolegji vëren se ky akt është hartuar në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, i cili parashikon se: Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.* ***Në këto kushte, ky procesverbal i hartuar mbështetur mbi një dispozitë ligjore nga organi kompetent, vlerësohet***

se është një dokument zyrtar në kuptim të nenit 49, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016, i cili për më tepër është administruar nga Komisioni zyrtarisht prej institucionit që e ka hartuar atë në funksion të procesit të rivlerësimit. *Kolegji vlerëson me rëndësi të nënvizojë faktin se përpilimi i këtij dokumenti zyrtar jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën dhe formën e kërkuar prej ligjit, por ai daton në një kohë të largët e pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përftuara në këtë dokument, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë shëruar pasaktësitë në deklarime të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit.* ***Në këtë kontekst, Kolegji çmon se vlera provuese e këtyre deklarimeve në këtë çështje, është e rëndësishme dhe nuk mund të anashkalohet nën frymën e një shqyrtimi objektiv të çështjes.*** *Në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, organet e rivlerësimit kanë detyrimin të shqyrtojnë deklaratat e subjektit për të shkuarën e tij dhe sigurisht të përcaktojnë vlerën e tyre provuese në raport e harmoni me të gjitha rrethanat e faktit që rezultojnë nga burime të tjera.* ***Në këtë këndvështrim, këto shpjegime të subjektit të dhëna në të kaluarën e tij e pikërisht në funksion të sqarimit të pasaktësive në plotësimin e deklaratave periodike të tij përpara institucionit të vetëm përgjegjës për deklarimin e pasurive, nuk mund të abstragohen dhe konsiderohen inekzistente, si akte që japin informacion relevant për çështjet e procesit të tij të rivlerësimit.*** *Mbi të gjitha, krijimi i tyre i provuar jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit dhe në mungesë edhe teorike, jo vetëm praktike, të qëllimit të subjektit për të deformuar veprimtarinë hetimore për vlerësimin e pasurisë sipas këtij procesi, u japin këtyre deklarimeve kredibilitetin e nevojshëm për t'u përdorur në analizën që trupa gjykuese vlerëson të bëjë për çështjet e ngritura në ankim prej Komisionerit Publik."*

Unë kam qënë i ndërgjegjshëm në kohën e plotësimit të deklaratës vetting, se një nga burimet e provave parësore që do të përdor Komisioni në proçesin tim të rivlerësimit, janë DPV-të përkatëse si dhe deklarimet e kryera nga unë sipas nenit 27 të ligjit Ligjit 9049 (të ndryshuar), në ILDKPKI. Kjo ndërgjegje e imja, vërtetohet nga fakti se ky burim provash përmëndet shprehimisht në ligjin e vettingut. Duke patur këtë ndërgjegje, është fakt i pamohueshëm se unë nuk mund të shpresoja të arrija asnjë lloj përfitimi, nëse me dashje, do të gaboja në plotësimin e dekleratës vetting, lidhur me tregimin e burimeve të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë që përbën objektin material të pyetjes, që më është parashtruar nga Komisioni. Për rrjedhojë, i vetmi shpjegim i mundshëm është ai që kam shprehur në pyetësorin standart, e theksoj me inisiativën time, pasi jam ndërgjegjësuar vetë, pa më pyetur Komisioni, se në dekleratën veting, kam gabuar pa dashje në tregimin e burimeve të kësaj pasurie, duke quajtur burime, vetëm kontributet e secilit prej anëtarëve të familjes time të origjinës përgjatë rrjedhës së kohës, ndërkohë që burimet reale të krijimit të pasurisë, nuk kanë qënë vetëm këto kontribute, por kanë qënë edhe dy huatë e sipërpërmëndura. Ky gabim ka ardhur nga fakti se në kohën e plotësimit të dekleratës veting, huatë e marra lidhur me këtë pasuri, kanë qënë të shlyera tërësisht, me kontributet e mëvonshme të anëtarëve të familjes. Për rrjedhojë, pa dashje në dekleratën veting, kam zëvendësuar dy huatë e marra, me kontributet e mëvonshme të anëtarëve të familjes time të origjinës, që kanë shërbyer për të shlyer dy huatë në fjalë. Këtë gabim pa dashje e kam riparuar vetë, me inisiativën time, pa më pyetur komisioni, në përgjigjet që i kam dhënë pyetësorit standart.

Kjo çmuarje imja, për mosdeklarimin e huave që nuk kanë ekzistuar në kohën e plotësimit të deklaratës vetting, gjen mbeshtetje edhe ne vendimin e KPA nr. 9/2020 lidhur me subjektin Alfred Gjoni, ku shprehet: *"**Kolegji çmon se munqesa e deklarimit të kësaj marrëdhënieje në deklaratën e pasurisë vetting nuk konsiderohet si shkelje e ndonjë detyrimi ligjor në kuptim të plotësimit të kësaj deklarate.Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë detyrimin e deklarimeve të detyrimeve apo kredive që kanë ndaj personave të tretë në momentin e plotësimit të deklaratës vetting, deklarime të cilat më pas i nënshtrohen verifikimit të vërtetësisë së tyre**, ndërsa kredia e deklaruar prej subjektit i përket një kohe të shkuar dhe po ashtu edhe shlyerja e saj, pra marrëdhënia mes subjektit dhe shtetasit E.Ç., në lidhje me këtë hua, i ka përfunduar efektet e saj dhe nuk prodhon më asnjë pasojë ligjore që të mund të deklarohet si e tillë në vitin 2017, në kohën e plotësimit të deklaratës vetting."*
V. Dy huatë e marra të përmëndura në pyetësorin standart, vërtetohen me akte noteriale të datës 24.04.2006. Këto janë akte zyrtare me fuqi të plotë provuese sipas nenit 253 të K. Pr. Civile.
Vetë fakti juridik i kalimit të rreth 11 vjetëve nga data që janë përpiluar këto dy akte noteriale, (si dhe rreth 16 vjet deri tani), tregon qartë jo vetëm që unë në kohën kur janë përpiluar këto akte noteriale, as kam ditur dhe madje as mund të dija se do t'i nënshtrohem proçesit të rivlerësimit nga Komisioni, por tregon në analizë të fundit, që unë nuk kam patur asnjë qëllim dhe/apo dëshirë për të gënjyer/fshehur/mosdeklaruar burimet reale që kanë shërbyer për të blerë pasurinë që përbën objektin material të pyetjes.
Theksoj se unë i kam përmëndur këto hua me inisiativën time me pyetësorin standart të dërguara nga ana Juaj, duke pasur si qëllim të jem tërësisht transparent në lidhje me çdo burim të krijimit të pasurisë time.

Ndryshe nga ana unë subjekti i rivlersimit Arben Nika, **i konfirmuar ne detyrë me vendimin me numër 445, datë 16.09.2021 KPK (vendim i formës së prerë),** i ka përmëndur huatë e marra nga ana e tij, per blerjen e apartamentit te banimit (në shumat 1,300,000 lekë dhe 10,792 euro), të shlyera brenda vitit, vetëm kur është pyetur nga KPK (jo me inisiativë si unë), hua të cilat nuk i kishte deklaruar as ne DPV dhe as në deklaratën veting. Nga KPK u pranua argumenti i këtij subjekti rivlersimi se këto hua i kishte shlyer brenda vitit dhe nuk ishin detyrime të mbartura në vitin e ardhshëm dhe se këto hua nuk kanë përbërë burimin real të blerjes së pasurisë së tij.

Siç e kam shpjeguar edhe më lart, unë nuk e kam fshehur në asnjë moment origjinën e fitimit të kësaj pasurie, duke evidentuar si burime të krijimit të saj kursimet nga pagat pensioni dhe bursa të pjestarëve të familjes time të origjinës, të ardhurat nga aktivitetet e tyre, të ardhura nga dhënia me qera e tokës bujqësore dhe huatë marrë shtetasit Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri.

Moaspasyrimit plotësisht i të gjitha burimeve te krijimit të pasurisë në deklaratë vetting shpjegoj se ky ka qenë një gabim padashje nga ana ime, për këto arsye:

a) Ngarkesën emocionale dhe presionin që kam perceptuar në kohën e përpilimit të deklaratës vetting, pasi është fakt i njohur botërisht, madje edhe juridikisht (shih opinionin e Komisionit të Venecias për vettingun) që procesi i rivlerësimit që fillon me përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratës vetting, përbën një ngjarje të jashtëzakonshme, e cila në vetvete shkakton presion dhe ngarkesë emocionale jo normale tek subjektet e rivlersimit gjyqtarë apo prokurorë. Është pikërisht kjo dukuri, që në kohën e përpilimit të deklaratës veting, ma ka ulur aftësinë intelektuale për të perceptuar drejtë mënyrën sesi përpilohet deklarata vetting.

b) Unë gjithnjë kam qenë i vetdijshëm që procesi i rivlersimit i kryer në lidhje me mua do të kishte si dokumente primare vlerësimi deklarimet ne DPV e viteve dhe shpjegimet e dhëna nga ana ime me pyetje dhe memorje përpara ILDKPKI. Ndodhur në kushtet që unë gjatë gjithë kohëvazhdimit të deklarimeve dhe dhënies së këtyre shpjegimeve kam qenë ezaurues ne drejtim të pasqyrimit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie mendoj se në asnjë moment nuk kam pasur si qëllim të fsheh apo të pasqyroj të dhëna të pavërteta në lidhje me këto burime krijimi të kësaj pasurie.

c) Faktor i dytë që ka ndikuar në gabimin pa dashje të lartëpërmendur, është edhe një zbehje e vigjilencës time në plotësimin e deklaratës vetting që ka patur dhe ka si premisë bazë një vlersim timin pozitiv për Komisionin, sipas të cilit ky organ administrativ edhe vetë është i ndërgjegjshëm që veprimtarinë e tij, krahas legjislacionit të posaçëm, duhet të zbatojë edhe Kodin e Proçedurave Administrative. Në këtë kod ka një parim që titullohet "*parimi i efecencës dhe deburokratizimit*". Sipas këtij parimi organi publik në veprimtarinë e tij ka për qëllim të zbulojë të vërtetën dhe të shqyrtojë në themel pretendimet që paraqet pala e interesuar në një proçedim administrativ. Pikërisht për të zbuluar të vërtetën organi publik detyrohet për të bashkëpunuar dhe ndihmuar palën e interesuar për rezultatet e proçedimit administrativ, duke e orientuar këtë palë lidhur me mënyrën sesi kjo e fundit duhet të përmbush detyrimet që ka gjatë proçedimit. Vetë fakti që Komisioni po më pyet përmes këtij pyetësori, tregon që vlersimi im në fjalë nuk ka qenë i gabuar, por i drejtë dhe për këtë e vlerësoj Komisionin. Kjo pasi përmes pyetjeve Komisionit jo vetëm po më orienton lidhur me mënyrën sesi duhet të përmbush detyrimet e mia, por edhe njëkohsisht po më ndihmon për të riparuar ndonjë gabim, pa dashje, të bërë prej meje në momentin e përpilimit të deklaratës vetting, ku gabimet e subjekteve të rivlersimit në plotësimin e deklaratës vetting nuk kanë sjellë pasoja ndaj tyre në proçesin e rivlersimit. Ky është edhe qendrimi që ka mbajtur KPK me subjektin e rivlersimit Ardian Dvorani, **me vendimin *49, i datës 25.07.2018,*** *ku* ***"****Komisioni pasi hetoi në lidhje me shkaqet e mosdeklarimit nga subjekti të likujditeteve, konkludoi se kjo nuk ka qenë rrjedhojë e përpjekjeve të subjektit të rivlersimit për t'i fshehur ato. Sipas Komisionit mosdeklarimi kishte ardhur si rrjedhojë e "pakujdesisë së subjektit në plotësimin e deklaratës" dhe jo fshehhjes.*

Të njëjtin qëndrim KPK ka mbajtur edhe në lidhje me subjektin e rivlersimit Valbona Vata, me vendimin me numër 327, datë 23.12.2020, ku mosdeklarimi i kursimeve nga subjekti nuk u konsiderua penalizues, por pakujdesi në plotësimin e deklaratës.

Bazuar në argumentet e mësipërme, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe barazisë Komisioni nuk mund të mos njihte si burim i të ardhurave për blerjen nga babai im të apartamentit në lagjen "Vasil Shanto", huanë prej 2.000.000 lekë, që ai i ka marrë vëllait të tij Fahri Ymeri.

Për të justifikuar qëndrimin e ndryshëm që anëtaret e Komisionit, vecanarisht Komisioneret Genta Bungo dhe Pamela Qirko kanë mbajtur për subjekte të tjera rivlersimi, të gjetur në të njëjtat situata faktike si dhe unë por edhe shumë më të rënda, ne pikën 36.4 të vendimit Komisioni ka tentuar t'i referohet praktikave të vendosura të KPA me vendimet e fundit në drejtim të vlerësimit të huave të padrklaruara.

Kështu Komisioni referon të vendimi 33/2022 për subjektin e rivlersimit Adnan Xhelili, ku Kolegji shprehet: "*Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e*

duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij. Për rrjedhojë të sa më sipër, edhe vendimet e Komisionit për të cilat subjekti i rivlerësimit kërkoi që të merren në cilësinë e provave të reja, edhe pse mund të përbëjnë provë të faktit lidhur me vlerësimin e ndryshëm të pretenduar nga subjekti për trajtimin e të ardhurave nga bujqësia, nuk përbëjnë provë të fakteve relevante që lidhen me krijimin e këtyre të ardhurave nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, çmohen pa efekt në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Mendoj se kjo praktikë e Kolegjit në lidhje me këtë subject nuk ka relevancë në raport me cmuarjen që Komisioni duhet t'i bënte huasë të padeklaruar nga ana ime, vecanarsisht në respektim të parimit të barazisë.

Edhe unë vlerësoj se konsiderimi i këtyre huave si burim i ligjshëm i të ardhurave duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke patur në konsideratë rrethanat individuale të cdo subjekti. Bazuar në rrethanat e mia personale vlerësoj se mosdeklarimi i kësaj huaje në Deklaratën Vetting, ndërkohë që më parë ajo ishte sqaruar në një deklaratë të dhënë nga ana ime përpara ILDKPKI nuk pasqyron ndonjë përpjekje timen për mos t'a deklaruar këtë hua apo fshehur atë. Ashtu sic shpjegova edhe më lart nuk duhet të harrohet se:

a) kjo hua rezulton nga një akt noterial i cili përbën një document me fuqi të plotë provuese për të pasqyruar ndodhjen e faktit juridik dhe kohës së ndodhjes së tij,
b) huaja në fjalë është shlyer nga familja ime brenda vitit ushtrimor të deklarimit, si një detyrim i pa mbartur në vitin pasardhës dhe
c) për më tepër unë isha i qartë se cdo deklarim që ne kishin bërë ndër vite, përfshi edhe shpjegimet përpara ILDKPKI do të konsideroheshin nga Komisioni gjatë procesit të rivlersimit.

Në zbatim të parimit të barazisë mendoj se anëtarët e Komisionit, vecanarisht komisioneret Genta Bungo dhe Pamela Qirko nuk kanë pasur asnjë justifikim ligjor dhe faktik të mos e konsiderojnë situatën time të deklarimit të kësaj huaje në kontekstin e vlerësimit që ato bënë për subjektin Artan Cupi. Personalisht nuk konstatoj një situatë të ndryshme deklarimi, përkundrazi deklarimi im në lidhje me këtë hua është në pozita më favorizuese. Kjo pasi ndërsa subjekti Cupi, i cili nuk i kishte deklaruar huatë marrë vëllait dhe babait të tij asnjëherë me DPV e kohës së krijimit të pasurisë, ai i ka vërtetuar ato gjatë hetimit përpara ILDKPKI me akte noteriale të hartuara në kohën e pyetjes nga inspektorët e këtij organi. Ndërkohë babai im këto akte noteriale i ka hartuar me huadhënësit në kohën e krijimit të pasurisë, situatë juridike që qartazi pasqyron faktin se nuk mund të vihet të dyshim as autenciteti i tyre dhe as ndodhja e faktit juridik në kohën e hartimit të këtyre akteve dhe rrjedhimisht as ndodhja e veprimit juridik në atë kohë.

Në pikën 36.5. Komisioni shprehet: ***"Kolegji ka një qëndrim tashmë të konsoliduar se pasaktësitë në deklarimet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Në rastin e subjektit të rivlerësimin nuk jemi në këto kushte, pasi ai, jo vetëm që nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit (shihni pikën 42 të këtij vendimi), por ka qenë kontradiktor në deklarimet e tij periodike, të cilat përbëjnë provë bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni konstaton se subjekti e ka deklaruar huan në shumën 2,000,000 lekë vetëm në vitin 2015, vit kur i është njoftuar nga ILDKPKI-ja se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme***

për apartamentit në shumën 1,537,040 lekë. Nga ana tjetër, në lidhje me pretendimin e subjektit se kontrata e huas vërtetohet me aktin noterial të datës 24.4.2006, Komisioni vlerëson se lidhja e kësaj kontrate jo detyrimisht provon që shumat e marra hua nga babai i tij janë përdorur për blerjen e këtij apartamenti, për më tepër ato janë marrë në një kohë më të vonë se pagesa e kryer për këtë apartament.

36.6. Mosdeklarimi i huas në deklaratën Vetting, si dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit, bëjnë që deklarimi i këtij të fundit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë, të bjerë ndesh me përcaktimet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, germa "a" e ligjit nr. 84/2016.

Përdorimi i këtyre argumenteve në konteksin e vendimarrjes që Komisioni ka marrë për personin tim, është jo vetëm një qëndrim kontradiktor në raport më arsyetimet e bëra më parë, por në të njëjtën kohë nuk ka asnjë relevancë për mua.

Kontradiktorialiteti i këtyre argumenteve në raport me arsyetimet e mëparshme të Komisionit rezulton nga fakti se është vetë Komisioni që në disa raste përdor vendimarrje të mëparshme për subjekte të tjerë rivlersimi për të hedhur poshtë pretendimet e mia, sic ndodhi në trajtimin e situatës time të deklarimit si të njëjtë më subjektet e rivlersimit Alfred Gjoni dhe Arjan Balliu (si dhe me shume subjekte të tjerë rivlersimi), edhe pse qartësisht deklarimi im nuk ka asgjë të përbashkët me deklarimin e këtyre subjekteve. Nëse Komisionin mban qëndrimin: "*bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni",* kurrsesi nuk mund të lejonte krahimin e deklarimeve të mia me ato të subjekteve të tjera të rivlersimit, vecanarsisht me subjektet e sipërcituar.

E gjej tërësisht të padrejtë qëndrimin e Komisionit, i cili kur nuk ka argumenta për të hedhur poshtë kërkesat e mia për aplikimin e parimit të barazisë, pretendon se *"cdo rast duhet të trajtohet sipas rrethanave individuale"*, ndërkohë që në raste të tjera ku gjoja gjen arsye për mospranimin e pretendimeve të mia nuk ngurron të më krahasojë me subjekte të tjerë rivlersimi.

Në lidhje me vendimet e cituara nga Komisioni, të cilat i përdor si praktikë e Kolegjit e detyrueshmë për zbatim (Vendimet nr. 28/2020, nr. 24/2021, nr. 25/2021, nr. 37/2021, nr. 20/2022 dhe nr. 29/2022) mendoj se këto vendime nuk kanë relevancë më situatën time të deklarimit. Nëse në lidhje me subjektet e gjykuara me keto vendime Kolegji ka deklaruar mungesë të burimeve të ligjshme dhe kontradiktorialitet në deklarime një gjë e tillë nuk ndodh me mua. Mungesa e burimeve te ligjshme të të ardhurave e pretenduar nga Komisioni, është rrjedhojë e mosnjohjes së të ardhurave të realizuara nga xhaxhai im nga aktivitetit tregtar, shitblerja e pasurive të paluajtshme dhe bëria e një analize financiare tërësisht të gabuar në lidhje me të. Nga ana tjetër në deklarimin e kësaj huaje unë nuk kam bërë asnjëhere deklarime kontradiktore, pavarsisht dëshirës së Komisionit për t'i konsideruar shpjegimet e mia si të tilla. Theksoj se ato shpjegime që unë kam dhënë përpara inspektorëve të ILDKPKI në vitin 2015 u kam qëndruar edhe më shpjegimet që kam dhënë me pyetësorin standart, me pyetësorët në vijim, më raporte përfundimtare dhe shpjegimet në seancën dëgjimore. Duke vlerësuar këtë fakt realisht nuk e kupton ku konsiston kontradiktorialiteti i pretenduar nga Komisioni.

Nisur sa më sipër mendoj se qëndrimi i Komisionit i cili nuk ka konsideruar huanë marrë nga babai im nga xhaxhai im Fahri Ymeri, si burim i ligjshëm i të ardhurave për blerjen e

apartamentit në fjalë, është një qëndrim tërësisht i gabuar, i paligjshëm, alogjik dhe i cili nuk bazohet në praktikat e mëparshme të KPK dhe KPA.

1.4 Në lidhje me vlerësimin e Komisionit në pikën *37.2:* ***"Subjektit, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, ka depozituar vërtetimin nr. 142 prot., datë 26.4.2022, të DRSSH-së Shkodër, i cili nuk përputhet me të dhënat e mësipërme, pasi deklarohet se babai i subjektit është trajtuar me pension suplementar para kohe për periudhën 1999 – 2016. Për sa më sipër, të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit nga pensioni suplementar janë marrë me rezervë, duke i kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar me dokumentacion provues mospërputhjen midis shkresës së ISSH-së dhe DRSSH-së Shkodër."*** i mbajtur që më aktin "Rezultatet e hetimit administrativ" ai ka marrë një përgjigje nga ana ime që në atë kohë si më poshtë: *"Përsa kohë Komisioni ka patur në dispozicion akte shkresore të lëshuar nga institucione shtetërore duhet të jetë i vetdijshëm për faktin se këto akte nuk prodhohen nga ana ime dhe mbi këtë shkak barra e provës nuk më përket mua por vetë institucionit që i la lëshuar ato. Ngarkimi i personit tim me këtë barrë të tillë prove në këto kushte mendoj se nuk ka si qëllim objektivitetin në ushtrimin e detyrës, por vetëm shpërqëndrimin dhe hallakatjen time, gjë që passjell cënimin e kohës nga unë në funksion të realizimin e një mbrojtje efektive. Bazuar në këtë cmuarje mendoj se Komisioni nuk mund të më ngarkojë mua me detyrimin e vënies në dispozicion të një informacioni të cilin fare thjeshtë mund t'a administrojë vetë përmes një shkrese drejtuar këtyre institucioneve. Ky qëndrim mbahet nga ana ime bazuar edhe në dëshirën që mos t'i jap asnjë mundësi Komisionit të vërë në dyshim ndershmërinë time nëse shkresa të tjera zyrtare që mund t'ju dërgoj mund të mos ju pëlqejnë në përmbajtjen e tyre apo t'ju krijojnë dyshime për parregullsi."*

Bazuar në qëndrimin që në vijim Komisioni mbajti në vendimin përfundimtar, ku në pikën 37.4 ai shprehet: ***"37.4. ...Nëse mbahen në konsideratë të dhënat e pasqyruara në këtë shkresë, rezultojnë të ardhura nga pensioni suplementar i babait vetëm për periudhën 2009 – 2016, ndërsa për periudhën paraardhëse nuk konfirmohen të dhëna. Pakësimi i të ardhurave të babait reflektohet me thellim të rezultatit negativ në analizën financiare. Komisioni, me qëllim mosthellimin e rezultatit negativ të analizës financiare të subjektit, vendosi që të përfshijë të ardhurat e babait nga pensioni suplementar, duke e ngarkuar subjektin vetëm me përgjegjësi për mungesë bashkëpunimi, e cila do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave."*** nuk më mbetet gjë tjetër vecse t'i falenderoj anëtaret e Komisionit për zemërgjerësinë dhe humanizmin që ato kanë treguar në vlerësimin e kësaj situate me minimumin e negativitetit që i karakterizon, të pasqyruar gjatë gjithë vendimarrjes në ngarkim të personit tim.

1.5 Në lidhje me vendimin e Komisionit: ***"Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion provues të ardhurat e përfituara nga babai i tij nga aktiviteti tregtar. Gjithashtu nuk arriti të provojë as pagimin e detyrimeve tatimore. Për sa i përket pagesave të kryera nga babai i subjektit në vitin 2022, për tatimin mbi të ardhurat individuale, ato nuk do të merren në konsideratë nga Komisioni, bazuar në vendimin nr. 15/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.....Për sa më sipër, subjekti nuk rezulton të ketë përmbushur asnjë nga rrethanat e përcaktuara nga Kolegji në vendimin nr.15/2021 në lidhje me të ardhurat e babait të tij, pasi ai nuk ka provuar***

bindshëm ekzistencën e këtyre të ardhurave, si dhe nuk ka provuar që babai i tij ka qenë i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e aktivitetit tregtar. Në lidhje me vendimet e cituara nga subjekti, Komisioni, për të mos rënë në përsëritje, paraqet të njëjta argumente si në pikën 36.4 e këtij vendimi. Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti tregtar nuk do të përfshihen në analizë financiare, për sa kohë ato nuk provohen me dokumentacion provues, si dhe babai i subjektit nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe, rrjedhimisht, nuk ka paguar as detyrimet tatimore" shpjegoj se ky qëndrim i Komisionit është tërësisht i paligjshëm dhe në kundërshtim me parimin e barazisë, duke më trajtuar në pozita më pak të favorshme krahasuar me subjekte të tjera që kanë qenë në kushte të ngjashme me personin tim, për të cilët të njëjtat anëtare Komisioni si dhe në procesin tim të rivlersimit mbajnë qëndrime të ndryshme, dhe për më tepër duke mos i dhënë përgjigje arsyetimit tim që në lidhje me të ardhurat e realizuara nga babai im në lidhje më këto aktivitete nuk duhet të kishte pagim të detyrimeve tatimore.

Me këtë rast gjej me vend të evidentoj vendimin me numër me numër **56, datë 01.08.2018 për subjektin e rivlerimit Dritan Hallunaj,** ku Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në përbërje të të cilin bëjnë pjesë dy anëtare të trupës time gjykuese konkretisht komisioneret Pamela Qirko dhe Genta Bungo) ka konsideruar si burime të ligjshme të ardhurat e babait të subjektit në shumën **30.000 euro**, për të cilat është bërë pagesa e detyrimeve tatimore gjatë kohës që subjekti do të dilte në seancën dëgjimore. Kështu nga vendimi në fjalë rezulton: *"Duke qenë se në dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP Shkodër, nuk pasqyrohet regjistrimi i aktit të heqjes dorë të z. F.H nga sipërfaqja prej 109 m², si dhe nuk rezultoi tatim i paguar për shumën prej 30.000 eurosh, subjektit iu kalua barra e provës…..Ndërsa në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Mandat datë 30.07.2018, këmbim valutor cash i "Raiffeisen Bank" për shumën 3.400 euro nënshkruar nga E. Ll. 2. Mandat datë 30.07.2018, derdhje për segmentin e taksave për pagimin e tatimit mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2012 në shumën 416.879 lekë nënshkruar nga E. Ll. 3. Urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për z. F.H në shumën 416.670 lekë. 4. Deklaratë Individuale Vjetore e të Ardhurave e z. F.H për vitin 2012 deklaruar në datë 30.07.2018……Bazuar në nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e burimit të pasurisë. Nga analiza e fakteve të mësipërme rezulton se personi tjetër i lidhur me subjektin, z. F.H, ka justifikuar me dokumentacion provues ligjshmërinë e burimit të pasurisë. Duke qenë se nga heqja dorë e të drejtës së pronësisë mbi këtë pasuri, personi tjetër i lidhur ka përfituar të ardhura, që më pas ia ka dhuruar subjektit, Komisioni vlerësoi edhe faktin nëse për këto të ardhura është paguar tatimi, siç parashikohet në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Nga provat e depozituara nga subjekti në seancën dëgjimore, rezulton se për shumën e përfituar nga z. F.H është paguar tatimi mbi të ardhurat personale në datën 30.07.2018, z. F.H, në cilësinë e individit, kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat personale në kuptim të pikës "dh" të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Neni 13/9 i po këtij ligji përcakton se për mosplotësim në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore. Neni 113 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se të gjithë tatimpaguesit, përveç tatimpaguesit të tatimit mbi fitimin, që nuk dorëzojnë në afatin e përcaktuar sipas ligjit përkatës deklaratën tatimore, për të cilën detyrohen sipas ligjit të deklarojnë, dënohen me 5.000 lekë gjobë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat. Pra ligji tatimor nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë*

detyrimet tatimore edhe me vonesë, për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor. ***Në vlerësimin e kësaj prove, Komisioni ka mbajtur parasysh se dispozitat e legjislacionit financiar nuk penqojnë paqimin e tatimit, përtej afatit të parashikuar, si dhe faktin që subjekt i detyrimit tatimor ka qenë babai i subjektit dhe jo vetë subjekti. Nëpërmjet paqimit të tatimit është përmbushur detyrimi ndaj buxhetit të shtetit duke u ligjëruar kështu burimi i këtyre të ardhurave në favor të subjektit.".***

Po kështu edhe nga vendimi me numër 187 datë 24.07.2019 i KPK në lidhje me subjektin e rivlersimit Elvin Gokaj, lënë në fuqi me vendimin me numër 181, datë 18.11.2020 të Kolegjit të Apelimit, është konsideruar si burim i ligjshem të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlersimit nga shitja e një automjeti në vlerën 5000 euro, shitje për të cilën detyrimet tatimore u paguan nga ky subjekt përpara kalimit në seancë dëgjimore. Ky fakt nuk u evidentua si problematikë nga Komisionit, nuk qe objekt ankimi nga Komisioneri Publik dhe po kështu nuk ka qenë objekt i trajtimit nga Kolegji i Apelimit, duke i konsideruar këto të ardhura si burime të ligjshme, në bazë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Vlerësimi i Komisionit se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare për shkak se nuk provohet realizimi i të ardhurave nga këto veprimtari/ aktivitete të ushtruara nga babai im bie në kundërshtim më provat të dërguara nga ana ime, që Komisioni ka patur për shqyrtim dhe konkretisht:

I. Deklarimet e mia peroidike për pasurinë dhe shpjegimet që kam dhënë përpara ILDKPKI. Të ardhurat nga këto veprimtari unë i kam deklaruar në kohë reale, pra në DPV-të e kohës, duke dhënë edhe shpjegime shtesë dërguar ILDKPKI, kohë kur unë as e kam ditur dhe as kam patur ndonjëherë mundësi t'a dija se do t'i nënshtrohesha ndonjëherë procesit të vetingut.

II. Provave rrethanore të paraqitura nga ana ime, për të provuar ushtrimin e aktivitetit të tilla si fotografi të kohës (babai im duke ushtruar këtë veprimtari), vendime të Gjykatës së Rrrethit Gjyqësor Shkodër (nr. 541, datë 16.03.2006) që provojnë rregjistrimin e babait tim si person fizik, me object veprimtarie "legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore, në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, Ambasadat e Huaja dhe institucionet të tjera shtetërore".

Nga ana ime pranohet fakti që në lidhje me këto veprimtari mungojnë të dhëna nga organet tatimore për të vërtetuar volumin e të ardhurave të realizuara nga babai im nga ushtrimi i tyre, por pavarsisht kësaj mendoj **se në zbatim të parimit të barazizë** Komisioni kishte detyrimin për të mi njohur këto të ardhura dhe përfshirë ato në analizën financiare.

Kjo bazuar jo vetëm në argumentimet e mia në bazë të legjislacionit tatimor për këto të ardhura, por edhe për shkak të praktikës së mëparshme të Komisionit me subjekte të tjerë rivlersimi, që kanë qenë në situata të ngjashme me personin tim, ku të njëjtat anëtare komisioni si në procesin tim të rivlersimit kanë mbajtur një qëndrim të ndryshëm.

Kështu evidentoj ***vendimin me numër 96, datë 09.01.2019Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlersimit Gentian Jahjolli, ku Komisioni njohu si të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlersimit shumën në vlerën 660.000 lekë, pas paraqitjes nga ky i fundit të provave rrethanore, por jo të drejtpërdrejta, për të provuar volumin e të ardhuravve të siguruara nga aktiviteti i babait te tij si shofer taksist.*** *" Edhe në rastin e këtij subjekti, ashtu si dhe në rastin e babait tim, nuk kishte një dokumentacion të qartë për të përcaktuar volumin e të ardhurave që ai kishte fituar, por subjekti paraqiti akte që provonin që ky aktivitet tregtar ishte ushtruar, gjë që u gjet bindës për Komisionin. "****Nga këto prova rrethanore Komisioni pranoi se***

aktiviteti i babait te subjektit të rivlersimit, jo vetëm kishte realizuar të ardhura për shpenzimet për jetesë të kësaj familje, por u çmua se edhe shuma prej 660.000 lekë, që ishte përdorur për investimin në pasurinë e paluajtshme, kishte këtë burim krijimi."

Po kështu, dhe me **vendimin me numër 31, të datës 04.07.2018 të subjektit të rivlersimit Arta Marku** nga ana e Komisionit u pranua si bindës shpjegimi i subjektit në lidhje me huanë në vlerën 1.200.000 lekë dhënë nga nëna e saj (pa akt shkresor), për blerjen e banesës nga subjekti. *"**Nëna e subjektit ishte rregjistruar si aktivitet tregtar "shitës ambulant" dhe ndërkohë gjatë viteve kishte depozituar vlera monetare në bankë. Pavarsisht kësaj nuk rezultonte volumi i të ardhurave të realizuara nga kjo veprimtari. Subjekti i rivlersimit me prova rrethanore provoi ushtrimin e aktivitetit, ku nga këto prova Komisioni vlersoi bindës argumentin e saj se nga ky aktivitet, jo vetëm ishin realizuar të ardhura për jetesën e nënës së subjektit, por edhe për krijimin e shumës dhënë hua kësaj të fundit, për blerjen e banesës**."*

III. Në vijim të procesit tim të rivlersimit unë ju kam dërguar akte që provojnë derdhjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga këto veprimtari nga babai (edhe vëllai im). Pavarsisht cmuarjes time bazuar në legjislacionin tatimor se në lidhje me të ardhurat në fjalë nuk duhet të paguheshin detyrime tatimore, evidentoj faktin se veprimi i kryer nga të afërmit e mi për pagimin e detyrimeve tatimore hedh poshtë cdo pretendim për moskonsiderimin e të ardhurave që kanë buruar nga këto aktivitete si të ardhura të ligjshme për efekt të procesit tim të rivlersimit, për arsye se në lidhje me këto të ardhura plotësohen të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës (Vlersimi i pasurisë), sipas të cilit: **"***Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore."* Kështu:

a) Këto të ardhura janë deklaruar në cdo moment nga ana ime si burime të krijimit të pasurisë, me DPV, shpjegime dhe memo përpara ILDKPKI.
b) Këto deklarime janë kryer në kohë reale me krijimin e pasurisë.
c) Në lidhje me këto të ardhura aktualisht janë paguar detyrimet tatimore.

IV. Theksoj se në raportin dërguar Komisionit mbi "Rezultatet e hetimit administrativ" unë kam pasqyruar shkaqet mbi të cilat të ardhurat e realizuara nga këto aktivitete duhet të më njiheshin si burime të ardhurash. Pavarsisht argumenteve të mia Komisioni nuk i ka njohur këto të ardhura si burime të ligjshme **pa një arsyetim bindës**, duke u mjaftuar në konkluzionin se unë nuk kam provuar volumin e të ardhurave të realizuara nga babai im. Duke e cmuar këtë vendim të Komisionit jo vetëm në kundërshtim me provat e paraqitura nga ana ime por edhe me praktikën e mëparshme të mbajtur nga të njëjtat komisionere në raste të ngjashme, mendoj se njohja e këtyre të ardhurave dhe përfshirja e tyre në analizën financiare do t'a fuste procesin tim të rivlersimit në shinat e ligjshmërisë, objektivitetit dhe barazisë.

Bazuar në këto shkaqe mendoj se situata ime e deklarimit të këtyre të ardhurave, për të cilat është realizuar pagimi i detyrimeve tatimore me vonesë, nuk bie ndesh me praktikën e vendosur me vendimin me numër 15/2021 të KPA, pasi në lidhje me këto të ardhura mendoj se plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën 23 të këtij vendimi dhe konkretisht.

- Nëpërmjet provave rrethanore të dërguara nga ana ime në Komision[42], por edhe deklarimit tim në DPV e kohës unë kam provuar realizimin e këtyre të ardhurave nga babai im.

[42] *Fotografi të kohës ku evidentohet ushtrimi i aktivietit tregtar të shitjes fruta-perime nga babai im, vendimi 562, datë 19.08.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për rregjistrimin e personit fizik të porosisë dhe agjensisë*

- Në lidhje me sjelljen për mospagimin e detyrimeve tatimor shpjegoj se shkaqet e mospagimit të këtyre detyrimeve tatimore nga babai im në kohën e realizimit të këtyre të ardhurave lidhen vecanarsisht me mënyrën e ushtrimit të aktiviteteve tregtare, të cilat cmuarjen time nuk e ngarkonin babain tim në atë kohë me pagimin e detyrimeve tatimore, të cilën do t'a trajtoj në vijim.
- As unë dhe as babai im nuk kemi qenë në kushtet e keqbesimit. Veprimtaria e ushtruar nga babai im ka qenë e ligjshme dhe nuk ka qenë product i ndonjë veprimtarie kriminale.

1.6 Në lidhje me vlerësimet e Komisionit: ***" 38.1Subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar kursime cash si më poshtë, të cilat sipas deklarimit të tij gjatë hetimit kanë qënë në vlerën totale 3,300,000 lekë..... Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e krijimit të kursimeve cash në shumën 1,500,000 lekë duke mos përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore trajtuar në pikën 48 të vendimit dhe nga puna e babait nga tregtia trajtuar në pikën 37.1-37.10 të vendimit..... nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka patur të ardhura të ligjshme për krijimin e kursimeve cash në shumën 621,964.07 lekë"*** theksoj se ky konkluzion është tërësisht i pasaktë dhe ka ardhur si rrjedhojë e mosnjohjes të burimeve të ligjshme të të ardhurave të familjes time.

Nga ana ime është deklaruar se shuma prej 3.300.000 (tremilion e treqind mijë) lekë është rezultat i kursimeve të pagave, pensionit të babait, aktiviteteve të familjarëve të mi dhe qerasë së tokës bujqësore, **e krijuar deri në përfundim të vitit 2006**. Pra kjo shumë nuk ka qenë e ardhur monetare e krijuar nga familja ime në kohën e blerjes së apartamentit, por ka qenë shumatorja e të gjitha të ardhurave monetare të familjes time në përfundim të vitit 2006.

Me konkretisht rishpjegoj se shuma prej 3.300.000 (tremilion e treqind mijë) lekë, e përmëndur në fq. 3, rubrika 2, e DPV 2006, (e plotësuar me datën 25.02.2007), nuk është e ardhur e fituar nga kontributet e anetarëve të familjes së origjinës, **vetëm për vitin 2006, por është** shumë e të ardhurave neto, (pasi zbriten shpenzimet e konsumit familjar), për vitet 2004, 2005 dhe 2006. Ky fakt konstatohet lehtësisht nga vetë përfshkrimi i shënuar në fq. 3, rubrika 2, të DPV 2006, që ka këtë përmbajtje: "*Gjatë vitit 2006, janë shtuar të ardhura në para duke arritur shumën **e përgjithshme** 3.300.000 (tremilion e treqindmijë) lekë*".

Fakti që shuma në fjalë është akumulim i kursimeve familjare për tre vite (2004, 2005 dhe 2006), del jo vetëm nga përshkrimi i sipërpërmëndur në DPV 2006, por edhe nga shpjegimet me shkrim që kam dhënë në vitet 2009, 2011 dhe 2015 në ILDKPKI, sipas nenit 27 të Ligjit nr. 9049 (të ndryshuar). Pra, duket qartë se në DPV 2006, unë nuk e kam deklaruar shprehimisht shtesën e pasurisë vetëm për këtë vit, (*që është në vlerën 1.762.960 (njëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë*), por e kam treguar këtë vlerë, sipas metodës së deklarimit progresiv, pra shtesa e pasurisë për vitin 2006, është **diferenca** ndërmjet pasurisë së akumuluar për tre vitet 2004, 2005 dhe 2006, me pasurinë e deklaruar në vitet 2005 dhe 2004.

Konkretisht,
- Sipas faqes 3 të DPV 2004, në datën 31.12.2004, familja ime e origjinës, ka patur 200.000 (dyqind mijë) lekë cash.

---

në emër të babait tim Faik Ymeri, vendimi 541, datë 16.03.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për rregjistrimin e personit fizik të porosisë dhe agjensisë në emër të babait tim Faik Ymeri.

Sipas faqes 3 të DPV 2005, unë nga paga si gjyqtar kam kursyer 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë cash + 400.000 (katërqindmijë) lekë nga toka bujqësore + 350.000 (treqind e pesedhjëtëmijë) lekë nga aktiviteti tregtar me pakicë i fruta perimeve të babait tim = përafërsisht 1.500.000 (njëmilion e pesëqind mijë) lekë. Këto janë kursime neto, pasi shpenzimet e konsumit familjar janë mbuluar nga një shumë e barazvlefshme me pensionin e babait tim si ish ushtarak, në një shumë të përafërt 150.000 (njëqind e pesedhjetëmijë) lekë + pagën si mësuese të nënës time, në një shumë të përafërt 300.000 (treqindmijë) lekë. Evidentoj se pensioni i babait për vitin 2005 dhe paga e nënës po për vitin 2006 gabimisht nuk janë deklaruar prej meje në fq. 4 të DPV 6, por për këtë gabim kam dhënë sqarime në ILDKPKI, kur jam pyetur sipas nenit 27 të Ligjit nr. 9049 (të ndryshuar), duke paraqitur edhe dokumentacionin provues përkatës.
Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga prindërit e mi nga paga dhe pensioni ju kam dërguar infomacion të detajuar të marrë pranë DRSSH.

<u>Në përmbledhje:</u> Shuma prej 3.300.000 (tremilion e treqind mijë) lekë, e përmëndur në fq. 3, rubrika 2, e DPV 2006, është akumulim që paraqitet si më poshtë:

200.000 (dyqindmijë) lekë, kursim i përmëndur në faqen 3 të DPV 2004.

+

1.500.000 (njëmilion e pesëqindmijë) lekë, shuma e kursimeve në fq 3 DPV 2005.

+

1.762.960 (njëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, në DPV 2006.

=

3.300.000 (tremilion e treqindmijë) lekë (përafërsisht, por pak me shumë).

Më poshtë po ju paraqes në mënyrë tabelare analizën financiare të vitit 2005.

Analiza financiare per vitin 2005

<u>Për vitin 01/01/2005- 31/12/2005</u>		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**	**2,103,254**	
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 2005	964,184	
1.2	Te ardhura nga pensioni i babait Faik Ymeri 2005	149,409	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2005	220,161	

Për vitin 01/01/2005- 31/12/2005		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 2005	-	
1.5	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga bursa Universiteti L.Gurakuqi	19,500	
1.6	Te ardhura nga aktiviteti si shites ambulant Faik Ymeri, sipas shkreses tatimore ……	350,000	
1.7	Te ardhura nga dhenia me qera e tokes nga Faik Ymeri tek Sheuqet Geci ,deklarate noteriale dt 16.02.2015, sipas shkreses tatimore …..	400,000	
1.8	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga asistent avokat dhe shitje fruta perime ,sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	-	
1.9	Te ardhura nga aktiviteti privat P/F legalizim dokumentash nga Faik Ymeri , sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	-	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Te ardhura nga shitja e shtepise Bushat, Rep 217, Kol 70 date 17.04.2000	-	
2.3	Apartament 73 m2 L. S. Halili, Shkoder		
2.3	Apartament 111 m2 Rr. A. Gj. Fishta, Shkoder - Faik Ymeri - 2006		
3	**Detyrimet**		**-**
3.1	Borxhe te marra nga Xheladin Cuf Thana, janar -mars 2006		
3.2	Borxhe te marra nga Fahri Fetah Ymeri, janar -mars 2006		
3.3	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi 1,500,000 leke 2006 - 2007		
3.4	Dhene Fahri Fetah Ymeri 2,000,000 leke 2006		
3.5	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi prej 1,500,000 leke 2006 - 2007		
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,103,254**
5	**Shpenzimet**		**438,228**
5.	Shpenzime jetese 2005	438,228	

Për vitin 01/01/2005- 31/12/2005		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1			
5.2	Shpenzime qeraje	0	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**200,000**	
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**1,714,490**	
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**	**150,536**	

Bazuar në raportin dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni evidentoj faktin se në të ardhurat e familjes time për vitet 2004, 2005 dhe 2006 (si rrjedhojë e së cilës u krijua shuma 3.300.000 (tremilion e treqind mijë) lekë) nuk janë njohur disa aktivitete të ushtruara nga familjarët e mi dhe konkretisht babai (si shitës ambulant dhe legalizim i dokumentave), vëllai im (si as/avokat..) dhe po kështu nuk kanë njohur të ardhurat e siguruara nga dhënia me qera e tokës bujqësore në shumën 600.000 lekë. Mosnjohja e këtyre burimeve të ardhurave të anëtarëve të familjes time ka sjellë si pasojë nxjerrjen e bilancit negativ në vlerën e pasqyruar në raport.

Më poshtë po riparashtroj argumentet e mia se përse nga aktivitetet e mësipërme familja ime ka realizuar të ardhura që duhet të njihen si të ligjshme dhe të përfshihen në analizën financiare (shpjegoj se edhe në mbrojtjen që unë i kam dërguar KPK mbi rezultatet e hetimit administrativ kam paraqitur këto argumente, por pavarsisht arsyetimit tim ligjor Komisionit nuk i njeh këto burime, pa dhënë asnjë shpjegim dhe vendimarrje të arsyetuar):

Së pari, lidhur me të ardhurat e babait tim në tregtinë me pakicë, që përmënden në DPV 2005 dhe në DPV 2006, ju sqaroj si më poshtë:

Sikurse kam dhënë shpjegime edhe kur jam pyetur në ILDKPKI, me memon e datës 13.02.2015, që i kam drejtuar këtij institucioni, të ardhurat e deklaruara për vitin 2005, "*nga puna e babait tim në tregti në shumën 350.000 lekë*", si dhe të ardhurat e deklaruara për vitin 2006, "*nga puna e babait tim si shitës ambulant me pakicë, në shumën 200.000 lekë*", janë të ardhura që ai ka realizuar në këto dy vite, si shitës ambulant me pakicë, fruta perimesh. Këtë veprimtari ai kryesisht e ka ushtruar në kohën e festave (veçanarisht në kohën e festave të fund vitit), me ndihmën e vëllait te tij, shtetasit Fahri Ymeri, i cili në atë kohë ka ushtruar veprimtari tregtare si tregtar fruta perimesh, me shumicë. Duke patur karakter jo të vazhdueshëm, veprimtaria tregtare e babait tim, ndonëse ka prodhuar të ardhurat e përmëndura më siper, nuk ka qënë e rregjistruar prej tij në organet tatimore. Për rrjedhojë unë jam në pamundësi objektive për t'a vërtetuar atë me ndonjë dokument zyrtar, që t'i jetë lëshuar babait tim, në atë kohë, të lëshuar nga organet kompetente tatimore.

Gjithsesi për t'a vërtetuar këtë veprimtari, unë kam paraqitur një deklaratë noteriale të datës 28.01.2022 të babait tim, që konfirmon sa më sipër si dhe të nënës time, shtetases Elvira Ymeri. Shpjegime në lidhje me këtë veprimtari unë kam dhënë jovetëm me DPV 2005 dhe 2006 edhe

gjatë pyetjes sime nga ILDKPKI, shpjegime që duhet të merren në konsideratë si pjesë e deklarimeve të mia për pasurinë.
Shpjegoj se fakti që babai im nuk është rregjistruar me inisiativën e tij në organet tatimore, nuk sjell si pasojë që veprimtaria e tij të jetë e paligjshme. Kjo pasi ai në atë kohë, ka ushtruar veprimtari si shitës ambulant me pakicë, pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit. Faktin që ai nuk e ka ushtruar aktivitetin në ndonjë vend fiks, e kam vërtetuar me dy fotografi të cilat i kam dërguar me përgjigjet e pyetësorit të dytë, në të cilat evidentohet qartë mënyra e ushtrimit të këtij aktiviteti tregtar nga babai im.
Sipas nenit 6, pika 4 të Ligjit nr. 8978, date 12.12.2002, "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël", rregjistrimi i babait im si shitës ambulant pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, duhet të ishte bërë nga organi kompetent tatimor. Kjo pasi në këtë nen përcaktohet "*Kur taksapaguesi nuk regjistrohet ose nuk riregjistrohet ne kohen e duhur, ai regjistrohet nga organi tatimor. Ky regjistrim ka te njëjtin efekt me regjistrimin ose riregjistrimin e bërë nga taksapaguesi dhe shoqërohet me sanksione, sipas nenit 12 pika 1.a te këtij ligji* ". Po i njëjti përcaktim gjendet edhe në nenin 12 të Ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar". Në këtë nen përcaktohet se "*Pika 1 e nenit 32/2 ndryshohet si me poshtë: "1. Te gjithë tatimpaguesit regjistrohen vetëm një here, ne çastin e fillimit te veprimtarisë ekonomike, para se te fillojnë biznesin. Përjashtimisht për vitin 2005, tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe/ose te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, riregjistrohen brenda datës 20 mars. Ne rastet kur tatimpaguesit nuk regjistrohen ose nuk riregjistrohen në kohën e duhur, degët e tatimeve bëjnë regjistrimin e tyre dhe ky regjistrim do te këtë te njëjtat efekte si regjistrimi i bërë nga vetë tatimpaguesit* ".
Në zbatim të këtyre normave juridike, rregjistrimi i babait tim si shitës ambulant me pakicë, pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, do duhej të ishte kryer nga administrata tatimore, dhe kjo gjë do të ishte e barazvlefshme me rregjistrimin e kryer nga vetë babai im. Për rrjedhojë, nëse administrata tatimore nuk ka vepruar në këtë drejtim, ose ka vepruar, (*gjë që unë besoj se duhet të ketë ndodhur, pasi prezumohet se personat zyrtar e zbatojnë ligjin dhe jo e kundërta*), por kjo administratë tatimore (*e Bashkisë Shkodër dhe/apo e Drejtorisë Rajonale Shkodër të Tatimeve*), për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, ose për shkak të mënyrës së organizimit që ka zbatuar për ruajtjen e fondit përkatës arkivor, nuk e disponon aktualisht dokumentacionin e rregjistrimit, **atëherë**, kjo nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi babain tim dhe aq më pak mua. Kjo pasi as unë dhe as babai im nuk kemi qënë përgjegjës për krijimin, ruajtjen dhe administrimin e fondit arkivor që do të dokumentonte rregjistirmin e babait tim, në administratën tatimore, si shitës ambulant me pakicë, pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit.
Në rastin konkret pamundësia aktuale e imja për të paraqitur dokument provues për rregjistrimin e babait tim si shitës ambulant pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, duhet të vlerësohet nga institucioni sipas nenit 32 të Ligjit mbi vettingun dhe nuk duhet të sjellë pasoja negative në drejtim të barrës së provës që më ngarkon ligji, për të vërtetuar burimet e ligjshme të të ardhurave në fjalë të babait tim. Kjo pasi vërtetohet se ose administrata tatimore nuk ka vepruar për rregjistrimin kryesisht të babait tim, ndonëse ka patur detyrim sipas normave juridike të mësipërme, ose edhe nëse ka vepruar, nuk disponon aktualisht të dhënat përkatëse arkivore, (*Gjë për të cilën i lutem Komisionit të kërkojë informacionin përkatës, pasi ndonëse unë kam bërë kërkëse në Bashkinë Shkodër, dhe në DRT Shkodër, akoma nuk më është kthyer përgjigje me shkrim, ndoshta për shkak të afatit të shkurtër*).
Nga fotografitë dhe nga deklarimet e bëra në DPV 2005 dhe DPV 2006, provohet se babai im e ka ushtruar aktivitetin në fjalë si shitës ambulant me pakicë, pa vend fiks të ushtrimit të

aktivitetit. Shpresoj që Komisioni të konsiderojë të ezauruar ninelin e provueshmërisë në këtë drejtim, pasi kjo është deklaruar që në vitet 2005 dhe në vitet 2006. Për më tepër DPV-të ku janë kryer këto deklarime, sikurse jam shprehur edhe më sipër, janë plotësuar me shkrim dore nga vetë babai im. Nga ana tjetër legjislacioni tatimor që normon mënyrën e mbledhjes të të ardhurave tatimore, gjithmonë është bazuar në deklarimin vullnetar të subjekteve tatimpagues. Vetë fakti që babai im as nuk është bërë ndonjëherë subjekt i kontrollit tatimor dhe as është penalizuar për fshehjen e të ardhurave, tregon se pasuria e deklaruar prej meje në DPV 2005 dhe DPV 2006, si e fituar nga babai si shitës ambulant, është e ligjshme.
Në kuptim të Ligjit mbi vettingun, duhet që pasuria e deklaruar jo vetëm të jetë e ligjshme, por duhet që të vërtetohen se mbi të janë paguar edhe detyrimet tatimore.
Unë vlerësoj se detyrimet tatimore të babait tim, lidur me aktivitetin si tregtar ambulant, kanë qënë zero. Kjo pasi në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", pikat 4, 4.1 dhe 4.2, parashikohet si më poshtë:

4. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

4.1 OBJEKTI I TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN

*Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj tatimpaguesve, pavarësisht nga forma e organizimit, **që nuk janë të regjistruar**, ose të detyruar me ligj për t'u regjistruar si tatimpagues për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.*

4.2 TARIFA E TATIMIT TË THJESHUAR MBI FITIMIN

Tarifa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 1.5% e të ardhurave bruto (qarkullimit) të tatimpaguesit. Për efekt të llogaritjes së bazës tatimore mbi të cilën llogaritet ky tatim nuk njihet asnjë lloj shpenzimi i zbritshëm.

4.3 PËRJASHTIMET

Në bazë të pikës 2 të Nenit 32/1 do të përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin:

a. Ambulantët në fushën e tregtisë.

Këtu përfshihen tregtarët lëvizës, pra që nuk kanë një vend fiks biznesi, por i tregtojnë mallrat ose produktet e tyre artizanale në mjete të thjeshta lëvizëse si karroca, apo qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara ku shesin me pakicë produkte artizanale ose produkte të tjera si gazeta, revista, pije freskuese, akullore, misra, zbukurime artistike, etj. Pra në këtë grup përfshihen tregtarë të vegjël ambulantë që nuk kanë dyqan apo një vend fiks në tregjet e shitjes me shumicë ose me pakicë;

b. Personat që merren me transport individual.

Këtu përfshihen shoferët e taksive, të furgonëve, autobusëve, kamionëve, kamionçinave apo të triçikleve që transportojnë pasagjerë apo mallra për nevoja të popullatës;

Përcaktimi i mësipërm, parashikohet edhe në nenin 32/1 të ligjit 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", që ka qënë në fuqi në periudhën kur babai im ka ushtruar veprimtari si shitës ambulant me pakicë, pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, në vitet 2005 dhe 2006.

Gjithsesi, edhe nëse do të konsiderohej se babai im, në ushtrimin e këtij aktiviteti, nuk është në kushtet e parasikuara nga pika 4.3, shkronja "a" të Udhëzimit si dhe nga neni 32/1 i ligjit 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", (pra me tatim zero), (hipotezë që unë besoj se nuk qëndron), përsëri është e pamohueshmen që ai sipas pikës 4.2 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", do duhet të paguantë një shumë prej 1.5% të ardhurave bruto (qarkullimit) të realizuar gjatë aktivitetit të tij tregtar.

Po të bëhet një përllogaritje aproksimative e tarifës 1.5%, që duhet të paguante babai im, për shumën 550.000 fitim, (për të dy vitet 2005 dhe 2006), si tregtar ambulant, do të diltë për të dyja vitet një shumë më e vogël së 8.000 (tetëmijë) lekë.

Ftoj Komisionin që të vlerësojë, sipas parimit të proporcionalitetit, **nëse është apo jo e drejtë**, që të ardhurat e babait tim si shitës ambulant, për vitet 2005 dhe 2006, të mos përfshihen në analizën financiare që do më bëhet mua. Kjo në kushtet kur në rastin më të keq të mundshëm, (*pasi unë mendoj se nuk duhet paguar fare tatim*), shuma e tarifës së papaguar, është shumë e vogël, por mosllogaritja e këtyre të ardhurave për të cilat **edhe mund** të duhej të paguhej tarifa, (*pra duke e marrë të mirëqënë këtë detyrim tatimor që në fakt për mua nuk ekziston*), mospagesa e kësaj tarife të vogël, shkakton pasoja juridike ekstremisht të mëdha.

Unë mendoj se mosllogaritja e të ardhurave në fjalë, jo vetëm do të binte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, por do të binte në kundërshtim gjithashtu edhe me parimin e barazisë përpara ligjit. Kjo pasi, që një pasuri të konsiderohet e ligjshme sipas ligjit mbi vetingun, duhet që subjekti i rivlerësimit të vërtetojë në mënyrë kumulative, dy kushte që janë:

a. Pasuria të jetë fituar në mënyrë të ligjshme. (*Unë mendoj se ky kusht plotësohet përsa i përket të ardhurave të fituara nga babai im si shitës fruta perimesh për vitet 2005 dhe 2006*).

b. Duhet që mbi pasurinë/të ardhurat, të jenë paguar detyrimet tatimore. (*Une përsëri se ky kusht plotësohet përsa i përket të ardhurave të fituara nga babai im si shitës fruta perimesh për vitet 2005 dhe 2006, por për t'a shtjelluar më konkretisht mendimin tim mbi zbatimin e parimit të barazisë, po abstragoj të kundërtën*). Duke e marrë të mirëqënë se do duhej paguar një tarifë shumë e vogël, pra më pak se tetëmijë lekë, në mënyrë që të ardhurat në fjalë, të më llogariten në analizën financiare, lind pyetja: - Cila sjellje përbën shkelje më të rëndë të rendit juridik, ngritja e një ndërtimi pa leje nga vetë subjekti i rivlerësimit, por që më pas është legalizuar, (*pasuri kjo e konsideruar e ligjshme nga jurisprudenca e KPK dhe e KPA*), apo mospagesa e një tarife shumë të vogël, më pak se tetëmijë lekë, edhe nëse merret e mirëqënë se kjo tarifë do duhej paguar ?

Unë mendoj se të ardhurat e babait tim për vitet 2005 dhe 2006, si shitës ambulant, duhen përllogaritur si burime të ligjshme, pasi veprimi në të kundërt do të binte në kundërshtim jo vetëm me parimin e proporcionalitetit dhe parimin e barazisë, por gjithashtu edhe me parimin e objektivitetit dhe me parimin e ligjshmërisë.

Parimi i objektivitetit do të shkelej pasi edhe nëse merret e mirëqënë se kjo tarifë do duhej paguar, (që e ritheksoj se unë vlerësoj se nuk qëndron), mosveprimi i babait tim për pagesën e kësaj tarife, në zanafillë është shkaktuar edhe nga mosveprimi i administratës tatimore për t'a rregjistruar aktivitetin e babait tim, edhe kryesisht, sipas nenit 6, pika 4 të Ligjit nr. 8978, date 12.12.2002, "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël", dhe nenit 12 të Ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar".

Parimi i ligjshmërisë do të shkelej, pasi edhe nëse merret e mirëqënë se kjo tarifë do duhej paguar në kohën kur janë realizuar të ardhurat, aktualisht, këto detyrime janë shuar përmes ligjit nr. 33/2017, "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore". Pra të ardhurat e babait tim si shitës ambulant, për vitet 2005 dhe 2006, pas veprimit të ligjit 33/2017, në rastin më të keq, ndodhen në pozitë të njëjtë sikurse ndodhen ndërtimet e paligjshme, por të legalizuara. Madje unë mendoj se në raport më ndërtimet e paligjshme, të ardhurat e babait tim kanë pozitë më të mirë. Kjo pasi në rastin e ndërtimeve të paligjshme, bëhet fjale për një pasuri të krijuar në mënyrë të paligjshme, (madje duke u konsumuar vepër penale), por që më vonë është legalizuar, ndërsa në rastin e të ardhurave të babait tim, edhe duke e marrë të mirëqënë se do duhej paguar tarifë, bëhet fjalë për pasuri të krijuar në mënyrë të ligjshme, për të cilën nuk janë paguar tatimet, por që më vonë, edhe detyrimi për pagesën e tarifës, është shuar me ligj.

Së dyti, lidhur me të ardhurat e babait tim si person fizik për veprimtarinë e legalizimit të dokumenteve parakonsullore dhe në Ministrinë e Jashtme, sipas vendimit të Gjykatës nr. 541, datë 16.03.2006, që përmënden në shumën 300.000 lekë, në faqen 4, rubrika e fundit e DPV 2006, ju sqaroj si më poshtë:

Nga pikpamja e faktit, këto të ardhura provohen pasi janë deklaruar prej meje që në vitin 2006 si dhe në sqarimet përkatëse që kam dhënë në ILDKPKI (shih memon e datës 13.02.2015 të cilën do Jua dëegoj bashkalilidhur).

Po ashtu provohen edhe nga kopja e vendimit të Gjykatës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. 541, datë 16.03.2006, të cilën e kam dërguar më përgjigjet e pyetësorit të dytë.

Ushtrimi i kësaj veprimtarie nga babai provohet edhe nga vendimi i Gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër, i vitit 2002, për rregjistrimin e babait tim si person fizik,të cilin po jua dërgoj bashkalidhur.

Kjo veprimtari që ka prodhuar fitimet prej përafërsisht 300.000 lekë, nga babai im, ka qënë e ligjshme. Kjo pasi në thelb, përmes saj babai im ka marrë përsipër që të transportojë dhe të dërgojë për të legalizuar në Ministrinë e Jashtme, të Drejtësisë dhe/apo në ambasadat e huaja në Tiranë, dokumente të ndryshme të banorëve të qytetit të Shkodrës, që kërkonin të emigronin dhe/ apo të udhëtonin për në shtetet e huaja. Këto dokumente këta kliente të kohës së babait tim, mund t'i dërgonin edhe me postë ose t'i legalizonin duke u paraqitur vetë në shërbimin konsullor në Ministrinë e Jashtme dhe/apo në shërbimin konsullor të ambasadave të huaja në Tiranë. Babai im, në atë kohë, përmes shërbimit të tij, merrte përsipër që t'i dërgonte doravisht në Tiranë si dhe t'i rikthente duke ia dorëzuar klientëve dokumentet e legalizuara, duke vepruar më shpejt në kohë sesa posta, si dhe duke u kursyer shpenzimet e udhëtimit klientëve. Për shërbimin e kryer ai

përfitonte shpërblimin përkatës. Kjo lloj marrëdhënie juridike, sipas Kodit Civil, ka tiparet e kontratës së porosisë (por me shpërblim). Kjo lloj marrëdhënie juridike jo vetëm që nuk është e ndaluar nga ligji por gjen rregullim në Kodin Civil, (kontrata e porosisë).

Fitimi tërësor i babait im nga kjo veprimtari, ka qënë rreth 300.000 (treqindmijë) lekë. Këto të ardhura janë fituar në mënyrë të ligjshme për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme të zgjatem më tej në shpjegimin tim lidhur me mënyrën se si janë fituar këto të ardhura.

Për ushtrimin e kësaj veprimtarie, babai im nuk ka patur vend fiks të ushtrimit të aktivitetit pasi ai këtë veprimtari e ka ushtruar përmes noterëve të qytetit të Shkodrës, të cilët e kontaktonin duke shërbyer si ndërmjetës ndërmjet tij dhe qytetarëve që kërkonin të legalizonin dokumentet.

Lidhur më tatimin apo tarifën që do duhej paguar për këto të ardhura, mendoj se vlen arsyetimi i përdorur më sipër, sikurse në rastin e të ardhurave nga shitja si tregtar ambulant fruta-perimesh. Kjo pasi sipas pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 8438, "Për të ardhurat", veprimtaria e babait tim, ka patur karakter ndihmës/përgatitor për noterët në ushtrimin e veprimtarisë së këtyre të fundit. Sipas kësaj normë juridike, im atë si tatimpagues konsiderohej se nuk kishte një vend të caktuar biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht apo pjesërisht biznesi i një personi.

Edhe në këtë rast, konsideroj se për përllogaritjen e tatimit, duhet zbatuar udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", pikat 4, 4.1 dhe 4.2, ku parashikohet se:

4. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

4.1 OBJEKTI I TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj tatimpaguesve, pavarësisht nga forma e organizimit, që nuk janë të regjistruar, ose të detyruar me ligj për t'u regjistruar si tatimpagues për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

4.2 TARIFA E TATIMIT TË THJESHUAR MBI FITIMIN

Tarifa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 1.5% e të ardhurave bruto (qarkullimit) të tatimpaguesit. Për efekt të llogaritjes së bazës tatimore mbi të cilën llogaritet ky tatim nuk njihet asnjë lloj shpenzimi i zbritshëm.

4.3 PËRJASHTIMET

Në bazë të pikës 2 të Nenit 32/1 do të përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin:

a. Ambulantët në fushën e tregtisë.

Këtu përfshihen tregtarët lëvizës, pra që nuk kanë një vend fiks biznesi, por i tregtojnë mallrat ose produktet e tyre artizanale në mjete të thjeshta lëvizëse si karroca, apo qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara ku shesin me pakicë produkte artizanale ose produkte të tjera si gazeta, revista, pije freskuese, akullore, misra, zbukurime artistike, etj. Pra në këtë grup përfshihen tregtarë të vegjël ambulantë që nuk kanë dyqan apo një vend fiks në tregjet e shitjes me shumicë ose me pakicë;

b. Personat që merren me transport individual.

Këtu përfshihen shoferët e taksive, të furgonëve, autobusëve, kamionëve, kamionçinave apo të triçikleve që transportojnë pasagjerë apo mallra për nevoja të popullatës;

Këtu theksoj se pika 4.3, shkronja "b" e udhëzimit, nuk ka karakter taksativ, por indikativ (orientues), pra përfshin jo vetëm shoferët, por përfshin çdo person që merret me transport individual mallrash për nevoja të popullatës, sikurse p.sh babai im që ka transportuar dokumentet që do të legalizoheshin në Ministrinë e Jashtme apo në ambasadat e huaja në Tiranë.

Nga ana tjetër, ky intepretim gjen mbështjetje edhe përkufizimin e tregtarit ambulant, sipas të cilit ambulant është personi fizik, që ka mbushur moshën 16 vjeç, i vetëpunësuar, i cili tregton mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, që ushtron aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike.

Po ashtu edhe lidhur me këto të ardhura të fituara nga babai im dhe që janë përmëndur në DPV 2006, mendoj se vlen gjithashtu arsyetimi i shprehur nga unë më sipër, lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, parimit të barazisë, parimit të objektivitetit dhe parimit të ligjshmërisë, (njësoj sikurse të ardhurat e analizuara më sipër të fituara nga babai im si shitës ambulant fruta-perimesh).

Parimi i proporcionalitetit do të të shkelej, pasi edhe nëse do konsiderohej se do duhej paguar tarifë, sipas pikës 4.2 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", kjo tarifë nuk do të ishtë më shumë se 4500 lekë. Mospagesa e kësaj tarife, nuk mund të sjellë si pasojë mosllogaritjen e këtyre të ardhurave për efekt të procesit tim të rivlerësimit, pasi haptazi nuk do të kishte balancë ndërmjet shkeljes se kryer (*duke abstraguar kundër qëndrimin tim dhe duke e marrë të mirëqënë se kjo është kryer*), më ndëshkimin e pritshëm.

Parimi i barazisë do të shkelej pasi, mospagesa e një tarife prej 4.500 lekë, qartazi është një shkelje shumë më pak e rëndësishme për rendin juridik, se bie fjala ngritja e një ndërtimi pa leje, qoftë edhe që është legalizuar. Aq më tepër që edhe duke e marrë të mirëqënë këtë mospagesë tarife prej 4500, ajo nuk është konsumuar nga unë por nga babai im. Pra ndërpritet lidhja shkakësore e drejtëpërdrejtë pasi mosveprimi ndonëse nuk është kryer nga unë, pasojat do më binin mua, madje ekstreme. Kjo shkel edhe parimin e gjykimit të drejtë.

Parimi i ligjshmërisë do të shkelej pasi detyrimi i babait tim për të paguar tarifën prej 4500 lekë është shuar përmes ligjit nr. 33/2017, "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore". Pra të ardhurat e babait tim si për vitin 2006, të përmëndura në rubrikën e fundit të faqes 5 të DPV 2006, pas veprimit të ligjit 33/2017, në rastin më të keq, ndodhen në pozitë të njëjtë sikurse ndodhen ndërtimet e paligjshme, por të legalizuara. Madje unë mendoj se në raport më ndërtimet e paligjshme, të ardhurat e babait tim kanë pozitë më të mirë. Kjo pasi në rastin e ndërtimeve të paligjshme, bëhet fjale për një pasuri të krijuar në mënyrë të paligjshme, (madje duke u konsumuar vepër penale), por që më vonë është legalizuar, ndërsa në rastin e të ardhurave të babait tim, edhe duke e marrë të mirëqënë se

do duhej paguar tarifë, bëhet fjalë për pasuri të krijuar në mënyrë të ligjshme, për të cilën nuk janë paguar tatimet, por që më vonë, edhe detyrimi për pagesën e tarifës, është shuar me ligj.

Parimi i objektivitetit, do të shkelej për arsye se pas vitit 2017 këto detyrime fiskale prej 4500 lekësh, (edhe duke e marrë të mirëqënë se ekzistojnë), janë falur dhe im atë nuk ka më mundësi juridike edhe sikur të dojë që t'i paguajë ato në administratën tatimore. Përveç kësaj duhet patur parasyh se nuk jam unë ai që nuk ka paguar tarifën në fjalë, edhe sikur kjo sjellje të konsiderohet e paligjshme. Për rrjedhojë mospagesa e kësaj tarife, nuk mund të sjellë si pasojë mosllogaritjen e këtyre të ardhurave për efekt të procesit tim të rivlerësimit, pasi haptazi nuk do të kishte balancë ndërmjet shkeljes se kryer (*duke abstraguar kundër qëndrimin tim dhe duke e marrë të mirëqënë se kjo është kryer*), më ndëshkimin e pritshëm.

Së treti, lidhur me të ardhurat e vëllait tim Gerti Ymeri, që përmënden në DPV në faqen 5 të DPV 2006, në shumën 250.000 lekë, sikurse sikurse kam përmëndur në veçanarisht në memon e e datës 13.02.2015, kur kam dhënë shpjegime me shkrim në ILDKPKI, sqaroj se ato përbëhen nga tre zëra:

a- Te ardhura te siguruara nga Universiteti Luigj Gurakuqi. Kjo pasi ne gjysmën e parë të vitit 2006 vëllai im ka perfituar burse studentore, pasi në vitin akademik 2004-2005, ka dalë me rezultate te shkëlqyera në studime (si shpërblim, në përputhje me rregulloren e universitetit, atij është akorduar bursë).
b- Të ardhura të siguruara si asistent avokat në Dhomen e Avokatisë Shkodër. Kjo për periudhën shtator 2006 - dhjetor 2006.
c- Te ardhura te siguruara nga puna e vëllait tim prane xhaxhait tim, shtetasit Fahri Ymeri, gjatë periudhës qershor 2006- gusht 2006.
Shuma tërësore e tre burimeve të mësipërme, faktikisht është shuma prej 250.000 lekësh e përmëndur si e ardhur për Gerti Ymerin në DPV 2006, faqja 5.

Për të vërtetuar këtë të ardhur kam depozituar në ILDKPKI një dekleratë noteriale të hartuar nga vëllai im, nëna dhe babai im, të cilën jua kam dërguar me rezultat e hetimit administrativ. Pra kjo e ardhur vërtetohet nga deklarimi në DPV 2006, fakti që kjo DPV është shkruar me dorën e babait tim, (që tregon se edhe ai që në atë kohë ka patur dijeni se kjo e ardhur ka ekzistuar në të vërtetë), shpjegimi plotësues që kam dhënë në ILDKPKI përmes memos së datës 13.02.2015 sipas nenit 27 të Ligjit 9049 (i ndryshuar), shpjegim ky që është dhënë prej meje përpara se të miratohej Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i vetingut.

Po ashtu, këto të ardhura vërtetohen edhe nga deklarata noteriale e bërë bashkarisht nga babai, nëna dhe vëllai im, e paraqitur në ILDKPKI, së bashku me memon e hartuar prej meje, përmes të cilës të gjithë këta e deklarojnë si të vërtetë atë pjesë të memos që iu referohet atyre.

Lidhur me faktin nëse janë paguar për këtë të ardhur detyrimet fiskale, vlerësoj se për bursën, kjo përjashtohet me ligj si e ardhur mbi të cilën paguhen detyrime tatimore. Lidhur me atë zë të kësaj të ardhure që është fituar nga vëllai im si shitës ambulant fruta perimesh, besoj se vlen i njëjti arsyetim sikurse ai i përdorur më sipër në rastin e të ardhurave të realizuara nga babai im si shitës ambulant fruta-perimesh pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit. Për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme të zgjatem më tej.

Lidhur me atë zë të kësaj të ardhure që është fituar nga vëllai im nga puna si asisent avokat, ju sqaroj se vëllai im meqënëse kam mbaruar Fakultetin Juridik me medalje të artë, pothuajse sa ka mbaruar fakultetin dhe është rregjistruar si as/avokat, është angazhuar duke hartuar kërkesë padi apo duke përgatitur materiale shkresore të ndryshme për llogari të avokatit ku është rregjistruar. Për këtë ka përfituar në tërësi një shpërblim që vëllai im nuk e mban mend saktësisht por që po të mblidhet me bursën dhe me atë që ka fituar si shitës ambulant fruta perimesh, nuk është më shumë se 250.000 lekë, sikurse kam deklaruar në DPV 2006 dhe në sqarimet që kam dhënë në vitin 2015 në ILDKPKI, (*shih memon si dhe dekleratat noteriale që i bashkangjiten asaj*). Lidhur me pagesën e tatimit për të ardhurën e përfituar si asisetent avokat, vlerësoj se sipas ligjit nr. 8438, "Për të ardhurat", tatimi mbi shpërblimin e punëmarrësit, mbahet në burim nga punëdhënësi. Për rrjedhojë nëse ky tatim nuk është mbajtur në burim nga punëdhënësi, ky fakt nuk mund të konsiderohet si penalizues në procesin tim të rivlerësimit, pasi nuk ka qenë përgjegjësi e vëllait tim.

<u>Së katërti: Lidhur me të ardhurat nga toka bujqësore</u> që përmënden në DPV 2005 dhe në DPV 2006, ju sqaroj se kjo e ardhur provohet nga vetë deklarimet e shprehura në DPV 2005 dhe DPV 2006.
Po kështu provohet edhe nga shpjegimet me shkrim që kam dhënë në ILDKPKI kur jam pyetur sipas nenit 27 të Ligjit 9049 (i ndryshuar), tre herë, dhe konkretisht në vitet 2009, 2011 dhe 2015, (procesverbale të cilat pavarësisht se besoj se i keni, po ua ridërgoj). Gjithashtu, provohet edhe nga fakti se sikurse jam shprehur më sipër, DPV 2005 dhe DPV 2006, janë plotësuar me shkrim dore nga babai im, (*gjë që tregon se edhe ky, në kohën kur janë plotësuar këto dy DPV, ka patur dijeni për ekzistencën e këtyre të ardhurave*).

<u>Përveç tyre, fakti që kjo e ardhur është realizuar, vërtetohet edhe nga një dekleratë noteriale e hartuar nga shtetasi Sheuqet Geci,</u> që është shtetasi që ka marrë tokën me qera në vitet 2005 dhe 2006, që e kam paraqitur së bashku me memon e datës 13.02.2015 në ILDKPKI, deklaratë kjo e bërë nga ky shtetas përpara përpara se të miratohej Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i vetingut.

Një gjë e tillë provohet edhe nga deklarata noteriale e bërë bashkarisht nga babai, nëna dhe vëllai im, e paraqitur në ILDKPKI, së bashku me memon e hartuar prej meje, përmes të cilës të gjithë këta e deklarojnë si të vërtetë atë pjesë të memos që iu referohet atyre. Të gjitha këto deklerata noteriale po ua ridërgoj.

Përsa i përket këtyrë të ardhurave që përshkruhen në shumën 400.000 lekë në DPV 2005 dhe në shumën 100.000 lekë në DPV 2006, vlerësoj se sipas ligjit për të ardhurat, është më së paku e diskutueshme nëse duhet apo jo për t'u paguar tatim mbi të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësëore prej pronarit, por gjithsesi, nëse Komisioni vlerëson se duhej paguar tatim, atëherë i lutem të ketë parasysh vleftën që ka patur ky tatim në vitin 2005 dhe 2006 si dhe në vijim, të zbatojë parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë, parimin e objektivitetit si dhe parimin e ligjshmërisë, që unë i përmënda më sipër, kur analizova ligjshmërinë e të ardhurave të babait dhë vëllait tim, (të cilat nuk po i përsëris për të mos u bërë i mërzitshëm).
Këto theksoj se babai im e ka paguar taksën e pasurisë tek pushteti vendor për këto vite **ku bashkalidhur unë do ju dërgoj një shkresë të marrë nga Bashkia Vau i Dejës që provon pagimin e tatimeve dhe taksave vendore për këtë pasuri nga babai im.**

Në drejtim të vlerësimit të të ardhurave të realizuara nga aktiviteti tregtar i babait tim dhe aktiviteti i vëllait tim si dhë të ardhurat nga toka bujqësore (*të përmëndura në DPV 2005 dhe në DPV 2006 si dhe në shpjegimet që kam dhënë në ILDKPKI në vitet 2009, 2011 dhe 2015*), mendoj se Komisioni duhet të ketë në konsideratë këto rrethana:
I. Të ardhurat nga këto veprimtari unë i kam deklaruar në kohë reale, pra në DPV-të e kohës, duke dhënë edhe shpjegime shtesë dërguar ILDKPKI.
II. Vlera e detyrimeve tatimore të papaguara në lidhje me këto të ardhura, (*edhe duke e marrë të mirëqënë si të bazuar faktin se këto detyrime do të duheshin paguar, pra kundër vlerësimit tim*), është shumë e vogël. Bazuar në këtë fakt çmoj se në bazë të parimit të proporcionalitetit unë nuk mund të ndëshkohem për mospagimin e këtyre detyrimeve tatimore, për më tepër që detyrimi për pagimin e tyre nuk ka qenë i imi, por i të afërmve të mi.
III. Edhe nëse aktualisht unë apo të afërmit e m'i do të tentonin t'i paguanin këto detyrime tatimore, ekzistojnë kushtet e pamundësisë objektive për t'a bërë këtë gjë. Kjo pasi për shkak të rregullimeve ligjore të kohës, ku këto detyrime janë shuar, pasi janë falur me ligj.
IV. Theksoj se të ardhurat e realizuara si rrjedhojë e këtyre aktiviteteve të ushtruara nga babai dhe vëllai im, nuk përbëjnë të ardhura të rëndësishme në drejtim të fitimit të pasurisë së paluajtshme-apartament banimi, që përbën objektin material të pyetjes. Kjo pasi sikur shumës së dy huave t'i shtohej vetëm paga ime si gjyqtar për vitet 2004 e 2005 dhe 4 muajt e parë të vitit 2006, (*pasi konsumi familjar minimalisht është mbuluar nga pensioni i pabait dhe paga si mësuese e nënës*), blerja e apartamentit të banimit do të dilte me bilanc pozitiv. Një mënyrë e tillë përllogaritjeje e të ardhurave të ligjshme (*që sipas meje jo vetëm nuk është e drejtë por nuk përputhet as me të vërtetën*), nuk do të sillte pasoja për përsa i përket ligjshmërisë së të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit që aktualisht kam në përdorim, pasi unë kam patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti. Kjo mënyrë përllogaritjeje e këtyre të ardhurave të ligjshme, (*që e ritheksoj nuk është e drejtë*), do të sillte si pasojë vetëm mosmbulimin e pjeshëm, me burime të ligjshme të kthimit të borxheve të marra për gjatë vitit 2006 për blerjen e apartamentit, por edhe këtu, ka pesë rrethana që sipas vlerësimit tim, shkaktojnë mungesën e përgjegjësisë time për efekt të procesit tim të rivlerësimit kalimtar.

Edhe pse gjatë gjithë procesit administrativ unë kam bërë një trajtim të hollësishëm faktik dhe juridik për shkak të të cilit Komisioni ose duhet t'i njihte ato si burime të ligjshme të të ardhurave, evidentoj faktin se nga ana e Komisionit nuk është marrë në konsideratë asnjë arsyetim të kryer nga ana ime, pa i kther përgjigje asnjë prej pretendimeve të mia.

Në funksion të parimit të paanshmërisë, ligjshmërisë, objektivitetit dhe barazisë mendoj se Komisioni kishte minimalisht detyrimin që nëpërmjet një arsyetimi juridik të hidhte poshtë argumentet e paraqitura nga ana ime, gjë që nuk e ka bërë, duke "*zgjedhur për të mos u shprehur fare në lidhje me to"*. Ky qëndrim i Komisionit, në vlerësimin tim pasqyron qartazi njëanshmërinë dhe paracaktimin e vendimit në drejtim të personit tim.

Në mënyrë tabelare analiza financiare e vitit 2006 paraqitet si më poshtë:

Për vitin 01/01/2006- 31/12/2006	**Vlersimi nga eksperti**

Nr	ANALIZA FINANCIARE	LEKE	
1	**Të ardhurat**		**2,168,960**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 2006	899,833	
1.2	Te ardhura nga pensioni i babait Faik Ymeri 2006	155,706	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2006	263,421	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 2006	0	
1.5	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga bursa Universiteti L.Gurakuqi	39,000	
1.6	Te ardhura nga aktiviteti privat Faik Ymeri pa vend fix ushtrimi te aktivitetit	200,000	
1.7	Te ardhura nga dhenia me qera e tokes nga Faik Ymeri tek Sheuqet Geci ,deklarate noteriale dt 16.02.2015, sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	100,000	
1.8	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga asistent avokat dhe shitje fruta perime ,sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	211,000	
1.9	Te ardhura nga aktiviteti privat P/F legalizim dokumentash nga Faik Ymeri , sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	300,000	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**3,936,000**
2.1	Te ardhura nga shitja e shtepise Bushat, Rep 217, Kol 70 date 17.04.2000		
2.2	Apartament 73 m2 L. S. Halili, Shkoder		
2.3	Apartament 111 m2 Rr. A. Gj. Fishta, Shkoder - Faik Ymeri - 2006	3,936,000	
3	**Detyrimet**		**700,000**
3.1	Borxhe te marra nga Xheladin Cuf Thana, janar -mars 2006	1,500,000	
3.2	Borxhe te marra nga Fahri Fetah Ymeri, janar -mars 2006	2,000,000	
3.3	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi 1,500,000 leke 2006 - 2007	-800,000	
3.4	Dhene Fahri Fetah Ymeri 2,000,000 leke 2006	-2,000,000	
3.	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi prej 1,500,000 leke 2006 -		

Për vitin 01/01/2006- 31/12/2006		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
5	2007		
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**(1,767,040)**
5	**Shpenzimet**		**438,228**
5.1	Shpenzime jetese 2006	438,228	
5.2	Shpenzime udhetimi 2006	-	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**1,714,490**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**14,809**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**194,413**

Bazuar në arsyetimin e mësipërm dhe në analizën financiare rezulton i qartë fakti se familja ime nuk ka qenë me bilanc negativ, sikurse konkludon Komisioni, por përkundrazi ka qenë me bilanc pozitiv në vlerën 194,413.

1.7 Në lidhje me vlerësimet e Komisionit në pikën 39.3 të vendimit: ***"Nga analiza financiare duket se z. Xheladin Thana nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1,708,274.85 lekë.....Për rrjedhojë shuma 1,500,000 lekë nuk do të përfshihet në analizë financiare për blerjen e apartamentit,*** shpjegoj sa më poshtë:

Në vlerësimin e burimeve të ligjshme të të ardhurave të huadhënësit të babait tim Xheladin Thana Komisioni nuk ka marrë në konsideratë asnjë nga shpjegimet dhe provat e dërguara nga ana ime nga të cilat rezulton qartë se shuma prej 1,500,000 lekë që ai i ka dhënë hua babait tim rezulton nga të ardhura të ligjshme.

Ashtu sic e kam shpjeguar gjatë gjithë procesit të rivlersimit burimet e ligjshme të të ardhurave të huadhënësit Xheladin Thana burojnë nga:
- ushtrim i aktivitetit tregtar nga ai,
- shitja e tokës së fituar në bazë të ligjit numër 7501.
- shfrytëzimi bujqësor i tokës,

1.Bashkëshorti i hallës time ka ushtruar aktivitet tregtar të shitjes së frutave – perimeve, me shumicë e pakicë për periudhën 1992 - 2014. Për të provuar këtë aktivitet tregtar, bashkëlidhur do ju dërgoj dokumente që më janë dhënë nga halla dhe bashkëshorti i saj, që janë:
a) "Çertifikata e rregjistrimit në organin tatimor" me numër serie 0101117, nga e cila rezulton se bashkëshorti i hallës Xheladin Cuf Thana, me vendimin e Gjykatës me numër 329, datë

01.03.2000 është rregjistruar në Degën e Tatim Taksave të Rrethit Shkodër (emërtim i asaj kohe) si "Biznes i Vogël", me Kod Fiskal 3304916, me adresë Dobraç, Komuna Rrethina, Shkodër.
b) Shkresë e DRT Shkodër (*vërtetimit me numër 3784/1 prot, datë 22.05.2014*), nga e cila rezulton se subjekti "Biznes i Vogel", në emër të Xheladin Thana, me NIPT: K46526085O, me adresë "Dobraç Shkoder", kur ka kaluar ne status "pasiv" me datën 21.05.2014.
c) Shkresa e DRT Shkodër, me numër prot 5533/1, datë 14.10.2021, drejtuar shtetasit XheladinThana, nga e cila rezulton kjo përgjigje: ***"****Në përgjigje të kërkesës tuaj nr 5533, dt. 14.10.2021 dhe çertifikatës së rregjistrimit në organin tatimor, me numër serial 0101117, konfirmojmë se subjekti Xheladin Thana është i rregjistruar me vendim gjykate nr. 329, datë 02.03.2000 me Kod Fiskal 3304916 dhe me aktivitet "Autodyqan".Sistemi tatimor elektronik (SIT) ka hyrë në zbatim në vitin 2005 për rregjistrimin e deklaratave tatimore. Nga të dhënat aktuale të sistemit C@ts të DRT Shkodër rezulton tatimpaguesi Xheladin Thana me NIPT: K46526085O dhe aktivitet "Transporti rrugor i mallrave", i cili është me status pasiv që nga data 21.05.2014. Bashkëngjitur Çertifikata e rregjistrimit në organin tatimor, me numër serial 0101117 dhe situata e printuar nga C@ts****".***
d) Dokumentacioni i mjetit furgon, në pronësitë bashkëshortit të hallës, dhe konkretisht mjetit me targë SH 8927 C , blerë me datë 21.02.2000 në vlerën 1.500.000 lekë, "autodyqan", që përbën edhe vendin në të cilin ai ka deklaruar për ushtrim të aktivitetit të tij në organet tatimore.

Unë kërkova në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër për ndonjë dokumentacion vërtetues për volumin e të ardhurave të siguruara nga kjo veprimtari tregtare, për periudhën 1992 – 1997, ku pavarsisht kërkimeve m'u bë i ditur fakti se në trazirat e vitit 1997 ky dokumentacion është djegur. Për rrjedhojë meqënëse është fakt i njohur botërisht, trazirat e vitit 1997, i kërkoj Komisionit që të konsiderojë sipas nenit 32 të ligjit 84/2016, pamundësinë time objektive për të vërtetuar ushtrimin e aktivitetit tregtar nga bashkëshorti i hallës time për këtë periudhë kohe.
Për të evidentuar faktin se bashkëshorti i hallës ka realizuar të ardhura si rrjedhojë e aktivitetit tregtar të ushtruar nga ai, theksoj se halla dhe bashkëshorti i saj nuk kanë patur të ardhura të tjera të ligjshme (vec shitblerjes së tokës, e cila ka ndodhur pas vitit 2000). Pavarsisht kësaj ata jo vetëm kanë përballuar shpenzimet e jetesës, por edhe kanë investuar në blerjen e pasurive (blerjen e automjetit në vlerën 1.500.000 lekë), gjë pasqyron faktin se nëpërmjet kësaj veprimtarie tregtare ata kanë realizuar kursime. Mbi bazën e këtij arsyetimi, bazuar në parimin e barazisë, i kërkoj Komisionit që vlersimi i burimive të ligjshme të të ardhurave të bashkëshortit të hallës time Xheladin Thana, si dhe të xhaxhait tim Fahri Ymeri, duke patur si burim aktivitetin tregtar të tyre, t'a bëjë duke iu referuar edhe praktikave të mëparshme të saj, pasqyruar me vendimarrje të tjera (vendimi nr. 96, datë 09.01.2019 për subjektin e rivlersimit Gentian Jahjolli, vendimin me numër 31, të datës 04.07.2018 të subjektit të rivlersimit Arta Marku etj).

2. Nga halla dhe bashkëshorti i saj me janë dhënë akte shkresore që provojnë faktin që familja e saj ka fituar tokë në pronësi, në bazë të ligjit numër 7501, ku një sipërfaqe së cilës ajo e ka tjetërsuar, duke realizuar të ardhura monetare, që e tejkalojnë shumën e dhënë hua tek babai im në vlerën 1.500.000 lekë**.**
Kështu mbi bazën e akteve të pronësise të cilat më janë vënë në dispozicion nga halla ime dhe bashkeshorti i saj, marrë nga Agjensia Shteterore e Kadastres Shkodër, rezulton se nga ana e tyre janë fituar, të vetëm dhe në bashkëpronesi, disa sipërfaqe toke, të cilat ndodhen në fshatin Dobrac Shkodër.

Mbi bazën e "Aktit të Marrjes të Tokës në Pronësi (pa datë) me numër akti 244, bashkëshorti i hallës sime ka marrë në pronësi një sipërfaqe toke prej 9000 m2, i vetëm, ku nga këto 8700 m^2 janë tokë arë.
Ndërkohë rezulton të ketë në bashkëpronësi me vëllezerit e tij edhe pasuri të tjera, toke arë, ndodhur në të njëjten zone kadastrale, të cilat janë shfrytëzuar nga ana e tij për prodhim produktesh bujqësore dhe shitjen e tyre (Bashkangjitur ju dërgoj dokumentacionin e ASHK Shkodër, që më është dhënë nga halla dhe bashkëshorti i saj për të gjitha pronat e tyre (pronësi dhe bashkëpronesi) dhe ndryshimet e gjendjes juridike te tyre ne vite, si dhe certifikatën e trungut familjar te bashkëshortit te hallës Xheladin (Xhelal) Thana) për të evidentuar lidhjet e gjinisë me bashkëpronarët e tjerë. Të gjitha këto pasuri janë të regjistruara në regjistrat publik të pasurive të paluajtshme të Zyrës Rajonale Shkodër dhe të gjitha këto pasuri janë të certifikuara rregullisht.

Një pjesë e këtyre pasurive është tjetërsuar nga ana e tyre, duke krijuar te ardhura monetare cash, ku nga dokumentacioni që më është dhënë kam mundur të evidentoj disa shitblerje, nga të cilat halla dhe bashkeshorti i saj kanë marrë të ardhura monetare, të cilat tejkalojnë shumën që i është dhënë hua babait tim në vlerën 1.500.000 lekë. Konkretisht janë shitur tre pasuri si më poshtë:

I. Përmes kontratës së shitblerjes me numër 2132 rep, 813 kol, të datës 23.07.1999, ku halla ime (bashkeshorti i saj) dhe familjare të bashkeshortit kanë shitur një toke në bashkëpronësi në vlerën 500.000 (peseqind mijë) leke dhe konkretisht është shitur pasuria me numër 144/67, me sipërfaqe 1500 m^2, ndodhur në zonën kadastrale me numër 1495, Dobrac Shkoder. Këtë dokument do t`jua rivë në dispozicion.

II. Me datën 27.12.2001 pasuria me numër 144/72, ndodhur në Zonën Kadastale me numër 1495 Dobrac Shkodër, në sipërfaqen 1668 m^2 ka ndryshuar pronesinë, nga bashkeshorti i hallës time Xheladin Cuf Thana, me numër pasaporte 1042879, që e kishte në pronësi, tek shtetasi me emrin Arif Brahim Pepaj, i cili e ka regjistruar këtë pasuri në emrin e tij dhe **shuma e paguar është në vlerën 1.751.400 (një milion e shtateqind e pesedhjetë e një mije e katërqind) lekë.** Ky fakt rezulton nga "Kartela e pasurise se paluajtshme" me këto të dhëna: Pasuria me numër 144/72, ndodhur në Zonen Kadastrale me numër 1495, volume 9, faqe 174, Dobrac Shkodër. (Ky dokument ndodhet ne faqen 7 te dokumentit me titull:1.2 DOKUMENTA PRONESIE - XH. THANA-55-99, që do t'jua dërgoj bashkëlidhur).

III. Xheladin Thana, i ka shitur shtetasit Fatmir Balijaj një sipërfaqe toke, në shumën 4.000.000 (katërmilion) lekë. Kjo shitje fillimisht është bërë me kontratën noteriale me nr. 2112 rep dhe nr. 598 kol, datë 11.12.2000 midis shitësve Xheladin e Fejzi Thana (vëllezër) dhe blerësve Sema e Fatmir Balilaj (nënë e bir), **për vlerën 1.800.000 (nje milione tetëqind mijë) lekë**. (Kjo kontratë është marrë nga dosja gjyqësore civile me nr. Regj. Them 887, datë 15.02.2010 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër të cilën po jua dërgoj bashkalidhur).
Çmimi nuk është paguar tërësisht nga blerësi i cili në kohën e lidhjes së kësaj kontrate, por është paguar vetëm vlera 1.800.000 (nje milione tetëqind mijë) lekë. Një pjesë tjetër prej 1.000.000 ia ka dhënë, gjithmonë sipas deklarimeve të bashkëshortit të hallës time, rreth viteve 2003-2004 por ai nuk e mban mend me saktësi. Pjesën tjetër nuk ia ka dhënë asnjëherë. Ndërkohë shtetasi (blerësi) Fatmir Balilaj e ka marrë në posedim sipërfaqen e tokës nga shitësi Xheladin Thana dhe

mbi të ka ngritur një ndërtim pa leje që aktualisht e përdor si shtëpi banimi. Meqënëse blerësi ka vonuar pagesën tjetër të çmimit, atëherë Xheladin Thana, në vitin 2010, ka hapur një proces gjyqësor, ku i ka kërkuar ose kthimin e sendit, sipas nenit 296 të Kodit Civil, ose pagimin e shumës së mbetur. Ky konflikt gjyqësor, ku avokat përfaqësues i Xheladin Thanës ka qënë av. Gerti Ymeri, që është vëllai im, është zgjidhur me pajtim, duke u pushuar gjykimi, me vendimin nr. 10.43, datë 19.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo pasi palët jashtëgjyqësisht janë dakortësuar që Xheladin Thana të merrte një pjesë të vlerës në konflikt që ai pretendonte se nuk i ishte paguar, ndërsa merrte përsipër detyrimin për të hequr dorë si nga e drejta e gjykimit të padisë, ashtu edhe nga një e drejta e tij për të kërkuar një pjesë të vlerës së papaguar.

Në përmbledhje rezulton se huamarrësi Xheladin Thana, vetëm nga shitja e tokave ka arkëtuar në periudhën 1999-2003 një shumë prej rreth 4 milionë lekë (nga tre shitjet e evidentuara), që konsiderohet e ardhur e ligjshme, sipas ligjit 84/2016, pasi në lidhje me këto veprim shitblerje janë paguar detyrimet tatimore dhe rezultojnë të rregjistruar në rregjistra publikë si veprime të ligjshme.

3. Nga halla dhe bashkëshorti i saj, por edhe për shkak të lidhjes së afërt në gjini, jam në dieni të faktit se nga ana e tyre ka pasur të ardhura edhe nga shfrytëzimi bujqësor i tokave të fituara në bazë të ligjit me numër 7501. Ashtu sic e shpjegova edhe më lart, halla dhe bashkëshorti i saj kanë fituar në pronësi sipërfaqe të konsiderueshme toke. Këto sipërfaqe toke janë përdorur nga ana e tyre jo vetëm për shitjen, por edhe prodhimin e produkteve bujqësore, ku një pjesë e tyre janë përdorur për konsum vetjak dhe disa janë shitur nga bashkëshorti i hallës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, meqenëse lidheshin me aktivitetin e tij (shitblerje fruta - perimesh).

Nga ana ime nuk mund të provohet se cila ka qenë vlera e të ardhurave të marra nga kjo veprimtari, por fakti që bashkëshorti i hallës dhe halla ime nuk kanë pasur ndonjë të ardhur tjetër (të paktën deri përpara shitjes së tokës në vitet 1999 dhe 2001) tregon qartësisht se të ardhurat e siguruara edhe në këtë formë kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për jetesë të tyre, ose kanë ndikuar në këto shpenzime.

Evidentoj faktin se në dieninë time halla dhe bashkëshorti i saj nuk janë trajtuar asnjëherë me ndihmë ekonomike, kjo edhe për shkak të faktit se në emër të bashkëshortit të hallës ishte rregjistruar një aktivitet tregtar dhe në bazë të ligjit personat me aktivitet tregtar nuk përfitojnë ndihmë ekonomike. Si të tillë ata nuk kishin asnjë burim tjetër të ardhurash, veç aktivitetit tregtar dhe shfrytëzimit të tokës. Pra edhe nëse nga ana ime nuk provohet fakti se të ardhurat e siguruara nga kjo veprimtari bujqësore - tregtare kanë qenë burim i huasë që më është dhënë, provohet minimalisht se me këto të ardhura halla dhe bashkëshorti i saj kanë mbuluar shpenzimet për jetesë, fakt që i ka mundësuar kursimin e të ardhurave të siguruara nga shitja e tokës.
Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji i Posacëm i Apelimit me vendimin me numër 18, datë 12.07.2021, në çështjen e subjektit të rivlersimit Ramiz Lala ku pranon *se të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore mund të kenë ndikuar apo ndikojnë në reduktimin e shpenzimeve për jetesë, të anëtarëve të saj"* .

Për të vërtetuar sa deklarova më sipër Komisionit i kam dërguar një deklaratë noteriale të hallës dhe bashshkëshortit të saj të datës 28.01.2022, nga e cila rezulton burimi i të ardhurave të huasë që i është dhënë babait tim.

Gjithashtu, në shpjegimet që po jap lidhur me burimet e të ardhurave të huadhënësit Xheladin Thana, i kam kërkuar Komisionin që të hetojë kryesisht mbi faktin - *Nëse në emër të Xheladin Thana, ka apo jo të dhëna në sistemin bankar të Republikës së Shqipërisë, (Bankën e Shqipërisë dhe/apo Bankat e nivelit të dytë), si dhe në organe shtetërore që ushtrojnë veprimtari administruese apo kontrolluese/mbikqyrëse në fushën ekonomiko financiare, (Ministria e Financave, etj), që tregojnë depozitimin/mbajtjen apo qarkullimin prej këtij shtetasi të vlerave monetare në periudhën ndërmjet datave 01.03.2000 - 21.05.2014, (qëështë periudha për të cilën nga provat e paraqitura nga ana ime, vërtetohet se bashkëshorti i hallës time ka ushtruar aktivitet tregtar të shitjes së frutave – perimeve, me shumicë e pakicë sipas vendimit të Gjykatës me numër 329, datë 01.03.2000, mbi bazën e të cilit është rregjistruar në Degën e Tatim Taksave të Rrethit Shkodër (emërtim i asaj kohe) si "Biznes i Vogël", me Kod Fiskal 3304916, me adresë Dobraç, Komuna Rrethina, Shkodër, dhe në vijim është rirregjistruar si "Biznes i Vogel", në emër të Xheladin Thana, me NIPT: K46526085O, me adresë "Dobraç Shkoder", duke kaluar në status "pasiv" me datën 21.05.2014)* ?

Sipas asaj që më ka deklaruar babai im Faik Ymeri, dhe që këtij të fundit i ka thënë motra e tij Lirije Thana, familja e tyre gjatë periudhës së kohës në fjalë, ka patur të depozituar në tërësi, mbi 10.000.000 (dhjetëmilion) lekë. Këtu sqaroj se shumën e saktë unë nuk e di dhe as mund t'a di pasi nuk kam mundur të kontaktoj vetë personalisht me shtetasin Xheladin Thana, se çfarë shumash monetare ka depozituar ai në sistemin bankar, për periudhën 01.03.2000 - 21.05.2014. Kjo e dhënë paraqet rëndësi pasi mbi bazën e saj mund të përllogaritet me përafërsi, fitimi (të ardhurat) që ka patur ky shtetas nga veprimtaria tregtare e shitjes së fruta perimeve, nëse administrata tatimore nuk ka të dhëna të sakta në këtë drejtim. Po ashtu mund të vlerësohet me përafërsi fakti nëse shtetasi Xheladin Thana, ka patur apo jo mundësi të kursejë nga aktiviteti tregtar i tij për gjatë viteve 1991-2014 shumën e të ardhurave në fjalë. Një e dhënë e tillë paraqet shumë rëndësi për efekt të procesit tim të rivlerësimit kalimtar, pasi në kushtet kur shtetasi Xheladin Thana, halla ime Lirije Thana, dhe/apo anëtarë të familjes së tyre, nuk rezultojnë të dënuar, si dhe nuk rezultojnë që të kenë qënë ndonjëherë persona nën hetim për kryerjen e ndonjë vepre penale, madje nuk rezulton as që të kenë qënë ndonjëherë subjekte mbi të cilët administrata tatimore të ketë marrë masa për ndonjë kundravajtje administrative, atëherë, përmes prezumimeve të thjeshta, arrihet në përfundimin që këto të ardhura janë fituar në mënyrë të ligjshme si dhe për to prezumohet se janë paguar tatimet dhe taksat, nëse vërtetohet që dokumentacioni që ka në fondin arkiv administrata tatimore, është i plotë, i saktë dhe pa mangësi.

Lidhur me të ardhurat e fituara nga Xheladin Thana nga aktiviteti tregtar i tij si biznes i vogël, për periudhën 1991-2005, që paraqet relevancë për qëllimet e procesit tim të rivlerësimit, shpjegoj se meqënëse bëhet fjalë për biznes të vogël, sipas Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", biznesi i vogël është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Sipas nenit 6, pika 4 të Ligjit nr. 8978, date 12.12.2002, "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël", dhe nenit 12 të Ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar", veprimtaria tregtare e

shtetasit Xheladin Thana, si biznes i vogël, edhe nëse nuk është rregjistruar prej tij, (*në fakt rezulton nga provat që kam dorëzuar se ai e ka rregjistruar rregullisht*), do duhej të rregjistrohej kryesisht nga organet tatimore dhe kjo do të ishte e barazvefshme me rregjistrimin e kryer nga vetë subjekti. Prezumohet ligjërisht që organet shtetërore e zbatojnë ligjin dhe jo e kundërta. Pra, prezumohet se veprimtaria e shtetasit Xheladin Thana ka qënë e rregjistruar. Sipas nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, "*faktet për të cilat ekziston një prezumim ligjor nuk ka nevojë të vërtetohen nga pala në dobi të të cilës ekziston prezumimi*" . Përveç prezumimit të rregjistrimit ka edhe një prezumim tjetër, që ka si premisë bazë arsyetimin se prezumohet që organet shtetërore të ngarkuara me ligj për mledhjen e taksave dhe tatimeve e zbatojnë ligjin, për mbledhjen me forcë të detyrimeve fiskale nëse subjekti nuk i paguan ato në mënyrë të vullnetshme. Vetë fakti që shtetasi Xheladin Thana, nuk rezulton të jenë bërë ndonjëherë subjekt kontrolli tatimor apo të procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve, tregon që këto detyrime, në masën 1.5% të të ardhurave për secilin vit ushtrimor të ushtrimit të aktivitetit, prezumohet se janë paguar në mënyrë të vullnetshme. Ajo që nuk vërtetohet dot me saktësi është volumi i veprimtarisë tregtare brenda fashës së biznesit të vogël dhe të ardhurat konkrete. Lidhur me këtë aspekt ftoj Komisionin që duke iu referuar të dhënave të mundshme të INSTAT dhe/apo anketave korresponduese të Bankës së Shqipërisë, **si dhe veçanarisht të dhënave mbi depozitat e shtetasit Xheladin Thana, të marra në sistemin bankar**, të bëjë një vlerësim të përafërt të fitimit të mundshëm që mund të ketë realizuar ai për periudhën 1991 - 2005, nga aktiviteti i tij si biznes i vogël i shitjes së fruta perimeve. Në këtë drejtim i kam kërkuar Komisionit që në vlerësimin e rëndësisë që ka në proçesin e rivlerësimit tim kalimtar, ky burim të ardhurash të shtetasit Xheladin Thana, të marrë në konsideratë edhe faktin që unë e kam vërtetuar tashmë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij, në një vlerë që e kapërcen pothuajse me 50% shumën prej 1.500.000 lekë që ai i ka dhënë hua në vitin 2006 babait tim Faik Ymeri, (*vetëm përmes shitjes së dy sipërfaqeve të tokës të lartëpërmëndura*). Për rrjedhojë, në rastin më të keq të mundshëm, burimi i të ardhurave të shtetasit Xheladin Thana si shitës fruta-perimesh me shumicë dhe pakicë, për gjatë viteve 1998-2006, duhet konsideruar si burim që në mos ka ndikuar, të paktën ka mjaftuar për përballimin e shpenzimeve të konsumit familjar për periudhën korresponduese. Po rezultuan vlera të depozituara edhe në sistemin bankar, atëherë qartësisht ky shtetas krahas konsumit familjar ka realizuar edhe të ardhura të ligjshme, mbi të cilat prezumohet se janë paguar taksat dhe tatimet, nga aktiviteti i tij tregtar.

Këtu sqaroj se sipas asaj që më ka deklaruar babai im Faik Ymeri, dhe që këtij të fundit i ka thënë motra e tij Lirije Thana, familja Thana shumicën e parave të kursyera nga të gjitha burimet e lartëpërmëndura, në pjesën më të madhe të kohës i ka ruajtur në shtëpi, në gjendje cash në pjesën më të madhe të kohës. Kjo për shkak të frikës që ata kanë perceptuar se mund t'i humbnin këto kursime, po t'i ruanin në sistemin bankar, frikë kjo që në vlerësimin tim, në raport me kohën, ka qënë deri diku e përligjur. Kjo pasi dihet botërisht kumbja e kursimeve të shumë familjjeve shqiptare gjatë skemave piramidale, që kulmuan me trazirat e vitit 1997. Kjo frikë në perceptim, është e dukshme edhe po të shikohen anketat e korresponduese të Bankës së Shqipërisë, ku vihet re se shtimi i depozitave si kursime familjare, ka ndodhur gradualisht pas vitit 2005 e në vijim. Këtu dëshiroj të theksoj se shtetasi Xheladin Thana, për gjatë rrjedhës së kohës, nuk ka patur dhe as nuk ka ndonjë detyrim ligjor që kursimet e tij t'i ruajë përmes sistemit bankar. Po ashtu dëshiroj të ritheksoj nenin 13/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "*faktet e njohura zyrtarisht apo botërisht nuk kanë nevojë të vërtetohen*". Fakte të tilla janë p.sh trazirat e vitit 1997 dhe frika që kanë perceptuar shumë familje shqiptare për të ruajtur kursimet e

tyre përmes sistemit bankar, pas këtyre trazirave të shkaktuara në zanafillë nga skemat mashtruese piramidale që ushtronin aktivitet financiar të liçensuar nga shteti.

Në lidhje me qëndrimin e Komisionit: "**Nga hetimit dhe analiza financiare z. Xheladin Thana nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huasë"** theksoj fillimisht se bëria nga ana e Komisionit të një analize financiare si ajo e pasqyruar në vendim, për "personin tjetër të lidhur" Xheladin Thana **është në kundërshtim të hapur me praktikën tashmë të konsoliduar me vendimin e Kolegjit të Posaçëm i Apelimit, me vendimin me numër nr. 15, datë 17.07.2019, i cili ka vendosur këtë standard:** ***"[...]*** *Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016,* ***ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.*** *Interpretimi në të kundërt i kësaj pasurie konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai është ngarkuar ligjërisht të mbajë* ***dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur [...].***

Në këtë shpjegim, në drejtim të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të shumës së dhënë hua nga personi tjetër i lidhur, ka cituar, po ashtu edhe pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ku një nga parimet mbi bazën e të cilit kryhet procesi i rivlerësimit është ai i proporcionalitetit. Sipas nenit 52 të këtij ligji në lidhje me standardin procedural të barrës së provës, Komisioni dhe Kolegji i Apelimit udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit. Për kryerjen sa më korrekt të procesit të kontrollit të pasurisë, ligjvënësi, por edhe vetë Komisioni nëpërmjet parimit të proporcionalitetit pranojnë zgjidhjen e çështjeve dhe marrjen e vendimeve duke pasur në konsideratë gjendjen që e dikton këtë vendimmarrje dhe ka kërkuar që të analizohet ky parim edhe në këndvështrim të zhvillimit historik dhe ekonomik të vendit tonë, situatës së informalitetit të krijuar, ndër vite, për shkak të rrethanave specifike të zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike dhe specifikisht, reminitancave të përftuara nga emigracioni".

Nga analiza financiare që Komisioni i bën "personit tjetër të lidhur" Xheladin Thana rezulton qartazi se ajo e barazon atë në cilësi me vetë subjektin e rivlersimit, qëndrim i cili del jashtë qëllimit të ligjit 84/2016. Detyra ime si subjekt i rivlersimit në lidhje me huanë e dhënë babait tim nga personi tjetër i lidhur Xheladin Thana është të provoj ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua dhe jo të provoj mundësinë e krijimit të cdo pasurie nga ky shtetas gjatë jetesës së tij.

Ky qëndrim i mbajtur nga Komisionit në lidhje me personit tjetër të lidhur Xheladin Thana bie ndesh edhe me praktikat e mëparshme të mbajtura nga të njëjtat anëtare të cilat kryejnë procesin tim të rivlersimit dhe konkretisht Pamela Qirko dhe Genta Bungo. Kështu gjej me vend të evidentoj vendimin e formës së prerë nr. **283, datë 29.07.2020 të KPK për subjektin e rivlersimit Altina Nasufi.** *"Në lidhje me këtë subjekt KPK bëri një hetim të thelluar nga ku rezultoi: Subjekti i rivlersimit kishte marrë hua kunatës së saj një shume të konsiderueshme monetare (27.000 euro), për blerjen e apartamentit të saj, shumë e cila pretendohej të ishte fituar në emigracion. Komisioni pasi vlersoi dokumentacionin për burimin e ligjshëm të të ardhurave, në lidhje me personit tjetër të lidhur (huadhënësen), konkludoni se shuma e të*

ardhurave të fituara nuk mjaftonte edhe për dhënien e huasë edhe për përballimin e jetës nga ky person. E pyetur për shpjegimin e këtij fakti subjekti i rivlersimit referoi te vendimi me numër 15, datë 17.07.2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në lidhje me vlersimin e burimit të ligjshëm për personin tjetër të lidhur (sic është halla ime dhe bashkëshorti i saj)". KPK, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, bazuar edhe në praktikën e KPA, të sipërcituar, ka pranuar bindëse shpjegimet e subjektit, duke konsideruar huanë për këtë subjekt, si burim të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Në një rast tjetër, në lidhje me subjektin e rivlersimit Arben Nika, **me vendimin me numër 445, datë 16.09.2021 KPK (vendim i formës së prerë),** ka pranuar si burime të ligjshme të krijimit të huave të dhëna në shumat 1,300,000 lekë dhe 10,792 euro (nga të afërme të tij) burime të krijuara shumë kohë përpara dhënies së huasë, të tilla si mësimdhënia, interesa nga shoqëria huamarrëse ....(më shumë se 10 vjet më parë), përdorimi bujqësor i tokës, **dhurata nga shoqata humanitare (????)** etj, pa i hyrë llogaritjes së faktit nëse këta persona të tjerë të lidhur, kishin edhe shpenzime të tjera jetese apo shpenzime per blerje pasurie te luajtshme apo të paluajtshme.

Në zbatim të parimit të ligjshmërisë dhe barazisë mendoj se Komisioni duhet të mbajë të njëjtin qëndrim që ka mbajtur për subjektet e tjera të rivlersimit në këto raste, edhe në lidhje me personin tim.

Gjej me vend të evidentoj faktin se analiza financiare e bërë nga Komisioni në lidhje me "personin tjetër të lidhur" Xheladin Thana është tërësisht e gabuar dhe niset nga premisa të gabuara.

Kështu evidentoj faktin se Komisioni nuk njeh në të ardhurat e Xheladin Thanës të realizuara nga aktiviteti tregtar, pavarsisht faktit se nga provat e paraqitura nga ana ime provoj katërcipisht se ky shtetas ka realizuar të ardhura nga kjo veprimtari. Të provuarit të këtyre të ardhurave rezulton jo vetëm nga dokumentacionet e paraqitura nga ana ime, por edhe bazuar në faktin se ne shkurt të vitit 2000 ky shtetas ka blerë një automjet furgon, të cilin e ka deklaruar në organet tatimore si vend të ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare.

Keqdashja e Komisionit në mos njohjen e burimeve financiare të Xheladin Thanës si rrjedhojë e këtij aktiviteti, shkon deri në pikën ku shpenzimet për blerjen e automjetit, në shumën 1.500.000 lekë vazhdon t'i zbresë nga të ardhurat e realizuara nga dy shitje të sipërfaqeve të tokës bujqësore, **që në kohë datojnë pas blerjes së automjetit.**

Kështu nëse automjeti në fjalë është blerë me datën 21.02.2000, shitja e pasurive të paluajtshme me datën 11.12.2000 në vlerën 1.800.000 lekë (nga e cila 1.200.000 lekë janë llogaritur në favor të Xheladin Thanës si pronar i 2/3) dhe shitja e datës 27.12.2001 në vlerën 1,751.400 lekë, janë bërë shumë kohë pas blerjes së automjetit.

Nga kjo rezulton qartë se vlera e të ardhurave të fituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme tokë nga Xheladin Thana nuk ka shërbyer për blerjen e automjetit, i cili ishte blerë shumë kohë më parë (10 muaj nga shitja e parë dhe thuajse dy vjet nga shitja e dytë). Mbi këtë bazë nuk ka asnjë llogjikë të shëndoshë të mendohet se të ardhurat e ardhurat e realizuara nga shitja e tokës kanë

shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Mbi këtë bazë mendoj se zbritja e vlerës së blerjes së automjetit nga të ardhurat e realizuara nga shitjet e mëvonshme është një veprim tërësisht i gabuar dhe keqdashës.

Në pikën 40.4. të vendimit në lidhje me analizën financiare që i ka bërë personit tjetër të lidhur Xheladin Thana Komisioni shprehet: **"*Në lidhje me analizën financiare, Komisioni e ka kryer këtë analizë bazuar në të dhëna të cunguara dhe jo të plota për sa i përket shpenzime të familjes Thana, pa u marrë në konsideratë: (i) përbërja e plotë familjare (familja Thana ka pasur tre fëmijë në përbërjen e saj familjare në momentin e dhënies së huas); (ii) shpenzimet e mundshme në investime të kryera; dhe (iii) huadhënie të tjera të mundshme apo shpenzimet nga sistemi TIMS. Në këtë analizë, referuar edhe kërkesave të subjektit, janë përfshirë vetëm shpenzimet jetike për dy persona dhe likuiditetet në bankë. Pra Komisioni nuk e ka barazuar familjen Thana me subjektet e rivlerësimit, si dhe nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për llogaritë bankare të familjes Thana apo për blerjen e automjetit.*
*Në lidhje me pretendimin e subjektit që shuma 1,500,000 lekë për blerjen e automjetit të mos përfshihet në analizë financiare, Komisioni, pavarësisht se kjo kërkesë e subjektit nuk është e bazuar, edhe sikur të mos e përfshijë në analizë financiare, sërish rezultati nuk do të ndryshonte, pasi nga ana e familjes Thana në vitin 2005 është rritur gjendja e tyre në banka në vlerën 2,000,000 lekë, duke mos qenë i bazuar pretendimi i subjektit se ato kanë pasur gjendje në bankë shumën 10,000,000 lekë, për rrjedhojë, ato nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1,500,000 lekë. Gjithashtu, edhe sikur në këtë analizë të hiqen shpenzimet jetike, sërish familja Thana rezulton me pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje"***

Konstatoj se këto shpjegime të Komisionit nuk zhbëjnë trajtimin që ata i kanë bërë "personit tjetër të lidhur" Xheladin Thana, të cilin realisht e kanë barazuar me vetë subjektin e rivlersimit në lidhje me mënyrën sesi i kanë kryer analizën financiare të tij. Ashtu sic e arsyetova edhe me lart mendoj se "personit tjetër të lidhur" nuk mund t'i bëhet analizë financiare si ajo që ka bërë Komisioni, pasi një veprim i tillë bie ndesh me praktikën e vendosur me vendimin me numër 15/2019 të KPA sipas të cilit subjekti i rivlersimit "***duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur".***

Bazuar në aktet shkresore të sipërcituara rezulton qartë se vetëm nga shitja tokave të kryera nga shtetasi Xheladin Thana në vitet 2000 dhe 2001 ky shtetas ka realizuar të ardhura të ligjshme në vlerën rreth 2.900.000 lekë, shumë e cila tejkalon dy herë shumën që i është dhënë hua babait tim nga ky shtetas. Në llogaritjen e këtyre të ardhurave nuk kam përfshirë shumën 500.000 lekë të përfituar nga shitblerja 23.07.1999, pasi këtë shumë e kam konsideruar si të përdorur për blerjen e automjetit me datën 21.02.2000.

E konsideroj tërësisht të pallogjiktë dhe dashakeq qëndrimin e Komisionit që nga shuma 2.900.000 lekë e përfituar nga shitja e tokës në vitet 2000-2001, personit tjetër të lidhur Xheladin Thana t'i zbresë shumën 1,500.000 lekë të shpenzuar nga ai për blerjen e automjetit, veprim i kryer përpara realizimit të këtyre të ardhurave dhe po kështu t'i zbresë edhe shpenzimet për jetese për 7 vite në vlerën 1,433,872.00 lekë (kjo e fundit vlerë shumë e lartë krahasuar me të dhënat e INSTAT për vitet në fjalë).

Ndodhur në kushtet që shuma rreth 2.900.000 lekë e përfituar nga dy shitjet e fundit të tokës ka filluar të krijohet në fund të vitit 2000 (me datë 11.12.2000) në llogaritjen e shpenzimeve për jetesë Komisioni nuk duhet të përfshinte shpenzimet për jetesë për vitet 1999 dhe 11 muaj për vitin 2000, por duhet të llogariste shpenzimet nga koha e këtyre shitjeve (dhjetor 2000) e deri në datën e dhënies së huasë, pra për një interval kohor që nuk është 7 vite, **por 5 vite e një muaj.**

Përfshirja e vlerës së blerjes së automjetit të vitit 1999 dhe shpenzimeve për jetesë për thuajse 2 vite (1999-2000) si shpenzime të familjes Thana, për t'i zbritur nga të ardhurat e realizuar më vonë, është një veprim keqdashës i Komisionit i kryer me qëllim nxjerrjen e këtij shtetasi me bilanc negativ në funksion të mosnjohjes së huasë si burim të ardhurash.

Për më tepër Komisioni nuk pranon në asnjë moment që shtetasi Xheladin Thana ka realizuar të ardhura nga veprimtaria tregtare, në lidhje me të cilën nga prova rrethanore kam provuar jo vetëm ushtrimin e kësaj veprimtarie, por edhe realizimin e të ardhurave, pavarsisht se nuk kam arritur të provoj volumin e tyre, qëndrim ky që bie ndesh me praktika dhe vendimarrje të mëparshme të të njëjtave komisionere të pasqyruara më lart, por edhe të tjera.

Nëse Kolegji do të rikryej një rivlersim të gjendjes financiare të këtij shtetasi, duke patur në konsideratë shpjegimet e mia (në lidhje me vlerësimin e faktit se nga aktiviteti tregtar Xheladin Thana minimalisht ka mbuluar apo ka ulur shpenzimet e jetëses, se Xheladin Thana ka realizuar të ardhura nga shitblerja e tokave në një vlerë që tejkalon disa herë shumën e dhënë hua dhe se zbritja e shpenzimeve të familjes Thana nuk duhet të bëhet në mënyrë abuzive sic ka vepruar Komisioni), qartësisht do të konstatojë se Xheladin Thana nuk rezulton me bilanc negativ në kohën e dhënies së huasë babait tim.

Në lidhje me vlerësimin e Komisionit: ***"40.6. Subjekti nuk arriti të provojë që huaja në shumën 1,500,000 lekë është marrë përpara datës 24.4.2006, pasi pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ. Për më tepër, në deklaratën noteriale nuk përcaktohet qëllimi i përdorimit të huas." (qëndrim të cilin Komisioni e mban edhe për huanë marrë xhaxhait Fahri Ymeri)*** shpjegoj se këto vlersime janë tërësisht të gabuara dhe kanë ardhur si rrjedhojë e mosmarrjes në konsideratë të përmbajtjes së vetë akteve noteriale dhe shpjegimeve që unë kam dhënë në lidhje me këto akte.

Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, risqaroj se një apo dy muaj përpara se të lidhej kontrata e sipërmarrjes e datës 10.04.2006, mbi bazën e të cilës është blerë apartamenti në fjalë, babai im ka filluar të interesohet për blerjen e një apartamenti 3+1 në qendër të qytetit, pasi aty ku banonim (që nga viti 2004) ishim larg nga godina e Gjykatës, (pothuajse në periferi), si dhe ishim ngushtë. Në kushtet kur nuk kishim automjet në pronësi apo në përdorim, unë detyrohesha çdo ditë t'a bëja rrugën vajtje-ardhje, për në punë, në këmbë. Kjo mbarte rrezik pasi për shkak të profesionit por edhe të kushteve të kohës, (bëhet fjalë për vitet 2005-2006), në të cilat rendi publik nuk mund të thuhet se ishte stabilizuar plotësisht, udhëtimi në këmbë, mund të dëmtonte si interesat e mia ashtu edhe të profesionit tim. Përveç kësaj, qënia e vëllait tim student në pritje të diplomimit, si dhe unë gjyqtar, (ku secili kishte nevojat e veta të ambientit të punës/studimit në banesë), ishte një rrethanë që nga familja ime është perceptuar si nevojë për t'u zgjeruar mjedisi i banimit, nga 2+1, në 3+1. Nevoja për zgjerim i familjes time në atë kohë diktohej edhe nga fakti

se vëllai im Gerti Ymeri, në atë kohë ishte fejuar me shtetasen Aurora Ndre Ndreu, me të cilën më vonë u martua, (por aktualisht martesa ndërmjet tyre, është e zgjidhur). Pra kishte pritshmëri që në familjen tonë do të vinte së shpejti edhe një anëtar i ri. Sqaroj se në atë kohë, babai im ka synuar që ne të jetonim bashkë dhe nuk ishte planifikuar që unë të jetoja në një banesë më vete. Kjo pasi isha beqar dhe në atë kohë, nuk kishte ndonjë pritshmëri që unë të krijoja ndonjë familje të re për së afërmi.

Në rrethanat e mësipërme, babai im ka filluar të interesohet në 4 vende për të blerë një apartament 3+1, me sipërfaqë rreth 140 - 150 m², që të ishte në afërsi të punës time. Për këtë ka parë dhe është interesuar tek pallati që po ndërtohej tek Restorant "Tradita" në Shkodër, tek pallati që ka ndërtuar shoqëria "Xhenis", ku sot ndodhen zyrat e Drejtorisë Shkodër të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, tek një ndërtues i quajtur Arben Mithi, në lagjen "Parrucë", etj. Pas studimit të tregut, babai dhe nëna ime vendosën të blejnë apartamentin ku unë dhe familja ime (e re), jetojmë aktualisht. Faktikisht, ky apartament nuk ishte planifikuar për 3+1, por 2+1, dhe kishte sipërfaqe më të vogël nga sa ishte planifikuar për t'u blerë, por meqenëse ishte akoma në ndërtim, ekzistonte mundësia që përmes ndarjes së mureve të brëndshme, nga firma ndërtuese, duke zvogëluar sipërfaqet e dhomave, të bëhej 2+1 si dhe një minidhomë e vogël, që në fakt është bërë. Pasi babai im ka rënë dakort me subjektin ndërtues, për të bërë këtë organizim të brëndshëm të apartamentit, që akoma nuk kishte përfunduar së ndërtuari, (me shpenzimet e subjektit ndërtues), si dhe babai studioi kushtet e tregut si dhe vuri në balancë nevojat me mundësitë financiare, vendosi të blinte pikërisht apartamentit që përbën objektin material të pyetjes që më shtrohet nga Komisioni.

Paralelisht me planifikimin paraprak si më sipër, (sipas të cilit ne dëshironim të blinim një apartament 3+1 me sipërfaqe 140-150 m², afër qëndrës), babai im fillimisht, kërkoi nga vëllai i tij Fahri Ymeri huanë prej 2.000.000 lekë, që iu dha prej tij. Meqenëse babai nuk e dinte se ku do t'a blinte apartamentin, pak ditë më pas i kërkoi edhe të motrës së tij dhe kunatit, (pra shtetasit Xheladin Thana), shumën prej 1.500.000 lekë hua, që po ashtu iu dha prej tij. **Pra marrja e dy huave faktikisht është marrë nga babai pak kohë më parë se të blinim apartamentin**. Kjo pasi babai fillimisht synonte të akumulonte fondet e nevojshme për të blerë një apartament, me para në dorë, apartament që ai e kishte vetëm si ide lidhur me karakteristikat që do të kishte. Vetëm pasi të siguronte këto fonde, ai do të përfshihej në negociata konkrete për blerjen e apartamentit.

Babai im, synonte t'a blente apartamentin e sipërpërshkruar, ndërkohë që pallati të ishte akoma në ndërtim e sipër, si dhe me para në dorë. Kjo pasi këto dy rrethana, dihet botërisht se ndikojnë shumë në uljen e çmimit, në raport me një apartament që ndodhet në një pallat të përfunduar, me çertifikatë pronësie dhe që blerësi e paguan me këste.

Me këto dy hua si dhe me fondet e kursyera në vitet 2004, 2005 si dhe muajt e parë të vitit 2006, sikurse kam sikurse kam deklaruar në DPV-të e viteve 2004, 2005 dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ne shpresonim se do të kishim fonde të mjaftueshme për të blerë një apartament 3+1, 140 - 150 m², sikurse e dëshironim. Përveç kësaj, babait tim do t'i mbeteshin edhe para për të blerë mall për të ushtruar aktivitetin tregtar si shitës ambulant fruta perimesh, si dhe do të mbetej diçka rezervë edhe për ndonjë rrethanë të paplanifikuar.

Faktikisht babai im vendosi të blejë në vitin 2006, apartamentin me sipërfaqe funksionale 111 m² (123 m² duke përfshirë edhe sipërfaqen e përbashkët), dhe për rrjedhojë tepruan para. Pikërisht këto para që tepruan nga fondet e akumuluara së bashku me kursimet e vitit 2006, pas blerjes së apartamentit, shërbyen për kthimin e një pjese të huasë tek Xheladin Thana, si dhe për të shlyer tërësisht huanë tek Fahri Ymeri, sikurse kam deklaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

Babai nuk nxitoi për kthimin e borxheve, pasi pas blerjes së apartamentit, po në vitin 2006, ai kaloi një sëmundje shumë të rëndë, (pankreatit akut), që e ka vdekshmërinë shumë shumë të lartë (fakt për të cilin ju kam dërguar edhe akte shkresore me përgjigjen e pyetësorit të tretë). Kjo mund t'a bënte të nevojshme për familjen shpenzimin e parave, pra të tepricës. Megjithatë, nga ana tjetër babai u kujdes, që çfarëdo që të ndodhte me sëmundjen e tij, t'i formalizonte me akte noteriale dy huatë e marra për blerjen e apaqrtamentit, dhe faktikisht kjo ka qënë arsyeja se përse këto hua janë dokumentuar me dy akte noteriale, (të të njëjtës ditë, pra të datës 24.04.2006). Pas kalimit të rrezikut të sëmundjes së babait, fondet tepricë, sigurisht u përdorën, krahas kursimeve, për shlyerjen e huave, sikurse jam shprehur në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

Gjej me vend që të theksoj se faktikisht huaja tek Fahri Ymeri, është marrë disa ditë para huasë të marrë nga Xheladin Thana. Që të dy këtyre huadhënësve, (që janë familjarë të afërt të babait tim, përkatësisht vëllai dhe kunati), babai im kur iu ka marrë huatë, iu ka bërë me dije qëllimin se përse i nevojiteshin huatë, pra për blerje apartamenti. As babai im dhe as huadhënësit nuk kanë patur dijeni se ku ndodhej apartamenti që do të blihej me paratë e marra hua pasi, sikurse e shpjegova, apartamenti do të blihej pas akumulimit të fondeve të nevojshme për t'a blerë me para në dorë, (gjë që do ndikonte shumë në uljen e çmimit). Fakti që të dy huadhënësit nuk e dinin se ku ndodhej ky apartament, duket qartë edhe nga përmbajtja e dy dekleratave noteriale të datës 24.04.2006, ku përmëndet se "*huatë janë dhënë në një kohë të mëparsshme, nga data e hartimit të dekleratës, për blerje apartamenti, por pa evidentuar konkretisht vendodhjen dhe karakteristikat identifikuese të këtij apartamenti*".

Fakti që këto hua janë marrë nga babai im <u>përpara së të blihet pasuria e paluajtshme dhe në funksion të blerjes së kësaj pasurie</u> **<u>rezulton edhe nga vetë përmbajtja e këtyre akteve noteriale.</u>**
Kështu sipas kontratës së huasë të lidhur përpara noterit publik Arben Salim Kopliku, anëtar i Dhomës së Noterisë Shkodër, me nr. rep. 1071, nr. kol. 547, datë 24.04.2006, ndërmjet huadhënësit Fahri Fetah Ymeri (vëllai i babait tim) dhe huamarrësit Faik Ymeri, (babai im) rezulton se pala huadhënëse Fahri Ymeri **<u>i ka dhënë</u>** palës huamarrëse Faik Ymeri një shumë të hollash prej 2.000.000 (dymilion) lekë të reja, për një periudhë kohore prej 5 (pesë) vjetësh, duke marrë dhe premtimin që do të kthehet shuma në afatin e caktuar dhe me këtë premtim ata nuk kërkojnë që të bëjnë hipotekim prone të paluajtshme meqënëse janë vëllezër". Këtu për të shmangur çdo keqintepretim, do t'i lutesha Komisionit të ketë parasysh diatezën foljore, të tipit të kryer të pësuar, "<u>i ka dhënë</u>", që shpreh jo vetëm veprimin që ka kryer pala Fahri Ymeri përkundrejt palës Faik Ymeri, **<u>por përcakton edhe kohën e kryerjes së këtij veprimi, që konkretisht është në një kohë të shkuar, të mëparshme, pra që i paraprin kohës kur është hartuar akti noterial.</u>**
Po kështu sipas kontratës së huasë të lidhur noterit publik Arben Salim Kopliku, anëtar i Dhomës së Noterisë Shkodër, me nr. rep. 1312, nr. kol. 691, datë 24.04.2006, ndërmjet huadhënësit Xheladin Cuf Thana (bashkëshorti i motrës së babait tim) dhe huamarrësit Faik Ymeri, (babai

im) rezulton se pala huadhënëse Xheladin Thana **i ka dhënë** palës huamarrëse Faik Ymeri një shumë të hollash prej 1.500.000 (njëmilion e pesëqind mijë) lekë të reja, për një periudhë kohore prej 3 (tre) vjetësh, duke marrë dhe premtimin që do të kthehet shuma në afatin e caktuar dhe me këtë premtim ata nuk kërkojnë që të bëjnë hipotekim prone të paluajtshme meqënëse janë krushqi (dhëndër e kunat pasi gruaja e Xheladinit është motra e Faik Ymerit)". Edhe këtu për të shmangur çdo keqintepretim, do t'i lutesha Komisionit të ketë parasysh diatezën foljore, të tipit të kryer të pësuar, **"i ka dhënë",** që shpreh jo vetëm veprimin që ka kryer pala Xheladin Thana përkundrejt palës Faik Ymeri, **por përcakton edhe kohën e kryerjes së këtij veprimi, që konkretisht është në një kohë të shkuar, të mëparshme, pra që i paraprin kohës kur është hartuar akti noterial.**

Pra të dyja këto hua, janë marrë nga babai im jo me datën 24.04.2006 në të cilën janë hartuar dekleratat noteriale, por në një kohë të mëparshme, që duke patur parasysh diatezat foljore, të tipit të kryer të pësuar, **"i ka dhënë",** të përdorura në këto akte noteriale, si dhe duke patur parasysh qëllimin se pse janë marrë këto dy hua, (për blerje apartamenti), që rezulton nga vetë përmbajtja e këtyre akteve noteriale, duket qartë këto hua janë marrë përpara datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, që është data 10.04.2006.

Përfundimisht mendoj se ndryshe nga qëndrimi që ka mbajtur Komisioni, Kolegji duhet t'a njohë si burim të ligjshem për blerjen e apartamentit të banimin nga babai im huanë në shumën 1,500.000 lekë të cilën babai im ia ka marrë shtetasit Xheladin Thana. Pavarsisht faktit se unë nuk e kam deklaruar këtë hua në Deklaratën Vetting (për shkaqet të cilat i kam shpjeguar) Kolegji duhet të ketë në konsideratë:

- Kjo hua buron nga një akt noterial i hartuar në kohën e krijimit të pasurisë (24.04.2006), në të cilën unë as e dija dhe as mund t'a dija se ndonjëherë do t'i nënshtrohesha procesit të rivlersimit.
- Unë këtë hua e kam deklaruar në DPV e vitit 2006 dhe DPV e vitit 2007 ku kam deklaruar shlyerjen plotësisht të detyrimit nga babai im.

Bazuar në shkaqet e mësipërme mendoj se mosdeklarimi i huasë në fjalë në Deklaratën Vetting duhet të vlerësohet nga Kolegji si pasaktësi në deklarim dhe si rrjedhim ky gabim nuk mund të sjellë pasoja në njohjen e këtij veprimi juridik, si burim i ligjshëm të ardhurash për blerjen e pasurisë.

Në lidhje me vlerësimin e Komisionit**:** ***"41.3. Për vitin 2006 subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare për kthimin e kësaj huaje në shumën 170,285.15 lekë."*** shoqëruar me analizën financiare për periudhën 10.04.2006-31.12.2006, shpjegoj se arritja në këtë konkluzion nga ana e Komisionit është jo e drejtë.

Nga vistimi i kësaj analize qartazi evidentohet fakti se Komisioni nuk ka përfshirë në të shumë prej burimeve të ardhurave të deklaruara nga ana ime të tilla si: huaja marrë shtetasit Xheladin Thana, aktiviteti tregtar i babait tim, të ardhura nga qeraja e tokës bujqësore etj, ndërkohë që cuditërisht zbret nga të ardhurat shpenzimin për kthimin e një pjesë të huasë në shumën 800.000 lekë shtetasit XheladinThana.
Fillimisht shpjegoj se nëse Komisioni do të njihte dhe do të përfshine në analizën financiare burimet e të ardhurave të deklaruara nga ana ime qartazi unë rezultoj me bilanc pozitiv në fund të

vitit 2006, pas shlyrjes nga babai im të huave shtetasve Xheladin Thana (në shumën 800.000 llekë) dhe Fahri Ymeri në të gjithë vlerën e huasë.
Po kështu e gjej të pavend qëndrimin e Komisionit i cili zbret shpenzimet për shlyerjen e huasë të cilën nuk e njeh më parë si të ardhur.
Në lidhje me këtë konkluzion më poshtë është paraqitur analiza financiare e vitit 2006 nga ku rezulton i qartë fakti se unë nuk rezultoj me bilanc negativ (vec shumës së detyrimit mbetur Xheladin Thanës, që është shlyer në vitin 2007).

1.8 Në lidhje me vlerësimin e Komisionit në pikën 42.5 të vendimit: ***"Në lidhje me shumën e shitjes së banesë në shumën 47.000 USD të z. Fetah Ymeri, e cila sipas deklarimeve të subjektit përveç vlerës 1,500,000 lekë i ka kaluar z. Fahri Ymeri për sa kohë nga ana e tij nuk është provuar me dokumentacion provues të kohës që kjo shumë është përfituar nga z.Fahri Ymeri ajo nuk është përfshirë në analizë financiare derisa subjekti të argumentojë bindshëm arsyet e përfitimit të kësaj shume nga ana e z. Fahri Ymeri si dhe të depozitojë dokumentacionin provues..... Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. Fahri Ymeri për dhënien e huasë. Nga hetimit dhe analiza financiare z. Fahri Ymeri nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huasë në shumën 3,981,543.6 lekë. Në këtë analizë, edhe sikur të përfshihet shuma e mbetur nga çmimi shitjes së banesës të z. F.Y, sërish rezultati do të ishte negativ në vlerën 570,043.60 lekë,*** shpjegoj se mbajtja e një qëndrimit të tillë nga ana e Komisionit është rrjedhojë e një zbatimit të gabuar të ligjit 84/2016, mosvlerësimit të të gjitha provave të paraqitura nga ana ime dhe kryerjes së një analizë financiare tërësisht të gabuar në lidhje me "personin tjetër të lidhur" Fahri Ymeri.

Ashtu sic e kam shpjeguar xhaxhai im Fahri Ymeri dhe gjyshi im i ndjerë Fetah Ymeri kanë jetuar në një banesë të ndodhur në qëndër të qytetit të Shkodrës, fqinj me vendin e quajtur "ish Kinema Verorja", ku edhe në të shkuarën organizoheshin festivalet kombëtare të këngës për fëmijë. Këto dy banesa kanë qënë pjesë përbërëse të një pasurie të paluajtshme truall + ndërtesë, që për shkak të marrëdhënieve familjare, ka qënë e rregjistruar në pronësi vetëm në emër të gjyshit tim, të ndjerit Fetah Ymeri. Këtë pasuri truall + ndërtesë, përmes kontratës noteriale nr. 9449 rep, nr.3182, kol, datë 15.03.1996, gjyshi im ia ka shitur blerësit "Shoqëria Etërve Jezuitë", duke përfituar si vlerë shumën prej 47.000 (dyzet e shtatëmijë) USD. Shuma e përfituar është ndarë ndërmjet gjyshit Fetah Ymeri, që ka marrë prej saj 1.500.000 (njëmilion e pesëqindmijë) lekë, me të cilat ka blerë një banesë-apartament banimi, në qytetin e Shkodrës, në vlerën 1.310.000 (njëmilion e treqind e dhjetëmijë) lekë, përmes kontratës me nr. 2821 rep, nr. 832 kol, datë 09.07.1996, nga shitësi Skënder Islam Sheqeri, ndërsa pjesën tjetër të kësaj shume e ka ruajtur si kursim familjar. Pjesën që mbetet nga shuma prej 47.000 USD, e ka marrë xhaxhai im Fahri Ymeri, të cilën e ka ruajtur si kursim familjar.

<u>Dhënia e kësaj shume xhaxhait tim Fahri Ymeri ka qenë rrjedhojë jo vetëm e investimeve dhe kontributeve që xhaxhai im kishte dhënë për mirëmbajtjen e kësaj banese dhe për përkujdesjen ndaj prindërve të tij, por buronte edhe nga fakti se pas shitjes së banesës në lagjen "ish Kinema Verorja" me datën 15.03.1996 xhaxhai im u detyrua të blinte një shtëpi banimi, që është pikërisht banesa e ndodhur në lagjen "Perash" Shkodër, blerë me kontratën e datës 10.07.1996.</u>

Në kohën e ndodhjes së këtij veprimi xhaxhai dhe gjyshi im nuk kanë mbajtur akt të shkruar, për shkak të marrëdhënieve familjare, por për të vërtetuar faktin e dhënies së kësaj shume xhaxhait tim unë ju kam paraqitur disa prova, të cilat qartësisht rezulton se nuk janë marrë në konsideratë nga Komisionit.

I. Kështu unë ju kam dërguar me përgjigjet e pyetësorit të dytë, si provë dekleratën noteriale të datës 28.01.2022 të babait tim Faik Ymeri, të xhaxhait tim Fahri Ymeri, të xhaxhait tjetër Sadetin Ymeri, si dhe të hallës time Lirije Thana, që janë fëmijë të gjyshërve të mij, të ndjerëve Fetah dhe Xhemalije Ymeri, si dhe nënës tim Elvira Ymeri, bashkëshortes së xhaxhait Sabahete Ymeri, bashkëshortit të hallës Xheladin Thana, të cilët konfirmojnë sa deklarova më lart . Më konkretisht nga kjo deklaratë rezulton: ***"..pjesën tjetër të vlerës monetare mbi të cilën u shit banesa (47.000 USD) babai/vjehrri ynë i ndjerë iia ka dhënë vëllait/kunatit Fahri Ymeri. Dhënia e kësaj shume Fahri Ymeri, u bë bazuar në konstributin e vazhdueshëm fananciar që ai kishte dhënë për vetë banesën e shitur (mirëmbajtjen e saj), si dhe përkujdesjen për prindërit/vjehrritë tanë".***

Në lidhje me këtë deklaratë noteriale Komisioni në pikën 42.11. shprehet: ***"Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion provues përfitimin e shumës së mbetur nga shitja e banesës së gjyshit të tij nga z. Fahri Ymeri Komisioni, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në lidhje me deklaratat e depozituara nga subjekti, vlerëson se ato nuk kanë fuqi provuese në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështeten nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit dhe se nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në këtë proces."***

Në lidhje me këtë qëndrim të Komisionit mendoj se deklarata noteriale e paraqitur nga ana ime ka fuqi të plotë provuese për të vërtetuar marrjen nga xhaxhai im Fahri Ymeri të shumës monetare 1.500.000 (njëmilion e pesëqindmijë) lekë nga gjyshi im Fetah Ymeri. Kjo deklaratë noteriale duhet të vlerësohet në harmoni edhe me provat e tjera të paraqitura nga ana ime, përmes së cilave provoj faktin se në banesën e shitur nga gjyshi im ka jetuar edhe xhaxhai Fahri Ymeri, ku dhënia e shumës monetare nga gjyshi është bërë vecanarsisht për këtë shkak.
Në lidhje me provat rrethanore që unë kam paraqitur për të mbështetur deklaratën noteriale evidentoj disa fotografi të kohës, nga të cilat pasqyrohet qartë fakti se në banesën e shitur krahas gjyshit tim ka jetuar edhe xhaxhai Fahri Ymeri, e dhënë indirekte kjo që vërteton pretendimin tim se shkak i dhënies së kësaj shume monetare xhaxhait nga gjyshi im është edhe nevoja për të siguruar një banesë pas shitjes së shtëpisë së madhe.
Kështu gjatë procesit të rivlersimit unë i kam paraqitur Komisionit një fotografi të kohës ku shfaqen tre fëmijë përpara portës hyrëse të oborrit të një shtëpie private. (*Bëhet fjalë për pasurinë truall, mbi të cilin ka patur bashkangjitur dy ndërtesa, që janë shitur nga gjyshi im, në shumën 47.000 USD*). Në këtë fotografi, vajza në të majtë është Iris Fahri Ymeri, vajza e xhaxhait tim, djali në mes është Argys Fahri Ymeri, djali i xhaxhait tim Fahri Ymeri, ndërsa vajza në të djathtë është Elda Kujtim Ymeri, që është vajzat e xhaxhait tim tjetër, që aktualisht është i vdekur. Kjo fotografi shërben të paktën si indicie për të vërtetuar që familja e xhaxhait tim, që përbëhet nga katër anëtare, ka banuar në një shtëpi private me oborr, që nga provat e tjera vërtetohet se është pikërisht banesa e shitur në shumën 47000 USD e cila është shitur. Kjo është fotografi e vjetër

dhe këtë e tregon mosha e fëmijëve që shfaqen në fotografi, e cila po të vlerësohet në harmoni me çertifikatën familjare të xhaxhait tim Fahri Ymeri, bën të mundur të përcaktohet me përafërsi, të paktën koha kur familja e xhaxhait tim, ka jetuar në banesën private në fjalë.

Ndodhur në kushtet që deklaratës noteriale të paraqitur nga ana ime, i janë bashkangjitur edhe prova të tjera rrethanore (fotografi të kohës) mendoj se arsyetimi i Komisionit se kjo provë nuk duhet të pranohet për shkak se është hartuar gjatë procesit të rivlersimit nuk është i drejtë dhe po kështu nuk përputhet me vendimet e Kolegjit të cituara nga Komisioni si praktikë e konsoliduar.

II. Për të vërtetuar përfitimin e kësaj shume monetare nga xhaxhai im Fahri Ymeri, si provë tjetër rrethanore, unë i kam kërkuar Komisionit thirrjen e personave që kanë nënshkruar deklaratën noteriale, për t'u pyetur në cilësinë e dëshmitarëve, kërkesë të cilës vazhdoj t'i qëndroj edhe aktualisht gjatë gjykimit të cështjes në Kolegj.

Në lidhje me këtë kërkesë Komisioni në pikën 42.10 (ii) a shprehet: **"*Për sa i përket kërkesës nr. 1, të gjithë këta shtetas janë shprehur nëpërmjet deklaratës të datës 28.1.2022, të depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, për rrjedhojë, vlerësohet se dëgjimi i tyre nuk do të paraqesë asnjë të dhënë të re për procesin e rivlerësimit. Kjo kërkesë e subjektit, sikundër edhe kërkesat e tjera të tij në lidhje me kryerjen e hetimit, vlerësohen se janë bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit të subjektit. Për këtë arsye, bazuar në nenin 49, pika 6, germat "a" dhe "ç" të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit.* "**

Në lidhje me këtë qëndrim të Komisionit mendoj se ai është në kundërshtim me parashikimet e nenit 49/6 të ligjit 84/2016, i cili parashikon:
6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur:
a) marrja e provës duket se është e panevojshme;
b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit;
c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm;
ç) bëhet me qëllim zvarritjen e gjykimit;
d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

Fillimisht mendoj se arsyetimi i Komisionit se "***dëgjimi i tyre nuk do të paraqesë asnjë të dhënë të re për procesin e rivlerësimit***" pasqyron një paragjykim të dëshmisë që shtetasit e kërkuar nga ana ime mund të jepnin përpara Komisionit. Pavarsisht se unë kam një lidhje të afërt në gjini me këta shtetas Komisioni nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta dhe indirekte do të mund të verifikonte saktësinë e shpjegimeve që ata kanë dhënë me deklaratë noteriale dhe po kështu do të mund të provonte "tej cdo dyshimi të arsyeshëm" nëse ato kanë deklaruar të vërtetën apo jo.

Vlerësuar në këtë këndvështrim është e qartë se unë kam rrezikuar në momentin kur kam kërkuar pyetjen e personave në fjalë, pasi nëse ata nuk ka thënë të vërtetën në deklaratën noteriale të paraqitur përpara Komisionit ky fakt nuk mund të mos konstatohej nga pyetja e tyre si dëshmitarë.

Ky paragjykim që Komisioni i ka bërë dëshmisë së kërkuar nga ana ime bie ndesh me parimin e objektivitetit dhe ligjshmërisë me të cilin neni 52 i ligjit 84/2016 ka Komisionin, duke cënuar si interesin public nga mosushtrimit si duhet të veprimtarisë së tij ashtu dhe personin tim si subject rivlersimi, për shkak të cënimit të të drejtës së mbrojtjes.

Nga ana tjetër edhe konkluzioni i Komisionit se përmes pyetjes së dëshmitarëve, unë kam synuar zvarritjen e gjykimit është tërësisht e gabuar. Ky konkluzion do të qëndronte nëse Komisioni do të kishte të dhëna konkrete dhe objective se:

- Dëshmia e dhënë nga dëshmitarët e kërkuar nuk do të ishte e vërtetë, pra se dëshmitarët do të bënin dëshmi të rreme përpara tyre.
- Përmes pyetjes së tyre do të shkaktohej zvarritja e gjykimit. Në këtë drejtim duhet të kihet në konsiderat fakti se unë në asnjë moment nuk kam kërkuar që pyetja e tyre të bëhet domosdoshmerisht në seancë dëgjimore (pasi këtë kërkesë e kam paraqitur edhe gjatë hetimit administrativ) apo në praninë time. Për të mënjanuar rrezikun e zvarritjes së procesit Komisionerët nuk kishin asnjë pengesë që personalisht apo me anë të ndihmësve juridik t'i pyesnin këta shtetas, madje edhe pa kaluar ende ne seancë dëgjimore, gjë që nuk do të passillte asnjë zvarritje të procesit.

Nëse i referohemi vendimit të Komisionit me të cilin është refuzuar kjo kërkesë e imja, evidentohet qartë se ky vendim nuk është i arsyetuar. Në vendimarrje nuk pasqyrohen shkaqet objective dhe faktike mbi të cilat është marrë ai. Refuzimi i pyetjes së dëshmitarëve të kërkuar nga ana ime, pa bërë asnjë argumentim ligjor dhe faktik është në kundërshtim me parashikimet e nenit 46/9 të ligjit 84/2016, sipas të cilit: "*9. Refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit"*

Vlerësoj se në përputhje me parimin e objektivitetit dhe ligjshmërisë ishte detyrë e Komisionit që përmes pyetjes së dëshmitarëve të kërkuar nga ana ime, të testonte vërtetësinë e deklarimeve të dhëna nga ata me deklaratë noteriale. Ky veprim do i shërbente ushtrimit të detyrës nga ana e tyre me objektivitet dhe paanshmëri, pa cënuar as të drejtat e mia si subject rivlersimi por as interesin public.

III. Po kështu, si provë tjetër rrethanore për të mbështetur deklaratën noteriale të paraqitur unë kam kërkuar dhe vijoj të kërkoj, që për të vërtetuar faktin që në banesën e shitur nga gjyshi im Fetah Ymeri ka jetuar edhe familja e xhaxhait tim Fahri Ymeri, të pyeten edhe komshijtë e kohës, një pjesë e të cilëve jetojnë po aty dhe që janë Ferdinand Topalli, Franc Topalli, David Topalli, Kujtime Vajushi, etj.

Edhe në lidhje me këtë kërkesë timen Komisioni ***në pikën 42.10 (ii) b shprehet se kjo kërkese duhet të refuzohet: bazuar në nenin 232 të K.Pr.Civile, pretendimit se unë po tentoj të zvarris procesin dhe se nuk kam përcaktuar rrethin e personave që kërkoj të pyeten.***

Edhe në lidhje me këtë vendim të ndërmjetëm të Komisionit, ashtu sic parashtrova edhe më lart, mendoj se ai është tërësisht i paarsyetuar, pasi në të nuk pasqyrohen shkaqet objektive konkrete që justifikojnë vendimarrjen e Komisionit. Theksoj edhe një herë se ishte detyrë e Komisionit që

përmes pyetjes së dëshmitarëve, atyre me lidhje të afërt gjinie me mua apo që nuk kanë asnjë lidhje me personin tim (sic janë dëshmitarët e kërkuar në këtë pikë) të verifikojë vërtetësinë e aktit të paraqitur nga ana ime. Nëse Komisioni do të vlerësonte që për të provuar vërtetësinë e këtij akti shkresor të paraqitur nga ana ime, përfshirë këtu edhe kontratën e shitblerjes së banesës së gjyshit tim, nuk lejohet prova me dëshmitar, në përputhje me nenin 232 të K.Pr.Civile, këtë fakt si rregull duhet t'a cmonte në favorin tim dhe jo ndryshe sic ka ndodhur në rastin konkret. Vlerësuar edhe në këtë këndvështrim rezulton qartë se vendimi i ndërmjetëm i Komisionit për refuzimin e këtyre dëshmive është kontadiktor dhe rrjedhimisht i paarsyetuar, në kundërshtim me nenin 46/9 të ligjit 84/2016.

Bazuar në këto shkaqe mendoj se bazuar në deklaratën noteriale të cilën e kam paraqitur në seancën dëgjimore dhe pas marrjes edhe të provave me dëshmitarë të kërkuar nga ana ime, Kolegji duhet të përfshijë në vlerësimin e burimeve të ligjshme të të ardhurave të xhaxhait tim Fahri Ymeri shumën 1.500.000 lekë që gjyshi im i ndjerë Fetah Ymeri i ka dhënë atij pas shitjes së banesës në fjalë.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit: **Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. Fahri Ymeri për dhënien e huasë, rishpjegoj:**

Për të vërtetuar burimet e ligjshme të të ardhurave të xhaxhait tim Fahri Ymeri krahas akteve të shitblerjes së pasurive të paluajtshme unë i kam paraqitur Komisionit akte dokumentare të tjera që vërtetojnë faktin se ai ka patur të ardhura edhe nga burime të të tjera të ligjshme. Këto akte lidhen më faktin e vërtetuar nga ana ime se xhaxhai im Fahri Ymeri ka ushtruar veprimtari tregtare. Të tilla janë:

I. Unë kam shpjeguar se xhaxhai im Fahri Ymeri, për gjatë viteve 1991 - 1997, ka ushtruar veprimtari të shitjes së fruta-perimeve me shumicë, në qytetin e Shkodrës, të cilat i ka importuar nga shtete te huaja, Greqi dhe Maqedoni. Unë kam qenë në pamundësi të të vërtetuar ushtrimin e kësaj veprimtarie nga xhaxhai im, por për këtë fakt i kam kërkuar Komisionit të kërkojë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me faktin nëse shtetasit Fahri Ymeri, subjekti "Ymeri Impex" (apo Fahri Dhëmbi, sikurse është quajtur në atë kohë), kanë importuar mall nga Republika e Greqisë dhe nga Republika e Maqedonisë së Veriut, për këtë periudhë kohe. Po ashtu kam kërkuar të merret informacion edhe nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit, për këtë periudhë kohe, lidhur me hyrje-daljet në kufi të xhaxhait tim Fahri Ymeri, (sidomos me Maqedoninë). Theksoj se këto informacione nuk mund të merrën nga ana ime, për shkak të mungesës së aksesit. Nga ky informacion për volumin e mallit të importuar Komisionit mund të krijojë një konkluzion në lidhje me volumin e punës dhe rrjedhimisht volumin e të ardhurave. **Nga sa kam konstatuar Komisioni nuk ka kryer asnjë verifikim në këtë drejtim, dhe mqns nuk ka marrë asnjë informacion të tillë pretendimin tim për ushtrimin e këtij aktiviteti nga xhaxhai im e ka konsideruar negativ.**

II. Për periudhën ndërmjet datave 01.01.1997 - 31.12.1997, xhaxhai im Fahri Fetah Ymeri, figuron si i siguruar pranë subjektit "Ymeri Impex", sipas vërtetimit nr. 800 prot, datë 12.03.2021 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Subjekti "Ymeri Impeks" ka patur natyrën tregtare të "biznesit të madh" dhe administrator dhe pronar i tij ka qënë xhaxhai im Fahri Ymeri. (*Natyra e biznesit rezulton nga përmbajtja e vërtetimit që do t'iu*

paraqes bashkangjitur). Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, nuk ka të dhëna për volumin dhe të ardhurat e realizuara nga ky subjekt, pasi ato janë djegur në vitin 1997.

III. Nga shkresa që ju kam dërguar me numër 379/1 prot, datë 26.01.2022 të DRTShkodër, rezulton: ***"Nga të dhënat në sistemin c@ts të DRT Shkodër konfirmojmë se subjekti IMERI IMEX, me Nipt J76504041H dhe administrator Fahri Ymeri është rregjistruar si person juridik me objekt aktiviteti "Tregti me shumicë të artikujve të përzier, ushqimore, pije dhe duhan". Tatimpaguesi është rregjistruar me datë 01.07.1994 dhe ka kaluar në statur pasiv me datën 02.03.2001".***

IV. Sipas deklarimit të xhaxhait tim familja e xhaxhait tim Fahri Ymeri ka patur për periudhën 1996 - 2005, një "market" ushqimor të ndodhur në lagjen "Perash" të qytetit, ngjitur me xhaminë e Perashit, ku kanë punuar sipas rastit bashkëshortja e tij, vetë ai apo djali i tij Argys Ymeri, duke tregtuar me pakicë produkte ushqimore. Lidhur me këtë aktivitet unë nuk kam arritur të siguroj prova të drejtëpërdrejta, por e vërtetoj me prova rrethanore të tilla si një shkrese me nr. 3411/1, datë 02.11.2016, e nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Shkodër e OSHEE sh.a, për detyrimin e akumuluar si abonent jofamiljar (njësi shërbimi), për pagesën e energjisë elektrike për periudhën 1996 - 2005. Nga ana ime ju janë dërguar të dhëna të siguruar nga ËEB SISTEMI i OSHEE-së në lidhje me abonentin jo familjar Fahri Ymeri, për objektin ku ai ka ushtruar këtë aktivitet si "market" ushqimor", nga i cili ka realizuar të ardhura ekonomike. Po kështu bashkalidhur me përgjigjet e pyetësorit te dytë ju kam dërguar edhe deklaratën noteriale të xhaxhait tim dhe bashkëshortes së tij, që e pasqyron këtë fakt. Mendoj se këto të dhëna indirekte duhen vlerësuar nga Komisionit në përputhje me parashikimin e ligjit të vitit 2003 për energjinë elektrike dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në pjesën ku parashikojnë se kontrata e furnizimit me energji elektrike mund të lidhet vetëm kur abonenti vërteton paraprakisht se është pronar apo posedues i ligjshëm (p.sh qeramarrës), i pasurisë që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Pra nëse xhaxhai im nuk do të kishte dyqan në lagjen Perash, ai nuk mund të lidhte kontratë furnizimi me energji elektrike. Po ashtu, meqënëse ky dyqan rezulton të ketë shpenzuar energji elektrike, kjo tregon se në të është ushtruar aktivitet tregtar. Lidhur me volumin dhe fitimet e këtij aktiviteti tregtar, unë vlerësoj se përsëri vlejnë ato që kam parashtruar më sipër, kur kam analizuar se përse duhet që Komisioni të marrë në konsideratë të ardhurat që ka fituar xhaxhai im si shitës fruta-perimesh më shumicë dhe pakice, në vitet 1998 - 2006. Pa dashur të kaloj në përsëritje, i kam kërkuar Komisionin që edhe për të ardhurat e realizuara nga xhaxhai im në marketin që ka patur në Lagjen "Perash" të qytetit të Shkodrës, minimalisht të vlerësojë se këto të ardhura, kanë shërbyer për të përballuar konsumin familjar.

Edhe në drejtim kam konstatuar se Komisioni nuk ka kryer asnjë veprim për verifikimin e pretendimeve të mia, dhe mungesën e dokumentacionit e ka konsideruar si negativ.

Në vlerësimin tim qëndrimi i Komisionit, i shprehur në pikën 42.10 (ii) c të vendimit se ***"unë kisha të gjitha mundësitë për t'i kërkuar xhaxhait të administronte këto të dhëna"*** pasqyron mungesën e dëshirës së këtij organi për të kryer veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe objektivitetit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84.2016.

Shpjegoj se personalisht, por edhe përmes ndihmës së xhaxhait unë kam tentuar të mbledh të dhëna në këtë drejtim. Pavarsisht kësaj, administrimi i informacionit ka qenë i pamundur ndodhur në kushtet që marrja e tij nuk varet vetëm nga dëshira e atij që e kërkon atë po piksëpari është rrjedhojë e vetë vullnetit të organit për t'a vënë në dispozicion këtë informacion (ndërkohë që cdo organ shtetëror ka detyrimin t'i përgjigjet Komisionit bazuar në nenin 50/6 të ligjit 84/2016).

Fakti që unë nuk kam munduar t'a siguroj këtë informacion, vlersuar në kontekstin e një provë shkresore që unë kam paraqitur në Komision, nga e cila rezulton se Fahri Ymeri ka qenë i rregjistruar pranë OSHEE **edhe si një abonent jofamiljar për periudhën 1996 – 2005** përbën një indicje të mjaftueshme nga e cila krijohet një dyshim i arsyeshëm se ky shtetas mund të ketë ushtruar një aktivitet ekonomik tregtar për vitet 1996 – 2005. **Kjo për shkak se vetëm një person që ushtron aktivitet tregtar lidh me OSHEE kontratë si abonent jo familjar.** Ky dyshim i arsyeshëm e ka ngarkuar minimalisht Komisionin me detyrimin e verifikimit të ketij pretendimi të paraqitur nga ana ime, detyrim që buron nga fakti se Komisioni duhet të mbledhë jo vetëm të dhëna negative për subjektet e rivlersimit, por edhe të dhëna që janë në favor apo mbështesin shpjegimet e tyre, në funksion të kryerjes së një hetimi objektiv dhe gjithëpërfshirës. Moskryerja e veprimeve në drejtim të verifikimit të këtij pretendimi bie ndesh me parashikimet e nenit 50 të ligjit 84/2016 i cili parashikon: *"1. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj,* ***për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit.".***

Është i vërtetë fakti se gjatë procesit të rivlersimit barra e provës i bie subjektit të rivlersimit, por pavarsisht kësaj kjo nuk përjashton detyrimin që ka Komisionit për kryerjen e nje hetimi të thellë dhe gjithpërfshirës, në funksion të zbatimit të parimit të objektivitetit dhe ligjshmërisë në ushtrimin e detyrës bazuar në nenin 52 të ligjit 84.2016.

V. Sipas deklarimit të xhaxhait tim Fahri Ymeri, familja e tij ka patur për periudhën 1998-2005, një "market" ushqimor të ndodhur në ish Kominën Velipojë, fshati Pulaj - Plazh, ku kanë punuar sipas rastit bashkëshortja e tij, vetë ai, djali i tij Argys Ymeri, apo vjehrri i tij i quajtur Enver Dhëmbi, duke tregtuar me pakicë produkte ushqimore, në periudhën sezonale të pushimeve verore. Lidhur me këtë aktivitet unë nuk kam arritur të siguroj prova të drejtëpërdrejta, por e vërtetoj me prova rrethanore të tilla si tre fotografi, të cilat ia kam dërguar Komisionit. Në njërën prej këtyre fotografive, shfaqet vajza e xhaxhait tim Iris Ymeri, në brëndësi të marketit, në mjedisin ku qëndron shitësit, (afër banakut), një një fotografi tjetër shfaqet po ajo afër frigoriferit - kashun ku ndodheshin akulloret që do të tregtoheshin, ndërsa në foton e tretë që është ajo më e rëndësishmja, shfaqet tërësisht familja e xhaxhait tim Fahri Ymeri, e përbërë nga vetë ai, që mban në prëhër djalin e tij Argys Ymeri, në të majtë ndodhet bashkëshortja Sabahete Ymeri, ndërsa në mes prindërve vajza Iris Ymeri. E gjithë familja është ulur në trotuarin përpara marketit. Fotografia tregon edhe pamjen që ka patur marketi si dhe destinacionin e tij të përdorimit. Personat që shfaqen pas familjes në foto janë: Vjehrri i Fahri Ymeri, i quajtur Enver Dhëmbi, që ndodhet në derën hyrëse të marketit, që i ndihmonte në ushtrimin e aktivitetit, personi i ulur, i veshur me bluzë, është Ardian Mokçi, që është djali i dajës i Fahri Ymerit (dhe i babait tim), që në atë kohë ka qënë i punësuar në market, ndërsa personi tjetër i ulur, me gjoks të zbuluar është Kujtim Dhëmbi, që po ashtu ka qënë i punësuar në market. Në dy prej fotove, po të shikohet me kujdes, në to, ka reklama të shkruara "Fruta". Përmëndja e kësaj fjale mund të vlerësohet nga Komisioni minimalisht si indicie që xhaxhai im është marrë me veprimtarinë e shitjes së fruta - perimeve, duke e lidhur këtë biznes me biznesin-market në Velipojë. Për këtë veprimtari sezonale, xhaxhai im më tha se i ka paguar taksat si në ish Komunën Velipojë ashtu edhe në Bashkinë Shkodër, si biznes i vogël, por për këtë veprimtari nuk kam mundur të siguroj informacion. **Edhe në drejtim të këtij pretendimi Komisioni nuk ka kryer asnjë veprim verifikimi, bazuar në nenin 50 të ligjit 84/2016.**

Nga ana ime është kërkuar që pretendimet e mia për ushtrimin e aktivitetit tregtar nga xhaxhai im Fahri Ymeri dhe bashkëshorti i hallës Xheladin Thana të vlerësohen nga Komisioni bazuar në parimin e barazisë, duke evidentuar edhe disa vendimarrje të mëparshme të tij.

Kështu në vlerësimin tim situata në fjalë është identifike me atë të subjektit të rivlersimit **Arta Marku, e konfirmuar në detyrë me vendimin me numër 31, datë 04.07.2018, ku pjesë e komisionit kanë qenë komisioneret Pamela Qirko dhe Genta Bungo.** Ashtu si dhe në në rastin e xhaxhait tim prokurorja Arta Marku pretendoi se shuma monetare e dhënë hua nga nëna e saj që kishte shërbyer për blerjen e apartamentit, ishte fituar nga aktiviteti tregtar. **Meqenëse nëna e subjektit nuk ishte rregjistruar si subjekt tregtar ushtrimin e këtij aktiviteti subjekti Arta Marku e provoi me prova rrethanore si fotografi dhe depozitë bankare, ku nëna e saj kishte depozituar vlera monetare**. Ky argument i saj u konsideruar bindës nga komisioni, pjesë e të cilit theksoj ishin dhe dy komisioneret që morën pjesë në procesin tim të rivlersimit.
Në rastin konkret natyrshëm më lind pyetja se mbi cfare argumenti juridik këto komisionere bëjnë një trajtim të ndryshëm të personit tim në raport më subjektin e rivlersimit Arta Marku, e cila e ndodhur në një situatë të ngjashme (madje unë kam të dhëna më shumë dhe konkretisht të dhëna se xhaxhai im është rregjistruar si subjekt tatimor) asaj i njihet huaja si burim i ligjshëm i të ardhurave, ndërkohë që mua nuk më njihet? Me këtë rast gjej me vënd të kujtoj se cdo procedurë administrative ka si bazë të saj respektimin e parimit të barazisë, sipas të cilit: *"1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. 2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë."*

Në lidhje me këtë pretendim timin Komisioni ***në pikën 42.10 (i) a të vendimit referon në arsyetimin e bërë në pikën 36.4, sipas të cilit "pretendimet duhet të vlerësohen sipas rrethanave individuale të cdo subjekti rivlersimi".*** Duke vlerësuar këtë qëndrim të mbajtur nga Komisioni, i cili në cdo rast kur nuk ka argumente juridike dhe faktike për të hedhur poshte pretendimet e mia përdor këtë shprehje standarte, mendoj se ai është pasqyrimi i qartë i faktit se në asnjë moment unë nuk jam trajtuar në mënyrë të barabartë më subjektet e tjera të rivlersimit, duke u cënuar haptazi në parimin e barazisë.

Në lidhje me pamundësinë time për të siguruar informacion për volumin e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet tregtar nga xhaxhai im, **unë i kam kërkuar Komisionit dhe vijoj ti kërkoj Kolegjit** që këtë situatë t'a konsiderojë në kontekstin e parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit 84/2016 "Për rivlersimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" në të cilin parashikohet:***"Nëse subjekti i rivlersimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlersimit se dokumentacioni është zhdukur, ka humbur,nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër.Institucionet e rivlersimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumentave nuk përgjigjet brenda afatit ligjor. "***

Në lidhje me këtë situatë vlersoj se Kolegji, mosparaqitjen e dokumenteve justifikuese nga ana ime mendoj se duhet t'a konsiderojë për shkaqe të arsyeshme dhe t'a vlerësojë në favorin tim, për shkak se dokumentacioni që provon ushtrimin e aktivitetit tregtar nga xhaxhai im (dhe huadhënësi Xheladin Thana) është asgjësuar apo ka humbur për faj të institucioneve shtetërore dhe jo për faj të huadhënësve.

Ndryshe nga sa arsyeton Komisioni se xhaxhai im ka të dhëna tatimore deri në vitin 2001 theksoj se nga ana e tyre janë kryer veprime verifikuese vetëm për një periudhe të veprimtarisë tregtare të ushtruar nga xhaxhai im Fahri Ymeri, ndërkohë që nuk kanë kryer asnjë veprim verifikimi për pretendimet e tjera të mia.

Në këtë drejtim theksoj faktin se huadhënësit nuk kanë patur ndonjë detyrim ligjor për të ruajtur dokumentacionin dhe për më tepër që ka kaluar një kohë tepër e gjatë (mbi 17 vjet).Për ruajtjen e dokumentacionit tatimore nuk mund të penalizohet as vetë tatimpaguesi, e rrjedhimisht unë, pasi në në udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton qartë se afati maksimal i ruajtjes se këtyre të dhënave nga ai është 5 vjet. **Afati i ruajtjes se dokumentacionit dhe mbajtja e kontabilitetit për qëllime tatimore**: *"Tatimpaguesit, janë të detyruar të përdorin dokumentacionin bazë tatimor dhe për çdo shitje lëshojnë faturë tatimore ose kupon tatimor. Dokumentacioni bazë, si faturat tatimore të TVSH-së dhe faturat e thjeshta tatimore; regjistrat dhe të gjitha regjistrimet e bëra në këto regjistra; librat kontabël dhe të gjitha regjistrimet e bëra në këto libra, të cilat mbahen siç përcaktohet në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; raportet financiare, librat e shitjes dhe librat e blerjes, të cilat mbahen siç përcaktohet në ligjin "Për TVSH-në dhe në udhëzimin në zbatim të tij, ruhen për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit ushtrimor në të cilin ato janë lëshuar. Kjo do të thotë që, një faturë tatimore e lëshuar në muajin janar të vitit 2013, duhet të ruhet deri me 31 dhjetor 2018."*

Gjithsesi, meqënëse bëhet fjalë për biznes të vogël, më sipër kam arsyetuar se sipas Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", biznesi i vogël është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Po ashtu, më sipër kam arsyetuar se sipas nenit 6, pika 4 të Ligjit nr. 8978, date 12.12.2002, "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël", dhe nenit 12 të Ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar", veprimtaria tregtare e xhaxhait tim Fahri Ymeri, si biznes i vogël, edhe nëse nuk është rregjistruar prej tij, (*në fakt xhaxhai sipas deklarimit që më ka thënë në telefon e ka rregjistruar rregullisht*), do duhej të rregjistrohej kryesisht nga organet tatimore dhe kjo do të ishte e barazvefshme me rregjistrimin e kryer nga vetë subjekti. Prezumohet ligjërisht që organet shtetërore e zbatojnë ligjin dhe jo e kundërta. Pra, prezumohet se veprimtaria e xhaxhait tim ka qënë e rregjistruar. Sipas nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, "*faktet për të cilat ekziston një prezumim ligjor nuk ka nevojë të vërtetohen nga pala në dobi të të cilës ekziston prezumimi*" . Përveç prezumimit të rregjistrimit ka edhe një prezumim tjetër, që ka si premisë bazë arsyetimin se prezumohet që organet shtetërore të ngarkuara me ligj për mledhjen e taksave dhe tatimeve e zbatojnë ligjin, për mbledhjen me forcë të detyrimeve fiskale nëse subjekti nuk i paguan ato në mënyrë të vullnetshme. Vetë fakti që xhaxhai im apo anëtaret e familjes së tij, nuk rezulton të jenë bërë ndonjëherë subjekt kontrolli tatimor apo të procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve, tregon që këto detyrime, në masën 1.5% të të ardhurave për secilin vit ushtrimor të ushtrimit të aktivitetit, prezumohet se janë paguar në mënyrë të vullnetshme. Ajo që nuk vërtetohet dot me saktësi është volume i veprimtarisë tregtare brenda fashës së biznesit të vogël dhe të ardhurat konkrete. Lidhur me këtë aspekt ftoj Komisionin që

duke iu referuar të dhënave të mundshme të INSTAT dhe/apo anketave korresponduese të Bankës së Shqipërisë, të bëjë një vlerësim të përafërt të fitimit të mundshëm që mund të ketë realizuar xhaxhai im për përiudhën 1998 - 2006, nga aktiviteti i tij si biznes i vogël i shitjes së fruta perimeve.
Në vlerësimin tim kjo analizë juridike duhet të vlerësohet në këndvështrim edhe të parashikimeve të nenit 49/3 të ligjit 84/2016, sipas të cilit: **"3. Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme."**

Në lidhje me analizën financiare që Komisioni i ka bërë "personit tjetër të lidhur" Fahri Ymeri, ashtu si dhe në lidhje me Xheladin Thanën **mendoj ai se bie ndesh me qëllimin e ligjit 84/2016, me praktikën e konsoliduar me vendime të Kolegjit të Posacëm të Apelit dhe me praktikën e mbajtur nga vetë anëtaret e Komisionit, me vendimet e mëparshme të dhëna për subjekte te tjera.**
Në këtë drejtim ripërmend vendimin e **Kolegjit të Posaçëm i Apelimit, me vendimin me numër nr. 15, datë 17.07.2019, i cili ka vendosur këtë standard:** ***"[...]*** *Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016,* ***ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.*** *Interpretimi në të kundërt i kësaj pasurie konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai është ngarkuar ligjërisht të mbajë* ***dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur [...].***
Në këtë shpjegim, në drejtim të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të shumës së dhënë hua nga personi tjetër i lidhur, ka cituar, po ashtu edhe pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ku një nga parimet mbi bazën e të cilit kryhet procesi i rivlerësimit është ai i proporcionalitetit. Sipas nenit 52 të këtij ligji në lidhje me standardin procedural të barrës së provës, Komisioni dhe Kolegji i Apelimit udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit. Për kryerjen sa më korrekt të procesit të kontrollit të pasurisë, ligjvënësi, por edhe vetë Komisioni nëpërmjet parimit të proporcionalitetit pranojnë zgjidhjen e çështjeve dhe marrjen e vendimeve duke pasur në konsideratë gjendjen që e dikton këtë vendimmarrje dhe ka kërkuar që të analizohet ky parim edhe në këndvështrim të zhvillimit historik dhe ekonomik të vendit tonë, situatës së informalitetit të krijuar, ndër vite, për shkak të rrethanave specifike të zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike dhe specifikisht, reminitancave të përftuara nga emigracioni".

Nga analiza financiare që Komisioni i bën "personit tjetër të lidhur" Fahri Ymeri rezulton qartazi se ajo e barazon atë në cilësi me vetë subjektin e rivlersimit, qëndrim i cili del jashtë qëllimit të ligjit 84/2016. **Detyra ime si subjekt i rivlersimit në lidhje me huanë e dhënë babait tim nga personi tjetër i lidhur Fahri Ymeri është të provoj ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua dhe jo të provoj mundësinë e krijimit të cdo pasurie nga ky shtetas gjatë jetesës së tij.**

Ky qëndrim i mbajtur nga Komisionit në lidhje me personit tjetër të lidhur Fahri Ymeri bie ndesh edhe me praktikat e mëparshme të mbajtura nga të njëjtat anëtare të cilat kryejnë procesin tim të

rivlersimit dhe konkretisht Pamela Qirko dhe Genta Bungo. Kështu gjej me vend të evidentoj vendimin e formës së prerë nr. **283, datë 29.07.2020 të KPK për subjektin e rivlersimit Altina Nasufi.** *"Në lidhje me këtë subjekt KPK bëri një hetim të thelluar nga ku rezultoi: Subjekti i rivlersimit kishte marrë hua kunatës së saj një shume të konsiderueshme monetare (27.000 euro), për blerjen e apartamentit të saj, shumë e cila pretendohej të ishte fituar në emigracion. Komisioni pasi vlersoi dokumentacionin për burimin e ligjshëm të të ardhurave, në lidhje me personit tjetër të lidhur (huadhënësen), konkludoni se shuma e të ardhurave të fituara nuk mjaftonte edhe për dhënien e huasë edhe për përballimin e jetës nga ky person. E pyetur për shpjegimin e këtij fakti subjekti i rivlersimit referoi te vendimi me numër 15, datë 17.07.2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në lidhje me vlersimin e burimit të ligjshëm për personin tjetër të lidhur (sic është halla ime dhe bashkëshorti i saj)".* KPK, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, bazuar edhe në praktikën e KPA, të sipërcituar, ka pranuar bindëse shpjegimet e subjektit, duke konsideruar huanë për këtë subjekt, si burim të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Bazuar në këtë praktikë të vendosur nga Kolegji i Posacëm i Apelimit dhe vendimarrje të mëparshme të vetë komisioneve që më gjykojnë mua, mendoj se huadhënësit Fahri Ymeri nuk duhet t'i bëhej një analizë financiare e cila qartësisht është e njëjtë me analizën financiare që më bëhet mua si subjekt rivlersimi.

Pavarsisht kësaj cmuarje mendoj se edhe analiza financiare që Komisioni i ka bërë Fahri Ymerit është e gabuar, për shkak të zhvendosjes në kohë të fakteve të ndodhura apo mosnjohjes së burimeve të ligjshme të të ardhurave të xhaxhait tim. Kështu rezulton qartë që Komisioni nuk njeh si burim i ligjshëm i të ardhurave shumën monetare që Fahri Ymerit i është dhënë nga gjyshi im i ndjerë Fetah Ymeri, fakt që rezulton qartë nga deklarata noteriale dhe provat rrethanore të paraqitura nga ana ime. Nga ana tjetër Komisioni zbret si shpenzimeve blerjen nga ana e Fahri Ymerit të banesës në lagjen "Perash" apo shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës të legalizuar më pas. Gjithashtu Komisioni zbret shpenzimet për jetesë të xhaxhait tim Fahri Ymeri pa marrë në konsideratë pretendimet e mia që këto shpenzime të konsiderohen minimalisht të mbuluar nga të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar.

Për secilin prej këtyre huadhënësve (Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri), jam përpjekur të paraqes dhe/apo tregoj prova të mjaftueshme dhe të hollësishme që ata kanë siguruar të ardhura të ligjshme edhe nga aktivitetet tregtare që kanë realizuar secili prej tyre. Sipas vlerësimit tim të shprehur më sipër, edhe për këto të ardhura, nëse nuk provohen drejtëpërdrejt, të paktën prezumohen se janë paguar taksat dhe tatimet. Kjo pasi nuk mund të më ngarkohet as mua dhe as shtetasve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, barra e provës për të vërtetuar faktin negativ, pra që dokumentacioni përkatës që vërteton të ardhurat e ligjshme nga veprimtaria e tyre tregtare, dhe që duhej të ishtë i përfshirë në fondin arkivor të administratës tatimore, ka mangësi dhe/apo nuk është i plotë, por duhet t'i ngarkohet barra e provës administratës tatimore dhe shtetit për të vërtetuar faktin pozitiv, pra që ky dokumentacion ndonëse ekziston i plotë dhe pa mangësi në fonin arkivor në fjalë, nuk përmban të dhëna për të ardhurat e ligjshme të shtetasve Fahri Ymeri dhe Xheladin Thana, përpara vitit 2006, (që është viti kur babai im ka marrë dy huatë nga këta shtetas).

I lutem Kolegjit, që meqënëse për veprimtarinë e tij janë të zbatueshme edhe normat e Kodit të Procedurës Civile, për sa janë të zbatueshme, të ketë parasysh lidhur me mënyrën e shpërndarjes së barrës së provës në këtë drejtim, edhe praktikën e konsoliduar gjyqësore duke filluar nga ajo e Gjykatës së Diktimit, të pasuar nga ajo e Pleniumit të Gjykatës së Lartë dhe duke përfunduar me praktikën aktuale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, se si shpërndahet barra e provës ndërmjet dy palëve në mosmarrëveshje, ku njëra pretendon një fakt negativ, ndërsa pala tjetër pretendon një fakt pozitiv. Pra p.sh a duhet t'i ngarkohet barrë prove palës që pretendon se Kalaja e Rozafës nuk është në pronësi të tij, (që është fakti negativ), apo duhet t'i ngarkohet barra e provës palës tjetër që pretendon se Kalaja e Rozafës është në pronësi të saj, (që është fakti pozitiv). Sipas rregullave të mendimit të shëndoshë juridik, nuk i ngarkohet barra e provës atij që pretendon faktin negativ, pasi nuk mund të vërtetohet ajo që nuk ekziston por mund të vërtetohet vetëm ajo që ekziston, (pra fakti pozitiv). Pra nuk mund të më ngarkohet mua si barrë prove që dokumentacioni i administratës tatimore është i mangët, por duhet kërkuar në administratën tatimore informacion nëse ky dokumentacion që vërteton volumin e veprimtarisë së tatimpaguesve, ashtë administruar apo jo i plotë në fondin arkivor të administratës tatimore. Vetëm nëse ky dokumentacion është administruar i plotë, atëherë barra e provës më kalon mua, babait tim dhe huadhënësve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri. Gjithsesi, risjell në vëmëndje se për efekt të procesit tim të rivlerësimit kalimtar, ekzistojnë dy prezumime ligjore, që janë: trazirat e vitit 1997 dhe djegja e dokumentacionit, (shih nenin 13/1 të KPC), dhe prezumimi se punonjësit e shtetit e zbatojnë ligjin në veprimtarinë e tyre, dhe jo e kundërta, (shih nenin 12/2 të KPC), që nënkupton se tatimpaguesit Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, për sa kohë nuk janë bërë subjekt kontrolli tatimor, nuk i janë nënshtruar procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, nuk janë dënuar penalisht, si dhe as kanë qënë të hetuar penalisht ndonjëherë, për fshehje pasurie dhe/apo mosdeklarim të ardhurash, atëherë prezumohet se ata kanë qënë në rregullt dhe të ligjshëm, në sigurimin e burimeve nga veprimtaria e tyre tregtare.

Së fundi, në këtë pjesë të analizës, i sjell në vëmëndje Kolegjit se në rastin më të keq të mundshëm, sipas standartit të vendosur me vendimin e lartëpërmëndur të KPA-së, të ardhurat e përfituara nga veprimtaria tregtare e huadhënësve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, minimalisht kanë shërbyer për të mbuluar konsumin familjar të familjeve të tyre. Edhe kaq mjafton (madje tepron shumë), që huatë që ata i kanë dhënë babait tim në vitin 2006, të konsiderohen si të ardhura me burime të ligjshme për efekt të procesit tim të rivlerësimit kalimtar. Kjo pasi e ritheksoj se provohet katërcipërisht se njëri ka shitur dy banesa dhe tjetri ka shitur tre sipërfaqe tokë, duke përfituar shuma që e kapërcejnë thellësisht dhe thelbësisht shumat e huave të dhëna prej tyre tek babai im, në vitin 2006 dhe që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit që unë përdor aktualisht, duke filluar nga viti 2008.

Do t'i lutesha Kolegjit që krahas sa më sipër, të bëjë një cilësim sipas ligjit 84/2016, të vetingut, nëse shtetasit Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri, quhen apo jo *"persona të tjerë të lidhur",* në kushtet kur secili prej tyre nuk është përfshirë në marrëdhënie juridike me mua (por me babain tim) si dhe në kushtet kur unë përveç të drejtës së banimit/përdorimit nuk kam ndonjë të drëjtë tjetër ligjore mbi apartamentin e banimit të blerë, ndër të tjera, duke përdorur si burime edhe dy huatë në fjalë. Pra lind pyetjet, - A *quhen persona të tjerë të lidhur, subjektet që nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit, përmes ndonjë marrëdhënie juridike dhe kur subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton të ketë përfituar drejtëpërdrejt, ndonjë të drejtë ligjore nga këto subjekte* ?

Kjo duke parë edhe disa praktika të ndryshme të institucioneve të rivlerësimit në këtë drejtim. Kjo pasi kam parë me dhjetra vendime si të KPK ashtu edhe të KPA, që në rastin kur një subjekt rivlerësimi, ka vetëm në përdorim, (me qera, huapërdorje, etj) një banesë, të cilin pronari e ka blerë me borxh ose kredi në bankë, insitucionet e rivlerësimit nuk i kanë ngarkuar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të vërtetuar as burimet e ligjshme të blerjes së kësaj pasurie nga pronari, dhe aq më pak barrën e provës për të vërtetuar që banka (*e cila mund të jetë off shore*), ka ushtruar aktivitet të ligjshëm, apo ka realizuar të ardhurat që deklaron në rregjistrat fiskal, ose dhe ku i gjeti ai që i dha borxh pronarit të banesës paratë që i dha hua, apo dhe veçanarisht nuk ka hetuar nëse këto të ardhura të dhëna hua, janë apo jo të ardhura mbi të cilat janë paguar detyrimet fikskale në favor të shtetit.
Për më tepër konstatoj se në ligjin 84/2016 nuk jepet asnjë përcaktim në lidhje me *"personi i lidhur me personin tjetër të lidhur"* sic janë huadhënësit Fahri Ymeri dhe Xheladin Thana dhe për më tepër në këtë ligj subjektit të rivlersimin nuk i kalohet asnjë barrë prone për vërtetimin e ligjshmërisë së të ardhurave të personave të kësaj kadegorie *(personi i lidhur me personin tjetër të lidhur)*.

Në lidhje me trajtimin që Komisioni i ka bërë vlerësimit të pasurisë së *"personit tjetër të lidhur"* të përdorur nga subjekti i rivlersimit, kërkoj të merret në konsideratë dhe të trajtohem mbi bazën e "parimit të barazisë" me subjektin e rivlersimit **Alma Bramo, e konfirmuar në detyrë me vendimin e formës së prerë me numër 536, datë 02.06.2022, të cituar edhe më lart**. Në këtë vendim Komisioni shprehet: *Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme financiare për të blerë këtë apartament. Pavarësisht këtij përfundimi, Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për personin e lidhur, nënës së subjektit, në blerjen e këtij apartamenti nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, për arsyet si vijojnë:*

i) Në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme, krijimi dhe marrëdhënia financiare për pagimin e saj është provuar nga hetimi administrativ se subjekti nuk ka asnjë shfaqje të vullnetit të saj, duke u provuar se nuk ka asnjë nënshkrim të asnjë dokumenti ligjor për përfitimin e saj dhe asnjë pagim të kësteve për këtë pasuri.

ii) Pasuria është regjistruar në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në emër të nënës së subjektit.

iii) Vetëm te pjesa takuese e babait të subjektit mbi këtë pasuri prej ½ si pjesë e pasurisë bashkëshortore, është pasuria ku subjekti tërheq të drejta pasurore si trashëgimtare ligjore e radhës së parë për 1/5 pjesë, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore sipas nenit 74 të Kodit të Familjes.

1.33 Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat lidhur me pasaktësinë e deklarimit dhe pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të nënës së saj për përfitimin e kësaj pasurie nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Në harmoni me këtë praktikë të vendosur nga Komisioni vlerësoj se unë nuk mund të ngarkohem me "barrë prove" për të provuar ligjshmërinë e krijimit të një pasurie që nuk është në pronësinë time, por është në pronësinë e prindërve të mi. Edhe nëse pranohet pretendimi se unë mbi këtë pasuri tërheq të drejta pasurore (si kontribues i saj dhe trashegimtar i ardhshëm i pasurisë së prindërve të mi), "barra e provës" me të cilën Komisioni duhet të më ngarkojë është në përpjestim me pjesën time takuese mbi këtë pasuri dhe jo plotësisht, qëndrim i cili do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit. Nga një llogaritje e thjeshtë matematikore i kësaj pjese takuese në raport me vlerën e të ardhurave që sipas Komisionit nuk mbulohen me burime të ligjshme, rezulton qartë se pjesa për të cilën unë ngarkohem me "barrë prove" nuk është e tillë që të justifikojë shkarkimin tim nga detyra, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe praktikës të vendosur me vendime të Kolegjit të Apelit (Ramiz Lala, Marinela Osmani etj) dhe vendimin e GJEDNJ në cështjen Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë.

Bazuar në konstatimet e Komisionit në lidhje me këto hua dhe analizën financiare të kryer nga ana e tij kam evidentuar faktin se huatë që babai im i ka marrë xhaxhait dhe bashkëshortit të hallës time nuk i ka konsideruar si burime të ardhurash dhe nuk i ka përfshirë në analizën financiare. Në vlerësimin tim ky qëndrim i Komisionit është tërësisht i gabuar pasi:

Së pari, fakti i marrjes së këtyre huave nga babai im rezulton plotësisht i provuar me kontrata noteriale, të cilat në bazë të nenit 253 të K.Pr.Civile kanë fuqi të plotë provuese. Hartimi i këtyre deklaratave noteriale është bërë në kohën e blerjes së banesës, viti 2006, kohë kur unë as nuk e dija dhe as mund ta parashikoja se ato do të ishin ndonjëherë pjesë e dokumentacionit për kryerjen e procesit të rivlersimit kalimtar për personin tim. Kjo pasqyron faktin se lidhja e këtyre kontratave noteriale nuk ka pasur si qëllim primar deklarimet e pasurisë nga ana ime, por ka pasur si qëllim formalizimin e veprimit të kryer, ne funksion të mbrojtjes të të drejtave të huadhënesve.

Së dyti,unë këto hua i kam deklaruar si burime të krijimit të pasurisë ku banoj me familjen time në DPV e vitit 2006, kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, ku konkretisht huanë marrë shtetasit Xheladin Thana e kam deklaruar në këtë DPV, dhe në memon që kam dorëzuar përpara ILDKPKI në datën 16.02. 2015, bazuar në 27 të ligjit numër 9040, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nënpunësve publik".
Në lidhje me këtë fakt, sic e kam trajtuar edhe me lart, ka praktikë të konsoliduar nga KPK ku deklarimet e dhëna nga subjektet e rivlersimit gjatë procesit administrativ të ILDKPI janë konsideruar si deklarime të rregullta dhe vlersuar si prova gjatë procesit të rivlersimit kalimtar (vendim i fomës së prerë me numër 444, datë 16.09.2021 i subjektit të rivlersimit Artan Cupi, vendimi me numër 37, datë 24.11.2021 për subjektin e rivlersimit Sokol Ngresi etj).

Së treti, evidentoj faktin që gabimisht apo ndoshta me keqdashje në analizën time financiare huatë nuk njihen si burime të ardhurash, ndërkohë që Komisioni njeh shlyerjen e tyre, si shpenzime, duke i zbritur dy herë nga të ardhurat e familjes time.
Konkretisht Komisioni citon:*"Në këtë analizë, nuk është përfshirë huaja prej 1,500,000 lekë e deklaruar si e marrë nga Xheladin Thana në vitin 2006, për arsye se subjekti nuk provon me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj vlere nga huadhënësi. Vlerat e deklaruara*

si kthime të kësaj huaje (përkatësisht 800,000 lekë në vitin 2006 dhe 700,000 lekë në vitin 2007) janë përfshirë si shpenzim për subjektin dhe familjen e tij të origjinës në vitet përkatëse"
Ky qëndrim i Komisionit, në vlerësimin tim është tërësisht i gabuar, pasi minimalisht nëse këto veprime nuk konsiderohet si në ardhura llogjikisht ato nuk mund të llogariten as si shpenzime për pagimin e tyre, pasi unë nuk mund të paguaj dicka që se kam marrë.

Përfundimisht mendoj se me akte shkresore, analizë juridike dhe shpjegime unë kam shpjeguar plotësisht burimet e ligjshme të të ardhurave të huadhënësve Fahri Ymeri dhe Xheladin Thana, shpjegime që në vlerësimin tim janë shterruese dhe plotësisht të qarta. Mosnjohja e këtyre huave në të ardhurat e familjes time dhe mospërfshirja e tyre në analizën financiare pasqyron dashakeqsinë dhe paracaktimin e vendimit përfundimtar nga Komisioni, duke e bërë procedurën e ndjekur nga ana e tij një farcë që synon në thelb realizimin edhe te *"gjyqit popullor"* ndaj meje dhe familjes time.

Kjo dashakeqësi evidentohet vecanarisht bazuar në faktin se në asnjë pjesë të raportit të dërguar nga Komisioni nuk i jepet përgjigje situata faktike dhe juridike të shtruara nga unë, për shkak të të cilave veprimet juridike të shitblerjes së pasurive të paluajtshme (banesë dhe tokë zyrtarisht të provuara me aktet ligjore që ju kam dërguar) dhe aktiviteti tregtar i huadhënësve Xheladin Thana dhe Fahri Ymeri duhet të konsiderohej si burim i ligjshëm i të ardhurave, jo vetëm për mbulimin e shpenzimeve për jetesë të familjeve të huadhënësve, por edhe për realizimin e shumave të huasë që ata i kanë dhënë babait tim.

Mbi këtë arsyetim mendoj se në zbatim të parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit dhe barazisë Komisioni duhet t'i përfshijë në analizën financiare të ardhurat që rezultojnë nga këto hua, ku pas njohjes dhe llogaritjes së tyre rezulton e mbuluar vlera e blerjes nga babai im të apartamentit në vitin 2008 dhe ne nuk rezultojmë me bilanc negativ as në kohën e blerjes dhe as pas zbritjes së shpenzimeve për jetesë.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit**:** ***"43.4. Në përfundim rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kthimin e huas marrë shtetasit F.Y në shumën 1,370,285.14 lekë, në kuptim të nenit 33/5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016."*** shpjegoj:

Nga vistimi i analizës financiare që Komisioni më ka bërë mua në lidhje me mundësinë e kthimit të huasë xhaxhait Fahri Ymeri qartazi evidentohet fakti se Komisioni nuk ka përfshirë në të ardhurat e familjes time shumë prej burimeve të deklaruara nga ana ime, të tilla si huaja marrë shtetasit Xheladin Thana, aktiviteti tregtar i babait tim, të ardhura nga qeraja e tokës bujqësore etj, të cilat nëse do të njiheshin dhe përfshiheshin qartësisht që unë nuk do të rezultoja me bilanc negativ. Në këtë drejtim kujtoj se vetëm huaja që babai im i ka marrë Xheladin Thanës e cila nuk është njohur nga Komisioni si burim të ardhurash, është në shumën 1,500,000 lekë, e cila qartësisht tejkalon vlerën e bilancit negativ me të cilën më nxjerr Komisioni në shlyerjen e huasë të xhaxhait Fahri Ymeri në fund të vitit 2006.

1.9 Në lidhje me konstatimin e Komisionit: ***"44.4. Në përfundim, Komisioni konkludon se: (i) subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri;***

(ii) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në shumën -3,813,555.33 lekë." shpjegoj:

Unë e pranoj faktin se në lidhje me këtë pasuri kam kryer deklarim të pasaktë në deklarimin e burimeve të krijimit të apartamentit të banimit ku unë jetoj. Kjo pasi në Deklaratën Vetting nuk kam shënuar si burime të ardhurash dy huatë që babai im i ka marrë shtetasve Fahri Ymeri dhe Xheladin Thana. Duke vlerësuar faktin se këto hua unë i kam deklaruar më parë më DPV e kohës së krijimit të pasurisë, në shpjegimet që kam dhënë përpara ILDKPKI, këto burime të ardhurash rezultojnë nga akte noteriale me fuqi të plotë provuese, unë i kam deklaruar sërish këto hua, me vetinisiativë në përgjigje të pyëtësorit standart etj (të trajtuara më lart), mendoj se kjo pasaktësi e imja nuk duhet të vlerësohet si shkak për shkarkimin tim nga detyra, pasi cdo qëndrim i kundërt do të binte ndesh me parimet e proporsionalitetit, ligjshmerisë e barazisë.

Ndërkohë në lidhje me konkluzionin e Komisionit se unë kam mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën -3,813,555.33 lekë, ashtu sic e trajtova edhe më lart, kjo ka ardhur për shkak se Komisioni nuk më ka njohur si burime të ligjshme të ardhurat:

- nga aktiviteti tregtar si shitës ambulant i babait tim,
- nga aktiviteti i babait tim për legalizimin e dokumentave
- nga aktiviteti i vëllait tim si as/avokat dhe shitjen e fruta perimeve
- nga dhënia me qera e tokës bujqësore
- huanë marrë shtetasit Xheladin Thana
- huanë marrë shtetasit Fahri Ymeri

Përfshirja e këtyre burimeve të ardhurash në analizën financiare të familjes time për vitet 2004-2006 pasqyron qartë faktin se babai im me datën 10.04.2006 ka pasur mundësi monetare të blejë apartamentin në lagjen "Vasil Shanto" të qytetit të Shkodrës dhe po kështu të shlyej detyrimin nga shtetasit Fahri Ymeri dhe një pjesë të detyrimit ndaj shtetasit Xheladin Thana.

Për të pasqyruar faktin se unë nuk kam patur një trajtim të barabartë në raport me subjekte të tjera rivlersimi, duke mu cënuar haptazi parimi i barazisë gjej me vend të përmend edhe **vendimin me numër 479, datë 03.12.2021, për subjektin e rivlersimit Arben Dosti. Kujtoj se në kryerjen e procesit të rivlersimit të këtij subjekti kanë qenë dy komisioneret Pamela Qirko dhe Genta Bungo**, të cilat kanë dhënë vendimin të cilin unë po ankimoj, ku qartazi evidetohet një standart i dyfishtë në trajtimin tim.
Në lidhje me këtë subjekt rezulton se Komisioni ka konsideruar si të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës prej 100.000 euro, të dhënë hua nga subjekti një personi tjetër, burime të tilla si puna në emigracion, punësimi pranë një shoqërie tregtare ku nuk provohej marzhi i fitimit për subjektin, shitjen e një dyqani në pronësi të nënës së subjektit, ku cmimi i shitjes në kontratë ishte shumë me i ulët se cmimi i pretenduar nga subjekti etj, për të cilat gjatë hetimit administrativ dhe seancës degjimore Komisioni nuk provoi me dokumentacion ligjor mundësinë e subjektit për t'i realizuar këto të ardhura, por provoi vetëm faktin që subjekti i rivlersimit kishte të ardhura të depozituara në banka apo rezultonte që kishte deklarata për dhënie huash nga familjarët e tij. Pra në lidhje me këtë shumë **100.000 euro (e cila është në nivel përralle krahasuar me shumat për të cilat unë sipas Komisionit jam me bilanc negativ)** subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor volumin e të ardhurave të realizuara nga secila veprimtari, por provoi vetëm faktin e depozitimit të shumave monetare në sistemin bankar.

Kjo situatë është e njëjtë me burimet e të ardhurave të pretenduara nga ana ime, madje në kah më të favorshëm për personin tim, jo vetëm për faktin se unë nuk kam dhënë asnjëherë deklarime kontradiktore (sic rezulton në rastin konreket), por edhe bazuar në faktin se shuma monetare që rezulton nga burimet e "personave të lidhur" me personin tim është shumë më e ulët se ajo e subjektit Arben Dosti.

Edhe nga ana ime u provua fakti i realizimit të të ardhurave nga aktiviteti tregtar nga xhaxhai dhe bashkëshorti i hallës time, jo vetëm nga aktet shkresore që provonin rregjistrimin e tyre si subjekt tatimor, por edhe nga fakti se secili prej tyre kishte depozita bankare apo kishte kryer investime nga të cilat provohej realizimi i fitimit nga ky aktivitet (psh automjeti i blerë nga bashkëshorti i hallës time në shkurt të vitit 2000). Të ardhurat e realizuara nga puna e babait tim unë i kam deklaruar në kohë reale në cdo DPV të kohës dhe njëkohsisht babai im rezulton të jetë rregjistruar si person fizik. Të ardhurat e realizuara nga toka bujqësore janë të provuara jo vetëm me deklarimin tim në DPV por edhe deklaratën noteriale të lëshuar nga shtetasi Shefqet Geci. Vlerësuar në këtë këndvështrim nuk konstatoj asnjë ndryshim në mes situatës time dhe asaj të subjektit Arben Dosti (vec vlerës monetare e cila të unë është shumë herë më e vogël), për të cilin Komisioni duket qartë se ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi që mban për personin tim.

Qëndrimi i pabarabartë dhe cënimi i parimit të barazisë në drejtim të personit tim shfaqet edhe në qëndrimin që Komisioni ka mbajtur 14 ditë përpara shpalljes se vendimit tim për subjektin e rivlersimti Arbër Cela, ku pjesë e komisionit të tij ishte Komisionierja Genta Bungo, pjesë edhe e procesit tim. Në lidhje me këtë subjekt mosdeklarimi i huasë që kishte shërbyer për blerjen e apartamentit të banimit as në DPV dhe as në deklaratën veting (por vetëm gjatë hetimit administrativ) nuk u konsiderua penalizues për këtë subjekti. Po kështu Komisioni vlerësoi konfirmimin e tij në detyrë pavarsisht faktit se nga hetimi nuk u provua mundësia financiare e huadhënësit të kësaj pasurie. Ky qëndrim i ndryshëm i Komisionerëve, sic edhe e kam trajtuar më lart, pasqyron standartin e dyfishtë që ata mbajnë për subjektet e rivlersimit.

Analiza e mundesise financiare per blerjen date 10/04/2006 e 111 m^2

Për vitin 01/01/2006- 10/04/2006		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**714,231**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01/01/2006- 10/04/2006	299,944	
1.2	Te ardhura nga puna dhe pensioni i babait Faik Ymeri 01/01/2006- 10/04/2006	42,819	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 01/01/2006- 10/04/2006	65,218	

Për vitin 01/01/2006- 10/04/2006		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 01/01/2006- 10/04/2006	-	
1.5	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga bursa Universiteti L.Gurakuqi nga 01/01/2006- 10/04/2006	21,667	
1.6	Te ardhura nga aktiviteti privat Faik Ymeri pa vend fix ushtrimi te aktivitetit	55,000	
1.7	Te ardhura nga dhenia me qera e tokes nga Faik Ymeri tek Sheuqet Geci ,deklarate noteriale dt 16.02.2015, sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	100,000	
1.8	Te ardhura nga aktiviteti privat P/F legalizim dokumentash nga Faik Ymeri , sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	82,500	
1.9	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga asistent avokat dhe shitje fruta perime ,sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	47,083	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**3,936,000**
2.1	Apartament 111 m2 Rr. A. Gj. Fishta, Shkoder - Faik Ymeri - 2006, 10.04.2006	3,936,000	
3	**Detyrimet**		**3,500,000**
3.1	Borxhe te marra nga Xheladin Cuf Thana, sipas dekl noteriale dt 24.04.2006 qe thekson se marre para nenshkrimit deklarates, pra para dates 10.04.2006	1,500,000	
3.2	Borxhe te marra nga Fahri Fetah Ymeri,sipas dekl noteriale dt 24.04.2006 qe thekson se marre para nenshkrimit deklarates, pra para dates 10.04.2006	2,000,000	
3.3	Borxhe te dhena Xheladin Thanes (nga 1,500,000 leke) ne 2006 , ne shumen 800.000 nentor- dhjetor sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit		
3.4	Dhene Fahri Fetah Ymeri 2,000,000 leke 2006 , dhene ne nentor- dhjetor sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit		
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		

Për vitin 01/01/2006- 10/04/2006		**Vlersimi nga eksperti**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
			(3,221,769)
5	**Shpenzimet**		**120,513**
5.1	Shpenzime jetese 2006	120,513	
5.2	Shpenzime udhetimi 2006	-	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**1,714,490**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**9,079**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**1,863,129**

2 **Pasuria automjeti me targë AA 993 NZ**

Në lidhje me vlerësimin e Komisionit: "***45.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në lidhje me lindjen e vajzave, për rrjedhojë ka rillogaritur këto shpenzime që janë në vlerën 675,889.5 lekë, ndërkohë në lidhje me shumën 80,000 lekë për sa kohë është shpenzuar së bashku me blerjen e automjetit dhe subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të provuar kohën kur janë kryer këto shpenzime, ato do të konsiderohen në momentin e blerjes së këtij automjeti. Në përfundim subjekti rezulton me pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti në shumën -51,244.44 lekë. Kjo shumë do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë."*** shpjegoj:

Nga analiza financiare që ka bërë Komisioni në lidhje me mundësinë e blerjes së këtij automjeti evidentoj se të ardhurat e marra nga bashkëshortja ime deri në kohën e blerjes së automjetit nuk janë llogaritur saktë, ku më janë llogaritur **më pak të ardhura në vlerësn 134,02 lekë.** Të ardhurat e bashkëshortes janë llogaritur **123,869 lekë më pak se shuma e marrë realisht.** Po kështu edhe interesat nga bonove të thesarit janë llogaritur **më pak dhe konkretisht me 38,585 lekë.** Evidentoj po ashtu se nga Komisioni **më janë rritur shpenzimet e jetesës me 132,728 lekë**. Shumatorja e këtyre të dhënave ka nxjerrë bilancin negativ për shkak të të cilit Komisioni ka konkluduar se unë nuk kam mjete të mjaftueshme financiare për blerjen e këtij automjeti.

Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit jap këto shpjegime:
Për vitin 2016 të ardhura në total janë 1.765.198 lekë të përbëra nga: Andri Ymeri 995.226 lekë; Arlinda Ymeri 495.476 lekë; të ardhura nga të afërmit për lindjen e vajzave 120.000 lekë; të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit në vlerën 154.196 lekë.

Shpenzimet në total (lëvizje paraje) janë 907.213 lekë, të ndara si më poshtë:
Shpenzime jetese 749.356 lekë
Mobilimi 102.857 lekë
Shkollimi i djalit 55.000 lekë

Investime në total, blerje makine plus riparime 1.010.000 lekë.
Blerja e makinës 930.000 lekë
Riparimi i makinës, duke e marrë të mirëqenë sipas Komisionit, që është bërë brenda periudhës 19.09.2016 në shumën 80.000 lekë.
Duke marrë parasysh se cash në fillim të periudhës është 7.495.760 lekë dhe në fund të periudhës paraqitet 7.287.760 lekë me formulën e lëvizjes së parasë rezulton se në fund të periudhës së analizuar që është më 30.09.2016 rezulton 55. 985 lekë. Pra mundësia e likujditetit për blerjen e automjetit sic ekziston, sic rezulton në tabelën si më poshtë:

Analiza financiare 19/09/2016
Analiza e mundesise se investimit ne blerje Automjeti - 1.010,000 leke - 19/09/2016

Pershkrimi	**Vleresim I subjektit te rivleresimit**
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 01.01.16-19.09.2016	995,226
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 01.01.16-19.09.2016	495,476
Te ardhura nga te afermit per lindjen e vajzes	120,000
Te ardhura bono thesari	154,496
Te ardhura totale 01.01.16-19.09.2016	**1,765,198**
Shpenzime jetese 3 persona 01.01.16-15.05.2016 dhe 5 persona nga 16.05.16-19.09.2016	557,854
Shpenzime per shlyerje kredie Pro Credit Bank 01.01.16-19.09.2016	0
Shpenzime mobilimi	12,757
Shpenzime Shkollimi	55,000
Shuma shpenzime likuiditeti	**625,610**
Investim ne blerje makine	1,010,000
Ndryshim likuiditeti 01.01.16-19.09.2016	
Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH	7,495,760
Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH	7,287,760
Pamundesi financiare	**337,587**

Madje analiza e mësipërme është bërë në sens përkeqsues për personin tim, pasi shpenzimi prej 80.000 lekë për dokumentacionin dhe riparimin e automjetit nuk është bërë brenda datës së blerjes së automjetit 19.09.2016, por është bërë deri në përfundim të vitit 2016. Kjo pasi është absurde të mendohet se unë kam bërë shpenzime për riparimin e automjetit përpara se t'a bleja atë. Po ashtu është absurde të besohet që në datën e blerjes së automjetit unë kam bërë shpenzime për riparimin e tij, pasi riparimi kërkon shpenzimin e një kohe fizike dhe sipas ligjit për

mbrojtjen e konsumatorit pagesa për riparimit bëhet pas kryerjes së riparimit dhe pasi të paraqitet fatura.

3 **Pasuria automjeti me targë AA 591**.

Në lidhje me këtë automjet Komisioni vlerëson: ***"i) Për sa i përket analizës financiare, Komisioni ka konstatuar një gabim material në llogaritjen e shpenzimeve jetike të familjes së vëllait të subjektit, i cili është korrigjuar. Pas korrigjimit të këtij gabimi familja e vëllait rezulton me të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti....dhe***

46.10. Në përfundim, në lidhje me këtë automjet, Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) deklarimet kontradiktore të subjektit në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti nga vëllai i tij; (ii) pretendimet e subjektit se si burim ka shërbyer edhe një hua në shumën 400,000 lekë dhënë babait nga ana e tij; (iii) deklarimet e subjektit se vëllai i tij kishte një automjet tjetër; (iv) mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit për të blerë këtë automjet në vitin 2014; (v) dhënien në vitin 2014 të shumës 1,400,000 lekë hua vëllait të tij; (vi) të dhënat e administruara nga AMF-ja, nga ku rezulton se bashkëshortja e subjektit është policëmbajtëse për këtë automjet për një periudhë të pandërprerë 30.3.2016 – 4.4.2018; si dhe (vii) subjekti nuk ka pasur automjet tjetër në pronësi – vlerëson se automjeti tip "F.F" mund të ketë qenë në pronësi të fshehur të subjektit." jap këto shpjegime:

Fillimisht evidentoj faktin se unë nuk kam dhënë asnjëherë shpjegime kontradiktore në lidhje me burimin e blerjes së këtij automjeti nga vëllai im. Në cdo rast unë kam shpjeguar se vëllai im ka patur burime të ligjshme për blerjen e automjetit, ndryshe nga sa Komisioni është munduar të më ngarkojë me pa të drejtë.

Në aktet "Rezultatet e hetimit administrativ" (dy aktet) unë fillimisht kam shpjeguar rrethanat e blerjes së këtij automjeti nga vëllai im, duke theksuar faktin se automjeti në fjalë nuk është në pronësinë time por është në pronësinë e vëllait tim Gerti Ymeri, por ai është përdorur nga bashkëshortja ime për një periudhë kohe.

Duke vlerësuar faktin e përdorimit të këtij automjeti nga bashkëshortja ime unë i kam dërguar Komisionit të dhëna shkresore nga të cilat rezultonin burimet e të ardhurave të vëllait tim, nga ku qartësisht rezulton qartësisht se ai kishte burime të mjaftueshme të ardhurash për blerjen e këtij automjeti.

Gjatë hetimit administrativ Komisioni arriti herë pas here në konkluzione të ndryshme në lidhje me këtë automjet, të cilat në cdo rast synonin t'a trajtonin atë si pasuri të fshehur nga ana ime. Kështu fillimisht në aktin e parë "Rezultatet e hetimit administrativ" Komisioni bëri analizën financiare të vëllait tim duke e llogaritur si një person i vetëm, ndërkohë që ai ishte i martuar dhe jetonte në një njësi familjare me bashkëshorten, vajzëne mitur (foshnjë), nënën e babanë tim.
Në aktin e dyte "Rezultatet e hetimit administrativ" Komisioni kreu analizën financiare të familjes së vallait tim, duke e barazuar atë me mua, pra në cilësinë e subjektit të rivlersimit, ku në përfundim arriti në konkluzionin se vëllai im nuk kishte burime të ardhurash për blerjen e automjetit.
Pas paraqitjes së provave të pakonstestueshme nga ana ime Komisioni u detyrua të ndryshojë sërish analizën financiare (për herë të tretë) ku në përfundim konkludon se vëllai im ka të

ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti, por pavarsisht kësaj sërisht konkludoi se ky automjet **mund** të ishte pasuri e fshehur nga unë.

Duke dashur të ritheksoj faktin se e gjithë kjo veprimtari e Komisionit tregon dashkeqsinë e tij në kryerjen e procesit të rivlersimit të personit tim, shpjegoj se arritja në këtë përfundim nuk bazohet në asnjë të dhënë reale, por vetëm në hamendësime të tij.

- Sic e theksova më lart unë nuk kam bërë asnjëhere deklarime kontradiktore mbi burimin e blerjes së kësaj pasurie, përkundrazi është Komisioni që minimalisht tre herë ka ndryshuar qëndrim në lidhje me të.
- Po kështu unë nuk kam deklaruar asnjëherë se burim për blerjen e këtij automjeti është huaja që unë i kam dhënë babait tim në vlerën 400.000 lekë në vitin 2013. Evidentimi i kësaj huaje që unë ndërkohë e kam deklaruar në DPV e këtij viti, është bërë me qëllim të evidentimit të të gjitha burimeve të të ardhurave të familjes së vëllait tim. Pavarsisht kësaj Komisioni me dashje nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të burimeve të ardhurave të vëllait tim, duke mos marrë në konsideratë të ardhurat që ai ka realizuar nga veprimtaria si avokat (ku nga të dhënat e tij bankare rezultojnë lëvizje të konsiderueshme monetare të cilat jo vetëm ia kam vënë në dispozicion Komisionit por janë marrë edhe nga vetë ai, të cilat me keqdashje nuk janë evidentuar nga ai), apo ndonjë hua të marrë nga babai im në këtë kohë.
- Fakti që vëllai im kishte automjet tjetër nuk është shkak për të cmuar se ai nuk duhet të blinte një tjetër. Sic e kam shpjeguar edhe më pare ky automjet është blerë nga vëllai im për bashkëshorten e tij të punësuar si mësuese në fshat. Ndodhur në kushtet që vëllai im është avokat ai nuk mund që automjetin e tij t'ia linte në përdorim bashkëshortes, pasi ai i nevojitet për veprimtarinë e tij. Për këtë shkak vëllai cmoi të nevojshme ti blinte bashkëshortes këtë automjet, i cili në vijim u përdor nga bashkëshortja ime, në kushtet që bashkëshortja e vëllait rregulloi një formë tjetër lëvizje për në punë, duke u grupuar me koleget e punës së saj.
- Nuk është i vërtetë fakti se unë nuk kam patur burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2014. Gjatë këtij viti unë rezultoj me bilanc pozitiv. Mosblerja e automjetit nga ana ime nuk është rrjedhojë e mungesës së atë ardhurave por rrjedhojë e faktit se për shkak të aktivitetit të përditshëm nuk e kishim shumë të nevojshëm pasjen e tij.
- Dhënia hua e shumën 1.400.000 vëllait tim Gerti Ymeri nuk ka asnjë lidhje me blerjen e automjetit në fjalë, pasi kjo shumë i është dhënë hua për nevojat e tij personale. Ndërkohë dhënia e kësaj huaje nuk ka asnjë lidhje me dhënien e shumës prej 400.000 lekësh nga ana ime një vit më parë, pra në vitin 2013 babait tim Faik Ymeri, rrethanat e të cilave i kam shpjeguar.
- Fakti qe bashkëshortja ime rezulton mbajtëse e policisë së sigurimit për këtë automjet, sic edhe e kam shpjeguar është rrjedhojë e faktit që në atë kohë cdo kush që nuk ishte pronar i automjetit duhet të dispononte një akt që e provonte përdorimin e mjetit. Në shumë raste këto akte kanë qenë policat e sigurimit të cilat kanë shërbyer për këtë fakt. Pavarsisht kësaj pagesa e policisë së sigurimit nuk e bën pronar një person dhe bazuar në këtë fakt është e qartë se ngritja e këtij argumenti si shkak për të më atribuar pronësinë e këtij automjeti nga Komisioni jo vetëm që nuk qëndron por është edhe absurd. **<u>Në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të këtij automjeti Komisioni me dashje nuk evidenton informacionin e marrë nga Agjensia e Mbikqyrjes Financiare dhe konkretisht shkresa me numer prot 432/1, datë 25.02.2022, ku pasqyrohet qartë fakti se në lidhje me këtë automjet polica e sigurimit për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është prerë nga pronari i këtij automjeti, vëllai im Gerti Ymeri. Pra Komisioni evidenton të</u>**

shkëputur informacionin e marrë nga ky institucion, duke pasqyruar vetëm ato pjesë të tij që i shërbejnë qëllimit të tij për të më atribuar fakte që nuk ekzistojnë.
Nëse automjeti do të ishte realisht në pronësinë timë unë nuk ka patur asnjë shkak t'a fsheh këtë fakt, ndodhur në kushtet që nuk kisha asnjë pengesë për të bërë një deklarim të tillë, kisha mundësi monetare të realizoja blerjen e tij dhe për më tepër unë kam dhënë informacion në lidhje me këtë automjet në cdo kohë bazuar në faktin e përdorimit të tij nga bashkëshortja ime.
Mbi këtë bazë konkludoj se konkluzioni i Komisionit se unë kam fshehur pronësinë e automjetit Autoveturë, Marka Ford Focus, me targa AA591 është tërësisht i pasaktë, dashakeq dhe ka si prapavijë atribuimit ndaj meje të fakteve të pavërteta, qëndrim të cilin Komisioni e ka bërë me cdo pasuri të familjarëve të mi në familjen e origjinës, me qëllim aplikimin ndaj meje të nenit 61/3 të ligjit 84/2016.

4 **Shpenzimet e mobilimit.**
Në lidhje me konkluzionet e Komisionit se : "47.9. Për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me vlerën e mobilimit, për rrjedhojë, konstatohet pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të mobilimit. Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në analizë financiare Komisioni do të përfshijë vlerën e mobilimit, sikundër e ka pasqyruar në rezultatet e hetimit, për sa kohë subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës." ndërkohë që në aktin "Rezultatet e hetimit administrativ" si vlerë e mobilimit është konsideruar shumën 1.200.000 lekë, e llogaritur vetëm për vitet 2008-2009, ku konkretisht për vitin 2008 ka caktuar shumën 623.000 lekë dhe për vitin 2009 ka caktuar shumën 577.000 lekë, pa shpjeguar sesi është caktuar kjo vlerë ndër vite, si dhe përse kjo shumë është ndarë vetëm në mes viteve 2008-2009 dhe nuk është përfshirë ne vitet e tjera, shpjegoj:

Ashtu sic edhe e kam shpjeguar edhe në Deklaratën Vetting "*vlera e çdo sendi, pajisje që ndodhet në shtëpi, është përafërsisht 1.200.000 – 1.500.000 lekë*". Ky deklarim rezulton qartë së është bërë nga ana ime me përafërsi, duke mos qenë plotësisht i sigurtë për vlerën që kanë shpenzuar personat që nga kanë dhuruar orendi dhe pajisje për blerjen e tyre. Mbi këtë bazë sqaroj se ndryshimet jo domethënëse në lidhje me vlerën e objekteve të dhuruara janë rrjedhojë e faktit se përcaktimi i kësaj vlere nga ana ime është bërë në cdo rast më përafërsi, në kushtet që nuk mund të pyesja dhuruesit se sa ka kushtuar dhurata e tyre (ne në Shkodër e kemi për turp t'a bëjmë një gjë të tillë, por nuk e di se cfare mendimi kanë për këtë anëtaret e Komisionit). Mbi këtë bazë sqaroj se unë nuk kam dhënë asnjëherë deklarime kontradiktore në lidhje me mobilimin e banesës time, si përsa i përket vlerës së mobilimit ashtu dhe përsa i përket shumës së shpenzuar nga unë për këtë mobilim.

Shpjegoj se nga ana e Komisionit është bërë një llogaritje e gabuar e shpenzimeve të mobilimit të kryer nga familja ime e re për vitet 2008-2016. Përqëndrimi i këtyre shpenzimeve vetëm për vitet 2008 dhe 2009, madje pa treguar se mbi cfarë baze është caktuar se sa është shpenzuar në secilin prej këtyre viteve, Ky qëndrim i mbajtur nga ana e Komisionit nuk është një veprim pa një qëllim të paramenduar dhe dashakeq. Qëllimi i këtij veprimi është rritja e shpenzimeve të familjes time për vitin 2008 që përkon me kohën e krijimit nga ne të bonove të thesarit, me

qëllim për të më nxjerr me bilanc negativ dhe rrjedhimisht konsiderimin e këtyre pasurive me mungesë burimesh të ligjshme të ardhurash.

Përllogaritja që Komisioni i ka bërë vlerës së mobilimit të banesës ku unë jetoj është tërësisht e gabuar dhe është bërë duke shfrytëzuar mënyrën e deklarimit të vlerës së mobilimit nga ana ime në dekleratën veting dhe përgjigjet e pyetësorëve, ku kam deklaruar se "*vlera e çdo sendi, pajisje që ndodhet në shtëpi, është përafërsisht 1.200.000 – 1.500.000 lekë*". Premisa e gabuar e Komisionit në përllogaritjen e këtyre shpenzimeve, konsiston në faktin se deklarimin tim që "*vlera e çdo sendi, pajisje që ndodhet në shtëpi, është përafërsisht 1.200.000 – 1.500.000 lekë*", e ka konsideruar si të barazvlefshëm me deklarimin (që unë nuk e kam bërë asnjëherë) se "*unë e paskam shpenzuar këtë vlerë për mobilimin e banesës*". Komisioni, nuk e ka marrë të plotë deklarimin tim, pasi unë kam deklaruar se jo çdo send apo pajisje e ndodhur në banesë dhe që shërben për mobilimin e saj, është blerë nga familja ime, pasi kemi marrë edhe dhurata, p.sh dhomën e gjumit, lavatriçen, karrocat për lindjen e fëmijeve, piktura, etj. Për rrjedhojë, këto sende zbriten nga vlefta e shpenzimeve. Këtë deklarim e kam bërë shprehimisht në përgjigjen e pyetësorit standart, prandaj do t'i lutem Komisionit t'a ketë parasysh. Nëse Komisioni e vlerëson këtë deklarim të paplotë, atëherë unë po e saktësoj përmes këtij shpjegimi por duke patur parasysh që edhe Komisionit i ka lindur detyrimi, që në kohën kur unë kam bërë këtë deklarim, që të bëjë pyetje plotësuese dhe jo të veprojë duke e konsideruar mungesën e detajimit si mosveprim apo ca më keq si premisë që çon në mungesa likuiditeti ose mundësie financiare.
Pikërisht për të qartësuar situatën, po iu paraqes një listë analitike të sendeve të përfshira në mobilimin e banesës, për të cilat nga ana e familjes time të re nuk është bërë asnjë shpenzim. Në vijim do iu paraqes një tabelë financiare që tregon shpenzimet e mobilimit të kryera realisht prej familjes time të re si dhe shpërndarjen e tyre ndërmjet viteve.

Analiza financiare e mobilimit

Shpenzime mobilimi jo me kostot e Subjektit te rivleresimit		*Subjekti I rivleresimit*
Analize e shumes se mobilimit		**623,000**
Dhome gjumi + aksesor shoqeruse (jorgan carcaf, dyshek etj) shuma[43] 200.000,paje e sjell	200,000	0
Lavatrice dhurat nga Fatmira Mema tezja e bashkeshortes	40,000	0
Televizor I perdorur I marre nga familja e bashkeshortes	10,000	0
Mobilim Tualete, firma ndertuse, dy cop	150,000	0
Shtrydhese frutash 12. 000 dhurat nga vella I Arlindes	12,000	0

[43] *Në qytetin e Shkodrës është traditë që nusja e re sjell në familjen bashkëshortore jo vetëm dhomën e gjumit, por edhe të gjithë aksesorët që lidhen me të të tilla si dyshek, batanie, carcafë etj. Rrjedhimisht vlera e shpenzuar nga familja e bashkëshortes time për të gjitha këto nuk është jo vetëm vlera e dhomës së gjumit, por edhe e e këtyre aksiesorëve. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm nga pyetja e cdo shkodrani.*

Karroca e lindjes se djalit dhurat nga vella I Arlindes			0
	60,000		
Karroca e lindjes se vajzave dhurat nga mamaja e Arlindes			0
	85,000		
Piktura dhurat nga Johan Bardeli shok I Imi, 4 cop			0
	20,000		
Ene guzhine 10.000 leke , prinderit e Andrit te mite			0
	10,000		
Fshese me korrent dhurate prinderit e Andrit			0
	20,000		
Krevat per lindjen e femijve I cop per lindjen e djalit			0
	60,000		
Krevat per lindjen e vajzes I cop per lindjen e nje vajze nga goca e tezes Arlindes			0
	60,000		
	1,350,000	727,000	623,000

Në lidhje me konstatimin: *"**Gjithashtu subjekti në asnjë moment nuk ka deklaruar se nuk kam paguar të gjithë shumën për mobilimin apo të saktësonte mobilimin"*** shpjegoj se përsa kohë që pyetja që mu shtrua kishte të bënte me përcaktimin e vlerës së mobilimit, pa specifikuar se për cilat kisha shpenzuar unë dhe cilat më ishin dhuruar, unë kam dhënë një përgjigje të vlerës që të gjitha sendeve dhe orendive që ndodhen në banesën time, pa bërë një ndarje në mes atyre që kam blerë unë dhe atyre që më janë dhuruar me rastin e martesës dhe familjes së re që unë krijova.

Theksoj se shuma e shpenzuar nga ana ime për mobilimin e banesës është gjithsej 623.000 lekë dhe jo 1.200.000 lekë sic është llogaritur nga Komisioni në analizën financiare të viteve 2008-2009. Më konkretisht shpjegoj se në vitin 2008 unë kam shpenzuar 373,800 lekë për mobilimin e banesës, në vitin 2009 vlerën 124,600 lekë dhe në vitet në vijim shpenzimet e mia për mobilim kanë qenë rreth vlerës 17.000 lekë. Theksoj se ne cdo vit kemi blerë sende dhe orendi shtepiake, shpenzime këto të cilat edhe pse nuk kanë qenë në vlerën e shpenzimeve në fillim të bashkëjetesës, ato kanë qenë detyrim, në funksion të jetës familjare.

Theksoj se Komisioni mund të aludojë për vlerën e shpenzuar nga ana ime për mobilimin, pa patur asnjë të dhënë faktike për të kundërshtuar pretendime e mia. Kjo pasi për vlerën e shpenzimeve në një banesë normalisht janë në dieni vetëm pjestarët e kësaj familje dhe askush nuk mund të masë shpenzimet e tjetrit në bazë të shpenzimeve dhe nivelit të jetës të ndjekur nga ai vetë. Përcaktimi me hamendësim i këtyre vlerave dhe kohës së shpenzimit të tyre përbën një veprim i gabuar nga ana e Komisionit, që kërkoj të ndreqet në analizën financiare nga ana e Kolegjit.

Nëse Komisioni kishte dyshime për vlerën e mobilit të objekteve të ndodhura në banesën time lehtësisht kishte mundësi që bazuar në nenin 49/3 të ligjit 84/2016 të bënte një kqyrje të apartamentit dhe në vijim ekspertimin vlerësues të pajisjeve dhe orendive, bazuar edhe në vlerësimin e kohës së blerjes së tyre.

5 **<u>Toka bujqësore.</u>**

Në lidhje me konstatimin e Komisionit: **"*48.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Rezulton e provuar se të dhënat e deklaruara nga subjekti në DPV nuk përputhen me të dhënat e deklaratës noteriale të shtetasit Sh.G. Komisioni vlerëson se kjo deklaratë mund të jetë hartuar me qëllimin që subjekti të mund të provonte përpara ILDKPKI-së në vitin 2015 të ardhurat e pretenduara nga toka bujqësore. Nga hetimit i Komisionit, por dhe nga vetë subjekti, nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore, jo vetëm për taksën e tokës bujqësore për vitet 2005 - 2007, por dhe për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga dhënia me qira e tokës bujqësore……Në përfundim, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk është provuar ekzistenca e këtyre të ardhurave, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare",*** shpjegoj se ky konstatim i Komisionit është tërësisht i gabuar.

Theksoj se në mes deklarimeve të mia në DPV 2005, 2006 dhe 2007 nuk ka asnjë kontraditë me deklarimin e shtetasit Shefqet Geci në deklaratën noteriale të datës 16.02.2015 që i kam dërguar Komisionit, pavarsisht faktit që ata vijojnë të ngulmojnë në këtë drejtim.

- Më konretisht shpjegoj se në DPV 2005 në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore unë kam deklaruar: *"fitime nga prodhimi i tokës bujqësore të babait tim fituar në bazë të ligjit 7501, fitime të bëra gjatë vitit 2005 nga prodhime bujqësore….400.000 lekë".*
- Në DPV 2006 në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore unë kam deklaruar: *"dhënia me qera e tokës bujqësore 100.000 lekë"***.**
- Në DPV 2007 në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore unë kam deklaruar: *"dhënie me qera e tokës bujqësore 70.000 lekë".*
- Ndërkohë Shefqet Geci në deklaratën noteriale në fjalë ka deklaruar: *"Gjatë periudhës 2005-2008 kam marrë në përdorim nga shtetasi Faik Fetah Ymeri pasurinë e paluajtshme në pronësi të tij tokë arë me sipërfaqe 10.800 m2. <u>Gjatë periudhës që unë e kam përdor këtë sipërfaqe toke për arsyet e mia fitimprurëse i kam dhënë pronarit Faik Ymeri shumën **rreth** 600.000 lekë të rinj për të gjithë periudhë e përdorimit".</u>*

Bëj me dije se shprehja "përdorim i tokës bujqësore" e përdorur nga shtetasi Shefqet Geci nuk lidhet vetëm me marrjen me qera të tokës bujqësore, por përfshin në vetvete edhe marrjen e prodhimeve bujqësore të realizuara nga kjo tokë. Kjo shprehje nuk është përjashtuese, por përfshirëse dhe në vetvete përfshin të gjitha veprimet që lidhen me shfrytëzimin në të gjitha format e mundshme të tokës bujqësore.

Personalisht mendoj se Komisioni ishte i qartë në lidhje me kuptimin që ka kjo shprehje dhe se ngritja e një pretendimi të tillë nga ana e tij bëhet me qëllim mosnjohjen e të ardhurave nga toka bujqësore, si burime të ligjshme, në kushtet që në lidhje me këtë tokë nga babai im janë paguar të gjitha detyrimet tatimore. Duke mos gjetur argumente të tjera për të refuzuar njohjen e këtij burimi të ligjshëm të ardhurash Komisioni përdor "lojra fjalësh" të cuditshme dhe të pakuptimta.

Nga ana tjetër shpjegoj se përdorimi i shprehjes "*Gjatë periudhës 2005-2008 kam marrë në përdorim*" nga shtetasi Shefqet Geci në këtë deklaratë noteriale pasqyron kohën e "vjeljes së të mirave kësaj toke" nga ky shtetas dhe vlerësuar në këtë këndvështrim nuk konstatoj ndonjë

Ajo që natyrshëm shtroj për diskutim është fakti se si ka mundësi që cdo akt i paraqitur nga ana ime përpara punonjësve të ILDKPKI është konsideruar nga Komisioni si i kryer me qëllim favorizimin tim dhe cuditërisht anëtaret e Komisionit, vëcanarsisht Pamela Qirko dhe Genta Bungo nuk kanë mbajtur të njëjtin qëndrim me akte të të njëjtës natyrë të konstatuara për subjekte të tjerë rivlersimi, sic ishte rasti i subjektit Artan Cupi.

Fakti është se:

- familja ime ka realizuar të ardhura nga toka bujqësore në formën e shitjes së produkteve dhe dhënies me qera të saj
- ky fakt rezulton i provuar jo vetëm me deklarimet e mia në DVP e kohës por edhe deklaratën noteriale të përdoruesit të kësaj tokë
- në lidhje me këtë tokë nga babai im janë paguar detyrimet tatimore

argumente këto që të gjitha sëbashku i bëjnë të ardhurat e realizuara nga kjo tokë të ligjshme, në pajtim me nenin D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit: ***"****Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore."*

Ndryshe nga sa pretendon Komisioni unë kam depozituar dokumentacion provues për të vërtetuar të ardhurat e fituara nga toka bujqësore.

Deklarimi i këtyre të ardhurave është pasqyruar nga ana ime fillimisht në DPV e viteve respective.

Në vijimsi në vitin 2015 nga ana ime është dorëzuar pranë ILDKPKI një deklaratë noteriale e lëshuar nga shtetasi Shefqet Geci, nga e cila rezulton e qartë fakti i përdorimit të tokës bujqësore në pronësi të babait tim nga ky shtetas, përdorim i cili është kryer në formën e marrjes së prodhimeve bujqësore dhe marrjes me qera të tokës nga ana e tij.

- Po kështu ndryshe nga sa pretendon Komisioni nga ana e babait tim janë paguar të gjitha detyrimet tatimore në lidhje me tokën bujqësore, për të gjitha vitet përfshi edhe vitet për të cilat kam deklaruar të ardhura nga kjo tokë, fakt i vërtetuar me shkresën dërguar më raportin për rezultat e hetimit administrativ. **Në këtë drejtim evidentoj faktin se nuk është i vërtetë përfundimi i Komisionit se në lidhje me të ardhurat e realizuar nga qeraja e tokës nuk janë paguar detyrimet tatimore. Bazuar në aktet shkresore që unë i kam dërguar Komisionit rezultoi qartë që babai im, gjatë kohës së hetimit administrative ka realizuar pagimin e këtyre detyrimeve tatimore, ku mbi këtë bazë i kam kërkuar Komisionit që këto të ardhura të vlerësohen sipas parimit të barazisë krahasuar me praktika të mbajura më parë për subjekte të tjerë rivlersimi të trajtuara me lart si Dritan Hallunaj, Elvin Gokaj etj.**
- Nga ana ime nuk është pretenduar në asnjë moment që shtetasi Shefqet Geci ka ushtruar aktivitet tregtar dhe shpjegoj se cdo person i cili ka jetuar në fshat është në dieni të faktit se përdorimi i tokës bujqësore jo domosdoshmërisht lidhet me ushtrimin e një aktiviteti tregtar. Madje i shpjegoj anëtareve të Komisionit se në pjesën më të madhe të rasteve përdorimi i një tokës bujqësore lidhet më shumë me sigurimin e burimeve të nevojshme për rritjen e kafshëve (si kullotë apo mbledhjen e ushqimit për dimër) apo sigurimin e prodhimeve bujqësore jetësore të

vetë familjes bujqësore. Shpjegoj se nuk ka qenë në asnjë moment detyrim as i imi dhe as i familjarëve të mi të informohemi hollësisht për qëllimet e përdorimit të tokës nga shtetasi Shefqet Geci, përsa kohë ishim të sigurtë se ky përdorim nuk lidhej me ushtrimin e ndonjë aktiviteti kriminal.

- Shpjegoj edhe një herë se nuk ka asnjë kontraditë në mes deklarimeve të mia të dhëna më DPV dhe përmbajtjes së deklaratës noteriale të shtetasit Shefqet Geci. Përdorimi i shprehjes përdorim lidhet me të gjitha format e përdorimit të tokës, ku përfshihet si marrja e prodhimeve të kësaj toke (marrja e jonxhës, barit të thatë etj) e deri në përdorimin e kësaj tokë si kullotë në rastin e marrjes së saj me qera nga babai im.
- Mosnjohja e këtyre të ardhurave si burime të ligjshme nga Komisioni nuk lidhet me provueshmërinë e faktit, i cili rezulton plotësisht i provuar dhe i qartë, por lidhet me mungesën e dëshirës së Komisionit për t'i njohur këto të ardhura dhe përfshirë ato në analizën time financiare, veprim i kryer me dashje për të thelluar bilancin negativ, në dëm të interesave të mia.

6 **Bonot e thesarit.**

Në lidhje me konstatimet që Komisioni ka bërë për blerjen e bonove të thesarit që fillojnë nga viti 2009 paraprakisht konsideroj të nevojshme të jap shpjegime dhe të paraqes në mënyrë analitike gjendjen financiare të familjes time për vitet 2007 dhe 2008, nga e cila rrjedh mundësia ime për blerjen e këtyre bonove në vitin 2009.

6.1 Analizë e viti 2007:

Në lidhje me këtë vit shpjegoj se pasi jam konsultuar me shpjegimet e mia të dhëna me DPV 2007, deklarime dhe memo përpara ILDKPKI, shpjegoj se burimet e të ardhurave të familjes time (të origjinës) për atë vit kanë qenë nga:

- Paga ime si gjyqtar,
- Paga e nënës time si mësuese,
- Pensioni i babait,
- Aktiviteti privat i babait si shitës ambulant në vlerën 250.000 lekë,
- Të ardhurat e realizuara nga puna e vëllait tim Gerti Ymeri si as/avokat dhe pastaj avokat në vlerën 600.000 lekë,
- Të ardhurat e realizuara nga dhënia me qera e tokës bujqësore në vlerën 70.000 lekë.

Nga analiza financiare që më është vënë në dispozicion nga Komisioni me aktin "Rezultatet e hetimit administrativ" e cila mesa konstatoj nuk ka ndryshuar as pas seancës dëgjimore, evidentoj se nga ana e tij nuk janë njohur si burime të ardhurash për këtë vit shuma prej 250.000 lekë nga aktiviteti privat i babait si shitës ambulant, 600.000 lekë të realizuara nga puna e vëllait tim Gerti Ymeri si as/avokat dhe pastaj avokat dhe shuma 70.000 lekë e ardhur e realizuar nga dhënia me qera e tokës bujqësore. Në lidhje me mosllogaritjen e këtyre burimeve si të ardhura të ligjshme të familjes time nga Komisioni, kam dhënë shpjegime më lart. Mbi këtë bazë duke ritheksuar se mosnjohja e këtyre burime të ardhurash është e gabuar dhe keqdashëse nga ana e Komisionin mendoj se nuk duhet të kaloj në përsëritje.

Bilanci negativ me të cilën Komisioni më ngarkon për këtë vit (**-762,702.17**) është pikërisht rrjedhojë e mosnjohjes së këtyre të ardhurave.

Analiza e financiare 2007

Për vitin 01/01/2007- 31/12/2007		**Vlersimi nga subjekti i rivleresimit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**2,258,324**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 2007	878,167	
1.2	Te ardhura nga pensioni i babait Faik Ymeri 2007	159,606	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2007	300,551	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 2007	-	
1.5	Te ardhura Gerti Ymeri nga bursa Universiteti L.Gurakuqi	-	
1.6	Te ardhura nga aktiviteti privat Faik Ymeri pa vend fix ushtrimi te aktivitetit, paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	250,000	
1.7	Te ardhura nga dhenia me qera e tokes nga Faik Ymeri tek Sheuqet Geci ,deklarate noteriale dt 16.02.2015, paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	70,000	
1.8	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga asistent avokat dhe shitje fruta perime , paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	600,000	
1.9	Te ardhura nga aktiviteti privat P/F legalizim dokumentash nga Faik Ymeri , paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	-	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Te ardhura nga shitja e shtepise Bushat, Rep 217, Kol 70 date 17.04.2000	-	
2.2	Apartament 73 m2 L. S. Halili, Shkoder	-	
2	Apartament 111 m2 Rr. A. Gj. Fishta, Shkoder - Faik Ymeri - 2006		

Për vitin 01/01/2007- 31/12/2007		Vlersimi nga subjekti i rivleresimit	
Nr	ANALIZA FINANCIARE	LEKE	
.3		-	
3	**Detyrimet**		**(700,000)**
3.1	Borxhe te marra nga Xheladin Cuf Thana, janar -mars 2006		
3.2	Borxhe te marra nga Fahri Fetah Ymeri, janar -mars 2006		
3.3	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi 1,500,000 leke 2006 - 2007		
3.4	Dhene Fahri Fetah Ymeri 2,000,000 leke 2006		
3.5	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi prej 1,500,000 leke 2006 - 2007	-700,000	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,258,324**
5	**Shpenzimet**		**558,571**
5.1	Shpenzime jetese 2007/01 - 2007/12	546,480	
5.2	Shpenzime udhetimi 2007/01 - 2007/12	12,091	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**14,809**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**1,520,654**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**(506,092)**

Analiza e financiare 2001-2007

Pershkrimi I veprimit	Vitet	Subjekti I Rivleresimit

Pershkrimi I veprimit	Vitet	Subjekti I Rivleresimit
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	**2001-2003**	**1,037,889**
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	**2004**	**448,395**
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	**2005**	**150,536**
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	**2006**	**194,413**
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	**2007**	**(506,092)**
Shumat Totale per efekt kuadrimi		**1,325,141**

Analiza e financiare 2001-2007

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2007		**Vlersimi nga subjekti i rivleresimit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**	**10,899,781**	
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 2004-2007	4,362,917	
1.2	Te ardhura nga pensioni i babait Faik Ymeri 2004-2007	948,953	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2007	1,552,214	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 2007	1,496,197	
1.5	Te ardhura Gerti Ymeri nga bursa Universiteti L.Gurakuqi	58,500	
1.6	Te ardhura nga aktiviteti privat Faik Ymeri pa vend fix ushtrimi te aktivitetit paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	800,000	
1.	Te ardhura nga dhenia me qera e tokes nga Faik Ymeri tek Sheuqet Geci ,deklarate noteriale dt 16.02.2015, paguar tatimi sipas shkresës së postës	570,000	

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2007		**Vlersimi nga subjekti i rivleresimit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
7	dhe tatimeve		
18.	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga asistent avokat dhe shitje fruta perime , paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	811,000	
19.	Te ardhura nga aktiviteti privat P/F legalizim dokumentash nga Faik Ymeri , paguar tatimi sipas shkresës së postës dhe tatimeve	300,000	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**4,506,000**
2.1	Te ardhura nga shitja e shtepise Bushat, Rep 217, Kol 70 date 17.04.2000	(430,000)	
2.2	Apartament 73 m2 L. S. Halili, Shkoder	1,000,000	
2.3	Apartament 111 m2 Rr. A. Gj. Fishta, Shkoder - Faik Ymeri - 2006	3,936,000	
3	**Detyrimet**	**-**	
3.1	Borxhe te marra nga Xheladin Cuf Thana, janar -mars 2006	1,500,000	
3.2	Borxhe te marra nga Fahri Fetah Ymeri, janar -mars 2006	2,000,000	
3.3	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi 1,500,000 leke 2006 - 2007	-800,000	
3.4	Dhene Fahri Fetah Ymeri 2,000,000 leke 2006	-2,000,000	
3.5	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi prej 1,500,000 leke 2006 - 2007	-700,000	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**6,393,781**
5	**Shpenzimet**	**3,547,986**	

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2007		Vlersimi nga subjekti i rivleresimit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
5.1	Shpenzime jetese 2007/01 - 2007/12	3,320,895	
5.2	Shpenzime udhetimi 2007/01 - 2007/12	227,091	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**2,129,299**	
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**3,649,953**	
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**	**1,325,141**	

6.2 Analizë e vitit 2008:

Në lidhje me këtë vit shpjegoj se pasi jam konsultuar me shpjegimet e mia të dhëna nga ana ime me DPV 2008 shpjegoj se burimet e të ardhurave të familjes time përbëhen nga:

- Paga ime
- Paga e bashkëshortes time ,
- Dhurata me rastin e martesës dhe lindjes së djalit nga miq dhe të afërm në vlerën 600.000 lekë,
- Dhuratë me rastin e martesës nga prindërit e mi në vlerën 300.000 lekë,
- Dhuratë më rastin e martesës nga nëna e bashkëshortes në vlerën 150.000 lekë.

Nga analiza financiare që më është vënë në dispozicion nga Komisioni evidentoj faktin se:

Komisioni ka njohur si burim të ardhurash dhuratat e marteses dhe lindjes së djalit jo në vlerën e deklaruar nga ana ime 600.000 lekë, por në një vlerë që unë nuk e kuptoj nga e ka nxjerrë 450.000 lekë. Në këtë rast Komisioni as në analizë financiare dhe as në raport nuk arsyeton se mbi cfare baze konkludon se dhuratat që më janë dhënë nuk janë në vlerën e pretenduar nga ana ime. Pra ulja e vlerës së dhuratave për dasmën dhe lindjen e djalit nga Komisioni nga 600.000 në 450.000 nuk bazohet në ndonjë vendim të arsyetuar. **Për më tepër kujtoj se në analizën që më është dërguar në muajin prill 2022 kjo vlerë njihej nga Komisioni sipas shpjegimeve të mia.** Kujtoj se nga kjo kohë dhe aktualisht nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë që të ndikojë në arritjen e këtij konkluzioni nga ana e Komisionit. Bazuar në këtë shpjegimet të dhënë nga ana ime, duke e konsideruar këtë cmuarje të Komisionit terësisht të pallogjiktë dhe të paarsyetuar i bëj thirrje të korrigjojë analizën financiare ku të përfshijë vlerën e të ardhurave të deklaruar nga unë.

Në lidhje me vlerësimin që Komisioni ka mbajtur në lidhje me këto të ardhura: ***"50.6. Në lidhje me këto të ardhura të pretenduara rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizë shumën 450,000 lekë, duke marrë të mirëqenë deklarimet e subjektit për këtë shumë si të dhuruar nga familjarë dhe të afërm, pavarësisht faktit që ai nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues dhe ka qenë në nivel deklarativ. Ky qëndrim i Komisionit nuk është në përputhje me vendimin nr. 18/2022 të Kolegjit71, por pavarësisht këtij fakti Komisioni, për të mos rënduar pozitën e subjektit, do të përfshijë këtë shumë në analizë financiare"*** shpjegoj se unë e kuptoj zonjën Bungo kur tenton të tregojë "gjoja" dashmirësinë dhe humanzimin e saj me qëllim mos thellimin e bilancit negativ timin, por ajo që nuk kuptoj dhe as nuk me sqarohem me vendim është se përse kjo zonjë personin tim e ka trajtuar ndryshe nga subjekti i rivlersimit që ajo ka konfimuar në detyrë me vendimin me numër 56, datë 01.08.2018 (në zbatim të parimit të barazisë) dhe si e shpjegon ajo faktin se përse vendimi nr. 18/2022 të Kolegjit nuk paska qenë i zbatueshëm për këtë subjekt (natyrisht nëse do të ishte i zbatueshëm kjo dotë sillte shkarkimin e subjektit pasi vlera e përfituar si dhuratë për dasëm e pranuar e plotë nga Komisioni, pjesë e të cilit ishte komisionerja Bungo ishte shumë e lartë, 3.000.000 lekë, ku vetëm kjo shumë si bilanc negativ do të përbënte bazë të mjaftueshme për shkarkimin e tij)?

Me konkretisht shpjegoj se në lidhje me këto dhurata komisionerja Genta Bungo ka praktikë të mëparshme të njohjes së tyre dhe konkretisht për subjektin e rivlersimit Dritan Hallunaj, i konfimuar në detyrë me vendimin me numër 56, datë 01.08.2018. Për këtë subjekt KPK-ja në përbërjen e të cilës ishte edhe komisionerja në fjalë pranoi dhurata me rastin e dasmës të subjektit (i cili është në të njëjtin fis me bashkëshorten time) në vlerë 3.000.000 lekë (5 herë më shumë nga shuma prej 600.000 lekë që kam deklaruar unë) dhe kjo shumë e pranuar ishte pikërisht shuma e deklaruar si dhuratë nga vetë subjekti, ku në këtë drejtim Komisioni nuk bëri një ulje apo reduktim të saj, si në rastin tim. Duke evidentuar faktin se qëndrimi i Komisionit nuk ka asnjë bazë faktike, llogjike dhe ligjore shtoj këtu se ai është në kundërshtim edhe me parimin e barazisë sipas të cilit: *"1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. 2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë."*

Gjithashtu evidentoj se Komisioni nuk ka njohur në të ardhurat e mia vlerën 300.000 lekë që më është dhënë dhuratë nga prindërit e mi me rastin e martesës dhe vlerën 150.000 lekë që më është dhuruar nga bashkëshortja e nënës time. Mosnjohja e këtyre dhuratave nga Komisioni nuk bazohet në ndonjë vendim të arsyetuar dhe për më tepër bie në kundërshtim me qëndrimin e mëpashëm të komisionit të dërguar më rezultatet e hetimit administrativ në muajin prill 2022. Nuk e kuptoj sesi një Komision njeh disa burime të ardhurash dhe një komision tjetër nuk i njeh ato, përsa kohë në lidhje me këto të ardhura nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ato të shqyrtuara më parë. Theksoj se ky qëndrim i Komisionit është tërësisht i gabuar dhe bie në kundërshtim me deklarimet e mia në DPV 2008.

Në lidhje me vlerësimin e Komisionit për këto të ardhura: "***Për sa i përket shumës së dhuruar nga prindërit, Komisioni ka konstatuar se ata nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer këtë dhurim. Mungesa e të ardhurave provohet edhe nga vetë deklarimet e subjektit se në vitin 2008 i ka dhënë hua prindërve të tij shumën 400,000 lekë. Nëse prindërit e subjektit do të kishin të ardhura të mjaftueshme për dhurimet e bëra subjektit,***

atëherë nuk do të kishte asnjë arsye që ai t'i jepte hua atyre shumën 400,000 lekë." shpjegoj se nuk është i vërtetë pretendimi i Komisionit se familja ime e origjinës ka patur mungesë të burimeve financiare për vitin 2008. Nga analiza financiare e familjes time e këtij viti, e cila do të paraqitet në vijim rezulton qartë se ata rezultojnë me bilanc pozitiv.
Po kështu nuk është i vërtetë pretendimi i Komisionit se vëllai im Gerti Ymeri nuk ka siguruar të ardhura nga veprimtaria e tij si avokat, pasi në atë kohë deyrimet tatimore nga kjo veprimtari paguheshin pranë Bashkisë Shkodër, kur për këtë fakt Komisionit i janë depozituar nga ana ime akte shkresore te marra nga ky institucion, bashkalidhur me një analizë financiare mbi mundësinë e realizimit të të ardhurave në bazë të xhitos vjetore të deklaruar.
Në lidhje me argumentin e përdorur nga Komisioni se mungesa e burimeve të të ardhurave e prindërve të mi rezulton edhe nga fakti se unë i kam dhënë babait shumën 400.000 lekë hua shpjegoj se ai është një abuzim dhe një vlerësim djallëzor i Komisionit, të cilit cili i kam shpjeguar edhe rrethanat e dhënies së kësaj shume babait, e cila theksoj se pavarsisht se si iu vu emri në thelb nuk ishte një hua.
Për transparencë risqaroj se dhënia e kësaj shume monetare babait tim nga ana ime është bërë jo për shkak se ata nuk kishin të ardhura për kurimin e nënës time, e cila kishte pësuar infrakt për të cilën u operua, por bazuar në dëshirën për t'i ndihmuar prindërit ndodhur në kushtet që nuk kishin asnjë informacion të qartë se sa mund të shkonte vlera monetare e ndërhyrjes kirurgjikale (bazuar në faktin se në atë kohë mendonin edhe mundësinë për t'a dërguar jashtë vendit). Nëse Komisioneret nuk e kuptojnë dot detyrimin që cdo fëmijë duhet të ketë për prindin e tij natyrisht ky nuk është faji im, por ajo që dua të shtoj është që ky qëndrim i tyre pasqyron edhe një herë mungesën e vlerave njerëzore që këta individë përfaqësojnë në familjen dhe shoqërinë e tyre.

Nga analiza financiare e vitit 2008, të cilës mesa duket i ka qëndruar Komisioni edhe pas seancës dëgjimore, evidentoj gjithashtu faktin se Komisioni ka rritur vlerën e shpenzimeve për mobilimin e banesës time nga 373,800 lekë në 623,000 lekë, qëndrim i cili nuk bazohet në ndonjë vendim të arsyetuar të Komisionit. Në lidhje me këtë kam dhënë shpjegime më lart dhe vec evidentimit të faktit se ky qëndrim është tërësisht i gabuar mendoj se nuk duhet të zgjatem më tej.

Po kështu Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare kthimin e vlerës prej 1.000.000 lekë nënës së bashkëshortes në lidhje me një depozitë bankare pranë Raiffaisen Bank të cilën bashkëshortja e kishte depozituar me të ardhura të familjes së origjinës së nënës së saj. Mospërfshirja e këtyre detyrimeve nga Komisioni është bërë me qëllim të mosnjohjes së kësaj depozite në vitin 2009 si një nga burimet për blerjen e bonove të thesarit.

Për shkak të këtyre gabimeve në vlerësimin e të ardhurave dhe shoenzimeve të mia padrejtësisht Komisioni më ka nxjerrë me një bilanc negativ për vitin 2008, ndërkohë që bazuar në analizën financiare të bërë nga eksperti unë jam me bilanc pozitiv.

TABELA FINANCIARE E FAMILJES SË ANDRI YMERI PËR VITIN 2008

Për vitin 01/01/2008- 31/12/2008		**Vlersimi i ekspertit**
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**
1	**Të ardhurat**	**3,266,024**

Për vitin 01/01/2008- 31/12/2008		Vlersimi i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2008 - 31.12.08	978,254	
1.2	Te ardhura nga paga Arlinda (Hallunovi)Ymeri	237,770	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2017		
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita 2008 - 2009		
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 2008 - 2010		
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit	600,000	
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra	150,000	
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku	300,000	
1.91	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja	1,000,000	
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
		0	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
3	**Detyrimet**		**(1,400,000)**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	(1,000,000)	
3.2	Dhene Andri babait Faik Ymerit sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI dhe pergjigjes te pyetjes te pyetsoreve	(400,000)	
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	-	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-	

Për vitin 01/01/2008- 31/12/2008		Vlersimi i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri, provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015	-	
3.6	Kthimi I Huadhenies dhene babait (ne vitin 2008), provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , kthy para dt 31 korrik	-	
3.7	Kthim huadhenie nga vellai Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,	-	
3.8	Marre overdraft	-	
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2012	-	
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit	-	
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000	-	
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT	-	
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	-	
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	-	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**3,266,024**
5	**Shpenzimet**		**693,513**
5.1	Shpenzime jetese 2008/01 - 2008/12	307,395	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke		
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke		
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke		
5.5	Shpenzime mobilimi 2008/01 - 2008/13	373,800	
5.6	Shpenzime udhetimi 2008/01 - 2008/12	12,318	
5.	Shpenzime shkollimi		

Për vitin 01/01/2008- 31/12/2008		Vlersimi i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
7			
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€	-	
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008	-	
5.91	Shpenzime dasme 2008	-	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**-**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**999,266**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**173,245**

6.3 Në lidhje me vlerësimin e Komisionit për depozitën e krijuar pranë Raiffeisen Bank në vitin 2008 se: ***"51.21. Në përfundim, në lidhje me shumën 1,000,000 lekë, Komisioni vlerëson se: i. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume, ii. Në deklaratën Vetting nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar si të ardhura shumën 1,000,000 lekë të dhuruar nga nëna e bashkëshortes, duke deklaruar vetëm shumën 150,000 lekë me numër rendor 13, në seksionin e të ardhurave të deklaratës Vetting, iii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për depozitimin e kësaj shume, iv. Subjekti nuk rezulton që këtë shumë ta ketë deklaruar si burim për krijimin e bonove të thesarit në DPV/2009 përpara ILDKPKI-së, por edhe në deklaratën Vetting (në këtë deklaratë subjekti ka bërë një deklarim të përgjithshëm për sa i përket burimit, duke deklaruar kursime dhe të ardhura familjare gjatë martesës). ➢Për rrjedhojë, kjo shumë nuk do të përfshihet në analizë financiare si burim për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2009."*** shpjegoj se ky vlerësimi Komisionit është tërësisht i gabuar.

Fillimisht rishpjegoj se këtë depozitë bankare unë e kam deklaruar në DPV e vitit 2008 dhe pikërisht në fq 3 të kësaj DPV ku në lidhje me të shprehem: *"Unë dhe bashkëshortja ime nga viti 2008 e në vazhdim kemi një pasuri të luajtshme prej 1.000.000 lekë të reja të depozituara në Raiffasen Bank".*

Në DPV e vitit 2008 unë e kam deklaruar këtë depozitë si më poshtë:


Unë dhe bashkëshortja ime nga viti 2008 e në vazhdim (3 muaj të parë 2008 kemi një pasuri të luajtshme prej 1.000.000 (një milion lekë të reja) të depozituara në Raiffeisen Bank.

Nndryshe nga sa vlerëson Komisioni në lidhje me këtë depozitë unë nuk kam bërë asnjëherë shpjegime kontradiktore. Theksoj se kur jam pyetur nga inspektorët e ILDKPKI unë kam deklaruar përsa jam pyetur dhe nuk kam patur shkaqe të deklaroj fakte të papyetura asnjëherë, që lidhen me burimin e krijimit të depozitës.
Duke patur parasysh se depozita në fjalë është tërhequr nga ana jonë (imja dhe e bashkëshortes) me datën 28.7.2009 pra dhe tre ditë përpara se të blinim bonot e thesarit që ka ndodhur në datën 31.07.2009 është tërësisht i kuptueshëm shkaku dhe qëllimi i përdorimit të kësaj depozite. Ashtu sic edhe Komisionit konstatoi brenda këtij intervali 3 ditor unë nuk kam kryer asnjë shpenzim tjetër, vec blerjes së bonove të thesarit, gjë që pasqyron qatazi faktin se kjo depozitë u përdor pikërisht për këtë qëllim.

Rishpjegoj edhe një herë se kjo shumë monetare nuk është dhuratë e nënës së bashkëshortes time, pasi ajo është kthyer nga ana jonë asaj në vjeshtën e vitit 2008, ashtu sic edhe e kam shpjeguar gjithmonë, pavarsisht së Komisioni ka bërë sikur nuk i ka dëgjuar shpjegimet e mia.

Kam për të thënë se analiza financiare që Komioni i ka bërë mundësisë së krijimit të kësaj depozite është e gabuar, pasi ajo nuk bazohet në rrethanat faktike të treguara nga ana ime, por bazohet në atë që vetë Komisioni ka dashur të krijojë, në dëm të interesave të mia.
Ashtu sic e kam shpjeguar kjo depozitë bankare nuk është krijuar fillimisht nga të ardhurat e mia, por ato të vjehrrës time Flutura Hallunovi, e cila ka dashur t'ia dhurojë ato vajzës së saj, dhuratë të cilën ne nuk e pranuam pasi në vjeshtën e vitit 2008 ia kemi kthyes këtë shumë vjehrrës time.
Për këtë arsye analiza financiare e krijimit të kësaj depozite nga Komisioni, me të ardhurat e mia në datën e krijimit të saj, nuk është e saktë. Kjo analizë financiare do të ishte e saktë nëse do të bëhej në kohën e kthimit të kësaj depozite, për të vlerësuar faktin nëse unë kisha burime të ligjshme për kthimin e saj.
Kryerja e kësaj analize nga Komisionit nuk është bërë pa patur një qëllim të paracaktuar dashakeq. Ky qëllim është nxjerrja ime me bilanc negativ për krijimin e depozitës dhe rrjedhimisht kjo depozitë të mos njihet si burim për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2009, duke më nxjerrë me bilanc negativ për krijimin e këtyre pasurive. Meqenëse viti 2009 ka qenë viti i parë nga i cili unë kam filluar të realizoj blerjen e bonove të thesarit, i lidhur zingjir me vitet e tjera, qëllimi i Komisionit ka qenë të nxjerrin me një bilanc negativ sa më të lartë në lidhje me to, mbi bazën e të cilit të mund të justifikonin veprimin e tyre për shkarkimin tim për pamjaftueshmëri në deklarimin e pasurisë, sic edhe ndodhi.

Në lidhje me depozitën bankare në fjalë me përgjigjet e pyetësorit të tretë unë kam shpjeguar:
Këto kursime janë krijuar nga puna e babait të saj të ndjerë Agim Halluni, (i vdekur në vitin 2001), rroga e nënës së saj si edukatore nga viti 2002 e në vijim, pensionet dhe pleqërisë dhe invaliditetit të gjyshërve të saj Fadil dhe Mynever Jera (të vdekur në vitet 2011 dhe 2018), të ardhurat që dihen botërisht se përfiton familja e të ndjerit nga miqtë, të afërmit, etj, në rastin e ndarjes nga jeta të të dashurit të tyre, (pra të ardhurat që ka përfituar familja e të ndjerit Agim Halluni në vitin 2001, kur ai është ndarë nga jeta. Këto të ardhura nuk kanë qënë të vogla pasi i ndjeri kur është ndarë nga jeta ka qënë 48 vjeç dhe ka lënë dy fëmijë të mitur. Unë nuk kam dijeni se sa kanë qënë këto të ardhura konkretisht, pasi ai ka vdekur në vitin 2001 dhe unë jam martuar me të bijën e tij në vitin 2008, (pra shtatë vjet më vonë), por nga sa më ka shpjeguar

vjehrra ime Flutura Hallunovi, kur e kam pyetur për shkak të nevojës për t'iu përgjigjur Komisionit, këto të ardhura kanë qënë mbi 1.000.000 lekë). Në kursimet famililjare në fjalë, përfshihen edhe të ardhurat që ka përfituar i ndjeri Agim Halluni për shkak të shitjes së një apartamenti në datën 15.01.2001, në shumën 2.700.000 lekë. Ky apartament është fituar në pronësi nga familja e të ndjerit mbi bazën e ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, konkretisht përmes kontratës me nr. 13561 rep, nr. 3284 kol, datë 16.08.1993, të lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa Shkodër dhe Agim dhe Flutur Hallunovi. Ky apartament është shitur në rrugë joformale pasi nuk ka qënë e rregjistruar në rregjistrat publikë të pasurive të paluajtshme të ish zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, kontrata e privatizimit të apartamentit në emër të Agim dhe Flutur Hallunovi. Kjo ka bërë që në vitin 2016 ndërmjet blerëses së këtij apartamenti dhe trashëgimtarëve të të ndjerit Agim Halluni, (ku përfshihet edhe bashkëshortja ime) të zhvillohet në proces gjyqësor që është përfunduar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, (vendimin nr. 51-2016-3990, datë 21.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër), të cilin unë do ua dërgoj bashkalidhur këtij parashtrimi.

Fillimisht vjehrra ime Flutura Hallunovi, ka patur synim që këtë shumë parash për të cilën pyet Komisioni, t'ia japë të bijës së saj, pra bashkëshortes time Arlinda Ymeri. Kjo pasi vjehrra ka konsideruar se kjo ka qenë një shumë parash që bashkëshortja ime duhet t'a përfitonte si trashëgimtare e të atit të saj Agim Halluni. Kjo është edhe arsyeja që bashkëshortja ime pasi i ka marrë këto para, i ka depozituar në emër të saj në Raiffeisen Bank.

Pasi kam filluar bashkëjetesën me bashkëshorten time në janar 2008, dhe veçanarisht pas dasmës së kryer me datën 06.04.2008, unë dhe bashkëshortja ime kemi rënë dakort që t'ia kthejmë vjehrrës shumën prej 1.000.000 lekë që ishte depozituar në emër të bashkëshortes time në bankë. Kjo për shkak se përderisa unë me vullnet të plotë nuk kisha marrë nga prindërit e mi pothuajse asgjë, (përveç dhuratës 300.000 lekë me rastin e dasmës dhe të drejtën e përdorimit të apartamentit), ndonëse kisha kontribuar me rrogën time në krijimin e pasurisë se familjes time të origjinës, nuk do ishte e drejtë që familja e origjinës së bashkëshortes time të n'a jepte një shumë të tillë, ndërkohë që bashkëshortja ime nuk kishte dhënë kontribute, (përveç një burse që ka përfituar në vitin 2007 si studente e shkëlqyer në Universitetin Luigj Gurakuqi Shkodër, në vlerën rreth 120.000 (njëqind e njëzetmijë) lekë).

Mbi bazën e dakortësisë së arritur nga unë dhe bashkëshortja ime, pak muaj pas dasmës, mos gaboj rreth vjeshtës së vitit 2008, ne ia kemi kthyer Cash vjehrrës time, (pra nënës së bashkëshortes), shumën prej 1.000.000 lekë që figuronin të depozituara në emër të bashkëshortes time, në Raiffeisen Bank sh.a.

Shpjegoj se pas kthimit të kësaj shume prej 1.000.000 lekë vjehrrës time Flutur Hallonovi, depozita bankare e hapur në emër të bashkëshortes time në pranë Raiffeisen Bank, mbeti në pronësinë tonë, ku në vijim kjo shumë është përdorur nga ana jonë si një nga burimet për blerjen e bonove të thesarit në vitin 2009, sic e kam shpjeguar edhe në përgjigjen e pyetjes nr. 4 të këtij pyëtësori.

Burimet që n'a kanë shërbyer për kthimin e kësaj shume kanë qënë të ardhurat nga familja ime dhe konkretisht rroga ime, rroga e bashkëshortes dhe dhuratat e përfituara me rastin e dasmës si dhe të lindjes së djalit.

Besueshmëria e deklarimit tim sa më sipër mund të konstatohet lehtësisht nga Komisioni përmes kryqëzimit të të dhënave që rezultojnë nga përmbajtja e këtij deklarimi, me DPV 2008 ku unë jam shprehur se pas krijimit të familjes time të re, ne kemi patur pasuri vetëm shumën e depozituar në Raiffeisen Bank, pavarësisht se totali i të ardhurave që kemi patur unë dhe bashkëshortja ime në vitin 2008, (të deklaruara edhe këto në DPV 2008) nga paga ime, nga paga

e bashkëshortes si dhe nga dhuratat e përfituara nga dasma dhe lindja e djalit, (të paktën në shumën 1.050.000 lekë), e kapërcen me mbi dyfish totalin e parave të kursyera + konsumin familjar për vitin 2008.

Bazuar sa më sipër shpjegoj se në lidhje me burimin fillestar të krijimit të kësaj shume nga vjehrra ime unë jo vetëm që kam dhënë shpjegime të plota, por edhe ju kam dërguar prova që e provojnë bindshëm ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume (dërguar me përgjigjet e pyetësorit 3).
Ndër këto prova evidentoj vendimin me numër 1082 (3990) datë 21.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga përmbajtja e të cilit rezulton se me datën 15.01.2001 shtetasit Flutur dhe Agim Hallunovi **i kanë shitur shtetases Mirela Margjeka një apartament banimi me sipërfaqen 55 m2, të ndodhur në lagjen "Daniel Matlia" Shkodër në vlerën 2.700.000 lekë.** Krahas kësaj sic e kam shpjeguar në përgjigjet e këtij pyetësori nëna e bashkëshortes time pas vdekjes së bashkëshortit të saj ka jetuar me prindërit e saj. Vjehrra ka qenë e punësuar (edukatore kopështi) dhe po kështu prindërit e saj janë trajtuar me pension pleqërie dhe invaliditeti.
Nga të gjitha këto prova rezulton qartë se nëna e bashkëshortes time ka patur mundësi të krijojë shumën e të ardhurave me të cilat u krijua depozita bankare nga bashkëshortja ime Arlinda Ymeri (Hallunovi) në vitin 2008. Komisioni i ka patur në dispozicion të gjitha këto prova por nuk i ka marrë në konsideratë. **Fillimisht në lidhje me këtë depozitë Komisioni pretendoi se Flutura Hallunovi nuk kishte të ardhura për krijimin e kësaj depozite dhe kur në vijim u gjend përballë provave të pakontestueshme të paraqitura nga ana ime, ku vecoj vendimin gjyqësor të formës së prerë të lartpërmendur, ndryshoi sërisht qëndrim duke konkluduar se krijimi i kësaj shume nuk ishte bërë nga vjehrra ime por është bërë nga unë. Theksoj se ky vlerësim i Komisionit nuk bazohet në ndonjë akt apo provë konkrete, por është rrjedhojë e dëshirës së Komisionit për t'a paraqitur këtë depozitë në këtë formë, me qëllim të paramenduar në dëm të interesave të mia.**

Bazuar në analizën financiare për vitin 2008 rezulton qartë se kam patur të ardhura të mjaftueshme për t'ia kthyer vjehrrës time shumën 1.000.000 lekë me të cilën u krijua kjo depozitë, veprim të cilin e kam kryer me qëllim që kjo depozitë t'i mbetej familjes time.

Fakti që kjo depozitë ka shërbyer për krijimin e bonove në vitin 2009 rezulton qartë nga deklarimet e mia me DPV 2009 dhe koha kur unë e kam tërhequr depozitën në raport me kohën e depozitimit të bonove që është vetëm 3 ditë më parë.

Gjithashtu theksoj se nga analiza financiare që më është dërguar me rezultatin e hetimeve në muajin prill 2022 kjo depozitë është njohur nga Komisioni si burim të ardhurash. Cuditërisht në këtë moment Komisioni nuk e njeh këtë depozitë si burim të ardhurash, pa asnjë vendim të arsyetuar, ndodhur në kushtet që në lidhje me këtë depozitë nuk ka ndryshuar asnjë e dhënë as në drejtim të provueshmërisë së faktit dhe as në drejtim të qëllimit të përdorimit të saj.

Në lidhje me këtë pretendim timin Komisioni shprehet: ***"Në lidhje me pretendimin e subjektit se kjo shumë është konsideruar si burim në rezultatet e para të hetimit, Komisioni çmon se pas riçeljes së hetimit janë administruar dokumente të reja, ndër to edhe shkresa nr.2334/1 prot., datë 14.7.2022, e ILDKPKI-së, dokumentacioni i së cilës është cituar më lart në cilësinë e provës në lidhje me shumën 1,000,000 lekë. Pas administrimit të të gjitha provave të reja është***

vendosur mbyllja e hetimit dhe dërgimi i rezultateve të hetimit subjektit, i cili nuk mund dhe nuk duhej të ishte i njëjtë me rezultatet e mëparshme të hetimit, për sa kohë është kryer një hetim më i thelluar, bazuar edhe në vetë kërkesat e subjektit, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, por edhe gjatë hetimit."

Në lidhje me këtë vlerësim të Komisionit paraprakisht shpjegoj se unë nuk jam njohur nga Komisioni me përmbajtjen e shkresës nr.2334/1 prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së, as me aktin "Rezultatet e hetimit administrativ" dhe as në seancën dëgjimore. Hera e para kur unë jam njohur me përmbajtjen e kësaj shkrese është aktualisht me vendim. Evidentimi dhe përdorimi i kësaj shkrese vetëm në vendimin e Komisionit është haptazi në shkelje të proçesit të rregullt ligjor, nenit 6 të KEDNJ dhe 42 të Kushtetutës, si dhe jurisprudencën e KPA e evidentuar në vendimin me numër 35, datë 15.12.2020 për subjektin e rivlersimit Arcile Koca.
Pavarisht kësaj bazuar në përmbajtjen e kësaj shkrese (me aq sa arrij të kuptoj nga vendimi) rezulton qartë se nuk ka asnjë të dhënë të re nga e cila ndryshon situatën time të deklarimit të kësaj depozite. Bazuar në këtë fakt mendoj se vlerësimi i Komisionit është abuziv, i pabazuar në asnjë provë dhe rrjedhimisht i paligjshëm.

7 **Në lidhje me bonot e thesarit të depozituara me datën 31.07.2009** për të cilat Komisioni ka arritur në konkluzionin: ***"51.25. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2009, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën - 1,926,639.56 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës "a" të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016." shpjegoj si më poshtë:***

7.1 Së pari, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se për arritjen e këtij konkluzioni janë njohur si burime të ardhurash vetëm:
1) Interesat nga depozita pranë Raiffasen Bank në vlerën 66.000 lekë dhe
2) Të ardhurat nga paga.

Evidentoj se nga Komisioni nuk janë llogaritur si burime të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit të këtij viiti:
1) Depozita pranë Raiffaisen Bank në vlerën 1.000.000 lekë, për të cilën dhashë shpjegime më lart.
2) Kredia e marrë pranë Tirana Bank në vlerën 1.500.000 lekë
3) Gjithashtu evidentohet se për vitin 2009 në tërësi dhe kohën kur janë krijuar bonot e thesarit 31.07.2009, Komisioni ka rritur vlerën e shpenzimeve të mobilimit, ku ndërsa në vlerësimin tim këto shpenzime kanë qenë në vlerën 72, 683 lekë, për komisionin këto shpenzime kanë qenë në vlerën 336. 583.33 lekë, pra rreth 4 herë me shumë (rritje e bërë pa vendim të arsyetuar dhe asnjë bazë faktike).

Evidetoj faktin se në të ardhurat e vitit 2009 Komisioni nuk llogaritur si të ardhura për blerjen e bonove të thesarit akumulimin e tërheqjes së shumës së depozituar nga bashkëshortja ime në Raiffaisen Bank në vlerën 1.000.000 lekë në vitin 2008.
Ky qëndrim i Komisionit nuk është i drejtë dhe është bërë me qëllim për të mos më njohur si burime të ligjshme të të ardhurash vlerat monetare të përfitura nga kjo tërheqje.

Qëllimi i përdorimit të shumës të tërhequr nga llogaria e bashkëshortes time me datën **28.7.2009** rezulton qartë edhe nga data e tërheqjes, e cila rezulton të jetë tre ditë para datës **31.07.2009** kur unë kam depozituar shumën 2,250,000 lekë për blerjen e bonove të thesarit. Bazuar në këtë distancë të shkurtër kohore **(vetëm 3 ditë)** dhe faktin se unë nuk kam investuar në blerjen e ndonjë pasurie tjetër të luajtshme apo të paluajtshme apo shpenzime udhëtimi, rezulton qartë se qëllimi i tërheqjes së kësaj shume nga ne ishte blerja e bonove të thesarit. Sic rezulton nga këto të dhëna mosnjohja e kësaj llogarie bankare ka ndikuar ndjeshëm në nxjerrjen e një bilanci negativ nga Komisioni në mundësinë e familjes time të re për blerjen e bonove të thesarit me datën 31.07.2009.

Së dyti, në arritjen nga Komisioni të konkluzionit për bilanc negativ në vlerën 1,926,639.56 lekë në blerjen e bonove të thesarit me datën 31.07.2009, evidentoj faktin se në të ardhurat e familjes time deri me këtë datë, nuk janë llogaritur edhe një pjesë e të ardhurave që kanë rezultuar nga një kredi bankare e marrë nga ana ime me datën 10.07.2009 (për kolateralin e të cilës do të japë shpjegime në vijim) e deklaruar nga ana ime, të cilën e kam shlyer për 40 muaj.
Në lidhje me këtë kredi, si një nga burimet e financimit të blerjes së bonove të thesarit, unë kam dhënë shpjegime të qarta në përgjigjen e pyetësorit të tretë, të cilat konstatoj që qëllimisht ato nuk janë marrë në konsideratë. Shpjegimet që unë kam dhënë janë: *"Kjo ka qënë kredi konsumatore, që faktikisht familja jone e ka përdorur shumë pak në vitin 2009, duke finacuar vetëm një udhëtim në Turqi që ka kushtuar rreth 1000 Euro, ndërsa pjesën tjetër të saj e kemi përdorur për të plotësuar (krahas burimeve të tjera) bonon e krijuar me datën 28.07.2009, (pra është përdorur një pjesë e vogël e kësaj kredie), ndërsa pjesën e mbetur të kësaj kredie e kemi përdorur për të financuar bonon e datës 05.04.2010. Fillimisht, kredinë e kemi marrë për t'a përdorur për mobilimin e shtëpisë, por nuk e kemi përdorur pothuajse fare sipas destinacionit të saj.*
Lidhur me gabimin e bërë në deklarimin e kësaj kredie, (që më shumë ka formën e mungesës së plotësisë dhe qartësisë në deklarim, gjë që mund të konstatohet me sy të lirë po të shihet fq 3 e DPV 2009, e plotësuar me datën 25.03.2010), kjo justifikohet me faktin që ka qënë hera e parë që unë kam shkruar me dorën time Dekleratën Individuale Vjetore, pasi herët e tjera (të mëparshme) janë shkruar nga babai, dhe jam ngatërruar"

Në lidhje me këtë kredi bankare Komisioni konstaton: ***"51.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se edhe pas kalimit të barrës së provës nuk është saktësuar sërish shuma përkatëse e përdorura prej tij për vitet 2009 - 2010 në lidhje me këtë kredi. Për rrjedhojë, për sa kohë vetë subjekti nuk është përpjekur për të saktësuar këto shuma, edhe pse Komisioni i ka kaluar barrën e provës, vlerësohet se kjo kredi nuk është përdorur për blerjen e këtyre bonove. Komisioni vlerëson se kjo kredi është deklaruar nga subjekti si burim gjatë hetimit, me qëllim rregullimin e pozitës së tij në analizën financiare, duke u fshehur në këtë mënyrë burimi i ligjshëm i të ardhurave për krijimin e bonove"*** shpjegoj:

Ky arsyetim i Komisionit është tërësisht i padrejtë dhe allogjik, përsa kohë rezulton qartë se nga momenti i marrjes së kredisë **(13.07.2009)** deri datën e blerjes së bonove të thesarit **(31.07.2009) ka një distancë kohore prej 18 ditësh. Ndodhur në kushtet që brenda kësaj periudhe unë nuk kam kryer asnjë blerje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme si dhe nuk kam**

shpenzuar në udhëtime <u>evidentohet qartë se një pjesë e të ardhurave monetare të marra me këtë kredi janë përdorur për blerjen e bonove të thesarit.</u>

Realisht më duket e cuditshme sesi Komisioni vlerëson se këtë kredi unë e kam përdorur gjatë hetimit si burim për të rregulluar analizën financiare ndërkohë që dukshëm rezulton se ky veprim është kryer nga ana ime, pra në favor të personit tim është disbursuar vlera monetare e marrë kredi dhe po kështu unë kam paguar 3 vjet për shlyerjen e saj.

Ndodhur në kushtet që unë nuk e paskam përdorur kredinë ndër të tjera edhe për këtë qëllim a mund të më shpjegohet cili ka qenë qëllimi i marrjes së saj? Asnjë person me llogjik të shëndoshë nuk kryen veprime fiktive të cilat rezultojnë në dëm të interesave materiale të tij. Pra nëse unë nuk kisha interes të kryeja këtë veprim për cfarë arsyesh e kam marrë këtë kredi? Sinqerisht nuk kam fjalë për këtë trajtim të pallogjiktë që Komisioni më ka bërë mua, ku gjithshka kam dëgjuar por ky përbën kulmin e padrejtësisë.

<u>E konstatoj këtë qëndrim të Komisionit tërësisht të padrejtë dhe dashakeq vecanarisht nëse kihet në konsideratë fakti se ndërsa Komisioni nuk njeh kredinë bankare si burim të ardhurash cuditërisht zbret si shpenzime pagimin e këtseve të kësaj kredie nga unë për 40 muaj. Logjikisht nëse një vlerë monetare nuk konsiderohet si e ardhur ajo nuk mund të llogaritet si shpenzim, pasi unë nuk mund të paguaj atë që se kam marrë.</u>

Nga ky qëndrim i Komisionit mendoj se evidentohet paragjykimi dhe paracaktimi i vendimit të tij në përfundim të kësaj procedure administrative, i cili qartësisht është në dëm të interesave te mia.

Bazuar në këtë perceptim timin, i kërkoj Kolegjit të riparojë gabimet në kryerjen e kësaj analize financiare të pallogjiktë, veprim i cili do ta kthente veprimtarinë e tij në procesin tim të rivlersimit brenda qëllimeve të veprimtarisë për të cilave është krijuar dhe duhet të funksionojë ky organ.
Këto qëllime nuk lidhen me evidentimin e pasaktësive në deklarimet e subjekteve të rivlersimit, por vetëm në nxjerrjen e deklarimeve që synojnë fshehjen e pasurisë apo burimeve të saj. Qartësisht veprimtaria e Komisionit në drejtim të personit tim nuk ka pasur si objektiv respektimin e këtij qëllimi të përcaktuar me praktikën e konsoliduar të KPA, të vendosur me vendimin e formës së prerë me numër 46, datë 4.07.2018, sipas të cilit: *"Komisioni vlerëson se kompetenca me të cilën Kushtetuta dhe ligji kanë ngarkuar këtë organ për të ushtruar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve,* ***<u>nuk mund të kufizohet dhe të jetë vetëm gjetja e gabimeve ndër vite të subjekteve që hetohen dhe gjykohen.</u>*** *Përkundrazi, Komisioni gjatë hulumtimit dhe zbatimit të detyrave funksionale duhet që këto pasaktësi t'i shoqërojë me konkluzionin se janë pikërisht ato mjetet me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj….* ***<u>kjo do të thotë që nëse pasaktësia ose mospërputhja është e palidhur me fshehjen e pasurisë dhe është pasojë e një konteksti të caktuar të perceptimit të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit, atëherë kjo rrethanë nuk mundet kurrsesi të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore nga ana e organeve vendimarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar</u>*** *".*
Bazuar në këtë arsyetim mendoj se respektimi nga Komisioni i këtij qëllimi të veprimtarisë do të ishte në përputhje me parimet e ligjshmërisë, objektivitetit, barazisë, proporcionalitetit, parime

bazë pa të cilët nuk mund të zhvillohet asnje procedurë administrative, aq më pak një procedurëme natyrë disiplinore, në përfundim të të cilave ndaj palës së interesuar mund të vendoset një dënim ose ndëshkim.

Analiza e financiare BTH 31.07.2009

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 2,250,000 leke - 31/07/2009

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga interesi nga depozita tek Raiffeisen Bank	67,500
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 01.01.09 - 31.07.09	598,247
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 01.01.09 - 31.07.09	270,271
Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri, levru me daten 13/07/2009	1,500,000
Te ardhura totale deri 31.07.2009	**2,436,018**
Shpenzime jetese 3 persona 01.01.09 - 31.07.09	239,085
Shpenzime mobilimi 01.01.09 - 31.07.09	72,683
Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH	999,266
Mjete Monetare me 31 korrik 2009 ne llogari Bankare dhe CASH	2,250,113
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	**873,402.15**

Analiza e financiare 2009

Për vitin 01/01/2009- 31/12/2009		**Vleresim i ekspertit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**1,742,513**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2009 - 31.12.09	975,803	
1.2	Te ardhura nga puna bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2016	484,457	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2017	25,260	
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita 2008 - 2009	67,500	
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 2008 - 2010	189,493	
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit		
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra		
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku		
1.91	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja		
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		

Për vitin 01/01/2009- 31/12/2009		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
2.2			
2.3			
2.4		-	
3	**Detyrimet**		**1,636,959**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	-	
3.2	Dhene Andri - babait Faik Ymerit sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI		
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	1,500,000	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-163,041	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri, provuar me DPV 2009 fq.3 kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015	-100,000	
3.6	Kthimi I Huadhenies dhene babait (ne vitin 2008), provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , kthy para dt 31 korrik	400,000	
3.7	Kthim huadhenie nga vellai Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,	-	
3.8	Marre overdraft	-	
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2012		
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit		
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000		
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT		
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri		

Për vitin 01/01/2009- 31/12/2009		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	-	
		-	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**1,742,513**
5	**Shpenzimet**		**774,990**
5.1	Shpenzime jetese	409,860	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke	60,042	
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke		
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke		
5.5	Shpenzime mobilimi	124,600	
5.6	Shpenzime udhetimi	180,488	
5.7	Shpenzime shkollimi		
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€		
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008		
5.91	Shpenzime dasme 2008		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**999,266**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**2,612,512**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**991,236**

7.2 Në lidhje me kredinë bankare të marrë pranë Tirana Bank në vlerën 1.500.000 lekë, për të cilën babai im ka vënë garanci shumën **1,850,000 lekë** Komisioni vlerëson: ***"51.10. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e tij nuk janë bindëse. Nuk ka asnjë logjikë ekonomike që babai i subjektit të merrte një kredi, që ta depozitonte në bankë për të siguruar kredinë që do të merrte vetë subjekti. Së dyti, subjekti ka pretenduar se gjatë vitit 2008 i ka dhënë babait të tij hua shumën 400,000 lekë, e cila po sipas subjektit, i është kthyer sërish në vitin 2009. Nëse babai i subjektit do të kishte të ardhura të mjaftueshme, ai nuk kishte pse të merrte hua shumën 400,000 lekë."*** shpjegoj se ky vlerësim i Komisionit është tërësisht i gabuar dhe në lidhje me të jap këto shpjegime :

<u>Së pari,</u> shpjegoj se për shkak të cilësisë së kësaj shume të depozituar nga babai im, si *"garanci bankare"* unë nuk kam patur asnjë detyrim t'a deklaroj atë ndonjëherë. Mosdeklarimi i kësaj garancie bankare nuk mund të konsiderohet nga Komisioni as si mosdeklarim dhe as si deklarim

i rreme nga ana ime. Kjo për shkak se kjo *"garanci bankare"* nuk sjell asnjë pasojë në analizën time financiare të pasurisë time, pasi kjo shumë nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ana ime për t'u përdorur as për krijim pasurie, as për mbulim shpenzimesh të tjera të ekonomisë time familjare dhe as rezulton të jetë deklaruar si burim për qëllime të kësaj natyre. Qëllimi i vetëm i kësaj garancie ka qenë garantimi i kredisë së marrë dhe në asnjë moment asnjë pjesë e kësaj garancie nuk është përdorur nga ana ime për shlyerjen e kredisë. Titullari i vetëm i të drejtave mbi këtë garanci bankare ka qenë babai im dhe unë personalisht nuk kam pasur asnjë të drejtë disponimi në lidhje me të. Kjo pasuri është shumë monetare e babait tim dhe sic unë do t'a shpjegoj në vijim është krijuar nga të ardhura të ligjshme të familjes time të origjinës.

Së dyti, ky arsyetim i imi bazohet edhe në praktikën e konsoliduar të vendosur nga KPK dhe Kolegji i Apelimit ku në lidhje me garancitë bankare, madje edhe huatë, që nuk kanë shërbyer për krijimin, investimin etj të pasurisë së subjektit të rivlersimit, mosdeklarimi i tyre nga subjekti nuk konsiderohet penalizues për të justitifikuar marrjen ndaj tij të masës ekstreme. I tillë është vendimi i Kolegjit të Apelimit për subjektin e rivlersimit Astrit Kalaja, me numër 1, i datës 27.01.2022, ku Kolegji shprehet: *"Trupi gjykues vëren gjithashtu se kjo shumë, e cila rezulton të jetë pjesë e shumës së dhënë hua nga z. P., ka shërbyer vetëm për qëllimin e garantimit të kredisë, pasi nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ana e subjektit të rivlerësimit për t'u përdorur as për krijim pasurie, as për mbulim shpenzimesh të tjera të ekonomisë së tij familjare dhe as rezulton të jetë deklaruar si burim për qëllime të kësaj natyre. Në kushtet kur kthimi i kësaj pjese të huas huadhënësit, z. Rr. P., rezulton të jetë kryer nga subjekti i rivlerësimit nga paratë e bllokuara në depozitën e garancisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo pjesë e huas nuk ka sjellë asnjë pasojë në analizën e kryer në kuadër të kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit (përveç sigurimit të kredisë)".*

Së treti, për shkak të cilësisë së kësaj shume monetare, e cila ka shërbyer vetëm për garantimin e kthimit të kredisë nga ana ime mendoj se unë nuk kam detyrimin për të justifikuar burimin e krijimit të kësaj shume. Këtë qëndrim e ka mbajtur Kolegji i Posacëm i Apelimit për subjektin e rivlersimit Astrit Kalaja, me numër 1, i datës 27.01.2022, ku Kolegji shprehet*: "Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se me të drejtë Komisioneri Publik pretendoi se Komisioni ka gabuar në moskonsiderimin e marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. P. si marrëdhënie huaje, por gjithashtu ndryshe nga sa pretendoi Komisioneri Publik, trupi gjykues vlerësoi se vetëm një pjesë e huas së marrë mund të merrej në shqyrtim në kuptim të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të analizës lidhur me kontrollin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të. Por për arsyet e treguara më sipër, në kushtet kur edhe kjo pjesë e huas nuk ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli dhe as të ndonjë pasurie tjetër të krijuar në vijim nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk prodhoi pasoja negative në analizën financiare, trupi gjykues e çmoi të panevojshme kryerjen e një analize për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të z. Rr. P. hua për shumën e dhënë".*

Në lidhje me krahasimin që unë i kam bërë kësaj situate të deklarimit tim me atë të subjektit të rivlersimit Astrit Kalaja Komisioni shprehet: "***51.14. Në lidhje me pretendimin e subjektit se është në të njëjtën situatë si në vendimin nr. 1/2022 të Kolegjit, Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është i mbështetur, pasi Komisioni nuk e ka analizuar shumën 1,850,000 lekë si garanci bankare, por si pasuri të fshehur të subjektit."***

Në lidhje me këtë qëndrim të Komisionit vlerësoj se ai është i paarsyetur pasi në të nuk pasqyrohen shkaqet përse kjo garanci konsiderohet "pasuri e fshehur" e imja dhe jo "garanci pasurore". Bëria e një cilësimi të drejtë të një fakti juridik nuk varet nga dëshira e personit që bën cilësimin për t'a konsideruar atë, por varet nga argumentat juridik mbi të cilat bazohet ky arsyetim. Në rastin konkret Komisioni nuk ka dhënë asnjë arsyetim të tillë juridik se përse garancia bankare e vënë nga babai im nuk e ka këtë cilësi dhe mbi cfarë arsyetimi juridik apo rrethanë faktike kjo shumë monetare është pasuri e fshhehur nga ana ime.

Shpjegoj se argumentat e Komisionit se kryerja e këtij veprimi nuk ka logjike ekonomike nuk qëndron. logjika ekonomike që ka ekzistuar në rastin konkret është fakti se babai im përmes depozitimit të kësaj shume monetare në bankë kishte mundësi të merrte interesat bankare, të cilat natyrisht nuk mund të mi kërkonte mua për shkak të lidhjes në gjini.

<u>Së katërti,</u> pavarsisht bindjes time, e cila duket se mbështetet edhe në praktikën e mëparshme të Kolegjit të Apelimit, unë nuk i shmangem asnjë detyrimi për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume monetare nga babai im. Kjo në funksion të transparencës dhe bashkëpunimit dhe vecanarsisht për të hedhur poshtë konkluzionin e Komisionit se kjo shumë monetare është pasuri e fshehur nga ana ime.

Shpjegoj se unë askund nuk kam thënë se shuma prej 1,850,000 lekë e vënë garanci nga babai im ka rezultuar nga marrja e një kredie bankare nga ai dhe në këtë drejtim Komisioni ka abuzuar me përdorimin e shprehjeve. Kjo shumë bankare është rrjedhojë e kursimeve familjare të familjes time të origjinës. Nëse Komisioni do të vlerësojë analizën financiare të familjes time të origjinës për vitin 2008 rezulton qartë se për këtë vit ata rezultojnë me balancë pozitive në një shumë më të madhe se 2 milion lekë, shumë e cila tejkalon shumën e vënë garanci bankare nga babai im. Konkretisht shpjegoj se kjo shumë është rrjedhojë e kursimeve të familjes time të origjinës për vitet 2007, 2008, 2009, ku veçanarisht duhen përmëndur të ardhurat rreth 950.000 lekë nga ekzekutimi i dy vendimeve gjyqësore në favor të nënës time në vitin 2008 , të ardhurat nga puna si avokat e vëllait tim Gerti Ymeri, që sikur 50% vitin mbi xhiron të llogariten, janë rreth 2.000.000 lekë, (në fakt Komisioni pranon që në rastin e avokatëve fitimi është 80%), pensionet e prindërve, etj.

Në lidhje me përdorimin sërisht nga Komisionit të huasë prej 400.000 lekësh (e cila theksoj nuk ishte hua) babait tim, për operacionin e nënës u shpreha më lart dhe mbi këtë bazë nuk e gjej me vend të kaloj në përsëritje, vec ritheksoj se është e turpshme që anëtarët e Komisionit përpjekjen time për të mbështetur dhe ndihmuar prindërit e mi janë munduar ta përdorin në dëm të interesave të mia në këtë proces rivlersimi.

Analiza financiare e familjes time të origjinës për vitin 2008 është si më poshtë:

<u>Për vitin 01/01/2008- 31/12/2008</u>		**Vleresim i ekspertit**	**Komente**
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**	**1,858,686**	

1.1	Te ardhura nga pensioni subjekti Faik Ymeri 01 janar 2008 - 31.12.08	160,014		
1.2	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08	244,691		
1.3	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008	816,908		
1.4	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008 ne shtator mbas ndarjes nga Andri sipas vendimit nr 38 dt 29.08.2008	137,073		
1.5	Te ardhura nga Xhiro e Gerti Faik Ymeri P/F me nipt K86330002V	500,000		Shkresa nr prot .6311/1 dt 26.04.2022
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**	
2.1		-		
2.2				
2.3				
2.4		-		
3	**Detyrimet**		**400,000**	
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, Kthimi I te ardhures se depozites Flutra Hallunovi	0		
3.2	Te ardhura nga kthimi I borxhit nga Andri Ymeri dhene Faik Ymerit	400,000		Deklarim I subjektit te rivleresimit
3.4				
		-		
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**1,858,686**	
5	**Shpenzimet**		**1,698,955**	
5.1	Shpenzime jetese 2008/01 - 2008/12	409,860		
5.2	Shpenzime udhetimi 2008/01 - 2008/12	-		

5.3	Shpenzime mobilimi 2008/01 - 2008/13	-		
5.4	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€	739,095		
5.5	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008	300,000		
5.6	Shpenzime dasme 2008	250,000		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**1,520,654**		
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**-**		
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**	**2,080,385**		

Kjo shumë monetare ka buruar **edhe** nga të ardhurat e realizuar nga vëllai im Gerti Ymeri, i cili ka qenë në një ekonomi të përbashkët me babain tim, nga puna e tij si avokat. Nga Zyra e Tatimtaksave në Bashkinë Shkodër kam nxjerrë informacion mbi xhiron vjetore të deklaruar nga vëllai im në vitet 2008 dhe 2009 nga puna si avokat dhe tatimeve të paguara nga ai për këto vite. Nga këto akte të cilat ia kam dërguar Komisionit rezulton qartë vlera e të ardhurave që ka realizuar vëllai im nga ky aktivitet.

Evidenca Mbi Llogaritjen E Fitimit Te Gerti Faik Ymeri	
Parashikimi Vjetor	1,000,000
Tatimi Vjetor I Parashikuar Ne %	3%
Tatimi Vjetor I Parashikuar	30,000
Vertetimi Per Pagesat	44,000
Pra Shume Faktike E Realizuar	
	35,600
Shpenzimet	1,466,667
Pagat E Te Vetpunesuarit	1,000,000
Kontribute Te Te Vetpunesuarit	3%
A)	30,000

Nr	**Periudha**	**Paga e deklaruar**	**% e kontributit te vetpunesuarit**	**Muaj**	**Shuma e sigurimeve shoq dhe shendetsore**
1	Janar - Qershor 2008	13,140	33.20%	6	26,175
2	Korrik-Dhjetor 2008	14,830	33.20%	6	29,541
Totali					**55,716**

Pra Kosto Kontributesh Sig Shoq Dhe Shendetsore				**55,716**

B) Taksa Bashkie					
Sipas Subekteve Analogje					8400
C) Shpenzime Materiale Dhe Kanceleri Afersisht Ose Me Mire Maksimalisht 20% E Te Ardhurave					146,667

Periudha Viti	Qarkullimi i parashikuar	Te ardhurat faktike sipas kuotes se paguar	Shpenzimet ushtrimore te llogaritura	FITIMI USHTRIMOR	TAPBV	Fitimi Neto
2008, Llogaritja e fitimit neto sipas pageses faktike te takses	1,000,000	1,466,667	210,783	1,255,884	35,600	1,220,284
2008, Llogaritja e fitimit neto sipas parashikimit	1,000,000	-	210,783	789,217	35,600	753,617

Në lidhje me këto të ardhura të realizuara nga aktiviteti si avokat i vëllait tim Komisioni shprehet: ***"51.11. Në lidhje me të ardhurat e vëllait të subjektit, nga hetimi ka rezultuar se nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore për vitet 2008 - 2010, si dhe nga të dhënat e deklaruara për vitet 2011 - 2012 të ardhurat e tij nga aktiviteti si avokat janë në shumën rreth 200,000 lekë."***

Pretendimi i Komisionit se në lidhje me këto të ardhura vëllai im nuk ka paguar detyrime tatimore nuk qëndron. Shpjegoj se në atë kohë këto tatime pagushen pranë organit të pushtetit vendor dhe jo tatime dhe mbi këtë bazë deklarimi i xhiros vjetore nga vëllai im është bërë në Bashkinë Shkodër. Nxjerrja e marxhit të fitimit nga Komisioni duhet të bëhej mbi bazën e këtij deklarimi dhe jo të konsiderohej negativ sikurse ka bërë ai.

8 **<u>Në lidhje me bonot e thesarit të depozituara me datën 05.04,2010</u>** për të cilat Komisioni ka arritur në konkluzionin: **"*52.9. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2010, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën - 1,157,759.41 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës "a" të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016"*** shpjegoj si më poshtë:

Së pari, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se për arritjen e këtij konkluzioni janë njohur si burime të ligjshme të ardhurash **vetëm të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes, interesat e depozitës**, ndërkohë që nuk janë njohur si të ardhura burime të tjera të ardhurash të deklaruara nga ana ime si në DPV ashtu procesverbalet e pyetjeve dhe memot drejtuar ILDKPKI që janë:

- Gjendja Cash prej 400.000 lekësh e deklaruar në DPV 2009,
- 100.000 lekë që më janë kthyer nga vëllai dhënë hua në vitin 2009,
- Pjesa e papërdorur e kredisë të marrë në vitin 2009 tek Tirana Bank sh.a,

Në lidhje me burimin e të ardhurave mbi të cilat janë krijuar këto bono thesari, në përgjigjen e pyetësorit të tretë kam dhënë këtë deklarim:

Për bonon e thesarit për të cilën me datën 05.04.2010, janë derdhur cash 1.750.000 lekë, ju sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim:

***1.** Akumulimi i kursimeve familjare të rrogës time deri në këtë datë, i rrogës së bashkëshortes time,*
+
***2.** Gjendja Cash prej 400.000 lekësh e deklaruar në DPV 2009, që faktikisht është deklaruar jo në mënyrë të qartë në fq. 3 të DPV 2009, që ka qënë një hua prej 400.000 lekësh, (që unë e kam quajtur hua pavarësisht se nuk ka qënë e tillë). Lidhur me këtë hua prej 400.000 lekë të marrë nga babai, në pyetësorin standart jam shprehur se "....Në vitin 2009 (me sa mbaj mënd, por datën e saktë nuk e kujtoj), kam marrë një shumë prej 400.000 (katërqindmijë) lekë nga babai im Faik Ymeri. Rrethanat e marrjes së kësaj shume janë si vijon:*
Rreth fundit të muajit korrik apo fillimit të muajit gusht të vitit 2008 (në kohën kur ishim me pushime ne plazhin e Velipojës, Shkodër), sikurse ju kam bërë me dije, nëna ime Elvira Ymeri ka pësuar infrakt miokardi, gjë që e ka bërë të domosdoshëm kryerjen e nje ndërhyrje kirurgjikale në zemër (bye pass). Duke qënë se ishte ngjarje e papritur për ne dhe duke mos ditur se çfarë shpenzimesh do të nevojiteshin për kurimin e saj, ne të gjithë të afërmit u munduam (me sa kishim mundësi), që të mblidhnim para për kurimin e nënës. Unë fillimisht i kam dhënë babait tim 120.000 (njëqind e njëzetmijë) lekë që kisha nga kursimet e mia familjare. Pas përfundimit të ndërhyrjes kirurgjikale të nënës, duke patur frikë se ajo mund t'i nënshtrohej edhe nje ndërhyrje kirurgjikale të dytë, menduam që do të ishte e udhës që t'a dërgonim (nëse do të ishte nevoja) në Itali. Për rrjedhojë disa muaj më pas, i kam dhënë babait tim edhe 150.000 (njeqind e pesedhjetë mijë) lekë të tjera, për t'u përdorur prej tij nëse do të ishte nevoja. Rreth muajit janar apo shkurt të vitit 2009, i kam dhënë përsëri babait tim, një shumë tjetër prej 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë), duke arritur tërësia e këtyre shumave në vleftën tërësore, 400.000 (katërqindmijë) lekë. Këtë shumë prej 400.000 (katërqindmijë) lekësh, të cilën unë ia kisha dhënë babait në rrethanat e sipërpërshkruara, unë e kisha llogaritur të shpenzuar dhe i kisha bërë me dije babait se nuk i doja që të mi kthente. Në vitin 2009, babai im më ka bërë me dije që shuma e parave të cilën unë ia kisha dhënë në vitin 2008, ishte në shtëpinë e tij dhe e papërdorur pasi nuk i kishte lindur nevoja e përdorimit të saj. Pavarësisht se unë nuk isha dakort, ai insistoi të ma kthejë dhe ma dorëzoi. Ndodhur në kushtet ku nuk dëshiroja t'ia prishja qejfin, unë e mora këtë shumë, por në mëndjen time unë e kam trajtuar si hua, të cilën në momentin më të parë ku do gjeja një arsye, do ia jepja përsëri. Këtë shumë parash unë ia kam dhënë në vitin 2011. Për të vërtetuar sa më sipër, ju bëj me dije se kam dhënë sqarime te hollësishme ne ILDKPKI në vitin 2011, e

dokumentuar me proçes-verbalin e datës 16.11.2011, të mbajtur nga Zamira Gjini, me detyrë Inspektore e Lartë në Inspektoriatin pranë ILDKPKI-së. Përveç kësaj edhe me deklaratën periodike të vitit 2011…..".

+

***3.** 100.000 lekë që më janë kthyer nga vëllai, pasi ia kisha dhënë borxh në vitin 2009, e deklaruar në DPV 2009.*

+

***4.** Pjesa e papërdorur e kredisë të marrë në vitin 2009 tek Tirana Bank sh.a, që unë gabimisht nuk e kam deklaruar saktësisht në DPV 2009, (duke u shprehur vetëm se kam marrë një kredi tek Tirana Bank, në shumën 1.500.000 lekë, të cilën kam marrë përsipër t'a shlyej për 40 muaj). Kjo ka qënë kredi konsumatore, që faktikisht familja jone e ka përdorur shumë pak në vitin 2009, duke finacuar vetëm një udhëtim në Turqi që ka kushtuar rreth 1000 Euro, ndërsa pjesën tjetër të saj e kemi përdorur për të plotësuar (krahas burimeve të tjera) bonon e krijuar me datën 28.07.2009, (pra është përdorur një pjesë e vogël e kësaj kredie), ndërsa pjesën e mbetur të kësaj kredie e kemi përdorur për të financuar bonon e datës 05.04.2010. Fillimisht, kredinë e kemi marrë për t'a përdorur për mobilimin e shtëpisë, por nuk e kemi përdorur pothuajse fare sipas destinacionit të saj.*

Lidhur me gabimin e bërë në deklarimin e kësaj kredie, (që më shumë ka formën e mungesës së plotësisë dhe qartësisë në deklarim, gjë që mund të konstatohet me sy të lirë po të shihet fq 3 e DPV 2009, e plotësuar me datën 25.03.2010), kjo justifikohet me faktin që ka qënë hera e parë që unë kam shkruar me dorën time Dekleratën Individuale Vjetore, pasi herët e tjera (të mëparshme) janë shkruar nga babai, dhe jam ngatërruar.

Së dyti, evidentoj faktin se nga ana e Komisionit nuk më është njohur si burim të ardhurash pjesë e pakonsumuar e kredisë të marrë në vitin 2009, me arsyetimin se *"nuk kam deklaruar kursime".*Ky konkluzion Komisionit është tërësisht i pasaktë, i pavërtetë dhe i qëllimtë, i bërë në funksion të ngarkimit tim me një bilanc negativ sa më të lartë.

Kursime nga të ardhurat e marra nga kjo kredi unë i kam deklaruar edhe gjatë pyetjes time më datën 16.11.2011 përpara inspektores së ILDKPKI Zamira Gjini.

Kështu në këtë procesverbal unë deklaroj: "*Bonot e krijuara në korrik 2010 kanë burimin nga pakësimi i gjendjes së cashit të mbartur nga viti 2009, pra 400.000 lekë kursime + 100.000 lekë kthim huaje nga vëllai + 300.000 lekë interesat nga bonot e vitit 2009 + kursimet nga pagat deri në korrik 2010 + 400.000 lekë marrë në formë borxhi nga babai pa kontratë, pa interes, pa afat"*

Nga sa rezulton nga ky procesverbal duket qartë se unë kam deklaruar kursime të mbarura nga viti 2009. Ky procesverbal bashkalidhur me shpjegimet e dhëna me DPV duhet të konsideroheshin nga Komisioni si një shpjegim i vetëm, në zbatim të nenit 27 të ligjit numër 9040, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nënpunësve publik", qëndrim të cilin Komisioni e ka mbajtur në cdo rast tjetër të mëparshëm, ku gabimet e subjekteve të rivlersimit në deklarimin e pasurisë të "shëruara" me shpjegime apo deklarime të mëvonshme përpara ILDKPKI i ka konsideruar tërësisht të sakta për procesin e rivlersimit. Një rast i tillë është ai i gjyqtarit Artan Cupi, i konflirmuar në detyrë, me vendimin e formës së prerë, më numër 444, datë 16.09.2021 ku shpjegimet e dhena nga ai gjatë procesit të hetimit administrativ përpara ILDKPKI u konsideruan si plotësues të shpjegimeve të dhëna me DPV dhe i shërbyen vërtetimit të shpjegimeve të dhëna nga ai.

Në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes së cash në deklaratat perodike nga subjektet e rivlersimit ka një praktikë të konsoliduar edhe me vendime të Kolegjit të Apelimit. Kështu Kolegji me vendimin me numër 1, datë 27.01.2022 të subjektit të rivlersimit Astrit Kalaja nuk ka konsideruar si penalizues faktin e mosdeklarimit nga ana e subjektit te gjendjes se cashit pas shitjes së banesës së tij, vlerë të cilën ai e ka përdorur në vijim për krijimin e pasurisë. Kështu në këtë vendim Kolegji shprehet: "*Për rrjedhojë, në konsideratë të fakteve dhe rrethanave specifike si më sipër trajtuar, trupi gjykues, edhe pse vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, në formën e duhur dhe në mënyrë të shprehur, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, shtimin e pasurisë likuiditet në gjendje cash në banesë, si pasojë e tërheqjeve bankare të të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë, e çmoi të përmbushur deklarimin e posedimit të një gjendjeje likuiditeti cash në masën e këtyre tërheqjeve, sa kohë në datën e dorëzimit të deklaratës periodike të vitit 2008, këto të ardhura me burim shitjen e apartamentit me sip. 63 m2, ishin deklaruar në rubrikën e shtesave dhe pakësimeve të pasurive, si një pasuri në formë likuiditeti. Ky përfundim i trupit gjykues përforcohet edhe nga deklarimet në vijim të përdorimit të këtij likuiditeti nga ana e subjektit të rivlerësimit, të cilat shprehen nga subjekti me nocionin e pakësimit të pasurisë dhe deklarohen pikërisht në rubrikën e shtesave dhe pakësimeve të interesave privatë të periodike deklaratave pavarësisht se pagesat e kryera me këtë likuiditet ndaj palëve të treta janë deklaruar rregullisht në formën e kërkuar nga ligji edhe në rubrikën e detyrimeve financiare të deklaratave periodike. Gjithashtu, edhe referimi në deklarimin e bërë në deklaratën periodike të vitit 2010: kam shlyer një pjesë të kredisë nga kursimet në cash në shtëpi, të përbëra (kursime në cash dhe lekë nga shitja e shtëpisë së deklaruar në deklarimet e mëparshme), u çmua si një element që çoi në krijimin e bindjes së trupit gjykues lidhur me vërtetësinë e deklarimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, në drejtim të konceptimit të tij të mënyrës së deklarimit të kursimit në gjendje cash."*

Duke çmuar se cdo procedurë administrative ka si bazë zbatimin e "parimit të barazisë" në trajtimin e rasteve të ngjashme, mendoj se Komisioni nuk mund të bënte një trajtim të ndryshëm të deklarimit tim nga ai i subjekteve të tjera të rivlersimit në këtë drejtim. Një qëndrim i ndryshëm, është jo vetëm i paligjshëm dhe në kundërshtim me qëllimet e vendosura me ligjin numër 9040, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nënpunësve publik", por do të nxirrte në pah njëanshmërinë e Komisionit në funksion të zbatimit ndaj meje të një vendimarrje të paracaktuar më parë, e cila qartësisht është në dëm të interesave të mia.

Së treti, evidentoj faktin që gabimisht apo me keqdashje në burimet e të ardhurave të mia për vitin 2010 nuk janë njohur borxhet e kthyera nga babai im në vlerën 400.000 lekë dhe vëllai im në vlerën 100.000 lekë, me arsyetimin se *"ato nuk i kam deklaruar në DPV e vitit 2009"*.

Ky konstatim i Komisionit është tërësisht i pasaktë, pasi nëse vistohet DPV e vitit 2009 mund të konstatohet lehtësisht deklarimi i këtyre të ardhurave . Shpjegoj se në DPV e vitit 2009 unë kam deklaruar këtë shumë të kthyer dhe konkretisht kjo gjë është bërë në fq 3 të kësaj DPV ku në rublikën NDRYSHIME E INTERESAVE PRIVATE PASURI TË PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME, deklaroj shprehimisht: "**Rreth 400.000 kesh në shtëpi**".

Më poshtë po paraqes flerën e DPV ku i kam deklaruar këto kursime.



Në lidhje me këto burime të ardhurash kam dhënë shpjegime edhe përpara ILDKPKI, me procesverbalin e lartpërmendur, ku i kam shpjeguar qartësisht, sic edhe evidentohet.
Shpjegoj se për dhënien e kësaj huaje nga babai im unë kam dhënë deklarime edhe në DPV 2011 ku deklaroj kthimin e kësaj huaje babait tim. Konkretisht në këtë DPV deklaroj: *"Është shlyer borxhi prej 400.000 lekë marrë nga babai".* Konstatoj se Komisioni e ka përfshirë këtë deklarim si shpenzim në analizën financiare të vitit 2011, por llogjikisht si mund të jetë shpenzim një shumë që nuk ka qenë më parë e ardhur?

Bazuar në këto dy forma të deklarimit të këtyre burimeve të ligjshme të të ardhurave ato duhet të më njiheshin nga ana e Komisionit dhe duhet të më përfshiheshin në analizën financiare të këtij viti. Edhe në lidhje me këto shpjegime vlen i njëjti arsyetim sa më sipër, ku njohja e këtyre burimeve të ardhuarave bazohet në zbatimin e parimit të ligjshmërisë, barazisë dhe objektivitetit.

Përfundimisht konkludoj së unë kam pasur të ardhura financiare për të realizuar shumën prej 1,750,000 lekë të depozituar nga ana ime për blerjen e bonove të thesarit me datën 05.04.2010 dhe kurrsesi nuk rezultoj me bilanc negativ për këtë vit.

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 1,750,000 leke - 05/04/2010

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga kthimi i huase nga vellai	
Kredia nga Tirana Bank	
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 01.01.10 - 05.04.10	319,025
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 01.01.10 - 05.04.10	109,150
Huamarrje marre babait (ne vitin 2010), provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , marre para dt 05.04.2010	400,000
Kthim huadhenie vellait Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep	100,000

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 1,750,000 leke - 05/04/2010

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
380.kol 139 dt 16.02.2015 ,marre para dt 05.04.2010	
Te ardhura totale deri 05.04.2010	**928,175**
Shpenzime jetese 3 persona 01.01.10 - 05.04.10	102,465
Shpenzime pre shlyerje kredie Tirana Bank 01.01.10 - 05.04.10	130,972
Shpenzime mobilimi	4,450
Ndryshim likuiditeti 31.12.09 - 05.04.10	
Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH	**2,612,512**
Mjete Monetare me 05.04 2010 ne llogari Bankare dhe CASH	**4,011,707**
DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)	
Pamundesi financiare	(708,906.86)

Analiza e financiare 2010

Për vitin 01/01/2010- 31/12/2010		**Vleresim i ekspertit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**1,799,651**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2009 - 31.12.09	1,006,874	
1.2	Te ardhura nga puna bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2016	509,815	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2017	-	
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita 2008 - 2009	-	
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 2008 - 2010	282,962	
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit		
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra		
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku		
1.91	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja		
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		

Për vitin 01/01/2010- 31/12/2010		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
3	**Detyrimet**		**81,965**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	-	
3.2	Dhene Andri Faik Ymeri sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI	-	
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	0	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-418,035	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri	0	
3.6	Huamarrje marre babait (ne vitin 2010), provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , marre para dt 05.04.2010	400,000	
3.7	Kthim huadhenie vellait Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,marre para dt 05.04.2010	100,000	
3.8	Marre overdraft		
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2012		
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit		
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000		
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT		
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri		
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri		
		-	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**1,799,651**
5	**Shpenzimet**		**675,108**
5.1	Shpenzime jetese		

Për vitin 01/01/2010- 31/12/2010		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
		409,860	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke	105,150	
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke		
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke		
5.5	Shpenzime mobilimi	17,800	
5.6	Shpenzime udhetimi	142,298	
5.7	Shpenzime shkollimi		
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€		
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008		
5.91	Shpenzime dasme 2008		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**2,612,512**	
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**4,202,084**	
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**	**(383,064)**	

Në lidhje me vitin 2010 shpjegoj se pamundësia financiare për krijimin e bonove të datës 05.04.210 në vlerën (-708,906.86) dhe në fund të vitit në vlerën – 383.064 lekë, nuk vjen realisht nga mungesa e mjeteve monetare, por është shkaktuar nga një gabim në raportim (deklarim) në DPV 2009, të dorëzuar në ILDKPKI, situatë të cilën unë e kam shpjeguar por mesa konstatojnë vendim, në pikën 52.7 të vendimit këto shpjegime nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Komisionit.

Gabimi për të cilin unë kam dhënë shpjegime është se në DPV e vitit 2009 gabimisht unë nuk kam deklaruar kursime në fund të vitit, ndonëse sikurse u pa nga analiza financiare e vitit 2009, unë rezultoj me një balancë pozitive prej **991.236 lekë**. Konkretisht, ju bëj me dije se në DPV e këtij viti më ka ndodhur një ngatërresë në identifikimin e saktë të periudhës së raportimit që mbulon DPV 2009. Kjo pasi sipas ligjit data fundore e periudhës se raportimit në DPV është data 31.12.2009. Duke qënë se DPV 2009 duhej dorëzuar në ILDKPKI, sipas ligjit deri në datën 31.03.2010, unë e kam plotësuar atë me datën 25.03.2010. Në këtë datë të fundit, pra në datën 25.03.2010, që unë kam plotësuar DPV 2009, unë kam menduar se **i kisha të dala nga -cash** mjetet monetare (kursimet), që kanë shërbyer për të krijuar bonon e thesarit të datës 05.04.2010. Kjo pasi depozitimi i fondeve për bonon e thesarit bëhet përpara datës së ankandit që ka qënë data 05.04.2010. Për rrjedhojë, duke u ngatërruar në diferencimin kohor të periudhës ligjore të raportimit që mbulon DPV 2009, që është data 31.12.2009, unë faktikisht në datën 25.03.2009 kur kam plotësuar tëtë DPV, nuk kam deklaruar kursime cash, pasi vërtet kursime cash nuk kam patur në datën e plotësimit të DPV 2009. Pra, në vend që të deklaroja përmes DPV 2009, gjendjen

financiare për periudhën 01.01.2009-31.12.2009, faktikisht unë përmes DPV 2009, kam raportuar (me pasaktësi në raportim) gjendjen financiare për periudhën 01.01.2009 - 25.03.2010. Është pikërisht kjo pasaktësi në raportim (deklarim), por që nuk është mungesë likuiditeti apo mundësie financiare, që ka shkaktuar si balancën negative për vitin 2010, në shumën – 383.064 lekë, ashtu edhe balancat negative në mundësinë e blerjes së bonos së thesarit të datës 05.04.2010, në shumën – 708.906,86 lekë..

Për t'ju bindur ju që ky është një gabim i bërë nga ana ime po ju paraqes analizën financiare 01.01.2009 - 31.03.2010 kohë në të cilën përkon me dorëzimin e DPV dhe jo me të ardhurat në fund të vitit 2009.

Analiza e financiare deri 31.03.2010

Për vitin 01/01/2009- 31/12/2009-31/03/2010		**Vleresim i ekspertit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**2,170,688**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2009 - 31.03.10	1,294,828	
1.2	Te ardhura nga puna bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2016	593,607	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2017	25,260	
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita 2008 - 2009	67,500	
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 2008 - 2010	189,493	
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit		
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra		
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku		
1.91	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja		
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
3	**Detyrimet**		**2,136,959**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	-	

Për vitin 01/01/2009- 31/12/2009-31/03/2010		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
3.2	Dhene Andri - babait Faik Ymerit sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI		
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	1,500,000	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-163,041	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri, provuar me DPV 2009 fq.3 kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015	-100,000	
3.6	Kthimi I Huadhenies dhene babait (ne vitin 2008), provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , kthy para dt 31 korrik	400,000	
3.7	Kthim huadhenie nga vellai Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,	-	
3.8	Marre overdraft	-	
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2012		
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit		
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000		
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT		
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri		
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	-	
	Huamarrje marre babait (ne vitin 2010), provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , marre para dt 05.04.2010	400,000	
	Kthim huadhenie vellait Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,marre para dt 05.04.2010	100,000	
		-	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,170,688**
5	**Shpenzimet**		**1,012,877**
5.1	Shpenzime jetese	512,325	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank -	191,014	

Për vitin 01/01/2009- 31/12/2009-31/03/2010		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
	1,500,000 leke		
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke		
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke		
5.5	Shpenzime mobilimi	129,050	
5.6	Shpenzime udhetimi	180,488	
5.7	Shpenzime shkollimi		
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€		
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008		
5.91	Shpenzime dasme 2008		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**2,612,512**	
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**	**4,011,707**	
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**	**1,895,575**	

9 **<u>Në lidhje me bonot e thesarit të depozituara me 18.07.2011,</u>** për të cilat Komisioni ka arritur në konkluzionin: ***"53.6. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2011, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -195,856.77 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, për sa kohë ka të bëjë me një vlerë, e cila nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore."*** shpjegoj si më poshtë:

Evidentoj faktin se nga analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit në burimet e të ardhurave të mia deri datë në depozitimit të bonove të thesarit <u>nuk janë llogaritur kursimet nga viti 2010.</u>

Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre bonove në përgjigjen e pyetësorit të tretë unë kam deklaruar: *Për bonon e thesarit për të cilën me datën 18.07.2011, për të cilën janë derdhur cash 750.000 lekë, ju sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim kursimet familjare nga të ardhurat e deklaruara në DPV 2010 dhe DPV 2011, pra gjendja cash prej 120.000 lekësh nga viti paraardhës, (shif fq 4 të DPV 2010, të plotësuar me datën 23.03.2011) + kursimet familjare deri në datën 18.07.2011, kur është bërë shtesa e fondeve për rinovimin e bonos.*

Mosnjohja e këtyre kursimeve nga Komisioni është bazuar në arsyetimin se unë *"kam qenë në pamundësi financiare për vitin 2010 në vlerën 1,002,407"*.
Arritja e këtij konkluzioni është tërësisht i gabuar dhe ka premisë arsyetimin e gabuar të bërë nga Komisioni në analizën e vitit 2010.

Bazuar në arsyetimin e bërë më lart, për vitin 2010, kam evidentuar faktin se Komisioni ka bërë një arsyetim të gabuar për analizën time financiare të vitit 2010 dhe rrjedhimisht ka arritur në konkluzione të gabuara për të ardhurat e mia gjatë këtij viti.

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 750,000 leke - 18/07/2011

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 31.03.11 - 18.07.11	461,301
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 31.03.11 - 18.07.11	163,020
Te ardhura nga interesi nga bono thesari	116,255
Teprice pozitive nga analiza per investim ne BTH - 150,000 leke	220,697
Te ardhura totale 31.03.11 - 18.07.11	**961,273**
Shpenzime jetese 3 persona 31.03.11 - 18.07.11	119,543
Shpenzime pre shlyerje kredie Tirana Bank 31.03.11 - 18.07.11	174,317
Shpenzime mobilimi	9,642
Ndryshim likuiditeti 31.03.11 - 18.07.11	780,910
Pamundesi financiare	**-123,139**

Analiza financiare 2011

Për vitin 01/01/2011- 31/12/2011		**Vleresim i ekspertit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**2,380,145**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2009 - 31.12.09	1,469,426	
1.2	Te ardhura nga puna bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2016	588,640	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01.11.08 - 2017	-	
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita 2008 - 2009	-	
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 2008 - 2010	322,079	
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit		
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra		
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku		
1.9	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja		

Për vitin 01/01/2011- 31/12/2011		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1			
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
3	**Detyrimet**		**(709,000)**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	-	
3.2	Dhene Andri Faik Ymeri sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI	-	
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	0	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-457,965	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri	0	
3.6	Kthimi I Huadhenies marre babait (ne vitin 2008), provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , kthy para dt 31 korrik	-400,000	
3.7	Kthim huadhenie nga vellai Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,	0	
3.8	Marre overdraft	148,965	
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2012	0	
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit	0	
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000	0	
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT	0	
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	0	
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	0	

Për vitin 01/01/2011- 31/12/2011		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,380,145**
5	**Shpenzimet**		**580,707**
5.1	Shpenzime jetese	409,860	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke	64,985	
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke		
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke		
5.5	Shpenzime mobilimi	17,800	
5.6	Shpenzime udhetimi	88,062	
5.7	Shpenzime shkollimi		
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€		
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008		
5.91	Shpenzime dasme 2008		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**4,202,084**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**5,613,857**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**(321,335)**

Në cmuarjen e bilancit negativ që rezulton për këtë vit mendoj se Komisioni duhet të vlerësonte zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe të barazisë pasi ai nuk mund të konsiderohet si shkak për të cmuar se unë kam bërë deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë, për shkak të të cilit Komisionit me pa të drejtë ka aplikuar nenin 61/1 të ligjit 84/2016, duke më shkarkuar. Ky qëndrim i imi gjen zbatim edhe në praktikën e KPA në rastin e subjektit të rivlersimit Ramiz Lala, ku balanca negative e konstatuar, e cila ishte thuajse tre herë më e madhe se imja nuk u vlerësuar si shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

10 <u>Në lidhje me bonot e thesarit të depozituara me datën 05.04.2012 në vlerën 900,000 lekë nga ana e Komisionit është arritur ne konkluzionin se për të krijuar kursimet në vlerën 750.000 lekë unë jam në balancë negative në shumën 452,500.47 lekë, shpjegoj:</u>

Nga verifikimi i DVP të vitit 2011 unë kam konstatuar se kam bërë një gabim ne deklarim, i cili lidhet me faktin se në këtë DPV kam shënuar se në fund të këtij viti kam marrë një kredi bankare

në vlerën 800.000 lekë. Si rrjedhojë e këtij deklarimi në DPV kam deklaruar gjendje cash kursime në vlerën 750.000 lekë.

Nga verifikimi i të dhënave bankare kam konstatuar se kredia për të cilën unë kam aplikuar në fund të vitit 2011 më është dispursuar nga banka më 20 janar të vitit 2012 në vlerën 796.000, nga e cila unë kam terhequr shumën 760.000 lekë. **Fakti i dispursimit të kësaj kredie në këtë datë (20.01.2012) rezulton edhe nga informacioni i marrë nga Komisionit pranë BKT, pikërisht në fq 36 të Rezultateve të përfundimit të hetimit administrativ.** Në fund të vitit 2011 unë nuk kam dispozuar cashin e deklaruar, por këtë shumë e kam disponuar pas marrjes së kredisë në 20 janar të vitit 2012.

Gabimi në bërien e këtij deklarimi lidhet me kohën e plotësimit të DPV e cila është në mars të vitit 2012, kohë kur unë e kisha marrë kredinë dhe isha në dieni të gjendjes cash në shtëpi në atë kohë. Ky gabim i kryer nga ana ime duket qartë bazuar në mënyrën e plotësimit të DPV-së të vitit 2011 dhe të dhënave bankare pranë BKT mbi kohën e aplikimit dhe disbursimit të kredisë.

Duke evidentuar këtë fakt i kam kërkuar Komisionit, që me mbrojtjen time të dërguar për rezultatin e hetimeve të muajit prill 2022, që në analizën financiare të blerjes së bonos për datën 05.04.2012 të përfshihet edhe kredia bankare e marrë pranë BKT në vlerën 800.000 lekë me datën 20.01.2012, fakt që rezulton qartësisht nga të dhënat bankare të marra edhe nga ana juaj nga BKT.
Njëkohsisht me paraqitjen e kësaj kërkese llogjikisht i kam kërkuar Komisionit që në analizën financiare të vitit 2011 të mos përfshijë si kursim vlerën 750.000 lekë të cilën unë e kam deklaruar gabimisht.

Konstatoj se pavarsisht kësaj kjo kërkesë e imja nuk është reflektuar në analizën financiare dhe raport, pavarsisht faktit se gabimi im në këtë drejtim konstatohet lehtësisht.

Në lidhje me këtë kërkesë timen Komisioni shprehet: "***Shkalla e njohjes që subjekti dëshmon për procesin e rivlerësimit në tërësi, normat, rregullat dhe metodologjinë për kryerjen e tij nga organet e rivlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, përmes parashtrimeve në prapësime për rezultatet e hetimit administrativ, si dhe çdo komunikimi përgjatë hetimit administrativ, përjashton mundësinë e paqartësive në lidhje me rëndësinë e deklarimeve të kryera prej tij në procesin e rivlerësimit, por edhe në deklaratat periodike. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson të mos marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, i cili nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes cash87 në shumën 452,500.47 lekë në vitin 2011.".***

Këtë qëndrim të Komisionit e konsideroj tërësisht abuziv, pasi fakti i pretenduar nga ana ime nuk përbën një tentativë time për t'u shmangur nga përgjegjësia apo për të përmirsuar gjendjen financiare, por përbën një situatë faktike qartësisht e dukshme nga të dhënat bankare të marra edhe nga ana e Komisionit. Deklarimi i kësaj kredie si e ardhur e marrë në fund të vitit 2011, ndërkohë që faktikisht ajo është dispusuar në janar 2012 qartësisht duket se është një gabim njerëzor i kryer nga ana ime, i cili si rregull nuk mund të më sjellë pasoja në procesin e rivlersimit, për shkak se dukshëm ai përbën një pasaktësi, e cila nuk mund të mos merret parasysh. Përdorimi nga Komisioni i shprehjeve të tilla "shkalla e njohurive të subjektit për

procesin etj...” pa tentuar që ti japë një përgjigje logjike pretendimeve të mia pasqyron dashakeqsinë dhe mungesën totale të tij për të mirëkuptuar situatën time financiare dhe gabimet që unë ashtu si dhe shumë subjekte të tjerë rivlersimi kemi bërë gjatë deklarimeve periodike vjetore.

Nga analiza financiare që Komisioni ka bërë për mundësinë e krijimit të shumës 750.000 evidentoj se ajo i është referuar vitit 2011 dhe nuk ka marrë në konsideratë shpjegimin e dhënë më lart nga ana ime se shuma 750.000 **nuk është kursim i vitit 2011**, por është shuma e krijuar pas marrjes së kredisë (disporsimit) të saj në vitin 2012. Theksoj edhe një herë se për këtë kredi pranë BKT unë kam aplikuar në fund të vitit 2011 dhe pas miratimit kredia më është dispursuar në janar 2022. Ka qenë pikërisht shuma e krijuar nga kjo kredi që ka shërbyer në masën më të madhë në krijimin e shumës me të cilën janë blerë bonot e thesarit në datën 05.04.2022. Theksoj se analiza financiare e bërë nga Komisioni në lidhje me krijimin e këtyre bonove është e gabuar.

Më poshtë po paraqes analizën financiare e cila pasqyron të ardhurat e mia dhe bashkëshortes deri datën e blerjes së bonove të thesarit të datës 05.04.2012, analizë e cila përfshin edhe shumën e kredisë të marrë në janar 2012.

Analiza financiare 05/04/2012

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 900,000 leke - 05/04/2012

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 01.01.12 - 05.04.12	493,586
Te ardhura nga dietat Andri Ymeri 01.01.12 - 05.04.12	17,000
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 01.01.12 - 05.04.12	173,154
Likuiditete te hyra nga Kredia Andri Ymeri ne Bkt dt 20.01.2012 , NEË LOAN (kredi e re) marre 796.000 terheq ne cash 760.000	796,000
Te ardhura totale 01.01.12 - 05.04.12	**1,479,740**
Shpenzime jetese 3 persona 01.01.12 - 05.04.12	104,661
Shpenzime pre shlyerje kredie Tirana Bank 01.01.12 - 05.04.12	130,738
Shpenzime pre shlyerje kredie BKT 01.01.12 - 05.04.12	0
Shpenzime pre shlyerje interes kredie Bkt 01.01.12 - 05.04.12	11,027
Shpenzime udhetimi 01.01.12 - 05.04.12	48,203
Shpenzime mobilimi 01.01.12 - 05.04.12	17,800
Blerje bono thesari	
Ndryshim likuiditeti 31.12.11 - 05.04.12	**918,453**
Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH	**5,613,857**
Mjete Monetare me 05.04 2010 ne llogari Bankare dhe CASH	**6,532,310**
Pamundesi financiare	**248,858**

Nga analiza financiare që më keni vënë në dispozicion për mundësinë e blerjes së bonove të thesarit të datës 05.04.2012 del qartë se edhe nga ana juaj është konstatuar se unë jam me balancë pozitive në vlerën 314,910.10 lekë.

11 **<u>Në lidhje me bonot e thesarit të depozituara me datën 23.07.2012 ,</u>**në vlerën 930.000 lekë nga ana e Komisionit është arritur ne konkluzionin se: ***"54.12. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2012, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -238,530.87 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016",*** shpjegoj:

Evidentoj faktin se nga analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit në burimet e të ardhurave të mia deri datë në depozitimit të bonove të thesarit nuk është llogaritur huaja marrë kushëririt Olsi Ymeri për këtë vit në vlerën 5000 euro.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre bonove në përgjigjen e pyetësorit të tretë unë kam deklaruar: *Për bonon e thesarit për të cilën me datën 23.07.2012, për të cilën janë derdhur cash 930.000 lekë, ju sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim:*

***1**. Akumulimi i kursimeve familjare deri në këtë datë, pra deri në datën 23.07.2012.*
+
***2**. 5000 euro që ia kam marrë borxh djalit të xhaxhait tim Olsi Ymeri. Në lidhje me këtë borxh, në përgjigjet e pyetësorit standart jam shprehur se "...Rreth muajit prill të vitit 2012, unë kam qënë në Itali bashkë me bashkëshorten time. Aty kam takuar djalin e xhaxhait tim të quajtur Olsi Kujtim Ymeri, që së bashku me familjen e tij, jeton që nga viti 1995 në qytetin e Breshias, Itali. Atij, i kam marrë hua, atje, shumën prej 5000 (pesëmijë) Euro. Qëllimi se përse ia kam marrë këtë hua, ka qënë se kam dashur të blej një automjet (të përdorur), në Itali apo Gjermani, pasi sikurse është e njohur botërisht, po të blihet një automjet jashtë shtetit, merret në një gjendje më të mirë teknike si dhe më çmim më të favorshëm. Burimi i kësaj huaje që më ka dhënë shtetasi Olsi Ymeri në atë, kohë, kanë qënë të ardhurat dhe/apo kursimet familjare të familjes së tij, ndër vite. Për të vërtetuar këtë huamarrje nga ana ime, ju bëj me dije se do t'iu paraqes një dekleratë noteriale të shtetasit Olsi Ymeri, se bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton mundësinë e tij dhe të familjarëve të tij, për të më dhënë, në atë kohë, hua, shumën e parave, të lartëpërmëndur. Por ju bëj me dije, se unë akoma nuk e disponoj këtë dokumentacion, për shkak të kohës së shkurtër që kam patur në dispozicion si dhe për shkak të faktit së shtetasi Olsi Ymeri dhe familja e tij, vazhdojnë të banojnë në Itali. Gjithashtu, ju bëj me dijë se huanë në fjalë, e kam shlyer, brënda vitit 2012, disa muaj pasi e kam marrë. Kjo pasi nuk e kam blerë automjetin që kam patur për qëllim për të blerë në kohën e marrjes së huasë. Faktin e marrjes së huasë dhe kohën e shlyerjes së saj, e kam deklaruar në dekleratën periodike të pasurisë, që është dorëzuar prej meje në ILDKPKI, në periudhën korresponduese…. ". Po në lidhje me këtë borxh që kam marrë tek Olsi Ymeri, në DPV 2012, të plotësuar në datën 15.03.2013, jam shprehur se "..5000 euro që ia kam marrë borxh djalit të xhaxhait Olsi Kujtim Ymeri (me banim në Itali), në muajin maj, (kur kam qënë në Itali), të cilin nuk e kam blerë dhe ia kam kthyer përsëri në muajin dhjetor…".*
+
***3**. interesat e bonos së thesarit të datës 05.04.2012.*

Ndodhur në kushtet që unë i kam vënë në dispozicion Komisionit akte që provojnë marrjen e kësaj huaje kushëririt tim Olsi Ymeri dhe që provojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij (mbi dyqind mijë euro) konstatoj se Komisioni ka gjetur një justifikim tjetër për të mos më njohur këtë hua, në funksion të thellimit të bilancit negativ të personit tim. Tashmë argumenti i Komisionit është *"se shpjegimet e kusheririt tim në deklaratë noteriale nuk përputhen me shpjegimet e mia në formularin standart dhe me të dhënat e sistemit TIMS" dhe se "**54.11. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk është provuar marrja e kësaj shume, si dhe subjekti ka depozituar një deklaratë që nuk përmban të dhëna të sakta e të provuara, huaja në shumën 5,000 euro nuk do të përfshihet si burim për blerjen e bonove të thesarit."***

- Në lidhje me këto argumente të Komisionit theksoj se nuk është e vërtetë se deklarimet e mia me pyetësorin standart kanë kundërthënie më deklarimet e kushëririt tim me deklaratë noteriale. Në vlerësimin e përputhshmërisë së këtyre deklarimeve duhet të kihet në konsideratë fakti se nga momenti i ndodhjes se faktit kanë kaluar 10 vjet dhe se kusheriri im nuk ka qenë i detyruar të mbajë mend cdo detaj që lidhet me këtë takim. Theksoj se përkundrazi, nëse deklarimet në mes nesh do të ishin identike kjo duhet të vlerësohej si një fakt që vë në dyshim vërtetësinë e faktit të pasqyruar me to.
- Pavarsisht kësaj theksoj se deklarimet e mia me pyetësorin standar me ato të kushëririt tim me deklaratë noteriale janë në përmbajtje të njëjtë dhe pasqyrojnë të njëjtin fakt, ndryshe nga sa pretendon Komisioni pa të drejtë.
- Deklarimet e kusheririt tim nuk janë në kundërshtim me të dhënat e sistemit TIMS pasi nëse kushëriri ka deklaruar se unë kam shkuar në Itali në periudhën prill-maj, të vitit 2012 nga sistemi TIMS rezulton se unë kam shkuar në Itali me datën 13.04.2012 dhe jam kthyer me 16.04.2012. Fakti që kushëriri im e përcakton kohën e shkuarjes time në Itali me përafërsi pasqyron faktin se ai tregon të vërtetën e asaj që ka ndodhur. Kujtoj se ai nuk ka qenë i detyruar të mbaj mend cdo detajë që lidhet me udhetimin tim në këtë shtet, detyrim që më përket mua si subjekt rivlersimi dhe jo atij, i cili nuk ka asnjë detyrim të bëj deklarim.
- Theksoj gjithashtu se shuma 5000 euro që unë i kam marrë hua kushëririt tim Olsi Ymeri ka shërbyer për krijimin e bonos së dytë të vitit 2012 dhe pikërisht atë të datës 23.07.2012 dhe jo bonos së parë të datës 05.04.2012. Edhe në këtë drejtim evidentoj faktin se nuk ka asnjë kundërshti në mes deklarimit të kushëririt tim dhe të dhënave në sistemin TIMS.
- **Për të vërtetuar pretendimet e mia për marrjen e kësaj huaje kusheririt tim i kam kërkuar Komisionit pyetjen e tij me cilësinë e dëshmitarit, kërkesë e cila është refuzuar ma asnjë vendim. Mendoj se ky qëndrim i Komisionit është i paligjshëm dhe jo korrektë dhe mbi këtë bazë vijoj t'i qëndroj kësaj kërkese, duke i kërkuar Kolegjit pyetjen kushëririt tim Olsi Ymeri përpara tij.**

Më poshtë po paraqes analizën financiare të mundësisë së krijimit të bonos në datën 23.07.2012 dhe analizën financiare të vitit 2012 në tërësi.

Analiza financiare 23/07/2012

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 930,000 leke - 23/07/2012

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 05.04.12 - 23.07.12	398,914

Te ardhura nga dietat Andri Ymeri 05.04.12 - 23.07.12	27,000
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 05.04.12 - 23.07.12	125,249
Te ardhura nga interesi nga Bono Thesari dt. 12.04.12	177,252
Hyrje borxhi nga Babai 801000 leke ne bkt me dt 23.07.2012	801,000
Hua nga Olsi Ymeri - 5,000€, 13-16 prill 2012 *139.93	698,600
Te ardhura totale 05.04.12 - 23.07.12	**2,228,015**
Shpenzime jetese 3 persona 06.04.12 - 23.07.12	139,548
Shpenzime pre shlyerje kredie Tirana Bank 06.04.12 - 23.07.12	174,317
Shpenzime udhetimi 06.04.12 - 23.07.12	69,860
Shpenzime mobilimi 06.04.12 - 23.07.12	
Shpenzime per shlyerje kredie Bkt 06.04.12 - 23.07.12	800,000
Shpenzime pre shlyerje interes kredie Bkt 01.01.12 - 05.04.12	25,611
Ndryshim likuiditeti 05.04.12 - 23.07.12	882,256
Pamundesi financiare	**136,423**

Analiza financiare 31/12/2012

Subjekti deklaron se këtë hua prej 5,000€, ia ka kthyer Olsi Ymerit në dhjetor 20

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 23.07.12 - 31.12.12	523,938
Te ardhura nga paga Andri Ymeri tek Argenti 23.07.12 - 31.12.13	28,247
Te ardhura nga dietat + shperblim Andri Ymeri 23.07.12 - 31.12.12	20,000
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 23.07.12 - 31.12.12	227,585
Te ardhura nga interesi nga Bono Thesari dt. 06.08.12	247,128
Te ardhura totale 23.07.12 - 31.12.12	**1,046,898**
Shpenzime jetese 3 persona 23.07.12 - 31.12.12	174,435
Shpenzime pre shlyerje kredie Tirana Bank 23.07.12 - 31.12.12	177,254
Shpenzime udhetimi 23.07.12 - 31.12.12	0
Shpenzime mobilimi 23.07.12 - 31.12.12	
Shpenzime per shlyerje kredie Bkt 23.07.12 - 31.12.12	0
Shpenzime pre shlyerje interes ne Bkt 01.01.12 - 31.12.12	363
Ndryshim likuiditeti 23.07.12 - 31.12.12	66,025
Kthim hua 5,000€ Olsi Ymerit	698,600
Pamundesi financiare likuiditeti	**-69,778**

Analiza financiare 2012

Për vitin 01/01/2012- 31/12/2012		**Vleresim i ekspertit**
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**
1	**Të ardhurat**	**2,523,900**

Për vitin 01/01/2012- 31/12/2012		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2012 - 31.12.12, + argenti trem 4	1,530,759	
1.2	Te ardhura nga puna bashkeshortja Arlinda Ymeri 01 janar 2012 - 31.12.12	568,761	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01 janar 2012 - 31.12.12	-	
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita	-	
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 01 janar 2012 - 31.12.12	424,380	
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit		
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra		
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku		
1.91	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja		
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
3	**Detyrimet**		**276,841**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	-	
3.2	Dhene Andri Faik Ymeri sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI	-	
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	0	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-460,959	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri	0	
3.6	Kthimi I Huadhenies marre babait (ne vitin 2008), provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , kthy para dt 31 korrik	0	
3.7	Kthim huadhenie nga vellai Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,	0	
3.8	Marre overdraft	0	
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat	800,000	

Për vitin 01/01/2012- 31/12/2012		Vleresim i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
	maturimi 20.07.2012		
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit	-800,000	
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000	800,000	
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT	-400,000	
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	400,000	
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	-62,200	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,523,900**
5	**Shpenzimet**		**770,602**
5.1	Shpenzime jetese	418,644	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi ProCredit - 400,000 leke	12,292	
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke	40,637	
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke	21,349	
5.5	Shpenzime mobilimi	17,800	
5.6	Shpenzime udhetimi	259,879	
5.7	Shpenzime shkollimi		
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€		
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008		
5.91	Shpenzime dasme 2008		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**5,613,857**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**6,730,591**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**913,405**

12 **Në lidhje me bonot e thesarit të depozituara me datën 29.03.2013 ,** në vlerën 350.000 lekë nga ana e Komisionit është arritur në konkluzionin se në lidhje me to rezultoj në pamundësi financiare në vlerën **6,500 lekë, të cilën e konsideron të papërfillshme,** shpjegoj se edhe në lidhje me këtë bono unë nuk jam me bilanc negativ.

Evidentoj faktin se nga analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit në burimet e të ardhurave të mia deri datën e depozitimit të bonove të thesarit vazhdojnë të mos llogariten kursimet nga

viti 2012, si dhe të ardhurat e realizuara nga puna ime si pedagog i jashtëm pranë Universitetit "Argenti" Shkodër dhe puna e bashkëshortes time në vlerën 70.000 lekë si pedagoge e jashtme pranë Universitetit Luigj Gurakuqi, të ardhura të deklaruara nga ana ime në DPV.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre bonove në përgjigjen e pyetësorit të tretë unë kam deklaruar: *Për bonon e thesarit për të cilën me datën 29.03.2013, për të cilën janë derdhur cash 350.000 lekë, ju sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim akumulimi i gjendjes cash të vitit paraardhës (120.000 lekë) + me kursimet familjare.*

Shpjegoj së bazuar në DPV e vitit 2013, fq 4 unë kam shënuar si të ardhura nga puna si pedagog i jashtëm, pranë Universitetit "Argenti" Shkodër vlerën 111,600 lekë.

Nga Komisioni është arsyetuar se këto të ardhura të pretenduara nuk llogariten në analizën financiare për shkak se nuk u provua vlera e tyre. Mendoj se ky arsyetim i Komisionit është i gabuar dhe ka ardhur si rrjedhojë e faktit se nga Komisioni nuk është administruar dosja e plotë e imja pranë ILDKPKI, ku me procesverbalin e datës 16.02.2015 unë i kam dorëzuar ndihmës inspektorit Alndrin Nano një akt shkresor që provon vlerën e të ardhurave të marra nga ushtrimi i kësaj veprimtarie. Nga ILDKPKI kam marrë vërtetimin e depozituar nga ana ime me procesverbalin e datës 16.02.2015, dhe konkretisht verëtimin me numër 454 prot, të datës 26.11.2013 të Kolegjit Profesional Argenti, Shkodër, nga i cili rezulton marrja e kësaj vlere monetare nga ana ime.

Fakti i ushtrimit të detyrës së pedagogut të jashtëm në Universitetin "Argenti" Shkodër mund të vërtetohej nga Komisioni edhe nëpërmjet vendimeve të KLD për dhënie leje për mësimdhënie për vitin 2013, nga ku rezulton qartë emri im dhe universiteti ku une do të jepja mësim (bashkalidhur Komisionit i kam dërguar një printim të kësaj fq). **Kam konstatuar se Komisioni nuk ka kryer asnnjë veprim në këtë drejtim.**

Nëse nga ana e Komisionit do të llogariten kursimet dhe të ardhurat nga aktiviteti mësimdhënës si dhe kursimet deri në datën e depozitimit të bonove të thesarit do të rezultojë qartë se unë nuk jam me balancë negative në lidhje me krijimin e këtyre bonove.

Analiza financiare* BTH *29/03/2013

Analiza e mundesise se investimit ne BTH - 350,000 leke - 29/03/2013

Pershkrimi	Vleresim i ekspertit
Te ardhura nga paga Andri Ymeri 01.01.13 - 29.03.13	375,827
Te ardhura nga paga Arlinda Ymeri 01.01.13 - 29.03.13	210,565
Te ardhura nga paga Argenti Andri Ymeri 01.01.13 - 29.03.13	41,676
Te ardhura totale 01.01.13 - 29.03.13	**628,068**
Shpenzime jetese 3 persona 01.01.13 - 09.03.13	105,768
Shpenzime per shlyerje kredie Pro Credit Bank 01.01.13 - 29.03.13	54,369
Shpenzime mobilimi	17,800
Ndryshim likuiditeti 31.12.12 - 09.03.13	422,365

Pamundesi financiare	**27,766**	

Analiza financiare 31/12/2013

Për vitin 01/01/2013- 31/12/2013		**Vlersimi i ekspertit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**2,401,524**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 01 janar 2013 - 31.12.13	1,393,651	
1.2	Te ardhura nga puna bashkeshortja Arlinda Ymeri 01 janar 2013 - 31.12.13	681,424	
1.3	Te ardhura nga raporta bashkeshortja Arlinda Ymeri 01 janar 2013 - 31.12.13	-	
1.4	Te ardhura nga interesat raif bank nga depozita 01 janar 2013 - 31.12.13	-	
1.5	Te ardhura nga interesat ne bono thesari 01 janar 2013 - 31.12.13	326,449	
1.6	Te ardhura nga dhurimet e te ftuarve dasmes dhe lindja djalit		
1.7	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit vjehrra		
1.8	Te ardhura nga dhurimet e dasmes dhe lindja djalit Faiku		
1.91	Te ardhura nga pasuri para martese nga bashkeshortja		
1.92	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 30.10.08		
1.93	Te ardhura nga ekzekutimi i vendimit Gjyq. Per Elvira Ymeri - 2008		
1.94	Te ardhura nga prinderit dhe miqte e te afermit per lindjen e vajzave		
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**-**
2.1	Automjet Benz AA993NZ - 2016	-	
3	**Detyrimet**		**(597,158)**
3.1	Derdhur nga Arlinda ne llogarine e depozites Raiffeissen bank, si pasuri paramartesore 1.000.000 leke.	-	
3.2	Dhene Andri Faik Ymeri sipas deklarates dhe memos te dt 13.02.2015 dorzuar ILDKPI	-	
3.3	Kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri	-	
3.4	Likuidim Kredi Tirana Bank nga marr- 1,500,000 leke - 2009 - Andri Ymeri+Arlinda likuidu ne 2009	-	
3.5	Huadhenie vellait Gerti Ymeri		

Për vitin 01/01/2013- 31/12/2013		Vlersimi i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
		-	
3.6	Kthimi I Huadhenies marre babait (ne vitin 2008), provuar kthimi me deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 , kthy para dt 31 korrik		
3.7	Kthim huadhenie nga vellai Gerti Ymeri,provuar me proces verbal deklarimi para ILDKPI dt 16.11.2011 dhe deklarat noteriale rep 380.kol 139 dt 16.02.2015 ,		
3.8	Marre overdraft		
3.9	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2012		
3.91	Kredi marre Bkt nga Andri Ymeri me 20.01.2012 me afat maturimi 20.07.2013, shlyer nga Faik Ymer ne perfundim te afatit		
3.92	Si rezultat I dy veprimeve te para Andri I ka borxh faik Ymeri 800.000		
3.93	Shlyer kredine (borxh) 50 % e Faik Ymeri , I cili shleu kredin ne BKT	-400,000	
3.94	Kredi ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri		
3.95	Pagese Kredie ProCredit Bank - 400,000 leke - 2012 - Andri Ymeri	-197,158	
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,401,524**
5	**Shpenzimet**		**499,162**
5.1	Shpenzime jetese	423,072	
5.2	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi ProCredit - 400,000 leke	20,474	
5.3	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi BKT - 2012 - 800,000 leke		
5.4	Shpenzime interesi, disbursimi per kredi Tirana Bank - 1,500,000 leke	23,795	
5.5	Shpenzime mobilimi	17,800	
5.6	Shpenzime udhetimi	14,021	
5.7	Shpenzime shkollimi		
5.8	Shpenzim mjekesore Elvira Ymeri - korrik 2008 - 6,000€		
5.9	Dhuruar subjektit per dasem nga babai - 2008		
5.91	Shpenzime dasme 2008		
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**6,730,591**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		

Për vitin 01/01/2013- 31/12/2013		Vlersimi i ekspertit
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**
		7,758,725
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**	**277,070**

13 **Në lidhje me shtëpinë e banimit me adresë"L. "Vasil Shanto", Bulevardi "Zogu i Parë", Pall 968, Shkodër**, ku Komisioni ka vlerësuar: ***"59.9. Në përfundim, në lidhje me këtë banesë, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -383,137.94 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016."*** shpjegoj:

Në lidhje me këtë konkluzion evidentoj se bilanci negativ i nxjerrë për blerjen e kësaj banese ka ardhur si rrjedhojë e mosnjohjes nga Komisioni të të gjitha burimeve të të ardhurave të familjes time.

Rishpjegoj se banesa në pronësi të prindërve të mi ka pasur këto burime të ardhurash:

- a. Shumën prej 200.000 (dyqindmijë) lekë e kursyer nga unë gjatë vitit 2003. Shih faqet 8 dhe 9 të DPV 2003.
- b. Pagat mujore që kam marrë si gjyqtar nga data 1 janar 2004 dhe deri në datën e blerjes së pasurisë 22.07.2004, pra për 7 muaj.
- **c. Pagat mujore që ka marrë si prokurore motra ime Ajola Prençi, nga data 1 janar 2004 deri në kohën e blerjes së banesës në datën 22.07.2004. Mesa mbaj mend motra është martuar në shtator 2004.**
- ç. Kursimet e motres time nga paga e saj si prokurore, pën periudhën 01.10.2003 - 31.12.2003, paga te cilat ajo si dhe une ia kemi dorezuar babait tone.
- d. Pensioni i babait për vitin 2004 (shtatë muaj).
- dh. Paga e nënës si mësuese, për vitin 2004, për shtatë muaj.
- **f. Prindërit e mi, kanë shitur në vitin 1999 një banesë që kanë patur në bashkëpronësi, në fshatin Bushat Shkodër, në shumën 430.000, të ardhurat e të cilës nuk janë konsideruar nga Komisioni si burim të ardhush, me pretendimin se unë kam deklaruar kursime në DPV e vitit 2003 shumën 200.000 lekë. Këtë qëndrim të Komisionit e konsideroj të padrejtë, pasi deklarimi i kursimeve nga ana ime është bërë vetëm për të ardhurat e mia, si subjekt rivlersimi dhe jo për kursimet e të gjithë familjes time. Kujtoj se prindërit e mi nuk ishin subjekt rivlersimi dhe nuk kishin asnjë detyrim të deklaronin kursime.**
- g. Kursimet e prindërve, nga pensionet, rrogat, puna që ka bërë babai si shitës ambulant duke filluar nga koha kur ka dalë në reserve si ish ushtarak, (viti 1992). Po ashtu, kursimet nga pagat që unë dhe motra kemi përfituar si student të shkollës së magjistraturës, për periudhën 2001-2003, (50% të pagës bruto të gjyqtarit të shkallës së pare të asaj kohe).
- gj. Të ardhurat që ka fituar babai im si shitës ambulant në tregun e Tuzit, Mal të Zi, për periudhën 1998-2003, përafërsisht 5000 Marka gjermane, etj. Lidhur me këtë mund të kërkohet informacion nga Drejtoria e Kufirimit të Migracionit në Policinë e Shtetit, lidhur me daljet dhe hyrjet e Faik Fetah Ymeri nga Pika e kalimit Kufitar Hani i Hotit, për këtë periudhë kohe.
- h. Bursa vjetore që kam përfituar unë si shpërblim për qënien time student me të gjitha 10-ta për vitin e parë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, etj.

Në përmbledhje: mund t'iu deklaroj dhe të shpjegoj sa më poshtë:

- 1. Gjatë vitit 2004, familja ime e origjinës, ka blerë apartamentin në shumën 1.000.000 (njëmilion) lekë, si dhe kanë kursyer një gjendje cash prej 200.000 (dyqindmijë) lekë (shih faqen 3 të DPV 2004).
- 2. Të ardhurat familjare për vitet 1992 (që është koha kur babai ka dalë në rezerve si ish ushtarak) deri në kohën që është blerë apartamenti, janë më se të mjaftueshme për të siguruar shpenzimet e jetesës dhe blerjen e apartamentit.
- 3. Gjithsesi, edhe po të llogariten vetëm të ardhurat nga pagat që kemi përfituar për vitet 2003, 2004, unë, motra ime, nëna ime, pensioni i babait tim për vitet 2003, 2004, të ardhurat nga shitja e apartamentit në Bushat Shkodër, në shumën 430.000 lekë, për të cilën u shpreha më sipër, si dhe gjendja cash e kursyer nga unë, në vitin 2003, (*shih DPV 2003, ku unë në fq 8 shprehem se vetëm unë kam kursuer nga pagat shumën prej 200.000 lekësh*), duket qartë se deklarimi im në DPV 2004, se familja ime e origjinës ka blerë apartamentin në shumën 1.000.000 (njëmilion) lekë, si dhe ka kursyer cash 200.000 (dyqind mijë) lekë, jo vetëm mbulohet me të ardhura të ligjshme, por edhe tejkalohet.

Nga analiza financiare që më është vënë në dispozicion nga ana juaj për mundësinë e blerjes së këtij apartamenti nga familja ime evidentoj se nuk është llogaritur paga e motrës time Ajola Prenci (Ymeri). Pavarsisht se në faqen 41 të raportit "Rezultatet e hetimit administrativ" citohet se të ardhurat e llogaritura në analizë financiare janë edhe ato të motrës deri në tetor 2004 qartësisht evidentohet fakti se në analizën financiare Komisioni nuk përfshin pagën e motrës për 4 muaj, ku vetëm paga e saj shkon ne vlerën 496,142 lekë.

Këtë pretendim unë e paraqita edhe në seancën dëgjimore, por mesa konstatoj nga analiza financiare e mundësisë së blerjes së kësaj banese në vendin evidentoj faktin se për motrën time Komisioni nuk ka llogaritur të ardhura monetare nga paga, pavarsisht faktit se ajo ka jetuar me familjen tonë deri në vjeshtën e vitit 2004 kur është martuar dhe paga që ajo ka marrë ka qenë pjesë e buzhetit familjar të familjes sonë.

Më poshtë po paraqes analizat financiare të familjes time për vitet 2003, 2004 dhe mundësinë e blerjes së apartamentit nga babai im.

Analiza financiare per periudhen 2001-2003

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2003		**Vlersimi i ekspertit**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**2,431,689**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 2001 - 31.12.2003	741,433	
1.2	Te ardhura nga pensioni i babait Faik Ymeri 2001 - 31.12.2003	346,526	

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2003		Vlersimi i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 31.12.2003	556,307	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 2001 - 31.12.2003	787,423	
1.5	Te ardhura Gerti Ymeri nga bursa Universiteti L.Gurakuqi	-	
1.6	Te ardhura nga aktiviteti privat Faik Ymeri pa vend fix ushtrimi te aktivitetit	-	
1.7	Te ardhura nga dhenia me qera e tokes nga Faik Ymeri tek Sheuqet Geci ,deklarate noteriale dt 16.02.2015, sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	-	
1.8	Te ardhura Gerti Faik Ymeri nga asistent avokat dhe shitje fruta perime ,sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	-	
1.9	Te ardhura nga aktiviteti privat P/F legalizim dokumentash nga Faik Ymeri , sipas shkreses tatimore ….., sipas deklarimeve te subjektit te rivleresimit	-	
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**(430,000)**
2.1	Te ardhura nga shitja e shtepise Bushat, Rep 217, Kol 70 date 17.04.2000	(430,000)	
2.2	Apartament 73 m2 L. S. Halili, Shkoder	-	
2.3	Apartament 111 m2 Rr. A. Gj. Fishta, Shkoder - Faik Ymeri - 2006		
2.4		-	
3	**Detyrimet**		**-**
3.1	Borxhe te marra nga Xheladin Cuf Thana, janar -mars 2006	-	
3.2	Borxhe te marra nga Fahri Fetah Ymeri, janar -mars 2006	-	
3.3	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi 1,500,000 leke 2006 - 2007	-	
3.4	Dhene Fahri Fetah Ymeri 2,000,000 leke 2006	-	
3.5	Dhene Xheladin Thanes nga borxhi prej 1,500,000 leke 2006 - 2007		
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2003		Vlersimi i ekspertit	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**	
			2,861,689
5	**Shpenzimet**		**1,623,800**
5.1	Shpenzime jetese	1,443,800	
5.2	Shpenzime qiraje	180,000	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**-**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**200,000**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**1,037,889**

Analiza financiare mbi mundesine e blerjes se apartamentit 73 m^2

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2003, 01/01/2004-20/07/2004		Vlersimi i ekspertitt, 01.01.2001-2003		Vlersimi i ekspertit, 01.01.2004-20.07.2004	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**		**LEKE**	
1	**Të ardhurat**		**2,431,689**		**1,196,576**
1.1	Te ardhura nga puna subjekti Andri Ymeri 2001 - 20.07.2004	741,433		512,925	
1.2	Te ardhura nga puna dhe pensioni i babait Faik Ymeri 2001 - 20.07.2004	346,526		74,591	
1.3	Te ardhura nga puna nena Elvira Ymeri 2001 - 20.07.2004	556,307		112,919	
1.4	Te ardhura nga puna motra Ajola Ymeri Prenci 2001 - 20.07.2004	787,423		496,142	
1.5					
2	**Ndryshimi i pasurisë**		**(430,000)**		**570,000**
2.1	Te ardhura nga shitja e shtepise Bushat, Rep 217, Kol 70 date 17.04.2000	(430,000)		(430,000)	

Për vitin 01/01/2001- 31/12/2003, 01/01/2004-20/07/2004		**Vlersimi i ekspertitt, 01.01.2001-2003**		**Vlersimi i ekspertit, 01.01.2004-20.07.2004**	
Nr	**ANALIZA FINANCIARE**	**LEKE**		**LEKE**	
2.2	Apartament 73 m2 L. S. Halili, Shkoder, blere 20.07.2004			1,000,000	
2.3					
3	**Detyrimet**		**-**		**-**
3.1					
4	**Ndryshimi i pasurisë netto**		**2,861,689**		**626,576**
5	**Shpenzimet**		**1,623,800**		**309,062**
5.1	Shpenzime jetese 2001 - 2004	1,443,800		274,062	
5.2	Shpenzime qiraje 2001 - 2004	180,000		35,000	
6	**Mjete Monetare ne fillim te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**-**		**200,000**
7	**Mjete Monetare ne fund te vitit ne llogari Bankare dhe CASH**		**200,000**		**100,000**
8	**DIFERENCA (Te Ardhura - Shpenzimet) (1-2+3-5+6-7)**		**1,037,889**		**417,514**

Në lidhje me konstatimin përfundimtar të Komisionit; ***"60. Në lidhje me analizën financiare 91 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për pamundësi financiare në shumën 2,746,975 lekë nga fillimi i detyrës deri në momentin e martesës dhe në shumën 1,817,804.62 lekë nga momenti i martesës deri në deklaratën Vetting. ....Për sa më sipër, subjekti nga fillimi i detyrës deri në deklaratën Vetting ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 4,506,279.70 lekë, në kuptim të nenit nr. 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016."***

Për këtë konstatim përmbledhëz jam shprehur si në atë pjesë të ankimit të titulluar shkaqet e ankimit (për rrjedhojë nuk dëshiroj të bie në përsëritje) ashtu edhe në këtë pjesë të ankimit.

Përmbledhtaz vlerësoj se balanca negative prej 2,746,975 lekë nga fillimi i detyrës deri në momentin e martesës, nuk qëndron, është pasojë e mosllogaritjes së burimeve të ligjshme të anëtarëve të familjes time të origjinës, si dhe përveç kësaj, edhe nëse do konsiderohej e tillë, (gjë që e riktheksoj që është e paligjshme), kjo balancë negative nuk ka të bëjë as me mua dhe as me persona të lidhur me mua por i referohet të gjithë anëtarëve të familjes time të origjinës. Për

rrjedhojë në zbatim të parimit të proporcionalitetit, kjo balancë për periudhën deri në vitin 2004 (kur është martuar motra), pjestohet me numrin 5 ndërsa pas marteses së motrës me nr. 4. Pjesa ideale që mund të më referohet mua, është e pamjaftueshme për penalizimin tim nga detyra sipas jurisprudencës së konsoliduar të KPA.

Gjithsesi, e riktheksoj edhe një herë se nuk ka fare balancë negative. Ka vetëm një balancë negative në vitin 2007, rreth 700.000 lekë, por edhe kjo ka natyrën e pasaktësisë në deklarim, që e kam shpjeguar tek shkaqet e ankimit, (*shih shkakun tridhjetë e dy, veçanarisht fq 82, 83, 84 të këtij ankimi*).

Përsa i përket balancës negative prej 1,817,804.62 lekë nga momenti i martesës deri në deklaratën Vetting, që pretendon komisioni, vlerësoj se më sipër është argumentuar mjaftueshëm se kemi të bëjmë me një fabrikim të pastër.

Ajo bazohet në deformime të të vërtetës, intepretime subjektive të fakteve, mosmarrjen në konsideratë me keqbesim nga Komisioni të provave të pakundërshtueshme që kam paraqitur për të vërtetuar të kundërtën. (Për më tepër, për të mos rënë në përsëritje, ftoj Kolegjin t'i referohet qëndrimit që kam shprehur tek shkaqet e ankimit, (*shih shkakun tridhjetë e dy, veçanarisht fq 81, 82, 83, 84 të këtij ankimi*).

PJESA E TRETË

Kriteri i Figurës

Nga raporti rezulton se DSIK ka kryer kontrollin e figurës time, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse une kam kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK ka dërguar një raport me shkresën nr. 12295 prot., datë 02.11.2017 për mua, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me Vendim të KDZH nr.210, datë 12.07.2022. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Si konkluzion DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z.Andri Ymeri. Nga raporti rezulton se në datë 26.09.2022 DSIK ka dërguar raportin e përditësuar të kontrollit të figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendim nr.395 datë 10.10.2022, sipas së cilit:
- Gjatë periudhës në të cilën subjekti ushtronte detyrën si gjyqtar dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive_____
- Gjithashtu për subjektin z. Andri Ymeri në cilësinë e gjyqtarit____ ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese gjyqësore duke dhënë vendime favorizuese gjatë gjykimit të çështjeve lidhur me tjetërsimin e pronave publike.
- Institucionet verifikuese kanë informuar instancat kompetente_____
DSIK ka konstatuar se:
Situata pasqyron korrupsion sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë disponohen informacione për përfshirje në veprime korruptive të një gjyqtari. Kjo veprimtari e

paligjshme përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të K.Pr.Penale "krim i organizuar, trafikim dhe korrupsioni".

Në përfundim grupi i punës ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri për vazhdimin e detytës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.
Nga raporti duket sa më poshtë:
A. DSIK, ka ndryshuar raportin, nga i përshtatshëm në i papërshtatshëm.
B. Komisioni ka kqyrur, kontrolluar, hetuar çdo informacion të përgatitur nga DSIK.
C. Nuk kuptohet qartë nëse në raport, Komisioni ka dhënë vlerësim për të gjithë materialet e DSIK, apo vetëm për një pjesë të tyre. Nëse ka dhënë vlerësim vetëm për një pjesë, kjo ka ardhur për shkak se pjesa e materialit të DSIK, për të cilën Komisioni nuk ka dhënë vlerësim:
a. Është sekret, b. Është e panevojshme. c. Është e pabazuar.ç. Komisionit i ka munguar koha sepse materiali është voluminoz. d. Variant tjetër.
Ç. Po ashtu, në raport, nuk përmenden prova të tjera mbi të cilat Komisioni ka krijuar bindjen për të më ngarkuar barrën e provës, përveç materialeve që Komisioni ka vlerësuar pasi ka kqyrur disa dosje gjyqësore, materialeve të tjera gjyqësore të marra nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër,
(vendimeve gjyqësore të pashoqëruara me dosje gjyqësore), të dhënave të sistemit TIMS si dhe disa denoncime që përmënden kryesisht tek kriteri i profesionalizmit. Komisioni, nuk rezulton të ketë dëgjuar rregjistrimet audio të seancave gjyqësore, (që në fakt janë procesverbali gjyqësor i mbajtur me rregjistrim audio), por vetëm ka parë idolongjet, (procesverbal i shkurtuar, që nuk përbën procesverbalin gjyqësor por thjesht është mjet ndihmës për gjyqtarin, që kur të tërhiqet për vendim, të kujtojë me saktësi kohën kur janë thënë fjalët e rregjistruara audio).
Gjithashtu, rezulton që Komisioni, në rastet e procesverbaleve të rregjistruara me audio, nuk ka administruar ndonjë procesverbal të rregjistruar audio, të transkriptuar tërësisht. Rezulton që në raport,
Komisioni nuk e ka mbështetur vlerësimin e tij, në ndonjë dëshmitar, fotografi, pamje filmike apo burime të tjera prove përveç atyre të sipërpërmëndura.

Në përmbyllje te raporti, përsa i përket kriterit të figurës, Komisioni shprehet: Në përfundim të hetimit në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në analizimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, si dhe duke marrë në konsideratë informacionet e organeve ligjzbatuese, duket se subjekti ka favorizuar palë në gjykim si dhe në disa raste ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit duke cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë. Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Komisioni tek kriteri i figurës, analizon disa dosje dhe vendime gjyqësore një për një si dhe pasi bën një analizë të përgjithshme dhe korrelative të tyre, duke patur parasysh edhe gjetjet në kriterin e profesionalizmit, shprehet *"Në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e aftësive profesionale, Komisioni konstaton gabime thelbësore dhe serioze si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, për rrjedhojë duket se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim*
të dobët, nuk ka respektuar në disa raste të drejtat e palëve si dhe në disa raste ngrihen dyshime për favorizim të palëve në gjykim."

Lidhur me kriterin e figurës, (por sikurse do shihet në vijim të këtij trajtimi, edhe për kriterin e profesionalizmit), jap paraprakisht konsideratën se vlerësimet, gjetjet dhe analiza e Komisionit e shprehur në raport, por edhe në vendimin që po ankimoj përpara Kolegjit, më cënon ushtrimin e një të drejtë efektive mbrojtjeje. Kjo pasi Komisioni shprehet me togflalësha bombastik në tingëllim, si p.sh, *"bazuar në informacionin e organeve ligjzbatuese",* pa mu thënë cili është ky informacion dhe për rrjedhojë, më ngarkon barrë provë për t'u mbrojtur në tym, në errësirë, pra duke më vënë në pozicion të barazvlefshëm me atë që i thuhet ke të drejtën për t'u mbrojtur lidhur me akuzën për vrasje, pa i thënë fare se kë ka vrarë.

Pikërisht, nga kjo lloj sjelljeje, mua më lind e drejta jo vetëm të dyshoj por të shpreh bindjen se informacionet e organeve ligjzbatuese që përmënd komisioni, të cilat nuk më thuhen, janë vetëm një tullumbace e fryrë që në pamje duket sikur ekziston por që nuk ka pothuajse fare peshë. Jo vetëm kaq,
por duke e vlerësuar këtë sjellje me faktin se të tre nga anëtarët e Komisionit nuk kanë thënë të vërtetën kur janë shprehur se nuk janë në konflikt interesi dhe madje gjatë hetimit janë përpjekur me mosveprim t'a fshehin këtë fakt, më krijohet bindja absolute se përfundimi i procesit tim të rivlerësimit, është i paracaktuar, i paragjykuar, i pandershëm dhe i padrejtë.

Kjo bindje më thellohet edhe nga fakti që nga raporti i Komisionit, duket qartë se trupi gjykues, është ngutur për të përfunduar sa më parë procesin tim të rivlerësimit, duke bërë një hetim sipërfaqësor dhe duke u përpjekur që natyrën sipërfaqësore të hetimit të tij, t'a kamuflojë duke më ngarkuar mua barrën e provës për të sjellë shumë dosje gjyqësore, secila prej të cilave është qindra faqe dhe që vetëm shpenzimet financiare dhe koha fizike që më duhet mua për t'a përmbushur këtë barrë prove, e dëmtojnë seriozisht ushtrimin efektiv të të drejtës së mbrojtjes nga ana ime.

Kjo bindje ime mbi natyrën e paragjykuar të procesit tim të rivlerësimit, krahas të tjerash përforcohet nga fakti se unë ndonëse disa herë me radhë kam paraqitur disa kërkesa procedurale për t'u njohur me kriterin objektiv mbi bazën e të cilit unë jam përfshire së bashku me motrën time, prokuroren Ajola Prençi, në të ashtuquajturin short special të datës 16.12.2019, (short mbi bazën e të cilit ka filluar procesi i rivlerësimit si për mua ashtu edhe për motrën time), kurrë nuk mu dha përgjigje, duke bërë trupi gjykues lojra fjalësh që të fyejnë për nga niveli i arsyetimit, të tilla si *"kjo nuk është kërkesë procedurale"* por është *"kërkesë për informacion",* ndonëse kush është jurist, qoftë edhe me nivelin minimal të aftësisë, e di që kërkesa procedurale është gjithmonë kërkesë që synon marrjen e informacionit dhe anasjelltas. P.sh. nëse unë do të pyesë dy komisionere të trupës, a duket se ato janë në konflikt interesi me mua, - a është kjo kërkese procedurale, kërkesë për informacion apo të dyja bashkë.

Tani, në vijim, do përpiqem të ç'montoj një për një të gjitha shpifjet, trillimet, shtrëmbërimet që më atribuohen në raport, përsa i përket kriterit të figurës time si gjyqtar.
Në lidhje me çështjet gjyqësore të gjykuara nga unë me palë shtetasin Izet Karini, babai i avokat Lulzim Karini, **si dhe në çështjet ku ky i fundit ka marrë pjesë në cilësinë e avokatit përfaqësues të palëve të ndryshme**, Komisioni tek kriteri i figurës dhe ai i profesionalizmit, shprehet se:

Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare, (dhe) Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile pasi ka gjykuar 103 çështje ku si avokat është paraqitur shtetasi Lulzim Kariniqë është person me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare.

Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni arsyeton (shih tek kriteri i profesionalizmit):
Nga hetimi i Komisionit në lidhje me figurën janë ngritur dyshime që subjekti i rivlerësimit ka bashkëpunuar me z. Lulzim Karini (gjatë kohës që ky ka ushtruar/ushtron detyrën e avokatit) të cilin e
ka patur shok shkolle.
Në lidhje me këto të dhëna Komisioni ka kryer një hetim për sa i përket marrëdhënies midis subjektit të rivlerësimti dhe z. Lulzim Karini nga hetimi ka rezultuar si më poshtë:

1. Subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar se në datë 03.01.2012 me sa mban mend kur është kthyer nga pushimet e vitit të ri e ka marrë me veturë një shok shkolle i tij, që quhet Lulzim Karini, që ndodhej në Mal të Zi dhe është kthyer në Shkodër.
2. Nga verifikimi i sistemtit TIMS është konstatuar se subjekti dhe z. Lulzim Karini kanë udhëtuar së bashku më shumë se njëherë dhe në disa raste prezente ka qënë dhe bashkëshortja e subjektit.
- Në datë 02.02.2007 subjekti ka dalë së bashku me z. Lulzim Karini me automjetin me targa TR8486 G (i cili ka qënë në pronësi të z. Karini) nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë në po të njëtën datë me këtë shtetas.
- Në datë 30.03.2008 subjekti ka dalë së bashku me z.Lulzim Karini me automjetin me targa TR8486 G nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë në po të njëtën datë me këtë shtetas.
- Në datë 29.11.2009 subjekti ka dalë së bashku me z. Lulzim Karini me automjetin me targa ULAF 759 tip furgon nga pika kufitare Hani i Hotit ka hyrë në datë 01.12.2009 me këtë shtetas.
- Në datë 27.11.2010 subjekti ka dalë së bashku me z. Lulzim Karini me automjetin me targa SH8000E (i cili ka qënë në pronësi të z. Karini) nga pika kufitare Morinë.
- Në datë 26.11.2011 subjekti ka dalë së bashku me z. Lulzim Karini me automjetin me targa SH8000E nga pika kufitare Murriqan. Në këtë udhëtim subjekti ka qënë i shoqëruar dhe nga bashkëshortja e tij.
- Në datë 10.11.2013 subjekti ka hyrë së bashku me z. Lulzim Karini me automjetin me targa SH8000E nga pika kufitare Hani i Hotit.

Siç konstatohet me lart, rezulton se subjekti ka udhëtuar disa herë me z. Karini në vite të ndryshme ku në dy udhëtime prezente ka qënë dhe bashkëshortja e tij. Referuar këtyre udhëtimeve si dhe deklarimit të subjektit se z. Karini e ka patur në shkollë, konstatohet një marrëdhënies shoqërore dhe familjare e subjektit me z. Lulzim Karini, e shtrirë në kohë.

3. Bazuar në të dhënat e mësipërme Komisioni i ka kërkuar informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me çështjet e gjykuara nga subjekti ku përfaqësues i palëve apo palë ka qenë z. Lulzim
Karini.

Në aneksin 2 gjendet lista e çështjeve 1 për periudhën 2006 deri aktualisht, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri ku si përfaqësues i palëve në gjykim rezulton z.Lulzim Karini. Subjekti në total ka gjykuar 122 çështje gjyqësore me z. Lulzim Karini si përfaqësues i palëve në gjykim.

 Për sa më sipër duket se subjekti bazuar në nenin 72 të K.Pr. Civile ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar çështjet e mësipërme ku si përfaqësues i palës ka qenë z. Lulzim Karini, me të cilin ai ka patur marrëdhënie shoqërore dhe familjare.

Ky gjoja arsyetim i konfiktit të interesit, jo vetëm që është i padrejtë por edhe abuziv. Kjo pasi:

Së pari: Eshtë e vërtetë, se në pyetësorin standart jam shprehur se subjekti me sa mbaj mend kur jam kthyer nga pushimet e Vitit të Ri më ka marrë me veturë një shok shkolle i imi, që quhet Lulzim Karini, që ndodhej në Mal të Zi dhe është kthyer në Shkodër, por kjo nuk do të thotë se ky shtetas ka patur në atë kohë (dhe madje as sot) lidhje interesi me mua. Madje, unë jam treguar i kujdesshëm që transportin tim për të cilin bëhet fjale, të mos m'a bënte ndonjë person që të kishte lidhje interesi qoftë edhe të largët me mua. Shtetasi Lulzim Karini, për periudhën për të cilën bëhet fjalë, nuk ka ushtruar as profesionin e avokatisë por ka qënë drejtor i Degës Shkodër të Entit Kombëtar të Banesave. Konkretisht, (sikurse rezulton nga shkesa nr. 424/1 prot, datë 02.06.2006 e Drejtorit të Përgjithshëm të EKB) ai e ka filluar këtë detyrë me datën 02.06.2006 dhe e ka përfunduar me datën 24.10.2014 (shkresa 171/1 prot, datë 24.10.2014) të cilat po ua vë në dispozicion si prova.

Së dyti: Qënia shok shkolle, nuk presupozon lidhje shoqërore dhe aq më pak lidhje familjare sikurse supozon padrejtësisht Komisioni. Kjo pasi kjo lidhje ka element cilësues dhe identifikues të saj, jo interesin (në kuptimin që i jep ligji për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike), por vendin e shkollimit. Kjo "lloj lidhjeje" është njësoj sikurse të thuash koleg, që nuk supozon miqësi, por i ka të gjitha alternativat e hapura, si nga miqësia, neutraliteti, armiqësia, etj.

P.sh vetë anëtarët e trupës gjykuese janë kolegë më zotin Roland Ilia. Po ashtu, gjatë studimeve të mia universitare, ky i fundit ka firmosur në borderonë e pagave si mësimdhënës i imi, po ashtu unë kam pirë shumë herë kafe më të dhe jemi përshëndetur rregullisht me ton miqësor me njëri tjetrin kur jemi përballur. Çfarë do të thotë kjo, që unë është dashur të jap dorëheqjen në çështjet ku ai ka qënë në pozicionin e avokatit?!!! Po ky zotëria, kur u përpoq të m'a helmatiste procesin tim të rivlerësimit, a do
duhej të jepte dorëheqjen vetë pa ia kërkuar unë?!!! E pra, e vërteta është, që marrëdhënia ime më këtë individin, nga çdo vëzhgues i jashtëm do të vlerësohej shumë më shumë intensive se marrëdhënia ime me shtetasin Lulzim Karini. Unë gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioni, kam kërkuar që të thërras me cilësinë e dëshmitarit shtetasin Roland Ilia, i cili përveçse ka dijeni, pasi ka qënë edhe avokat, mbi marrëdhëniet e mia me shtetasin Lulzim Karini, (të cilin e ka patur gjithashtu student), më nevojitet si dëshmitar për të vërtetuar përmes shëmbullit se jo çdo person që njeh për shkak të vendit të punës, vendit ku shkollohesh, etj, konsiderohet si lidhje interesi apo sikurse cilësohet nga komisioni, me togfjalëshin jo cilësues dhe të përgjithshëm "lidhje shoqërore dhe familjare". Shtetasi Roland Ilia, më nevojitet si dëshmitar edhe për ca elemete të tjera, dhe meqë është larguar nga procesi im i rivlerësimit, nuk ka asnjë pengesë ligji dhe/apo

fakti që ky shtetas të thirret si dëshmitar, (përveçse nëse ai ka frikë të jetë dëshmitar në betim ose Komisioni dëshiron të fshehë apo mbulojë diçka). ***Kjo kërkesë për thirrjen e këtij dëshmitari më është refuzuar padrejtësisht nga Komisioni***.

<u>Së treti</u>: Fakti që shtetasi Lulzim Karini më ka transportuar me makinë, nuk është gjë tjetër veçse mirësjellje nga ana e tij, asgjë më shumë, ndërsa fakti që unë kam pranuar të transportohem, nuk është gjë tjetër veçse pranim i mirësjelljes së tij nga ana ime. Po të quhej lidhje interesi kjo, atëherë do duhej të quhej lidhje interesi çfarë do lloj shfaqjeje mirësjelljeje në marrëdhëniet ndërpersonale. P.sh. do mund të quhej lidhje interesi fakti që komisionerja Pamela Qirko ka fjetur dhe është ushqyer për disa ditë në qytetin e Vlorës me donacionin e një kompanie sigurimi ku qartësisht ka patur interes material bashkëshortja e dajos tim; do të quheshin lidhje interesi kafet që i kemi paguar njëri tjetrit unë dhe komisioneri Roland Ilia, (faktikisht kam paguar vetëm unë mesa mbaj mend); do të quhej lidhje interesi fakti që komisionerja Pamela Qirko, në sencën e datës 27.05.2022 më tha "ne jemi miqësorë", dhe shumë e shumë sjellje etike dhe kësisoj kuptimi që i jep ligji konfliktit të interesit do të zgjerohej aq shumë saqë jo vetëm do të transformohej në diçka komike (duke humbur, për rrjedhojë, si seriozitetin ashtu edhe qëllimin e ekzistencës si institut i të drejtës publike), por do përbënte pengesë serioze për funksionimin e aparatit shtetëror, ku përfshihet si puna ime si gjyqtar ashtu edhe veprimtaria e vetë Komisionit. ***Po ashtu do të quheshin lidhje interesi fakti i vërtetuar nga ana ime, me video, gjatë gjykimit të çështjes nga Komisioni se Komisionerja Genta Bungo shfaqet duke u puthur me subjektin e rivlerësimit Dritan Hallunaj, të cilin ajo e ka gjykuar***?

<u>Së katërti</u>: Lidhur me 6 (gjashtë) udhëtimet për në Mal të Zi, që Komisioni ka konstatuar se unë paskam jashtë shtetit me shtetasin Lulzim Karini, (ndër të cilat përfshihen edhe dy udhëtime se bashku me bashkëshorten time), dhe mbi të cilat Komisioni ngre supozimin dashakeq se kjo tregon se unë me shtetasin Lulzim Karini kam një marrëdhënie shoqërore dhe familjare të shtrirë në kohë, kam për të thënë si më poshtë:

a. Këto 6 udhëtime mbulojnë fashën kohore 2007-2012. Vetëm një deformues voluntarist i të vërtetës mund të ngrejë supozimin se fakti që unë pas vitit 2008, kam udhëtuar në dy raste me shtetasin Lulzim Karini, së bashku me bashkëshorten time, tregon një lidhje familjare me këtë shtetas në kohën kur kam gjykuar cështet e babait të tij dhe/apo çështjet ku shtetasi Lulzim Karini ka qënë avokat, për vitet 20042006. Në këtë kohë, pra për vitet 2004 - 2006, unë kam qënë beqar dhe as e njihja bashkëshorten
time. Pra si mund të kisha lidhje familjare për këtë peridhë kohe me këtë shtetas në vitet 2004-2006 ?!!!!

Ndër 122 çështjet që numëron Komisioni se kam gjykuar gjithsejt me shtetasin Lulzim Karini për vitet 2004-2022, 47 çështje i përkasin periudhes 2004-2006, kohë në të cilën kam qënë beqar. Pra, përsa i përket këtyre 47 çështjeve, "lidhja familjare" e supozuar, përjashtohet haptazi meqënëse kam qënë beqar. Unë nuk e di kë quan familje Komisioni por di që Kodi i Familjes e përcakton qartë kush quhet familje dhe gjithashtu di që ky përcaktim i Kodit të Familjes nuk ka pikë lidhjeje me atë që shpreh Komisioni në raport, përmes përdorimit të tofjalëshit interesant "lidhje familjare". Këto 47 çështje janë 39% e totalit prej 122 çështjesh.

b. Për vitet 2007-2013, në çështjet që kam gjykuar (përveç dy-tre çështjeve që ka përfaqësuar babain e tij), shtetasi Lulzim Karini, ka qënë përfaqësues i Entit Kombëtar të Banesave, në 14 çështje. Pra ndër 122 çështjet që numëron Komisioni se kam gjykuar gjithsej me shtetasin Lulzim Karini për vitet 2004-2022, në 14 çështje ai ka qënë përfaqësues i nje institucioni shtetëror dhe këto gjykime ose kanë përfunduar me pushim gjykimi ose ka fituar institucioni shtetëror. - A mund të më thuhet se cili është interesi im si gjyqtar që ka pikprerje me interesin personal të shtetasit Lulzim Karini si përfaqësues i një institucioni shtetëror sikurse është EKB, për vitet 2007-2013 !! Zero, asnjë. Kjo pasi Komisioni nga hetimi i thelluar që ka kryer, besoj se e di as unë dhe as familjarët e mi sa do të afërm, nuk kemi aplikuar ndonjëherë për të marrë banesë si të pastrehë apo për të përfituar nga ndonjë shërbim tjetër që ofron Enti Kombëtar i Banesave. Këto 14 çështje janë 11% e totalit prej 122 çështjesh.

c. Për periudhën pas vitit 2013, - a ka ndonjë logjikë mbi të cilën të mund të supozohet se meqënëse shtetasi Lulzim Karini, më paska transportuar më makinë, nga Shkodra për në Mal të Zi, (distancë rreth 20/30 km) unë t'a kem favorizuar në gjykime të ndryshme, që në pjesën më të madhe janë gjykime pa sensibilitet publik të lartë, pasi janë gjykime për njohje vjetërsie në punë për efekt përfitimi pensioni pleqërie ose gjykime në të cilat unë e kam caktuar kryesisht shtetasin Lulzim Karini si avokat mbrojtës
dhe gjithmonë kam vendosur caktimin e masës së sigurimit arrest në burg ose e kam dënuar të pandehurin. Ndër 122 çështjet që numëron Komisioni se kam gjykuar gjithsejt me shtetasin Lulzim Karini për vitet 2004-2022, në 14 çështje ai ka qënë mbrojtës i të arrestuarit/pandehurit i caktuar kryesisht nga Gjykata, (pra jo i zgjedhur nga i arrestuari/i pandehuri). Çfarë interesi ka patur avokati Lulzim Karini përsa i përket këtyre 14 çështjeve, që ka patur ose mundet të ketë patur pikprerje me përmbushjen e rregullt të detyrës time si gjyqtar...!! Asnjë, zero absolute. Për më tepër Komisioni prezumohet t'a dijë se sipas Kodit të Procedurës Penale, Gjykata cakton si mbrojtës kryesisht personat që përcaktohen në listën e nxjerrë nga Kryetari i Dhomës Vendore së Avokatisë. Këto 14 çështje janë 11% e totalit prej 122 çështjesh.

ç. Po për periudhën pas vitit 2013, - a ka logjikë të supozohet që unë e kam favorizuar këtë shtetas ndërkohë që një gjykim që ai ka patur në cilësinë e paditësit, me procredit sh.a, unë e kam pushuar, pasi paditësi Lulzim Karini ka hequr dorë nga gjykimi. Prapë, shtrohet pyetja, - a ka logjikë të supozohet që
unë e kam favorizuar shtetasin Lulzim Karini në gjykimet e babait të tij, ndërkohë që unë kam dalë gjyqtar në pakicë, duke votuar rrëzimin e padisë së ngritur nga babai i tij Izet Karini, ndaj Bashkisë Shkodër, me objekt njohje pronësie.[44] Këto dy çështje, janë 1.8% e totalit prej 122 çështjesh.

d. Fakti që unë nuk kam patur ndonjë lidhje të veçantë afektive me shtetasin Lulzim Karini, sikurse supozon Komisioni, (të ndryshme nga mirësjellja reciproke dhe e vazhdueshme që tregoj me çdo të njohur dhe të panjohur), vërtetohet edhe nga të dhënat e sistemit TIMS. Konkretisht, ndër 6 herë që kam udhëtuar me këtë shtetas për vitet 2007-2012, tre herë kemi udhëtuar në grup. Konkretisht,

[44] Për këtë çështje për të cilën kam dalë në pakicë u shpreha hollësisht tek pjesa e titulluar "shkaqet e ankimit". Shih shkakun e emertuar "së trembëdhjeti", fq. 33-39 të ankimit, veçanarisht fq. 37, 38, 39.

- Një herë kemi shkuar në Mal të Mi me bashkëshorten pasi na kishte ftuar një mik i imi dentist, i quajtur Gentian Sekniqi, që kishte shtëpi në Mal të Zi. Ai kishte ftuar disa çifte dhe/apo persona që bënin pjesë në rrethin e tij miqësor, ku bëja pjesë edhe unë edhe shtetasi Lulzim Karini. Meqënëse kishte ftuar edhe shtetasin Lulzim Karini që e kishte mik, unë shkova me këtë të fundit në Mal të Zi, pasi nuk kisha makinë dhe ai për edukatë dhe mirësjellje pranoi të na marrë. Kjo ndër të tjera, edhe sepse e dinte gjuhen si dhe e dinte se ku e kishte shtëpinë shoku im Gentian Sekniqi, në Mal të Zi.

- Një herë me furgon ku kemi qënë unë dhe bashkëshortja ime, shtetasi Ervin Kruja, shtetasi Lulzim Karini, shtetasi Bashkim Rroji, në atë kohë drejtor i Ndërmarrjes Studenti Shkodër, bashkë me të shoqen, shtetasi Gentian Dumleku me të shoqen, shoferi i furgonit dhe një çift tjetër që nuk e mbajmë mend. Atëherë kemi shkuar për vizitë turistike në Bosnje, në Sarajevë. Vetë mjeti i udhëtimit dhe numri i personave tregon që qënia ime dhe e bashkëshortes time në një furgon me shtetasin Lulzim Karini, ka qënë rastësor.

- Një herë tjetër, mosgaboj në vitin 2007 kemi udhëtuar grup katër djem, po në Mal të Zi. Ndërkohë Lulzim Karini në të tre këto raste, nuk ka qënë avokat dhe as ka patur me mua ndonjë lidhje të çfarëdoshme interesi, që të mund të klasifikohet si konflikt faktik interesi, konflikt në dukje interesi, konflikt i mundshëm interesi apo konflikt i vazhdueshëm interesi, sipas përcaktimeve të ligjit Për parandalimin e konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksioneve publike.

<u>Së pesti</u>: Një element tjetër që tregon se fakti i 6 udhëtimeve të sipërpërmëndura, nuk ka ndikuar në ushtrimin tim të detyrës si gjyqtar, është edhe numri përpjestimor i çështjeve gjithsejt që kam gjykuar unë për vitet 2003-2022, që është mbi 13 mijë, me numrin e këtyre çështjeve ku shtetasi Lulzim Karini ka marrë pjesë si avokat, që është 122. Pra, rreth 0.85%. Po të kisha bashkëpunuar me shtetasin Lulzim Karini, sikurse supozon Komisioni, kjo përqindje do ishte ndjeshëm më e lartë, pasi qyteti i Shkodrës në
kohë të ndryshme, ka patur jo më shumë se 15-20 persona që e ushtronin në mënyrë aktive profesionin
e avokatit.

<u>Së gjashti</u>: Një element tjetër që tregon se fakti i 6 udhëtimeve të sipërpërmëndura, nuk ka ndikuar në ushtrimin tim të detyrës si gjyqtar, është edhe fakti se ndër 122 vendimet e dhëna nga unë, ku palë ka qënë Izet Karini dhe/apo përfaqësues i palëve ka qënë i biri tij Lulzim Karini, nuk ka vetëm përfundime të sukseshme gjykimi për këtë shtetas. Ka pranime, ka rrëzime[45],

[45] Komisioni thotë të pavërtetën në vendim se nuk ka asnjë vendim për rrëzimin e padisë ku ka qënë përfaqësues i paditësit av. Lulzim Karini. <u>P.sh unë kam paraqitur si provë vendimin me paditës Gilë Martingilaj i paditur Gjon Dukgilaj, me objekt kthim sendi, ndërtesë (bar-restorant-hotel Tradita) dhe vetëm vlera objektit material të gjykimit i kalon 2 milion euro</u>. Kjo padi është rrëzuar dhe vendimi i marrë nga unë i tejkalon nga pikpamja e vlerës material me disa fish, vlerën e të gjitha vendimeve për pensioneve të kooperative ku ka qënë avokat i paditësve, shtetasi Lulzim Karini, që përbëjnë thuajse të gjitha çështjet ku ai ka marrë pjesë në gjykime me mua.

Unë vendimin në fjalë, të rrëzimit të padisë, e kam marrë më përpara në kohë se të njihesha me raportin e Komisionit që më ngarkonte barrë prove për të vërtetuar të kundërtën apo mungesën e marrëdhënieve miqësore me shtetasin Lulzim Karini. Ky vendim, qëllimisht dhe me dashakeqësi, nuk përmendet ne vendimin e Komisionit me të cilin unë jam shkakruar nga detyra e gjyqtarit. Kjo pasi qartazi do ishte provë në favorin tim dhe do hidhej kësisoj

pushime gjykimi, kthimi aktesh si padi me të meta, etj. Sigurisht përqindja e suksesit është më e madhe se bie fjala p.sh e ish avokatit Roland Ilia por kjo nuk lidhet me konflitin e interesit por lidhet me shumë faktorë si p.sh kompetenca profesionale e avokatit, ndershmëria e tij në raport me klientin dhe Gjykatën, etj. Konkretisht, ndër 122 çështjet që numëron Komisioni se kam gjykuar gjithsej me shtetasin Lulzim Karini për vitet 20042022, për 17 çështje është vendosur pushimi i gjykimit me vendim të formës së prerë, (dhe sipas nenit 300 të KPC, padia quhet se nuk ka ekzistuar), në 5 çështje Gjykata ka vendosur kthimin e padisë me të meta, (pra sipas neneve 154 dhe 158 të KPC, padia quhet e paraqitur dhe gjykimi quhet se nuk është bërë), në 2 çështje me EKB, është vendosur zgjidhje e çështjes me pajtim pasi debitori ka pranuar të shlyejë detyrimin ndaj EKB, në 1 çështje është disponuar moskompetence e gjykatës për të shqyrtuar çështjen.

Pra, 17 + 5 + 2 + 1 = 25 çështje. Për keto 25 çështje, qartazi nga mënyra e disponimit me vendim, duket se jo vetëm nuk ka patur por as mund të ketë patur koflikt interesi ndërmjet detyrës time si gjyqtar, me interesat e avokatit Lulzim Karini. Këto 25 çështje janë 22% e totalit prej 122 çështjesh.

Në përmbledhje të sa më sipër, po të mbledhësh përqindjet e lartëpërmendura, 39% +11% +11%+ 1.8% + 22% = 83.8%. Pra, nga vetë mënyra si ka disponuar Gjykata, rezulton se për 83.8% të totalit prej 122 çështjesh që unë kam gjykuar me avokatin Lulzim Karini për vitet 2004-2022, përjashtohet kategorikisht jo vetëm qënia por edhe mundësia e qënies time në konflikt interesi. Edhe përqindja e mbetur prej 15.2 %, rrëzohet pasi ka rrëzime kërkesë padish ku avokati Lulzim Karini ka qënë përfaqësues i palës paditëse, ka pranime të pjeshme të padisë ku avokati Lulzim Karini ka qënë përfaqësues i palës paditëse, ka pranime padish ku avokati Lulzim Karini ka qënë përfaqësues i palës së paditur, etj.

Së shtati: Komisioni në përdorimin e togfjalëshit *"duket se është në konflikt interesi për 122 çështje ku ka marrë pjesë si përfaqësues shtetasi Lulzim Karini*" nuk bën asnjë refencë në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike si dhe nuk bën asnjë lloj cilësimi nëse kemi të bëjmë me konflikt faktik interesi, konflikt në dukje interesi, konflikt të mundshëm interesi apo konflikt të vazhdueshëm interesi. Po ashtu, nuk bën individualizim të saktë të momentit se ku ushtrimi i detyrës time si gjyqtar, është pikprerë në mënyrë të paligjshme apo që duket se është e paligjshme, me favorizimin e avokatit Lulzim Karini. Lidhur me këtë pikë, në raportin që më është dërguar tregohet vetëm që avokati Lulzim Karini, ka përfituar shtyrjen e një seance të vetme gjyqësore, pasi më ka dërguar një SMS me kërkese për shtyrje seance (shih rastin e ankueses Ariana Muja), ndërkohë që sipas Komisionit, njoftimi duhet të behet me shkresë të depozituar në Kryesekretarine e Gjykatës. Po sipas Komisionit, fakti që unë e kam shtyrë seancën me një sms tregon se unë kam patur lidhje miqësore me avokatin Lulzim Karini. Ky konstatim dhe vlerësim është jo vetëm abuziv por edhe i paligjshëm. Kjo pasi:

a. Nuk është e vërtetë që njoftimi i shkaqeve për shtyrjen e seancave gjyqësore bëhet vetëm me shkrese të depozituar në kryesekretari, por mund të bëhet me çdo mënyrë të padyshimtë njoftimi. Fakti që avokati në fjalë, më ka njoftuar me sms, në numrin tim personal, nuk është i paligjshëm. Kjo pasi ai ka patur të atin duke vdekur (dhe që pas pak vdiq) dhe çdo njeri normal është logjike

---

poshtë gjithë arsyetimi abuziv, supozues, i pavërtetë dhe i paprovuar që unë kam patur lidhje miqësore dhe familjare të shtrira në kohë me avokatin Lulzim Karini.

që të mos jetë i kthjellët mendërisht dhe/apo të gjejë kohë të shkruajë shkresën dhe t'a depozitojë atë në Gjykatë, në kushte të tilla urgjence dhe fatkeqësie të rëndë familjare.

b. Unë kam treguar një sjellje korrekte gjyqësore dhe në seancën gjyqësore në fjalë, këtë sms ia kam lexuar fjalë për fjalë palëve dhe i kam kërkuar mendim lidhur me vijimin e procedurës gjyqësore. Palët pasi u njohën me përmbajtjen e kësaj sms-je, duke qënë se janë njerëz dhe si të tillë kanë empati, keqardhje dhe solidaritet njerëzor në raste fatkeqësie familjare, të gjitha së bashku kërkuan shtyrjen e
seancës gjyqësore. Sipas Komisionit, gjyqtari nuk është njeri dhe duhet të pushonte gjykimin në këtë seancë. Por Komisioni harron me dashje se guri i themelit në një proces të rregullt ligjor, qoftë administrativ dhe aq më shumë gjyqësor, është humanizmi, pra qënia njeri jo vetëm fiziologjikisht por
edhe shpirtërisht dhe mendërisht. Po ashtu Komisioni harron se sipas nenit 100 të KPC, mirëbesimi është një nga gurët e themelit të procedurës gjyqësore. Veprimi me mirëbesim, vlen jo vetëm për palët si detyrim, por mbi të gjitha duhet të karakterizoje sjelljen e duhur gjyqësore.

c. Po të dëgjohet rregjistrimi audio i kësaj seance, (që unë do t'a paraqes si provë), duket qarte se teksti i sms që avokati Lulzim Karini më ka dërguar, është shumë formal dhe zyrtar. Fillon me fjalët, "*I nderuar zoti gjyqtar. Ju bëj me dije se nuk mund të paraqitem në seancën gjyqësore. Kjo pasi im atë ka pësuar hemoragji cerebrale dhe jemi nisur me urgjencë në Athinë Greqi, sepse nuk mund t'a operojmë në Shqipëri pasi ka bërë tashmë dy bye passe në zemër. Po iu dërgoj locationin ku ndodhem në Greqi, afër spitalit ku është shtruar im atë. Ju lutem më shtyni seancën gjyqësore*". Cfarë duhet të bëja unë pasi u njoha më këtë SMS. Unë korrektësisht, ua kam lexuar palëve në seancë, duke iu treguar saktësisht orën dhe minutën kur më ka ardhur ky SMS. Pasi mora miratimin e palëve shtyva seancën. Po të kisha lidhje me avokatin Lulzim Karini, sms nuk do të ishte kaq formal dhe zyrtar. As unë dhe madje as avokati në fjalë, nuk ka menduar ndonjëherë që njohja jonë do të përbëntë premisë favorizimi që do binte ndesh me detyrën time si gjyqtar. Fakti që as avokati nuk e ka menduar këtë gjë, duket qartë po të krahasohet karakteri formal dhe zyrtar i kësaj sms-je, p.sh me sms që i dërgova Komisionit bashkangjitur kërkesës për përjashtimin e Komisionerit Roland Ilia, "Andri, si je", që komisioneri në fjalë, më dërgoi ndërkohë që ai kishte ca shqetësime personale, dhe që kësaj SMS unë as nuk iu përgjigja fare, (pasi binte ndesh me figurën dhe detyrën e gjyqtarit), për aq kohë sa atij t'i kalonin shqetësimet që kishte. Tani lind pyetja: - Si mundet që Komisioni të konsiderojë favorizim shtyrjen e seancës që unë bëra pasi u njoha me sms e avokatit Lulzim Karini, ndërkohë që nuk konsideron veprim të paligjshëm pjesmarrjen e Komisionerit Roland Ilia, në trupën time gjykuese, dhe mosdeklarimin e konfliktit të interesit prej tij, qoftë edhe vetëm për shkak se më ka dërguar sms e lartëpërmëndur, ndërkohe që ka patur shqetësime që ai i di vetë.

Së teti: Në veprimtarinë time si gjyqtar, gjithmonë kam menduar se Gjykata nuk është shefi i procesit gjyqësor, pra ajo nuk ka pozitë eprore përkundrejt palëve apo aktorëve të tjerë të procesit gjyqësor.
Gjykata është e barabartë me tërësinë e këtyre aktorëve, por vetëm ka rol të ndryshëm në raport me ta.
Po ashtu, vlerësoj se trupa gjykuese e Komisionit që udhëheq procesin tim të rivlerësimit, nuk është shefi i procesit tim, por është e barabartë me mua, vetëm se ka rol të ndryshëm ligjor. Përse e them këtë. Në raportin që Komisioni më ka dërguar, por edhe në vendimin përfundimtar të tij,

që më poshtëron dhe më fyen përsa i përket kriterit të figurës dhe profesionalizmit, si premisa fillestare bazë ashtu edhe premisa përmbyllëse konkluzive, është "*duket se subjekti ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit në rastet kur është përfshirë në proces avokati Lulzim Karini apo babai i tij*".

Kjo premise mbi të cilën Komisioni më ngarkon barrën e provës, ka të bëjë jo me faktin por me "dukjen", pra jo me përmbajtjen por me perceptimin. Dukja nuk është kategori objektive (fakt), por është kategori subjektive dhe është produkt i bashkimit të arsyes (ratios) me dëshirën (dashjen). Është fakt i njohur botërisht se njerëzit pa ratio ose edhe me ratio por gjithashtu edhe me shumë dëshirë, janë të prirur të shohin atë që dëshirojnë të shohin ose ua thonë të tjerët se ekziston, pa u lodhur të shohin përmbajtjen e asaj që dëshirojnë të duket ose ua thonë të tjerët se duket.
Duke qënë "dukja" kategori subjektive, pra çështje perceptimi (jo fakt), as unë dhe askush tjetër nuk mund t'a përmbysë barrën e provës, pra të hedhin poshtë dukjen, përveç se më dëshmitarë, ose me shëmbuj të rasteve të ngjashme, ku dukja nuk është marrë parasysh dhe/ose nuk do merret parasysh.

Unë gjatë procesit të rivlerësimit, jam përpjekur që t'i bëj të dyja. Kam kërkuar edhe deshmitarë (që më janë refuzuar si të panevojshëm nga Komisioni) por edhe kam sjellë nëpërmjet shëmbujve konkret raste ilustrative kur dukja/pamja nuk mjafton për të arritur në konkuzionin që kemi të bëjmë me marrëdhënie miqësore/armiqësore, etj. Madje këto shëmbuj i kam dhënë brënda proceësit tim të rivlerësimit po edhe jashtë tij. Përmes tyre jam përpjekur të shpjegoj bindshëm se dukja nuk mjafton për të cënuar integritetin e tjetrit dhe poshtëruar atë, aq më pak kur ekziston dëshira për të parë ose për të mos parë atë që do ose nuk do të shohësh. Sipas këtyre shëmbujve kam ilustruar konkretisht si më poshtë:

1. Është fakt se pas seancës dëgjimore të datës 13.06.2022, u largua nga gjykimi komisioneri relator Roland Ilia, pasi një trup tjetër gjykuese ku bëjnë pjesë edhe komisionerët e trupës aktuale, Firdes Shuli dhe Genta Bungo, për shkak se kjo trupë gjykuese e konsideroi të bazuar kërkesën time se komisioneri Roland Ilia e kishte ushtruar detyrën zyrtare në kushtet të paktën të konfliktit të dukje të interesit si dhe të konfliktit të mundshëm të interesit. (fakti 1).

2. Është fakt se në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, në kohën kur unë ekspozova shkakun e përjashtimit të komisionerit Roland Ilia, Komisionerja Pamela Qirko u shpreh me fjalët. Komisioneri Roland Ilia nuk ka ditur gjë për ekzistencën e konfliktit të interesit, pasi ne të kemi hetuar vetëm për pasurinë. Kjo dokumentohet me rregjistrimin audio. (fakti 2).

3. Është fakt që në shumicën e fotografive ku shfaqen Komisionerët e KPK, (në mos të gjitha), të publikuara në faqen ëub të vetë KPK, Komisionerët Ilia dhe Qirko qëndrojnë afër. (fakti 3).

4. Është fakt se as aneksi i kushtetutës dhe as ligji i vetingut nuk i kanë ngarkuar komisioneres Qirko
të drejtën dhe/apo detyrën të bëjë rolin e avokatit mbrojtës ose mësueses së Komisionerit Ilia. (fakti 4).

5. Është fakt se neni 14 i ligjit mbi vetingun, 84/2016, i jep çdo komisioneri të KPK, të drejtën për të filluar procedim disiplinor ndaj një komisioneri që gjykon në kushtet e konfliktit të interesit. Komisionerja Pamela Qirko nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, (që njëkohësisht është edhe detyrim pasi
nuk është e drejtë e personit privat por është e drejtë e zyrtarit, pra që ushtrohet në shërbim të publikut), përkundrejt komisionerit Roland Ilia që ka gjykuar në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit. (fakti 5).

6. Eshtë fakt që Kodi i Procedurave administrative në fuqi si dhe ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, e konsiderojnë si "detyrim" jo "të drejtë", fillimin e procedimit disiplinor ndaj zyrtarit që gjykon ose e ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit. (fakti 6).

7. Është fakt se komisioneri Roland Ilia, kur i drejtohet në ambientet jozyrtare komisioneres Pamela Qirko, përdor akronimin e shkurtuar "Pam", që tregon afrimitet. Ky fakt u konstatua nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kur komisionerët e KPK-së u paraqitën për të organizuar shortin për të tërhequr nga pesë çështje, për secilin subjekt rivlerësimi të kësaj Gjykate.
(fakti 7).

8. Është fakt se Komisionerja Pamela Qirko pasi u njoh me shkakun e përjashtimit të komisionerit Ilia, në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, u përpoq të na e kufizonte në ekstrem nga pikpamja kohore, të drejtën për të paraqitur me shkrim kërkesën për përjashtimin e komisionerit Ilia, duke na caktuar fillimisht vetëm 5 orë dhe pas insistimit të avokatit tim mbrojtës, n'a la afat deri të nesërmen ora 13:00, duke mos respektuar kështu afatin ligjor tre ditor të parashikuar në nenin 74 të KPC, që zbatohet edhe në rastin e gjykimeve administrative dhe për rrjedhojë, sipas ligjit 84/2016, zbatohet edhe në rastin e procesit tim të rivlerësimit, (fakti 8).

9. Është fakt se çdo vëzhguesi të jashtëm, do t'i krijohej perceptimi se Komisionerët Roland Ilia dhe Pamela Qirko, minimalisht kanë "raporte shoqërore të shtrira në kohë", me njëri tjetrin, nëse vlerësohen në sintezë dhe në mënyrë kumulative të tetë faktet e mësipërme, (fakti 9).

10. Është fakt se përjashtimi nga procesi im i rivlerësimit të Komisionerit Roland Ilia si dhe fakti që ai kur është pyetur nga trupa gjykuese që e ka përjashtuar, është shprehur "nuk mund të qëndroj indiferent se subjekti po hedh baltë përditë mbi mua, (shih përmbajtjen e vendimit të përjashtimit)", më së paku krijon perceptimin (dukjen) se marrëdhëniet e Komisionerit Ilia me mua, aktualisht janë armiqësore. (fakti 10).

11. Fakt është se komisionerja Pamela Qirko në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, u përpoq të më bullizojë dhe të më provokojë ndërsa unë po kërkoja të parashtroja kërkesat paraprake, (që është e drejtë e ime ligjore), me shprehje të tilla si: "*Nëse është qëllimi juaj për të zvarritur procesin, ne kemi kohë sa të duash. Megjithatë, ne po tërhiqemi për të marrë vendim lidhur me kërkesat tuaja, por t'a dini se nuk do të merrni asnjë informacion prej nesh*". (Dëgjo rregjistrimin audio të seancës). Përdorimi i këtyre shprehjeve nga komisionerja, qartazi nuk është sjellje e denjë gjyqësore pasi shpreh haptazi dy gjëra:

i. Paragjykim, duke u përpjekur të më vendos nën dritën e rreme se unë përmes këtyre kërkesave nuk kam për qëllim të mbrohem por vetëm të zvarris procesin, gjë që nuk mund të bëhet pa u shqyrtuar më parë kërkesat, dhe **ii**. Dëshirë për shkurajimin tim për të ushtruar të drejtën time të mbrojtjes dhe për të m'a zvogëluar personalitetin deri në atë shkallë sa t'i përngjasoj deles që nuk ka mundësi për t'u mbrojtur kur shkon tek kasapi. Sigurisht, komisionerja në fjalë, mund t'i binte fare shkurt dhe të mos lodhej për t'i thënë këto fjalë që më kanë fyer dhe poshtëruar, por të urdhëronte Gardën e Republikës të më nxirrte jashtë sapo unë të kërkoja fjalën për të parashtruar kërkesat paraprake, (ndonëse unë nuk shkela asnjë ligj, por vetëm guxova të ushtroj të drejtëm time të mbrojtjes, duke e ruajtur si solemnitetin e gjykimit ashtu edhe rregullat e etikës, ndërkohë që u përpoqa të ekspozoj se përse Komisioneri Roland Ilia duhej përjashtuar nga gjykimi). (fakti 11).

12. Fakt është se komisionerja Pamela Qirko në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, duke thënë fjalët '*ne po tërhiqemi për të marrë vendim lidhur me kërkesat tuaja, por t'a dini se nuk do të merrni asnjë informacion prej nesh*", më shkeli standartin e gjykatës se krijuar me ligj. Kjo pasi në atë seancë ajo i tha këto fjalë pa u këshilluar më dy kolegët e saj të trupit gjykues, sapo unë parashtrova kërkesën paraprake. Unë po gjykohesha nga një organ kolegjil i përbërë nga tre Komisionerë dhe jo nga një organ monokratik i përbërë nga komisionerja Qirko. Fakti që kjo komisionere i tha këto fjalë pa u këshilluar më dy kolegët e saj, tregon dijeninë paraprake që ajo ka patur lidhur me atë ç'ka mendonte lidhur me kërkesat paraprake miku i saj, komisioneri Ilia, (pra element që tregon bashkëpunimin mes tyre), por duket se tregon edhe paragjykimin që këta dy komisionerë, në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë patur përkundrejt meje në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022. (fakti 12).

13. Fakt është se komisionerja Pamela Qirko duke vazhduar të jetë pjesë e trupit tim gjykues, madje kryesuese, ka marrë dijeni se thelbi i kërkesave paraprake që kam parashtruar në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, (anima pretendi), është vlerësuar i drejtë si nga një trup tjetër gjykues i Komisionit (lidhur me përjashtimin e dy komisionerëve, veçanarisht Komisionerit Ilia) ashtu edhe nga shumica e trupit gjykues aktual, (lidhur me marrjen e provave shtesë për kriterin e pasurisë si dhe lidhur me riçeljen e hetimit për të treja kriteret e vleresimit). Ky fakt e delegjitimon edhe moralisht përveçse ligjërisht, sjelljen e lartëpërmëndur të Komisioneres Pamela Qirko, kur m'u drejtua me fjalët "*Nëse është qëllimi juaj për të zvarritur procesin, ne kemi kohë sa të duash. Ne po tërhiqemi për të marrë vendim lidhur me kërkesat tuaja, por t'a dini se nuk do të merrni asnjë informacion prej nesh*". (fakti 13).

14. Fakt është se në seancën e datës 13.06.2022, në sallën e gjykimit ishin 8 gardistë, ndërsa 2-3 qëndronin jashtë sallës. Kjo u interpretua si nga unë, nga mbrojtësit e mi si dhe nga shumë gazetare, si tentativë për bullizim fizik dhe psikologjik, të ngjashëm me gjyqin e famshëm të popullit të kryesuar nga gjyqtari Fon Frahjer, (kryetar i Gjykatës së Lartë të Rajhut të Tretë), që ndërsa po gjykonte ata që sipas tij kishin organizuar atentatin e vitit 1944 ndaj Fyhrerit të tij Adolf Hitler, kishte urdhëruar paraprakisht që atyre t'u mos u lejohej në sallën e gjyqit rrypi i pantallonave, duke bërë që jo vetëm personaliteti i tyre të zvogëlohej në sytë e pjesmarrësve në gjyq, por edhe që ata në vend që të ushtronin të drejtën e mbrojtjes, fokusin kryesor të vëmëndjes së tyre, ta kishin dhe përqëndronin tek mbajtja e pantallonave me dorë. Natyrisht, përfundimi i gjyqit dihej. U rropën të gjallë dhe pa dhënë shpirt, u varën me çengel në fyt.

Mbushja e sallës me gardistë, që qartësisht ishte e tepërt, nuk e përjashtohen mundësinë që të jetë bërë pikërisht për të më bullizuar si mua ashtu edhe mbrojtësit e mi, (av. Arben Llangozi dhe av. Gerti Ymeri), (fakt 14).

15. Fakt është se asnjërit nga mbi 500-600 subjektet e rivlerësimit që i janë nënshtruar procesit të rivlerëmit kalimtar, nuk i është shtrirë periudha e hetimit për kriterin profesional për gjithë kohën e ushtrimit të detyrës dhe aq më pak për 19 vjet si në rastin tim. Po ashtu, fakt është që për asnjë subjekt rivlerësimi nuk ka rezultuar që në të njëjtën kohë të jenë konstatuar njëherazi, në seancë dëgjimore, në kushtet e konfliktit të interesit dy nga tre anëtarët e trupës, njëri nga të cilët, komisioneri relator. Gjithashtu, fakt është se në dijeninë time asnjë subjekti rivlerësimi nuk ia janë tërhequr pas përjashtimit të dy komisionerëve dhe pas riçeljes së hetimit, mbi 1400 vendime për t'u kqyrur dhe vlerësuar.

Së fundi, fakt është edhe se trupa e re e kryesuar nga komisionerja Pamela Qirko, nuk ka marrë ndonjë vendim të shkruar, dhe të m'a ketë njoftuar, se përse hetimi i kriterit tim profesional, në këtë mënyrë, duket se nuk e cënon parimin e trajtimit të barabartë, dhe se nuk është bërë për hakmarrje ose interes të tërthortë. (fakte 15).

16. Fakt është se në vendimin për shkarkimin tim nga detyra, nuk përmëndet kjo pjesë e parashtrimeve të mia. Kjo pasi qartazi po të përmendej do të tregonte shkeljen e barazisë në trajtim që më është bërë, (në raport me përgjegjësinë ligjore që do duhej të mbante komisioneri Roland Ilia), pasi ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo pasi palët e përfshira në gjykimet që Komisioni më përmënd në raport, në pjesën e figurës dhe atë të profesionalizmit, nuk kanë në rendin tonë juridik ndonjë të drejtë më shumë nga të drejtat që kam unë në procesin tim të rivlerësimit. Po ashtu unë kur i kam gjykuar këto palë, nuk kam patur detyrime më shumë nga sa kanë patur dhe kanë Komisionerët Roland Ilia dhe Pamela Qirko, që në bashkëpunim me njëri-tjetrin, më cënojnë të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, veçanarisht në standartin e Gjykatës së paanshme. Gjithashtu, do ishte shkelje e parimit të barazisë në trajtim që unë të shkarkohem nga detyra si gjyqtar për shkelje të standartit të dukjet se paanësisë, ndërsa dy komisionerëve Roland Ilia, (veçanarisht ky) dhe Pamela Qirko, që në bashkëpunim duket se kanë vepruar në konflikt interesi lidhur me mua, jo vetëm të mos shkarkohen nga detyra, por madje të mos iu fillojë as edhe procedim disiplinor, madje madje Ilia as të mos pyetet lidhur me motivet dhe qëllimet që ka ndjekur kur ka vepruar kësisoj. Pra çfarë ka dashur të fshehë në sytë e publikut. (fakti 16).

17. Fakt është se në nenin 30 shkonjat "c", "ç" dhe "g" të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave i Republikës së Shqipërisë", (i titulluar pengesat ligjore), parashikohet se: Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjil, nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur:
..c) Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni, kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë ose me të njëjtën rrethana ligjore me çështjen në gjykim[46]....

[46] Padiskutim fare edhe Komisionerja Genta Bungo e ka vendosur veten në kushtet e zbatimit të kësaj dispozite. Kjo pasi ndërsa mua më ka shkarkuar nga detyra me arsyetimin se kam gjykuar disa çështje ku avokat ka qënë një shok shkolle i imi, (në kuptimin që kam qënë bashkëstudent me të në të njëjtin kurs porn ë klasa të ndryshme), Komisionerja Genta Bungo, provohet me video se del duke u puthur dhe përqafuar me subjektin Dritan Hallunaj. Po

...ç) Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial, merr pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim...
....g) *Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni, kanë marrëdhënie të tilla të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim.* (fakti 17)

18. Fakt është se në zbatim të kësaj dispozite ligjore, Pamela Qirko, duke marrë pjesë si këshillare dhe avokate mbrojtëse, e komisionerit Roland Ilia kur unë ekspozova shkaqet e përjashtimit tij, (e rregjistruar me zë nga audioja e seancës dëgjimore të datës 13.06.2022), ndonëse ligji as nuk ia njeh këtë të drejtë dhe madje i ngarkon detyrimin për të filluar procedimin disiplinor ndaj këtij komisioneri, duket se ka dhënë këshilla dhe mendim për një nga çështjet më të rëndësishme të procesit tim të rivlerësimit, që ka të bëjë me standartin e paanësisë së Gjykatës (pika "ç", e nenit 30). Vetë lidhja miqësore që ka kjo komisionere me komisionerin e përjashtuar Roland Ilia, si dhe marrëdhënia armiqësore e pohuar prej tij me personin tim, bën të duket se vetëofrimi i komisioneres në fjalë për të dhënë këshilla dhe për të bërë avokatin mbrojtës të Komisionerit Roland Ilia në seancën e datës 13.06.2022, dhe mosveprimi i saj për t'i filluar procedimin disiplinor këtij të fundit pasi ai u përjashtua nga gjykimi, për shkak të konfliktit të interesit, nuk janë gjëra të rastit. Pra, duket se e përligjin frikën dhe dyshimin tim të arsyeshëm se unë jam ekspozuar ndaj hakmarrjes së Komisionerit Roland Ilia, duke u përdorur si instrument, mikja e tij komisionerja Pamela Qirko (pika "g" e nenit 30).

Përveç të tjerash, duket se Komisionerja Pamela Qirko, ndërkohë që duhet të vlerësojë marrëdhënien time me avokatin Lulzim Karini, ajo mund të vihet në syrin e çdo vëzhguesi të jashtëm, në pozicionin e detyrimit për të bërë krahasim ndërmjet intensitetit të kësaj marrëdhënieje, për të cilën mua ajo më ngarkon barrën e provës, me intensitetin e marrëdhënies që ajo ka me mikun e saj Roland Ilia (pika "c" e nenit 30). **Lidhur me pikën "c" të nenit 30, kujtoj Komisionin se në vendimin për përjashtimin e Komisioneres Etleda Çiftja, dy komisioneret Genta Bungo dhe Firdes Shuli, u shprehën se pikërisht qënia e zyrtares Etleda Çiftja në pozicionin e mundësisë për të bërë krahasimin e pozitës së saj me pozitën e subjektit të rivlerësimit, përbën pengesë ligjore që ajo të marrë pjesë në procesin tim të rivlerësimit. Kjo pasi interesi im si subjekt rivlerësimi u konsiderua si një çështje objektivisht e njëjtë me interesin ligjor të komisioneres Etleda Çiftja.**

Edhe në rastin e vlerësimit të marrëdhënies time të supozuar me avokatin Lulzim Karini, komisionerja Pamela Qirko duket se ndodhet në të njëjtat kushte të parashikuara pika "c" të nenit 30 e Kodit të procedurave Administrative. Kjo pasi detyrohet të bëjë krahasimin e dy çështjeve objektivisht të njëjta
që janë:
a. A ekziston konflikti i supozuar i interesit ndërmjet meje me avokatin Lulzim Karini ?

---

ashtu ka gjykuar shokët e klasës së saj si Ledina Riza, Besa Nikhasani, vazhdon të mbajë në gjykim prokurorin Agron Bushati, etj. Është e qartë se çështja për të cilën më është ngarkuar barrë prove është objektivisht në të njëjtat rrethana me rrethanat e komisioneres Genta Bungo. Ky arsyetim ishte një nga kërkesat e përjashtimit që u rrëzua nga një trup tjetër e Komisionit dhe këtë vendim mospërjashtimi, ftoj Kolegjin t'a ketë parasysh se unë po e ankimoj së bashku me vendimin përfundimtar të Komisionit.

b. A është apo jo e ligjshme që Komisionerja Pamela Qirko, me mosveprim në kundërshtim me nenin 14 të ligjit 84/2016, e shpëton mikun e saj Komisionerin Roland Ilia, nga përgjegjësia ligjore (procedimi disiplinor) për faktin se ka ushtruar veprimtari në konflikt interesi me personin tim. Madje jo vetëm e shpëton me mosveprim, por duket se këtë sjellje e paraprin edhe me veprimin aktiv për t'a këshilluar dhe për t'iu bërë avokate mbrojtëse, në kundërshtim me ligjin, në seancën e datës 13.06.2022, lidhur me mënyrën se çfarë duhet të thotë për t'u mbrojtur nga pasojat e veprimtarisë së tij në kushtet e konfliktit të interesit ?

Në nenin 609/2 të Kodit Civil, parashikohet "*mosmarrja e masave për t'i dhënë fund gjendjes së paligjshmërisë, të ngarkon me përgjegjësi solidare e shkaktuesin e dëmit*". Këto masa, padyshim duhet
të përfshinin dërgimin e komisionerit në procedim disiplinor, gjë që nuk është bërë dhe jo vetëm nuk është bërë por në favor të tij ajo që duhet të merrte këto masa, luan rolin e avokatit mbrojtës dhe i jep këshilla, publikisht, madje së sy të subjektit të dëmtuar. Pra, Komisionerja Pamela Qirko duke mos marrë masat ligjore për t'i dhënë fund gjëndjes se paligjshmërisë së Komisionerit Ilia, për dëmin me natyrë jopasurore që ky i fundit më ka sjellë në të drejtën për proces të rregullt ligjor në procesin tim të rivlerësimit, mban përgjegjësi solidare me këtë të fundit. Pikërisht kjo përgjegjësi solidare, duket se përbën interes të mjaftueshëm që ajo të jetë në kushtet e zbatimit të nenit "c" të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më sipër, u përpoqa të arsyetoj përmes një shëmbulli të marrë brënda procesit tim të rivlerësimit, pra brënda trupit tim gjykues, se përdorimi i togfjalëshit "duket se është në konflikt interesi" jo gjithmon mjafton për të argumentuar konfliktin e interesit. Sidomos kur nuk dëshirohet të shikohet kjo dukje.

Unë jap konsideratën dhe vlerësimin se Komisionerja Etleda Çiftja, që u përjashtua nga gjykimi i procesit tim të rivlerësimit, pikërisht përmes përdorimit të togjalëshit "duket se", nuk ka të drejta më të pakta në rendin tonë kushtetues dhe ligjor se bie fjala Komisionerja Pamela Qirko si dhe Komisionerja Genta Bungo (që puthet me subjektet e rivlerësimit që ajo ka gjykuar), që gjithashtu janë në kushte të njëjta me Komisioneren Etleda Çiftja, përsa i përket zbatimit të nenit 30 shkronja "c" të K.Pr.Administrative.

Pikërisht qëndrimin që do mbajë Kolegji, pasi të njihet me këtë pjesë arsyetimi, i kërkoj që t'a vlerësojë si mjet provues (përmes shëmbullit) për faktin që marrëdhënia etike dhe vetëm njerëzore që unë kam patur me avokatin Lulzim Karini, të mos konsiderohet si konflikt në dukje interesi. Kjo pasi marrëdhënia miqësore ndërmjet komisionerëve Roland Ilia - Pamela Qirko, Genta Bungo – Dritan Hallunaj, Genta Bungo-Ledina Riza, Genta Bungo-Besa Nikhasani, Genta Bungo - Alaudin Malaj, Genta Bungo - Agron Bushati[47], etj, qartazi duket se ose janë objektivisht të njëjta ose jane më intensive dhe të shtrira në kohë, se marrëdhënia që unë kam patur më avokatin Lulzim Karini.

[47] Si shëmbuj të këtyre marrëdhënieve mund të sjellim edhe atë ndërmjet Komisionerit Roland Ilia me subjektin Sander Simon, (kanë qënë shokë shkolle), gjyqtarit të nderuar të KPA Sokol Çomo me subjektin Genti Shala. Madje në këtë shëmbull të fundit, KPA nuk ka pranuar kërkesën për dorëheqje të gjyqtarit Çomo, duke vendosur kësisoj standartin se nuk mjafton që të kesh mbaruar fakultetin në të njëjtën kohë me një tjetër dhe mbi këtë konstatim të ngrihet supozimi që ka miqësi të vërtetuar.

Gjithashtu, Kolegji të ketë në konsideratë se si marrëdhënia miqësore ashtu edhe marrëdhënia armiqësore janë anë të të njëjtës medalje dhe janë njësoj të patolerueshme për procesin e rregullt ligjor.
Po ashtu, lejimi i përdorimit të vetvetes si instrument hakmarrjeje nga ai me të cilin subjekti që gjykohet, është në marrëdhënie armiqësore, nuk ka vend në procesin e rregullt ligjor.

Së nënti: Më sipër kam arsyetuar duke dhënë shembuj brënda procesit tim të rivlerësimit lidhur me problematikën e "dukjes së konfliktit të interesit" dhe se si ai nuk shihet nga ai që nuk do të shohë për
shkak se duket se është vetë në konflikt flagrant interesi. Tani do të jap një shëmbull tjetër jashtë procesit tim të rivlerësimit, që tregon qartazi si drita e diellit veprimin me dy standarte që ka ndjekur trupa gjykuese kur më ngarkon mua barrën e provës për të vërtetuar mosekzistencën e dukjes se konfliktit tim të interesit me avokatin Lulzim Karini.

Konkretisht, me vendimin nr. 26, datë 21,06.2018 për subjektin e rivlerësimit Ilir Toska, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shprehet si më poshtë vijon:

Komisioni iu drejtua ZVRPP-së Tiranë 7, duke i kërkuar kopje të plotë të të gjithë transaksionit të kryer për këtë apartament, qysh prej fillimit; kontratën fillestare hipotekore, që shërbeu për marrjen e kredisë
për trajtimin e funksionarëve të lartë në "Raiffeisen Bank" nga subjekti i rivlerësimit.

"Raiffeisen Bank" vuri në dispozicion kopje të kontratës hipotekore të vitit 2005, me palë shtetasit L. A.
*dhe A. A., të cilët kanë hipotekuar një apartament me sipërfaqe 112 m2 , në rrugën "***", Tiranë. Hipoteka është vendosur si garanci deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve të kredimarrësit Ilir Toska.*

Duke qenë se ky fakt nuk ishte bërë me dije më parë, Komisioni vendos të hetojë për këtë fakt të ri. Nga verifikimi i kryer për këtë shtetas, rezulton se L. A. është avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, që prej vitit 2007, më parë ai ka qenë oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për arsye të kësaj marrëdhënieje mes z. Toska dhe shtetasit L. A., iu kërkua zyrtarisht informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Ndërsa Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e tij si gjyqtar, dërgimi i të gjitha vendimeve të mundshme të Gjykatës (nëse ka), ku palë ka qenë avokati L. A. dhe gjyqtar Z. Ilir Toska, për periudhën 2007 deri në vitin 2013 (kur kontrata e kolateralit në bankë është zëvendësuar). Verifikimi u bë për të konstatuar nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me këtë shtetas.

Gjykata e Apelit Tiranë dërgoi bashkëlidhur 19 vendime, për çështje gjyqësore me anëtar gjyqtarin Ilir
Toska dhe avokat L. A., për periudhën 2007 - 2013. Lidhur me këtë material mbi konfliktin e mundshëm të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe avokatit L. A., u pyet Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si autoritet qendror përgjegjës, për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të

interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar. Nga shqyrtimi në tërësi i akteve, ILDKPKI-ja ka konkluduar se:

Së pari: nuk gjendemi para një konflikti faktik të interesit, pasi interesi faktik i zyrtarit nuk rezulton se ka ndikuar apo mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive shtetërore në kuptim të nenit 3, pika 4, germa "a", të ligjit.
Së dyti: parimi i interesit të supozuar të gjyqtarit, që mund të ngrejë dyshime për ekzistencën e një konflikti në dukje të interesit, nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi të ndodhë, pasi vendimet gjyqësore nuk kanë asnjë ndikim mbi interesat e supozuara të gjyqtarit dhe se nuk rezulton ndonjë lidhje mes interesit të supozuar dhe vendimmarrjes gjyqësore konkrete, të tilla që ato, për këtë shkak dhe vetëm për të, të jenë të padrejta.
Së treti: nuk gjendemi përpara një konflikti të mundshëm të interesit, sepse interesi i supozuar nuk ekziston tashmë dhe as nuk ekziston mundësia që në të ardhmen të vihet në diskutim shfaqja ose jo e një interesi faktik ose konflikti në dukje, pasi kontrata e kolateralit në bankë është zëvendësuar.

Në përfundim, ILDKPKI-ja arrin në përfundimin se: "Nuk rezulton dhe nuk provohet që z. Ilir Toska, gjyqtar i Gjykatës së Apelit, të ketë ushtruar funksionin e vet publik në kushtet e konfliktit të interesit.".

U pyet nëpërmjet e-mail-it edhe subjekti i rivlerësimit, i cili dha sqarimet e duhura lidhur me këtë çështje, të cilat ishin bindëse për Komisionin.....

Hetimi administrativ në lidhje me konfliktin e interesit, (i KPK).
Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, është subjekt i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative". Për këtë subjekt nuk pati ndonjë rast të konstatimit të konfliktit të interesit, që të ishte pjesë e hetimit nga Komisioni, përveç atij të sipërpërmendur. Për rastin e përmendur më lart vlerësojmë se nuk jemi në kushtet e konfliktit të interesit, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar, janë përcaktuar në mënyrë shteruese interesat private të zyrtarit, prania e të cilave në vendimmarrjet e zyrtarit bën shkak që vendimmarrja të konsiderohet vendimmarrje e marrë në kushtet e konfliktit të interesit. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat të përcaktuar shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që zbatohet ai kufizim, që është më i rreptë.

Nëse do të përkufizojmë interesin privat, në rastin konkret të gjyqtarit, vërejmë se aktivizimi i hipotekës për pasojat që ajo sjell ndodhin në rastin kur kreditori nuk përmbush detyrimin dhe, referuar të drejtës së hipotekës, kreditori ka të drejtën e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrimit. Nga sa rezulton nga hetimi, subjekti ka përmbushur me përpikëri detyrimet për pagesat ndaj shoqërisë dhe, për pasojë, shlyerjen e borxhit. Kështu, marrëdhënia e hipotekës nuk ka sjellë dhe as nuk mund të passillte asnjë përfitim pasuror në raportin mes gjyqtarit dhe shtetasit L. A.
Nga analiza e situatës rezulton se hipoteka e vendosur ka shërbyer vetëm për përmbushjen e një kushti të bankës dhe për asnjë rast nuk rezulton që gjyqtari mund të ketë pasur një interes privat që të çonte në ndonjë përfitim për shkak të detyrës, aq më tepër nisur edhe nga deklarimet e tij se

ai nuk ka pasur ndonjë shoqëri të theksuar me këtë shtetas dhe as marrëdhënie miqësore ndër vite.

Për rrjedhojë, vendimet e gjyqtarit, në trupat ku ky shtetas ka qenë përfaqësues i palës, kanë qenë vendime të organit kolegjial për të cilat vendimmarrja ka qenë unanime dhe ku rezulton se gjyqtari nuk ka pasur ndonjë kompetencë thelbësore dhe përcaktuese konkrete. Përgjithësisht, në 14 raste, këto vendimmarrje gjyqësore të organit kolegjial, ku ka marrë pjesë dhe zyrtari/gjyqtari në fjalë, kanë të bëjnë me masa sigurimi personal në lëndë penale, përkundrejt individëve të dyshuar si autorë veprash penale, vendimmarrje të cilat parimisht nuk mund të thuhet se determinojnë procesin penal ndaj këtyre individëve, ndërkohë që nuk ka ndonjë të dhënë faktike që ato të kenë determinuar proceset penale në ato raste. Duket që ato janë çështje gjyqësore rutinë, për vepra dhe autorë me rrezikshmëri jo të theksuar, të vogël apo të moderuar. Vetëm në një rast, organi kolegjial, ku ka marrë pjesë dhe zyrtari/gjyqtari në fjalë, ka ndryshuar vendimin e gjykatës më të ulët (Gjykatës së Shkallës së Parë), ndërsa në rastin tjetër është vendosur mospranimi i ankimit të të akuzuarit. Në dy rastet e fundit, këto vendimmarrje gjyqësore të organit kolegjial, ku ka marrë pjesë edhe zyrtari/gjyqtari në fjalë, kanë të bëjnë me mosmarrëveshje civile, ku në një rast Gjykata e Apelit ka dhënë vendim në disfavor të palës së përfaqësuar nga avokati L. A., duke prishur vendimin e gjykatës më të ulët (Gjykatës së Shkallës së Parë), ndërsa në rastin tjetër, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët (Gjykatës së Shkallës së Parë).

Së dhjeti: Sikurse shihet nga shëmbulli i mësipërm, marrëdhënia ndërmjet subjektit të rivlerësimit Ilir Toska më avokatin L.A, që kishte lënë shtëpinë e tij në hipotekë si garanci për shlyerjen e kredisë që kishte marrë subjekti i rivlerësimit Ilir Toska, ka në përmbajtjen e saj një interes me natyrë materiale dhe për më tepër kohëzgjatja e hipotekës e ka përfshirë kohën kur ky gjyqtar ka ushtruar funksionin e tij gjyqësor lidhur me hipotekuesin. Pikërisht, ky interes në rastin tim mungon pasi ndërmjet meje dhe avokatit Lulzim Karini nuk ka ekzistuar në asnjë kohë ndonjë interes pasuror. Përveç kësaj, kohëzgjatja
e 6 udhëtimeve kohore për në Mal të Zi, e përmëndur në raport, qartësisht nuk ka pikprerje kohore, me ushtrimin e veprimtarisë time gjyqësore me avokatin Lulzim Karini.

Ajo që rastin tim e bën të ndryshëm nga rasti i subjektit të rivlerësimit Toska, është edhe mënyra e trajtimit tim. Konkretisht, Komisioni në rastin e subjektit të rivlerësimit Ilir Toska, ka kërkuar mendim
të specializuar nga ILDKPKI, lidhur me problematiken e konfliktit të interesit, gjë që në rastin tim nuk e ka bërë. Jam absolutisht i sigurte se po t'a bënte konkluzioni do të ishte njësoj si në rastin e zotit Toska. Për rrjedhojë i kërkoj Kolegjit, që t'a kërkoj këtë mendim nga ILDKPKI njësoj si në rastin e subjektit të rivlerësimit Ilir Toska.

Së njëmbëdhjeti: Më sipër kam arsyetuar përmes paralelizimit me shëmbuj (të marra nga brënda procesit tim të rivlerësimit por edhe jashtë tij), se në zbatim të parimit të barazisë "dukja e marrëdhënieve miqësore/armiqësore", nuk mjafton për të arritur në konkluzionin e ekzistencës së tyre, pasi njeriu subjektivisht është i prirur të shohë atë që do ose atë për të cilën ka interes të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të shohë. Po shtu edhe e kundërta, subjektivisht nuk shihet ajo që nuk do ose nuk ke interes t'a shohësh.

Procesi i rivlerësimit sipas aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016, nuk zhvillohet sipas parimit të subjektivitetit (madje ndalohet të zhvillohet sipas këtij parimi), por zhvillohet sipas parimit të objektivitetit. Pikërisht në zbatim të këtij parimi, unë i kërkova Komisionit marrjen e provave objektive, me dëshmitarë, për të përmbysur barrën e provës subjektive që më ngarkohet padrejtësisht. Kjo kërkesë m'u refuzua nga komisioni në vlerësimin tim padrejtësisht.
Për rrjedhojë, ia parashtroj këtë kërkesë Kolegjit duke i kërkuar që të të pyeten si dëshmitarë shtetasit:
1- Lulzim Karini. Subjekti që dyshohet se e kam favorizuar në veprimtarinë e tij gjyqësore. Njoftimi të bëhet në vendin e punës, Rruga Don Bosko, Shkodër, afër Gjykatës, ku ushtron profesionin e avokatit.
2- Roland Ilia, ish pegagog i imi dhe i shtetasit Lulzim Karini, dhe në vijim avokat i Dhomës së Avokatisë Shkodër. Ky mund të pyetet nëse ka verejtur ndonjë marrëdhënie të theksuar shoqërore ndërmjet meje dhe shtetasit Lulzim Karini, që nga vitet e shkollimit dhe deri për gjatë viteve ku ai ka ushtruar profesionin e avokatit në Dhomën e Avokatisë Shkodër. Njoftimi të bëhet në vendin e punës, selia e Komisionit të pavarur të Kualifikimit.
3- Sandër Beci, ish pegagog i imi dhe i shtetasit Lulzim Karini, si dhe koleg dhe mik i shtetasit Roland
Ilia. Aktualisht, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
4. Ajola Prençi, motra ime dhe gjithashtu shoqe shkolle në universitet me shtetasin Lulzim Karini. E bëj
unë njoftimin nëse kjo kërkesë pranohet.
5. Solida Dibra, ish juriste e Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, aktualisht drejtoreshë
ekzekutive tek "Kastrati group" sh.p.k. Kjo shtetase ka qënë përfaqësuese e DRSSH Shkodër, në shumë prej gjykimeve për të cilat më ngarkon barrë prove komisioni lidhur me këtë tematikë.
6. Yllka Rupaj, ish juriste e Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, aktualisht anëtare e
Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo shtetase ka qënë përfaqësuese e DRSSH Shkodër, në shumë prej gjykimeve për të cilat më ngarkon barrë prove komisioni lidhur me këtë tematikë.
7. av. Ilir Kuka, anëtar i Dhomës së Avokatisë Shkodër. Ky është letërshkruesi real i dy prej ankesave të bëra nga shtetasi Dedë Preka, mbi bazën e të cilave Komisioni ka ngritur supozimet lidhur me lidhjet e mia me avokatin Lulzim Karini.
8. av. Miranda Ramadani, anëtare e Dhomës së Avokatisë Shkodër, kjo është letërshkruesja e një prej ankesave si dhe ka qënë ish sekretare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
9. Shtetasi Dedë Preka, në emër të të cilit është bërë ankesa.
10. Shtetasit Gentian Sekniqi, Rovena Sekniqi, Bashkim Rroji, Ervin Kruja, Gentian Dumleku, Mirjana Dumleku, shtetas që mund të shpjegojnë rrethanat në të cilat unë kam udhëtuar jashtë shtetit.
11. Çdo avokat në Dhomën e Avokatisë Shkodër, sipas zgjedhjes tuaj të lirë, mund të pyetet nëse ka vërejtur apo jo ndonjë raport afektiv ndërmjet meje dhe shtetasit Lulzim Karini, të tillë që e ka shtyrë të mendojë se do të disfavorizohej në gjykimet e zhvilluara nga unë, në të cilat kishte kundërshtar shtetasin Lulzim Karini.
12. Çdo prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas zgjedhjes tuaj të lirë, mund të pyetet nëse ka vërejtuar apo jo ndonjë raport afektiv ndërmjet meje dhe shtetasit Lulzim Karini, të tillë që e ka shtyrë të mendojë se do të disfavorizohej në gjykimet e zhvilluara nga unë, në të cilat kishte kundërshtar shtetasin Lulzim Karini.

Përveç provave me dëshmitarë, i kam paraqitur Komisionit edhe vendime që nuk i kishte administruar[48], që kanë përfunduar nëmënyrë të disfavorshme për avokatin Lulzim Karini, që datojnë në kohë përpara se unë të njihesha me raportin që Komisioni më ka dërguar dhe përmes më është ngarkuar si barrë prove, në thelb, për të vërtetuar që nuk e kam favorizuar avokatin Lulzim Karini. (p.*sh vendimi me paditës Gile Martingilaj të paditur Gjon Dukgila, ku av. Lulzim Karini ka qënë përfaqësues i paditësit dhe unë, në cilësinë e gjyqtarit, kam disponuar rrëzimin e padisë*).

<u>Së dymbëdhjeti</u>: Për të vërtetuar faktin që ekzistenca e marrëdhënies së konfliktit të interesit për të cilën më ngarkohet barra e provës, nuk është e vërtetë, do i lutem Kolegjit të arsyetojë paraprakisht, mbi faktin që nëse kjo marrëdhënie të ishte e tillë, do duhej të ishte fakt i njohur publikisht ose botërisht. Nëse do kishim të bënim me një fakt të tillë, atëhere ndonjë nga palët dhe/apo përfaqësuesit e tyre do t'a ngrinin si shkak për përjashtimin tim nga ushtrimi i detyrës gjyqësore në ndonjë çështje konkrete. Kjo qartazi nuk ka ndodhur në 122 çështjet ku ky avokat është përfshirë. Ka vetëm dy ankesa, që janë shkruar nga e njëjta dorë, që është avokati Ilir Kuka, në emër të denoncuesit Dedë Preka dhe një kallzim në SPAK, që po ashtu është shkruar nga Avokati Ilir Kuka, në emër të shtetasit Dedë Preka. Po të ishin të bazuara këto dy ankesa si dhe po të ishte fakt i njohur botërisht ose publikisht, konflikti i interesit për të cilin më ngarkohet barra e provës, atëherë Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë (ose edhe SPAK) do të vepronin, pasi qënia e gjyqtarit në konflikt interesi parashikohet në ligj si shkak pavlefshmërie absolute, me pasojë prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me tjetër trup gjykues. Po ashtu, do të kishte ndonjë rast të individualizuar nga Koimisioni, që unë të jem përjashtuar nga gjykimi, pikërisht për shkak të ekzistencës së konfliktit tim të interesit me avokatin Lulzim Karini. Nuk ka asnjë vendim të tillë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, (vendim përjashtimi). <u>Madje ka një vendim të kundërt (që Komisioni e ka të administruar) të dhënë nga gjyqtarja Kostandina Kuro në një çështje personale të avokatit Ilir Kuka (që është një nga letërshkruesit në emër të shtetasit Dedë Preka, që unë kërkoj t'a thërras si dëshmitar)</u>. Në këtë çështje që i përket denoncueses Elsa Kamata, që është bashkëshortja e Avokatit Ilir Kuka, vendimi përmbyllës i procedurës gjyqësore i marrë nga unë në këtë rast, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, duke u konfirmuar kështu në mënyrë të nënkuptuar mosqënia ime në kushtet e konfliktit të interesit, për të cilën shpif avokati në fjalë, për motive hakmarrjeje ndaj vendimit që unë kam marrë si gjyqtar[49]. <u>Nuk ka gjithashtu, as vendime të tilla nga Gjykata e Apelit Shkodër, apo nga Gjykata e Lartë, që t'a kenë konfirmuar gjendjen e konfliktit të interesit ndërmjet meje dhe avokatit Lulzim Karini. Zero. Asnjë vendim gjyqësor të tillë</u>.

<u>Së trembëdhjeti</u>: Për të argumentuar mungesën e dukjes së konflitit të interesit, do i kërkoja Kolegjit të ketë parasysh se në listën e 122 çështjeve gjithsejt, ku ka marrë pjesë shtetasi Lulzim Karini, (të përmëndura në aneksin 2 të raportit), nga Gjykata e Apelit, janë cënuar vetëm 4 vendime, ndërsa 7 të tjera presin radhën e gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe/apo në Gjykatë e Lartë. Pra 122 - 4 – 7 = 111vendime të formës së prerë që janë përfundimtare. Kjo është mbi 91% e 122 çështjeve në fjalë.

[48] Shih shënimin në fund të faqes 246 të këtij ankimi.
[49] Edhe kjo provë e favorshme për mua nuk përmendet në vendimin e Komisionit.

Për këto 111 vendime që përbëjnë gjë të gjykuar, në nenin 451/a të Kodit të Procedures Civile parashikohet se: *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e*
tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.
Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.
Këto 111 vendime që përbëjnë gjë të gjykuar, janë tashmë pjesë e rendit juridik dhe fuqia detyruese e tyre shtrihet edhe mbi autoritetin e KPK-së. Duke mos dashur të zgjatem shumë, do i kërkoja Kolegjit që për këto 111 vendime të ketë parasysh jurisprudencën e konsoliduar si të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ashtu edhe të Gjykatës Kushtetuese, në rastin e magjistratëve Sokol Ngresi, (që ka kaluar vetingun), Gjinovefa Gaba, Vasil Minga, Theodhori Sollaku, Arben Rakipi, etj, lidhur me pyetjen – A mund të lind përgjegjësia dispiplinore e gjyqtarit, kur vendimi i dhënë prej tij, ka marrë formë të prerë pa u cënuar në Gjykatat më të larta, dhe nëse po, në çfarë rastesh? Ju sjell në vëmëndje se sipas kësaj praktike jurisprudenciale që është e detyrueshme edhe për KPK-në, përgjigjja e këtyre pyetjeve është qartësisht JO, përveç rasteve flagrante kur nga provat e administruara vërtetohet pa hije dyshimi se gjyqtari, ka vepruar për motive të përfitimit personal, si korrupsioni, konflikti faktik i interesit, etj.

Sipas kësaj praktike jurisprudenciale, gabimet e parëndësishme dhe që nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë shkakësore me rastet flagrante në të cilat provohet katërcipërisht se gjyqtari ka vepruar duke u shtyrë nga motive dhe qëllime të përfitimit personal dhe/apo të konfliktit faktit të interesit, nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme fakti, as për të filluar procedim disiplinor dhe aq më pak për t'a shkarkuar gjyqtarin nga detyra. Kur këtyre gabimeve gjyqësore të parëndësishme, iu mungon provueshmëria e padyshimtë e lidhjes shkakësore me motivet dhe qëllimet në fjalë, ose kjo lidhje shkakësore dhe/apo këto motive/qëllime nuk provohen, atëhere gabimet gjyqësore duhet të riparohen vetëm në rrugën gjyqësore
përmes ankimimit në Gjykatat më të larta. Çdo veprim i kundërt, cënon pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Së katërmbëdhjeti: Nga 11 vendimet që mbeten nga tërësia e 122 vendimeve të përmëndura në aneksin
2 të raportit, vetëm 3 janë cënuar me vendim të formës së prerë që është përfundimtar. Edhe këto 3 vendime (nga 122) nuk janë cënuar për shkakun e konfliktit të interesit për të cilin më është ngarkuar barra e provës. 3 çështjet për të cilat janë dhënë këto vendime, janë dy me objekt njohje vjetërsie në punë për efekt pensioni, ndërsa 1 rast në të cilin avokati Lulzim Karini, ka qënë mbrojtës i caktuar kryesisht. Pra, në këto 3 rastë, si sensibiliteti i vogël publik i çështjeve (në dy raste) ashtu edhe pozicioni i pjesmarrjes së shtetasit Lulzim Karini, (si mbrojtës kryesisht), në një rast, e përjashtojnë qartazi ekzistencën e konfliktit të interesit tim për të cilën më ngarkohet barra e provës.

Së pesëmbëdhjeti: Nga tërësia e 122 vendimeve që përmënden në aneksin 2 të raportit, 6 presin radhën e gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër, ndërsa 2 presin radhën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Unë vlerësoj se Komisioni në trajtimin e këtyre 6+2=8 vendimeve, duhet të ketë parasysh nenin 36 paragrafi

3 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se: Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për
shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata. Nëse komisioni nuk e pranon
këtë arsyetim, lidhur me këto 8 vendime, atëherë unë sipas nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile, që
është i zbatueshëm së bashku me ligjin 48/2012 "Për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe krijimin e Gjykatave Administrative si dhe me ligjin /2015 "Kodi i Procedurave i Republikës së Shqipërisë", si dhe me ligjin 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", i parashtroj si kërkesë procedurale trupës gjykuese, kërkesën me objekt pezullimin e procesit tim të rivlerësimit kalimtar, deri në përfundimin e këtyre 8 çështjeve, për të cilat Komisioni ka të dhëna të administruara se ndodhen në Gjykatën e Lartë.

<u>Së gjashtëmbëdhjeti</u>: Përveç shëmbujve (që i referohen 1. Subjektit të rivlerësimit Ilir Toska dhe, 2. lidhjes në dukje, ndërmjet komisionerëve Roland Ilia dhe Pamela Qirko si dhe komisioneres Genta Bungo me subjektet Dritan Hallunaj, Ledina Riza, Agron Bushati, etj), si dhe dëshmitarëve të sipërpërmëndur, unë për të vërtetuar mungesën e konfliktit të interesit me shtetasin Lulzim Karini, në rast se nuk më pranohet thirrja e tij si dëshmitar, kërkoj që ai, në referim të nenit 192 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile, të thirret si person i trete (palë e interesuar) në procedimin administrativ që po zhvillohet për rivlerësimin tim kalimtar. Në këtë dispozitë përcaktohet secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim që lidhet me përfundimin e çështjes. Në çmuarjen time kjo dispozitë ligjore duhet është e zbatueshme së bashku me ligjin 48/2012 "Për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe krijimin e Gjykatave Administrative si dhe me ligjin /2015 "Kodi i Procedurave i Republikës së Shqipërisë", si dhe me ligjin 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", i parashtroj si kërkesë procedurale trupës gjykuese, kërkesën me objekt pezullimin e procesit tim të rivlerësimit kalimtar, deri në përfundimin e këtyre 8 çështjeve, për të cilat Komisioni ka të dhëna të administruara se ndodhen në Gjykatën e Lartë.

<u>Unë besoj se krahas dispozitave ligjore në fjalë, Kolegji e di se çdo organ shtetëror qoftë gjyqësor apo administrativ, në zbatim të nenit 6 paragrafët 1 dhe veçanarisht paragrafi 2 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, (dhe nenit 17/2 dhe 42 të Kushtetutës), e ka të ndaluar jo vetëm të ndyejë por edhe të bëjë objekt bisedimi emrin, ndershmërinë dhe pafajësinë e tjetrit, pa i dhënë paraprakisht të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.</u> Meqënëse, Komisioni në raport mua më ka quajtur bashkëpunëtor me shtetasin Lulzim Karini në dhënie/marrje favoresh gjyqësore, atëherë duhet jo vetëm të thirret ky shtetas për të marrë pjesë si palë në proces, por edhe t'i krijohet mundësia të mbrojë emrin, personalitetin, ndershmërine dhe pafajësinë tij, të cilat krahas të miave po i vihen edhe atij në diskutim. Pikërisht, mbrojtjen që ky shtetas do ti bëjë vetes së tij, unë kërkoj ta përdor si mjet provues, pra fakt juridik që vërteton mosekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit që Komisioni përmes raportit që më ka dërguar, m'a ka ngarkuar si barrë prove.

Komisioni lidhur me shpjegimet që kam dhënë dhe kërkesat procedurale të parashtruara me qëllim për të përmbysur barrën e provës lidhur me shtetasin Lulzim Karini, shprehet si më poshtë:

67.5. Për sa i përket shpjegimeve të subjektit në lidhje me barrën e provës, ato nuk janë bindëse. Në kërkesën e z. I.K nuk gjendet asnjë e dhënë për sa i përket adresës së banimit të tij apo numër kontakti për të bërë të mundur njoftimin e tij nga ana e sekretarisë gjyqësore, sikundër pretendohet nga subjekti. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar njoftimi i këtij shtetasi, detyrim ligjor i parashikuar nga neni 128 i Kodit të Procedurës Civile i kohës së shqyrtimit të çështjes gjyqësore, ku parashikohet se thirrja në gjykatë bëhet me letërthirrje, e cila si rregull njoftohet me anë të nëpunësit gjyqësor. Neni 144 i Kodit të Procedurës Civile, të cilit i referohet subjekti në prapësime në kohën e shqyrtimit të çështjes gjyqësore, parashikonte se gjykata mund të urdhërojë me vendim edhe mënyra të tjera njoftimi nga ato të parashikuara nga ligji, si nëpërmjet telegramit me përgjigje, me faks kur vërtetohet me shkrim marrja e tij, me shkresë dorazi e me mënyra të tjera që garantojnë një njoftim të rregullt, kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë.

67.6. Lidhur me konfliktin e interesit, Komisioni vlerëson se subjekti, për sa kohë ka gjykuar një çështje, ku si palë është paraqitur babai i një personi, me të cilin ka pasur njohje shoqërore dhe familjare, bazuar në nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja, në zbatim të nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

.....

95.11. Në vlerësimin e kësaj çështjeje, Komisioni mban në konsideratë faktet e mëposhtme të rezultuara nga hetimi:

i) Subjekti ka udhëtuar disa herë me shtetasin L.K, me të cilin ka qenë shok klase vetëm në prani të bashkëshortes ose në prani të rrethit shoqëror, udhëtime këto të shtrira në kohë, kryesisht në raste festash.

ii) Subjekti ka pranuar se z. K ka pasur numrin e tij të telefonit dhe i ka dërguar mesazhe për shtyrjen e seancave, të paktën në një rast të evidentuar. iii) Subjekti ka gjykuar çështje gjyqësore me palë babain e z. K, ku në njërën prej tyre janë konstatuar dhe gabime thelbësore (të pranuara dhe nga vetë subjekti) dhe serioze.

iv) Në të gjitha çështjet gjyqësore të gjykuara nga ana e subjektit, ku përfaqësues i njërës palë ka qenë z. K (si në kohën kur ka qenë avokat, ashtu dhe kur ka qenë drejtues i EKB-së), nga ana e subjektit në asnjë rast prej tyre nuk është vendosur rrëzimi i padisë, fakt i cili i parë më vete nuk lidhet me gjendjen e konfliktit të interesit.

v) I pyetur në seancë nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti ka deklaruar se mund të ketë pirë edhe ndonjë kafe me z. K, specifikisht duke iu referuar vitit të fundit ai pretendon se mund të ketë ndodhur një apo dy herë, por nuk e mban mend.

vi) Gjithashtu, për aspekte të ndryshme të marrëdhënies së tij me z. K në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të deklaronte pothuajse asgjë për shoqërimin e tyre ose kohën e kaluar së bashku në ngjarje shoqërore ose profesionale. Subjekti i rivlerësimit nuk e kundërshtoi faktin që z. K ishte shok shkolle i cili kishte përfaqësuar palët në mbi 100 çështje para subjektit

të rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk i kundërshtoi provat se z. K dhe subjekti i rivlerësimit kishin bërë udhëtime të shumta ndërkufitare në festa dhe raste të tjera, ndonjëherë me anëtarë të familjes të pranishëm. Kur iu kërkuan detaje në lidhje me bisedat e tyre, angazhimin e tyre shoqëror ose detaje bazë për z. K, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të jepte pothuajse asnjë informacion, të gjitha në një përpjekje për t'u distancuar nga ky shtetas.

95.12. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, germat "dh/i" dhe "v" të ligjit nr. 9367/2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" për shkak të marrëdhënies së provuar shoqërore dhe familjare me shtetasin L.K. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 17, pika 1, germa "ë" e Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja në zbatim të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

.....

95.13. Në mbështetje të sa më sipërarsyetuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar që me veprimet e tij të shmangë dyshimin për paanësinë e tij, duke mos paraqitur dorëheqjen nga çështjet e gjykuara prej tij bazuar në nenin 17, pika 1, germa "ë" e Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 72/6 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, duke afektuar kështu indikatorin e parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/201624, sa i përket kujdesit ndaj konfliktit të interesit. Në kushtet kur janë evidentuar 122 raste të konfliktit të interesit bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit me konsideratë rrethanat e çështjes, ky konflikt interesi do të ishte i mjaftueshëm për të afektuar kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

Në bindjen time më të thellë i gjithë arsyetimi i mësipërm i Komisionit, është abuziv, keqdashës i padrejtë dhe për rrjedhojë i paligjshëm: Kjo pasi:

1. Nuk merr parasysh asnjë nga shpjegimet e mia, të cilat jo vetëm nuk merret mundimi që të hidhen poshtë por madje as nuk citohen të plota në vendimin e Komisionit.

2. Komisioni konstaton se kam shkelur "*nenin 5, pika 1, germat "dh/i" dhe "v" të ligjit nr. 9367/2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" për shkak të marrëdhënies së provuar shoqërore dhe familjare me shtetasin L.K.* Kjo është baza ligjore ku e referon vendimin e tij.

Referimi në *shkonjën "dh/i",* është i gabuar. Kjo pasi norma flet për kufizimin e interesave private të zyrtarit "për shkak të marrëdhënieve të bashkëjetesës". Se ku m'a gjeti marrëdhënien e bashkëjetesës Komisioni mua me shtetasin Lulzim Karini, jo vetëm që nuk kuptohet por madje as mund të kuptohet. Kjo është thjesht e pavërtetë.

Referimi në *shkonjën "v",* është po ashtu i gabuar. Kjo pasi norma flet për kufizimin e interesave private të zyrtarit "për shkak të marrëdhënieve të njohura të miqësisë apo armiqësisë". Ftoj Kolegjin të përqëndrohet tek cilësori "të njohura", që dikton natyrën e marrëdhenieve. Po të ishin këto marrëdhënie të njohura, do të ishtë ngritur ndonjëherë si shkak përjashtimi dhe/apo ankimi

gjyqësor marrëdhëniet e mia me avokatin Lulzim Karini, në gjykimet që kam marrë pjesë së bashku me të[50]. Vetë fakti që janë ngritur ndonjëherë pretendime të kësaj natyre, pra zero, asnjë, tregon që këto marrëdhenie nuk kanë qënë të njohura. Veç kësaj, ftoj Kolegjin të përqëndrohet tek kryefjalët e fjalisë që përmban dispozitivi i normës, dhe që janë miqësi/armiqësi. Sipas gjuhës shqipe, mik është një person që ke apo ke patur në të shkuarën interesa të përbashkëta jetësore, të rëndësishme dhe serioze, nga shfrytëzimi i të cilave t'i ke mundur të marrësh kënaqësi nga jeta. A mund të më thuhet se çfarë interesash të tilla, të rëndësishme dhe serioze, kam patur apo kam unë me shtetasin Lulzim Karini. Zero, asnjë. Fakti që më ka transportuar 5 herë me makinë në vitet 2007-2013, (dhe përveç tyre 1 herë kam udhëtuar me furgon ku ka qëlluar që ka qënë edhe shtetasi në fjalë), tregon natyrën e rastësishme të këtyre udhëtimeve. Nuk tregon ndonjë interes të rëndësishëm dhe serioz jetësor as timin dhe as të subjektit tjetër. Fakti që udhëtimet kanë qënë të rastësishme vërtetohet edhe nga fakti se nga 5 transportimet me makinë për në Mal të Zi, po të kqyret sistemi TIMS, duket qartë se 2 prej tyre, unë dhe bashkëshortja, vetëm jemi kthyer për në Shkodër nga Mali i Zi përmes makinës së Lulzim Karinit. Pra tregon se jemi takuar rastësisht në Mal të Zi, dhe meqënëse nuk kemi patur makinë, dhe ndërkohë ky shtetas po kthehej në Shkodër, (pasi kishte qënë në Mal të Zi për punët e veta), n'a ka marrë edhe neve. Kjo është edukatë, mirësjellje, jo miqësi.

Pra, nga 6 udhetimet (ndërmjet viteve 2007-2013), rezulton se 1 ka qënë në furgon së bashku me të tjerë[51], 2 qartazi rastësore, ndërsa 3 të tjera prapë për shkak të mungesës së sëriozitetit të tyre, (bëhet fjalë për një transport 5-10 km linearë), nuk mund të konsiderohen si tregues miqësie. Rethanat në të cilat janë bërë këto udhëtime, i kam shpjeguar më sipër.

3. Komisioni thotë të pavërtetën kur shprehet se *Subjekti ka pranuar se z. K ka pasur numrin e tij të telefonit dhe i ka dërguar mesazhe për shtyrjen e seancave, të paktën në një rast të evidentuar.* Fakti që një subjekt ka numrin tënd të telefonit, nuk do të thotë që ti ia ke numrin atij. Pastaj kjo puna e zmadhimit që bën Komisioni më fjalët, "*i ka dërguar mesazhe për shtyrjen e seancave, të paktën në një rast të evidentuar",* është qartazi abuzivitet. Kjo pasi nuk ka patur rast të tillë përveç njërit (rasti Ariana Muja), si dhe edhe në këtë rast, sikurse shpjegova më sipër, unë jam njeri dhe ia shtyva seancën avokatit pasi e kishte baban duke i vdekur.

4. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se "*Subjekti ka gjykuar çështje gjyqësore me palë babain e z. K, ku në njërën prej tyre janë konstatuar dhe gabime thelbësore (të pranuara dhe nga vetë subjekti) dhe serioze",* bëhet fjalë për një çështje me objekt dëshmi trashëgimie, gjykim i karakterit gracioz. Lidhur me këtë çështje vetë komisioni, e pranon në vendim se rëndësia e gabimit është aq e vogël sa nuk sjell si pasojë penalizimin automatik të subjektit të rivlerësimit. Për këtë çështje do shprehem në vijim, por këtu po mjaftohem të them se përmëndja e kësaj çështjeje nga Komisioni është tregues i qartë i abuzivitetit, i dëshirës së tij që me çdo kusht të gjejë, dhe në mos të gjejë, të intepretojë rrethana në atë formë që të përputhen me qëllimin e dëshiruar prej tij paraprakisht, që ka qënë shkakrimi im nga detyra e gjyqtarit.

5. Lidhur me konstatimin e Komisionit se "*Në të gjitha çështjet gjyqësore të gjykuara nga ana e subjektit, ku përfaqësues i njërës palë ka qenë z. K (si në kohën kur ka qenë avokat, ashtu dhe kur ka qenë drejtues i EKB-së), nga ana e subjektit në asnjë rast prej tyre nuk është vendosur*

[50] Shih arsyetimin e përdorur nga unë në fq. 258 të ankimit.

[51] Komisioni poshtërsisht këta të tjerët që ndodheshin në furgon i cilëson me emrin "shoqëri e përbashkët".

rrëzimi i padisë, fakt i cili i parë më vete nuk lidhet me gjendjen e konfliktit të interesit", ***evidentoj se kjo rrethanë është e pavërtetë***. Komisioni thotë të pavërtetën në vendim se nuk ka asnjë vendim për rrëzimin e padisë ku ka qënë përfaqësues i paditësit av. Lulzim Karini. **P.sh unë kam paraqitur si provë vendimin me paditës Gilë Martingilaj i paditur Gjon Dukgilaj, me objekt kthim sendi, ndërtesë (bar-restorant-hotel Tradita) dhe vetëm vlera objektit material të gjykimit i kalon 2 milion euro.** Kjo padi është rrëzuar dhe vendimi i marrë nga unë i tejkalon nga pikpamja e vlerës material me disa fish, vlerën e të gjitha vendimeve për pensioneve të kooperative ku ka qënë avokat i paditësve, shtetasi Lulzim Karini, që përbëjnë thuajse të gjitha çështjet ku ai ka marrë pjesë në gjykime me mua.
(Edhe në këto gjykime pensionesh, që më të shumtën kanë qënë vërtetime fakti pa palë kundërshtare, ka raste pushimi gjykimi, pra jo pranim padie, kthime aktesh me të meta, nxjerrje çështjesh jashtë juridiksioni/kompetence, etj[52]).

Unë vendimin e lartëpërmëndur, të rrëzimit të padisë, e kam marrë më përpara në kohë se të njihesha me raportin e Komisionit që më ngarkonte barrë prove për të vërtetuar të kundërtën apo mungesën e marrëdhënieve miqësore me shtetasin Lulzim Karini. Ky vendim, qëllimisht dhe me dashakeqësi, nuk përmendet ne vendimin e Komisionit me të cilin unë jam shkakruar nga detyra e gjyqtarit. Kjo pasi qartazi do ishte provë në favorin tim dhe do hidhej kësisoj poshtë gjithë arsyetimi abuziv, supozues, i pavërtetë dhe i paprovuar që unë kam patur lidhje miqësore dhe familjare të shtrira në kohë me avokatin Lulzim Karini.

6. Lidhur me arsyetimin e Komisionit që "*Gjithashtu, për aspekte të ndryshme të marrëdhënies së tij me z. K në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të deklaronte pothuajse asgjë për shoqërimin e tyre ose kohën e kaluar së bashku në ngjarje shoqërore ose profesionale. Subjekti i rivlerësimit nuk e kundërshtoi faktin që z. K ishte shok shkolle i cili kishte përfaqësuar palët në mbi 100 çështje para subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk i kundërshtoi provat se z. K dhe subjekti i rivlerësimit kishin bërë udhëtime të shumta ndërkufitare në festa dhe raste të tjera, ndonjëherë me anëtarë të familjes të pranishëm. Kur iu kërkuan detaje në lidhje me bisedat e tyre, angazhimin e tyre shoqëror ose detaje bazë për z. K, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të jepte pothuajse asnjë informacion, të gjitha në një përpjekje për t'u distancuar nga ky shtetas".* Ky konstatim është abuziv, pasi bazohet në presisën subjektive se "po nuk mbajte mend, je fajtor". Ky lloj arsyetimi nuk është në përputhje me parimin e objektivitetit.

Veç kësaj, arsyetimi i Komisionit, deformon të vërtetën përmes lojrave të fjalëve, "udhëtime të shumta", "kryesisht, në raste festash", apo "shoqëri e përbashkët". Kjo është dashakeqësi në intepretimin e fakteve. Nëse Komisioni i referohet udhëtimit me furgon në rastin e festave të nëntorit bëj me dije Kolegjin se sikurse e shpjegova edhe më sipër, ky udhëtim ka qënë me një furgon që n'a siguroi agjensia turistike. Ne (unë dhe bashkëshortja) as e dinin dhe as mund t'a dinin që do udhëtonte në këtë furgon edhe shtetasi Lulzim Karini. Le që pastaj, edhe po t'a dinin, çfarë !!! Ky fakt është aq i parëndësishëm sa tregon dëshmërimin e Komisionit për të sajuar lloj lloj arsyetimesh subjektive, me qëllim për të argumentuar gjoja "konfliktin e interesit tim në lidhje me shtetasin Lulzim Karini". Në një udhëtim tjetër, kohë festash, ne vetëm jemi kthyer në Shkodër, nga Mali i Zi. Këto kanë qënë dy rastet e vetme të festave.

[52] Këto është nuk referohen me keqdashje nga Komisioni në vendimin që unë po ankimoj pasi janë prova në favorin tim.

7. Sipas nenit 5 të Ligjit 9367/2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", për të ekzistuar konflikti i interesit, duhet të vërtetohet se e kam kryer detyrën në mënyrë të padrejtë. Sikurse do shihet në vijim, asnjë rast i vetëm nuk është konstatuar nga Komisioni që të kem dhënë vendime të padrejta në raport me shtetasin Lulzim Karini[53]. Po ashtu, i lutem Kolegjit që të ketë parasysh nenin 4/2 të Ligjit që përcakton se "kush quhet akt i aftë"[54] për të vendosur zyrtarin në kushtet e konfliktit të interesit dhe konkretisht i tillë quhet vetëm vendimi përfundimar gjyqësor. Kjo pasi norma e nenit 4 të Ligjit parashikon se "*vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit".*
Kjo ka shumë rëndësi, pasi nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, duket qartë se konflikti im i supozuar i interesit me shtetasin Lulzim Karini, ***nuk tentohet të argumentohet përmes drejtësisë/padrejtësisë së supozuar të vendimeve përfundimtare të dhëna nga unë, por përmes vendimeve të ndërmjetme***, (si p.sh shkeja e afat ligjor të parashikuar në nenin 155/1 të KPC për caktimin e seancës gjyqësore, shkelja e rregullave të njoftimeve, etj)[55]

8. Sipas nenit 3 të Ligjit 9367/2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", ***për të ekzistuar konflikti i interesit, duhet të argumentohet pasoja e kundërligjshme nga kryerja e detyrës në mënyrë të padrejtë ose minimalisht mundësia e ardhjes së saj***. Ky arsyetim nuk përfshihet fare në vendimin e Komisionit. Përkundrazi, unë në shpjegimet e mia kam arsyetuar se jo vetëm që në të gjitha rastet e kam kryer detyrën e gjyqtarit në mënyrë të drejtë por edhe se nuk ka patur pasoja të paligjshme dhe madje as që mund të vinin pasoja të paligjshme nga veprimtaria ime gjyqësore.

9. Nuk ka asnjë fotografi, apo provë që tregon se unë dhe shtetasi Lulzim Karini, kemi marrë pjesë në dasma, ditëlindje, ceremoni varrime, festa, etj, së bashku. Nuk ka asnjë provë të vetme se unë e kam telefonuar shtetasin Lulzim Karini, ose i kam uruar vitin e ri, apo ngjarje të gëzueshme familjare. Në mungesë të tyre, si mund të ngrihet supozimi se unë e paskam mik këtë shtetas. Fakti që unë nuk mbaj mend çfarë kam biseduar me të në takimet e rastësishme, nuk tregon dëshirën time për distancim prej tij, por po të intepretohet drejt tregon se bisedat kanë qënë aq të parëndësishme për interesat e mia jetësore sa kujtesa nuk është e prirur t'i mbaj mend. P.sh e mbajnë mend Komisionerët e trupës që Komisionit që më kanë shkakrkuar nga detyra, çfarë kanë biseduar me njëra tjetrën në datat 28.2.2019, 24.03.2018, 12.05.2022, etj. Nëse nuk i mbajnë mend a mund të konsiderohen fajtore apo thjesht mund të ngrihet supozimi objektiv se bisedat mund të kenë qënë të parëndësishme dhe për rrjedhojë janë fshirë nga kujtesa e tyre.

---

[53] Me përjashtim të një rasti që unë kam dalë në pakicë dhe Komisioni në vendim shpif se nuk kam dalë në pakicë, që e trajtova tek pjesa "shkaqet e ankimit", e titulluar se trembëdhjeti, por që do e trajtoj edhe në vijim.

[54] 2. Për qëllimet e këtij ligji:
a) ***vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit****;*
b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit;
c) një zyrtar'" ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

[55] Të cilat në vijim do argumentohet se as këto pretendime të komisionit nuk qëndrojnë.

Tani le të kalojmë tek analizimi një për një i çështjeve që më përmënden në kriterin e figurës. Pra të 12 çështjeve.

<u>Së pari</u>: **Lidhur me çështjen gjyqësore, të regjistruar në datë 14.07.2005, me kërkues Izet Karini dhe objekt "Lëshim urdhër ekzekutimi të vendimit nr.810 dt.10.05.2004"**. Komisioni ka konstatuar se unë kam disponuar me vendimin e datës 14.07.2005, "Pranimin e kerkeses". Po sipas Komisionit, nga shqyrtimi i fashikullit gjyqësor konstatohet:

1. Nuk gjendet njoftimi dërguar palës kërkuese për caktimin e seancës gjyqësore.

2. Z. Izet Karini rezulton të jetë babai i z. Lulzim Karini, me të cilin rezulton e provuar se subjekti ka patur njohje shoqërore dhe familjare (trajtuar në detaje në kriterin e aftësive profesionale).

Mbi bazën e këtyre konstatimeve, Komisioni ka arritur në konkluzionin që duket se:

 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare.

 Për rrjedhojë ngrihen dyshime për favorizimin e z. Izet Karini duke marrë në konsideratë dhe faktin që nuk gjendet njoftimi i z. Karini për zhvillimin e seancës gjyqësore Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe të paraqesë vendime me të njëjtin objekt të përfunduar brenda 4 ditëve.

Lidhur me këtë barrë prove, kam për të thënë sa më poshtë:

1. Konflikti i supozuar i interesit, u argumentua më sipër hollësisht se nuk ekziston dhe për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme që të kaloj në përsëritje.

2. Lidhur me mungesën e njoftimit, përpara se Kolegji të arrijë në ndonjë përfundim, duhet të ketë parasysh se kryerja e njoftimit, nuk është detyrë e gjyqtarit por e sekretarit gjyqësor dhe nëpunësit gjyqësor, (ftuesit), sipas neneve 77/3 dhe 78/2 të KPC, që parashikojnë se:

Neni 77/3 "*Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor*".

Neni 78/2: *Punonjësi i gjykatës është përgjegjës për kryerjen e rregullt të njoftimeve. Ai merr masa për realizimin e kërkimeve të nevojshme në lidhje me adresën e personit që i drejtohet njoftimi, në regjistrat publikë, në organet e administratës shtetërore, në familje dhe tek të afërmit, në vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit të personit që i drejtohet njoftimi, ose nëpërmjet burimeve të tjera të mundshme*.

3. Gjyqtarit ka kompetencë mbikqyrëse dhe kontrolluese përkundrejt sekretarit dhe ftuesit që e ushtron kur është nevoja dhe rasti i përshtatshëm, por në rastin konkret vetë fakti i paraqitjes së të njoftuarit në gjykim, ka bërë që sipas vlerësimit tim, të bien në dekadencë pretendimet e mundshme lidhur me njoftimin e shtetasit Izet Karini. Kjo sipas nenit 119 të KPC që parashikon se *Akti procedural që nuk është kryer në formën që kërkohet shprehimisht nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm. Akti mund të shpallet i pavlefshëm edhe kur i mungojnë të dhënat e domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij.*

Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar.

4. Nuk ka asnjë kuptim as juridik dhe as logjiko-praktik që unë të shtyja seancën gjyqësore për pavlefshmërinë e njoftimit të kërkuesit Izet Karini, ndërkohë që ai u paraqit në gjykim.

5. Nuk ka sekretar gjyqësor në Republikën e Shqipërisë që në veprimtarinë e tij, që për arsye praktike (për t'u mos u mbingarkuar) nuk aplikon lidhur me njoftimet nenin 144 të KPC, që parashikon "Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur
konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin". Në rastin konkret, paraqitja e shtetasit Izet Karini dhe dokumentimi i faktit të paraqitjes me procesvërbal gjyqësor, nuk është gjë tjetër veçse konfirmim me shkrim i faktit që njoftimi ka qënë jo vetëm bindës por edhe se e ka realizuar qëllimin për
të cilin është destinuar.

6. Lidhur me barrën e provës për të paraqitur vendime të ngjashme, të gjykuara brënda 4 ditëve nga rregjistrimi, do t'a përmbush.

7. Kjo natyrë çështje nuk ka pikën e sensibilitetit publik dhe kontrolli i saj nuk shërben për të rikthyer besimin publik në organet e drejtësisë. Unë mendoj se shkarkimi im nga detyra e gjyqtarit se kam gabuar në gjykimin e kësaj çështjeje (gjë që faktikisht nuk ka ndodhur), është njësoj sikurse të shkarkohem si gjyqtar për shkak të faktit se kam bërë gabime ortografike në ndonjë vendim. Pra, një gjë e tillë qartazi bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

8. Unë vlerësoj se veprimi i komisionit për të më ngarkuar barrë prove lidhur me këtë çështje, duke u vlerësuar në sintezë me faktin se në trupin gjykues tre komisionerët janë në konflikt interesi lidhur me mua, nuk bëhet me qëllim rikthimin e besimit të publikut por bëhet me qëllim detyrimin e tim që të merrem me gjethe, pupla, tollumbace dhe kësisoj të hallakatem, të humbas kohë fizike dhe energji mendore, pra të shpërqëndrohem, duke mos e ushtruar efektivisht të drejtën e mbrojtjes.

9. Po të merret në konsideratë kjo çështje për shkarkimin tim nga detyra, atëherë duhet minimalisht ti fillojë procedim disiplinor kryesueses së trupës Pamela Qirko, për faktin se ndonëse duket se ajo është në konflikt interesi me mua, (për shkak të miqësisë që ka me komisionerin Roland Ilia dhe shkaqe të tjera), ajo përpara se të zhvillohej seanca e datës 27.06.2022 (ku isha njoftuar paraprakisht për orën dhe sallën në të cilën do të zhvillohej seanca dëgjimore), nuk më njoftoi ndryshimin e vendit ku do të zhvillohej seanca dëgjimore e kësaj date, në mënyrat e parashikuara në ligjin 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve". Kjo sipas parimit të trajtimit të barabartë përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve. Natyrisht, edhe unë mendoj se kjo është jo vetëm e paligjshme por edhe absurditet logjik që të mendohet dhe veprohet.

10. ***Arsyetimit të mësipërm, i shtoj edhe atë se kjo çështje, është jashtë periudhës së vlerësimit për qëllimet e vlerësimit profesional***.

Së dyti: **Lidhur me çështjen gjyqësore, të regjistruar në datë 24.09.2014, me kërkues Izet Karini me**

objekt "sigurim prove", komisioni ka konstatuar se në përmbajtje të dosjes evidentohet vendim "Mbi caktimin e çështjes në seancë gjyqësore", përmes së cilit subjekti i rivlerësimit ka vendosur kalimin e
çështjes në seancë gjyqësore si dhe caktimin e seancës në datë 25.09.2014 ora 11:30. Në lidhje me këtë kërkesë është zhvilluar vetëm një seancë gjyqësore ne date 25.09.2014. Në përfundim të kësaj seance subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejimin e sigurimit të provës duke u pranuar kërkesa për kqyrjen e ndërtimit në marrëdhënie fqinjësore me pasurinë e kërkuesit. Referuar procesverbalit që i bashkëlidhet vendimit gjyqësor, rezulton se subjekti së bashku me sekretaren gjyqësore dhe kërkuesin kanë kryer kqyrjen në datë 26.09.2014. Për sa më sipër duket se:

 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare.

 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me këtë barrë prove, kam për të thënë sa më poshtë:

1. Konflikti i supozuar i interesit, u argumentua më sipër hollësisht se nuk ekziston dhe për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme që të kaloj në përsëritje.

2. Lidhur me konfliktin e interesit, po t'i referohemi ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", është e qartë se vendimi i marrë për pranimin e kërkesës me objekt sigurim prove, është një vendim i ndërmjetëm, që nuk mund të shërbejë si bazë fakti për t'a vendosur zyrtarin në gjendjen e konfliktit faktit, në dukje, të mundshëm apo të vazhdueshëm të interesit. Kjo pasi kqyrja dhe fotografimi i bërë në zbatim të këtij vendimi, nuk përbën ndonjë kompetencë as thelbësore dhe as jo thelbësore që ka ndikuar apo mund të ndikonte në vlerësimin pasues me vendimarrje nga unë si gjyqtar në gjykimin e ndonjë çështjeje konkrete.

<u>Së treti</u>: **Lidhur me çështjen gjyqësore, të regjistruar në datë 04.12.2003, me paditës Izet Karini, përfaqësuar në gjykim me prokurë nga av.Lulzim Karini, me palë të paditur bashkëpronarët Karini; objekt pjesëtimi gjyqësor faktik i pasurisë së përcaktuar me vendim gjyqësor të fazës së parë ndërmjet trashëgimtarëve të Xhemal Karini. Pasuritë objekt gjykimi janë një ish furre buke me sip.140 m2, dyqane me një sip. Trualli 220 m2 dhe të një trualli të lirë me sip.253 m2 në lagjen Partizani**.
Komisioni ka konstatuar se: *Në datë 10.05.2004 subjekti i rivlerësimit ka vendosur zhdukjen e bashkëpronësisë ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe caktimin e pjesëve takuese të pasurive. Z. Izet Karini rezulton të jetë babai i z. Lulzim Karini, me të cilën rezulton e provuar se subjekti ka patur njohje shoqërore dhe familjare. Gjithashtu përfaqësues i palëve të paditura rezulton z. Lulzim Karini për të cilin është provuar që subjekti ka marrëdhënie shoqërore dhe familjare.*

Për sa më sipër duket se:

 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile pasi ka gjykuar një çështje ku si përfaqësues i palëve është paraqitur z. Lulzim Karini, me të cilin subjekti ka

marrëdhënie shoqërore dhe familjare, ndërsa si palë e paditur është paraqitur babai i z. Lulzim Karini.

Lidhur me këtë barrë prove, kam për të thënë sa më poshtë:
1. Konflikti i supozuar i interesit, u argumentua më sipër hollësisht se nuk ekziston dhe për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme që të kaloj në përsëritje.
2. Ritheksoj se unë jam martuar në 2008, pra është absurde të mendohet që unë në vitin 2004 paskam patur lidhje familjare me Lulzim Karinin për shkak se bashkëshortja ime (që nuk e njihja fare në vitin 2004) paska patur, bashkë me mua, dy udhëtime jashtë shtetit në Mal të zi, pas vitit 2008 me këtë shtetas. Përsa i përket marrëdhënieve shoqërore, i kam parashtruar më lart argumentimet e mia.
3. Vendi i marrë për këtë çështje, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe nga Gjykata e Lartë. Pra ka autoritetin e vendimit gjyqësor që përbënn gjë të gjykuar sipas nenit 451/a të KPC. Më sipër, jam shprehur duke e dhënë konsideratën mbi pyetjet – A mund të lind përgjegjësia dispiplinore e
gjyqtarit, kur vendimi i dhënë prej tij, ka marrë formë të prerë pa u cënuar në Gjykatat më të larta, dhe
nëse po, në çfarë rastesh?
4. ***Arsyetimit të mësipërm, i shtoj edhe atë se kjo çështje, është jashtë periudhës së vlerësimit për qëllimet e vlerësimit profesional***.

<u>Së katërti</u>: **Lidhur me çështjen gjyqësore, të regjistruar në datë 18.06.2012, me paditës Izet Karini, me palë të paditur Bashkia Shkodër dhe ZVRPP, me objekt detyrimin e palës së paditur të njohë pronar të pasurisë paditësin, mbi pasurinë që ka fituar me parashkrim fitues me vendim gjyqësor të formës së prerë**.

Komisioni lidhur me këtë çështje ka konstatuar se në seancën gjyqësore datë 29.01.2013, nuk u paraqit paditësi dhe avokati i tij e për pasojë trupa gjykuese në përbërje të së cilës ishte edhe subjekti i rivlerësimit, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

Lidhur me këtë çështje, trupa gjykuese nuk rezulton të më ketë ngarkuar ndonjë barrë prove. Gjithsesi,
pavarësisht se nuk më është ngarkuar barrë prove, ekzistenca e këtij vendimi për pushimin e gjykimit,
vlerësoj se duhet konsideruar nga komisioni, si tregues se unë nuk kam qënë në kushte të konfliktit të
interesit me shtetasin Lulzim Karini.

<u>Së pesti</u>: ***Lidhur me çështjen gjyqësore të rregjistruar me datën 11.02.2013, (që është e njëta çështje sikurse ajo e rregjistruar me datën 18.06.2012), Komisioni ka konstatuar se trupi gjykues ku unë kam***
qënë relator, ka marrë vendimin nr. 1595, datë 01.07.2013, përmes të cilit ka vendosur pranimin e
kërkesë padisë. Lidhur me këtë çështje, pasi Komisioni bën konstatimet e tij, më ngarkon si barrë prove sa më poshtë:

 Për sa më sipër duket se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar, si dhe evidentohet shkelje procedurale në rregullimin e ndërgjyqësisë duke cënuar në këtë mënyrë të drejtën e pronarit shtet Bashkia Shkodër.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe të paraqesë vendimin nr.1209/2012.
 Vendimi i subjektit nuk është i argumentuar si dhe evidentohet shkelje procedurale pasi gjykata në argumentim ka dalë tej objektit të padisë duke e kanalizuar çështjen sërish në parashkrim fitues.
 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare.
 Për rrjedhojë ngrihen dyshime për favorizimin e z. Izet Karini.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me këtë çështje, kam për të thënë sa më poshtë:

1. Gjetjet dhe konkluzionet për të cilat Komisioni më ngarkon barrë prove, nuk kanë lidhje me mua.
Kjo pasi sikurse rezulton nga dokumentacioni provues që do iu dërgoj, dhe konkretisht nga nënshkrimi im në vendimin origjinal, si dhe nga procesverbali i mendimit në pakicë, unë kam votuar për rrëzimin e kërkesë – padisë së paditësit Izet Karini.
2. Për konfliktin e interesit jam shprehur më sipër. Në shtim të argumenteve që tashmë kam dhënë, ftoj Komisionin të vlerësojë mënyrën se si kam votuar unë në këtë çështje, si provë dhe fakt në favorin tim se gjendja e dukjes së konfliktit të interesit për të cilën më është ngarkuar barrë prove, jo vetëm nuk ekziston por është në kundërshtim me rregullat më minimale të logjikës. Kjo pasi nuk ka mbështetje në arsyetim logjik, pretendimi se dy çështjet më të rëndësishme ku paraqitet si paditës, babai i personit për të cilin supozohet se kam marrëdhënie shoqërore dhe familjare të shtrira në kohë, rezultati i gjykimit, për sa është varur nga unë, ka qënë, njëra pushim gjykimi, ndërsa tjetra rrëzimi i padisë.

3. Unë vlerësoj se Komisioni lidhur me këtë çështje ka vepruar qartazi me dy standarte. Kjo pasi gjyqtarit Emiljano Ruli, që ka qënë anëtar që ka votuar në favor të pranimit të padisë, (dhe për rrjedhojë duhet të jepte ai llogari për gjetjet dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje), as nuk i është ngarkuar barrë prove dhe as i është përmëndur ekzistenca e kësaj çështjeje në kriterin e figurës dhe/apo të profesionalizmit, ndërsa mua, që kam votuar kundër, pra për rrëzimin e padisë, më kërkohen shpjegime. I përket Komisionit barra e provës për të vërtetuar se kjo nuk është keqdashje në dëmin tim, duke u nisur edhe nga fakti se sikurse do shihet, dy nga tre komisionerët e trupës gjykuese, duket se janë në konflikt interesi si me mua ashtu edhe me të afërmit e mi të ngushtë.

4. Vlerësoj se Komisioni duhet të rezervohet në dhënien e opinioneve lidhur me këtë çështje, pasi formimi i rregullt i ndërgjyqësisë, përbën çështje të gjykuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, po në Gjykatën e Apelit Shkodër, gjë që e nënkupton faktin se formimi i ndërgjyqësisë ka qënë i rregullt, (pasi në të kundërt çështja do të kthehej për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së parë). Për këtë Komisioni ka administruar të dhëna të cilat m'i vuri edhe mua në dispozicion.

5. Vlerësoj se Komisioni ka bërë mirë në rastin e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli, që nuk është marrë me këtë çështje, për sa kohë ajo është akoma në gjykim në Gjykatën
e Apelit Shkodër. Kjo pasi ka zbatuar nenin 36/3 të KPC që parashikon se "*Asnjë juridiksion tjetër nuk*
ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata".

Lidhur me këtë çështje Komisioni shprehet në vendim se:

*71.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se: i) Në lidhje me pretendimin e subjektit se ai ka qenë në pakicë, Komisioni vlerëson se është i pambështetur në fakt. Në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i parë, parashikohet se: "Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën 'kundër' dhe nënshkruan vendimin". Në nenin 307 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë, parashikohet se: "Së pari voton gjyqtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga gjyqtarët nuk mund të abstenojë nga vendimi. Mendimi i gjyqtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin". Bazuar në vendimin origjinal të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se subjekti ka firmosur së bashku me dy anëtarët e tjerë dhe nuk ka asnjë shënim "kundër", si dhe as mendim kundër të bashkëlidhur nga ana e gjykatës. Subjekti për të provuar pretendimin e tij ka depozituar një fletë me emërtimin "vendim", e cila duket se është firmosur nga tre gjyqtarët e çështjes, përfshirë edhe subjektin, në të cilën ka nënshkrimin "në pakicë". Në këtë fletë nuk rezulton të ketë firmosur sekretarja gjyqësore. Gjithashtu, ai ka paraqitur edhe shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, sipas së cilës i vihet në dispozicion mendimi i pakicës për këtë çështje gjyqësore. Në lidhje me fletën e depozituar nga subjekti, Komisioni konstaton se ajo nuk i përket dosjes gjyqësore, si dhe nuk rezulton të jetë pjesë e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, ajo nuk përputhet me vullnetin e subjektit në vendimin origjinal, kopje e të cilit është administruar nga Komisioni, ku subjekti nuk ka shprehur vullnetin e tij kundër. Në këto kushte, duket sikur kjo fletë është prodhuar pas kalimit të barrës së provës, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të subjektit, në lidhje me këtë barrë prove. Komisioni nuk ka tagrat e organit të Prokurorisë dhe nuk mund të merret me autenticitetin e kësaj flete, por vlerëson të mos e konsiderojë atë si provë. ii) Për sa i përket shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisioni vlerëson se nuk përputhet me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2022, të së njëjtës gjykatë, ku në faqen 3 të saj në seksionin nr. III, pika 6, cilësohet se: "Po na vihet në dispozicion kopje e njehsuar e vendimit nr. ***, datë 1.7.2013". Kopja e njehsuar e vendosur në dispozicion nga gjykata nuk ka të bashkëlidhur mendimin e pretenduar të pakicës. Për këtë arsye, Komisioni nuk mund të marrë në cilësinë e provës këtë shkresë të dytë, e cila duket se përmban të dhëna që janë bërë me qëllim favorizimin e subjektit për procesin e rivlerësimit. Për më tepër, mendimi i pakicës, i presupozuar se gjendej në kasafortën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është njehsuar me origjinalin nga kancelarja e kësaj gjykate, znj. B.B, dhe jo nga dy anëtaret e tjera të sekretarisë gjyqësore105. Konstatohet gjithashtu se mungon edhe nënshkrimi i kryesekretares së sekretarisë gjyqësore, e cila është personi*

*përgjegjës për mbajtjen e kasafortës, por dhe personi i ngarkuar me ligj për të nënshkruar njehsimin e vendimeve gjyqësore. 105 Shihni procesverbalin nr. *** prot., datë 2.11.2022, të depozituar nga subjekti më 30.11.2022. 78 Si konkluzion, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë pretendimin e subjektit se ai ka qenë në pakicë në këtë vendimmarrje, pasi veprimet e tij nuk janë në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. iii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se kjo çështje nuk mund të merret në vlerësim nga Komisioni për sa kohë është ende në gjykim në një gjykatë më të lartë, Komisioni vlerëson se ky pretendim i tij nuk duhet të merret në konsideratë, pasi Kolegji106 ka një jurisprudencë të konsoliduar në lidhje me çështjen në gjykim. Në vendimin nr. 28/2020, Kolegji shprehet se: "Në një qëndrim të konsoliduar tashmë, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2- të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj dhe qenia e saj e varur para Gjykatës së Lartë, në pritje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje 'nën shqyrtim', në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit". Në nenin Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: "Në çdo rast shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale". Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit në lidhje me këtë çështje nuk mund të ndikojë dhe nuk mund të përbëjë provë për gjykimin e saj në të gjitha shkallët e gjykimit të juridiksionit gjyqësor. iv) Për sa i përket konfliktit të interesit, Komisioni mban të njëjtin qëndrim si më lart.*

Lidhur me qëndrimin e mësipërm të Komisionit, vlerësoj se ai është i paligjshëm, nuk përputhet me të vërtetën dhe është abuziv. Për të mos u zgjatur, i kërkoj Kolegjit që të ketë parasysh arsyetimin tim të shprehur në pjesën "shkaqet e ankimit", të titulluar "së trembëdhjeti", veçanarisht fq. 37, 38 dhe 39 të këtij ankimi.

<u>Së gjashti</u>: **Lidhur me çështjen gjyqësore, të regjistruar në datë 23.02.2012, me kërkues Izet Karini dhe objekt "Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë olograf" për të ndjerin Xhemal Karini**, Komisioni ka konstatuar se me vendimin datë 27.02.2012 subjekti i rivlerësimit ka vendosur "Pranimin e kërkesës dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë". Komisioni ka konstatuar në vijim, se subjekti në dispozitiv të
vendimit ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare për trashëgimlënësin Xhemal
Karini duke caktuar si trashëgimtar testamentar djalin e tij Izet Karini mbi pasurinë e paluajtshme godinë, e cila ndodhet në Lagjen Partizani. Në pjesën argumentuese të vendimit, subjekti shprehet se z. Xhemal Karini ka shprehur vullnetin e tij duke lënë si trashëgimtarë të tij djalin Izet Karini. Nga verifikimi i fashikullit gjyqësor konstatohet se janë administruar në cilësinë e provës, ndër të tjera, dhe një deklaratë dore, sipas së cilës z. Xhemal Karini i dhuron djalit të tij Izet Karini një godinë që ndodhet në lagjen (nuk lexohet qartë).

Nga raporti, rezulton se në vlerësimin e kësaj çështje, ka cituar dy dispozita ligjore që janë si më poshtë'
Neni 372 i K.Civil, ku parashikohet se: *Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes. Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke*.
Neni 379 i K.Civil, ku parashikohet se: *Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të*
trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

Nga raporti rezulton se Komisioni pas vlerësimit të dosjes, ka dhënë këto konsiderata:
1. Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore konstatohet se nga ana e subjektit vendimi i tij nuk është i bazuar në prova. Deklarata e depozituar nga ana e z. Izet Karini nuk është testament, pasi në këtë dokument z. Xhemal Karini nuk ka disponuar për pasurinë e tij pas vdekjes, por është shprehur se i
dhuron djalit të tij Izet Karini një pasuri të palujatshme.
2. Gjithashtu nuk rezulton të jetë adminstruar dokumentacion nëse trashëgimlënësi ka patur trashëgimtarë minorenë, në mënyrë të tillë që të vërtetohej cënimi i rezervës ligjore.

3. Subjekti e ka gjykuar këtë çështje brenda 4 ditëve duke caktuar në datë 24 seancën gjyqësore më datë 27. Nga verifikimi i kalendarit data 24.02.2012 rezulton ditë e premte. Pra subjekti e ka gjykuar këtë cështje brenda 1 dite pune.
4. Në fashikullin gjyqësor nuk gjendet njoftim i kërkuesit për datën e seancës gjyqësore.

Në nenin 155 të K.Pr.Civile parashikohet se: *Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë.*
Kur vendi i njoftimit është jashtë rrethit ose jashtë shtetit, afati për paraqitjen në gjyq duhet të jetë i tillë sa të sigurohet një komunikim normal i padisë dhe paraqitja në gjykatë e të padituri ose të personave të tretë.
Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të paditurit të drejtën e mbrojtjes.

Për sa më sipër rezulton se subjekti nuk ka respektuar parashikimet ligjore të parashikuar nga neni 155
i K.Pr.Civle në lidhje me afatin për caktimin e seancës.
Në përfundim duket se:
 Në këtë proces gjyqësor evidentohen gabime thelbësore dhe serioze, pasi është vendosur lëshimi i trashëgimisë testamentare të z. Izet Karini në mungesë të testamentit.

 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K.Pr.Civile, pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare.
 Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës.
 Nuk provohet njoftimi i kërkuesit sipas parashikimeve të K.Pr.Civile.
Për rrjedhojë ngrihen dyshime për favorizimin e z. Izet Karini.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe të paraqesë vendime me të njëjtin objekt të përfunduar brenda 1 dite pune.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me këtë çështje, përpara se të shprehem hollësisht për gjetjet, vlerësimet si dhe barrën e provës
që më ka ngarkuar Komisioni, e vlerësoj të nevojshëm që qëndrimin tim lidhur me vlerësimin e Komisionit, t'a jap duke e ilustruar me një shëmbull.

Konkretisht, ky shëmbull i referohet Trasimakut, pra një filozofi situacionist të Athinës së lashtë, që njëkohësisht ishte krahas Aristofanit, Protagorës, etj, një nga themeluesit e shkollës juridike të sofizmit.

Trasimaku, 2500 vjet përpara, ndër të tjera, ka thënë edhe shprehjen e famshme "*Drejtësia nuk është gjë*
tjetër veçse një armë në duart e më të fortit". Natyrisht, unë nuk jam dakort me këtë shprehje, ndërsa për
Komisionin, pavarësisht nga fakti nëse e di apo nuk e di, tani për tani nuk dëshiroj t'a di.

Duke kaluar tek shëmbulli, Trasimaku përshkruan se ishin dy prindër pleq që kishin vetëm një djalë.
Familja e tyre ishte shumë e varfër dhe kishin pasuri vetëm një copë tokë të vogël që e punonin përmes dy qeve dhe një parmende të vjetër. Duke qënë se ishin shumë të varfër dhe nuk dëshironin që djali i tyre, të kishte në jetë fatin e tyre, ata vendosën që djalin t'a çojnë në një shkollë juridike që ishte më e famshmja dhe që ishte shkolla juridike e sofistëve. Meqënëse shkolla kushtonte shumë, prindërit pleq vendosën të shisnin qetë për të paguar shkollën dhe tokën t'a punonin duke vendosur veten në vend të dy qeve. Ditën e parë që djali shkoi në shkollë, prindërit pleq, e vunë veten në vend të dy qeve dhe punuan tokën. Ata u lodhën jashtëzakonisht shumë por ama sytë u shkëlqenin nga krenaria që pavarësisht vuajtjeve të tyre, kishin arritur që djalin e tyre t'a çonin në shkollë duke e shmangur kësisoj mundësinë që ai të kishte në jetë fatin e tyre.
Pasi mbaruan ditën e punës, prindërit pleq shkuan në shtëpi dhe me padurim po prisnin djalin që të kthehej nga shkolla. Sapo djali u kthye, pa i përshëndetur prindërit fare, iu afrua të atit dhe e qëlloi me
grusht në fytyrë, duke e hedhur përdhe të gjakosur. Kur i ati e mori veten nga alivanosja, i biri u afrua dhe e pyeti: *Baba – a më ke qëlluar ndonjë herë kur kam qënë i vogël ? Po – i tha i ati. Përse e pyeti i biri ? Për të mirën tënde i tha i ati. Po mirë atëherë i tha i biri, - Për sa kohë t'i e*

ke ditur të mirën time kur isha fëmijë dhe i pafuqishëm, atëherë edhe unë të qëllova për të mirën tënde, ndërkohë që ti tani je plak dhe i pafuqishëm.

Shëmbulli i mësipërm tregon një nga nënllojet e arsyetimit sofist, që në mënyrë të thjeshtuar përdor një apo dy premisa të drejta për të argumentuar një konkluzion të gabuar, por ndërkohë lë pa përmëndur një, dy apo më shumë premisa gjithashtu të drejta që nëse do të përmëndeshin, do të ndryshonin bazueshmërine logjike të argumentimit të konkluzionit.

P.sh. në rastin e shëmbullit, janë premisa të drejta që përmënden fakti që babai ka bërë gabim që ka rrahur fëmijën në vogëli dhe fakti që fëmija nuk edukohet me të rrahur, por lihen pa përmëndur premisat e drejta që fëmija duhet të ketë dashuri dhe empati për të atin, fëmija duhet të ketë ndjesi mirënjohjeje për sakrificat e të atit, fakti që nëse dikush sillet keq nuk të jep të drejtën të sillesh po ashtu keq, etj.

Duke u rikthyer tek çështja që përmend Komisioni, unë vlerësoj se qëndrimi i Komisionit lidhur me këtë çështje, është i argumentuar cilësisht më dobët se shëmbulli që përmënda më sipër.
Kjo pasi ndërsa shëmbulli përmënd vetëm dy premisa të drejta për të argumentuar konkluzionin e gabuar, komisioni përmënd vetëm një premisë të drejtë, që është ajo e konstatimit të gabimit në leximin e fjalës "dhurim", e pason argumentimin me dy premisa të tjera që minimalisht është e diskutueshme (pra nuk është e thënë) të jenë të drejta apo të gabuara, (pasi ka qëndrime të ndryshme), që janë gjetjet se "Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës", dhe "Nuk provohet njoftimi i kërkuesit sipas parashikimeve të K.Pr.Civile", dhe pastaj pa përmëndur premisat e drejta të tjera që do duheshin përmëndur, arrin në konkluzione të gabuara.

Tani po shprehem më hollësisht si më poshtë:

1. Jam dakort me gjetjen e Komisionit se dorëshkrimi shkruan "dhurim". Ndonëse nuk e kam parë dosjen (për mungesë kohe), kjo gjetje me siguri është fakt dhe mosbesimi im ndaj Komisionit nuk shkon deri në këtë shkallë dyshimi.

2. Jam dakort me vlerësimin e Komisionit se mosleximi apo leximi gabim i fjalës "dhurim", është gabim thelbësor. Kjo pasi është e qartë se mos të lexohej kjo fjalë, përfundimi i gjykimit do të kishte rezultat të ndryshëm.

3. Nuk jam dakort me vlerësimin e Komisionit se mosleximi apo leximi gabim i fjalës "dhurim", është gabim serioz. Kjo pasi natyra e çështjes për të cilën po jap mendim, ka të bëjë me një çështje që i përket juridiksionit gjyqësor gracioz, pra gjykim pa palë kundërshtare, me objekt lëshim dëshmie trashëgimie. Si natyra e gjykimit ashtu edhe objekti i gjykimit, e përjashtojnë që në pamje të parë (in primma facie) çdo lloj interesi personal timin lidhur me rezultatin e gjykimit. Kjo pasi vendimi gjyqësor i marrë me këtë rast, ka qënë pa palë kundërshtare dhe sipas nenit 451/a të KPC, nuk ka qënë detyrues për asnjë subjekt tjetër përveç kërkuesit që nuk ka qënë palë në vendim. Përveç kësaj, ligji përmes nenit 349 të Kodit Civil, ka parashikuar mundësinë e çdo subjekti që cënohet nga një dëshmi trashëgimie, të ngrejë padinë për kërkimin e trashëgimit. Fakti që ndonëse kanë kaluar mbi 10 vjet dhe nuk është ngritur ndonjë padie e tillë, tregon që gabimi im, ndonëse bie në kundërshtim me ligjin, nuk ka sjellë ndonjë pasojë juridike për

askënd. Pra, ky gabim nuk ka patur asnjë lloj ndikimi në cënimin e besimit publik në dhënien e drejtësisë. Është fakt se kush ha bukë bën edhe thërrime.
Ama është po ashtu fakt se do të binte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit që meqënëse ke bërë thërrime ndërkohë që ke qënë duke ngrënë bukë, t'i duhet të parandalohesh që në të ardhmen të hash prapë bukë, në mënyrë që të jetosh.

4. Në shtim të argumentit se përse nuk jam dakort me qëndrimin e Komisionit se mosleximi apo leximi gabim i fjalës "dhurim", është gabim serioz, theksoj se jo vetëm që ekzistenca e këtij gabimi nuk ka sjellë ndonjë pasojë juridike, (përgjatë mbi 10 vjetëve që kanë kaluar nga kryerja e këtij gabimi), por as mund t'a sillte as në kohën kur është kryer gabimi dhe as sot, një pasojë të tillë.

Kjo pasi edhe nëse unë nuk do të kisha gabuar (duke pranuar për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë), prapë se prapë, mosekzistenca e gabimit, (pra moslëshimi i dëshmisë së trashëgimisë), nuk do të sillte ndonjë pasojë negative për kërkuesin Izet Karini, që të ishte e aftë për të vënë në dyshim titullin e tij të
pronësisë mbi sendin që përbën objektin material të dëshmisë së trashëgimisë së lëshuar prej meje.

Kjo pasi, vetë fakti juridik i kalimit të një kohe mbi 20 vjet nga data kur është lëshuar shkresa e shkruar me dorë nga i ndjeri Xhemal Karini, (babai i izet Karinit), shkresë kjo që mban vulën e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Qytetit të Shkodrës, deri në datën që unë kam lëshuar dëshminë e trashëgimisë, bën që kërkuesi Izet Karini, t'a kishte tashmë të fituar me parashkrim fitues sipas nenit 168 dhe/apo 169 të Kodit Civil, sendin për të cilin unë kam lëshuar dëshminë e trashëgimisë, që në datën kur unë kam lëshuar dëshminë e trashëgimisë. Aq më tepër aktualisht, pra sot.

Kjo edhe pasi vetë fakti i kalimit të një kohe mbi 30 vjet (nga data që është shkruar me dorë shkresa dhe eri më sot), që askush nuk ka parashtruar në ndonjë rrugë ligjore (administrative dhe/apo gjyqësore) ndonjë pretendim mbi titullin pronësor të të ndjerit Xhemal Karini, dhe të birit të tij, Izet Karini, tregon që jo vetëm posedimi ka qënë i qetë dhe i pandërprerë por edhe se publiku i gjërë, gjithmonë e ka quajtur titullin e pronësisë që ndërmjet brezash ndjek kronologjinë e mësipërme, diçka të padyshimtë, të vërtetë dhe të besueshme. Për rrjedhojë, për sa kohë publiku ka patur këtë lloj besimi, atëherë është e qartë se gabimi që kam kryer, nuk ka sjellë dhe as mund të sillte kurrfarë pasoje në rendin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Natyrisht, shkon përtej qëllimit tim në këtë trajtim, argumentimi i ligjshmërisë së titullit pronësor të të ndjerit Izet Karini mbi sendin për të cilin unë kam lëshuar dëshminë e trashëgimisë, por unë këtë po e bëj jo vetëm për të argumentuar mungesën e ardhjes si dhe të mundësisë së ardhjes së pasojës të paligjshme nga gabimi im, por edhe për të argumentuar gjithashtu, edhe mungesën e konfliktit të interesit. Lidhur me këtë të fundit theksoj se qartazi fakti që unë kam lëshuar dëshminë e trashëgimisë, tregon se nuk kam patur konflikt interesi as në dukje. Kjo pasi ekzistenca e gabimit tim, ka shkaktuar një pasojë që ka shkuar jo në favor por në disfavor të kërkuesit Izet Karini. Konkretisht, nëse nuk do t'a kisha lëshuar dëshminë e trashëgimisë, nuk përjashtohet mundësia që ai të kishte fituar sendin me një mënyrë tjetër fitimi pronësie, që është parashkrimi fitues, që është një mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë dhe që për rrjedhojë,

është më e favorshme për fituesit e sendit, sipas të drejtës civile materiale, se fitimi i pronësisë me mënyrë të prejardhur, me trashëgim, (që në këtë rast të fundit, bën që fituesi i sendit të bartë në titullin e tij të pronësisë të gjitha veset mbi titullin e pronësisë që mund të ketë patur pronari i mëparshëm i sendit. Kjo nuk ndodh në rastin kur pronari i ri e fiton sendin me një mënyrë origjinale të fitimit të pronësisë, pasi konsiderohet se e fiton sendin për herë të parë, të çliruar nga çdo ves i titullit të pronësisë të pronarit të mëparshëm të sendit).

5. Nuk jam dakort me vlerësimin e Komisionit se kam qënë në konflikt interesi me shtetasin Lulzim Karini apo të atin e tij. Për këtë jam shprehur më sipër dhe vlerësoj se është e panevojshme që të kaloj në përsëritje. Megjithatë, këtu duhet të shtoj se Komisioni në argumentimin sofist të tij, lë pa përmëndur një premisë të drejtë. Kjo premisë ka të bëjë me faktin e shtrëmbëruar se supozohet padrejtësisht që po njohe të birin i bie që ke njohje edhe me të atin. Madje supozohet se jo drejtësisht se nëse ke miqësi me të birin (gjë që nuk është e vërtetë në rastin objekt analize), i bie që do të favorizosh edhe të atin. Këto supozime nuk janë as argumentime sofiste, por janë shtrëmbërime të të vërtetës dhe nuk vlerësoj se duhet të ndalem gjatë pasi është tepër e qartë. Kjo pasi nuk ka asnjë provë, fakt apo indicie që unë të kem patur miqësi me Izet Karinin, për shkak të miqësisë së supozuar dhe të pavërtetë që më atribuohet se kam patur me të birin e tij. Madje vetë ekzistenca në raport e këtyre shtrëmbërimeve të të vërtetës, më bën të dyshoj akoma më shumë se Komisioni m'a ngarkon pandershmërisht, barrën e provës në këtë drejtim.

6. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se kam shkelur nenin 155 të KPC, pasi nuk kam respektuar kohën e parashikuar ligjore për caktimin e seancës, dhe nuk figuron njoftimi i kërkuesit, nuk jam dakort. Kjo pasi:

i. Afati ligjor i parashikuar nga neni 155/1 i KPC, zbatohet për paditë me palë kundërshtare (të juridiksionit gjyqësor kontencioz), dhe nuk zbatohet për kërkesat pa palë kundërshtare, që në thelbin e
tyre janë vërtetime faktesh gjyqësore, (që përfsëhihen në juridiksionin gjyqësor grocioz). Kjo sipas intepretimit literal (gjuhësor) të normës. Çështja për të cilën po shpreh mendim është kërkesë, pa palë. Ratioja e ekzistencës së këtij afati ligjor, është garantimi i zbatimit të parimit të kontradiktoritetit dhe e
së drejtës së mbrojtjes. Në gjykimet e të njëjtës natyrë me çështjen në fjalë, pra pa palë kundërshtare, nuk ka një ratio të tillë, pasi nuk ka kontradiktoritet palësh.

ii. Edhe sikur të pranohet se kjo dispozitë është e zbatueshme përsa i përket afatit ligjor, edhe për çështjen në fjalë, Komisioni duhet të ketë parasysh se afati ligjor që parashikon neni 155 i KPC, në thelbin e tij është afat në dobi të palës, pra nuk është afat i prerë. Sipas nenit 146 të KPC, "*Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç kur ligji e parashikon shprehimisht se janë të prera. Afatet e prera nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve*".
Me intepretim literal si dhe intepretim ad contrario, (që është një nënllojet e intepretimit logjik në normës), rezulton se afatet jo të prera, mund të shkurtohen ose zgjaten kur pala jep pelqim për këtë. Kërkuesi duke marrë pjesë në seancë, në mënyrë të nënkuptuar ka dhënë pëlqim për shkurtimin e këtij

afati. Ky lloj intepretimi i normës është në pajtim edhe me paragrafin e tretë të nenit 155 të KPC që parashikon se "*Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e*
paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje
me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të padituri të drejtën e
mbrojtjes". Për sa kohë kam caktuar seancën, qartësisht kjo ka qënë kërkesë e kërkuesit Izet Karini, që
është pranuar. Edhe sikur të ketë patur të meta në formën e pranimit të kërkesës, Komisioni duhet të ketë parasysh nenin 119/3 të KPC ku parashikohet se "*Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar*".

7. Lidhur me mungesën e njoftimit, sikurse jam shprehur edhe më sipër, përpara se Komisioni të arrijë në ndonjë përfundim, duke të ketë parasysh se kryerja e njoftimit, nuk është detyrë e gjyqtarit por e sekretarit gjyqësor dhe nëpunësit gjyqësor, (ftuesit), sipas neneve 77/3 dhe 78/2 të KPC, që parashikojnë se:

Neni 77/3 "*Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor*".
Neni 78/2: *Punonjësi i gjykatës është përgjegjës për kryerjen e rregullt të njoftimeve. Ai merr masa për realizimin e kërkimeve të nevojshme në lidhje me adresën e personit që i drejtohet njoftimi, në regjistrat publikë, në organet e administratës shtetërore, në familje dhe tek të afërmit, në vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit të personit që i drejtohet njoftimi, ose nëpërmjet burimeve të tjera të mundshme*.

Gjyqtarit ka kompetencë mbikqyrëse dhe kontrolluese përkundrejt sekretarit dhe ftuesit që e ushtron kur është nevoja dhe rasti i përshtatshëm, por në rastin konkret vetë fakti i paraqitjes së të njoftuarit në gjykim, ka bërë që sipas vlerësimit tim, të bien në dekadencë pretendimet e mundshme lidhur me njoftimin e shtetasit Izet Karini. Kjo sipas nenit 119 të KPC që parashikon se *Akti procedural që nuk është kryer në formën që kërkohet shprehimisht nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm. Akti mund të*
shpallet i pavlefshëm edhe kur i mungojnë të dhënat e domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij. Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar.

Nuk ka asnjë kuptim as juridik dhe as logjiko-praktik që unë të shtyja seancën gjyqësore për pavlefshmërinë e njoftimit të kërkuesit Izet Karini, ndërkohë që ai u paraqit në gjykim.
Nuk ka sekretar gjyqësor në Republikën e Shqipërisë që në veprimtarinë e tij, që për arsye praktike (për t'u mos u mbingarkuar) nuk aplikon lidhur me njoftimet nenin 144 të KPC, që parashikon "*Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin*". Në rastin konkret, paraqitja e shtetasit Izet Karini dhe dokumentimi i faktit të paraqitjes me procesvërbal

gjyqësor, nuk është gjë tjetër veçse konfirmim me shkrim i faktit që njoftimi ka qënë jo vetëm bindës por edhe se e ka realizuar qëllimin për
të cilin është destinuar.

Në seancën dëgjimore unë kam paraqitur vendime të ngjashme.

7. Nuk jam dakort me vlerësimin e Komisionit lidhur me rezervën ligjore. Kjo pasi vetë fakti i kalimit të mbi dhjetë vjetëve nga koha që unë kam lëshuar dëshminë e trashëgimisë, dhe askush nuk është ankuar as në rrugë gjyqësore dhe as në organet e mbikqyrjes disiplinore të veprimtarisë time gjyqësore, duke parashtruar pretendime se unë përmes dëshmisë së trashëgimisë, i kam cënuar të drejtën e rezervës ligjore, tregon se kjo rezervë ligjore nuk ka ekzistuar. Pra vetë fakti i kalimit të një kohe mbi 10 vjet, më
ka dhënë të drejtë. Përveç kësaj, fakti që kërkuesi Karini nga aktet ishte i moshuar në kohën kur është zhvilluar gjykimi, tregon se babai i tij, në kohën që ka lëshuar shkresën që unë gabimisht e kam lexuar
si testament olograf, i ka patur fëmijët minimalisht madhorë. Gjithashtu, fakti që shkresa në fjalë përmban vulën e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Qytetit të Shkodrës, (që përbën fakt të njohur botërisht por edhe juridikisht se mblidhte informacion nga këshillat popullor të lagjeve dhe këto të fundit mblidhnin informacion për përbërjen familjare të familjeve), tregon indirekt që babai i kërkuesit Izet Karini, nuk ka patur persona të paaftë në punë në ngarkimin e tij, në kohën kur ka lëshuar shkresën.

8. Lidhur me çështjen e rezervës ligjore dua të shtoj se mendoj që çështja se si duhej të bëhej hetimi gjyqësor për verifikimin e ekzistencës apo jo të rezervës ligjore, si dhe çështja nëse duhej që Gjykata t'a
bënte këtë hetim kryesisht, pa kërkesën e palëve, duket se nuk përfshihet në juridiksionin dhe kompetencën e organeve të rivlerësimit, sipas nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Këtë vlerësim e krijoj edhe duke iu referuar
standartit të vendosur me vendimin nr. 28/2020 (JR) të Marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha, (për të cilin nuk po shprehem tani se do të shprehem në vijim të
këtij trajtimi).

9. Në përfundim të trajtimit të kësaj çështjeje, ftoj Komisionin që të ketë parasysh edhe nenin 95 të KPC që parashikon se "Askush nuk mund të bëjë të vlefshme në emrin e tij, në një proces gjyqësor civil, një të drejtë të një tjetri, përveç kur parashikohet shprehimisht nga ligji". Në këndvështrim në zbatimit të kësaj dispozite, fakti që askush (që potencialisht mund të jetë dëmtuar nga dëshmia e trashëgimisë së lëshuar nga unë) nuk është ankuar në rrugë gjyqësore apo qoftë edhe disiplinore, tregon se publiku i gjërë gjithashtu nuk është cënuar. Kjo pasi është jashtë logjike që të cënohet publiku i gjërë, (që për shkak të kategorisë ka natyrë abstrakte dhe të papërcaktuar konkretisht), nga vendimarrja e një procesi gjyqësore pa asnjë sensibilitet publik, ndërkohë që nuk ka asnjë person konkret që në emër të tij të ketë të vlefshëm ndonjë të drejtë që mund t'i jetë cënuar nga vendimi gjyqësor.

Lidhur me këtë çështje Komisioni ka mbajtur qëndrimin (përmbledhtaz) ***se po të ishte kjo çështje rast i izoluar, nuk do të sillte si pasojë automatike penalizimin e subjektit***. Megjithatë, duke qënë se janë konstatuar edhe raste të tjera në të cilat subjekti ka gjykuar në konflikt interesi më avokatin Lulzim Karini ose babain e tij, kjo çështje, do merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit profesional.

Më sipër, kam arsyetuar se konflikti i interesit i supozuar, nuk ekziston. Per rrjedhojë, është e qartë se sipas parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, gabimi i bërë pa dashje, dhe pa ndonjë pasojë serioze në cënimin e besimit publik në dhënien e drejtësisë, në gjykimin e kësaj çështjeje, nuk mund të shkaktojë si pasojë shkarkimin tim nga detyra e gjyqtarit.

Së shtati: **Lidhur me çështjen gjyqësore të rregjistruar me datën 13.09.2004, me të pandehur Vuksan Cubi, e gjykuar me trup gjykues në përbërje të së cilit ka qenë edhe unë në pozicionin e gjyqtarit relator**. Në këtë çështje, Komisioni pasi parashtron gjetjet e tij, vlerëson si më poshtë:
Për sa më sipër duket se:
Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar, për rrjedhojë ngrihen dyshime për favorizimin e të pandehurit Vuksan Cubi.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me këtë çështje, kam për të thënë sa më poshtë:
1. Gjetjet dhe konkluzionet për të cilat Komisioni më ngarkon barrë prove, nuk kanë lidhje me mua.
Kjo pasi sikurse rezulton nga dokumentacioni provues që do iu dërgoj, dhe konkretisht nga nënshkrimi im në vendimin origjinal, si dhe nga procesverbali i mendimit në pakicë, (mbi 20 faqe). unë kam votuar për dënimin e këtij të pandehuri me 20 vjet burgim sipas akuzës së prokurorit.
2. Unë vlerësoj se Komisioni lidhur me këtë çështje ka vepruar qartazi me dy standarte. Kjo pasi gjyqtarit Arben Zefi, që ka qënë anëtar që ka votuar në favor të formimit të shumicës që ka marrë vendimin dhe madje është ai që ka arsyetuar vendimin, (si dhe për rrjedhojë duhet të jepte ai llogari për gjetjet dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje), as nuk i është ngarkuar barrë prove dhe as i është përmëndur ekzistenca e kësaj çështjeje në kriterin e figurës dhe/apo të profesionalizmit, ndërsa mua, që kam votuar në pakicë, më kërkohen shpjegime.
I përket Komisionit barra e provës për të vërtetuar se kjo nuk është keqdashje në dëmin tim, duke u nisur edhe nga fakti se sikurse do shihet, dy nga tre komisionerët e trupës gjykuese, duket se janë në konflikt interesi si me mua ashtu edhe me të afërmit e mi të ngushtë.

Për këtë çështje Komisioni më ka shkarkuar nga barra e provës.

Së teti: **Lidhur me çështjen gjyqësore me palë paditëse Hava Hasa e përfaqësuar në gjykim ngaav.Lulzim Karini, të paditur Halil Behri dhe persona të tretë Hysen e Hasan Temali dhe Amine Dibra përfaqësuar nga z. Lulzim Karini, objekt gjykimi: detyrimin e të paditurit për të njohur pronar paditësin**.

Komisioni ka konstatuar se kam disponuar me vendimin e datë 23.12.2015 .

Lidhur me këtë çështje, trupa gjykuese nuk rezulton të më ketë ngarkuar ndonjë barrë prove. Gjithsesi, pavarësisht se nuk më është ngarkuar barrë prove, ekzistenca e këtij vendimi për pushimin e gjykimit,
vlerësoj se duhet konsideruar nga komisioni, si tregues se unë nuk kam qënë në kushte të konfliktit të interesit me shtetasin Lulzim Karini.

<u>Së nënti</u>: **Lidhur me çështjen gjyqësore me palë paditëse Hava Hasa e përfaqësuar në gjykim nga av.Lulzim Karini, të paditur Halil Behri dhe persona të tretë Hysen e Hasan Temali dhe Amine Dibra përfaqësuar nga z. Lulzim Karini, objekt gjykimi: detyrimin e të paditurit për të njohur pronar paditësin, (që është iniciuar përmes një padie të riparaqitur pas pushimit të një padisë së mësipërme)**, Komisioni ka konstatuar se kam disponuar me vendimin datë 04.10.2016 subjekti i rivlerësimit vendosi pranimin e pjesshëm të padisë duke rrëzuar kërkimin për zërin "ndërtesë" të objektit material të gjykimit. Sipas shënimit të sekretarisë gjyqësore, ky vendim është ankimuar nga pala paditëse dhe pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala e paditur dhe çështja është regjistruar për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.
Komisioni, në raport lidhur me këtë çështje shprehet se:
i. Nga analizimi i vendimit gjyqësore konstatohet se
- Subjekti nuk ka argumentuar arsyet se pse kjo padi duhet të pranohet, por ka argumentuar arsyet se pse prapësimet e palës së paditur nuk duhet të pranohen. Në vendim subjekti shprehet për ekzistencën e tre vendimeve gjyqësore të formës së prerë sipas së cilave në lidhje me padinë objekt gjykimi duket se kemi të bëjmë me gjë të gjykuar.
- Pala paditëse dhe palët e treta përfaqësohen në këtë proces nga ana e z. Lulzim Karini me të cilin subjekti ka njohje shoqërore dhe familjare.
Për sa më sipër duket se:
 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar.
 Jemi përpara gjësë së gjykuar.
 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit pasi ka gjykuar një çështje ku përfaqësuses i palëve ka qënë një z. Lulzim Karini me të cilin ka patur marrëdhënie shoqërore
 Për rrjedhojë duke marrë në konsideratë informacionin e organeve ligjzbatuese ngrihen dyshime për favorizimin e e palës paditëse duke marrë në konsideratë faktin që vendimi i gjykatës nuk është i argumentuar si dhe subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit.
Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, të depozitojë tre vendimet e mëparshme gjyqësore si dhe vendimin e gjykatës së apelit që ka prishur këtë vendim.

Lidhur me këtë çështje, kam për të thënë sa më poshtë:

1. Përsa i përket cilësisë së arsyetimit/argumentimit të vendimit, unë mendoj se vendimi është i arsyetuar mirë. Po të ishtë vendimi i pa arsyetuar, në vendimin nr. 321, datë 14.05.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, do të evidentohej ky fakt dhe çështja do të prishej dhe do kthehej për rigjykim, mbi këtë shkak. Përkundrazi, po të lexohet si përmbajtja e vendimit të dhënë nga unë si gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë ashtu edhe vendimi i Gjykatës së Apelit, çdo jurist do arrinte në konkluzionin se kemi të bëjmë me një vendim të arsyetuar, minimalisht mbi nivelin mesatar për të mos thënë shumë mirë.

2. Përsëri, përsa i përket cilësisë së arsyetimit/argumentimit të vendimit, mendoj se Komisioni përmes kësaj barrë prove që më ka ngarkuar, ka kapërcyer qartësisht kompetencat e tij, pasi merr indirekt përsipër të shprehet për themelin e çështjes, duke vepruar kësisoj në kundërshtim me nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Përsëri, përsa i përket cilësisë së arsyetimit/argumentimit të vendimit, mendoj se Komisioni përmes kësaj barrë prove që më ka ngarkuar, ka vepruar në kundërshtim me standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR) të Marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha. Në këtë vendim, KPA ndër të tjera, vendos standartin e mëposhtëm.

"*...10.7. Në lidhje me çështjet e grupuara në grupin e parë, Kolegji konstaton se të gjitha vlerësimet e Komisionit lidhen dhe i adresohen zgjidhjes në themel të çështjes penale, duke tentuar të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes nga ajo që ka kryer vetë Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Në këto konkluzione të Komisionit, Kolegji verën se gjendemi para një tejkalimi të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Përpos pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se ky vlerësim i takon Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: "Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet", dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016*.

.....

10.8 Në këtë kuadër ligjor të zbatueshëm, Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe,
si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

.....

... 12.4 Pasi shqyrtoi rrethanat e faktit, konstatimet e Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, Kolegji vëren sërish se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim të kryer nga Komisioni mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes së marrë në shqyrtim. Nga natyra e

çështjes dhe arsyetimi i përdorur edhe në këndvështrim të pretendimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, perceptohet qartë se evidentimi i problematikes që Komisioni ka konstatuar lidhet me gjykimin dhe vlerësimin nëse bindja e brendshme e krijuar prej trupës gjykuese mbi analizën e provave të marra gjatë procesit e në kuptim e zbatim të ligjit material, për më tepër mbi një çështje tejet të debatueshme e profesionale, siç është analiza mbi ekzistencën e lidhjes shkakësore në kryerjen e një vepre penale, se nuk ekziston lidhja shkakësore mes veprimeve të parregullta të të gjykuarve dhe pasojës së ardhur, është një konkluzion i gabuar e ka ardhur si pasojë e një analize sipërfaqësore të të gjitha fakteve. Kolegji çmon se edhe në këtë rast gjendemi përpara së njëjtës situatë si ajo e përshkruar më lart në këtë vendim, paragrafët 10.7-10.8, kur Komisioni tejkalon kompetencën e tij kushtetuese e ligjore duke vlerësuar vendimmarrjen dhe zgjidhjen në themel të një çështjeje gjyqësore, atribut vetëm i një gjykate më të lartë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se do të përdorej i njëjti arsyetim ligjor si ai i përdorur në arsyetimin më sipër, njësoj i vlefshëm dhe i zbatueshëm edhe për këtë qëndrim të Komisionit".

4. Përsa i përket konstatimit të Komisionit se kemi të bëjmë me "gjë të gjykuar", vlerësoj se është i gabuar. Si provë për këtë do iu ftoja ti referoheni vendimit nr. 321, datë 14.05.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër, që në faqen 11, paragrafi 2 të tij shprehet "Gjykata e Apelit e gjen të drejtë arsyetimin që ka bërë Gjykata e Shkallës së parë li lidhur me parimin e gjësë së gjykuar ashtu edhe me parashkrimin e padisë së paditëses Hava Hasa, duke konkluduar se pretendimet e saj të pronësisë duhen gjykuar në themel, me një vendim gjyqësor përfundimtar". Këtë e kam paraqitur në Komision si provë, por duke iu kërkuar njëkohësisht që të keni parasysh standartin e mëposhtëm të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR) të Marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha:

"*...12.5 Gjithashtu, Kolegji vlerëson të nënvizojë qëndrimin se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë*
rast Gjykata e Lartë e vendit, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur gjykata ku është pjesë e vendimmarrjes magjistrati (subjekti i rivlerësimit), nuk mund të përdorej apriori si një argument për të vlerësuar negativisht aftësitë profesionale të magjistratit, veçanërisht ato që lidhen me zgjidhjen e çështjes, siç është rasti konkret. Në këtë arsyetim, vlen të sillet në vëmendje se edhe sistemi i vlerësimit periodik të magjistratëve, i parashikuar prej ligjit nr. 96/2016, nuk parashikon matjen e aftësive për gjykim apo arsyetimin ligjor të magjistratëve në varësi të qëndrimit që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet e tyre. Aq më shumë, ky kriter nuk mund të përdoret si determinant në procesin e rivlerësimit, në të cilin pasoja e vlerësimit profesional mund të ndikojë në mënyrë thelbësore fatin profesional të magjistratit, por edhe më tepër kur i gjithë ky proces ka pasur nën vlerësimin e tij edhe vetë aftësitë profesionale të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, të cilët në raste të caktuara, në varësi të shkallës ku kanë gjykuar, mund të kenë qenë përkatësisht, gjyqtarë më të lartë ose më të ulët. Në këtë kontekst, qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta mund të provokojnë një vlerësim apo hetim të mëtejshëm drejt sjelljes profesionale të magjistratit, por ato nuk mund të jenë kriteri matës determinant për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre. Përpos këtij arsyetimi, rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Lartë në Shqipëri, dhe parimet e gjithëpranuara të Bangalores mbi sjelljen e gjyqësorit, kanë qenë të

qarta dhe eksplicite në këto raste për mospërdorimin e një vendimi të një gjykate më të lartë për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët.

5 Gjithashtu, kërkoj nga Kolegji të ketë parasysh rekomandimin e Këshillit të Evropës, përkatësisht të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare [17 nëntor 2010 CM/Rec(2010)12], "Mbi pavarësinë e eficencën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve", në Kreun VII ku trajnohet përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, ku përcaktohet se: "*Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose i provave të kryera nga gjyqtarët gjatë gjykimit të çështjeve nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë. Gjyqtarët nuk mund të jenë personalisht përgjegjës në rastet kur vendimet e tyre ndryshohen nga një gjykatë më e lartë* ".

Unë nuk vlerësoj me vend që të shprehem gjatë për meritën e çështjes përpara Kolegjit, por mjaftohem për të thënë se në vlerësimin tim, qëndrimi i Gjykatës së Apelit që e ka prishur vendimin e dhënë nga unë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, është i gabuar. Kjo pasi ndryshe nga vlerësimi i Gjykatës së Apelit, vlerësoj ndërgjyqësia ka qënë e rregullt, pasi Z.V.Rr.P.P.Shkodër, nuk tërheq asnjë interes ligjor në mosmarrëveshjen gjyqësore për të cilën kam marrë vendim. Nga ana tjetër, bashkëshortja e të padituritHalil Behri, nga aktet dhe shpjegimet e vetë këtij të padituri, ka rezultuar se nuk ka qënë bashëpronare epasurisë së pretenduar nga padituri. Ndërsa shkaku tjetër i prishjes së vendimit, prapë është i gabuar, pasi nëse Gjykata e Apelit ka vlerësuar se duhej riekspertim i tretë, këtë ajo mund t'a bënte vetë.

6. Përsa i përket konfliktit të interesit, jam shprehur më sipër dhe e vlerësoj të panevojshme të kaloj në përsëritje.Vlerësoj vetëm të shtoj se vetë natyra e disponimit tim me vendim, pra pranimi i pjesshëm i padisë, (***duke u rrëzuar tërësisht padia për ndërtesën dhe duke u pranuar vetëm pjesërisht për truallin***[56]), po të vlerësohet në sintezë me argumentet e dhëna tashmë lidhur me konfliktin e interesit, tregojnë qartë se ky nuk ekziston.

7. Përsa i përket vlerësimit të Komisionit se subjekti nuk ka argumentuar arsyet se pse kjo padi duhet të pranohet, por ka argumentuar arsyet se pse prapësimet e palës së paditur nuk duhet të pranohen, kjo ka të bëjë me cilësinë e arsyetimit për të cilën u shpreha më lart. Megjithatë, shumë shkurt, po shtoj se vetë natyra e çështjes si dhe struktura e arsyetimit të vendimit, e nënkuptojnë që ose do të pranohej padia dhe nuk do të merreshin në konsideratë prapësimet për truallin ose e kundërta, do të pranoheshin prapësimet dhe për rrjedhojë të rrëzohej padia për truallin. Po ashtu janë cilësuar të gjitha provat që kam vlerësuar në krijimin e bindjes së padia duhej pranuar pjesërisht për zërin truall të pasurisë, kam përshkruar saktësisht faktet, gjë që vërehet edhe nga fakti se këtë përshkrim e ka marrë të mirëqënë fjalë për fjalë edhe Gjykata e Apelit në vendimin e saj si dhe kam cituar dhe analizuar korrektësisht, normat ligjore që kam vlerësuar se kanë patur rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nëse komisioni vlerëson përsëri se kam gabuar, të ketë në konsideratë se unë në kohën që kam dhënë këtë vendim, as e kam ditur dhe as nuk kisha mundësi për t'a ditur se në të ardhmen, ky vendim do të vlerësohej

[56] Tregues tjetër që dëshmon të pavërtetën e shprehur në vendimin e Komisionit se nuk ka rrëzime kërkesë padish ku ka qënë përfaqësues i paditësit, avokati Lulzim Karini.

nga dikush që nuk ka të bëjë me rrugën e zakonshme të ankimit gjyqësor dhe aq më pak kam patur mundësi për të ditur ose parashikuar mendimin profesional të ketij vlerësuesi.

8. Përsa i përket barrës së provës që më ngarkon Komisioni për të paraqitur vendimin e Gjykatës së Apelit që ka prishur vendimin tim si dhe tre vendimet që e bëjnë komisionit të arrijë në vlerësimin se duket se kemi të bëjmë me gjë të gjykuar, kam për të thënë dy gjëra që janë: 1. Komisioni e ka të administruar dosjen gjë që rezulton nga materialet që vetë komisioni më vuri në dispozicion me cd kur më njohu me aktet e hetimit. Nëse i kanë humbur dhe/apo nuk i gjen dot, në dijeninë time, selia e lidhjes së shkrimtarëve nga Gjykata e lartë, nuk është më shumë se 400 metër linearë. Unë mendoj se bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit që të urdhërohem unë që të bëj rrugën Shkodër-Tiranë dhe anasjelltas, pra 250 km, ndërkohë që këtë mund t'a bëjë komisioni vetë. Nëse komisioni e vlerëson po ia ridërgoj edhe njëherë cd që më ka dhënë vetë.

9. Veç sa më sipër, në vlerësimin e kësaj çështjeje, i kërkoj komisionit të ketë parasysh se meqënëse çështja është në Gjykatën e Lartë, Komisioni duhet të tregohet i përmbajtur në dhënien e opinioneve lidhur me meritën (themelin) e çështjes, sipas nenit 36 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se: Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata.

10. Përsa i përket informacioneve të organeve ligjzbatuese që përmënden në raport por nuk më thuhet se kush janë, bëj me dije Komisionin se edhe para se të jepja vendimin edhe pasi kam dhënë vendimin, i padituri Halil Behri, në formë të nënkuptuar kërcënuese (jo të hapur), dhe po ashtu edhe përfaqësuesi i
tij, av. Kujtim Capo, (bashkëshorti i gjyqtares së Tiranës Anila Capo), më kanë thënë në mënyrë të përsëritur. Ki kujdes "se jam shtetas amerikan", (pra i padituri është shtetas amerikan). Unë me mirësjellje i kam kthyer përgjigje, që "në sytë e mi të gjithë janë të barabartë". Si provë të kësaj që po them shërben vetë fakti se unë nuk kam nga t'a di nëse shtetasi Halil Behri është apo jo shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përveçse mbi bazën e informacionit të thënë prej tij. Nëse është shtetas amerikan, nuk besoj se ka të drejta më shumë se një shqiptar. Gjithashtu, vlerësoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë shtet madhështor, pikërisht se janë të bazuara në funksionimin e aparatit shtetëror të tyre, në parimin e barazisë, në parimet e transparencës dhe drejtësisë dhe nuk kanë asgjë të përbashkët as me shantazhin dhe as me konspiracionin.

11. Përsëri, përsa i përket informacioneve të organeve ligjzbatuese që përmënden në raport por nuk më
thuhet se kush janë, bëj me dije Kolegjin se ndonëse raporti i dytë i DSIK, që më ka nxjerrë të papërshtatshëm, shprehet ndër të tjera për korrupsion sistematik, në raportin e rezultateve të hetimit që më ka dërguar Komisioni, nuk përmënden raste të tilla. Kjo më detyron të mbrohem me hamendësim, në errësirë. Meqënëse përmëndet rasti Hysen dhe Hasan Temali, në kriterin e figurës, atëherë kjo është shpifje e ulët. Këtu kërkoj që Kolegji të ketë në konsideratë standartin detyrues të vendosur me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, që përcakton ndër të tjera si më poshtë:

34.3 Kolegji vlerëson se pavarësisht se u është dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura nga subjekti në ankim, këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të

vlerësimit të kriterit të figurës, por duke analizuar aftësitë profesionale të subjektit, pasi në raportin e DSIK-së rezulton se disponohen të dhëna, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këtë kontekst, është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kritereve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale.

34.4 Kolegji, në mbështetje të rrethanave faktike të konstatuara në kontrollin e figurës, nisur dhe nga praktikat e vendimmarrjeve15 të mëparshme, vlerëson se në të dyja rastet e procedimeve penale, dyshimi për akte korruptive, i shprehur nga DSIK-ja në raportin për subjektin e rivlerësimit, lidhet me persona që nuk përfshihen në krimin e organizuar sipas përcaktimeve të pikave 6, 8 e 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerëson se standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të këtij neni, por Komisioni, në vendim, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit dhe nuk arsyeton mbi asnjë nga parashikimet e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji arrin në përfundimin se rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë standardet e kontrollit që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është plotësuar nga subjekti në mënyrë të plotë dhe të besueshme, të parashikuara nga neni 38, pikat 6 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016.

34.5 Kolegji konstaton se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së dhe të pasqyruara në vendim referojnë në dyshime për veprime me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në dy çështje penale.
Grupi i punës së DSIK-së nuk rezulton të ketë referuar të dhëna konkrete për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të Kreut V të ligjit nr. 84/016 që rregullon kontrollin e figurës. Raporti i DSIK-së nuk përmban informacion se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që formulari i kontrollit nuk është i plotë dhe i besueshëm sipas përcaktimeve të neneve 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, Kolegji vëren se rastet e referuara në raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për korrupsion, në mungesë të provave apo hetimit nga ana e Komisionit, në funksion të përcaktimit të ekzistencës së (Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1/2020, datë 15.01.2020, paragrafët nr. 66, 68 dhe nr. 6/2020, datë 18.06.2020, paragrafi nr. 43.6. nga 3)5 kontakteve të papërshtatshme në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës.

34.6 Nga analiza më sipër, Kolegji konkludon se në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës nuk provohet ë subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo se ka rrethana të tilla që të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për kriterin e kontrollit të figurës. Përfundimet e Komisionit në vlerësimin e këtij kriteri janë të paplota dhe nuk janë të mirargumentuara dhe në përputhje me standardet e kontrollit të figurës dhe, për pasojë, gjenden të mbështetura në ligj dhe në prova. Komisioni nuk ka arritur të provojë me dokumente dhe argumente bindëse se faktet e parashtruara në dokumentin e DSIK-së plotësojnë rrethanat
parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se çështjet e trajtuara nga Komisioni si rrethana të cilat e bëjnë subjektin e rivlerësimit të
papërshtatshëm sa i përket kriterit të kontrollit të figurës, nuk parashikohen nga ligji nr. 84/2016 si shkaqe që e bëjnë të pamundur vazhdimin e detyrës lidhur me këtë kriter, por edhe elementet e këtyre çështjeve nuk janë të vlefshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut,
sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të trajtimit të kësaj çështjeje, i lutem Kolegjit të ketë në konsideratë se gabimet që mund të kem bërë unë në gjykimin e kësaj çështjeje, sipas parimit të objektivitetit dhe sipas parimit të proporcionalitetit, nuk janë të mjaftueshme për të sjellë si pasojë shkarkimin tim nga detyra e gjyqtarit.

Gjithashtu, theksoj me forcë që unë i konsideroj qëndrimet e mësipërme ligjore dhe konstatimet dhe vlerësimet e shprehura në vendimin e komisionit si subjektivizma keqdashës dhe për më tepër pa rëndësi për të matur besimin publik në dhënien e drejtësisë apo aftësinë time organizative për zhvillimin e gjykimeve ose njohuritë e mia ligjore.

Së dhjeti: **Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë shtetasin Shefqet Molla, çështje gjyqësore regjistruar në datë 26.9.2011, me palë kerkuese Shefqet Molla dhe objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, vërtetim fakti të qënies së kërkuesit bashkëpronar të pasurisë në lagjen Zogaj Shkodër si dhe rivendosje në afat për t'iu drejtuar AKKP Tiranë. Me vendimin e datës 17.10.2011, nr. 2275 subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesë padisë**. Komisioni nga verifikimi, ka konstatuar:
 Kërkimet e palës së paditur nuk mund të shqyrtoheshin në të njëjtin proces gjyqësor pasi kemi të bëjmë me objekte të ndryshme, dëshmia e trashëgimisë nuk përbën vërtetim fakti juridik.
 Njohja bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme nuk bëhet me vërtetim fakti, pasi nuk mund të prodhojë pasoja për palët të treta.
 Vërtetimi i fakti nuk është një nga format e padisë për të zgjidhur njohjen e pronësisë së një pasurie të paluajtshme.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me vlerësimet e mësipërme të Komisionit, kam për të thënë sa më poshtë:

1. Ndryshe nga Komisioni mendoj se kërkesa me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, është vërtetim fakti juridik. Paraprakisht, jap konsideratën që komisionerja Genta Bungo që në

dijeninë time ka qënë pedagoge e të drejtës, s'ka asnjë mundësi të mos e di që kam të drejtë në këto që po shkruaj lidhur me këtë pikë.
Tani, lidhur me dallimin në qëndrim lidhur me këtë pikë, kam për të thënë se sipas doktrinës të së drejtës së procedurës civile, (Stavri Vinjau, Kleanthi Koçi, Stavri Çeço, Nonda Papuli, Sokol Çomo, etj), praktikës gjyqësore të konsoliduar ndër breza (shih pothuajse të gjitha kërkesat nga viti 1996 deri në 2013, - a e kanë të shënuar si bazë juridike të tyre, nenin 388 të KPC, krahas neneve 348 e vijues të Kodit Civil), praktikës së Gjykatës së Lartë, (shih p.sh vendimin nr. 223, datë 08.05.2012, me paditëse Ëngjëllushe Bishqemi), si dhe ligjit, (neni 388 i KPC), kjo nuk ka dyshim se është kështu si them unë.

Megjithatë, duke qënë se Komisioni ka qëndrim të ndryshëm, më lejoni të argumentoj se përse dëshmia e trashëgimisë, kuk është gjë tjetër veçse një vërtetim gjyqësor fakti.

Konkretisht, është fakt i ditur besoj se çështjet civile ndahen në dy kategori që janë:
a. çështje me palë kundërshtare, (që quhen ndryshe çështje të juridiksionit gjyqësor kontencioz).
b. Çështje pa palë kundërshtare, (që quhen ndryshe çështje të juridiksionit gjyqësor gracioz).
Çështjet e juridiksionit gjyqësor gracioz, vetë ndahen në dy nënkategori që janë:
a. Vërtetime fakti juridik, kur dokumenti që e vërteton faktin, ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri.
b. Vërtetime fakti juridik, kur dokumenti që e vërteton faktin, nuk mund të merret në rrugë tjetër përveç asaj gjyqësore.
Vërtetimet e faktit që nuk mund të merren në rrugë tjetër përveç asaj gjyqësore, ndahen edhe vetë në dy kategori, që janë:
a. Rastet kur vetë ligji parashikon që dokumenti merret në rrugë gjyqësore. Këto futen p.sh. Dëshmitë e trashëgimisë, (përpara se t'i bënin noterët), urdhrat e ekzekutimit, rivendosjen në afat, rastet kur ishpronarët që kërkonin t'iu ktheheshin apo kompensoheshin pronat, duhet të përcaktonin paraprakisht, në rrugën e vërtetimit të faktit, planvendosjen, kufitarët, etj, pra karakteristikat individualizuese të pasurisë, për kthimin ose kompensimin e pronës nga ish KKKP ish pronarëve, dhe organet suksesore të tyre, deri tek agjensia e Trajtimit të Pronave që është aktualisht, etj. (Për këtë rast të fundit, ka disa VKM dhe Udhëzime ndër vite, që përcaktojnë detyrimin e aplikuesve tek organet administrative që trajtonin problematikën e ish pronarëve, që së bashku me kërkesat për kthimin/kompensimin e pronës, të dorëzonin edhe një vërtetim gjyqësor fakti, ku të përcaktohej në mënyrë hartografike, planvendosja e pasurisë dhe karakteristikat e tjera që e individualizonin atë nga tërësia e pronavë të të njëjtës natyrë).
b. Rastet e tjera, kur nuk ka ekzistuar në mënyrë fillestare ndonjë dokument që të vërtetojë faktin juridik, por ligji nuk parashikon ndonjë rrugë përveç asaj gjyqësore për t'a vërtetuar faktin juridik me pasoja për kërkuesin.
Fakti që dëshmia ka qënë vërtetim fakti, përcaktohej shprehimisht nga neni 348 i Kodit Civil, i pandryshuar, që shprehej "*cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga Gjykata, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile*". Pra është pika "a" e paragrafit të mësipërm.

2. Ndryshe nga Komisioni mendoj se nuk është i bazuar në nenet 55 dhe 159 të KPC, vlerësimi se tre kërkesat që përfshihen në objektin e çështjes, nuk mund të shqyrtoheshin në të njëjtin proces gjyqësor

pasi kemi të bëjmë me objekte të ndryshme. Konkretisht, Neni 55 i KPC: Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, besoj se është e qartë se kërkimet kryesore të çështjes janë dy, (pasi qëndrojnë të pavaruara përkundrejt njëri tjetrit). Ato janë: a. Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë, dhe b. Përcaktimi përmes rrugës së vërtetimit gjyqësor të faktit, të planvedosjes së pasurisë, të sipërfaqes së saj, të faktit se i ati i kërkuesit ka bërë pjesë në bashkëpronarët e pasurisë, përpara se ajo (sipas kërkuesit) të shtetëzohej. Kërkimi më objekt "rivendosje në afat", ka karakter dytësor, pra mund të gjykohet së bashku me kërkimin për përcaktimin përmes rrugës së vërtetimit gjyqësor të faktit, të planvendosjes së pasurisë, të sipërfaqes së saj, të faktit se i ati i kërkuesit ka bërë pjesë në bashkëpronarët e pasurisë, përpara se ajo (sipas kërkuesit) të shtetëzohej.

Neni 159 i KPC: *Në një kërkesëpadi mund të parashtrohen shumë kërkime, në rast se gjykata është*
kompetente për të gjitha kërkimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre, do të shkaktojë
vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç.
Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, është e qartë se të tre kërkimet mund të gjykohen së bashku përderisa Gjykata ka qënë kompetente për të gjitha. Për më tepër Gjykata nuk ka patur ndonjë rol për të luajtur sepse përcaktimin e objektit të gjykimit e ka realizuar kërkuesi Shefqet Molla, përmes kërkesës të paraqitur prej tij dhe jo gjykata. Sipas neneve 5 dhe 185 të KPC e drejta e disponimit të padisë i përket në mënyrë paditësit/kërkuesit dhe Gjykata nuk mund të ndërhyjë për kufizimin e saj.

Përveçse tre kërkimet e përfshira në objektin e çështjes, referuar natyrës së tyre, janë përfshirë që të treja në juridiksionin gjyqësor gracioz, pra janë vërtetime gjyqësore fakti, bashkimi i tyre ka qënë i nevojshëm edhe pasi kanë patur lidhje të mjaftueshme referuar shkakut të këtyre kërkimeve.
Se kush quhet shkak i padise, përveç teorisë të së drejtës civile përcaktohet edhe nga praktika e konsoliduar me vendimet unifikuese nr. 9/viti 2006 dhe nr. 3/viti 2012 të KBGJL, që përmbledhtaz përcakton se me shkak të padisë kuptohet arsyeja e faktit që ka motivuar paditësin t'i drejtohet gjykatës me padi si dhe norma e ligjit që rregullon këtë gjendje fakti. Lidhja e mjaftueshme përsa i përket shkakut ndërmjet tre kërkimeve është e qartë. Kjo pasi shkaku i secilit prej këtyre kërkimeve ka qenë në thelbin e tij, nevoja e kërkuesit për të plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjor sipas kërkesave të VKM përkatëse që parashikonte mënyrën sesi duhet të plotësohej ky dokumentacion, për t'a dorëzuar së bashku me kërkesën për kthimin ose kompensimin e ish pronës, në organet administrative kompetente.

Fakti që kam patur të drejtë në mosveprimin për ndarjen e gjykimit të tre kërkimeve të përfshira në objektin e gjykimit, (që faktikisht janë paraqitur të bashkuara nga vetë kërkuesi si dhe kanë patur lidhje të mjaftueshme përsa i përket shkakut të tyre), konfirmohet edhe nga zhvillimet legjislative që kanë pasuar kohën në të cilën është zhvilluar gjykimi. Konkretisht, në nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, (ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, 30.3.2017), parashikohet si më poshtë vijon:

1. Kur dy ose më shumë padi janë duke u gjykuar në procese të ndryshme dhe lidhen midis tyre për nga objekti ose shkaku, mund të bashkohen në një gjykim të vetëm.
2. Vendimin për bashkimin e çështjeve e merr gjykata në të cilën çështja është regjistruar më parë në kohë.
3. Bashkimi i çështjeve mundet të bëhet me kërkesë të palëve ose kryesisht, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e séances gjyqësore nga gjykata që merr vendimin.
4. Në rastin kur bashkohen padi, të cilat gjykohen sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar me padi që gjykohen sipas rregullave të zakonshme, për gjykimin e çështjes zbatohen rregullat e zakonshme.
5. Kjodispozitë nuk zbatohet në rastin kur kompetenca lëndore në çështjet në gjykim është e ndryshme.

Përsa i përket vlerësimit (opinionit) të Komisionit se "njohja bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme nuk bëhet me vërtetim fakti, pasi nuk mund të prodhojë pasoja për palët të treta", jam dakort por ky vlerësim kam opinionin se nuk paraqet relevancë për rastin. Për të argumentuar qëndrimin tim lidhur me mungesën e rëndësisë së vlerësimit të Komisionit në trajtimin e rastit, po i referohem tre vendimeve unifikuese të KBGJL, që janë 9/2006, 3/2012 dhe 5/2012.
Sipas vendimeve unifikuese nr. 9/2006 dhe 3/2012 të KBGJL, me objekt të padisë kuptohet (përmbledhtaz), qëllimi që ndjek paditësi përmes padisë që ka paraqitur, pra pasoja juridike që ai synon
dhe dëshiron nga vendimi gjyqësor përfundimtar.
Sipas vendimit unifikues nr. 5/2012 të KBGJL, Gjykata e individualizon objektin e gjykimit jo vetëm
duke iu referuar fjalëzimit të përdorur nga paditësi përmes vendimit gjyqësor përfundimtar, por nga shqyrtimi edhe i përmbajtjes së padisë si dhe nga shpjegimet që japin palët gjatë tërësisë së gjykimit.

Pikërisht duke patur në vëmëndje këto vendime unifikuese, është e qartë se "objekti i gjykimit" të kërkesës së gjykuar me vendimin 51-2011-4224, datë 17.10.2011, (për çështjen e rregjistruar me datën 26.09.2011), me kërkues shtetasin Shefqet Molla, nuk ka patur të përfshirë në objektin e tij, ndonjë kërkim për njohje bashkëpronësie, përcaktime raportesh bashkëpronarësh, etj. Madje, kjo duket qartë si nga përmbajtja e kërkesës (padisë), përmes të cilës kërkuesi Shefqet Molla kërkon në thelb "vërtetimin e
faktit juridik se babai i tij Sait Molla, ka patur në pronësi përpara se t'i shtetëzohej, një pasuri të paluajtshme", por edhe nga përmbajtja e vendimit gjyqësor si dhe veçanarisht nga pika 3 e dispozitivit të
vendimit, ku unë, në cilësinë e gjyqtarit, jam shprehur "*Vërtetimin e faktit juridikse i ndjeri Sait Ymer*
Molla, ka patur në pronësi, pasurinë e paluajtshme të përbërë nga pjesët e mëposhtme...shih vendimin".

Pra, unë nuk arrij të kuptoj se cila është problematika e bashkëpronësisë për të cilën shprehet Komisioni për rastin. Ndoshta, Komisioni ngatërrohet me faktin se me të njëjtin vendim është lëshuar njëkohësisht

edhe dëshmia e trashëgimisë, dhe për rrjedhojë, i quan të gjithë trashëgimtarët e ish pronarit Sait Molla
si bashkëpronarë të pasurisë, për shkak të faktit se të gjithë këto bashkëtrashëgimtarë, do duhet të ishin
përfitues nga vendimi i Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, (tek e cila do të paraqitej vendimi krahas dokumentacionit tjetër tekniko-ligjor), nëse ky organ administrativ do t'a konsideronte
të bazuar kërkesën e tyre për kthimin dhe kompensimin e pronës.

Përsa i përket vlerësimit (opinionit) të Komisionit se "vërtetimi i fakti nuk është një nga format e padisë për të zgjidhur njohjen e pronësisë së një pasurie të paluajtshme", përsëri jam dakort por prapë nuk mendoj se ka relevencë për rastin. Kjo pasi sikurse u shpreha dhe më sipër, me vendimin gjyqësor 512011-4224, datë 17.10.2011, nuk kam trajtuar ndonjë çështje që ka të bëjë me mosmarrëveshje bashkëpronësie.
Pra, përmes vendimmarrjes time nuk kam identifikuar ndonjë shkak ligjor apo objekt gjykimi që ka të bëjë me njohje të drejte bashkëpronësie, që të ketë qënë ekzistuese dhe njohur nga rendi juridik në kohën që është zhvilluar gjykimi.

Lidhur me Konstatimet dhe vlerësimet e Komisionit se "nga analizimi i pjesës argumentuese të vendimit, konstatohet se:
i. Në lidhje me objektin e padisë vërtetim fakti të qënies së kërkuesit bashkëpronar në një pasuri të paluajtshme.
- Subjekti në vendim, në seksionin legjislacioni i zbatueshëm të vendimit, citon si bazë ligjore nenet 388-392 të K.Pr.Civile.
- Subjekti i referohet notës së transkiptit në favor të z. Sait Molla me nr.10230 rep. dhe nr.5726 kol. të vitit 1935 për të provuar pronësinë e z. Shefqet Molla. Nga ana e tij nuk ka referim në asnjë dokument tjetër për t'u provuar pronësia e z. Molla në lidhje me këtë pasuri.
- Nga ana e subjektit nuk është administruar asnjë provë në lidhje me ekzistencën e ndonjë AMTP për sa kohë kishim të bënim me një pasuri të llojit kullotë të ndodhur në Zogaj si dhe statusin juridik të kësaj prone në momentin e gjykimit.
 Për sa më sipër duket, Komisioni ka dhënë vlerësimin se vendimi i subjektit në lidhje me vërtetimin e faktit të qënies së kërkuesit bashkëpronar nuk është i argumentuar dhe nuk është në përputhje me normat procedurale civile pasi vërtetimi i faktit juridik nuk është padi njohje pronësie.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Kam për të thënë sa më poshtë:
1. Se përse zbatohen nenet 388-392 të KPC, e kam sqaruar më lart. Kjo pasi të tre kërkimet gjyqësore që parashtrohen përmes padisë, "për efekt të parashikimit shprehimisht në ligj", janë secili vërtetim gjyqësor fakti. Pra, vlerësoj se është e padobishme të kaloj në përsëritje.

2. Përsa i përket "përmendjes në vendim vetëm të notës së transkriptimit në favor të z. Sait Molla me nr.10230 rep. dhe nr.5726 kol. të vitit 1935, dhe mospërmëndes së ndonjë dokumenti tjetër si provë", (gjë që më lë të kuptoj se Komisioni ka qëndrimin se hetimi gjyqësor është i paplotë),

vlerësoj se hetimi gjyqësor ka qënë i plotë në këtë pikë. Kjo pasi nota e transkriptimit në fjalë, është paraqitur si provë nga
kërkuesi Shefqet Molla, në formën e aktit zyrtar me fuqi të plotë provuese. Duke patur këtë cilësi ky dokument, sipas nenit 253 të KPC, kam vlerësuar se e ka qënë e panevojshme thellimi i hetimit gjyqësor. Konkretisht, në nenin 228 të KPC parashikohet se "Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar".

3. Përveç, sa më sipër, vlerësoj se Komisioni duke u shprehur në mënyrë të nënkuptuar për thellësinë e hetimit gjyqësor, duket se kapërcen kompetencat e tij, duke rënë në kundërshtim me nenin 74, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu,
duket se Komisioni përmes këtij opinioni, bie në kundërshtim edhe me standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR) të Marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8 dhe 12.4, të tij, (të cilin e evidentova më sipër).

4. Gjithashtu, vlerësoj se Komisioni duke u shprehur në mënyrë të nënkuptuar për thellësinë e hetimit gjyqësor, si dhe duke e vendosur këtë vlerësim të tij në atë pjesë të raportit që merr në analizë "kriterin e figurës" të veprimtarisë time gjyqësore, duket se bie në kundërshtim, edhe me standartin detyrues të përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5 të tij, (të cilin e evidentova më sipër).

5. Përsa i përket konstatimit të Komisionit se "nga ana e subjektit nuk është administruar asnjë provë në lidhje me ekzistencën e ndonjë AMTP për sa kohë kishim të bënim me një pasuri të llojit kullotë të ndodhur në Zogaj si dhe statusin juridik të kësaj prone në momentin e gjykimit", kam për të thënë sa më
poshtë:

I. Hetimi nëse mbi pasurinë ka patur apo jo ndonjë AMTP, nuk ka qënë pjesë e objektit të gjykimit.

Sipas nenit 6 të KPC, Gjykata shprehet për gjithshka që kërkohet por vetëm për atë që kërkohet. Sipas ligjit të kohës për kthimin e pronës, ky hetim lidhur me AMTP-të, do duhet të kryhej nga Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi vetëm ky organ administrativ, kishte juridiksionin dhe kompetencën lëndore për të hetuar nëse kishte apo jo AMTP, në kuadrin e hetimit do do të kryente mbi
faktin që ish prona duhej trajtuar me kthim fizik apo kompensim, (gjithmonë nëse kërkesa për kthimin e
pronës, do të vlerësohej nga ky organ si e bazuar në ligj dhe prova).

II. Duket se Komisioni përmes evidentimit të kësaj "gjetjeje" dhe dhënies së këtij "vlerësimi", ka për qëllim të nënkuptuar të lërë për t'u kuptuar se unë përmes dhënies së këtij vendimi, kam

disfavorizuar disa subjekte që nuk kanë qënë palë në gjykim dhe që mund t'a kenë patur tokën me AMTP, (që edhe mund të përfshihen në subjektet që kanë bërë kallzim ndaj shtetasit Shefqet Molla për fallsifikim dhe përdorim dokumenti të fallsifikuar), dhe këtë e kam bërë me qëllim për të favorizuar kërkuesin Shefqet Molla, (që para gjykimit as e kam njohur fare dhe madje as tani nuk e mbaj mend as për fytyrë). Nëse Komisioni ndjek këtë qëllim të nënkuptuar, kjo është e padrejtë. Kjo pasi:

a. Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), që ka qënë në fuqi në kohën që kam dhënë vendimin gjyqësor objekt analize, (që sikurse u tha më sipër, nuk është gjë tjetër veçse një vërtetim gjyqësor fakti), në nenin të tij 17 të tij, të ndryshuar me ligjin nr.10207, datë 23.12.2009), në paragrafin 3 të tij, parashikohet se "*3. Në zbatim të këtij ligji, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk do të trajtojë me vendim asnjë kërkesë që mbështet pretendimin e vet vetëm në një vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës mbi pasurinë e paluajtshme, në kuptim të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha aplikimet e mbështetura mbi vërtetim fakti juridik do t'u kthehen subjekteve brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre*".

Pra nga zbatimi i kësaj dispozitë, duket qartë se jo vetëm nuk kam favorizuar apo disfavorizuar askënd, por madje nuk ka ekzistuar as edhe ligjërisht mundësia për t'a bërë këtë gjë.

b. Sipas nenit 451/a, paragrafi i paarë të KPC, nuk ka ekzistuar ligjërisht as mundësia për të bërë disfavorizime. Kjo pasi vendimi duket qartë se ka patur vetëm një palë, dhe për rrjedhojë vendimi ka
fuqi detyruese vetëm për këtë person. Asnjë tjetër.

c. Sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), që ka qënë në fuqi në kohën që kam dhënë vendimin gjyqësor objekt analize, zgjidhja e çështjes nëse duhej kthyer/kompensuar apo jo pasuria në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit Sait Molla, ku bën pjesë edhe
kërkuesi Shefqet Molla, nuk ka bërë pjesë në juridiksionin gjyqësor por në atë administrativ dhe konkretisht në atë kohë, ka qënë në kompetencën lëndore dhe funksionale të Agjensisë së Kthimit të Pronave. Unë përmes vendimit të dhënë, që nuk është gjë tjetër veçse një vërtetim gjyqësor fakti, (që madje sipas nenit 193 të Kodit Civil, nuk rregjistrohet në rregjistrin publik të pasurive të paluajtshme), nuk kam njohur ndonjë titull pronësie. Vetëm kam përcaktuar elementët identifikuese të pasurisë, planvendosjen, si dhe kam përcaktuar kush ka qënë ish pronari i saj. Në vijim, sipas ligjit, ishte Agjensia e Kthimit të Pronës, institucioni kompetent për të zgjidhur problematikën në fjalë. Pra, në këtë këndvështrim, vendimi i dhënë prej meje, absolutisht nuk ka sjellë dhe madje as mund të sillte ndonjë
pasojë ligjore. Ky vendim, thjesht ka ndihmuar shtetasin Shefqet Molla, për t'i treguar Agjensisë së Kthimit të Pronave, elementet identifikuese të pasurisë që ajo do duhej të trajtonte sipas ligjit nr.9235,
datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), mbi bazën e kërkesës së tij.

ç. Nëse Komisioni ndjek në mënyrë të nënkuptuar qëllimin e mësipërm, atëherë Kolegji, në shqyrtimin e kësaj çështjeje, të ketë parasysh se Komisioni ka vepruar me dy standarte. Kjo pasi

në rastin e subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja, Komisioni ka vërejtur po të njëjtën problematikë, dhe nuk e ka konsideruar përgjegjës. Ky vendim i KPK-së, është lënë në fuqi edhe nga KPA.

6. Në përfundim të kësaj pjese të analizë, unë mendoj se Komisioni ka gabuar kur në përmbledhje të sa më sipër, jep konluzionin se "*vendimi i subjektit në lidhje me vërtetimin e faktit të qënies së kërkuesit bashkëpronar nuk është i argumentuar dhe nuk është në përputhje me normat procedurale civile pasi vërtetimi i faktit juridik nuk është padi njohje pronësie*". Kjo pasi as kam njohur dikë bashkëpronar, as kam shkelur normat procedurale, vendimi është i argumentuar mjaftueshëm, nuk është kompetencë e komisionit cilësia e arsyetimit, sipas standartit e përcaktuar me vendimin 28/2020 (JR) të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8 dhe 12.4, të tij, (të cilin e evidentova më sipër), Komisioni duke e dhënë këtë vlerësim tek kriteri i figurës, shkel standartin e përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5 të tij, (të cilin e evidentova më sipër). Përveç kësaj, vërtetimi i faktit juridik jam dakort me komisionin që nuk është padi njohjeje pronësie, por ky vlerësim, nuk ka relevancë në rastin objekt analize. Kjo pasi "njohja e të drejtës së pronësisë", kur vihet në dyshim, qartësisht trajtohet me padi me palë kundërshtare, por "vërtetimi i faktit juridik të ish pronësisë dhe përcaktimi i planvendosjes hartografike të pronës", që është fiks rasti i trajtuar përmes vendimit objekt analize, qartësisht i përket juridiksionit gjyqësor gracioz. Kjo pasi për efekt të akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), aplikuesi do duhej të përcaktonte në rrugën e vërtetimit gjyqësor të faktit, planvendosjen, sipërfaqen dhe ish të drejtën e pronësisë, dhe pastaj vendimin për vërtetimin gjyqësor të faktit, t'a përfshinte si pjesë përbërëse e dokumentacionit tekniko-ligjor që do t'i përcillte për trajtim, së bashku me kërkesën, Agjensisë së Kthimit të Pronave.

Përsa i përket vlerësimit (opinionit) të Komisionit se:
"*Në lidhje me objektin e padisë të rivendosje në afat. Subjekti në vendim deklaron se kërkuesi ka argumentuar objektivisht në lidhje me humbjen e afatit për t'u drejtuar pranë AKKP Pronave të Tiranë,*
por nuk referon në asnjë prove apo fakt. Për sa më sipër duket se vendimi i subjektit i subjektit në lidhje me këtë pjesë të padisë nuk është i argumentuar. Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016", Unë përsëri nuk jam dakort. Kjo pasi:

1. Në këtë vlerësim, Komisioni shkel standartin e përcaktuar me vendimin 28/2020 (JR) të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8 dhe 12.4, të tij, (të cilin e evidentova më sipër).
2. Komisioni duke e dhënë këtë vlerësim tek kriteri i figurës, shkel standartin e përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5 të tij, (të cilin e evidentova më sipër).
3. Komisioni në raport, nuk referon në asnjë provë, indicie, etj, se përse ky konstatim dhe vlerësim, është bërë tek kriteri i figurës.
4. Lidhur me substancën e këtij vlerësimi, evidentoj se nga ana e kërkuesit më është pretenduar se ka qënë në padijeni të ekzistencës së notës së transkriptimit të pasurisë së babait të tij mbi

pronën dhe prandaj e ka humbur afatin. Kur kam pranuar kërkesën për rivendosje në afat, kam vlerësuar se përbën fakt të njohur botërisht se humbja e afatit të të paraqitur kërkesën për kthimin/kompensimin e ish pronës në ish AKP, në shumicën dërrmuese të rasteve, nuk është shkaktuar për fajin e subjekteve. Kjo pasi dokumentacioni që vërtetonte titullin e pronësisë mbi ish pronat, (rregjistrat e vjetër hipotekor të para vitit 1944), në qytetin e Shkodrës, ishte djegur ose dëmtuar tërësisht apo pjesërisht, në vitet 1997, 1998, (gjatë trazirave). Për rrjedhojë, subjektet nuk mund të konsideroheshin përgjegjës për pamundësinë e mbledhjes së dokumentacionit tekniko-ligjor që duhet të paraqisnin në AKP, bashkë me kërkesën për kthimin/kompensimin e ish pronës. Sipas nenit 13/1 të KPC "Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht
nuk ka nevojë të provohen". Kjo ka qënë edhe arsyeja që mbi 99% e gjyqtarëve të Republikës por në veçanti e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i pranonin këto kërkesa për rivendosje në
afat kur i merrnin në shqyrtim. Madje, kjo ka qënë edhe arsyeja që vetë ligjvënësi përmes ndryshimeve
të mëvonshme që i bëri legjislacionit për kthimin e pronave, e shtynte herë pas here afatin.

Përsa i përket konstatimit dhen vlerësimit (opinionit) të Komisionit se: "*Komisioni ka konstatuar se me vendim nr.134 datë 15.01.2018 z. Shefqet Mollaj së bashku me ekspertin e thirrur nga subjekti në këtë gjykim z. Gëzim Salja janë deklaruar fajtor për veprën penale të fallsifikimit në lidhje me dokumentin notë transkipti të depozituar nga z. Shefqet Molla në këtë proces gjyqësor. Nga shqyrtimi i kësaj dosje ngrihen dyshime për favorizim të paditësi Shefqet Molla, pasi duket se nga ana e subjektit vendimi nuk është i argumentuar si dhe ka kryer shkelje procedurale në lidhje me gjykimin e tre padive të llojeve të ndryshme në një padi, Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016* ", përsëri nuk jam dakort. Kjo pasi:

1. Për cilësinë e arsyetimit/argumentimit, shkeljet procedurale dhe tre paditë që komisioni padrejtësisht i quan të llojeve të ndryshme, u shpreha më sipër. Për rrjedhojë është e panevojshme që të kaloj në përsëritje.
2. Përsa i përket faktit që Shefqet Molla si dhe eksperti, qënka dënuar, tani po e marr vesh, por kjo nuk më ngarkon me asnjë përgjegjësi. Kjo pasi lipas ligjit penal, përgjegjësia penale është individuale. Unë as e kam ditur dhe as kam patur mundësi për t'a ditur në kohën kur kam zhvilluar gjykimin, se këta shtetas kanë kryer vepra penale. Supozimi i nënkuptuar që bën komisioni në këtë drejtim, jo vetëm që është i paligjshëm, por është edhe jo logjik. Kjo pasi i bie që Komisionerja Pamela Qirko, apo komisioneri i larguar nga procesi im i rivlerësimit, Roland Ilia, të kenë përgjegjësi për shkak të faktit se potencialisht unë, mund të kem përdorur ndonjë dokument të rremë në procesin tim të rivlerësimit, të cilin ata e kanë marrë të mirëqënë. Përveç kësaj, sipas nenit 6/2 të KEDNj-së, pafajësia ndaj supozimit se ke kryer një vepër penale, prezumohet dhe nuk është në barrën e provës të atij ndaj të cilit ngrihet supozimi, që t'a vërtetojë atë.
3. I lutem Kolegjit që në shqyrtimin e kësaj çështjeje, të mos e lejojë Komisionin të veprojë me dy standarte. Shihni rastin e subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja, ku KPK me vendimin 224, datë 20.12.2019 të tij, pasi ka shqyrtuar rrethana të njëjta (madje më të shumta në numër) nga rasti im, ka konstatuar se ato nuk mbështeten në prova bindëse dhe për rrjedhojë nuk qëndrojnë.

Edhe në përfundim të trajtimit të kësaj çështjeje, i lutem Kolegjit të ketë në konsideratë se gabimet që mund të kem bërë unë në gjykimin e kësaj çështjeje, sipas parimit të objektivitetit dhe sipas parimit të proporcionalitetit, nuk janë të mjaftueshme për të sjellë si pasojë shkarkimin tim nga detyra e gjyqtarit.

Gjithashtu, theksoj me forcë që unë i konsideroj qëndrimet e mësipërme ligjore dhe konstatimet dhe vlerësimet e shprehura në vendimin e komisionit si subjektivizma keqdashës dhe për më tepër pa rëndësi për të matur besimin publik në dhënien e drejtësisë apo aftësinë time organizative për zhvillimin e gjykimeve ose njohuritë e mia ligjore.

Së njëmbëdhjeti: **Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë shtetasin Shefqet Molla, çështje gjyqësore regjistruar në datë 15.12.2011 me palë kërkuese Shefqet Molla dhe objekt vërtetimin e faktit juridik të qënies pronar të ish-pronarit Sait Molla për pasurinë e ndodhur në fshatin Kosmaç, Komuna Bushat Shkodër, me sip.20,000 m2 dhe rivendosje në afat të të drejtës të kërkuesit për t'iu drejtuar AKKP Tiranë**. Në lidhje me këtë gjykim, nga ana e Komisionit konstatohet:

- subjekti ka caktuar tre seanca gjyqësore në harkun kohorë të 5-ditëve. Seanca e parë është caktuar në datë 19.12.2011 dhe seanca e fundit në datë 23.12.2011. Në seancës e datës 21.12.2011 subjekti ka caktuar ekspert duke i dhënë vetëm 2 ditë kohë për aktin e ekspertimit.
- Në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i shtetasit z. Shefqet Molla për zhvillimin e seancës duke marrë në konsideratë që vendimi është marrë ditë të premte dhe seanca është caktuar për ditë të hënë.
- Nga analizimi i vendimit konstatohet se nga ana e subjektit nuk është argumentuar kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuesit Shefqet Molla për t'iu drejtuar AKK Pronave Tiranë.
-Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore të nenit 155 të K.Pr.Civile për caktimin e seancës.

 Në përfundim, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër vetëm 5 ditë të gjykimit të çështjes, caktimit të një afati shumë të shkurtër ekspertit për të bërë aktin e ekspertimit si dhe mungesës së njoftimit të paditësit për zhvillimin e gjykimit ngrihen dyshime për favorizim të paditësi Shefqet Molla.
Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe të paraqesë vendime me të njëjtin objekt të përfunduar brenda 5 ditëve dhe caktimin e afatit të ekspertimit 2 ditë.

Në lidhje me konstatimet dhe vlerësimet e mësipërme të Komisionit, kam për të thënë sa më poshtë.

1. Lidhur me mungesën e njoftimit, përpara se Komisioni të arrijë në ndonjë përfundim, duke të ketë arasysh se kryerja e njoftimit, nuk është detyrë e gjyqtarit por e sekretarit gjyqësor dhe nëpunësit gjyqësor, (ftuesit), sipas neneve 77/3 dhe 78/2 të KPC, që parashikojnë se:
Neni 77/3 "*Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor*".

Neni 78/2: *Punonjësi i gjykatës është përgjegjës për kryerjen e rregullt të njoftimeve. Ai merr masa për realizimin e kërkimeve të nevojshme në lidhje me adresën e personit që i drejtohet njoftimi, në regjistrat publikë, në organet e administratës shtetërore, në familje dhe tek të afërmit, në vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit të personit që i drejtohet njoftimi, ose nëpërmjet burimeve të tjera të mundshme*.

2. Gjyqtarit ka kompetencë mbikqyrëse dhe kontrolluese përkundrejt sekretarit dhe ftuesit që e ushtron kur është nevoja dhe rasti i përshtatshëm, por në rastin konkret vetë fakti i paraqitjes së të njoftuarit në gjykim, ka bërë që sipas vlerësimit tim, të bien në dekadencë pretendimet e mundshme lidhur me njoftimin e shtetasit Shefqet Molla. Kjo sipas nenit 119 të KPC që parashikon se *Akti procedural që nuk është kryer në formën që kërkohet shprehimisht nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm. Akti mund të shpallet i pavlefshëm edhe kur i mungojnë të dhënat e domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij. Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar*.

3. Nuk ka asnjë kuptim as juridik dhe as logjiko-praktik që unë të shtyja seancën gjyqësore për pavlefshmërinë e njoftimit të kërkuesit Shefqet Molla, ndërkohë që ai u paraqit në gjykim.

4. Nuk ka sekretar gjyqësor në Republikën e Shqipërisë që në veprimtarinë e tij, që për arsye praktike (për t'u mos u mbingarkuar) nuk aplikon lidhur me njoftimet nenin 144 të KPC, që parashikon "Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin". Në rastin konkret, paraqitja e shtetasit Shefqet Molla dhe dokumentimi i faktit të paraqitjes me procesverbal gjyqësor, nuk është gjë tjetër veçse konfirmim me shkrim i faktit që njoftimi ka qënë jo vetëm bindës por edhe se e ka realizuar qëllimin për të cilin është destinuar.

5. Lidhur me barrën e provës për të paraqitur vendime të ngjashme, të gjykuara brënda 5 ditëve nga rregjistrimi, e kam përmbushur pasi kam dorëzuar në Komision disa vendime të kësaj natyre.

6. Kjo natyrë çështje nuk ka sensibilitet publik dhe kontrolli i saj nuk shërben për të rikthyer besimin publik në organet e drejtësisë. Kjo pasi sikurse u shpreha edhe në lidhje me çështjen tjetër, të mësipërme të shtetasit Shefqet Molla, konstatimet dhe vlerësimet e mësipërme të Komisionit, duket se janë bërë me qëllim të nënkuptuar për të nxjerrë në pah, favorizimin që sipas Komisionit unë dyshohet se i kam bërë shtetasit Shefqet Molla. Unë jo vetëm që nuk i kam bërë ndonjë favorizim këtij shtetasi lidhur me këtë çështje, po madje as kam patur objektivisht mundësi që t'a bëjë një gjë të tillë. Kjo pasi:

a. Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), që ka qënë në fuqi në kohën që kam dhënë vendimin gjyqësor objekt analize, (që sikurse u tha më sipër, nuk është gjë tjetër veçse një vërtetim gjyqësor fakti), në nenin të tij 17 të tij, të ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009), në paragrafin 3 të tij, parashikohet se "3. Në zbatim të këtij ligji, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk do të trajtojë me vendim asnjë kërkesë që mbështet pretendimin e vet vetëm në një vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës mbi pasurinë e paluajtshme, në kuptim të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha aplikimet e mbështetura mbi vërtetim fakti juridik do t'u kthehen subjekteve brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre".

Pra nga zbatimi i kësaj dispozitë, duket qartë se jo vetëm nuk kam favorizuar apo disfavorizuar askënd, por madje nuk ka ekzistuar as edhe ligjërisht mundësia për t'a bërë këtë gjë.

b. Sipas nenit 451/a, paragrafi i parë të KPC, nuk ka ekzistuar ligjërisht as mundësia për të bërë favorizime apo disfavorizime. Kjo pasi vendimi duket qartë se ka patur vetëm një palë, dhe për rrjedhojë vendimi ka fuqi detyruese vetëm për këtë person. Asnjë tjetër. Madje nuk ka patur fuqi detyruese as për Agjensinë e Trajtimit të Pronave (shih arsyetimin e mësipërm) dhe as për Zyrën Vendore Shkodër të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo pasi sipas nenit 193 të K.Civil, nuk rregjistrohet në rregjistrin e pasurive të paluajtshme, titulli i pronësisë mbi vërtetimin gjyqësor të faktit të pronësisë.

I lutem Kolegjit që në vlerësimin e kësaj çështjeje, të ketë në vëmëndje se sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), që ka qënë në fuqi në kohën që kam dhënë vendimin gjyqësor objekt analize, zgjidhja e çështjes nëse duhej kthyer/kompensuar apo jo pasuria në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit Sait Molla, ku bën pjesë edhe kërkuesi Shefqet Molla, nuk ka bërë pjesë në juridiksionin gjyqësor por në atë administrativ dhe konkretisht në atë kohë, ka qënë në kompetencën lëndore dhe funksionale të Agjensisë së Kthimit të Pronave. Unë përmes vendimit të dhënë, që nuk është gjë tjetër veçse një vërtetim gjyqësor fakti, nuk kam njohur ndonjë titull pronësie. Vetëm kam përcaktuar elementët identifikuese të pasurisë, planvendosjen hartografike, sipërfaqen, kufitarët, si dhe kam përcaktuar kush ka qënë ish pronari i saj. Në vijim, sipas ligjit, ishte Agjensia e Kthimit të Pronës, institucioni kompetent për të zgjidhur problematikën në fjalë. Pra, në këtë këndvështrim, vendimi i dhënë prej meje, absolutisht nuk ka sjellë dhe madje as mund të sillte ndonjë pasojë ligjore. Ky vendim, thjesht ka ndihmuar shtetasin Shefqet Molla, për t'i treguar Agjensisë së Kthimit të Pronave, elementet identifikuese të pasurisë që ajo do duhej të trajtonte sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës, (i ndryshuar), mbi bazën e kërkesës së tij.

c. Nëse Komisioni ndjek në mënyrë të nënkuptuar qëllimin e mësipërm, atëherë Kolegji të ketë parasysh se Komisioni ka vepruar me dy standarte. Kjo pasi në rastin e subjektit të rivlerësimit Astrit Kalaja, Komisioni ka vërejtur po të njëjtën problematikë, dhe nuk e ka konsideruar përgjegjës. Ky vendim i KPK-së, është lënë në fuqi edhe nga KPA.
7. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se "subjekti ka caktuar tre seanca gjyqësore në harkun kohorë të 5-ditëve. Seanca e parë është caktuar në datë 19.12.2011 dhe seanca e fundit në datë 23.12.2011. Në seancës e datës 21.12.2011 subjekti ka caktuar ekspert duke i dhënë vetëm 2 ditë kohë për aktin e ekspertimit", nuk jam dakort me qëllimin e nënkuptuar që dëshirohet të nxirret në pah përmes këtyre konstatimeve. Kjo pasi:

a. çështja sikurse u tha, nuk është gjë tjetër veçse një vërtetim gjyqësor fakti që ka për shkak nevojën e kërkuesit Shefqet Molla, për të përcaktuar në mënyrë hartografike, planvendosjen, sipërfaqen dhe kufitarët e ish pronës së trashëgimlënësit të tij në mënyrë që ky kërkues, në vijim, të ketë mundësi t'i tregojë Agjensisë së Kthimit të Pronës, elementët identifikuese të pasurisë që ai kërkon të trajtohet.
Objekti i hetimit gjyqësor të çështjes, (që diktohet nga shkaku i padisë dhe objekti i saj), nuk ka të bëjë me njohjen e ndonjë të drejte pronësie ekzistuese dhe konkrete, (të aftë për të marrë pjesë në qarkullimin civil), mbi pasurinë të cilës kërkuesi Shefqet Molla, ka nevojë t'i përcaktohet planvendosja hartografike, sipërfaqja dhe kufitarët e ish pronës së trashëgimlënësit të tij. Objekti

i hetimit gjyqësor të çështjes ka të bëjë vetëm me një shqyrtim paraprak dhe jo të thelluar, që nuk i nënshtrohet rregullave të kontradiktoritetit, të faktit juridik nëse trashëgimlënësi i kërkuesit Shefqet Molla, ka patur apo jo në pronësi të tij, në gjallëri të tij, pasurinë, përpara se ajo t'i shtetëzohej. Në vijim, i përkiste Agjensisë së Kthimit të Pronave, e drejta dhe detyra ligjore (kompetenca) që pasi t'i hetonte thellësisht dhe në mënyrë përfundimtare, pretendimet eventuale të shtetasit Shefqet Molla, të dispononte nëse prona që ai pretendonte duhej apo jo t'i kthehej/kompensohej tërësisht, pjesërisht, apo kërkesa t'i refuzohej.

b. Thënë sa më sipër, duke iu referuar objektit dhe shkakut të kërkesës për vërtetim gjyqësor fakti, që ka paraqitur kërkuesi Shefqet Molla, ka qënë e qartë për mua se hetimi gjyqësor nuk ka patur karakter kompleks. Madje, mungesa e kompleksitetit të kësaj çështjeje, ka qënë e qartë edhe për ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që kur ka miratuar rregullat për sistemin periodik të vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike të gjyqtarëve, që ka qënë në fuqi, në kohën e zhvillimit të gjykimit të çështjes, kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve të së njëjtës natyrë me çështjen objekt analize, e ka përfshirë në standartin kohor "deri në 2 muaj nga koha e paraqitjes së kërkesës". Pra, vetë mungesa e kompleksitetit të hetimit gjyqësor si dhe ekzistenca e standartit kohor dy muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, sigurisht janë marrë në konsideratë nga ana ime, në planifikimin organizativ që kam zbatuar lidhur me zhvillimin e gjykimit. Kjo ka qënë arsyeja që gjykimi i çështjes, ka zgjatur 8 ditë, pra brënda standartit kohor në fjalë.

c. Unë në caktimin e datës së parë të zhvillimit të seancës gjyqësore, nuk e kam konsideruar të zbatueshëm, paragrafin e parë të nenit 155 të KPC, (shkeljen e të cilit Komisioni nuk m'a evidenton si gjetje apo vlerësim në çështjen për të cilën po shprehem), pasi sikurse e kam thënë edhe më sipër:

i. Afati ligjor i parashikuar nga neni 155/1 i KPC, zbatohet për paditë me palë kundërshtare (të juridiksionit gjyqësor kontencioz), dhe nuk zbatohet për kërkesat pa palë kundërshtare, që në thelbin e
tyre janë vërtetime faktesh gjyqësore, (që përfshihen në juridiksionin gjyqësor grocioz)[57]. Kjo sipas intepretimit literal (gjuhësor) të normës. Çështja për të cilën po shpreh mendim është kërkesë, pa palë.
Ratioja e ekzistencës së këtij afati ligjor, është garantimi i zbatimit të parimit të kontradiktoritetit dhe e së drejtës së mbrojtjes. Në gjykimet e të njëjtës natyrë me çështjen në fjalë, pra pa palë kundërshtare, nuk ka një ratio të tillë, pasi nuk ka kontradiktoritet palësh.

ii. Edhe sikur të pranohet se kjo dispozitë është e zbatueshme përsa i përket afatit ligjor, edhe për çështjen në fjalë, Komisioni duhet të ketë parasysh se afati ligjor që parashikon neni 155 i KPC, në thelbin e tij është afat në dobi të palës, pra nuk është afat i prerë. Sipas nenit 146 të KPC, "*Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç kur ligji e parashikon shprehimisht se janë të prera.*
Afatet e prera nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve".

[57] Komisioni shprehet se afati 10 ditor zbatohet edhe për gjykimet gracioze, pa palë, pasi neni 155 nuk ka parashikim të kundërt. Duke lënë mënjanë aftësinë e Komisionit për të njohur llojet e interpretimit që i bëhen normave juridike, i lutem Kolegjit të ketë parasysh se me intepretim sistematik dhe gjuhësor, fakti se ky afat zbatohet vetëm për paditë me palë kundërshtare, pra vetëm për paditë kontencioze, rezulton i qartë nga përmbajtja e paragrafit të tretë të nenit 155 të KPc, që ka fjalëzimin "me qëllim që paditësit t'i sigurohet e drejta e mbrojtjes".

Me intepretim literal si dhe intepretim ad contrario, (që është një nënllojet e intepretimit logjik në normës), rezulton se afatet jo të prera, mund të shkurtohen ose zgjaten kur pala jep pëlqim për këtë. Kërkuesi duke marrë pjesë në seancë, në mënyrë të nënkuptuar ka dhënë pëlqim për shkurtimin e këtij
afati. Ky lloj intepretimi i normës është në pajtim edhe me paragrafin e tretë të nenit 155 të KPC që parashikon se "Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e
paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të padituri të drejtën e mbrojtjes". Për sa kohë kam caktuar seancën, kjo ndoshta ka qënë kërkesë e kërkuesit Shefqet Molla, që
është pranuar. Edhe sikur të ketë patur të meta në formën e pranimit të kërkesës, Komisioni duhet të ketë parasysh nenin 119/3 të KPC ku parashikohet se "*Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar*".
Me kaq, besoj se e justifikova mjaftueshëm se përse seanca e parë është caktuar me datën 19.12.2011, pra katër ditë nga koha e rregjistrimit të çështjes, (ndërsa padia duhet të jetë paraqitur dy-tre ditë para rregjistrimit, por nuk e kujtoj, pasi nuk e kam në dispozicion që t'a shoh dosjen, për shkak të mungesës
së kohës që kam për t'i kthyer përgjigje Komisionit).

ç. Seanca e parë gjyqësore duhet të jetë ndërprerë, pasi është caktuar eksperti Gëzim Salja i cili duhet të
jetë njoftuar me telefon nga sekretarja, pasi sikurse shumë ekspertë të tjerë gjyqësore të fushave të ndryshme, e ka patur zyrën në një distancë 10-15 metër nga godina e Gjykatës. Kështu, jo vetëm në atë
kohë por madje edhe sot, veprojnë pothuajse të gjithë gjyqtarët e Republikës, madje ka raste që për nevoja të punës, njoftimin me telefon e bëjnë vetë gjyqtarët, jo sekretarja, për t'i dhënë më autoritet njoftimit telefonik dhe përmes autoritetit, të garantojnë realizimin e qëllimit të veprimit procedural të njoftimit. P.sh, me datën 09.11.2022, kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër, zoti Fuat Vjerdha, ka njoftuar me telefon personalisht, bashkëshorten time, për t'u paraqitur në Gjykatën e Apelit dhe për të marrë pjesë në një gjykim, si eksperte psikologe. Ky gjyqtar, e ka kaluar vetingun me vendim të KPA, të votuar unanimisht nga të 5 anëtarët e trupës gjykuese. Po ashtu, edhe gjyqtarja Valbona Vata, e Gjykatës së Apelit Shkodër, ka telefonuar bashkëshorten time, me datën 06.11.2022, për të njëjtin qëllim. (Mund të shihen tabulatet e bashkëshortes time). Edhe gjyqtarja Valbona Vata, e ka kaluar vetingun me vendim të KPK, ndaj të cilit nuk është bërë ankim. Unë, në modelin tim të punës si gjyqtar, nuk kam njoftuar kurrë vetë personalisht, palët, avoketerit, ekspertet, prokurorët, etj, por ama, nuk kam patur asnjë arsye fakti ose ligji, që të mos lejoja që sekretarja, për lehtësi pune, të përdorte njoftimin telefonik, për sa kohë as lloji (mënyra) e njoftimit, as pavlefshmëritë eventuale të formës së njoftimit, (mungesa e dokumentimit të njoftimit), nuk kompromentonin realizimin e qëllimit për të cilin kryhej veprimi procedural i njoftimit telefonik, (këtu shih nenin 119 të KPC).

d. Në seancën e dytë të datës 21.12.2011, në të cilën eksperti është paraqitur dhe ka marrë detyrat, unë e kam pyetur ekspertin, sa kohë të nevojitet dhe ai vetë më ka thënë dy ditë. Për rrjedhojë, unë kam shtyrë seancën, fiks aq kohë sa i është dashur ekspertit. Kjo pasi një gjë e tillë

më është dukur e arsyeshme për shkak të faktit se eksperti në thelb, nuk është se kishte ndonjë detyrë të vështirë. Unë kam perceptuar në
atë kohë se përcaktimi i një planvendosje hartografike të një sipërfaqeje toke, matja e sipërfaqes, pra detyrat e ekspertit, nuk kanë qënë të vështira. Vetë fakti që eksperti nuk është shprehur se koha është e pamjaftueshme si dhe fakti që ai në seancën e datës 23.12.2011, e ka sjellë aktin e ekspertimit, tregon se koha ka qënë e mjaftueshme dhe se ekspertimi nuk ka qënë i vështirë.

dh. Lidhur më shkallën e vështirësisë së ekspertimit, i kam kërkuar Komisionit që të ketë në konsideratë si të provuar faktin që unë kam mbaruar shkollën e mesme. (Madje e kam mbaruar me mesatare 9.41). Po ashtu, kam mbaruar Fakultetin Juridik, (me mesatare 9.72). Në vijim, Shkollën e Magjistraturës, etj. Formimi im kulturor e quan të papranueshëm dhe difektoz për ushtrimin e pozicionit të gjyqtarit, komisionerit apo funksionarëve të tjerë të drejtësisë, mbarimin e studimeve në cilindo cikël shkollimi/studimesh, duke filluar nga shkolla fillore, marrjen e notave mesatare nën notën tetë, (p.sh bie
fjala 7.14 (sikurse komisionerja Pamela Qirko) që në fakt nuk është as aq po të heqësh notën 10 që është marrë në fiskulturë). Në shkollë të mesme, kam bërë vizatim teknik. Po ashtu, kam bërë lëndën e fizikës, lëndën e njohurive teknologjike, (që të mëson si maten detalet), etj. Në të gjitha këto lëndë, kam marrë në më të shumtën e rasteve notën 10, por jo poshtë notës 9. (Për këtë që po them, mund t'i referoheni duke pyetur DSIK-në). Të gjitha këto njohuri që kam marrë, përfshihen në njohuritë mesatare kulturore që ka çdo njeri që ka mbaruar një gjimnaz normal. Këto njohuri, për rrjedhojë, i bie të kenë qënë në dijeni edhe të anëtarëve të trupës së Komisionit dhe sigurisht edhe të Kolegjit. Ndër këto njohuri mesatare padyshim përfshihet edhe aftësia "për të matur sipërfaqen e një plani" si dhe "aftësia për të pasqyruar hartografikisht një plan, kur të jepen të dhënat përkatëse të sipërfaqes dhe kufinjtë perimetral". Këto janë njohuri mesatare. Sa kohë duhet për t'a bërë këtë, një njeri me formim mesatar që ka mbaruar një gjimnaz, - a i duhet më shumë se 3-4 orë. Qartësisht jo. Po një eksperti topograf që ka mbaruar shkollën e lartë për inxhinieri gjeodezike, - sa kohë i duhet ?!!!!.
Natyrisht, pyetja shtrohet në formë retorike, pasi përgjigjja dihet. Prandaj, koha dy ditë është vlerësuar si nga eksperti ashtu edhe nga unë, si e arsyeshme për ekspertin, që qartësisht ka qënë e mjaftueshme. Kjo pasi eksperti në përcaktimin e kohës që i duhet, merr vetë parasysh shkallën e vështirësisë, (që qartësisht ka qënë minimale), por edhe faktorë të tjerë, sikurse janë angazhimet e tjera, koha që i duhet për të shkruar aktin, etj. Prandaj, i lutem Kolegjit që arsyetimin voluntarist të Komisionit lidhur me afatin e shkurtër të ekspertit, të mos e konsiderojë të bazuar. Kjo pasi ky arsyetim i Komisionit bazohet në premisa haptazi të pavërteta dhe të palogjikshme se "koha që i është caktuar ekspertit ka qënë e pamjaftueshme" dhe "për rrjedhojë, ngrihet dyshimi se ka patur favorizim".

Unë për përcaktimin/dhënien e dakortësisë për kohën dy ditore që i është dashur ekspertit për të përfunduar aktin e ekspertimit, padyshim i jam referuar si natyrës së detyrave që i janë shtruar ekspertit
por kam përdorur si kriter bazë edhe njohuritë e prezumuara të njeriut me formim kulturor mesatar, që
ka mbaruar një gjimnaz, (ku modestisht e përfshij edhe veten time). Pikërisht, duke marrë në konsideratë natyrën e këtyre detyrave si dhe duke iu referuar si kriter minimal bazë, këtyre njohurive mesatare, i lutem Kolegjit t'a hedhë poshtë si të pabazuar qëndrimin e mësipërm të Komisionit (të shprehur në vendim tek kriteri i figurës), që bazohet në premisën e palogjikshme

dhe haptazi tregues padituri, se koha për të matur një plan dhe për t'a hedhur atë në hartë, është e pamjaftueshme.

I lutem gjithashtu, Kolegjit që përpara se të arrijë në ndonjë konkluzion lidhur me bazueshmërinë e kësaj që thashë më sipër, të vlerësojë paraprakisht, se një nga standartet e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 6/1 i KEDNj-së, është ai i "gjykatës së drejtë. Vetë ky standart, ndahet në dy nënstandarte që janë "gjykatë e ditur" dhe "gjykatë e ndershme", që duhen të plotësohen bashkarisht. Unë vlerësoj se në rastin konkret, është e palejueshme që mungesa e qëllimshme e plotësimit të njerit nënstandart nga Komisioni, (pasi realisht prezumoj se tek ju (Kolegji) nuk ka një mungesë të tillë), të ngrihet deri aty sa të përdoret si premisë argumentimi për të më ngarkuar mua barrën e provës për të vërtetuar se kam plotësuar nënstandartin e "gjyqtarit të ndershëm", në gjykimin e çështjes që përbën objektin e kësaj pjese të trajtimit. Kaq, besoj se është e mbaftueshme për kohën që i është dashur ekspertit.

dh. Në seancën e datës 23.11.2011, në të cilën është administruar akti i ekspertimit, është dhënë vendimi
përfundimtar. Kjo pasi pala Shefqet Molla, nuk ka patur kundërshtime si dhe çështja jo vetëm që nuk ka
patur karakter kompeks, por ka qënë e thjeshtë.

8. Në nenin 4 të KPC, parashikohet se "*Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor.*
Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme". Kjo dispozitë ligjore, i jep diskrecionalitet gjyqtarit, në planin organizativ të veprimtarisë gjyqësore që zhvillon për gjykimin e çështjeve. Unë vlerësoj se konstatimet dhe vlerësimet e Komisionit, për gjykimin e kësaj çështjeve, lidhur me zbatimin e nenit 155/1 të KPC, janë të gabuara. Konstatimet dhe vlerësimet për kohën e shkurtër që i është dhënë ekspertit, janë subjektive dhe të gabuara. Konstatimet dhe vlerësimet për kohën e shkurtër të gjykimit, janë subjektive. Konstatimet dhe vlerësimet lidhur me mungesën e njoftimeve, janë të sakta por përdoren gabimisht kundër personit tim, pasi nuk janë përgjegjësi e imja por e sekretares dhe/apo ftuesit gjyqësor, dhe për më tepër nuk kanë sjellë asnjë pasojë për procesin. ***Për rrjedhojë, do të ishte jo në pajtim me parimin e objektivitetit dhe parimin e proporcionalitetit, që këto mangësi të përdoren kundër meje, veçanarisht, tek kriteri i figurës. Konstatimet dhe vlerësimet se duket se kam bërë favore, mbi arsyet e lartëpërmëndura, janë të pavërteta, subjektive, të paprovuara, keqdashëse, të paligjshme dhe arbitrare***.
Duke patur të gjitha karakteristikat e mësipërme, gjetjet e Komisionit të përmëndura më sipër, në vlerësimin tim, nuk mjaftojnë për të vënë në dyshim, ndershmërine e mënyrës se si unë si gjyqtar, e kam ushtruar diskrecionalitetin që më ka dhënë neni 4 i KPC, në hartimin dhe zbatimin e planit organizativ të gjykimit.

9. Lidhur me gjetjen që "*vendimi është marrë ditë të premte dhe seanca është caktuar për ditë të hënë*", është shpifje. Nuk ka vendim përfundimtar ditën e premte ndërkohë që seanca në të cilën është marrë vendimi, të ishte caktuar të hënën, pra pas dy ditësh nga shpallja e vendimit. Ndoshta, Komisioni e paraqet të përmbysur kronologjinë kohore të zhvillimit të seancave, që është: ditën e hënë me 19.12.2011 seanca e parë, ditën e mërkurë me datën 21.12.2011 seanca e dytë dhe ditën premte me 23.12.2011 seanca e tretë dhe e fundit. Fakti që nuk gjendet njoftimi i

shtetasit Shefqet Molla, justifikohet me faktin se ai pas shortimit të çështjes, që është data 15.12.2011, pasi ka marrë njoftim për emrin e gjyqtarit, është paraqitur personalisht dhe ka marrë kontakt me sekretaren e cila i ka njoftuar gojarisht dhe pa e dokumentuar njoftimin për seancën e parë, që është zhvilluar me datën 19.12.2022, seancë në të cilën ai është paraqitur. ***Kjo formë e gabuar dhe mosdokumentim njoftimi, ka ndodhur dhe ndodh edhe aktualisht tek të gjithë gjyqtarët, në mënyrë rutinë***. Po qe se Kolegji gjen dot një gjyqtar të vetëm, në Republikën e Shqipërisë, në veprimtarinë e të cilit, në vit nuk konstatohet të paktën 50 herë një gabim i tillë nga sekretaret, atëherë unë jam dakort që të pranoj jo vetëm ato që më atribuon padrejtësisht Komisioni, por madje të pranoj edhe se unë jam përgjegjës për ngjarjen e 11 shtatorit 2001 në SHBA, unë jam fajtor edhe për vrasjen e Arqidukës Franc Ferdinand, me 24.06.1914, (që solli si pasojë luftën e pare botërore), pra do të pranoj çfarë të duan tre komisionerët që nuk kanë thënë të vërtetën që duket se janë në konflikt interesi me mua.

10. Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Nga analizimi i vendimit konstatohet se nga ana e subjektit nuk është argumentuar kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuesit Shefqet Molla për t'iu drejtuar AKK Pronave Tiranë ", përsëri nuk jam dakort. Kjo pasi:

a. Në këtë vlerësim, Komisioni shkel standartin e përcaktuar me vendimin 28/2020 (JR) të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8 dhe 12.4, të tij, (të cilin e evidentova më sipër).

b. Komisioni duke e dhënë këtë vlerësim tek kriteri i figurës, shkel standartin e përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5 të tij, (të cilin e evidentova më sipër).

c. Komisioni në raport, nuk referon në asnjë provë, indicie, etj, se përse ky konstatim dhe vlerësim, është bërë tek kriteri i figurës. Madje, këtu theksoj se edhe përfshirja "tërësisë së konstatimeve dhe vlerësimeve të Komisionit lidhur me çështjen", tek kriteri i figurës, në mungesë të provave, fakteve, indicieve, përbën shkelje të standartit të përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5 të tij, (të cilin e evidentova më sipër).

ç. Lidhur me substancën e këtij vlerësimi, evidentoj se nga ana e kërkuesit më është pretenduar se e ka
humbur afatin për të paraqitur kërkesën në AKP, për trajtimin e ish pronës, pikërisht për shkak të faktit
se pa u përcaktuar më parë hartografikisht planvendosja e pasurisë, në rrugën e vërtetimit gjyqësor të faktit, AKP nuk pranon që të ta shqyrtojë dokumentacionin. (Faktikisht, kjo ka qënë edhe arsyeja se përse kam çmuar se shqyrtohen bashkë kërkimi i vërtetimit gjyqësor të faktit dhe kërkimin për rivendosjen në afat). Unë kam vlerësuar se ky pretendim është i bazuar, pasi është çështje ligji dhe jo fakti. Kjo pasi sipas vendimit nr. 255, dt.13/04/2010 të K.M, ish pronari është i detyruar që të paraqesë në këtë organ administrativ, paraprakisht, vendimin gjyqësor të formes së prerë që vërteton të drejtën e pronësise dhe përcaktojë sipërfaqen, vendndodhjen dhe kufitarët e pronës sipas dokumentacionit hartografik të mëparshëm dhe atij aktual. Pra, pa u bërë vërtetimi i gjyqësor i faktit, nuk paraqitej dot kërkesa në AKP. Për rrjedhojë, subjektet nuk mund të konsideroheshin përgjegjës për pamundësinë e mbledhjes së dokumentacionit tekniko-ligjor (ku duhej përfshirë edhe vërtetimi gjyqësor i faktit) që duhet të paraqisnin në AKP, bashkë me kërkesën për kthimin/kompensimin e ish pronës. Sipas nenit 13/1 të KPC "*Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen*". Ekzistenca e VKM, 255, datë 13.04.2010, që

është botuar në fletoren zyrtare, është një fakt i njohur zyrtarisht. Prandaj, është pranuar edhe kërkesa për rivendosjen në afat. (Ky argument, vlen edhe për të arsyetuar se përse është pranuar kërkesa për rivendosje në afat me vendimin 17.10.2011, nr. 2275, të cilin e trajtova më sipër, krahas argumenteve të dhëna në pjesën përkatëse që i referohen këtij vendimi).
Në përfundim të trajtimit të kësaj çështjeje, i lutem Kolegjit të ketë në konsideratë se gabimet që mund të kem bërë unë në gjykimin e kësaj çështjeje, sipas parimit të objektivitetit dhe sipas parimit të proporcionalitetit, nuk janë të mjaftueshme për të sjellë si pasojë shkarkimin tim nga detyra e gjyqtarit.

Gjithashtu, theksoj me forcë që unë i konsideroj qëndrimet e mësipërme ligjore dhe konstatimet dhe vlerësimet e shprehura në vendimin e komisionit si subjektivizma keqdashës dhe për më tepër pa rëndësi për të matur besimin publik në dhënien e drejtësisë apo aftësinë time organizative për zhvillimin e gjykimeve ose njohuritë e mia ligjore.

Së dymbëdhjeti: **Në lidhje me çështjet gjyqësore të gjykuara nga subjekti me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër.** Sipas Komisionit, bazuar në informacionet e administruar nga organet ligjzbatuese ka administruar të gjitha vendimet gjyqësore ndër vite të subjektit me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka gjykuar me vendim përfundimtar për periudhën 2003-2015, 918 çështje me palë DRSSH Shkodër nga të cilat ka rrëzuar vetëm 49 padi të palës paditese ose vetëm 5% të padive.
1. Në lidhje me këto vendime Komisioni ka konstatuar se nga ana e subjektit, në vazhdimësi, janë gjykuar çështje brenda 1 dite pune:
- Çështja rezulton e regjistruar ditën e premte dhe të hënën subjekti ka gjykuar çështjen duke marrë dhe vendimin përfundimtar.
- Ditën e regjistrimit të çështjes subjekti ka gjykuar duke marrë dhe vendimin përfundimtar.
- Subjekti gjykon çështjen duke marrë dhe vendimin përfundimtar ditën pasardhëse të regjistrimit.
- Në disa raste çështja rezulton e regjistruar ditën e shtunë.
2. Në nenin 155 të K.Pr.Civile parashikohet se:
Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë.
Kur vendi i njoftimit është jashtë rrethit ose jashtë shtetit, afati për paraqitjen në gjyq duhet të jetë i tillë
sa të sigurohet një komunikim normal i padisë dhe paraqitja në gjykatë e të paditurit ose të personave të tretë.
Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të paditurit të drejtën e mbrojtjes.

 Për sa më sipër rezulton se subjekti nuk ka respektuar parashikimet ligjore të parashikuar nga neni 155 i K.Pr.Civle në lidhje me afatin për caktimin e seancës duke cënuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.

 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe për të paraqitur dokumentacion provues për njoftimin e palëve sipas parashikimeve të K.Pr.Civile.
Në përfundim në lidhje me këto gjykime duke marrë në konsideratë dhe informacionin e organeve ligjzbatuese duket se:
 Nga ana e subjektit janë favorizuar palët paditese në gjykimin e këtyre çështjeve pasi (i) njoftimi i palëve nga ana e gjykatës është i pamundur të kryhet për sa kohë afati për njoftim nuk është asnjë ditë
pune; (ii) është e paqartë se si subjekti ka studiuar dosjen ka marrë vendim si dhe ka zhvilluar gjykime të tjera brenda të njëjtës ditës; (iii) afati i gjykimit për çështje të ngjashme nga subjekti është nga 20 ditë-5 muaj.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me vlerësimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit, kam për të thënë sa më poshtë:

1. Komisioni evidenton gjetjen se vetëm 5% të padive/kërkesave që kam gjykuar në vitet 2003-2015 i kam rrëzuar. Kjo gjetje e Komisionit vlerësoj se nuk mund të shërbejë si dyshim i arsyeshëm se kam favorizuar gjyqfituesit. Kjo pasi në tërësinë e 918 çështjeve që unë kam gjykuar me palë DRSSH Shkodër, ka edhe vendime pushimi, edhe pranime të pjesshme të padisë. Po të mblidhen të gjitha së bashku me rrëzimet e padive, bëjnë më shumë se 20% të totalit të çështjeve. Unë për mungesë kohe nuk ka patur mundësi që të studioj të gjitha fashikujt, (pasi në të kundërtën nuk do isha në gjendje të respektoja afatin kohor që parashikon ligji për të paraqitur ankim ndaj vendimit të Komisionit), por nga analiza e vendimeve që kam mundur të gjej në kompiuterin tim, jam i sigurtë se kjo që po them është e vërtetë. Besoj se këtë mund t'a konstatojë lehtësisht edhe vetë Kolegji.

Përveç kësaj, pothuajse 99% të vendimeve që kam marrë (nga tërësia prej 918 vendimesh), janë vendime që kanë marrë formë të prerë ose pa u ankimuar ose janë lënë nën fuqi nga Gjykatat që kanë shqyrtuar ankimet gjyqësore. Kjo tregon drejtësinë e këtyre vendimeve. Për më tepër, më sipër u shpreha se vendimet që përbëjnë gjë të gjykuar, janë tashmë pjesë e rendit juridik dhe fuqia detyruese e tyre shtrihet edhe mbi autoritetin e KPK-së. Duke mos dashur të zgjatem shumë, do i kërkoja Kolegjit që për këto mbi 950 vendime të ketë parasysh jurisprudencën e konsoliduar si të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ashtu edhe të Gjykatës Kushtetuese, në rastin e magjistratëve Sokol Ngresi, (që ka kaluar vetingun), Gjinovefa Gaba, Vasil Minga, Theodhori Sollaku, Arben Rakipi, Mirela Mishgjoni etj, lidhur me pyetjen – A mund të lind përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit, kur vendimi i dhënë prej tij, ka marrë formë të prerë pa u cënuar në Gjykatat më të larta, dhe nëse po, në çfarë rastesh? Ju sjell në vëmëndje se sipas kësaj praktike jurisprudenciale që është e detyrueshme edhe për KPK-në, përgjigjja e këtyre pyetjeve është qartësisht JO, përveç rasteve flagrante kur nga provat e administruara vërtetohet pa hije dyshimi se gjyqtari, ka vepruar për motive të përfitimit personal, si korrupsioni, konflikti faktik i interesit, etj. Sipas kësaj praktike jurisprudenciale, gabimet e parëndësishme dhe që nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë shkakësore me rastet flagrante në të cilat provohet katërcipërisht se gjyqtari ka vepruar duke u shtyrë nga motive dhe qëllime të përfitimit personal dhe/apo të konfliktit faktit të interesit, nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme fakti, as për të

filluar procedim disiplinor dhe aq më pak për t'a shkarkuar gjyqtarin nga detyra. Kur këtyre gabimeve gjyqësore të parëndësishme, iu mungon provueshmëria e padyshimtë e lidhjes shkakësore me motivet dhe qëllimet në fjalë, ose kjo lidhje shkakësore dhe/apo këto motive/qëllime nuk provohen, atëhere gabimet gjyqësore duhet të riparohen vetëm në rrugën gjyqësore përmes ankimimit në Gjykatat më të larta. Çdo veprim i kundërt, cënon pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

2. Lidhur me gjetjet e Komisionit se "*për 38 vendime, ka konstatuar se nga ana e subjektit, në vazhdimësi, janë gjykuar çështje brenda 1 dite pune, çështja rezulton e regjistruar ditën e premte dhe të hënën subjekti ka gjykuar çështjen duke marrë dhe vendimin përfundimtar, ose ditën e regjistrimit të çështjes subjekti ka gjykuar duke marrë dhe vendimin përfundimtar, ose subjekti gjykon çështjen duke marrë dhe vendimin përfundimtar ditën pasardhëse të regjistrimit si dhe në disa raste çështja rezulton e regjistruar ditën e shtunë*[58]", nuk jam dakort. Për këtë gjetje duket se edhe vetë Komisioni e quan të bazuar në vendim argumentimin tim për të cilin kam bërë shënimin në fund të faqes. Megjitha për t'a hedhur poshtë edhe pjesën tjetër të këtyre gjetjeve/vlerësimeve të Komisionit, i kërkoj Kolegjit që të vlerësojë në meritë argumentimin tim të mëposhtëm.

I. Ndër 38 vendimet që përmenden, 20 vendime janë vërtetime gjyqësore fakti. Këto çështje, sikurse e kam thënë edhe përpara i përkasin juridiksionit gjyqësor grocioz. Për rrjedhojë, as nuk kanë ndonjë sensibilitet publik të lartë (madje as mesatar), dhe as për gjykimet e përfunduara me këto vendime, në
vlerësimin tim, nuk kam qënë i detyruar që të zbatoj afatin 10 ditor, (që vlen për paditë më palë kundërshtare, me qëllim për të garantuar kontradiktoritetin, sikurse jam shprehur në analizen që i kam
bërë dy çështjeve) të shtetasit Shefqet Molla dhe çështjes së testamentit olograf të shtetasit Izet Karini.
Pra, vlerësoj se i njëjti arsyetim, mund të përdoret edhe për 20 çështjet me DRSSH, që janë vërtetime gjyqësore fakti dhe është e padobishme që të kaloj në përsëritje).

II. Dy (2) vendime nga 38 që përmënd Komisioni, janë kërkesa për korigjim gabimi material. Vetë natyra e këtyre dy gjykimeve, haptazi përjashton faktin që unë kam bërë favorizime përmes këtyre dy vendimeve. Kjo pasi sipas nenit 312 që ka qënë në fuqi në kohën kur janë dhënë këto dy vendime për korigjimin e gabimit material, (shih dispozitën e kohës), korigjimi i gabimeve materiale mund të bëhej
nga Gjykata edhe kryesisht, pa kërkesën e palëve.

III. Për 24 vendimet e mësipërme (22+2=24), natyra e gjykimeve ka qënë jashtëzakonisht e thjeshtë gjë që justifikon kohën e shkurtër të përfundimit të gjykimit. Madje, pikërisht duke iu referuar natyrës jo komplekse dhe shume të thjeshtë të këtyre gjykimeve, ish KLD-ja, në sistemin e vlerësimit periodik të

[58] Kjo gjetje e shprehur në raportin e barrës së provës nga Komisioni, edhe nga vetë Komisioni, në vendimin e tij konsiderohet si e pabazuar. Kjo pasi Komisioni shprehet se pas kalimit të barrës së provës, subjekti vërtetoi që çështjet nuk janë gjykuar brënda një dite punë pasi shortimi i padive është bërë përpara rregjistrimit të tyre të tyre. Po ashtu, Komisioni pranon se subjekti i rivlerësimit provohet se ka kryer veprimtari procedurale përpara datës së rregjistrimit.

gjyqtarëve dhe prokurorëve që ka qënë në fuqi, në kohën kur janë dhënë vendimet, ka parashikuar një
kohëzgjatje kohore deri në dy muaj, nga data e paraqitjes së kërkesës për vërtetim gjyqësor fakti, deri në
kohën e dhënies së vendimit.

3. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së 38 gjykimeve të përfunduara me vendimet që përmënd Komisioni në aneksin 1 të raportit, (20 vërtetime fakti pa palë + 2 korigjime gabimesh materiale të vendimeve të mëparshme + 16 kërkesë padi me palë kundërshtare), vlerësoj se Komisioni gabon kur i referohet si datë e fillimit të gjykimit, datës së rregjistrimit të çështjes. Kjo pasi në nenin 153 të KPC, parashikohet se "*Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim*". Unë, për shkak mungesës së kohës që kam në dispozicion për t'i kthyer përgjigje Komisionit, që është deri me datën 27.11.2022, nuk kam mundësi që të analizoj të gjithë 38 fashikujt që përmenden në aneksin 1 të Raportit por vetëm një pjesë të tyre. Kryesisht, analizova 5 vërtetime gjyqësore fakti dhe 12 vendime me palë kundërshtare, (pra, kërkesëpaditë janë në numër mbi dyfishi i vërtetimeve të faktit, pasi vlerësova se këto të fundit kanë sensibilitetin më të lartë publik, në matjen e veprimtarisë time gjyqësore). Këto vendime do ua paraqes si provë. Nga kjo analizë, rezulton se:

Për paditë me palë kundërshtare.
i- Për vendimin nr. 2938, datë 17.12.2007. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 28.05.2007, (pra rreth 6 muaj para se të jepej vendimi). Me datën 13.11.2007, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 20.11.2007. (pas 7 ditësh). Njoftimi i palës së paditur nuk është bërë nga sekretarja. Janë zhvilluar 3 seanca, përkatësisht me datat 20.11.2007, 04.12.2007 dhe 17.12.2007. Rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën
16.11.2007, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, ishte mëse i thejshtë "pasaktësi gjeneralitetesh, nga ato të shënuara gabim Nusha Gjon Doçi, në ato të sakta, Nusha Gjon Shani, në rregjistrin e kooperativës Velipojë".

ii- Për vendimin nr. 1367, datë 21.05.2009. Padia është paraqitur fillimisht me datën 26.03.2009, por çështja është pushuar me vendimin 967, datë 14.04.2009. Padia është riparaqitur me datën 30.04.2009 dhe më ka kaluar mua brënda ditës së paraqitjes. Me datën 15.05.2009, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 21.05.2009, (pas 6 ditësh). Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja po me datën 15.05.2009, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 16.05.2009, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, ishte mëse i thejshtë "pasaktësi mbiemri e shënuar gabim në rregjistrin e kooperativës Bajzë, nga Çerkezi në Lakej".

iii- Për vendimin nr. 1363, datë 21.05.2009. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 30.04.2009. Me datën 15.05.2009, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 21.05.2009, (pas 6 ditësh). Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja po

me datën 15.05.2009, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 16.05.2009, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, ishte mëse i thejshtë "pasaktësi emri i shënuar gabim në rregjistrin e kooperativës Gur i zi, nga Halit Alija Sylja në Halil Ali Alija".

iv- Për vendimin nr. 1626, datë 07.07.2006. Padia është paraqitur me datën 05.05.2006, dhe më ka kaluar mua brënda ditës së paraqitjes. Me datën 05.05.2006, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 07.05.2006. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja po me datën 05.05.2006, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 07.07.2006, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, ishte mëse i thejshtë "pavërtetësi dokumenti lidhur me vjetërsinë në punë në ish kooperativën bujqësore Kelmend". v- Për vendimin nr. 1376, datë 22.5.2009. Padia është paraqitur me datën 05.05.2009, është shortuar dhe më ka kaluar mua me datën 07.05.2009. Me datën 15.05.2009, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 22.11.2009. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 16.11.2009. Objekti i gjykimit, më se i thjeshtë "pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në rregjistrin e ish kooperativës Shtoj i vjetër, Nga hysni Fadil Jaku, në Hysni Fadil Erkoçeviq".

vi- Për vendimin nr. 3027, datë 11.11.2009. Padia është paraqitur fillimisht me datën 24.09.2009, por çështja është pushuar me vendimin 2816, datë 26.10.2009. Padia është riparaqitur me datën 04.11.2009 dhe më ka kaluar mua brënda ditës së paraqitjes. Me datën 06.11.2009, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 11.11.2009. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja po me datën 06.11.2009, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 09.11.2009, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, ishte mëse i thjeshtë "Njohje vjetërsie në punë të paditëses Vera Leka në ish Koperativën Velipojë".

vii- Për vendimin nr. 3013, datë 10.11.2009. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 05.10.2009. Me datën 14.10.2009, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën përgatitore që e kam planifikuar me datën 21.10.2009. Janë zhvilluar 1 seancë përgatitore në datën 21.10.2009 dhe 2 gjyqësore, me datat 03.11.2009 dhe 10.11.2009. Njoftimi i palës së paditur për seancën përgatitore, është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 17.10.2009. Objekti i gjykimit, kishte vështirësi relative "pasaktësi gjeneralitetet në rubrikën datëlindja, të shënuara në librezën e punës së paditësit Pal Mustafa".

viii- Për vendimin nr. 1949, datë 19.07.2010. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 08.07.2010. Me datën 16.07.2010, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 19.07.2010. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën

17.11.2010. Objekti i gjykimit, më se i thjeshtë “pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në rregjistrin e ish kooperativës Mjede, nga Safete Abdyl Smajli, në Safete Abdyl Zylja”.

ix- Për vendimin nr. 461, datë 02.03.2007. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 30.01.2007. Me datën 01.03.2007, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 02.03.2007. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja po me datën 02.03.2007, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, më se i thjeshtë “pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në rregjistrin e ish kooperativës Vukël, nga Pren Mark Gjelaj në Prendë Mark Gjelaj”.

x- Për vendimin nr. 144, datë 23.01.2008. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 17.01.2008. Me datën 22.01.2008, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 23.01.2008. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja po me datën 23.01.2008, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, më se i thjeshtë “pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në rregjistrin e ish kooperativës Boriç i Madh, nga Nafije Berhan Lekaj në Nafije Cuf Lekaj”.

xi- Për vendimin nr. 16, datë 09.01.2008. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 24.12.2007. Me datën 28.12.2007, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 09.01.2008. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 08.01.2008, një përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, i thjeshtë “pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në rregjistrin e ish kooperativës Rragam, nga Pjetër Lazër Shtjefni, në Pjetër Lazër Ahmati”.

xii- Për vendimin nr. 146, datë 23.01.2008. Padia është paraqitur, shortuar dhe më ka kaluar mua, me datën 17.01.2008. Me datën 22.01.2008, pasi kam studiuar aktet, kam konstatuar se padia është pa të meta, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve për seancën që e kam planifikuar me datën 23.01.2008. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja, ndërsa rregjistrimi dhe formimi i fashikullit, është bërë nga sekretarja me datën 22.01.2008, një përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, i thjeshtë “pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në rregjistrin e ish kooperativës Golem, nga Rabije Dalipi, në Rabije Dalip Bishani”.

Për vërtetimet e faktit.
a. Për vendimin nr. 1186, datë 30.04.2010. Kërkesa është paraqitur me datën 26.04.2010. Me datën 29.04.2010, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e kërkesës dhe caktimin e seancës me datën 30.04.2010. Njoftimin e palëve e ka bërë sekretarja. Po sekretarja ka bërë rregjistrimin dhe formimin e fashikullit me datën 29.04.2010. Objekti i gjykimit, shumë i thjeshtë, pasi bazohet kryesisht në prezumim ligjor, vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë në ish kooperativen Mjedë, për të cilën janë dëmtuar rregjistrat.

b. Për vendimin nr. 1638, datë 15.06.2010. Kërkesa është paraqitur me datën 27.05.2010. Me datën 08.06.2010, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e kërkesës dhe caktimin e seancës me datën 15.06.2010. Njoftimin e palëve e ka bërë sekretarja. Po sekretarja ka bërë rregjistrimin dhe formimin e fashikullit me datën 12.06.2010. Objekti i gjykimit, shumë i thjeshtë, pasi bazohet kryesisht në premum ligjor, vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë në ish kooperativen Shalë, për të cilën janë dëmtuar rregjistrat.

c. Për vendimin nr. 2964, datë 27.12.2006. Kërkesa është paraqitur me datën 19.12.2006. Me datën 26.12.2006, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e kërkesës dhe caktimin e seancës me datën 27.12.2006. Njoftimin e palëve e ka bërë sekretarja. Po sekretarja ka bërë rregjistrimin dhe formimin e fashikullit me datën 27.12.2006, përpara fillimit të seancës. Objekti i gjykimit, shumë i thjeshtë, pasi bazohet kryesisht në premum ligjor, vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë në ish kooperativen Kelmend, për të cilën janë dëmtuar rregjistrat.

d. Për vendimin nr. 989, datë 13.04.2010. Kërkesa është paraqitur me datën 07.01.2010. Me datën 06.04.2010, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e kërkesës dhe caktimin e seancës me datën 13.04.2010. Njoftimin e palëve e ka bërë sekretarja. Po sekretarja ka bërë rregjistrimin dhe formimin e fashikullit me datën 10.04.2006. Objekti i gjykimit, shumë i thjeshtë, pasi bazohet kryesisht në prezumim ligjor, vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë në ish kooperativen Trush, për të cilën janë dëmtuar rregjistrat.

dh. Për vendimin nr. 1375, datë 22.05.2009. Kërkesa është paraqitur me datën 07.05.2009. Me datën 15.05.2009, kam nxjerrë urdhrin për rregjistrimin e kërkesës dhe caktimin e seancës me datën 22.05.2009. Njoftimin e palëve e ka bërë sekretarja. Po sekretarja ka bërë rregjistrimin dhe formimin e fashikullit me datën 16.05.2009. Objekti i gjykimit, shumë i thjeshtë, pasi bazohet kryesisht në prezumim ligjor, vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë në ish kooperativen Juban, për të cilën janë dëmtuar rregjistrat.

4. Nga analiza e mësipërme, rezulton se kohëzgjatja e gjykimit për paditë me palë kundërshtare, nuk është aq sa përcakton Komisioni në gjetjet e tij, nga 1 deri në 4 ditë, ku ka ditë të shtunë dhe të diel në mes. Kohëzgjatja e gjykimit është 2 ditë (një rast), 21 ditë (2 raste), 6 muaj (një rast), 17 ditë (një rast), 7 ditë (një rast), 35 ditë (një rast), 11 ditë (një rast), 2 muaj (një rast), 4 ditë (një rast), 5 ditë (një rast) dhe 15 ditë (një rast). Në të gjitha rastet e analizuara prej meje, vihet re se unë kam ushtruar veprimtari gjyqësore përpara se ajo të rregjistrohej, pra kam parë padinë sipas nenit 154 të KPC, nëse ka patur të meta, përpara se ajo të rregjistrohej nga sekretaria gjyqësore. Kjo më ka mundësuar të bëj një vlerësim paraprak të shkallës së vështirësisë së çështjes, që sikurse shihet është tejet minimale. Nga kohëzgjatja variable e këtyre gjykimeve vihet re gjithashtu se është sekretarja subjekti procedural që ka bërë rregjistrimet e fashikujve dhe njoftimet e palëve. Kjo ka qënë kompetencë e saj, sipas nenit 77/3 të KPC, që parashikon se "*Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor*". Koha kur sekretari ka bërë rregjistrimin, nuk shënon fillimin e gjykimit pasi koha e gjykimit përcaktohet nga data e paraqitjes së padisë, sipas nenit 153 që u përmend më sipër. Nga analizimi i të dhënave të mësipërme, rezulton se unë nuk mund të konsiderohem

përgjegjës as për kohën e rregjistrimit të fashikujve dhe as për rregullshmërinë e njoftimeve pasi kryerja e këtyre veprimeve nuk ka qënë detyrë e imja funksionale.

5. Edhe nëse njoftimet kanë patur parregullshmëri në formën e dokumentimit, ju bëj me dije se në asnjë rast kjo nuk ka sjellë pasojë në dështimin e seancave. Kjo pasi sipas nenit 119/3 të KPC, pavlefshmëria e një akti nuk mund të shpallet kur ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar. Perveç kësaj, fakti që palët u paraqitën në këto seanca, tregon që sekretarja i kishte njoftuar palët, pavarësisht se nuk e kishte dokumentuar si duhet veprimin procedural të njoftimit. Ju bëj me dije se në vitet për të cilat bëhet fjalë, DRSSH Shkodër është përfaqësuar nga dy juriste, zonja Yllka Rupaj, (që sot është anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor), dhe Solida Dibra (që sot punon tek Kastrati Group shp.k). Këto dy juriste ishin gjithë ditën në ambientet e Gjykatës, prandaj ishte plotësisht e mundur që të njoftoheshin, ose gojarisht nga sekretarja ose me telefon. Në të gjitha gjykimet objekt analize, ose njëra ose tjetra, janë paraqitur dhe për rrjedhojë gjykimi ishte e pakuptimtë të shtyhej. Madje edhe sot, në vitin 2022, mbi 90 % e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër, tolerojnë që sekretaret për të mos u mbingarkuar, të njoftojnë juristet e DRSSH Shkodër, me telefon ose gojarisht.

6. Lidhur me njoftimet, me lejoni t'iu shpjegoj se si ka qënë praktika e veprimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vitet 2000-2010. Fillimisht padia e paraqitur shortohej e parregjistruar, sipas nenit
153 të KPC. (Kjo praktikë ka ndryshuar rreth vitit 2011 me sa mbaj mend, me instalimin në Gjykatën e
Rrethit Gjyqësor Shkodër, të sistemit aktual të menaxhimit elektronik të çështjeve gjyqësore, që kërkon që paditë pasi të paraqiten, të rregjistrohen dhe pastaj të shortohen). Paditë e parregjistruara, pas shortimit i përcilleshin gjyqtarit. Meqënëse këto padi shpesh ishin pa pulla poste, për të bërë njoftimet, ose edhe me të meta në kuptim të nenit 154 të KPC, pritej derisa të paraqitej paditësi/kërkuesi tek gjyqtari. Me këtë rast gjyqtari i komunikonte të metat eventuale dhe nëse nuk kishte të meta, urdhëronte ose me një vendim të ndërmjetëm të zbardhur ose me një shënim të shkruar me dorë në faqen e padisë, që kjo padi të rregjistrohej si dhe të bëheshin njoftimet, duke caktuar njëkohësisht edhe seancën përgatitore ose gjyqësore. Në kohën kur gjyqtari, në rrethanat e mësipërme, kontaktonte me palën, merrte edhe mendimin e tij për datën e seancës. Në rastet objekt analize, mua më është kërkuar nga palët caktimi i një gjykimi sa më të shpejtë pasi qëllimi i këtyre padive kërkesave ishte plotësimi i dokumentacionit për të përfituar pension pleqërie në marrëdhënie pune me kooperativen, që faktikisht ishte niveli minimal i pensionit. Meqënëse behej fjalë për të moshuar, unë gjithmonë kam bërë një diskriminim pozitiv. Kjo jo vetëm duke marrë në konsideratë moshën e tyre por edhe pasi vetë gjykimet ishin të thjeshta si dhe pasi besoja dhe vazhdoj të besoj se nëse gjykimi zgjat me muaj ose vite (sikurse ndodh sot), rrezikohet që pensioni të mos merret fare për shkak të moshës së paditësve/kërkuesve dhe kësisoj humbet edhe kuptimi i arsyes së përse zhvillohet gjykimi. Kjo është arsyeja që unë kam vepruar relativisht shpejt në këto raste. Në këtë praktikë që është zbatuar nga të gjithë gjyqtarët, përfshirë edhe mua, në vitet 2003-2010, mund të ketë edhe gabime procedurale, por kurrsesi nuk mund të përdoren këto gabime, (që jo vetëm nuk kanë patur asnjë pasojë negative por madje kanë patur pasoja pozitive), për të hedhur baltë mbi figurën time si gjyqtar.

Për këtë kategori gjykimesh ku palë ishin të moshuar, që iu nevojitej plotësimi i dokumentacionit për të përfituar pension pleqërie, kam menduar se duhej bërë një diskriminim pozitiv në

kohëzgjatjen e gjykimit, pra që çështjet e tyre, të gjykoheshin sa më shpejt. Ky qëndrim, në atë kohë nuk është mbajtur vetëm nga unë, por nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Madje, edhe aktualisht, ekziston akti normativ nr. 58/viti 2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që për këtë kategori çështjesh, shpreh qartazi se duhet bërë një diskriminim pozitiv në kohëzgjatjen e gjykimit. Jo vetëm kaq, por besoj se dihet botërisht që miredukata e kërkon që kur ke të bësh me të moshuar, gra shtatzëna, invalidë, madje edhe me zonja/zonjusha, kryerja e diskriminimeve pozitive në sjellje, në të folur, të shkruar apo në të vepruar/mosvepruar, është veprimi i duhur.

7. Për të vërtetuar ekzistencën e praktikës së veprimit të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në ato vite, do iu paraqes si provë, i kam paraqitur si provë Komisionit një përgjigje shkresore që më ka kthyer kancelarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, një kërkese time për informacion (se bashku me këtë të fundit). Përveç kësaj, i kam paraqitur si prova edhe vendime të gjyqtarëve të tjerë të së njëjtës Gjykatë, madje të gjyqtarëve që e kanë kaluar vetingun.

8. Lidhur me 5 vërtetimet gjyqësore të faktit të analizuara prej meje, vihet re se unë kam gjykuar shumë shpejt, 2 ditë, 5 ditë, 6 ditë,15 ditë dhe 19 ditë, nga koha e paraqitjes së padisë dhe po ashtu kam kryer veprimtari gjyqësore, përpara se sekretarja të rregjistronte çështjen. Edhe për këto çështje, ka vlejtur e njëjta praktikë, me dallimin se ato janë gjykuar më shpejt pasi shkalla e kompeksitetit të tyre ka qënë tejet minimale. E vlerësoj të padobishme që të zgjatem më tej në shtjellimin e arsyes se pse i kam gjykuar shpejt pasi vlen përgjithësisht ajo që thashë për paditë me palë kundërshtare, me dallimin që vërtetimet e faktit janë akoma më të thjeshta për t'u gjykuar se paditë me palë kundërshtare. Gjithashtu, vlejnë si argumente, edhe ato që kam përmëndur më sipër, në rastin kur kam analizuar çështjen e testamentit olograf të shtetasit Izet Karini, si dhe dy vërtetimet gjyqësore të faktit të shtetasit Shefqet Molla. E vlerësoj të padobishme që të zgjatem më tej në këtë pikë.

9. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se "*duke e vlerësuar informacionin e organeve ligjzbatuese në raport me analizimin e vendimeve, duket se subjekti ka favorizuar palë në gjykim si dhe në disa raste ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit duke cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë*", përsëri nuk jam dakort. Kjo pasi:

a. Në këtë vlerësim, Komisioni shkel standartin e përcaktuar me vendimin 28/2020 (JR) të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8 dhe 12.4, të tij, (të cilin e evidentova më sipër). Kjo pasi gabimet e mundshme në njoftime ose në kohën e gjykimit, (në disa raste), përpiqet t'i përdorë si argument për të vënë në dyshim veprimtarinë time gjyqësore në kriterin e figurës[59]. Unë vlerësoj se kjo jo vetëm që është e

[59] Kjo ka shumë rëndësi, pasi duket qartë se dëshira dhe qëllimi i Komisionit për të argumentuar se paskam dhënë favore gjyqësore, ***nuk tentohet të argumentohet përmes drejtësisë/padrejtësisë së supozuar të vendimeve përfundimtare të dhëna nga unë, por përmes vendimeve të ndërmjetme***, (si p.sh shkeja e afat ligjor të parashikuar në nenin 155/1 të KPC për caktimin e seancës gjyqësore, shkelja e rregullave të njoftimeve, etj). Kjo bie në kundërshtim me nenin 4/2 të Ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve pubvlike ", që parashikon se:
Për qëllimet e këtij ligji:
a) ***vend.immarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit***;

gabuar por bie në kundërshtim si me parimin e objektivitetit ashtu edhe atë të proporcionalitetit. Për më tepër bie në kundërshtim me parimin e barazisë në trajtim.

I kujtoj Kolegjit se në rastin e subjekteve të rivlerësimit Riselda Fishta, Marsida Frashëri, (ndonëse këto prokurore kishin shkaktuar me mosveprim vdekjen klinike të dhjetra procedimeve penale secila, pasi nuk kishin kryer veprime procedurale duke i mbajtur në dorë, për një kohë mbi tre vjet), Komisioni nuk mori ndaj tyre masën ekstreme.

Po ashtu, në rastin e subjekteve të rivlerësimit Elvin Gokaj, Artan Çupi dhe Gjergji Tako, që kishin zvarritur ose nuk kishin kryer fare, veprime procedurale që destinonin fatin e çështjeve, pra kishin shkaktuar pasoja të paligjshme në dhjetëra çështje, prapë nuk u mor masa ekstreme.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Irida Kacerja, u konstatua se ajo në një dosje objekti material i të cilës ishte qindra mijëra euro, kishte humbur procesverbalin gjyqësor që është akti më i rëndësishëm procedural, pas vendimit përfundimtar, dhe prapë nuk u mor asnjë masë.

Situata ime dallon në shkallë përralle me këto subjekte. Kjo pasi, sipas Komisionit, ndaj meje ngrihen dyshime në kriterin e figurës, jo se kam zvarritur apo nuk kam kryer veprime procedurale, por në thelb, ***këto dyshime ngrihen pasi kam gjykuar shpejt çështjet e disa moshuarve***, që po të mos gjykoheshin, jo vetëm mund të humbisnin para nga pensioni më minimal i mundshëm (në marrëdhënie pune me ish kooperativën) që mund të përfitonin, por edhe që për shkak të kalimit të kohës, jo për faj të tyre, mund t'i zvogëlohej koha që do të përfitonin pensionin deri në fund të jetës. Pra, i paskam bërë favore pensionistëve të moshuar se ua paskam gjykuar shpejt çështjet e pensionit. Kjo është kulmi.

Nejse. Ç'të them...!!!! Mund të them veçse aktualisht, me ligjin 169/2020, "Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish kooperativat bujqësore", vetë shteti është ndërgjegjesuar se është jo e drejtë që këta të moshuar që kanë punuar gjithë jetën në ish kooperativat bujqësore, të detyrohen të sorollaten gjyqeve për të vërtetuar vjetërsinë në punë për të cilën ata nuk mund të ngarkohen me përgjegjësi lidhur me faktin që dokumentacioni që e vërteton këtë vjetërsi, ka humbur, është dëmtuar, për gjatë rrjedhës së kohës. Pra, përmes këtij ligji, vetë shteti e ka pranuar tashmë, se nuk ka nevojë për gjyq fare. Përveç shtetit, edhe praktika gjyqësore e të gjithë gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, i ka trajtuar ndër vite, por edhe aktualisht, këtë kategori gjykimesh, si "gjykime limonatë", pra aq të thjeshta sa angazhimi gjyqësor në gjykimin e këtyre çështjeve, zgjaste në intervalin nga 10 minuta deri në gjysëm ore.
b. Komisioni theksoj se edhe përfshirja "tërësisë së konstatimeve dhe vlerësimeve të Komisionit lidhur me çështjen", tek kriteri i figurës, në mungesë të provave, fakteve, indicieve, përbën shkelje të standartit të përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5

b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit;
c) një zyrtar'" ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

të tij, (të cilin e evidentova më sipër). Ky lloj veprimi kësisoj i Komisionit jo vetëm më lë shije të hidhur, por edhe në dukje, pamje, më cënon të drejtën e mbrojtjes.

Në përfundim të hetimit në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni shprehet se:

78. Në përfundim të hetimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar nga hetimi, të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, si dhe në seancë dëgjimore, trupi gjykues çmon se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIKsë dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë bërë deklarim të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

78.1. Konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmëri të subjektit lidhet me dyshimet për favorizim të palëve në gjykim, që duket se përputhet me rezultatet e hetimit nga analizimi i dosjeve gjyqësore nga Komisioni.

78.2. Duke qenë se ky rezultat nuk përmbush kushtet e nenit 61, pikat 2 dhe/ose 3 të ligjit nr. 84/2016, këto konstatime do të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit .

Lidhur me barrën e provës, vlerësimet dhe gjetjet e Komisionit, u shpreha më sipër. Megjithatë, në mbyllje të opinionit tim lidhur me vlerësimin që i ka bërë Komisioni kriterit të figurës time, kam për të
thënë tre gjëra, si më poshtë:

Së pari: Unë e di pse Komisioni ka vlerësuar si ka vlerësuar. Unë s'kam asgjë në dorë të ndryshoj rrjedhën e ngjarjeve, por ama të paktën kam në dorë të mbrohem me dinjitetin dhe krenarinë që në vlerësimin tim duhet të ketë një gjyqtar i Republikës së Shqipërisë.

Së dyti: Tre Komisionerëve që duket se janë në konflikt interesi, iu them që as mos t'iu shkojë nëpër mënd se do tregohem i përulur përpara tyre, pra të mbaj një sjellje që kërkon mëshirë. Kurrën e Kurrës.
As drejtësi nuk iu kam kërkuar atyre që nuk kanë asgjë të përbashkët me drejtësinë. Këtë ua kam thënë ballas sy më sy, në të gjitha seancat dëgjimore dhe veçanarisht në seancën e datës 13.12.2022 kur kam dhënë shpjegimet lidhur me kriterin e figurës. Kjo është zgjedhja ime. Jam absolutisht i gatshëm iu thashë që të përballem me pasojat.

Së treti: ***Kolegjit i kërkoj drejtësi***. E di që mund t'i kem lodhur gjyqtarët e Kolegjit me këtë ankim, por iu lutem të kenë në konsideratë se kanë në dorë një nga aspektet themelore të jetës time, që është dinjiteti im, që më është cënuar padrejtësisht, paligjshmërisht, në kundërshtim me të gjitha parimet e drejtësisë, si ligjshmëria, proporcionaliteti, objektiviteti, etj, nga Komisioni, në vendimin që ka dhënë kur më ka vlerësuar në lidhje me kriterin e figurës time si gjyqtar.

PJESA E KATËRT

Kriteri i Profesionalizmit

C.VLERËSIMI PROFESIONAL

Lidhur me këtë kriter, nga raporti rezulton se Komisioni, është bazuar në sa më poshtë:
- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ nr. 6080/5 prot., datë 15.05.2020;
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
- Denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Pasi u njoha me këtë pjesë të raportit, kam për të thënë sa më poshtë:
Lidhur me gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga unë për t'u rivlerësuar në lidhje me kriterin e profesionalizmit si dhe tre dokumentet (vendimet) e përzgjedhura nga unë, Komisioni nuk më ka ngarkuar asnjë barrë prove, pra i bie të ketë vlerësuar pozitivisht këto fakte, në favorin tim. Për rrjedhojë, e vlerësoj të padobishme që të zgjatem, duke qënë dakort me atë pjesë të raportit të Komisionit.

I. PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT.

Dosja nr. 1.
Çështja civile nr. 1171 regj. them., datë 07.05.2014 regjistrimi, që i përket paditës K.K. dhe A.K., të paditur M.G., P.Tretë sh.p.k. Nika, Zyra Vendore e Rr.P.P.Shkodër dhe Bashkia Shkodër, me objekt "njohje bashkëpronar në sip trualli 302 m katrore" e përfunduar me vendimin nr. 1257, date 06.10.2014.

Komisioni ka konstatuar se:

Çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 07.05.2014 dhe me shortin e datës 08.05.2014 aktet i janë kaluar subjekti. Me vendimin e datës 14.05.2015(pas 6 dite) subjekti ka caktuar seancën përgatitore në datën 28.05.2014, ora 15.00 duke urdhëruar njoftimin e palëve. Nxjerrja e vendimit, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar në nenin 155 të K.Pr.Civile. Kundër vendimit ka ushtruar ankim pala paditëse dhe gjykata e apelit Shkodër me vendim nr 596 dt. 05.11.2015 ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim por me tjetër trup gjykues.
1. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore konstatohet se nga ana e subjektit nuk janë thirrur si pale ndërgjyqëse trashigimtarët e tjerë ligjor të pasurisë së paluajtëshme objekt i këtij gjykimi sipas parashikimeve të nenit 193 të K.Pr.Civile.

 Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka formuar drejt ndërgjyqësinë duke mos vepruar në përputhje me nenin 193 të K.Pr.Civile si dhe duke cënuar të drejtën e pronarëve të tjerë të sendit objekt gjykimi për t'u mbrojtur.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.
2. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit në sekretarinë gjyqësore në datën nuk ka të dhëna nga rregjistrat përkatës.

 Subjekti duhet të paraqesë faqen e regjistrit të sekretarisë gjyqësore ku të evidentohet depozitimi i dosjes gjyqësore dhe vendimit gjyqësor.

3. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 4 muaj e 28 ditë, në intervalin kohor 08.05.2014 - 06.10.2014, brenda afatit 6 mujor të parashikuar nga pika 5, shkronja "e" e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit 3 , rrjedhimisht është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i përcaktuar nga neni 42 i Kushtetuës dhe neni 6 i KEDNj-së.
4. Janë caktuar 10 seanca nga të cilat 6 produktive dhe 4 jo produktive. Shkak ka qenë mungesa e konfirmimit të njofitmit për palën e paditur në dy raste dhe mos pagesa e ekspertit për dy raste.
 Në 2 raste të shtyra për shkak të mos pagesës së ekspertit, gjykata nuk duhej të shtynte seancën, por të urdhëronte nxjerrjen e detyrueshme te shpenzimeve për ekspertët me anë të përmbaruesit gjyqësor sipas nenit 105 të K.Pr.Civile.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.
5. Nuk ka pasur seanca të çelura me vonesë. Distancat kohore midis seancave mesatarisht kanë qenë të arsyeshme me rreth 15 ditë ditë nga njëra tjetra. Duke përjashtuar 1 rast me mbi 1 muaj për shkak të pushimeve vjetore të muajit gusht.
 Seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit. Shkaku nuk relatohet
 Subjekti duhet të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.
6. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, nuk konstatohen të meta. Procesverbali i séances gjyqësore të administruar në dosje, është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera i nënshkruar rregullisht nga sekretari dhe gjyqtari. Në dosje ndodhet 1 kopje e dorëshkrimit të vendimit me kompjuter e gjyqtarit (5 faqe) dhe e 1 kopje e zbardhur nga sekretaria vendimit, e nënshkruar nga sekretari dhe gjyqtari, gjithsej 5 faqe. Fashikulli penal është i inventarizuar rregullisht nga sekretarja gjyqësore.
7. Në procesverbalin e seancës gjyqësore dhe nga aktet e njoftimit vihet re mesa mundet mënyra e komunikimit me palët dhe të tretët, gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka të dhëna apo kërkesa në dosje nëse ka patur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.
8. Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile. Ai përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Në përcaktimin e faktit civil apo mosmarrëveshjes civile janë cituar shprehimisht dispozitat e zbatueshme në zgjidhjen e çështjes si nenet 199, 200, 300 të K.Civil, neni 193 të K.Pr.Civile, neni 21 ligj nr 7512/1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronësisë private nismës së lirë dhe inisiativës private", ligj nr 7698/1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve", Udhëzim nr 3/1993 të KM i dala në bazë e për zbatim ligjit për pronat. Në vlerësimin e gjykatës konkludohet se palës paditëse i mungon legjitimiteti aktiv substancial pasi nuk kanë fituar me trashëgim pasurinë truall të pretenduar e për rrjedhim nuk kanë të drejtë subjektive për të mbrojtur, pasi të dyja palët mdërgjyqëse e kanë humbur që nga viti 1976 të drejtën e pronësisë mbi truallin për të cilin ekziston prezumimi ligjor "on blok" me anë të shpronësimit nga shtetit me akt ligjor të përgjithshëm në bazë të Kushtetutës të asaj kohe. Edhe pala e paditur nuk ka legjitimitet pasiv pasi nuk është bërë pronare e truallit nën ndërtesën e saj me trashëgim as me vendim gjyqësor, por me anë të ligjit(nenit 21 ligj 7512/1991) duke e cituar të plotë këtë dispozitë. Për rrejdhim objekti i kërkesë padisë nuk mund të realizohet në rrugë

gjyqësore sipas nenit 199 e 200 të K.Civil, pasi nuk përfshihet fare në juridiksionin gjyqësor. Gjatë zgjidhjes së çështjes është cituar parimi i veprimit të ligjit në kohë(Kushtetuta e vitit 1976). Nga struktura, pjesa arsyetuese e vendimit paraqitet me tekst unik me paragrafë të panumërtuar ku janë cituar dhe përshkruar me radhë objekti i kërkesë padisë, kërkimet e paditësit dhe prapësimet e palës së paditur e të tretë, provat e pranuara, analiza ligjore dhe konkluzionet e gjykatës.
Janë respektuar rregullat drejtëshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Teksti ka strukturë të qartë dhe është i kuptueshëm.

Lidhur me këtë dosje, kam për të thënë si më poshtë:

<u>Së pari</u>: Lidhur me konstatimin se "*Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka formuar drejt ndërgjyqësinë duke mos vepruar në përputhje me nenin 193 të K.Pr.Civile si dhe duke cënuar të drejtën e pronarëve të tjerë të sendit objekt gjykimi për t'u mbrojtur*", kam mendimin se ky konstatim (si dhe gjithashtu edhe vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, që e ka prishur vendimin tim, duke e kthyer çështjen për rigjykim për shkak të mosformimit të rregullt të ndërgjyqësisë), janë të gabuara. Ky qëndrim bie ndesh me praktikën e Gjykatës së Lartë, ndër vite. Po iu përmen vetëm një vendim të Gjykatës së Lartë, që i përket vitit 2019. Konkretisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar një çështje thuajse identike më çështjen për të cilën unë kam dhënë vendimin objekt analize, me vendimin nr. datë 00-2017-315, datë 30.04.2019 ka arsyetuar:

"ommisis.....*Rekursi i paraqitur nga pala paditëse kundër vendimit nr.395, datë 03.03.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të cilat do ta bënin të cenueshëm këtë vendim.*
Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi nr.395, datë 03.03.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit. Për këtë shkak, ky vendim do të prishet dhe çështja do të kthehet për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.
Nga përmbajtja e vendimit nr.395, datë 03.03.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me faktet e çështjes, rezulton se pala paditëse ka kërkuar regjistrimin e pronës që pretendon se e ka fituar nëpërmjet kontratës së dhurimit, pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe. Pas refuzimit të kësaj të fundit për shkak të problemeve me dokumentacionin dhe marrjes së një përgjigjeje negative edhe në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pala paditëse i është drejtuar me padi gjykatës. Gjykata e shkallës së parë, pasi e ka gjykuar çështjen në themel, ka vendosur pranimin e padisë. Mbi ankimin e palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, me argumentin se nuk ishte ndërtuar drejt ndërgjyqësia, pasi në gjykim duhet të thirreshin pronarët e pronave me te cilët prona e paditësit krijonte mbivendosje. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një interpretim të gabuar të dispozitave të KPC-s lidhur me formimin e ndërgjyqësisë dhe pasojat që ajo sjell në raport me vendimin gjyqësor të një shkalle më të ulët. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka kuptuar drejt natyrën e ndërgjyqësisë si një institut i të drejtës procedurale civile. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë thekson se formimi i drejtë i ndërgjyqësisë përbën një nga elementët bazë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Gjykata duhet të marrë të gjitha masat që në proces të thirren personat që heqin

të drejta nga vendimmarrja e saj. Megjithatë, jo në çdo rast, mosthirrja e një subjekti që ka interes në çështje shkakton proces të parregullt ligjor, me pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim. Në rastin e subjekteve të interesuar, sikurse kemi të bëjmë me çështjen në gjykim, thirrja e të cilëve është në disponibilitetin dhe çmimin e gjykatës, ometimi i kësaj të fundit për ta kryer këtë veprim procedural nuk shkakton zhvillimin e një procesi të parregullt gjyqësor. Ky subjekt, në çdo rast mund t'i mbrojë të drejtat e tij në një gjykim tjetër, duke u paraqitur qoftë në rolin e paditësit qoftë në atë të të padituri. Për më tepër, vendimi i rrjedhur nga një proces gjyqësor ku ai nuk ka qenë pjesëmarrës nuk do të ketë efekt ndaj këtij subjekti, pasi nuk plotësohen të tre elementët e gjësë së gjykuar (res judicata), duke qenë se mungon identiteti i palëve. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se pozita procedurale e palëve nuk është plotësisht e barabartë me atë të pjesëmarrësve të tjerë në proces, duke qenë se këtyre të fundit u mungon e drejta e disponimit mbi objektin e padisë. Është për këtë shkak që pretendimet, të cilat pjesëmarrësit (personat e tretë) nuk mund t'i ngrenë në një proces të zhvilluar ndërmjet dy palëve ndërgjyqëse, nuk përbëjnë gjë të gjykuar. Në këto kushte, ndryshe nga palët ndërgjyqëse, ata e kanë të gjithë mundësinë që pretendimet dhe kërkimet e tyre t'i ngrenë në një gjykim tjetër, duke mos pasur asnjë efekt vendimi i procesit në të cilin ata nuk kanë marrë pjesë. E ndryshme është situata e palëve ndërgjyqëse, sidomos kur bëhet fjalë për ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive. Në këtë rast, nuk mund të ekzistojnë procese paralele apo të ndryshme për secilin nga të padituri, për sa kohë që baza faktike dhe juridike e padisë është e njëjtë por edhe të drejtat e tyre burojnë nga i njëjti objekt dhe e njëjta e drejtë (p.sh. bashkëpronësia). Në një situatë të tillë mund të krijoheshin vendime kontradiktore për të njëjtin objekt, shkak ligjor dhe ndërmjet të njëjtave palë në kuptimin juridik. Në këtë logjikë kanë shkuar edhe ndryshimet e fundit të KPC-s me ligjin nr.38/2017, datë 30.03.2017, duke ndryshuar shkronjën "ç", të nenit 467, të këtij Kodi, në lidhje me rastet e prishjes së vendimit të shkallës së parë dhe kthimit të çështjes për rishqyrtim, për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë. Tashmë vendimi i shkallës së parë prishet dhe çështja kthehet për rishqyrtim vetëm në rastin kur kemi të bëjmë me ndërgjyqësinë kryesore të detyrueshme (paditës dhe i paditur). Në këtë pikë, ligji ka reflektuar standardin doktrinal dhe jurisprudencial (shih, vendimin nr.124, datë 03.07.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë). Duke u nisur pikërisht nga kuptimi i gabuar i institutit procedural të ndërgjyqësisë ligjvënësi tashmë ka përcaktuar si urdhërim ligjor atë që rridhte nga interpretimi korrekt i kësaj dispozite të pandryshuar. Në këtë kontekst, nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në arsyetimin e mësipërm, arrihet në përfundimin se prishja e vendimit të shkallës së parë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim mund të bëhet vetëm në rastet kur kjo gjykatë nuk ka respektuar dispozitat lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme. Nga ana tjetër, siç me të drejtë ka parashtruar në rekurs pala paditëse çështja është e natyrës administrative dhe shkaku i refuzimit të regjistrimit të pronës lidhet me problemet e dokumentacionit dhe jo me mbivendosjet. Thirrja si persona të tretë e pronarëve të pronave me të cilat krijon mbivendosje pasuria e palës paditëse nuk do të sillte ndonjë ndryshim në fatin e çështjes për sa kohë çështja nuk ka të bëjë me kundërshtimin e titujve të pronësisë. Thirrja e personit të tretë sipas nenit 193 të KPC-s bëhet kur nga vendimi vijnë pasoja të tërthorta për këtë palë dhe jo pasoja thelbësore, sikurse është cenimi i të drejtës së pronësisë.

Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit do të duhet ta shqyrtojë çështjen në themel, duke u mbështetur në shkakun ligjor të padisë, që ka të bëjë me të drejtën subjektive të paditësit për të regjistruar pronën e tij, të cilës i kundërvihet fakti i paligjshëm i palës së paditur dhe personit të tretë, të cilët i kanë refuzuar regjistrimin. Pra, meritat e çështjes duhet të vlerësohen në raport me veprimtarinë administrative të palës së paditur dhe personit të tretë. Në të njëjtën kohë,

Gjykata Administrative e Apelit çështjen e ndërgjyqësisë duhet ta shohë në raport me pozitën procedurale të personit të tretë, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe, nisur nga fakti se pala paditëse, në objektin e padisë, ka kërkuar detyrimin e saj që të kryejë një veprim administrativ.....".

I lutem Kolegjit që në lidhje me këtë dosje gjyqësore, përpara se të arrijë në konkluzione lidhur me profesionalizmin tim, të ketë në konsideratë, përveç praktikës së Gjykatës së Lartë, edhe tre rrethana të tjera që janë si më poshtë:

I. Në kohën e gjykimit të çështjes objekt analize, akoma nuk kishin hyrë në fuqi, dispozitat e ligjit "nr.38/2017, datë 30.03.2017, Për disa ndryshime në KPC". Për rrjedhojë, unë si gjyqtar, në atë kohë, nuk kam patur asnjë mundësi juridike për të vepruar përmes urdhërimit të paditësit për të rregulluar ndërgjyqësinë pasive të detyrueshme (edhe nëse pranohet se kjo ndërgjyqësi pasive ka qënë e detyrueshme sikurse shprehet Gjykata e Apelit). Neni 161 shkronja ç, i KPC, që i mundëson gjyqtarit që të urdhërojë paditësin të rregullojë ndërgjyqësinë pasive, nuk ka qënë i shtuar në vitin 2014 kur është zhvilluar gjykimi, por është shtuar vetëm në vitin 2017. Sipas vlerësimit tim, në atë kohë, "*e drejta e përcaktimit të ndërgjyqësisë pasive, pra përcaktimi se kush është/duhet të jetë i paditur*", në mungesë të një autorizimi ligjor të kundërt, përfshihej në "*të drejtën e disponibilitetit të paditësit*". Kjo e drejtë disponibiliteti, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin 38/2017, datë 30.03.2017, sipas praktikës së unifikuar me vendimet nr. 9/2006, nr. 3/2012 dhe nr. 5/2012 të KBGJL, ka patur karakter "ekskluziv dhe absolut", vetëm në dobi të paditësit, ndryshe nga aktualisht, (pas ndryshimeve të bëra me ligjin 38/2017, datë 30.03.2017), që prapë kjo e drejtë disponibiliteti ka karakter "ekskluziv", por jo "absolut", pasi Gjykatës i është njohur përmes nenit 161 shkronja "ç" të KPC, mundësia, pra e drejta që të urdhërojë paditësin që të rregullojë ndërgjyqësinë e paditur, kur Gjykata vlerëson se ka të bëjë më ndërgjyqësi pasive të detyrueshme.

II. Vendimi i Gjykatës së Apelit nr 596 dt 05.11.2015 që lë të kuptohet se unë si gjyqtar, është dashur të orientoj paditësin që të thërras si të paditur edhe trashëgimtarët e tjerë, ka qënë i kundërligjshëm. Kjo pasi, unë nuk mund të jepja "orientime të tilla", pasi do rrezikoja, madje do të minoja zbatimin e parimit të paanësisë së Gjykatës që nënkupton se Gjykata jo vetëm duhet të jetë e paanshme por edhe duhet të duket se është e tillë. Pra, po të bëja atë ç'ka thoshte Gjykata e Apelit, unë i bie të ndihmoja paditësin në mënyrën se si duhet të hartonte padinë dhe t'a këshilloja se kë të thërras të paditur. Kjo përbën shkak për përjashtimin e gjyqtarit, sipas nenit 72 të KPC si dhe praktikës së konsoliduar gjyqësore.

III. I lutem Kolegjit që në vlerësimin e performancës time në gjykimin e çështjes, të ketë paraprakisht parasysh edhe standartin detyrues të KPA, të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha. Sipas këtij standarti detyrues, rezulton se:

"*...10.7. Në lidhje me çështjet e grupuara në grupin e parë, Kolegji konstaton se të gjitha vlerësimet e Komisionit lidhen dhe i adresohen zgjidhjes në themel të çështjes penale, duke tentuar të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes nga ajo që ka kryer vetë Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Në këto konkluzione të Komisionit, Kolegji verën se gjendemi para një tejkalimi të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në*

drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Përpos pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se ky vlerësim i takon Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: "Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet", dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

10.8 Në këtë kuadër ligjor të zbatueshëm, Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

... 12.4 Pasi shqyrtoi rrethanat e faktit, konstatimet e Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, Kolegji vëren sërish se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim të kryer nga Komisioni mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes së marrë në shqyrtim. Nga natyra e çështjes dhe arsyetimi i përdorur edhe në këndvështrim të pretendimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, perceptohet qartë se evidentimi i problematikes që Komisioni ka konstatuar lidhet me gjykimin dhe vlerësimin nëse bindja e brendshme e krijuar prej trupës gjykuese mbi analizën e provave të marra gjatë procesit e në kuptim e zbatim të ligjit material, për më tepër mbi një çështje tejet të debatueshme e profesionale, siç është analiza mbi ekzistencën e lidhjes shkakësore në kryerjen e një vepre penale, se nuk ekziston lidhja shkakësore mes veprimeve të parregullta të të gjykuarve dhe pasojës së ardhur, është një konkluzion i gabuar e ka ardhur si pasojë e një analize sipërfaqësore të të gjitha fakteve. Kolegji çmon se edhe në këtë rast gjendemi përpara së njëjtës situatë si ajo e përshkruar më lart në këtë vendim, paragrafët 10.7-10.8, kur Komisioni tejkalon kompetencën e tij kushtetuese e ligjore duke vlerësuar vendimmarrjen dhe zgjidhjen në themel të një çështjeje gjyqësore, atribut vetëm i një gjykate më të lartë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se do të përdorej i njëjti arsyetim ligjor si ai i përdorur në arsyetimin më sipër, njësoj i vlefshëm dhe i zbatueshëm edhe për këtë qëndrim të Komisionit".

"...12.5 *Gjithashtu, Kolegji vlerëson të nënvizojë qëndrimin se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë rast Gjykata e Lartë e vendit, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur gjykata ku është pjesë e vendimmarrjes magjistrati (subjekti i rivlerësimit), nuk mund të përdorej apriori si një argument për të vlerësuar negativisht aftësitë profesionale të magjistratit, veçanërisht ato që lidhen me zgjidhjen e çështjes,*

siç është rasti konkret. Në këtë arsyetim, vlen të sillet në vëmendje se edhe sistemi i vlerësimit periodik të magjistratëve, i parashikuar prej ligjit nr. 96/2016, nuk parashikon matjen e aftësive për gjykim apo arsyetimin ligjor të magjistratëve në varësi të qëndrimit që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet e tyre. Aq më shumë, ky kriter nuk mund të përdoret si determinant në procesin e rivlerësimit, në të cilin pasoja e vlerësimit profesional mund të ndikojë në mënyrë thelbësore fatin profesional të magjistratit, por edhe më tepër kur i gjithë ky proces ka pasur nën vlerësimin e tij edhe vetë aftësitë profesionale të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, të cilët në raste të caktuara, në varësi të shkallës ku kanë gjykuar, mund të kenë qenë përkatësisht, gjyqtarë më të lartë ose më të ulët. Në këtë kontekst, qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta mund të provokojnë një vlerësim apo hetim të mëtejshëm drejt sjelljes profesionale të magjistratit, por ato nuk mund të jenë kriteri matës determinant për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre. Përpos këtij arsyetimi, rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Lartë në Shqipëri, dhe parimet e gjithëpranuara të Bangalores mbi sjelljen e gjyqësorit, kanë qenë të qarta dhe eksplicite në këto raste për mospërdorimin e një vendimi të një gjykate më të lartë për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët.

IV. Gjithashtu, kërkoj nga trupa gjykuese e Kolegjit të ketë parasysh rekomandimin e Këshillit të Evropës, përkatësisht të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare [17 nëntor 2010 CM/Rec(2010)12], "Mbi pavarësinë e eficencën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve", në Kreun VII ku trajnohet përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, ku përcaktohet se: "Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose i provave të kryera nga gjyqtarët gjatë gjykimit të çështjeve nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë. Gjyqtarët nuk mund të jenë personalisht përgjegjës në rastet kur vendimet e tyre ndryshohen nga një gjykatë më e lartë ".

<u>Së dyti</u>: Lidhur me barrën e provës që "Subjekti duhet të paraqesë faqen e rregjistrit të sekretarisë gjyqësore ku të evidentohet depozitimi i dosjes gjyqësore dhe vendimit gjyqësor", bëj me dije Kolegjin se e kam përmbushur pasi ia kam paraqitur Komisionit si provë.

<u>Së treti</u>: Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin se "*Në 2 raste të shtyra për shkak të mos pagesës së ekspertit, gjykata nuk duhej të shtynte seancën, por të urdhëronte nxjerrjen e detyrueshme te shpenzimeve për ekspertët me anë të përmbaruesit gjyqësor sipas nenit 105 të K.Pr.Civile*", kam për të thënë se në vlerësimin tim, neni 105 i KPC, dhe mënyra e veprimit që e quan të saktë Komisioni, duhen aplikuar vetëm në rrethanat e "ultima ratio", pra si mjeti i fundit. Kjo pasi vlerësoj se një nga parimet se si matet efiçenca e veprimtarisë gjyqësore, është "<u>aftësia e gjyqtarit për të zbatuar atë mjet procedural që garanton zgjidhjen e situatës, pa kompromentuar dëmtimin e standarteve të tjera të së drejtës së palëve për një proces të rregullt ligjor, sikurse është p.sh kohëzgjatja e arsyeshme e gjykimit, moslejimi i zvarritjeve, etj</u>". Kjo mënyrë veprimi e imja, (nëse është e vërtetë, pasi nuk e kam parë dosjen), është jo vetëm e duhura por edhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit. Kjo pasi mjeti i zgjedhur nga unë për të garantuar moslejimin e zvarritjes së gjykimit, si dhe të së drejtës së njohur nga ligji, të ekspertit për parapaguar për punën e tij, qartësisht ka balancë me rrezikun e shmangur të zvarritjes së gjykimit si dhe ka qënë efektiv. Përveç kësaj, nëse nuk do t'a konsideroja vetëm "si mjet të fundit" mënyrën e veprimit që sygjeron Komisioni, qartësisht do të ndikoja negativisht në diligjencën

(zellin) e ekspertit/ekspertëve, për të ndihmuar Gjykatën përmes këshillave të tyre shkencore, në zgjidhjen e çështjeve. Kjo pasi ekspertet janë të gatshëm që të paraqiten në gjykime se kanë perceptimin e garancisë nga Gjykata që do paguhen sipas ligjit për punën e tyre dhe kjo garanci në perceptimin e ekspertëve, nuk është e barasvlefshme me dokumentin që mund t'i japë Gjykata sipas nenit 105 të KPC, mbi bazën e të cilit ato mund t'i drejtohen shërbimit përmbarimor. Kjo pasi ekspertët edhe objektivisht por edhe subjektivisht mund të mos kenë dëshirë të përfshihen në procedura përmbarimore me palët ndërgjyqëse të çështjeve ku ekspertet kanë dhënë mendimin e tyre shkencor.

Gjithsesi, kjo mënyrë veprimi e imja, edhe po të konsiderohet si jo e duhur, ***nuk ka sjellë ndonjë pasojë për procesin gjyqësor, pra nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit që unë të konsiderohem përgjegjës në procesin tim të rivlerësimit, lidhur me këtë mënyrë veprimi***. Nëse veprohet kështu, kjo do të shkelte edhe parimin e barazisë në trajtim. Kjo pasi nuk ka asnjë rast subjekti rivlerësimi, të cilin KPK apo KPA, t'a ketë konsideruar përgjegjës, për moszbatimin e nenit 105 të KPC lidhur me pagesën e ekspertit, ndonëse të gjithë gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë, veprojnë njësoj sikurse kam vepruar unë, në rastin objekt analize.

Së katërti: Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin se "*Seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit. Shkaku nuk relatohet*", kam për të thënë se unë jam gjyqtari kampion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, madje edhe në Republikën e Shqipërisë për përdorimin e sistemit RDA. Mbi 85% e seancave janë rregjistruar audio, nga viti 2015 kur është instaluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe deri më sot. Në këtë gjykatë, gjyqtari i dytë pas meje është 55%, të tjerët poshtë nivelit 40%. Edhe ato pak seanca që nuk janë rregjistruar audio, nuk janë për fajin tim por për shkaqe të ndryshme dhe të ditura, që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë time. Ndër këto shkaqe mund të përmënd, numrin e kufizuar të sallave të gjykimit për numër gjyqtarësh, gabimet në vitin 2014/2015 të sekretarisë në përdorimin e sistemit RDA, (pasi nuk e kishin përvetësuar si duhet dijeninë se si përdorej ky sistem rregjistrimi, mungesat e energjisë elektrikë, etj). Madje, jo vetëm unë, për hir të transparencës, jam munduar të jem kampion në përdorimin e sistemit RDA të rregjistrimit të seancave me zë, por edhe kam reaguar shkresërisht në rastet kur jo për fajin tim, kjo nuk është realizuar dot. Si shëmbull për këtë, meqënëse çështja objekt analize bën fjalë për vitin 2015, do iu paraqes me cilësinë e provës shkresore, një korrespondencë shkresore të këtij viti, që kam zhvilluar me kryetarin e Gjykatës, Kancelarin dhe punonjësin e IT-së, ku unë jo vetëm i shpreh shqetësimin tim lidhur me rastet kur jo për fajin tim, nuk është mundësuar përdorimi i sistemit të rregjistrimit audio RDA, por edhe kërkoj marrjen e masave që kjo të mos përsëritet në të ardhmen. Shikoni edhe përgjigjet që kam marrë lidhur me kërkesën time shkresore të parashtruar si më sipër.

Lidhur me këtë dosje, Komisioni në vendimin e tij, ka dhënë konsideratat e mëposhtme:

81.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:
i) Në lidhje me referencën e subjektit në vendimin nr. 28/2020, të Kolegjit, Komisioni e ka trajtuar në detaje më lart qëndrimin e tij në lidhje me këtë vendim.
ii) Në lidhje me rregullimin e ndërgjyqësisë, Komisioni nuk i konsideron shpjegimet e subjektit bindëse dhe në përputhje me nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, gjykata, kur

çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore.
iii) Në rastin konkret subjekti duhet të thërriste si palë ndërgjyqëse edhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të pasurisë së paluajtshme.
iv) Në lidhje me pretendimet e subjektit sa i përket seancave gjyqësore joproduktive, Komisioni vlerëson se është detyrë e gjyqtarit që të marrë masat e duhura për zhvillimin e një procesi gjyqësor në kohë. Në nenin 105 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se kur një palë është e detyruar që të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme.
v) Për sa i përket zhvillimit të seancave pa audio shpjegimet e subjektit janë bindëse. 95 81.5. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se veprimet e subjektit afektojnë kriterin e vlerësimit të përcaktuar në nenin 74, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket seancave produktive dhe në nenin 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket rregullimit të ndërgjyqësisë.

Lidhur me qëndrimin e Komisionit, i lutem Kolegjit që të marrë në konsideratë se ky qëndrim lidhur me ndërgjyqësinë bie në kundërshtim me jurisprudencën e tanishme të Gjykatës së Lartë, që nuk e konsideron të parregullt procesin e zhvilluar nga unë si më sipër.

Në lidhje me seancat joproduktive, unë vlerësoj se nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit që të ndëshkohet pasi pasojat që do të vuaja qartazi nuk kanë balancë me qëllimin që synohet të arrihet. Nga ana tjetër, unë vlerësoj se kam të drejtë në shpjegimet që kam dhënë. Ky pretendim i imi përkrahet nga të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë që nxjerrjen e shpenzimeve të ekspertëve e konsiderojnë njësoj si unë "ultima ratio".

Në lidhje me standartin e Kolegjit, vlerësoj se Komisioni mban qëndrim të gabuar. Kjo pasi nuk përfshihet në tagrin e tij por vetëm të Gjykatave më të larta, mundesia për të kritikuar vendimin tim lidhur me mënyrën e formimit të ndërgjyqësisë.

Dosja nr 2.
Çështja penale nr. 319 regj.them., datë 28.01.2015 regjistrimi, kundër të pandehurit A.K. akuzuar për veprën penale të "vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulseve telefonike" të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr. 78 datë 30.01.2015.

Komisioni ka konstatuar se: Çështja gjyqësore është depozituar në Gjykatën e Rrethti Gjyqësor Shkodër më datën 27.01.2015 nga prokurori për vleftësim të arrestit në flagrancë dhe gjykim të drejtëpërdrejtë. Me shortin elektronik të datës 27.01.2015, çështja i është caktuar subjektit i cili me vendimin e dt 27.01.2015 (brenda dite), ka caktuar seancën gjyqësore për vleftësim arresti në flagrancë dhe gjykim të drejtëpërdrejtë në datën 28.01.2015 ora 10.30 duke urdhëruar njoftimin e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit.(Palët në këtë rast i njofton prokurori). Nxjerrja e vendimit, data e caktuar e seancës si dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet dhe proçedurën e shpejtë të gjykimit të përcaktuara në nenin 259 dhe 400/3 të K.Pr.Penale mbi vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe gjykimin e drejtëpërdrejtë.
Gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur : Deklarimin fajtor të pandehurit A.K. të akuzuar për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike", të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal dhe bazuar edhe në nenin 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar me 14 ditë burgim. Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim nga palët.

1. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit në sekretarinë gjyqësore në datën 02.02.2015 pas 3 diteve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.
2. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 ditë për masën e sigurimit dhe 3 ditë për gjykimin e d.p.d , në intervalin kohor 27.01.2015 – 30.01.2015, brenda afatit ligjor 2 dhe 15 ditor të përcaktuar nga neni 259/5 dhe 400/1/3 i K.Pr.Penale. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e paraburgosur, të përcaktuar nga neni 28 pika 2 të Kushtetutës dhe neni 5 pika 3 i KEDNj-së.
3. Janë caktuar 2 seanca gjyqësore të cilat kanë qënë produktive. Janë marrë masat për administrimin e shpejtë të procesit gjyqësor gjer në shpalljen e vendimit përfundimtar. Nuk ka pasur vonesë në çeljen e seancës gjyqësore.
 Seanca gjyqësore është zhvilluar në sallë gjykimi dhe është dokumentuar me proces verbal pa regjistrim audio dhe nuk relatohet shkaku.
 Subjekti duhet të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.
4. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Procesverbali i séances gjyqësore është i plotë, me të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të neneve 345/1 e 346 të K.Pr.Penale. Gjithashtu, procesverbali është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore dhe kryetari seancës në çdo faqe dhe në fund të tij, konform nenit 345/2 të K.Pr.Penale. Në dosje ndodhet 2 kopje e dorëshkrimit të vendimit nga gjyqtari sipas nenit 382 të K.Pr.Penale dhe 2 kopje me kompjuter, të zbardhur nga sekretaria gjyqësore për vendimin e masës së sigurimit 3 faqe dhe vendimit përfundimtar 4 faqe, e nënshkruar nga sekretari dhe gjyqtari. Fashikulli penal është i inventarizuar rregullisht nga sekretarja gjyqësore.
5. Në procesverbalin e seancës gjyqësore dhe nga aktet e njoftimit vihet re mënyra e komunikimit me palët dhe të tretët, gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjy qësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka të dhëna apo kërkesa në dosje nëse ka patur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.
6. Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar me dy vendime të veçanta. i. Vendimi për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 245 të K.Pr.Penale: i) pjesa hyrëse, ii) pjesa përshkuese- arsyetuese dhe iii) dispozitivi i gjykatës. Gjykata ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur faktin penal, duke treguar ligjin që konsiderohet i shkelur, si dhe shkaqet e posaçme dhe të dhënat që përligjin arrestimin në flagrancë nga policia gjyqësore dhe caktimin e masën e sigurimit personal. Janë cituar(sipas rastit të plota ose të pjesshme) dispozitat e zbatueshme në zgjidhjen e çështjes, ku përcaktimi i ekzistencës së faktit penal i referohet nenit 137/1 i K.Penal (Vjedhjes së energjisë elektrike) dhe përhapja masive e kësaj vepre penale në vendin tonë, më tej janë cituar nenet 228, 229 e 230 për kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit personal, si dhe nenet 251/2 e 252 të K.Pr.Penale për kushtet dhe kriteret e arrestimit në falagrancë nga policia gjyqësore. Është cituar parimi i përgjithshëm i dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova sipas nenit 228/1 të K.Pr.Penale në caktimin dhe përzgjedhjen e masës së sigurimit personal. Në arsyetim nuk citohet ndonjë parim i veçantë i së drejtës dhe as referenca në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore.
ii. Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale: i) pjesa hyrëse, ii) përshkuese- arsyetuese dhe iii) dispozitivi i gjykatës. Fillimisht përshkruhet rregjistrimi çështjes në gjykatë dhe disponimi saj për të proceduar nga gjykimi i d,p.d. në senacë gjykimi të shkurtuar sipas nenit 405/6 dhe 404 të K.Pr.Penale, janë

analizuar rrethanat e çështjes si kanë rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, tregohen provat që e mbështesin atë si dhe kërkimi i prokurorit. Më tej është përcaktuar fakti penal dhe janë cituar dispozitat e zbatueshme në zgjidhjen e çështjes; norma të K.Penal që bën fjalë për veprën penale të "vjedhjes së energjisë elektrike" të parashikuar nga neni 137/1 të K.Penal. Janë analizuar elementët objektivë dhe subjektivë të figurës së veprës penale duke arritur në konkluzionin se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Gjykata analizon llojin, masën e dënimit dhe mënyrën e caktimit të tij sipas nenit 47, 48 e 49 të K.Penal dhe sanksionit apo kufizimit të përcaktuar nga dispozita e nenit 137/1 e i K.Penal, "vjedhja e energjisë elektrike" konsiston në kryerjen e saj me anë të rilidhjes së paligjëshme, pas ndërprerjes më parë për shkak të mos përmbushjes së detyrimit kontraktor për pagesën. Mbi analizën e elementëve si më sipër gjykata ka arritur në konkluzionin se i pandehuri është fajtor pasi veprimin e kundraligjshëm e ka kryer me dashje direkte, për motive interesi dhe me qëllim nxjerrje përfitimi material, pendimin e tij të thellë, moshën e tij, faktin që është kryefamiljar, por nuk janë të detajuara. Gjyqtari nuk ka përdorur ndonjë parim të së drejtës dhe referenca në jurisprudencën e mëparshme unifikuese gjyqsore. Nga struktura, pjesa arsyetuese e vendimit është unike, me paragrafë të renditur me etikë ku është përshkruar objekti i kërkesës që lidhet me akuzat penale të prokurorit ndaj të pandehurit, janë paraqitur përmbledhtazi pretendimet e prokurorit, qëndrimi i palës së pandehur dhe mbrojtjes, analiza dhe kualifikimet ligjore dhe konkluzionet e Gjykatës. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe në tërësi janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

V.O. Procedimi penal në përmbajtjen e tij finalizohet me ndëshkimin apo dënimin e personit fajtor. Dënimi penal është instituti më i rëndësishëm i së drejtës penale i cili caktohet në bazë të parimeve të përgjithëshme dhe të vecanta të K.Penal (parimi i ligjshmërisë, i individualizimit të dënimit, i dobishmërisë apo domosdoshmërisë dhe parimi i proporcionalitetit të dënimit). Dënimi ka qëllim edukimin e fajtorit, dhe në aspektin e gjërë respektimin e ligjit për parandalimin e kryerjes së veprave penale nga shtetasit. Mënyra e caktimit të dënimit bazohet në nenet 47 – 50 të K.Penal duke u përcaktuar nga rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore e autorit të saj, shkalla e fajit, rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrethanave lehtësuese dhe rrethanat rënduese.
Masa dhe lloji i dënimit caktohet duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në dispozitën e pjesës së posacme të K.Penal. Neni 137/1 i K.Penal ka parashikuar ; « Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, dëmtimi matësit si dhe cdo ndërhyrje tjetër e paligjëshme dhe e paautorizuare në sistemin e matjes apo në rrjetin telefonik e kryer me qëllim përfitimi të paligjëshëm përbën vepër penale dhe, dënohet me burgim deri në 3 vjet ». Masa e dënimit e caktuar nga gjykata me 14 ditë burgim me anë të procedurës së gjykimit të shkurtuar është në kufijtë minimalë që parashikon dispozita e K.Penal, ose rreth 1.3 % e masës së dënimit maksimal.
Në rastin konkret në funksion të një politike penale vihet re se vepra penale është shumë të përhapur, i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore, ai i ka kryer veprimet e kundraligjëshme penale pas një mase administrative të dhënë më parë ndaj tij.
Kjo masë dënimi nuk është në proporcion mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik apo dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar, si dhe synimit që kërkon të arrijë dënimi penal. Në caktimin e dënimit janë përcaktuese ana objektive dhe subjektive i figurës së veprës penale. Ana objektive vlerësohet nga veprimi i i kundraligjshëm, me mjetet dhe format e përdorura në raport me

gjendjen që e ka diktuar atë dhe pasojën e ardhur. Ana subjektive vlerësohet nga shkalla e fajit sipas nenit 14 dhe 15 të K.Penal.
Në rastin konkret i pandehuri ka vepruar me dashje direkte megjithëse ka qënë i ndëshkuar më parë me masë adminisrativet (ndërprerje të energjisë elektrike), e cila është shkallë më e rëndë e fajit, me motiv interesi dhe qëllim nxjerrjen e përfitimit material. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra tjetrën. Gjykata ka çmuar si rrethana lehtësuese të përgjithëshme sipas nenit 49 të K.Penal, qënien k/familjar, pendimin e thellë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pranimin e akuzës, moshën etj, por të padetajuara. Në këtë kuptim masa e dënimit të caktuar është dhënë në interpretim të gabuar të nenit 47 të K.Penal dhe për rrjedhim është cënuar parimi i proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K.Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës(shih edhe vendimin nr.19/2011 dhe nr 47/2012 të Gjykatës Kushtetuese).
Në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërsië" pa zëvendësuar interpetimin dhe logjikën e gjyqtarit, ky vendim të merret në konsideratë për velrësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me këtë dosje, kam për të thënë si më poshtë:

<u>Së pari</u>: Lidhur me funksionimin e sistemit RDA (rregjistrimet audio) për vitin 2015, u shpreha në shpjegimet e çështjes së mësipërme dhe vlerësoj se është e padobishme të zgjatem, pasi po të njëjtat argumente dhe prova vlejnë edhe për këtë çështje. Gjithsesi, kjo mënyrë veprimi, edhe po të konsiderohet jo e duhur, nuk ka sjellë ndonjë pasojë për procesin, pra nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit që unë të konsiderohem përgjegjës në procesin tim të rivlerësimit, lidhur me këtë mënyrë veprimi. Nëse veprohet kështu, kjo do të shkelte edhe parimin e barazisë në trajtim. Kjo pasi nuk ka asnjë rast subjekti rivlerësimi, të cilin KPK apo KPA, t'a ketë konsideruar përgjegjës disiplinarisht për qëllimin e procesit të rivlerësimit, për shkak të mosrregjistrimit audio të seancave. Kjo edhe kur është konstatuar se është bërë me faj të tyre, dhe aq më pak pa faj të tyre (sikurse ka ndodhur në rastin tim, në të gjitha momentet kur raporti i Komisionit referon se séance konkrete nuk janë rregjistruar audio).

<u>Së dyti</u>: Përsa i përket konstatimit të Komisionit se argumentimi/arsyetimi i dënimit me vetëm 14 ditë burg për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulseve telefonike" të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, "është jo i detajuar si dhe dënimi është jo proporcional", nuk jam dakort. Kjo pasi përmes këtij konstatimi, qartësisht Komisioni shprehet për meritën e çështjes, gjë që bie në kundërshtim me standartin detyrues të vendosur me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër dhe për rrjedhojë e vlerësoj të panevojshme të zgjatem.

<u>Së treti</u>: Gjithsesi, në shtim të argumentit të bërë në paragrafin e mësipërm, unë vlerësoj se qëllimi i dënimit vërtet ka të bëjë me parandalimin e posaçëm dhe më parandalimin e përgjithshëm, por qëndra e rëndesës është gjithmonë parandalimi i posaçëm. Pra edukimi i të pandehurit përmes dënimit. Kjo pasi nëse qëndra e rëndesës vihet tek parandalimi i përgjithshëm, "pra tek edukimi i popullit në përgjithësi, përmes dhënies së shembullit", atëherë rrezikohet të cënohet një nga të drejtat themelore të njeriut, që është ajo e parashikuar në nenit 3 të KEDNj-së, që është e drejta e mosnënshtrimit ndaj torturës, trajtimit çnjerëzor apo poshtërues. Kjo pasi kam

çmuar se i pandehuri po të dënohej më shumë se 14 ditë në kushtet kur është kryefamiljar, tejet i varfër, me fëmijë të mitur, etj, kjo do ishte ç'njerëzore, mizori. Gjithashtu kam ç'muar se në rastin konkret, nuk mund të dënohet ashpër njeriu i varfër, pra një fakir fukara, vetëm për t'i treguar popullit se energjia elektrike duhet paguar pasi në të kundërtën, shif se ç'të gjen. Kjo pasi njeriu nuk është kavie eksperimentale për t'u përdorur vetëm si shembull për të modeluar një sjellje shoqërore të caktuar. Nëse njeriu trajtohet si kavie eksperimentale për t'u përdorur vetëm, si shëmbull për popullin, kjo do të ishte trajtim poshtërues për këtë njeri. Ka praktikë të konsoliduar për këtë lloj trajtimi poshtërues, (shih vendim i GJEDNj Abdullah Occalan v Turqisë).

Sipas vlerësimit tim, varfëria nuk luftohet duke patur si armë vetëm kërbaçin. Republika jonë pavarësisht nga si është në realitet, në formë është Republikë demokratike, që ka si gur themeli të drejtat e njeriut. Unë si gjyqtar, modestisht, kam bërë, po bëj dhe do bëj çfarë kam në dorë që realiteti dhe forma të përputhen me njëri tjetrit. Vetëm kështu vlerësoj se i shërbej Atdheut tim. Vetëm kështu vlerësoj se nuk i ngjasoj atyre patricëve që nuk kishin dhëmbshuri për vuajtjet e plebejve. Në vështrimin tim, gjyqtari i Republikës së Shqipërisë, kurrsesi nuk mund të jetë patric, por brënda kompetencave që i njeh kushtetuta dhe ligji duhet të jetë tribun i popullit. Vetëm duke u sjellë kësisoj, vlerësoj se gjyqtari parandalon që të ndodhin ngjarje tragjike sikurse kanë ndodhur kur njerëz të varfër, të dënuar për energji elektrike, kanë varur veten ose janë vetvrarë në forma të ndryshme, për shkak të pamundësisë për të paguar energjinë elektrike.

<u>Së katërti</u>: Përsa i përket konstatimit të Komisionit se argumentimi/arsyetimi i dënimit me vetëm 14 ditë burg për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulseve telefonike" të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, "*është jo proporcional pasi i pandehuri është dënuar më parë administrativisht me masën e ndërprerjes së emergjisë elektrike*", nuk jam dakort. Kjo pasi:

1. As nga pikpamja ligjore as nga pikpamja faktike, ndërprerja e energjisë elektrike nuk është denim jo e jo penal (pra i pandehuri nuk konsiderohet recidivist), por as administrativ. Kjo pasi shoqëria tregtare që ka ndërprerë energjinë elektrike, nuk konsiderohet sipas ligjit 48/2015 apo ndonjë ligj tjetër, organ administrativ shtetëror. Pra ky argument është pa pikë lidhjeje.

2. Ndërprerja e nergjisë elektrike, më parë, është element i domosdoshëm i anës objektive të veprës penale për të cilën është dënuar i pandehuri, jo rrethanë rënduese që ndikon në ashpërsinë e dënimit që duhet caktuar. Kjo pasi nëse ky element i figurës së veprës penale do mungonte, nuk do kishte fare vepër penale.

3. Vendimi është i formës së prerë. Pra ka fuqinë e ligjit. Çdo argument që bie në kundërshtim me ligjin, në çmuarjen time është i paligjshëm. Sikurse thotë Aristoteli, "ligji është inteligjenca superiore". As unë dhe as Komisioni vlerësoj se nuk disponojme më shumë inteligjencë se inteligjenca superiore, që është vetë ligji.

Në lidhje me këtë argumentim timin, Komisioni ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

82.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se pretendimi i

subjektit në lidhje me themelin e çështjes nuk qëndron dhe qëndrimi i Komisionit në lidhje me këtë pretendim është trajtuar gjerësisht më lart. Argumentet e subjektit në lidhje me barrën e provës nuk janë bindëse, por meqenëse ka të bëjë me masën e dënimit për të shmangur gjykimin e korrektësisë së vendimit të subjektit, vlerëson të mos e përfshijë këtë konstatim në vlerësimin profesional të subjektit.

Unë kam bindjen se Kolegji do t'a kuptojë se unë kam të drejtë. Meqënëse vetë Komisioni, me qëndrimin e mësipërm, shprehet se konstatimi i tij nuk do të përfshihet në vlerësimin tim profesional, vlerësoj se është e kotë të zgjatem.

Dosja nr. 3.
Çështja civile nr. 783 regj. them. datë 22.01.2015 regjistrimi, që i përket paditëses A.L. kundër të paditurit Alerti L, me objekt "zgjidhje martese dhe të pasojave që rrjedhin prej saj", e përfunduar me vendimin nr. 303(759), datë 20.02.2015.

Komisioni ka konstatuar se:

1. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 22.01.2015 dhe me shortin e datës 22.01.2015, i është caktuar subjektit. Me vendimin e datës 28.01.2015 (pas 6 ditësh), gjyqtari ka caktuar séance përgatitore të pajtimit në datën 06.02.2015 ora 15.00 minuta.

 Nxjerrja e vendimit nga subjekti, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit nuk respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar në nenin 155 të K.Pr.Civile. Subjekti duhet të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur: Pranimin e padisë, duke zgjidhur martesën midis palëve ndërgjyqse, pa përcaktuar fajësinë. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim.

2. Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri në datën 23.02.2015 - pas 3 ditëve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 308 paragrafi 2 i K.Pr.Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 29 ditë, në intervalin kohor 22.01.2015-20.02.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standart 4 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja "d" të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht është respektuar standarti i procesit të rregullt ligjor i përcaktuar nga neni 42 i Kushtetuës dhe neni 6 i KEDNj-së.
3. Veprimet proceduriale për organizimin e procesit gjyqësor janë dokumentuar rregullisht dhe nuk janë konstatuar të meta në kryerjen e tyre.
 Seancat nuk janë zhvilluar me rregjistrim audio dhe nuk relatohet shkaku në funksion të soleminitetit dhe transparencës së gjykimit.
 Subjekti duhet të jap shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

4. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, nuk konstatohen të meta. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118/1 të K.Pr.Civile. Procesverbali është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe tregojnë shkakun ligjor. Në dosje ndodhet 1 kopje e vendimit, e hartuar me kompjuter, e nënshkruar vetëm nga gjyqtari i çështjes, gjithsej 5 faqe, si

dhe një kopje e vendimit, që përmban nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretares gjyqësore, me vulë të gjykatës, gjithsej 3 faqe kalibër nr.12. Fashikulli gjyqësor është i inventarizuar nga sekretarja gjyqësore.

5. Procesverbali gjyqësor tregon me sa mund të kuptohet se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, përsa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse si dhe për komunikimet apo kërkimet e akteve apo provave me shkresa drejtuar institucioneve të treta janë të qarta. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale. Komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka të dhëna për kërkesa për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes.

6. Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar formalisht sipas nenit 310 të K.Pr.Civile: pjesa hyrëse, përshkuese - arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës. Fillimisht citohet rregjistrimi i çështjes në gjykatë, kompetenca dhe jurudiksioni megjithëse i pakundërshtuar nga palët, paraqiten faktet dhe rrethanat e çështjes ashtu si kanë rezultuar gjatë gjykimit,është analizuar kërkimi i palës paditëse dhe shkaku për zgjidhjen e martesës pa u cilësuar personi fajtor pasi nuk është kërkuar nga palët sipas kërkesave të nenit 132 dhe 133 të K.Familjes. Në zgjidhjen e pasojave referuar nenit 146/1 të K.Familjes paditësja merr mbiemrin e vajzërisë, ndërsa nuk ka pasoja dhe kërkime të tjera për të zgjidhur pasi çifti bashkëshortor nuk ka fëmijë. Në zgjidhjen e çështjes nuk janë cituar parime të së drejtës dhe praktika të mëparëshme gjyqësore.

Nga struktura, pjesa arsyetuese e vendimit është unike, me paragrafë të renditur me etikë ku është përshkruar objekti i kërkesë padisë, kërkimet palës paditëse, analiza faktike dhe ligjore si dhe konkluzionet e Gjykatës. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive dhe në tërësi janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Teksti ka strukturë të qartë dhe është i kuptueshëm.

Në lidhje me këtë dosje, kam për të thënë se:

<u>Së pari</u>: Lidhur me vlerësimin e Komisionit se kam shkelur nenin 155 të KPC, pasi nuk kam respektuar kohën e parashikuar ligjore për caktimin e seancës, nuk jam dakort. Kjo pasi afati ligjor që parashikon neni 155 i KPC, në thelbin e tij është afat në dobi të palës, pra nuk është afat i prerë. Sipas nenit 146 të KPC, "*Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç kur ligji e parashikon shprehimisht se janë të prera*. *Afatet e prera nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve*". Me intepretim literal si dhe intepretim ad contrario, (që është një nënllojet e intepretimit logjik në normës), rezulton se afatet jo të prera, mund të shkurtohen ose zgjaten kur pala jep pelqim për këtë. Palët duke marrë pjesë në seancë, në mënyrë të nënkuptuar kanë dhënë pëlqim për shkurtimin e këtij afati. Ky lloj intepretimi i normës është në pajtim edhe me paragrafin e tretë të nenit 155 të KPC që parashikon se "*Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të padituri të drejtën e mbrojtjes*". Për sa kohë kam caktuar seancën, qartësisht kjo ka qënë kërkesë e palëve, që është pranuar. Edhe sikur të ketë patur të meta në formën e pranimit të kërkesës, Kolegji shpresoj të ketë parasysh nenin

119/3 të KPC ku parashikohet se "*Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar*".

Së dyti: Mos rregjistrimi audio i seancës nuk ka ardhur si rezultat i fajësisë time, pasi sallat duhet të kenë qënë të zëna me gjykime që po zhvilloheshin nga gjyqtarë të tjerë. Megjithatë, e pranoj që duhet të isha më i kujdesshëm në kontrollimin e procesverbalit gjyqësor, duke shënuar në të se arsyen se përse gjykimi nuk është zhvilluar në sallë, me rregjistrim audio. Faktikisht kjo iu është thënë palëve, por nuk është shënuar në procesverbal nga sekretarja. Gjithsesi, ky gabim vlerëson se në mungesë të pasojës, nuk ka fare ndikim në procesin tim të rivlerësimit.

Komisioni në vendim lidhur me argumentet e mia mban qëndrimin se:

83.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe janë në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë provë për të provuar deklarimet e tij.

83.5. Për rrjedhojë, veprimet e subjektit afektojnë kriterin e vlerësimit të parashikuar nga neni 74, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, pasi subjekti nuk ka respektuar afatin e parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, seancat nuk janë zhvilluar me regjistrim audio, si dhe nuk relatohet shkaku në funksion të solemnitetit dhe transparencës së gjykimit.

Lidhur me këtë qëndrim të Komisioni, vlerësoj se ai është subjektiv dhe keqdashës. Për problematikën e rregjistrimit audio kujtoj Kolegjin se Komisioni në dy rastet e mësipërme, që ishin thuajse identike shprehet se shpjegimet e mia ishin bindëse.

Nga ana tjetër, arsyetimi i Komisionit se unë nuk kam paraqitur prova është absurditet. Shpjegimet e mia kanë të bëjnë me rrethana ligji dhe jo fakti dhe për rrjedhojë nuk paraqiten prova.

Gjithsesi, i lutem Kolegjit të konsiderojë se edhe nëse kam gabime, ato në kuptim të parimit të proporcionalitetit nuk mund të konsiderohen se kanë balancë me pasojën e shkarkimit tim nga detyra e gjyqtarit. Komisioni, në qëndrimin e tij duket qartë se edhe në këtë rast, si në raste të tjera, përmes zmadhimit në ekstrem të qimes, synon që t'a bëjë atë tra. Kjo është tregues i drejtësisë së vendimit të tij. Po ashtu edhe i paanësisë së komisionerëve në procesin tim të rivlerësimit.

Dosje nr. 4.

Çështja penale me nr. 695 regj. Them, datë 28.07.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër me objekt "vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit 'arrest në burg' ndaj të dyshuarit A.R. për veprën penale të

“Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, i përfunduar me vendimin nr. 1830 akti, datë 24.12.2015.

Për këtë dosje, Komisioni nuk më ka kërkuar as shpjegim dhe nuk më ka ngarkuar as barrë prove. Pra mendoj se vlerësimi i Komisionit është pozitiv, prandaj nuk është e dobishme të zgjatem.

Dosja nr. 5.

Çështja civile nr. 1889 regj. them. datë 27.05.2015 regjistrimi, që i përket paditëses H.D. kundër të paditurit SH.R. etj, me objekt “Njohje pronësie me parashkrim fitues mbi një shtëpi banimi”, e përfunduar me vendimin nr. 1830, datë 24.12.2015.

Komisioni ka konstatuar se:

1. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 27.05.2015 dhe me shortin e datës 29.05.2015, i është caktuar subjektit. Me vendimin e datës 01.06.2015 (pas 3 ditësh), gjyqtari ka caktuar séance përgatitore në datën 29.06.2015 ora 13.00 minuta. Nxjerrja e vendimit nga gjyqtari, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar në nenin 155 të K.Pr.Civile.

Gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur: rrëzimin e kërkesë padisë. Seanca është mbyllur në orën 10.22 minuta. Procesverbali është nënshkruar nga sekretari gjyqësor dhe gjyqtari i çështjes.
Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga pala paditëse dhe Gjykata Apelit Shkodër me vendim nr 844 datë 11.12.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

2. Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri në datën 31.12.2015 - pas 7 ditëve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 308 paragrafi 2 i K.Pr.Civile. Gjykimi ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 26 ditë, në intervalin kohor 27.05.2015-24.12.2015. Kjo kohëzgjatje është 26 ditë jashtë afatit standart 6 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, por është respektuar standarti i procesit të rregullt ligjor i përcaktuar nga neni 42 i Kushtetuës dhe neni 6 i KEDNj-së.

3. Veprimet proceduriale për organizimin e procesit gjyqësor janë dokumentuar rregullisht, por janë konstatuar edhe të meta në kryerjen e tyre.

 Pengesë në 4 seancë joproduktive ka qenë mungesa e konfirmimit të njoftimit për të paditurit ku vihet re se ka munguar bashkëpunimi i gjykatës me administratën gjyqësore për njoftimin e tyre.
 Në 1 rast duhet evidentuar fakti se seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në mungesë të palës paditur pa patur njoftim, me arsyen se është deklaruar mungesa në seancë përgatitore në kundërshtim me nenet 175 dhe 179 të K.Pr.Civile, pasi për seancën e parë gjyqësore palët duhej të rinjoftoheshin përsëri me anë të fletë thirrjeve apo shpalljes publike.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Seancat janë zhvilluar me rregjistrim audio në funksion të soleminitetit dhe transparencës së gjykimit.

4. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar, nuk konstatohen të meta. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e nenit 118/1 të K.Pr.Civile. Procesverbali është i nënshkruar rregullisht. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe tregojnë shkakun ligjor. Në dosje ndodhet 1 kopje e vendimit, e hartuar me kompjuter, e nënshkruar vetëm nga gjyqtari i çështjes, gjithsej 6 faqe, si dhe një kopje e vendimit, që përmban nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretares gjyqësore, me vulë të gjykatës, gjithsej 6 faqe kalibër nr.12. Fashikulli gjyqësor është i inventarizuar nga sekretarja gjyqësore.

5. Procesverbali gjyqësor tregon me sa mund të kuptohet se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, përsa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqse si dhe për komunikimet apo kërkimet e akteve apo provave me shkresa drejtuar institucioneve të treta janë të qarta. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosje është normale. Komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka të dhëna për kërkesa për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes.

6. Vendimi gjyqësor përfundimtar është i strukturuar sipas elementëve të parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile. Ai përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Fillimisht gjykata ka analizuar rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, ashtu si kanë rezultuar gjatë hetimit gjyqësor të çështjes, shkaqet e ngritjes së padisë dhe të drejtës së saj, pretendimet e pales paditëse për fitimin e pronës me anët të parashkrimit, janë analizuar provat përkatëse si dhe janë marrë edhe prova me eskpertë kopetentë në fushën e topografisë. Për përcaktimin e faktit civil gjykata i është referuar nenit 193 të K.Civil, nenit 21 ligj nr 7512/1991 ”Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe veprimtarive private të pavaruara dhe privatizimit”, Udhëzim i KM nr 3/1993, ligji nr 7698/1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”, Udhëzim i KM nr 3/1993 i dalë në bazë e për zbatim të ligjit për pronat, ku analizohen faktet, provat e hetuara dhe interpretohen dispozitat ligjore të cituara më sipër mbi të drejtën e pronësisë dhe mënyrën e fitimit të saj me parashkrim fitues të pretenduar nga pala paditëse. Më tej është analizuar legjitimiteti aktiv dhe pasiv i palëve ndërgjyqëse duke arritur në përfundimin se padia është e pabazuar në ligj. Pasi paditësit i mungon legjitimiteti pasiv përkundrejt të paditurve si palë ndërgjyqëse, të cilët nuk rezulton të kenë titull pronësie mbi pasurinë e pretenduar nga paditësi, si dhe për faktin se paditësi e ka fituar njëherë pronësinë mbi truallin e pretenduar me kontratë shitblerje për objektin, që njëkohësisht është bërë edhe pronar i truallit(shih neni 21 ligj 7512/19991). Në arsyetim nuk janë cituar parimet e së drejtës dhe nuk jepen referenca në jurisprudencën e mëparëshme gjyqësore. Janë respektuar rregullat e drejtëshkrimit në ndërtimin e fjalive por nuk janë përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi paraqitet me një strukturë të qëndrueshme dhe me format të standardizuar. Arsyetimi është i qartë dhe i kuptueshëm.

Në lidhje me këtë dosje, kam për të thënë se:

<u>Së pari</u>: Nuk jam dakort me konstatimin e Komisionit se "*Pengesë në 4 seancë joproduktive ka qenë mungesa e konfirmimit të njoftimit për të padituri ku vihet re se ka munguar bashkëpunimi i gjykatës me administratën gjyqësore për njoftimin e tyre* ". Për t'u treguar se mungon bashkëpunimi, do duhej treguar se si do duhej të ishte ky bashkëpunim i munguar. Besoj se Komisioni e ka ditur që ftuesin e Gjykatës dhe/apo shërbimin postar, gjyqtari nuk e ka në varësi funksionale. Gjithashtu, besoj se Komisioni e ka ditur që sipas nenit 128 të KPC, është detyrë funksionale e nëpunësit gjyqësor (ftuesit) të bëj kërkim proaktiv për realizimin e njoftimit gjyqësor që i adresohet palës ndërgjyqëse. Megjithatë, duke iu referuar kohëzgjatjes tërësore të gjykimit, vlerësoj se qartësisht edhe nëse ky bashkëpunim i munguar, por i paargumentguar, merret padrejtësisht si e metë e imja, prapë se prapë, sipas parimit të proporcionalitetit, kjo nuk ka ndikim për qëllimet e procesit tim të rivlerësimit.

<u>Së dyti</u>: Ka qënë më së paku e diskutueshme, përpara se të hynin në fuqi, ndryshimet e KPC, të miratuara me ligjin 38/2017, nëse kur Gjykata merrte vendim në seancë përgatitore, për vazhdimin e gjykimit në mungesë të të padituri, - a duhej ajo që t'a njoftonte përsëri për seancën gjyqësore. Unë kam mendim të kundërt juridik me Komisionin që në raport shprehet "*Në 1 rast duhet evidentuar fakti se seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në mungesë të palës paditur pa patur njoftim, me arsyen se është deklaruar mungesa në seancë përgatitore në kundërshtim me nenet 175 dhe 179 të K.Pr.Civile, pasi për seancën e parë gjyqësore palët duhej të rinjoftoheshin përsëri me anë të fletë thirrjeve apo shpalljes publike*".
Kjo pasi:

I. Në kohën që kam vepruar sikurse e përshkruan Komisioni, unë nuk kam patur faj. Kjo pasi as e kam ditur dhe as nuk kam patur mundësi as objektive dhe as subjektive për të pyetur Komisionin në atë kohë, se çfarë mendimi kishte lidhur me pyetjen – Nëse duhej njoftuar apo jo më i padituri, për seance gjyqësore, kur më parë ishte deklaruar mungesa në seancën përgatitore. Unë në kohën që kam vepruar sikurse e përshkruan Komisioni, përgjigjen e kësaj pyetjeje e kam konsideruar të ezauruar nga praktika e Gjykatës së Lartë, të paktën që nga viti 2002. Gjithsesi, edhe nëse do konsiderohem si fajtor që nuk e kam ditur mendimin e Komisionit, prapë ftoj Komisionin t'a respektojë mendimin tim juridik të kundërt me të tijin, si shenjë që Komisioni si organ administrativ që është, e respekton pavarësinë e sistemit gjyqësor në guximin për të patur mendim juridik qoftë edhe të kundërt me të, për çështje të caktuara të së drejtës.

II. Kam menduar dhe vazhdon të mendoj, që sjellja gjyqësore përveçse është sjellje me natyrë procedurale, njëherazi është edhe veprim (ose mosveprim) juridik me pasoja materiale. Sipas nenit 80 të Kodit Civil "veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo shfaqje të padyshimtë të vullnetit". Unë në rastin objekt analize, kam vlerësuar se (mos)veprimi i palës së paditur, për t'u paraqitur në seancën përgatitore ndonëse ishte njoftuar rregullisht, përbënte shfaqje të padyshimtë të vullnetit të tij, me heshtje, që ai nuk dëshironte për të marrë pjesë në gjykim.

III. Edhe nëse do konsiderohej se kam vepruar gabim, mungon pasoja e paligjshme. Pa pasojë, nuk ka dënim. Kjo pasi i padituri është paraqitur në vijim të gjykimit dhe madje ka dalë gjyqfitues perms vendimit gjyqësor përfundimtar të marrë nga unë si gjyqtar.

Komisioni në vendim lidhur me argumentet e mia mban qëndrimin se:

84.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Në nenin 128 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se gjyqtari kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga nëpunësit e administratës gjyqësore. Për rrjedhojë, nga ana e tij nuk është marrë asnjë masë për të shmangur shtyrjen e seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së konfirmimit të njoftimit nga ana e palëve në gjykim. Për sa i përket mosnjoftimit të palës në gjykim, ky është një detyrim ligjor i parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile në nenet 175 dhe 179 të tij dhe nuk është në diskrecion të gjyqtarit të vlerësojë dhe të abstragojë në lidhje me vullnetin e palëve për sa i përket gjykimit, nëse ky vullnet nuk shfaqet me veprime ose mosveprime sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

84.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 dhe mangësi në drejtim të aftësive organizative, sipas përcaktimeve të nenit 73, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

Në lidhje me arsyetimin e Komisionit, mbaj përpara Kolegjit qëndrimin se është abuziv, i paligjshëm dhe përveç kësaj përbën provë të qartë se komisionerët që e kanë dhënë këtë vendim kanë shkelur jo vetëm standartin e gjykimit të drejtë, (gjë që duket nga thellësia e arsyetimin in primma facia), por edhe parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Nuk do të çuditesha po të konsideronin edhe ndonjë gabim ortografik si demostrim të mangësive në aspektin e njohurive profesionale.

II. DENONCIME

1. Në lidhje me denoncimet e Pëllumb Gavoci (nr.80 prot. datë 11.01.2021); Kin Gurraj e Kin Camaj(nr.1620 prot. datë 05.02.2020); Thanas Moçka (nr.8207 prot. datë 30.12.2019); Artan Bregu (nr.6121prot. Date 08.09.2021); Ardita Rrepishti (nr.1470 prot. date 12.2.2021); Tome Ndreshaj (Nr.1025 protdatë 26.01.2018); Mark Curraj (nr.4809 prot. datë 21.06.2018); Mark Lleshi (nr.2632 prot. datë20.03.2018); Gentjan Hoxhaj (nr.3905 prot. datë 30.04.2018); Servete Lujkaj (nr. 5262 prot. datë13.07.2018) Redi Xhelepi[60] (avokat) pas analizimit të tyre konstatohet se Komisioni nuk mund të evidentojë shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga ana e subjekti të rivlerësimit.

Unë nuk ka çfarë t'i shtoj këtij vlerësimi të Komisionit.

[60] Lidhur me denoncimin e avokatit Redi Xhelepi, kam paraqitur si shkak përjashtimi për Komisioneren Firdes Shuli, se ajo pavarësisht se është shprehur se unë nuk kam problematika, nuk është dashur që t'a shqyrtonte këtë denoncion dhe të jepte dorëheqje nga çështja. Kjo pasi komisionerja në fjalë, kur ka qënë notere në Gjirokastër, dyshohet se ka fallsifikuar një dokument pronësie për një pasuri të paluajtshme. Kallzimi ndaj shtetases Firdes Shuli është bërë nga tre avokatët Arben Llangozi, Gerti Ymeri (vëllai im), Orgesa Serani, dhe studio ligjore "Jurisprudenca".

Rrethanat e këtij kallzimi me rrethanat e faktit të çështjes për të cilën më ka denoncuar mua avokati Redi Xhelepi, janë objektivisht të njëjta. Për rrjedhojë sipas nenit 30 të ligjit 44/2025, shkronja "b", komisionerja Firdes Shuli duhej të përjashtohej nga gjykimi. Për më tepër që ajo është kallzuar penalisht nga tre avoketërit mbrojtës të mi, që përpara se ajo të caktohej si komisionere në trupën time gjykuese, gjë që natyrisht, duke parë edhe sjelljen e saj, më krijon bindjen e padyshimtë se si unë ashtu edhe motra ime, prokurorja Ajola Prençi, i jemi ekspozuar hakmarrjes së paligjshme të kësaj komisionereje, në proceset tona të rivlerësimit.

2. Daria Damidova (nr. 2803 prot. date 24.3.2021).

Nga çfarë përshkruhet në raport, denoncuesja pretendon se unë në cilësinë e gjyqtarit, kam dhënë vendimin nr.17, datë 12.01.2021 në kundërshtim me ligjin dhe me provat. Sipas saj, unë nuk kam njoftuar palën e paditur "Alart" shpk si dhe kam dhënë vendimin pa u shprehur më parë Prokuroria në lidhje me përfundimin e procedimit penal nr.528/2019 lidhur me plagosjen në vendin e punës, të paditësit E.Miri.

Komisioni ka administruar fashikullin e çështjes gjyqësore me padites Edmir Miri etj, të paditur shoqërinë "Alart"shpk, objekt "detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësve dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe jopasuror për aksidentin me plagosje në punë me datë 05.03.2019.

Komisioni konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqesore rezultoi se paditësi Edmir Miri, ka qënë i punësuar mbi bazën e kontratës individuale të punës, pranë shoqërisë "Alar" shpk dhe gjatë marrëdhënies së punës ai ka pësuar aksident me pasojë plagosjen. Për këtë ngjarje ka filluar procedimi penal nr.528/viti 2019.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për mungesën e njoftimit nga gjykata/subjekti i rivlerësimit lidhur me gjykimin në të cilin shoqëria "Alart" shpk kishte cilësinë e "të padituri", në përmbajtje të dosjes gjyqësore evidentohen:

- Urdhër dt.14.09.2020 "për kryerjen e veprimeve proceduriale lidhur me paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes dhe caktimin e seancës përgatitore", dërguar të padituri në adresën Melgushë Shkodër, kthyer nga Posta me shënimin "objekt i pakërkuar".

- Urdhër dt.05.10.2020 "për kryerjen e veprimeve proceduriale lidhur me paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes dhe caktimin e seancës përgatitore", dërguar të padituri në adresën Lagjia Kosmaç Rruga Nacionale Shkodër Lezhë, kthyer nga Posta me shënimin "larguar..subjekti është mbyllur".

-Nga procesverbalët e seancave gjyqësore të datave 5.10.2020 dhe 23.10.2020 rezulton se pala e paditur nuk është paraqitur, dhe subjekti i rivlerësimit ka vijuar me njoftimin e tyre në adresën e përcaktuar në QKB.

- Shpallje datë 23.10.2020 "për paraqitje në seancë gjyqësore". Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se Gjykata e ka të pamundur të njoftojë të padituri, pasi nuk ka një adresë të përcaktuar të vendbanimit të tij dhe në mbështetje të neneve 131,132,133 te K.Pr.Civile ka vijuar me shpallje për njoftimin e seances duke e afishuar atë në ambientet e Gjykatës, në bashki, pranë QKR, në adresën Lagjia Kosmaç, Rruga Nacionale Shkodër Lezhë.

Subjekti i rivlerësimit ka vijuar me caktimin e ekspertëve dhe në datë 12.02.2021 ka vendosur pranimin e padisë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur "Alart"shpk, duke pretenduar se Gjykata ka kryer njoftimin e të padituri në një adresë në të cilën aktiviteti i saj

është pezulluar si dhe ka gjykuar çështjen pa pritur përfundimin e hetimeve të kryera nga prokuroria në lidhje me këtë ngjarje.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit kërkoi informacion nga Prokuroria lidhur me fazën e hetimit të procedimit penal dhe në vijim pezulloi gjykimin deri në përfundimin e hetimeve për procedimin penal nr.528/2019, bazuar në parashikimet e nenit 297/a të K.Pr.C.

Subjekti ka administruar në dosjen gjyqësore, disa akte të procedimit penal nr.528/2019, por nuk ka pezulluar gjykimin në perputhje me nenin 297/a të K.Pr.Civile ku parashikohet se: *Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: (a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative*;
 Për sa më sipër duket se subjekti ka vijuar gjykimin pa u zgjidhur më parë çështja penale duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të K.Pr.Civile, për pasojë janë cënuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Lidhur me këtë të dosje kam për të thënë sa më poshtë:

<u>Së pari</u>: Për këtë ankesë, ka hetuar mbi të njëjtat pretendime edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me vendimin nr. 1812/3, datë 30.07.2021 të ILD, kjo ankesë është hedhur poshtë si e pabazuar duke mos i konsideruar faktet e ekspozuara përmes saj, as të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor. Këtë vendim të ILD e kam dorëzuar si provë.

Unë nuk kam çfarë t'i shtoj shumë, në pikpamje të argumentimit ligjor, arsyetimit të një organi të drejtësisë së re, sikurse është ILD. Për më tepër që vendimi i këtij organi, ka marrë formë të prerë dhe për rrjedhojë është bërë pjesë e rendit juridik duke mos patur më mundësi ligjore për cënimin e tij.

Gjithsesi i lutem Kolegjit që në shqyrtimin e kësaj çështjeje të respektojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe të mos marrë përsipër që të gjykojë meritat e çështjes. Një veprim në të kundërt do të binte ndesh me nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repunlikën e Shqipërisë", që parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes* së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye".

Gjithashtu, ftoj Kolegjin që të ketë parasysh standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër. Në çmuarjen time, Komisioni shkel kompetencat e tij, kur në mënyrë të hapur ose të nënkuptuar merr përsipër të vlerësojë drejtësinë e vendimeve të ndërmjetme apo ndoshta edhe të vendimit përfundimtar. Po ashtu kur merr përsipër të japë vlerësim mbi mënyrën se si duhej të bëhej hetimi gjyqësor i çështjes. Ky kapërcim kompetencash është akoma më i qartë po të konsiderohet edhe neni 36/3 të KPC që parashikon se "*Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata*". Çështja për të cilën më kërkohen shpjegime, është akoma në

Gjykatën e Apelit Shkodër, prandaj si unë përmes këtij trajtimi ashtu edhe organet e rivlerësimit, duhet të tregohemi të përmbajtur në trajtimin e rastit.
Së dyti: Pavarësisht nga qëndrimi i mësipërm, vlerësoj se intepretimi që i bën Komisioni përmbajtjes së nenit 297 "a" të KPC, ku parashikohet se "*Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: (a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative*", është jo i drejtë.

(Madje, sikurse e kam evidentuar edhe në përmbajtje të këtij ankimi, duket se i vendos anëtarët e trupës gjykuese të Komisionit, në kushtet e konfliktit të interesit[61]).

Ky interpretim është jo i drejtë pasi sikurse Komisioni e di, intepretimi primar i normës, është ai literal (gjuhësor). Vetëm kur ky intepretim çon në kuptime të palogjikshme të normës ose të paqarta, apo në kuptime që janë në kundërshtim me parimet e gjithëditura të të drejtës, atëherë zbatohen llojet e tjera të intepretimit ligjor, që janë ai krahasimor, sintetik, teleologjik, ad contrario, etj.
Me intepretim gjuhësor, vihet re qartësisht se në shkronjën "a" të nenit 299 të KPC, përdoret folja "mund". Kjo folje nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të Gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj, të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit.
Duke patur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit e Gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet deri sa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brëndshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes.

Unë mendoj se Komisioni, nuk mund të hynte këtu pasi në të kundërt i bie se ka vepruar në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repunlikën e Shqipërisë", që sikurse u tha parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".

Në vlerësimin tim, ushtrimi i diskrecionalitetit gjyqësor për të vendosur se duhet të pezullohet gjykimi i një çështje civile, deri sa të zgjidhet një çështje penale, duhet të përbëjë jo rregull, por përjashtim nga rregulli. Kjo pasi në parim, Kolegji besoj bie dakort me mua, se pushteti gjyqësor i dhënies së drejtësisë, për shkak të natyrës së tij, si rregull, nuk ushtrohet me delegim tek pushtetet e tjera.

Në rastet përjashtimore kur Gjykata vendos t'a ushtrojë me delegim pushtetin shtetëror që i ka dhënë kushtetuta dhe ligji, ajo duhet të tregohet e kujdesshme që t'a argumentojë këtë delegim subtancial kompetence për të dhënë drejtësi, sipas parimit të objektivitetit, pra me tregimin e rrethanave komplekse të faktit apo të ligjit, të cilat nuk e lejojnë atë që t'a zgjidhë vetë çështjen. Pra, Gjykata, në rastin që përbën objektin e shpjegimit tim, do duhet të tregonte konkretisht, se cili është apo janë veprimi/veprimet hetimore që nuk mund ti kryejë ajo, (Gjykata civile), por që mund t'i kryejnë vetëm organet e juridiksionit gjyqëësor penal. Në rastin konkret nuk ka asnjë veprim të tillë që nuk mund të kryhet nga vetë Gjykata civile. Prandaj nuk ka qënë nevoja e

[61] Unë kam paraqitur kallzim në SPAK ndaj Komisionerëve dhe kam kërkuar pezullimin e gjykimit, kërkesë kjo që nuk është pranuar. Për më tepër shih pjesën e titulluar "shkaqet e ankimit".

delegimit substancial të kompetencës time si gjyqtar për të zgjidhur çështjen, tek organet e juridiksionit gjyqësor penal.

Unë vlerësoj se gjykimi i një çështje civile duhet të pezullohet deri sa të gjykohet një çështje tjetër, vetëm kur ekziston si domosdoshmëri për të respektuar parimin e sigurisë juridike, ose kur ekziston pamundësia faktike apo ligjore e zgjidhjes së çështjes, pa u zgjidhur paraprakisht çështja tjetër.

Në rastin konkret, unë kam vlerësuar dhe vlerësoj se nuk është cënuar nga zgjidhja që unë i kam dhënë çështjes, parimi i sigurisë juridike. Këtë bindje e kam patur dhe e kam edhe duke patur parasysh nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale që parashikon se "1. *Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përsa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. 2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër* ". Në rastin objekt gjykimi, paditësit nuk kanë pretenduar shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga pala e paditur, mbi shkakun se pala e paditur ka kryer veprën penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, por mbi shkakun se sjellja e palës së paditur që ka dëmtuar punëmarrësin e saj, bie në kundërshtim me Kodin e Punës, (pavarësisht se mund të përbëjë ose mund të mos përbëjë vepër penale).

Përgjegjësia penale dhe përgjegjësia civile për shpërblimin e dëmit, nuk janë e njëjta gjë. Ndërsa përgjegjësia penale është gjithmonë përgjegjësi me faj, dhe i pandehuri nuk është i detyruar që të provojë pafajësinë e tij, në rastin e përgjegjësisë civile për shpërblimin e demit jashtëkontraktor, është i padituri që sipas neneve 608 dhe 609 të Kodit Civil, duhet të provojë pafajësinë e tij. Nëse nuk e provon pafajësinë e tij, i padituri konsiderohet përgjegjës. Kjo provueshmëri pafajësie nuk ka ndodhur në gjykimin për të cilin po jap shpjegim, pasi pala e paditur nuk u paraqit fare në gjykim, ndonëse kishte dijeni të rregullt.

Përveç kësaj, rasti objekt për të cilin po jap shpjegim, nuk kishte lidhje me çështjen penale edhe për një fakt të thjeshtë. Ky rast, qartësisht, përfshihet në rastet e përgjegjësisë objektive, të parashikuar nga neni 622 i Kodit Civil, që ka këtë përmbajtje "Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin
e dëmit". Në kushtet kur pala e paditur nuk u paraqit fare në gjykim, qartësisht nuk duhej pezulluar gjykimi, për sa kohë kjo palë, nuk e përmbushi barrën e provës që i ngarkon ligji. Aq më pak mund të pezullohej gjykimi, kur pala nuk e ka kërkuar atë përpara Gjykatës.

Në vlerësimin tim, edhe Gjykata e Apelit, që ka pezulluar gjykimin e çështjes, ka vepruar gabim. Kjo pasi në kushtet kur pezullimi i gjykimit, nuk është kërkuar në gjykimin e shkallës së parë, është e diskutueshme në këndvështrim të zbatimit të nenit të 459/2 të KPC, nëse kjo kërkesë mund të parashtrohet për herë të parë dhe fillestare vetëm gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Në këtë dispozitë përcaktohet se "2. Në ankim nuk mund të parashtrohen kërkime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të pare ".

Gjithsesi, vlerësoj se çështja se si Gjykata e Apelit (por edhe Gjykata e Shkallës së Parë) e zhvillon hetimin gjyqësor të çështjes, është çështje e bindjes së brëndshme të saj, dhe për rrjedhojë ajo në zbatim të nenit 3 të ligjit 96/2016, nuk mund të ketë asnjë lloj ndikimi të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë në këtë drejtim. Kjo ka të bëjë me pavarësinë e bindjes së brëndshme të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Komisioni në vendim në lidhje me këtë çështje mban qëndrimin se:

*85.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se fakti që kjo çështje është trajtuar nga ILD-ja nuk e përjashton mundësinë e Komisionit për vlerësimin e saj, pasi kompetencat e dy institucioneve nuk janë të njëjta. Për më tepër ILD-ja, në vendimin e saj nr. ***, datë 30.7.2021, shprehet se kjo ankesë mund të jetë objekt i shqyrtimit të mëtejshëm pas përfundimit të gjykimit 128 , nëse konstatohen nga kontrolli gjyqësor shkelje të ligjit procedural apo material.*

85.9. Në lidhje me pretendimet e subjektit se Komisioni ka shqyrtuar meritën e çështjes, pretendime të cilat nuk qëndrojnë, pasi subjektit nuk i ka kaluar barrë prove për vendimmarrjen, por vetëm për faktin e mospezullimit të procesit gjyqësor, për sa kohë në këtë vendim gjykata referohet në provat e fashikullit penal129 . Pra, vetë subjekti referon në një procedim penal, ndërkohë pretendon se ky procedim penal nuk kishte lidhje me çështjen që po shqyrtohej nga ana e tij. 85.10. Në lidhje me pretendimin e subjektit se në nenin 299 të Kodit të Procedurës Civile (subjekti ka bërë lapsus kur i është referuar nenit 299, pasi është neni 297 i Kodit të Procedurës Civile), folja "mund" nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj, Komisioni çmon se edhe ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi në këtë nen folja "mund" shoqërohet me pjesëzën mohuese "nuk", e cila përdoret për të mohuar plotësisht kuptimin e shprehur nga një folje. 128 Shihni f. 3 të vendimit nr. 1812/3, paragrafi i fundit. 129 Shihni f. 2 të vendimit, ku, ndër të tjera subjekti shprehet: "...nga deklarimet dhe hetimi i bërë nga ana e prokurorisë rezulton se...".

85.11. Për sa i përket mosparaqitjes së kërkesës nga ana e palës së paditur, ky pretendim i subjektit qëndron, por ndërkohë kjo nuk e përjashton nga përgjegjësia subjektin për të vlerësuar nëse ishin kushtet për pezullimin e çështjes apo jo, për sa kohë nga ana e tij ishte në dijeni të faktit që kishte një procedim penal dhe akte të këtij procedimi i përmend si prova në këtë çështje gjyqësore.

85.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti ka përdorur akte të fashikullit penal në procesin e tij civil, si dhe ka konkluduar se kemi të bëjmë me shkelje të rregullave të sigurimit në punë, ai nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje derisa të përfundonte procedimi penal. Këto veprime të subjektit tregojnë mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

Unë vlerësoj se ky qëndrim i Komisionit është jo vetëm voluntarisht dhe keqdashës por gjithashtu edhe i gabuar. Duke mos dashur të zgjatem bëj me dije Kolegjin se i qëndroj shpjegimeve dhe argumentimeve të mia të sipërcituara si dhe ato që kam përmëndur në pjesën

"shkaqet e ankimit", të titulluar "së pesëmbëdhjeti", shih fq 40 - 45, si dhe të titulluar "së shtatëmbëdhjeti", shih fq 49.

3. Mark Kulla (nr.2253 prot. datë 03.03.202020; nr.322 prot. datë 18.01.2021+69) Nadire Kullolli (nr.1610 prot. date 05.02.2020; nr.2254 prot. date 03.03.2020; nr.317 prot. date 18.1.2021).

Nga raporti rezulton se:

1. Denoncuesi Mark Kulla sqaron se me Vendimin nr.5112 datë 24.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesë padinë e paditësit Dul Hysa dhe ka rrëzuar kundërpadinë e tij. Aktualisht çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër.
Denoncuesi kërkon që përmes kësaj ankese të merret në shqyrtim vendimi i ndërmjetëm i subjektit për rrëzimin e kërkesës së tij për "pezullimin e gjykimit të çështjes" pas kallëzimit të bërë nga denoncuesi në ngarkim të paditësit Dul Hysa për veprën penale të "Fallsifikimit të dokumentave". Denoncuesi sqaron se procedimi penal nr.483, datë 02.03.2018 mbi bazë të së cilit është kërkuar edhe pezullimi i gjykimit, vijon të jetë në hetim mbas dy vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilat kanë prishur vendimet e pushimit të hetimeve në lidhje me fallsifikimin e dokumentacionit të përdorur në gjykimin civil.

2. Në ankimin e saj denoncuesja Nadire Kullolli sqaron se ka patur cilësinë e "personit të tretë" në gjykimin me paditësit Dul Hysej e të padituri Mark e Pllumb Kulla, me objekt "detyrimin e njohjes pronar me parashkrim fitues". Ajo sqaron se kjo çështje është gjykuar fillimisht nga një tjetër gjyqtar.
Pasi pala paditëse ka kërkuar të heqë dorë nga thirrja në cilësinë e personit të tretë të denoncueses, kërkesa është shqyrtuar dhe pranuar nga gjykata. Pasi gjyqtari i çështjes u trasferua në një tjetër gjykatë, çështja i kaloi subjektit të rivlerësimit me statusin "e pezulluar". Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit duhet t'a kishte thirrur atë në cilësinë e personit të tretë për shkak të mbivendosjes së pronës së saj me pronat objekt gjykimi.

i. Komisioni ka administruar fashikullin e çështjes gjyqësore që i përket palëve:
Paditës/i kundërpaditur: Dul Hysaj; Të paditur/kundërpaditës: Mark Kulla etj; objekt padie : kthim sendi, njohje pronar me parashkrim fitues.

Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit gjyqësor rezulton se:
- Në kërkesë padi në cilësinë e të padituri përveç shtetasve Mark dhe Pëllumb Kulla është thirrur dhe shtetësja Nadire Kullolli.
Nga verifikimi i akteve në fashikullin gjyqësore konstatohet se në datë 21.03.2017 një subjekt tjetër rivlerësimi ka vendosur pranimin e kërkesës së palës paditëse duke hequr si palë të paditur znj. Nadire Kullolli. Nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara nga subjekti znj. Nadire Kullolli rezulton si e paditur, por ndërkohë nuk relatohet njoftimi apo prezenca e saj në proces.

- Çështja ka vijuar të jetë e pezulluar deri më datë 25.01.2019, datë në të cilën subjekti ka urdhëruar njoftimin e palëve për seancën e radhës gjyqësore.

- Nuk gjendet vendimi i subjektit për revokimin e vendimit të pezullimit të gjykimit të çështjes gjyqësore.
- Gjendet i administruar Vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 164 datë 04.06.2018 sipas së cilit është prishur vendimi i mosfillimit të procedimit penal inicuar me kallzim penal nr.483/2018 të Z. Mark e Pllumb Kulla ndaj z. Dul Hysa dhe është urdhëruar prokuroria të regjistroj prcoedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallzim.

- Gjatë gjykimit të kësaj çështje, në datë 04.03.2019, përfaqësuesja e palës së paditur (denoncuesit) ka paraqitur kërkesat e mëposhtme:

• Kërkesë për "pezullimin e gjykimit të çështjes" me argumentin se të padituri kanë paraqitur pranë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, kallëzimin penal nr.483 datë 2.3.2018 për veprën penale "fallsifikim të dokumentave". Në këtë kërkesë, përfaqësuesja e të padituréve informon gjykaten se Prokuroria ka vendosur "mosfllimin e procedimit penal", ndaj të cilit është ushtruar ankim në gjykatë. Me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër, është urdhëruar vazhdimi i hetimeve dhe kjo çështje penale vijon të jetë në hetim nga Prokuroria e Rrethit Shkodër.

• Kërkesë "për konstatimin e fallsifikimit të dokumentit" përmes së cilës kërkuesi informon gjykatën se një pjesë e dokumentave të depozituara nga pala paditëse në këtë proces civil janë objekt hetimi në çështjen penale nr.483 datë 2.3.2018. si pasojë, ai kërkon konstatimin e fallsitetit të këtyre dokumentave.
Në lidhje me këto dy kërkesa nuk gjendet në fashikull vendim i ndërmjetëm i subjektit të rivlerësimit.

- Në vendimin përfundimtar nr.512 datë 24.4.2019 subjekti i rivlerësimit është shprehur si më poshtë në lidhje me kërkesat e mësipërme:

Gjykata i vlerëson si të papranueshme pretendimet e ndërgjyqësve Kulla, lidhur me fallsitetin e vendimit të K.K.K.P Shkodër dhe notës së transkriptimit pasi këto pretendime nuk u mbështeten në prova nga ana e paditësit. Marrja në konsideratë e këtyre pretendimeve/prapësimeve bie në kundërshtim me parimin e "gjësë së gjykuar", pasi po të merren në konsideratë vihen në diskutim fakte krijuese të pranuara me një vendim gjyqësor të formës së prerë që është vendimi i vitit 2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Sipas jurisprudencës së konsoliduar gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, fuqia detyruese e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kuptimin procedurial, mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit gjyqësor por gjithashtu edhe pjesën arsyetuese të tij. Sipas vlerësimit të Gjykatës, fallsitetet e pretenduara nga të padituri përbëjnë gjë të gjykuar të nënkuptuar, që nuk ekzistojnë. Kjo mosekzistencë përbën fakt juridik të pranuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë, dhe nuk mund të vihet në bisedë përsëri në këtë gjykim. Kërkesat për pezullimin e gjykimit, gjykata i ka konsideruar si të paligjshme pasi ndërgjyqësit Hysej, sendin objekt gjykimi e kanë fituar përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Përsa kohe nuk ka ndonjë procedurë ligjore që të vihet në diskutim ligjshmëria e këtij vendimi, atëherë rezultatet e këtij gjykimi nuk ndërvaren nga ndonjë çështje tjetër.

Në lidhje me argumentimin e subjektit se paditësat pronësinë e kanë fituar nëpërmjet një vendimi gjyqësor, ky argumentim nuk qëndron pasi në vendimin nr.1388 datë 11.12.2001 është vendosur ndryshimi i vendimit të K.K.K Pronave të Bashkisë Shkodër duke u ndryshuar sipërfaqe e pronës së kthyer për shkak të njësisë matëse.

Në përfundim duket se:
 Subjekti ka vijuar gjykimin pa u zgjidhur më parë çështja penale duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të K.Pr.Civile, për pasojë janë cënuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.
 Subjeki nuk ka nxjerrë vendim për rifillimin e gjykimit të çështjes gjyqësore.
 Subjekti nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gjyqësore pasi shkaku për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të K.Pr.Civile.
 Subjekti nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e fallsifikimit të dokumentit.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Në lidhje me konstatimet dhe vlerësimet e Komisionit, kam për të thënë sa më poshtë:

Së pari: Për këtë ankesë, ka hetuar mbi të njëjtat pretendime edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me vendimin nr. 807 prot, datë 12.02.2021 të ILD, kjo ankesë është hedhur poshtë si e pabazuar duke mos i konsideruar faktet e ekspozuara përmes saj, as të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor. Këtë vendim të ILD po jua dorëzoj si provë.
Unë nuk kam çfarë t'i shtoj shumë, në pikpamje të argumentimit ligjor, arsyetimit të një organi të drejtësisë së re, sikurse është ILD. Për më tepër që vendimi i këtij organi, ka marrë formë të prerë dhe për rrjedhojë është bërë pjesë e rendit juridik duke mos patur më mundësi ligjore për cënimin e tij.
Komisioni nuk ka respektuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe ka marrë përsipër që të gjykojë meritat e çështjes. Një veprim në të kundërt do të binte ndesh me nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repunlikën e Shqipërisë", që parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim I drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".
Gjithashtu, ftoj Komisionin që të ketë parasysh standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër. Në çmuarjen time, Komisioni shkel kompetencat e tij, kur në mënyrë të hapur ose të nënkuptuar merr përsipër të vlerësojë drejtësinë e vendimeve të ndërmjetme apo ndoshta edhe të vendimit përfundimtar. Po ashtu kur merr përsipër të japë vlerësim mbi mënyrën se si duhej të bëhej hetimi gjyqësor i çështjes. Ky kapërcim kompetencash është akoma më i qartë po të konsiderohet edhe neni 36/3 të KPC që parashikon se "*Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata*".

Së dyti: Vendimi i dhënë nga unë, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. Ky vendim akoma nuk është zbardhur por unë po iu dorëzoj si provë një kopje të shkurtuar të dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Fakti që vendimi im është lënë në fuqi nga Gjykata e

Apelit Shkodër, ka shumë rëndësi. Kjo pasi sipas nenit *102, paragrafi 2 të ligjit 96/2016, përbën shkelje disiplinore të magjistratit "a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë* ".
Në kuptim të kësaj dispozite ligjore, nuk mund të thuhet se unë kam gabuar në legjislacionin procedural, për sa kohë një Gjykatë më e lartë, ka lënë në fuqi vendimin tim.

Së treti: Pretendimet për fallsifikim, janë hedhur poshtë me vendimin gjyqësor penal nr. 260, date 15.11.2021 të Gjykatës së Apelit Shkdoër, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 1740 (3717), datë 12.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Këtë vendim gjithashtu po ua dorëzoj si provë. Kjo tregon se pretendimet e fallsifikimit, nuk kanë qënë të bazuara, dhe në bindjen time janë paraqitur vetëm për të zvarritur gjykimin e çështjes për të cilën unë kam dhënë vendimin për të cilin po shpjegohem.

Së katërti: Lidhur me vlerësimin e Komisionit se do duhej të pezulloja gjykimin deri sa të zgjidhej çështja penale, nuk jam dakort. Kjo pasi, sikurse u shpreha edhe më sipër, vlerësoj se intepretimi që i bën Komisioni përmbajtjes së nenit 297 "a" të KPC, ku parashikohet se "*Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: (a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative*", është jo i drejtë. Ky interpretim është jo i drejtë pasi sikurse Komisioni e di, intepretimi primar i normës, është ai literal (gjuhësor). Me intepretim gjuhësor, vihet re qartësisht se në shkronjën "a" të nenit 299 të KPC, përdoret folja "mund". Kjo folje nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të Gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj, të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit.
Duke patur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit e Gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet deri sa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brëndshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes.
Unë mendoj se Komisioni, nuk mund të hyjë këtu pasi në të kundërt do vepronte në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repunlikën e Shqipërisë", që sikurse u tha parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".
Në vlerësimin tim, ushtrimi i diskrecionalitetit gjyqësor për të vendosur se duhet të pezullohet gjykimi i një çështje civile, deri sa të zgjidhet një çështje penale, duhet të përbëjë jo rregull, por përjashtim nga rregulli. Kjo pasi në parim, Komisioni besoj bie dakort me mua, se pushteti gjyqësor i dhënies së drejtësisë, për shkak të natyrës së tij, si rregull, nuk ushtrohet me delegim tek pushtetet e tjera. Në rastet përjashtimore kur Gjykata vendos t'a ushtrojë me delegim pushtetin shtetëror që i ka dhënë Kushtetuta dhe ligji, ajo duhet të tregohet e kujdesshme që t'a argumentojë këtë delegim subtancial kompetence për të dhënë drejtësi, sipas parimit të objektivitetit, pra me tregimin e rrethanave komplekse të faktit apo të ligjit, të cilat nuk e lejojnë atë që t'a zgjidhë vetë çështjen. Pra, Gjykata, në rastin që përbën objektin e shpjegimit tim, do duhet të tregonte konkretisht, se cili është apo janë veprimi/veprimet hetimore që nuk mund ti kryejë ajo, (Gjykata civile), por që mund t'i kryejnë vetëm organet e juridiksionit gjyqësor penal. Në rastin konkret nuk ka asnjë veprim të tillë që nuk mund të kryhet nga vetë Gjykata civile. Kjo pasi sikurse kam arsyetuar në përmbajtjen e vetë vendimit që po jap shpjegim, dhe që citohet nga vetë Komisioni,

(“ *ommisis....Gjykata i vlerëson si të papranueshme pretendimet e ndërgjyqësve Kulla, lidhur me fallsitetin e vendimit të K.K.K.P Shkodër dhe notës së transkriptimit pasi këto pretendime nuk u mbështeten në prova nga ana e paditësit. Marrja në konsideratë e këtyre pretendimeve/prapësimeve bie në kundërshtim me parimin e “gjësë së gjykuar”, pasi po të merren në konsideratë vihen në diskutim fakte krijuese të pranuara me një vendim gjyqësor të formës së prerë që është vendimi i vitit 2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Sipas jurisprudencës së konsoliduar gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, fuqia detyruese e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kuptimin procedurial, mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit gjyqësor por gjithashtu edhe pjesën arsyetuese të tij.*
Sipas vlerësimit të Gjykatës, fallsitetet e pretenduara nga të padituri përbëjnë gjë të gjykuar të nënkuptuar, që nuk ekzistojnë. Kjo mosekzistencë përbën fakt juridik të pranuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë, dhe nuk mund të vihet në bisedë përsëri në këtë gjykim. Kërkesat për pezullimin e gjykimit, gjykata i ka konsideruar si të paligjshme pasi ndërgjyqësit Hysej, sendin objekt gjykimi e kanë fituar përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Përsa kohe nuk ka ndonjë procedurë ligjore që të vihet në diskutim ligjshmëria e këtij vendimi, atëherë rezultatet e këtij gjykimi nuk ndërvaren nga ndonjë çështje tjetër”.
Prandaj nuk ka qënë nevoja e delegimit substancial të kompetencës time si gjyqtar për të zgjidhur çështjen, tek organet e juridiksionit gjyqësor penal. Nëse komisioni ka qëndrim të kundërt më këtë pjesë të arsyetimit të vendimit tim, kam vlerësimin se dakortësia ose mosdakortësia e komisioni me këtë pjesë të arsyetimit, ka të bëjë me meritat e zgjidhjes së çështjes, dhe vlerësuesi, sipas ligjit 84/2016 por edhe sipas ligjit 96/2016, nuk mund të hyjë këtu pasi në të kundërt, cënon jo vetëm pavarësinë e pushtetit gjyqësor por edhe standartin detyrues të vendosur me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër. Aq më shumë, se sikurse u tha më sipër, vendimi im është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, pra ka dalë i pacënuar nga kontrolli gjyqësor i ushtruar nga Gjykatat më të larta. Gjithashtu, është shqyrtuar edhe nga ILD dhe është gjetur pa asnjë shkelje.

<u>Së pesti</u>: Nuk jam dakort me Komisonin kur bën vlerësimin dhe konstatimin se “Në lidhje me argumentimin e subjektit se paditësat pronësinë e kanë fituar nëpërmjet një vendimi gjyqësor, ky argumentim nuk qëndron pasi në vendimin nr.1388 datë 11.12.2001 është vendosur ndryshimi i vendimit të K.K.K Pronave të Bashkisë Shkodër duke u ndryshuar sipërfaqe e pronës së kthyer për shkak të njësisë matëse ”. Kjo është çështje e pavarësisë time si gjyqtar në intepretimin e fakteve dhe ligjit. Po ashtu edhe e Gjykatës së Apelit Shkodër. Sikurse e thashë më sipër, as ndonjë vlerësues dhe as Komisioni nuk mund të hyjnë këtu. Mëgjithatë, arsyetimi im është i drejtë. Kjo pasi si vendimi i KKKP ashtu edhe vendimi i Gjykatës së e ka ndryshuar atë, janë që të dyja mënyra origjinale të fitimit të pronësisë. Pra vlerësimi në fjalë i Komisionit, nuk ka pikën e relevancës në zgjidhjen e çështjes. Unë kam dyshimin se duke u nisur nga ky konstatim/vlerësim i shprehur nga Komisioni, në raport, Komisioni ose nuk e kupton ose dëshiron të duket se nuk e kupton arsyetimin e vendimit, të cilin ai faktikisht e kupton shumë mirë.

<u>Së gjashti</u>: Nuk jam dakort me Komisonin kur bën vlerësimin dhe konstatimin se “Subjekti nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e fallsifikimit të dokumenti. Ky qëndrim i Komisionin bie ndesh me ligjin. Konkretisht në nenin 171/a, paragrafi 3 të KPC parashikohet se: “Gjykata drejton procesin

gjyqësor nëpërmjet vendimeve dhe urdhrave. Vendimet dhe urdhrat e shpallura në seancë gjyqësore quhen të njohura nga palët e pranishme ose që duhej të paraqiteshin në gjykatë. Vendimet e shpallura jashtë seancës dhe ato, ndaj të cilave lejohet ankim i veçantë u komunikohen palëve të interesuara nga sekretari i seancës jo më vonë se tre ditë nga shpallja e tyre ". Nga kjo dispozitë ligjore duket qartë se unë kam patur detyrimin për të nxjerrë vendime të ndërmjetme të zbardhura, vetëm për vendime të marra jashtë seance ose kur për këto ligji parashikon ankim të veçantë. Vendimet për të cilat bën fjalë Komisioni, nuk janë as njëra dhe as tjetra. Faktikisht, për këto kërkesa unë kam marrë vendime të ndërmjetme, por ato i janë njoftuar palëve në seancë, sipas nenit 171/a paragrafi e të KPC që u përmënd më sipër.

<u>Së shtati</u>: Nuk jam dakort me Komisonin kur bën vlerësimet dhe konstatimet se "*Subjeki nuk ka nxjerrë vendim për rifillimin e gjykimit të çështjes gjyqësore. Subjekti nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gjyqësore pasi shkaku për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të K.Pr.Civile* ". Kjo pasi, vendimi i pezullimit të gjykimit dhe vendimi i revokimit të pezullimit, janë vendime të ndërmjetme sipas nenit 125 të KPC që parashikon se "Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi ".
Duke qënë vendime të ndërmjetme, ato e humbasin fuqinë juridike ipso lege, kur janë kushtet për t'u zbatuar neni 181, paragrafi 2 i KPC që parashikon se "Kur për shkaqe të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari ose anëtarët e rinj duhet të njihen me përmbajtjen e procesit gjyqësor. Anëtari ose anëtarët e rinj mund të kërkojnë që hetimi gjyqësor të përsëritet pjesërisht ose tërësisht ".
Sikurse Komisioni e ka parë nga dosja, vendimi i pezullimit të gjykimit është bërë nga gjyqtari i mëparshëm. Më largimin e tij nga gjykimi dhe caktimin tim si gjyqtar i çështjes, ka qënë e drejta ime sipas nenit 181/2 të KPC, për të konvaliduar ose jo duke i përsëritur veprimet e gjyqtarit të mëparshëm.
Pra duke vendosur vlerësuar fillimin e gjykimit nga fillimi, me ometim kam mbajtur qëndrim të ndryshëm me gjyqtarin e mëparshëm, gjë që përsëri është e drejtë e imja sipas nenit 3 të ligjit 96/2016 që sikurse e thashë më sipër përcakton Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye".
Gjithashtu, edhe për këtë pikë, qëndrojnë argumentet që thashë më sipër se dakortësia ose mosdakortësia e komisioni me këtë qëndrim timin për të filluar gjykimin nga e para, ka të bëjë me meritat e zgjidhjes së çështjes, dhe vlerësuesi (Komisioni), sipas ligjit 84/2016 por edhe sipas ligjit 96/2016, nuk mund të hyjë këtu pasi në të kundërt, cënon jo vetëm pavarësinë e pushtetit gjyqësor por edhe standartin detyrues të vendosur me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër. Aq më shumë, se sikurse u tha më sipër, vendimi im është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, pra ka dalë i pacënuar nga kontrolli gjyqësor i ushtruar nga Gjykatat më të larta. Gjithashtu, është shqyrtuar edhe nga ILD dhe është gjetur pa asnjë shkelje.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioni mban qëndrimin se:

86.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

*i) Për sa i përket pretendimit se kjo çështje është trajtuar më parë nga ILD-ja, përveç sa është çmuar në pikën 85.8 të këtij vendimi, konstatohet se ILD-ja, në faqen 6, paragrafi 3 i vendimit nr. ***, datë 12.2.2021, analizon vetëm pretendimet e ankueses për korrupsion të subjektit.*

ii) Në lidhje me pretendimin se, meqenëse ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, ai nuk mund të jetë pjesë e vlerësimit profesional, çmohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për themelin e çështjes apo për veprime procedurale që prekin themelin e çështjes.

*iii) Gjithashtu, Komisioni vlerëson se edhe pretendimi i subjektit se është trajtuar themeli i gjykimit të tij, nuk qëndron, pasi barra e provës nuk ka pasur të bëjë me vendimmarrjen, por me veprime procedurale të tij, të cilat vlerësohet se prekin kriteret e vlerësimit profesional të parashikuar nga neni 71 e në vijim të ligjit nr. 96/2016. 86.7. Më konkretisht, nga ana e subjektit është vijuar gjykimi pa u zgjidhur më parë çështja penale, duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile, për pasojë janë cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt. Subjekti ka pretenduar se është në diskrecion të tij të vendosë ose jo pezullimin, si dhe pretendimet për falsifikim janë hedhur poshtë me vendimin gjyqësor penal nr. ***, datë 15.11.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër.*

86.8. Komisioni ka konstatuar se nga ana e subjektit është vijuar gjykimi pa u nxjerrë më parë vendimi për rifillimin e gjykimit, si dhe pa u argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gjyqësore, pasi shkaku për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile.

86.9. Subjekti pretendon se, për sa kohë është ndryshuar trupi gjykues, ai ka pasur të drejtë që hetimi gjyqësor të përsëritej tërësisht ose pjesërisht. Ky pretendim i subjektit është i drejtë, por në rastin kur çështja gjyqësore shqyrtohet nga një trup gjykues, ndërkohë, në rastin në fjalë çështja gjyqësore po gjykohej vetëm nga një gjyqtar, i cili kishte marrë vendim të ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit. Për rrjedhojë, subjekti, në cilësinë e gjykatës, kishte detyrimin ligjor që në bazë të nenit 315 të Kodit të Procedurës Civile të vendoste revokimin e këtij vendimi dhe rifillimin e gjykimit. Nga ana e subjektit, në këtë rast, nuk është vepruar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, pasi ai nuk ka marrë asnjë vendim për revokimin e vendimit të pezullimit dhe të rifillimit të gjykimit. Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 – të arsyetimit ligjor në kuptim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të gjykimit, si dhe të aftësive organizative, në kuptim të nenit 74/3 të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka nxjerrë vendimet e ndërmjetme, duke mos kryer veprimet e nevojshme procedurale.

86.10. Subjekti nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e falsifikimit të dokumentit. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka pretenduar se ai ka pasur detyrime për të nxjerrë vendime të zbardhura vetëm për vendime të marra jashtë seance ose kur për këto ligji parashikon ankim të veçantë.

86.11. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi, bazuar në nenin 171/b të Kodit të Procedurës Civile, vendimet e ndërmjetme dhe urdhrat që jep gjykata në seancë gjyqësore duhet të arsyetohen dhe të mos paragjykojnë zgjidhjen e çështjes, për rrjedhojë, ai kishte detyrimin ligjor për të nxjerrë vendimin e ndërmjetëm, parashikuar edhe në nenin 182133 të Kodit të Procedurës Civile. Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, si dhe të aftësive organizative, në kuptim të nenit 74/3 të ligjit nr. 96/2016, pasi ai nuk ka nxjerrë vendimet e ndërmjetme, duke mos kryer veprimet e nevojshme procedurale.

Këto qëndrime të Komisionit i konsideroj abuzive dhe keqdashëse, (si shëmbull flagrant të keqashjes shih arsyetimin absurd dhe të paligjshëm të Komisionit të shprehur në paragrafin 86.9 se gjykimi fillon nga fillimi kur ndryshojnë dy gjyqtarë në trupin gjykues por jo gjyqtari kur çështja shqyrtohet me gjyqtar të vetëm). Unë i konsideroj të bazuara argumentimet e mia të mësipërme. Të Komisionit, kryekëput të paligjshme dhe arbitrare. Këto qëndrime në vetvete janë prova të pandershmërisë së komisionerëve në procesin tim të rivlerësimit.

Shpresoj që Kolegji t'i marrë parasysh shpjegimet e mia sipas parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Kjo veçanarisht për faktin se vendimi im është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. Pra jo vetëm që nuk ka ardhur ndonjë pasojë nga mospezullimi, por kanë ardhur pasoja pozitive për drejtësinë. Nëse nuk do të kisha vepruar kështu, jo vetëm do të kisha zbatuar gabim ligjin (sipas bindjes time), por sot kjo çështje do të ishte duke pritur radhën e gjykimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, pra akoma nuk do gjykohej, duke shkuar kështu kohëzgjatja e gjykimit rreth 8 vjet[62]. Pra duke u vënë në jetë parimi "Drejtësi e vonuar drejtësi e mohuar".

4. **Ariana Muja (nr.73 prot. datë 7.1.2019)**.

Nga raporti rezulton se:

1. Denoncuesja ankohet për dy subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin për të cilin pretendon se ka kryer proces jo të rregullt gjyqësor, pasi administroi në dosjen gjyqësore dokumenta të fallsifikuara për të cilat ishte bërë kallëzim penal edhe në Prokurori. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit vijoi gjykimin e çështjes me objekt "pjesëtim pasurie" pa pritur përfundimin e procesit penal.
2. Komisioni administroi kopje të fashikullit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me palë paditëse shtetasin Darling Muja (përfaqësuar në gjykim nga av.Lulzim Karini), palë të paditur Kleves Muja etj, me objekt "pjesëtimin e sendit të përbashkët".
3. Në seancën gjyqësore të datës 03.03.2016 paditësi dhe përfaqësuesi i tij, nuk janë paraqitur në gjykim dhe për pasojë subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e gjykimit. Nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 01.02.2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit është shprehur "..nuk u paraqit Av.Lulzim Karini, përfaqësuesi i paditësit. Av.Karini ka dërguar një sms..sipas sms-së përfaqësuesi i paditësit është i shtruar në spital në qytetin e Athinës. Komunikimi është zhvilluar dje në ora 12.13 min." Pasi palët kanë dakordësuar për shtyrjen e

[62] Çështja është marrë në rigjykim nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Shkodër, pasi Gjykata e Apelit Shkodër, përpara se t'a gjykoja unë çështjen e kishte prishur më parë vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë.

seancës subjekti ka vendosur "shtyrjen e seancës gjyqësore për të bërë njoftimin me letërthirrje të paditësit dhe përfaqësuesit të tij".

4. Kërkesë padia është paraqitur sërish nga paditësi Darling Muja në datë 03.05.2016, dhe gjyqtar i çështjes është caktuar sërish, subjekti i cili me vendimin datë 7.10.2016 ka vendosur "lejimin e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme" .

5. Në vijim, në datë 27.03.2018 bashkëpronarja Arjana dhe Rigela Muja ka kërkuar vijimin e fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë në natyrë. Me vendimin datë 07.12.2018 subjekti i rivlerësimit vendosi zhdukjen në fakt të bashkëpronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe pjesëtimin e saj në raportet përkatëse mes bashkëpronarëve. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga bashkëpronarët e paditur, të cilët në vijim kanë hequr dorë nga ankimi i paraqitur. Për pasojë, Gjykata e Apelit Shkodër vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes civile.
Nga shqyrtimi tërësor i fashikullit gjyqësor nuk rezulton që denoncuesja të ketë paraqitur pretendim për fallsifikim dokumentacioni dhe as kërkesë për pezullim gjykimi për shkak të një procesi penal.

6. Në lidhje me këtë denoncim përtej sa ka pretenduar ankuesja konstatohet se:

i. përfaqësues i njërit prej palëve në gjykim ka qënë z. Karini i cili sipas deklarimeve të subjektit ka qënë shok shkollë me të. Nga verifikimi i sistemit TIMS konstatohet se subjekti ka kryer disa udhëtime me z. Karini. Gjithashtu vetë subjekti në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 01.02.2016 është shprehur se z. Karini e ka njoftuar nëpërmjet sms se është i shtruar në spital një ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore. Nga të dhënat e mësipërme duket se subjekti ka marrëdhënie shoqërore me z. Karini marrëdhënie të cilat janë konfirmuar nga komisioni dhe nga hetimi i kryer i trajtuar më poshtë.

Në nenin 72 të K.Pr.Civile parashikohen rastet e përjashtimit të gjyqtarit si më poshtë:

1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;
2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose nga mbrojtësit;
3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;
4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërës apo tjetrës palë;
5. është kujdestar, punëdhënës i njërës prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim;
6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

ii. Nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit konstatohet se ai ka deklaruar si kontakt të përshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar shtetasin Kleves Muja ku ka deklaruar se ka patur kontakte me këtë shtetas gjatë vitit 2011-2012.
Për sa më sipër duket se:

 subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar këtë çështje, pasi përfaqësues i njërës prej palëve ka qënë një person që subjekti ka patur marrëdhënie shoqërore, si dhe njëra nga palët e paditura është deklaruar nga ana e tij si kontakt i papërshtatshëm në deklaratën e kontrollit të figurës.
 Gjithashtu ngrihen dyshime që subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse për sa kohë ka pranuar shtyrjen e seancës me kërkesë të dërguar me sms nga z. Lulzim Karini përfaqësues i palës paditëse, e cila nuk është një nga format e parashikuar nga K.Pr. Civle (pasi çdo kërkesë duhet të paraqitet në sekretarinë gjyqësore me shkrim shoqëruar me dokumentacion provues) si dhe ka vendosur në favor të kësaj pale.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Nga lidhje me këtë pjesë të raportit kam për të thënë se:

Së pari: Lidhur me konfliktin e supozuar të interesit me shtetasin Lulzim Karini, jam shprehur hollësisht në kriterin e figurës dhe për rrjedhojë e vlerësoj të padobishme të zgjatem. Në vlerësimin tim Komisioni trillon me dashje në këtë pikë, duke vendosur në themel të arsyetimit të tij, fakte të pavërteta, të paprovuara, në kundërshtim me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. Kjo bëhet me qëllim që të justifikohet gjoja ligjërisht dëshira e Komisionit për të zhvilluar procesin tim të rivlerësimit, në kundërshtim me standartet themelore të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, që janë "gjykimi i drejtë" dhe "gjykimi i paanshëm". Besoj se është e paarsyeshme të jam shpjegime më shumë për shpifje dhe trillime të kryera me dashje.

Së dyti: Lidhur me problematikën e shtetasit Kleves Muja, unë nuk kam patur asnjë marrëdhënie me këtë shtetas, që të mund t'a ndieja veten në konklikt interesi. Sikurse e kam deklaruar edhe në formularin e figurës të shqyrtuar nga DSIK, nuk kam patur miqësi ndonjëherë me këtë shtetas. Kontaktet e mia me të kanë qënë rastësore, madje aq të tilla, sa as nuk i mbaj mend. Pra, të tipit sikurse Komisioni ka konsideruar sms e komisionerit Roland Ilia, që ua prura si provë kur paraqita kërkesën për përjashtimin e tij nga gjykimi, "Andri, si je". (Faktikisht, këto sms të Rolandit, nuk ishin edhe aq rastësore, por meqë Komisioni ka frikë të gërmojë me tej, po e respektoj frikën e Komisionit).

Këto kontakte kanë qënë në kohën kur unë as kam patur dhe as mund të kisha patur dijeni për qënien e këtij shtetasi i dënuar. Ky shtetas, në kohën që unë kam patur kontaktet e rastësore në fjalë, ka qënë Kryetar i Komunës Rrethina. Aty ka punuar vëllai im Gerti Ymeri. Sapo unë dhe vëllai im kemi marrë dijeni, për shkak të punës time si Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi faktin që ky shtetas ka qënë i dënuar, menjëherë kemi ndërprerë çdo kontakt me të. Madje, vëllai im, me këshillën time, ka lënë menjëherë edhe punën në Komunën Rrethina, duke u distancuar qartë nga ky person. Sjellja ime ka qënë e përshtatshme dhe e kam deklaruar në formularin e figurës, deklarim të cilit i qëndroj plotësisht.

Përveç deklarimit tim në formularin e figurës, në procesin e rivlerësimit të motrës time, prokurores Ajola Prençi, ka qënë pjesë e trupës gjykuese edhe një nga komisioneret e trupës time gjykuese, dhe konkretisht komisionerja Firdes Shuli. Aty, në këtë proces të rivlerësimit të motrës time, komisionerja Firdes Shuli, ka hetuar hollësisht për llojin e kontaktit që kam patur unë me

shtetasin Kleves Muja, madje ka administruar edhe një dekleratë noteriale që kam lëshuar unë me kërkesën e motrës time Ajola Prençi, të cilën Komisionit i kërkoj t'a konsiderojë edhe për qëllimet e procesit tim të rivlerësimit. Gjithsesi, po ua bie vetë si provë. Në këtë dekleratë noteriale unë kam sqaruar hollësisht natyrën e kontaktit që unë dhe vëllai im kemi patur me këtë shtetas.

Këtë dekleratë Komisionit i kërkoj t'a marrë si provë duke e tërhequr nga dosja e rivlerësimit të motrës time, pra të veprojë njësoj, me të njëjtin standart, sikurse p.sh komisionerja Firdes Shuli veproi në procesin e rivlerësimit të motrës time, tek i cili për qëllime të rivlerësimi të saj, tërhoqi dokumente lidhur me figurën, nga dosja ime e rivlerësimit.
(Komisionerja Firdes Shuli, në vendimin e motrës time, është shprehur edhe për mua, duke më paragjykuar në shkelje të ligjit, pa më dëgjuar. Unë për këtë kam protestuar duke shprehur opinionin tim që në shpjegimet që kam dhënë për raportin e rezultateve të hetimit të hartuar nga Komisioneri i larguar turpshëm nga procesi im i rivlerësimit, Roland Ilia.

Madje, sikurse mund të shihet nga ky material shkresor që kam përgatitur unë për të kundërshtuar raportin e hetimit të hartuar nga komisioneri Ilia, unë i kam thënë aty Komisioneres në fjalë dhe i them prapë, se ka bërë shumë gabim që pa më dëgjuar, ka guxuar të shkelë ligjin në dëmin tim, në procesin e rivlerësimit të motrës time Ajola Prençi. Po aty i them se kjo komisionere duke trilluar për mua pa më dëgjuar në procesin e rivlerësimit të motrës time, jo vetëm e ka vënë veten në konflikt interesi me mua në procesin tim të rivlerësimit, *por ka "harruar" ca punë në Gjirokastër, dhe me kë i ka këto punë, të cilat e shndërrojnë konfliktin e interesit që ajo ka me mua, një "një gjendje të shumëfishtë, konflikti interesi*".

<u>Së treti</u>: Përsa i përket sms përmes të cilës, Komisioni vlerëson se "Gjithashtu ngrihen dyshime që subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse për sa kohë ka pranuar shtyrjen e seancës me kërkesë të dërguar me sms nga z. Lulzim Karini përfaqësues i palës paditëse. e cila nuk është një nga format e parashikuar nga K.Pr. Civle (pasi çdo kërkesë duhet të paraqitet në sekretarinë gjyqësore me shkrim shoqëruar me dokumentacion provues) si dhe ka vendosur në favor të kësaj pale", jam shprehur më sipër, tek kriteri i figurës. Megjithatë, po e përsëris edhe këtu arsyetimin e bërë në këtë rast. Pra, konkretisht:

a. Nuk është e vërtetë që njoftimi i shkaqeve për shtyrjen e seancave gjyqësore bëhet vetëm me shkrese të depozituar në kryesekretari, por mund të bëhet me çdo mënyrë të padyshimtë njoftimi. Fakti që avokati në fjalë, më ka njoftuar me sms, në numrin tim personal, nuk është i paligjshëm. Kjo pasi ai ka patur të atin duke vdekur (dhe që pas pak vdiq) dhe çdo njeri normal është logjike që të mos jetë i kthjellët mendërisht dhe/apo të gjejë kohë të shkruajë shkresën dhe t'a depozitojë atë në Gjykatë, në kushte të tilla urgjence dhe fatkeqësie të rëndë familjare. Nëse pranohet e kundërta, ose je nën njeri ose je mbi njeri. Unë fatkeqësisht, jam gjyqtar por jam edhe njeri.

b. Unë kam treguar një sjellje korrekte gjyqësore dhe në seancën gjyqësore në fjalë, këtë sms ia kam lexuar fjalë për fjalë palëve dhe i kam kërkuar mendim lidhur me vijimin e procedurës gjyqësore. Palët pasi u njohën me përmbajtjen e kësaj sms-je, duke qënë se janë njerëz dhe si të tillë kanë empati, keqardhje dhe solidaritet njerëzor në raste fatkeqësie familjare, të gjitha së bashku kërkuan shtyrjen e seancës gjyqësore. Sipas Komisionit, gjyqtari nuk është njeri dhe duhet të pushonte gjykimin në këtë seancë. Por Komisioni harron me dashje se guri i themelit në

një proces të rregullt ligjor, qoftë administrativ dhe aq më shumë gjyqësor, është humanizmi, pra qënia njeri jo vetëm fiziologjikisht por edhe shpirtërisht dhe mendërisht. Po ashtu Komisioni harron se sipas nenit 100 të KPC, mirëbesimi është një nga gurët e themelit të procedurës gjyqësore. Veprimi me mirëbesim, vlen jo vetëm për palët si detyrim, por mbi të gjitha duhet të karakterizoje sjelljen e duhur gjyqësore.

c. Po të dëgjohet rregjistrimi audio i kësaj seance, (që unë do t'a paraqes si provë), duket qarte se teksti i sms që avokati Lulzim Karini më ka dërguar, është shumë formal dhe zyrtar. Fillon me fjalët, "*I nderuar zoti gjyqtar. Ju bëj me dije se nuk mund të paraqitem në seancën gjyqësore. Kjo pasi im atë ka pësuar hemoragji cerebrale dhe jemi nisur me urgjencë në Athinë Greqi, sepse nuk mund t'a operojmë në Shqipëri pasi ka bërë tashmë dy bye passe në zemër. Po iu dërgoj locationin ku ndodhem në Greqi, afër spitalit ku është shtruar im atë. Ju lutem më shtyni seancën gjyqësore*".
Cfarë duhet të bëja unë pasi u njoha më këtë SMS. Unë korrektësisht, ua kam lexuar palëve në seancë, duke iu treguar saktësisht orën dhe minutën kur më ka ardhur ky SMS. Pasi mora miratimin e palëve shtyva seancën. Po të kisha lidhje me avokatin Lulzim Karini, sms nuk do të ishte kaq formal dhe zyrtar. As unë dhe madje as avokati në fjalë, nuk ka menduar ndonjëherë që njohja jonë do të përbënte premisë favorizimi që do binte ndesh me detyrën time si gjyqtar.

Fakti që as avokati nuk e ka menduar këtë gjë, duket qartë po të krahasohet karakteri formal dhe zyrtar i kësaj sms-je, p.sh me sms që i dërgova Komisionit bashkangjitur kërkesës për përjashtimin e Komisionerit Roland Ilia, "Andri, si je", që komisioneri në fjalë, më dërgoi ndërkohë që ai kishte ca shqetësime personale, dhe që kësaj SMS unë as nuk iu përgjgja fare, (pasi binte ndesh me figurën dhe detyrën e gjyqtarit), për aq kohë sa atij t'i kalonin shqetësimet që kishte.

Tani lind pyetja: - Si mundet që Komisioni të konsiderojë favorizim shtyrjen e seancës që unë bëra pasi u njoha me sms e avokatit Lulzim Karini, ndërkohë që nuk konsideron veprim të paligjshëm pjesmarrjen e Komisionerit Roland Ilia, në trupën time gjykuese, dhe mosdeklarimin e konfliktit të interesit prej tij, qoftë edhe vetëm për shkak se më ka dërguar sms e lartëpërmëndur, ndërkohe që kapatur shqetësime që ai i di vetë (që kanë qënë probleme me zbatimin e ligjit penal, të padeklaruara nga ky komisioner as në dosjen që ka depozituar tek avokati i popullit, as në kuvendin e Shqipërisë dhe as në formularin e dekriminalizimit, fakte këto që janë vepra penale) !!! Ky standart i dyfishtë që ndiqet në zbatimin e ligjit, të kujtoj George Orëell tek "Ferma e kafshëve", me shprehjen lapidare të derrkucit Napoleon "*të gjithë janë të barabartë por ca janë më të barabartë se të tjerët*".
Të nderuar Komisionerë, gjithmonë në historiografi, letërsi, sociologji, filozofi, madje edhe në jurisprudencë, ka ekzistuar një rrymë e mendimit shoqëror që përshkruan shoqëritë dystopike, (e kundërta e utopikes), ku njerëzve që jetojnë në këto shoqëri, në pamje, dukje, formë, iu jepet propoganda, bojatisja, flamujtë dhe fanfarat, por në përmbajtje iu jepet vuajtja, pabarazia shoqërore, kontrolli i çdo të drejte dhe lirie individuale, kontrolli mbi mjetet e punës dhe të prodhimit, iu jepen patronazhistët dhe gardistët për t'iu kufizuar shfaqjen e mendimit, iu jepet uria dhe skamja dhe.... nëse nuk mjafton kaq, iu jepet kërbaçi, depersonalizimi përmes shpifjeve dhe trillimeve, distancimi, segregacioni dhe izolimi shoqëror, etj.

Sigurisht, unë nuk e kam aftësinë dhe fuqine e shprehjes as të Protagorës, Trasimakut, etj, në lashtësi, as të Dante Aligerit dhe Shekspirit në mesjetë, as të Emil Zolasë, Albert Kamysë, Graham Green, Charles Dickens, dhe George Orëell, që secili prej tyre, në kryeveprat e tyre, satirizojnë këto lloj shoqërish dystopike. Ama, me kaq fuqi shprehëse sa më ka dhënë Zoti, do t'i thoja Komisionit, që përmes mendimeve dhe vlerësimeve që jep, jo vetëm të mos vendosë tulla për lartësimin e mureve ekzistuese të shoqërisë për të cilën po flas, por të përpiqet, me aq sa ka mundësi, t'i shëmbë këto mure.

Vetëm kështu, duke kontribuar të gjithë ne, me sa kemi mundësi secili, me guxim, brënda kompetencave formale që n'a jep ligji dhe Kushtetuta, besoj se do të mundësojmë që shoqëria që jeton në Republikën tonë, në Atdheun tonë, të ketë krenarinë dhe nderin që forma e ndërtimit ligjor dhe institucional të shtetit, të përputhet plotësisht me përmbajtjen e mënyrës së veprimit të secilit institucion shtetëror dhe të çdo zyrtari individual në veçanti.

<u>Së katërti</u>: Vendimi për të cilën po jap shpjegim në këtë pjesë të trajtimit, është vendim i formës së prerë. Për rrjedhojë, vlejnë të gjitha ato që kam thënë më sipër, se ai ka forcën e ligjit, se sipas nenit 102, paragrafi 2 të ligjit 96/2016, *përbën shkelje disiplinore të magjistratit "a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë* ". Në kuptim të kësaj dispozite ligjore, nuk mund të thuhet se unë kam gabuar në legjislacionin procedural, për sa kohë një Gjykatë më e lartë, ka lënë në fuqi vendimin tim, etj. Gjithshtu, mund të shtohet se pretendimet eventuale për fallsifikim, janë hedhur poshtë nga juridiksioni gjyqësor penal, me vendim të formë së prerë, pra sjellja ime gjyqësore nuk ka sjellë asnjë pasojë, etj.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioni në vendim shprehet se:
87.10. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit me shtetasin L.K është kryer një hetim i thelluar, konkluzionet e të cilit janë shtjelluar në vijim, në pikën 95 të këtij vendimi.

87.11. Në lidhje me shtetasin K.M, Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për shkak të kontakteve të papërshtatshme, pasi nga ana e tij në deklaratën e kontrollit të figurës është deklaruar një gjë e tillë. Barra e provës i ka kaluar për shkak të mundësisë së një konflikti interesi, duke qenë se ai vetë e ka deklaruar këtë shtetas si njohje të tij.

87.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar këtë çështje, pasi: (i) ka pasur marrëdhënie shoqërore me shtetasin L.K, (ii) si dhe njohje me shtetasin K.M, për të cilin, siç deklaron, i ka kërkuar vëllait të tij të distancohej. Ky përfundim i Komisionit është përfshirë në vlerësimin e konfliktit të interesit, të trajtuar në pikën 95 të këtij vendimi.

Në lidhje me këtë arsyetim të Komisionit i lutem Kolegjit të mbajë parasysh se marrëdhënien e shtetasin Lulzim Karini e shpjegova më sipër që nuk ka patur konflikt interesi ndërmjet tij dhe meje. Për shtetasin Kleves Muja, Komisioni ndonëse nuk më ka ngarkuar barrë prove, guxon duke shkelur standartet e gjykimit të drejtë, që të japë opinion. Kjo nuk është gjë tjetër veçse tregues i dëshirrës së zjarrtë që ka patur Komisioni për të gjetur argumente qoftë edhe të

pabazuara me qëllim që të argumentojë vendimin për shkarkimin tim nga detyra. Në bindjen time më të thellë kjo nuk është drejtësi dhe as proces i rregullt ligjor. Gjithashtu, bëj me die Kolegjin se unë iu qëndroj të gjitha argumenteve që dhashë më sipër, të cilat pata kurajon që t'ia përplas anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, ballas, sy më sy, në seancën dëgjimore të datës 14.12.2022.

5.Stiven Kiri (nr.4573 prot. datë 07.06.2018).

Nga raporti rezulton se:

1. Denoncuesi pretendon se subjekti ka kryer shkelje ligjore dhe proces jo të rregullt gjyqësor, sepse nuk i është përgjigjur pretendimeve të denoncuesit dhe ka zhvilluar gjykimin bazuar në dokumentacion të fallsifikuar. Ai pretendon gjithashtu se i ka kërkuar subjektit pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative e më pas pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes penale, por këto kërkesa janë refuzuar nga subjekti. Denoncuesi shprehet se pas vendimit të padrejtë të dhënë nga subjekti, Prokuroria vërtetoi fallsifikimin e dokumentave të pretenduar nga denoncuesi dhe vendimi i dhënë, u prish nga Gjykata e Apelit. Më tej, denoncuesi pretendon se avokati me të cilin ai konsultohej për problematikën e pronës, është shprehur se "ky gjyqtar, që ta mbyllë çështjen në një seancë të vetme kërkon 3 mijë euro".

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vënë në dispozicion të Komisionit kopje të Vendimit date 08.07.2015 dhënë për këtë çështje nga subjekti i rivlerësimit i cili ka vendosur "pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë". Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur Stiven Kiri dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur "prishjen e vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes". Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala paditëse dhe dosja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe pretendimeve të denoncuesit konstatohet se subjekti nuk ka pezulluar gjykimin në perputhje me nenin 297/a të K.Pr.Civile ku parashikohet se:
Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative;

 Për sa më sipër duket se subjekti ka vijuar gjykimin pa u zgjidhur më parë çështja penale duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të K.Pr.Civile, për pasojë janë cënuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe për të depozituar vendimin e gjykatës së apelit së bashku me dosjen gjyqësore.

Nga lidhje me këtë pjesë të raportit përpara Komisionit kam mbajtur qëndrimin se:

<u>Së pari</u>: Për diskrecionalitetin që ka Gjykata për të disponuar pezullimin ose jo të gjykimit të çështjes civile deri sa të zgjidhet paraprakisht një çështje penale, jam shprehur edhe më sipër, në trajtimin e ankesave të Daria Damidova, Mark Kulla dhe Ariana Muja. Unë i qëndroj të njëjtit arsyetim. Pra është e padobishme që të zgjatem pasi kaloj në përsëritje të panevojshme. Pra, i

kërkoj Komisionit që qëndrimin tim lidhur me ankesat e shtetasve në fjalë, (që u trajtuan më sipër), t'a konsiderojë të pandryshuar edhe për ankesën e shtetasit Stiven Kiri.

Së dyti: Specifikisht për ankesën e shtetasit Stiven Kiri, ju bëj me dije se shkaqet e kësaj ankese janë trajtuar edhe nga ish Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në vitin 2018 ose në vitin 2019, duke u hedhur poshtë si të pabazuara. Unë nuk e disponoj vendimin e ish Kryeinspektores Marsida Xhaferllari, të marrë me këtë rast, (pasi nuk e kam ruajtur), por besoj se në dosjen e rivlerësimit, Komisioni ka marrë gjithë praktikën ndër vite të ankesave që i janë bërë veprimtarisë time gjyqësore.
Nëse trajtimi i kësaj ankese, nuk ndodhet në dosjen që administron Komisioni, ju kërkoj t'a merrni si provë ne favorin tim. Marrja e kësaj prove ka rëndësi pasi vërteton që ankesa është e pathemeltë.

Së treti: Në vlerësimin e kësaj ankese, i kërkoj Komisionit që të ketë parasysh se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka prishur vendimin tim dhe ka pushuar çështjen, nuk e ka bërë këtë për shkak të të metave të hetimit gjyqësor. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, vendimi im është prishur dhe është pushuar çështja, pasi Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në kushtet kur paditësja nuk e ka patur të rregjistruar në emër të saj, titullin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, në ZVRrpp Shkodër, ajo nuk ka legjitimitet aktiv lidhur me padinë. Duke qënë se vendimi nuk është prishur për hetim të paplotë gjyqësor, i bie që vendimi im për mospezullimin e gjykimit, të jetë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. Pra unë sipas nenit 102, paragrafi 2 të ligjit 96/2016, nuk mund të konsiderohem përgjegjës, për një mosveprim për të cilin një Gjykatë më e lartë, nuk është shprehur se është shkelje e ligjit.

Së katërti: Pavarësisht se Komisioni me të drejtë nuk më ka kërkuar as shpjegim dhe as më ka ngarkuar ndonjë barrë prove, unë me vullnet po shpjegoj se në vlerësimin tim, qëndrimi i Gjykatës së Apelit është i gabuar. Kjo pasi sipas vendimit unifikues nr. 1/viti 2009 i KBGJL, që e kam cituar edhe në vendim, pronar të një pasurie të paluajtshme, nuk të bën fakti juridik i rregjistrimit të titullit të pronësisë në rregjistrin publikë të pasurive të paluajtshme, (që për më tepër paditësja në rastin në gjykim e ka patur të rregjistruar), por ekzistenca e vetë titullit pronësor që nënkupton tregimin e mënyrës se si je bërë pronar i pasurisë. Pikërisht, ky vlerësim i imi është edhe shkaku i rekursit (që unë e zbulova tani, ndërsa po merrem me procesin e rivlerësimit), që ka bërë paditësja ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit, në Gjykatën e Lartë, ku çështja akoma nuk është gjykuar pasi është në pritje të radhës së gjykimit. Unë mendoj se Komisioni ka bërë mirë që nuk ka dhënë asnjë konsideratë lidhur me themelin e çështjes në raportin e tij, pasi kësisoj ka respektuar si nenin 36/3 të KPC që parashikon se "*Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata*", ashtu edhe nenin 3 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repunlikën e Shqipërisë", që sikurse u tha parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".

Së pesti: Kërkoj që në trajtimin e kësaj ankese, të kihet parasysh edhe standarti detyrues i përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër. Po ashtu edhe standartin tjetër detyrues

të vendosur po me këtë vendim të KPA, sipas të cilit KPA ka ndryshuar vendimin e KPK, duke e rikthyer në detyrë gjyqtarin Fuat Vjerdha, duke përdorur ndër të tjera si argument *edhe rekomandimin e Këshillit të Evropës, përkatësisht të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare [17 nëntor 2010 CM/Rec(2010)12], "Mbi pavarësinë e eficencën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve", në Kreun VII ku trajnohet përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, ku përcaktohet se: "Interpretimi i ligjit, vlerësimi I fakteve ose i provave të kryera nga gjyqtarët gjatë gjykimit të çështjeve nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë. Gjyqtarët nuk mund të jenë personalisht përgjegjës në rastet kur vendimet e tyre ndryshohen nga një gjykatë më e lartë* ".

<u>Së gjashti</u>: Lidhur me pjesën e trillimeve që përmend shtetasi Stiven Kiri në ankesën e tij, nuk e vlerësoj me vend të shprehem. Vlerësoj se fakti që Komisioni këto trillime nuk i ka përfshirë në kriterin e figurës, tregon që edhe vetë Komisioni vlerëson se ato janë të pabazuara.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioni në vendimin e tij shprehet se:

88.4. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur135, ka shpjeguar se, për sa i përket pezullimit, ai paraqet të njëjtat argumente si në pikën 85.7 të këtij vendimi.

Në këto kushte, edhe qëndrimi i Komisionit është sikundër është trajtuar më lart. Më pas, subjekti vijon të analizojë vendimmarrjen e tij, për të cilën Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove, pasi nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016.

Tek ky qëndrim i Komisionit më tërheq vëmendjen se komisioni vijon të jetë konseguent në qëndrimin e tij se kur paraqitet një kallzim penal, gjykata civile duhet të pezullojë gjykimin. Ky qëndrim në vlerësimin tim është i gabuar. Arsyet i kam shtjelluar më lart prandaj edhe unë sikurse Komisioni e vlerësoj të pavënd që të zgjatem më tej.

6. Desara Kalleshi (nr.5120 prot., datë 03.08.2020).

Në raport, në lidhje me këtë ankese rezulton se:

Denoncuesja sqaron se ka qënë palë ndërgjyqëse në gjykimin me: Palë paditëse - Elsa Kamata e Desara Kalleshi; Të paditur: Amir Kamata dhe Ermira Reçi; Palë e tretë: ASHK dhe D.A.M.T Shkodër; objekt: konstatim i pavërtetësisë së pjesshme të dokumentit – Libër i pronësisë qyteti Shkodër në lidhje me regjistrimin në emër të Hilmi Kamata dhe saktësimin e dokumentit në lidhje me pronësinë nga Hilmi Kamata ne Hamide Kamata etj.

Denoncuesja pretendon se përmes një vendimi të ndërmjetëm, subjekti ka vendosur përjashtimin nga gjykimi të personit të tretë D.A.M.T Shkodër ndërkohe që objekti i padisë lidhej me një dokument të lëshuar pikërisht nga D.A.M.T Shkodër.

Paditësja/ denoncuesja shprehet se ka paraqitur ankim në lidhje me këtë vendim të ndërmjetëm por për një periudhë prej 4 muajsh subjekti nuk ka dorëzuar materialet e dosjes në sekretarinë e gjykatës, duke penguar kështu dërgimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Ajo pretendon gjithashtu se në një seancë gjyqësore ka qënë prezent në sallën e gjyqit edhe vëllai i subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me këtë denoncim duket se:

 Subjekti ka zvarritur nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm duke cënuar të drejtën e palës në lidhje me një proces brenda afateve të arsyeshme.
 Është e paqartë prezenca e vëllait të subjektit në seancë gjyqësore.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe për të depozituar dokumentacion provues për depozitimin e vendimit të ndërmjetëm dhe vijimin e gjykimit.

Lidhur me këtë ankesë kam për të thënë të njëjtën gjë që kam thënë, kur kam paraqitur mendimin me shkrim kur është kërkuar përjashtimi im nga gjykimi i çështjes. Ky mendim me shkrim është konsideruar i bazuar nga gjyqtari tjetër i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Shkodër që ka refuzuar kërkesën për përjashtimin tim nga gjykimi, të cilin ju e keni të administruar si provë ne dosjen time të rivlerësimit.
Konkretisht kam thënë sa më poshtë:

" *...ommisis Une gjyqtari Andri Ymeri, pasi u njoha me kerkesen per perjashtimin tim nga gjykimi, të paraqitur nga ndergjyqësja Elsa Kamata, etj, sikurse në çdo rast tjetër, e vlerësoj me vend që të parashtroj qëndrimin tim lidhur me këtë kërkesë, si më poshtë vijon:*
Thelbi i kerkeses me objekt perjashtimin tim nga ushtrimi i funksionit gjyqesor ne gjykimin e çeshtjes, mund te permblidhet ne aspekt e meposhtme:

1. Çështja objekt gjykimi është gjykuar edhe me parë nga unë duke u përmbyllur procedura gjyqësore me vendim jo përfundimtar për pushimin e gjykimit. Në atë gjykim të përfunduar me vendim për pushimin e gjykimit, palët ndërgjyqëse kundërshtare, me ndërgjyqësen Elsa Kamata, kanë kërkuar përjashtimin tim, kërkesë kjo që nuk është pranuar nga një gjyqtar tjetër i po kësaj Gjykatë. Pasi çështja rifilloi, përmes paraqitjes së një kërkese te re, në dallim nga gjykimi i mëparshëm, pala kundërshtare me ndërgjyqësen Elsa Kamata, ndryshoi avokat dhe nuk kërkoi më përjashtimin tim si gjyqtar, gjë që e kishte bërë në gjykimin e mëparshëm. Kjo sipas palës ndërgjyqëse që kërkon përjashtimin tim nga ushtrimi i funksionit gjyqësor, hedh hije dyshimi, në paanësinë time si gjyqtar..!!!

2. Unë në cilësinë e gjyqtarit, nuk kam legjitimuar si përson të trete, Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkuit Shkodër, duke e marrë vendimin e ndërmjetëm sipas nenit 194 të KPC-së. Ndaj këtij vendimi, pala ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, dhe unë ndonëse kam patur dijeni për këtë fakt, nuk kam përcjellë dosjen në sekretari, duke u bërë pengese për ushtrimin e të drejtës së palës, për ushtrimin e një ankimi efektiv.

3. Në seancën e fundit të zhvilluar në sallën e gjyqit, ka qënë present një familjar i imi, gjë që ka krijuar dyshime tek pala që kërkon përjashtimin lidhur me paanësinë time si gjyqtar.

4. Pala ndërgjyqëse që ka kërkuar përjashtimin tim nga gjykimi, ka paraqitur ndaj meje ankesë administrative tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe KPK, për fillimin e procedimit administrative ndaj meje si dhe tek zevendeskryetari i Gjykatës ku unë ushtroj funksionet e gjyqtarit. Kjo gjë, sipas kësaj pale, e vendos personin tim në gjëndjen e "Konfliktit në dukje të interesit", me palën ndërgjyqëse në fjalë, dhe përbën shkak përjashtimi të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes.

Lidhur me keto pretendime, une vleresoj se ato ose jane te pabazuara ne ligj, ose ne rastin me te mire, nuk perbejne premise te mjaftueshme per te vene ne dyshim ndershmerine dhe korrektesine time ne ushtrimin e funksionit te gjyqtarit te ngarkuar per gjykimin e çeshtjes. Kjo pasi:

Lidhur me shkakun e parë, (që konsiston në faktin se përse pala që ka kërkuar përjashtimin tim në gjykimin e mëparshëm, nuk e kërkon edhe këtë herë), unë mendoj se ky shkak përjashtimi i ekspozuar nga pala, ka karakter haptazi abuziv. Kjo pasi gjyqtari në asnjë rast nuk mund të mësojë, sygjerojë apo modelojë sjelljen e palëve apo të përfaqësuesve të tyre në një gjykim. Fakti që një palë e caktuar nuk kryen një veprim procedural në një gjykim, as nuk mund dhe as nuk duhet të shërbejë për palën tjetër, për të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit, përveç kur është gjyqtari që e ka sygjeruar, këshilluar apo udhëzuar palën, për të mos e kryer këtë veprim. Unë, sikurse pala vetën e pranon, (pasi nuk e përmënd një gjë të tillë në kërkesën për përjashtim të paraqitur prej saj), nuk i kam thënë kujt të paraqesë apo jo kërkesë për përjashtimin tim nga gjykimi.

Lidhur me shkakun e dytë, (përsa i përket pengimit të supozuar nga ana ime të së drejtës së palës për të ushtruar ankim efektiv, përmes mosdorëzimit të dosjes që t'i jepej rrugë ankimit të veçantë), kam mendimin se ky shkak i ekspozuar, për përjashtimin tim nga gjykimi, mbështetet në të dhëna pjesërisht të rreme dhe/ose të paprovuara si dhe të paligjshme. Kjo pasi unë nuk kam marrë dijeni ndonjëherë mbi faktin që pala ka paraqitur ankim të veçantë, ndaj vendimit të ndërmjetëm gjyqësor për moslegjitimimin e personit të tretë. Nga ana tjetër, fakti i paraqitjes se ankimit të veçantë nuk pezullon vazhdimin e gjykimit. Gjithashtu, kurrsesi unë nuk jam bërë pengesë për fotokopjimin e dosjes gjyqëore dhe dërgimin e dosjes në Gjykatën e Apelit, (pasi vetëm tani po e marr vesh që është paraqitur ankim i veçantë). Gjithsesi, ju bëj me dije se sot sapo u njoha me kërkesën për përjashtimin sim nga gjykimi, të bazuar ndër të tjera edhe mbi këtë shkak, (dhe për rrjedhojë edhe për faktin se është paraqitur ankim i veçantë), menjëherë udhëzova dhe urdhërova sekretaren gjyqësore, që të fotokopjopjë dosjen gjyqësore, për të vijuar procedurat e përcjelljes së saj në Gjykatën e Apelit, por kurrsesi dosjen origjinale, pasi gjykimi vazhdon dhe paraqitja e ankimit të veçantë nuk përbën shkak pengues për përfundimin e gjykimit.

Lidhur me shkakun e tretë, (prania e familjarit tim në sallë), ju bëj me dije se është e vërtetë, që në sallë ka qënë vëllai im Gerti Ymeri, por ai ka ardhur në sallë, (ndërkohë që gjykimi ka qënë në vijim), për të më sjellë një palë çelësa të automjetit tim). Duke qënë se gjykimi ishte në vijim, dhe ai nuk mund të afrohej që të m'i jepte, (dhe duke qënë se seance ishte drejt fundit), ai është ulur në vendin e publikut, ku ka qëndruar një apo dy minuta deri sa përfundoi seance, kur dhe më dha çelësat në prani të palëve pasi dola jashtë nga salla. Unë nuk arrij të kuptoj se si kjo rrethanë paska krijuar dyshim tek pala lidhur me paanësine time si gjyqtar, ndërkohë që kjo rrethanë, po të vlerësohej normalisht, duhet t'i shërbente palëve për të mësuar se si respektohet solemniteti i gjykimit nga gjyqtari, qoftë edhe përkundrejt familjarëve të tij. Lidhur me këtë rrethanë, ju lutem vlerësoni pamjet filmike të sallës nr. 5 të katit të tretë të Gjykatës.

Lidhur me shkakun e katërt, (ankesën disiplinore),

Së pari: kërkesës me objekt përjashtimin e gjyqtarit, nuk i është bashkangjitur ankesa administrative. Për rrjedhojë, nuk mund të krijohet "nga provat e paraqitura" asnjë llooj ideje,

qoftë edhe e vakët, lidhur me shkeljet e supozuara nga pala ndërgjyqëse, të konsumuara nga ana ime, në cilësinë e gjyqtarit, gjatë gjykimit të çështjes. Unë në bindjen time më të thellë, nuk kam shkelur ligjin, në asnjë rrethanë. Po ashtu, nuk kam lënë shteg përmes sjelljes time gjyqësore apo jashtëgjyqësore, për ndonjë intepretim që vë në dyshim apo mund të duket se vë në dyshim, parimet e korrektesës gjyqësore, ndershmërisë, paanësisë dhe objektivitetit të gjyqtarit.

Pavarësisht se unë nuk jam njohur me përmbajtjen e ankesës disiplinore që pala ndërgjyqëse ka paraqitur ndaj meje në cilësinë e gjyqtarit, duke u nisur nga përmbajtja e vetë kërkesës për përjashtim, mendoj se nga pikpamja e bazës faktike, përmbajtja e saj, është e njëjta gjë, me përmbajtjen e kërkesës për përjashtim, të analizuar më sipër. Për rrjedhojë, sipas mendimit tim, nga nga pikpamja substanciale, kjo ankesë disiplinore, sikurse edhe kërkesa për përjashtim, jo vetëm është e pabazuar por edhe abuzive.

<u>Së dyti</u>: Pavarësisht nga bindja ime sa më sipër, mendoj se është fakt se paraqitja e një ankese disiplinore ndaj meje, nga pala ndërgjyqëse, krijon një gjendje "konflikti interesi në dukje" ndërmjet meje dhe kësaj pale. Në bindjen time ky konflikt interesi, është vetëm në dukje, dhe kurrsesi nuk është faktik. Kjo pasi duke marrë në konsideratë sjelljen e palës ndërgjyqëse në fjalë, gjatë gjykimit, duke paraqitur kërkesa të paligjshme për përjashtim gjyqtari, etj, krijohet më së paku "dyshimi i arsyeshëm", se kërkesa me objekt përjashtim gjyqtari e paraqitur kundër meje, ka si qëllim të fshehtë, "të cënojë standartin kushtetues të Gjykatës së krijuar me ligj", gjë që mund të realizohet perms paraqitjes abuzive të kërkesave me objekt përjashtim gjyqtari. Përveç kësaj, kjo kërkesë, krijon më së paku dyshimin e arsyeshëm se synon "të cënojë standartin kushtetues të gjykimit të çështjes brënda një kohëzgjatjeje të arsyeshme". Kjo pasi aktualisht faza në të cilën ndodhet gjykimi, është faza e paraqitjes së bisedimeve përfundimtare lidhur me çështjen.

<u>Së treti</u>: Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në Gjykatën e Apelit Shkodër, ka një praktikë të konsoliduar tashmë, se vetë fakti i paraqitjes së një kallzimi penal, ankese administrative disiplinore apo kërkesë padie, ku thirret si i paditur gjyqtari për shkak të veprimtarisë së tij gjyqësore, nuk përbën "bazë faktike të mjaftueshme" për të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit dhe për rrjedhojë, për t'u pranuar si "kërkesat e paraqitura nga gjyqtari me objekt heqje dore nga gjykimi", ashtu edhe kërkesat e palëve me objekt "përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi". Kam bindjen se gjyqtarët në veprimtarine e tyre, (çdo gjyqtar), kanë si gur themeli, parimin e barazise. Zbatimi praktik i këtij parimi, sipas jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nënkupton, "jo vetëm trajtim të barabartë të palëve ndërgjyqëse në të njëjtin gjykim", por edhe "trajtim të barabartë të të gjithë subjekteve që kanë nevojë për akses në shërbimin gjyqësor, pavarësisht së mund të jenë pjesmarrës në gjykime të ndryshme".

Unë, mendoj se zbatimi i parimit të barazisë, nënkupton vijimin e zbatimit të standartit tashmë të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, se vetë fakti i paraqitjes së një kallzimi penal, ankese administrative disiplinore apo kërkesë padie, ku thirret si i paditur gjyqtari për shkak të veprimtarisë së tij gjyqësore, nuk përbën "bazë faktike të mjaftueshme" për të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit dhe për rrjedhojë, për t'u pranuar si "kërkesat e paraqitura nga gjyqtari me objekt heqje dore nga gjykimi", ashtu edhe kërkesat e palëve me objekt "përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi".

Kjo pasi në të kundërt, ndryshimi i këtij standarti, në mënyrë të papërligjur, do t'i hapte rrugë, jo vetëm parashtrimit të pretendimeve eventuale për diskriminim, të subjekteve që kanë nevojë për akses në shërbimin gjyqësor, por do të sillte një pasojë, akoma më të rëndë. Kjo pasojë do të ishte krijimi i mundësisë abuzive për pjesmarrësit në një proces gjyqësor, që përmes paraqitjes së një kallzimi, ankimi apo padie, përkundrejt gjyqtarit, të krijonin një gjendje konflikti fiktive, që në vijim t'a përdornin për të shmangur nga gjykimi, gjyqtarë të papëlqyer nga palët apo për të zvarritur gjykimin në mënyrë të pajustifikuar.

Pikërisht duke vënë në balancë tërësinë e opinioneve që shfaqa si më sipër, mendoj se nuk është rasti që unë të paraqes kërkesë me objekt heqjen dorë nga ana ime, prej gjykimit të çështjes.
Ky mendim i imi, përforcohet edhe nga jurisprudenca e Gjykatave më të larta të rendit tonë juridik, (Gjykata e Lartë, Gjykata kushtetuese dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut), sipas të cilës, "testi subjektiv i paanësisë së gjyqtarit", jo domosdosmërisht mjafton për të vënë në dyshim paanësinë e tij. Kjo pasi "dukja e anshmërisë", duhet të shoqërohet edhe me element të "testit objektiv të paanësisë së gjyqtarit", të cilat të tregojnë së ekziston rreziku serioz i cënimit të të drejtës për një process të rregullt gjyqësor, në drejtim të respektimit të standartit "Gjykatë e paanshme.
Në kushtet kur nga përmbajtja e kërkesës për përjashtim, nuk rezulton "as të evidentohet, përshkruhet dhe aq më pak provohet", ndonjë element i tillë i testit objektiv të anësisë time të supozuar si gjyqtar, kam mendimin se gjendja e konfliktit në dukje të interesit, me të cilën pala, në thelb, e motivon kërkesën për përjashtim që ka paraqitur, nuk mjafton as që unë të paraqes kërkesë më objekt heqjen dorë nga gjykimi, dhe aq më pak për t'u pranuar kërkesa e paraqitur nga pala, për përjashrimin tim nga gjykimi.

<u>Në përfundim</u>: Meqënëse afatet procedurale për paraqitje ankesash, kërkesash, etj, kanë qënë në pezulluara, në bazë të aktit normative, vlerësoj se kërkesa për përjashtimin tim nga gjykimi, duhet gjykuar në meritën e saj duke mos u përmbyllur procedura gjyqësore për shqyrtimin e saj, me vendim jomeritor".

Sikurse e thashë dhe më sipër, ky qëndrim im imi, është përkrahur nga gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtim.

Veç kësaj, i paraqes provë Komisionit vendimin nr. 14, datë 26.01.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka lënë në fuqi vendimin tim. Kjo tregon që qëndrimi që kanë mbajtur gjatë gjykimit ankueses Elsa Kamata dhe Desara Kalleshi, (që të dyja motra me njëra tjetrën dhe përkatësisht bashkëshortja e avokatit Ilir Kuka që është faktikisht letërshkruesi i kësaj ankese si dhe ankesës së bërë në emër të shtetasit Dedë Preka), ka qënë jo në përputhje me ligjin.

Pra janë dy vendime gjyqësore që tregojnë se ankesa është e pabazuar dhe konkretisht vendimi i gjyqtarit që ka refuzuar përjashtimin tim nga gjykimi dhe vendimi në fjalë i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Veç sa më sipër, kërkoj që pabazueshmërinë e kësaj ankese (gjë që duket që në pamje të parë) Komisioni t'a vlerësojë edhe në drejtim të çmuarjes gjithashtu, si të pabazuara, edhe të trillimeve dhe shpifjeve që avokati Ilir Kuka, (duke u nisur nga motive mllefi, hakmarrjeje apo ku t'a di

unë, që janë prodhuar nga vendimarrja ime gjyqësore në disfavor të tij, të bashkëshortes së tij dhe të kunatës së tij), ka bërë në ankesën e paraqitur në KPK, në emër të shtetasit Dedë Preka.

Lidhur me këtë ankesë Komisioni në vendim ka mbajtur qëndrimin se:

89.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka depozituar vendimin e ndërmjetëm për të provuar në këtë mënyrë të kundërtën e barrës së provës, sipas kërkesës së Komisionit. Nga sa konstatohet nga leximi i shpjegimeve, rezulton se ai nuk ka kryer në kohë të gjithë procedurat e nevojshme për sa i përket zbardhjes dhe vënies në dispozicion të vendimit të ndërmjetëm për refuzimin për marrje pjesë të personit të tretë, vendim ndaj të cilit mund të bëhet ankim i veçantë, bazuar në nenin 194 të Kodit të Procedurës Civile.

89.7. Bazuar në nenin 316 të Kodit të Procedurës Civile 137 subjekti kishte detyrimin ligjor që të njoftonte palët për këtë vendim të ndërmjetëm, e drejta e ankimimit të së cilit është 3 ditë nga marrja dijeni dhe, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tri ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar. Në këto kushte, subjekti ka zvarritur nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm, duke cenuar të drejtën e palës në lidhje me një proces brenda afateve të arsyeshme, duke treguar mangësi në kriterin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3, si dhe neni 74, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

Vlerësoj se ky qëndrim i Komisionit është i gabuar. Kjo pasi meqënëse Komisioni nuk ka administruar vendimin e ndëmjetëm të zbardhur, arrin në përfundimin se unë kam zvarritur zbardhjen e tij gjë që është tërësisht e pavërtetë. Nga ana tjetër Komisioni përmes paragrafit 89.7 të vendimit, më vendos në pozicionin e ftuesit të gjykatës. Sipas Komisionit do duhej gjyqtari dhe jo postieri i gjykatës, që t'i njoftonte palës vendimin.

Gjithsesi, kjo problematikë vlerësohet nga unë si e parëndësishme për qëllimet e procesit të rivlerësimit dhe i lutem Kolegjit që t'a konsiderojë atë edhe sipas parimit të proporcionalitetit por edhe sipas parimit të objektivitetit. Ky parim i fundit, duhet patur parasysh pasi në kohën kur është gjykuar kjo çështje, ka patur një ngarkesë anomalisht të lartë në Gjykatë, gjë që është shkaktuar ndër të tjera edhe nga largimi i disa prej kolegëve[63] ose nga procesi i vetingut ose përmes transferimit në Gjykata të tjera. Për rrjedhojë çështjet e kolegëve, pas rihedhjes në short, i janë caktuar gjyqtarëve të tjerë, ndër të cilët, edhe mua. Ky fakt besoj njihet botërisht. Për rrjedhojë, njihet edhe nga Kolegji, prandaj sipas nenit 12 të KPC nuk ka nevojë për vërtetim.

7. Kurum International sh.a (nr.5911 prot. datë 17.08.2021)

Nga raporti rezulton se:

Në denoncimin e paraqitur, shoqëria pretendon se në çështjen gjyqësore me palë paditëse Nexhat Maliqi e palë të paditur Kurum International sh.a, nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer shkelje të rënda të standardit të procesit të rregullt ligjor dhe shkelje të renda të etikës profesionale si dhe është evidentuar njëanshmëri e theksuar e subjektit në favor të palës paditëse.

[63] Konstantina Kuro, Albano Çepele, Tonin Sterkaj, Gentian Jahjolli, etj.

1. Në mënyrë të përmbledhur denoncuesi pretendon se:

a. Ekzistojnë dyshime të arsyeshme se kërkesë padia është hartuar nga vetë subjekti duke u bazuar në faktin se:
• Kërkesa padia është 160 faqe dhe ka 151 prova bashkëngjitur ku bie në sy niveli i lartë i profesionalizimit dhe referencat e shumta në praktikat gjyqësore (pjesë prej të cilës janë marrë pikërisht nga vendimet e vetë subjektit të rivlerësimit).
• vlera e objektit të padisë është përcaktuar në vlerën 49,000,000 lekë pa asnjë bazë teorike apo praktike duke maksimalizuar "të ardhurat" për palën paditëse dhe duke evituar kështu që çështja të gjykohet nga trupa gjykuese me tre gjyqtare.

b. Subjekti ka caktuar me ngut seancat përgatitore dhe gjyqësore, dhe në seancën e parë përgatitore ka caktuar 6 ekspertë.

c. Subjekti ka kryer gjykim të njëanshëm duke orientuar palën paditëse dhe duke e udhëzuar në përgjigjet e saj. Ky fakt mund të verifikohet nga regjistrimi audio i seancës së datës 30.06.2021.

d. Kërkesat e përfaqësuesve ligjore të palës së paditur janë rrëzuar sistematikisht edhe pse kanë qënë të mbështetura në ligj në prova. (mbështetur në raporte mjekësore e bileta udhëtimi jashtë vendit).

e. Subjekti ka caktuar seanca gjyqësore në një hark të shkurtër kohor.

f. Duke marrë në konsideratë artikujt mediatik, gjyqtari nuk mohon njohjen me avokatin e pales paditëse, duke e bërë vlerësimin e çështjes të njëanshëm.

g. Sipas informacioneve informale, kërkesëpadia mund të jetë hedhur në disa kopje në gjykatë, për të rritur mundësitë që çështja t'i kalonte për gjykim gjyqtarit Andri Ymeri. h. Kërkimi i dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

2. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se shoqëria Kurum ka paraqitur disa kërkesa ku ndër të tjera ka pretendua se:

- Padia është parashkruar pasi ka kaluar afati:

• 1 vjeçar i parashikuar nga neni 115/e i Kodit Civil pasi ajo është ngritur në datë11.04.2021 dhe marrëdhënia e punës është ndërprerë në datën 27.06.2018 • afati 180 ditor i parashikuar nga neni 146/2 i Kodit të Punës.

• afati 30 ditor i zbulimit të motivit abuziv.

- Subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit pasi:

• Ai është shprehur për themelin e çështjes në një bisedë private që ka patur me përfaqësuesin e shoqërisë Kurum.

• Avokati Ndrek Ruka që ka përfaqësuar palën paditëse është akuzuar për afera së bashku me subjektit ddhe nuk subjekti nuk ka mohuar njohjen me këtë avokat.

• Eksperti Vlerësuar z. Taulan Muka është parë në zyrën e subjektit duke biseduar me të pas përfundimit të një prej seanca gjyqësore.

3. Nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit konstatohet se ai ka deklaruar si kontakt të përshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar shtetasin Ndrek Ruka.

Në përfundim në lidhje me këtë denoncim duket se:

 Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi sipas pretendimeve të denoncuesit ai ka patur njohje me avokatin e palës paditëse, është shprehur privatisht për themelin e çështjes si dhe ka biseduar me njërin prej ekspertëve në zyrën e tij.
 Padia mund të jetë hedhur në disa kopje me qëllim shortimi i saj tek subjekti i rivlerësimit.
 Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
 Subjekti ka caktuar seanca si dhe ka përfunduar gjykimin në një afat shumë më të shkurtër se afatet normale të shqyrtimit të çështjeve të ngjashme nga ana e tij.
 Subjekti ka gjykuar një padi e cila është parashkruar.
Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin si dhe ka vepruar jo në përputhje me dispozitat e parashikuara nga K.Pr.Civile, për rrjedhojë ngrihen dyshime që subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe për të depozituar dokumentacion provues për shortimin e kërkesë padisë, numrit të kërkesë padive të depozituar nga paditësi, dosjen gjyqësore të vendimit si dhe vendime të ngjashme të tij me të njëjtin afat përfundimi si në këtë gjykim.

Në lidhje me konstatimet dhe vlerësimet e shprehura si më sipër përpara Komisionit kam dhënë shpjegimet përkatëse si dhe mbajtur qëndirmin e mëposhtëm:

Së pari: Për këtë ankesë, ka hetuar mbi të njëjtat pretendime (shkaqe) edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me vendimin nr. 168/2 prot, datë 20.07.2022 të ILD, kjo ankesë si dhe të gjitha shkaqet ku bazohet ajo, (të cilat janë të njëjta me ato që përmënd komisioni, duke iu vënë përpara togfjalëshin e paligjshëm dhe paragjykues “duket se”), është hedhur poshtë si e pabazuar duke mos i konsideruar faktet e ekspozuara përmes saj, as të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor.

Këtë vendim të ILD-së ia kam dorëzuar Komisionit si provë.

Gjithashtu, kjo ankesë si dhe shkaqet ku ajo bazohet, janë shqyrtuar edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, që ka barrë në shqyrtim ankesën e bërë ndaj vendimit të lartëpërmëndur të ILD, nga shoqëria Kurum International sh.a. KLGj me vendimin nr. 73, datë 07.11.2022, gjithashtu ka hedhur poshtë si të pabazuara shkaqet e ankesës duke lënë në fuqi vendimin e ILD. Edhe këtë vendim do ua paraqes si provë.

Unë nuk kam çfarë t'i shtoj shumë, në pikpamje të argumentimit ligjor, arsyetimit të dy organeve të drejtësisë së re, sikurse janë ILD dhe KLGj. Nëse Komisioni nuk ka besim as në vlerësimin e organeve të drejtësisë së re, që për më tepër janë organe të qeverisjes së drejtësisë, apo e vlerëson veten me të ditur se zyrtarët e këtyre organeve, atëhere kjo përbën qëndrim subjektiv të vetë Komisionit. Për rrjedhojë, ky qëndrim subjektiv, nuk mund të ndikojë në rezultatet e procesit tim të rivlerësimit, i cili sipas ligjit 84/2016, zhvillohet mbi bazën e parimit të objektivitetit dhe jo mbi bazën e qëndrimeve subjektive.

Për më tepër do thoja, që vendimi i nr. 73, datë 07.11.2022 i KLGJ, ka marrë formë të prerë dhe për rrjedhojë është bërë pjesë e rendit juridik duke mos patur më asnjë mundësi ligjore për cënimin e vlerësimeve, konstatimeve dhe arsyetimeve të tij, qoftë drejtëpërdrejt, qoftë tërthorazi, (sikurse po përpiqet që të bëjë indirekt të bëjë Komisioni).

Gjithsesi ftoj me mirësjellje Komisionin që të respektojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe të mos marrë përsipër që në procesin tim të rivlerësimit, të shkelë një nga parimet themelore të së drejtës, që ka të bëjë me "res judicata", gjënë e gjykuar. Veprimi në të kundërt, do përbënte sipas vlerësimit tim, shkelje të parimit të sigurisë juridike në dëmin tim, dhe besoj se ky parim përbën një nga parimet themelore të standartit "gjykim i drejtë", që është një nga standartet përbërëse të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

<u>Së dyti</u>: vlerësoj se Komisioni nuk duhet të jepte konsiderata që kanë të bëjnë me meritat e çështjes, sikurse ka bërë duke dhënë vlerësimet "*Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Subjekti ka gjykuar një padi e cila është parashkruar. Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin si dhe ka vepruar jo në përputhje me dispozitat e parashikuara nga K.Pr.Civile, për rrjedhojë ngrihen dyshime që subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse*".

Unë e kuptoj se Komisioni në dhënien e këtyre konsideratave, mesa duket është ndikuar nga opinion tepër i kualifikuar juridik (!!!) i ministres Belinda Balluku dhe të të besuarve të kësaj të fundit, në shoqëritë tregtare të kontrolluara prej saj, sikurse janë OSHE Group sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, që janë ankuar në SPAK, KPK, ILD, etj, ndaj veprimtarisë time gjyqësore të ushtruar në raste të ngjashme, madje të njëjta me rastin objekt analize, në të cilat vendimet e mia sipas ligjit dhe drejtësisë, qartësisht kanë mbajtur anën e të dëmtuarve dhe jo të dëmtuesve.

Unë arrij t'a kuptoj që rastësisht (!!!) ka qëlluar që ministrja Belinda Balluku, është motra e Komisioneres Pamela Qirko,

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që kjo komisionere ka bashkëpunuar me komisionerin Roland Ilia për të helmatisur procesin tim të rivlerësimit,

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që dy motrat mendojnë njësoj lidhur me pyetjen se si duhen argumentuar ligjërisht çështja e përcaktimit të masës së dëmshpërblimit në raste të ngjashme ose të njëjta, me rastin për të cilin po jap opinionionin tim në këtë pjesë të trajtimit,

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që dy motrat mendojnë njësoj lidhur me pyetjen nëse duhet pezulluar medeomos apo jo një gjykim civil, deri sa të zgjidhet një çështje penale me vendim të formës së prerë,

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që dy motrat mendojnë njësoj lidhur me pyetjen nëse duhet apo jo që vendimi të jepet me ekzekutim të përkohshëm, në raste të ngjashme ose të njëjta, me rastin për të cilin po jap opinionionin tim në këtë pjesë të trajtimit, dhe madje kanë opinion të ngjashëm edhe për cilësinë e arsyetimit që duhet përdorur.

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që "një dorë e kujdesshme" ka fshehur në procesin tim të rivlerësimit faktin që në të paktën në tre raste, është ose ministrja Belinda Balluku ose vartësit e saj në shoqëritë tregtare të kontrolluara prej saj, sikurse janë OSHE Group sh.a, FSHU sh.a dhe FTL sh.a, që kanë bërë ankesa në KPK ndaj veprimtarisë time gjyqësore. Pra kanë bërë ankim tek motra e ministres në fjalë.

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që "një dorë e kujdesshme" ka fshehur në procesin tim të rivlerësimit faktin që vëllai im Gerti Ymeri, ka qënë palë gjyqfituese në të paktën 5 gjykime më shoqërinë OST sh.a, që kontrollohet nga ministrja Belinda Balluku, pra motra e komisioneret Pamela Qirko, (dhe vazhdon edhe dy gjykime të tjera në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku padyshim do të jetë gjyqfitues). Ky fakt ka qënë i ditur për Komisionin sepse Komisionerja Firdes Shuli që ka qënë pjesë edhe e trupës gjykuese të motrës time Ajola Prençi, ka kërkuar informacion të detajuar në procesin e motrës time, se sa gjykime ka shtetasi Gerti Ymeri me OST sh.a. Kjo pasi OST sh.a dhe/ose ministrja (apo i besuari i kësaj të fundit që është administrator i OST sh.a) janë ankuar në mënyrë të përsëritur në KPK, se Gerti Ymeri i ka fituar gjyqet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, (me vlera materiale mbi 12 milion lekë, tashmë të ekzekutuara) pasi ka ndikuar tek gjyqtarët, (ka kanë rastisur që e kanë të gjithë kaluar vetingun), i vëllai i tij gjyqtari Andri Ymeri dhe motra e tij prokurorja Ajola Prençi.

- Lidhur me këtë, mendoj se ka qënë absolutisht detyrë e komisionit që në kuadrin e hetimit të kriterit të figurës time, si gjyqtar, të verifikonte nëse këto "pretendime për ndikime të paligjshme", të ngritura nga gjyqhumbësit, janë apo jo të vërteta. Kjo pasi edhe DSIK në raportin e saj, ngre dyshime kur shprehet për mua se ka informacione se ka ndikuar në mënyrë të paligjshme në procese të tjera.

Aq më tepër, ky verifikim duhej bërë edhe për shkak të faktit se ministrja që është motër e Komisioneres Pamela Qirko, prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që është edhe zëvendës/kryeministre, pra që ka nën vartësinë funksionale të saj, edhe DSIK-në, si dhe prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që DSIK fillimisht më ka nxjerrë të përshtatshëm, ndërsa pasi ministrja është bërë zëvendës /kryeministre, më ka nxjerrë të papërshtatshëm, me motivacionin, ndër të tjera "se paskam ushtruar ndikim të paligjshëm", por pa më thënë se ku.

- Pra, prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që "një dorë e kujdesshme" nuk ka hetuar ose nuk ka përmëndur në procesin tim të rivlerësimit (në kriterin e figurës time), nëse kam ndikuar ose jo që vëllai im Gerti Ymeri të fitojë mbi 12 milion lekë nga proceset gjyqësore me OST sh.a, që është shoqëri e kontrolluar nga ministrja, që është motra e komisioneres Pamela Qirko, duke vepruar

kësisoj, me dy standarte në raport me motrën time ku është hetuar po për këtë fakt. (Kjo duket qartë se është bërë për të fshehur gjendjen e konfliktit të interesit, të paktën në dukje, të Komisioneres Qirko në raport me personin tim).

- që prapë rastësisht (!!!) ka qëlluar që "një dorë e kujdesshme" nuk ka hetuar ose nuk ka përmëndur në procesin tim të rivlerësimit faktin që si vëllai im ashtu edhe unë personalisht, e kemi paditur OST sh.a dhe Ministrinë e Energjitikës me titullare Ministren në fjalë, për shpifjet dhe trillimet që ka bërë se unë në cilësinë e gjyqtarit kam ndikuar në gjykimet që ka me OST sh.a, vëllai im Gerti Ymeri. (Kjo duket qartë se është bërë për të fshehur gjendjen e konfliktit të interesit të Komisioneres Qirko në raport me personin tim). Ky gjykim vazhdon të jetë në zhvillim e sipër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- Po ashtu, në raport nuk përmëndet që Ministrja Belinda Balluku dhe/ose vartësi i saj në shoqërinë e kontrolluar prej saj, administratori i KESH sh.a, pasi ka/kanë marrë dijeni për padinë që kam depozituar unë dhe vëllai im kundër Ministrisë së Infrastukturës dhe Energjitikës dhe OST sh.a, me qëllim për të adresuar shpifjet dhe trillimet e mësipërme, pa kaluar një javë, dhe konkretisht me datën 27.09.2022, ka marrë masa për të pushuar nga puna në KESH sh.a, kunatin tim Ardit Hallunovi.

Këtu theksoj se në takimin e datës 05.10.2022, që punëmarrësi Ardit Hallunovi ka zhvilluar me shtetasen Joana Bushi, drejtoreshë e çështjeve të përgjithshme në KESH sh.a, të organizuar për të biseduar për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, (takim që Arditi i ka rregjistruar plotësisht), shtetësja Jonana Bushi, nuk shpreh asnjë rezervë për punën e Arditit, madje i thotë që "*je punëtor i dalluar*" por i thotë ndër të tjera edhe se "*për ty na ka marrë në telefon shefi i kabinetit të ministres*", "*Ti je kunati i Andrit*", "*na ka marrë në telefon konsulli turk*", etj.
I sjell në vëmëndje Komisionit se shtetësja Joana Bushi, më përpara ka qënë e punësuar të Autoriteti i Aviacionit Civil, si zëvendësdrejtoreshë, në kohën kur ka qënë titullare aty zonja Belinda Balluku.
- Në raport nuk përmëndet edhe që kunati im aktualisht ka cilësinë e paditësit në tre padi gjykimet e të cilave janë në zhvillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, që kanë të bëjnë me adresimin ligjor të problematikës në marrëdhëniet e punës që i ka krijuar atij, pas asnjë faj, zonja Belinda Balluku, (pra, motra e komisioneres Pamela Qirko), dhe vartësit e saj në KESH sh.a. Këto padi kanë të bëjnë pikërisht me diskriminimin për një grup shkaqesh bashkëekzistuese.

- Në raport nuk përmendet edhe fakti që konfliktet gjyqësore të vëllait tim Gerti Ymeri dhe kunatit tim Ardit Hallunovi, përkatësisht me OST sh.a dhe KESH sh.a, (shoqëri të kontrolluara nga motra e Komisioneres Pamela Qirko), kanë filluar pasi këta të afërm të mi kanë denoncuar në rrugë ligjore veprimet korruptive të të besuarve të Ministreses Belinda Balluku. (Në seancën dëgjimore kam paraqitur rregjistrime audio për të provuar këto veprime korruptive tashmë të adresuara në rrugë ligjore).

- Ndër rastësitë e mësipërme (!!!) padyshim bën pjesë edhe fakti që unë dhe motra ime, që të dy u përfshimë në të ashtuquajturin "short special" të datës 16.12.2019, si dhe fakti që asnjëherë as

asaj dhe as mua, ndonëse e kërkova disa herë, nuk mua dha ndonjë shpjegim për kriterin objektiv pse qëlloi që u përfshimë në këtë short special.

- Në fund të rastësive të mësipërme (!!!) po atë ditë që KESH sh.a, është njoftuar nga Gjykata se është thirrur si e paditur nga kunati im Ardit Hallunovi, (duke i dorëzuar bashkë me paditë, edhe një pjesë të materialeve audio që vërtetojnë se ai është diskriminuar për shkak se ka denoncuar korrupsionin), ka qëlluar që në orën 11 të natës (të datës 31.10.2022), mua më ka ardhur përmes emailit, raporti për rezultatet e hetimeve, për të cilin aktualisht po jap shpjegime.

Të gjitha faktet e mësipërme, po hiqem se i kuptoj që janë rastësi (!!!), pavarësisht se janë të shumta në numër, janë gjithashtu të rëndësishme, dhe që po të vlerësohen në sintezë me njëra tjetrën, duket qartë se, minimalisht, shërbejnë si indicie për të vërtetuar se Komisionerja Pamela Qirko, duket se është në konflikt interesi të shumëfishtë, si me mua, si me vëllain tim, si me kunatin tim, (për shkak të motrës së saj Belinda Balluku).

Kjo dukje e gjendjes së shumëfishtë të konfliktit të interesit, padyshim thellohet ose nga parregullsitë dhe gjendja e dukjes së konfliktit të interesit që unë mendoj se kjo komisionere shprehu në séance dëgjimore të datës 27.05.2022 dhe veçanarisht, në seancën dëgjimore të datës 13.06.2022, që unë e evidentova në shpjegimet që dhashë tek kriteri i figurës, (dëgjo rregjistrimet audio të këtyre dy seancave).

Pavarësisht se po hiqem kësisoj, pra po i konsideroj ose rastësi ose gabime të vogla dhe të pafajshme, gjithçka evidentova më sipër, një gjë nuk arrij t'a kuptoj. Kjo ka të bëjë me pyetjen se përse Komisionerja Pamela Qirko, duke u rikthyer tek rasti objekt analize në këtë pjesë të trajtimit, jep vlerësimet dhe konstatimet që "Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Subjekti ka gjykuar një padi e cila është parashkruar. Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin si dhe ka vepruar jo në përputhje me dispozitat e parashikuara nga K.Pr.Civile, për rrjedhojë ngrihen dyshime që subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse".

Veprimi i saj, nuk duket por është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", që parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".
Po ashtu, bie ndesh edhe me standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër.
Në çmuarjen time, Komisioni shkel kompetencat e tij, kur në mënyrë të hapur ose të nënkuptuar merr përsipër të vlerësojë drejtësinë e vendimit përfundimtar.

Po ashtu kur merr përsipër të japë vlerësim mbi mënyrën se si duhej të bëhej argumentimi/arsyetimi i vendimit. Ky kapërcim kompetencash është akoma më i qartë po të konsiderohet edhe neni 36/3 të KPC që parashikon se "*Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata*". Çështja

për të cilën më kërkohen shpjegime, është akoma në Gjykatën e Apelit Shkodër, prandaj si unë përmes këtij trajtimi ashtu edhe Komisioni, duhet të tregohemi të përmbajtur në trajtimin e rastit.

Çfarë synon të arrijë Komisioni tërthorazi, kur jep opinione që kanë të bëjnë me meritën e çështjes, në kuadrin e procesit tim të rivlerësimit ? A duket se kjo shkelje si e ligjit ashtu edhe e standartit detyrues të vendosur me vendimin e lartëpërmëndur të KPA, tek çdo vëzhgues i jashtëm, që është vërtet i pavarur në gjykim dhe vlerësim, krijon të ai dy përshtypje që janë:
1. Hakmarrja.
2. Synimi për të formësuar një opinion ligjor se çështjet e ngjashme me rastin objekt analize, ku merr pjesë Ministria e Energjitikës ose shoqëritë publike të varura prej saj, duhen zgjidhur në favor të këtyre të fundit, se në të kundërt ka edhe kërbaç për atë që vepron ndryshe ?
A është kjo mënyrë veprimi e Komisionit në pajtim me parimin e gjykimit të drejtë ?

Besoj se edhe vetë Komisionët e dinë përgjigjen e kësaj pyetjeje jo vetëm në mendjen e ttyre por edhe në thellësi të zemrës së ttyre, pasi këto pyetje kanë natyrë retorike.

Gjithsesi, me qëllim për t'a ç'montuar qëndrimin që mban në konflikt interesi komisionerja Pamela Qirko, (ku merr përsipër të japë vlerësime për meritat e çështjes), po u parashtroj një kërkesë procedurale.
Kërkoj që sipas nenit 191 të KPC, që është i zbatueshëm së bashku me ligjin 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, që të thirren si palë të interesuara në procesin tim të rivlerësimit edhe palët paditëse të vendimit për të cilin është ankuar Kurum International sh.a.

Kjo pasi unë kam interes përbashkues me këto subjekte, për shkak të faktit se unë nga njëra anë dua të vërtetoj se nuk i kam favorizuar, ndërsa këto subjekte qartësisht kanë interes të vërtetojnë se vendimi që kam dhënë unë, jo vetëm që është produkt jo i ndonjë favorizimi por edhe se është i drejtë, i arsyetuar dhe ligjor si dhe kanë interes që të parandalojnë formimin e çdo opinioni të kundërligjshëm që ndikon ose mund të duket se ndikon në veprimtarinë e Gjykatës së Apelit Shkodër, që akoma ka në shqyrtim çështjen.

<u>Së treti</u>: Lidhur me barrën e provës që më ngarkon Komisioni për të sjellë "vendime të ngjashme me të njëjtin afat përfundimi si në këtë gjykim", do u paraqes si provë disa vendime, në një ndër të cilët ka qënë palë e paditur OSHEE group sh.a. Në këtë vendim të fundit, me paditës Afrim Halluni, etj, çështjen jo vetëm e kam gjykuar në kohë të përafërt me rastin për të cilin po jap shpjegim në këtë pjesë të trajtimit, por e kam dhënë vendimin kundër "oshee group" sh.a, me ekzekutim të përkohshëm si dhe nuk kam pranuar kërkesën e palës së paditur që të pezullohet gjykimi civil derisa të zgjidhet çështja penale.

Arsyetimi i dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm është thuajse identik me rastin për të cilin po shprehem. (Po ashtu, në gjykimin e përfunduar përmes këtij vendimi, arsyetimi se përse nuk duhet pezulluar çështja civile deri sa të gjykohet çështja penale, është thuajse identik me arsyetimin e shprehur nga unë denoncimet e mësipërme, se përse nuk duhet pezulluar gjykimi i çështjes civile).

Këtë vendim po ua paraqes si provë pasi për këtë vendim, (por edhe për disa të tjera), Ministrja Belinda Balluku dhe/ose vartësit e saj, kanë bërë kallzim ndaj meje në SPAK, ankesa disiplinore në ILD si edhe në KPK, (por që nuk përmendet në raport me dashje).
Natyrisht, organet e drejtësisë së re, (me përjashtim të KPK), i kanë kushtuar këtyre kallzimeve/ankesave rëndësinë përkatëse dhe unë mendoj që pikërisht kjo gjë e ka detyruar komisioneren Pamela Qirko, që të shfrytëzojë funksionin e saj, në procesin tim të rivlerësimit, për të treguar se e "motra ose të besuarit e kësaj të fundit, kanë patur të drejtë" kur është/janë ankuar ndaj meje.

Unë pres që komisionerja Pamela Qirko të japë mendimin e saj lidhur me këtë vendim, (që ajo po m'a kërkon vetë, duke më ngarkuar barrë prove për të sjellë vendime të ngjashme), paçka se ka një vendim të KPK-së, në procesin tim të rivlerësimit që e përjashtoi Komisionerin Roland Ilia, për një situatë të ngjashme, (ku pjesë e trupës gjykuese që e përjashtoi këtë Komisioner ishin komisioneret Genta Tafa dhe Firdes Shuli).

Natyrisht, rastet kanë dallim me njëri tjetrin për shkak të faktit se komisioneri Roland Ilia nuk e ka motrën ministre, (madje nuk ka motër fare), si dhe komisioneri Roland Ilia nuk është kryetar i KPK, sikurse është komisionerja Pamela Qirko.

Në nenin 44/2015 "Kodi i Procedurave i Republikës së Shqipërisë", (i titulluar pengesat ligjore), parashikohet se: *Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjil, nuk përfshihet në një procedure administrative vendimmarrëse, në rastët kur: ..c) Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni, kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë ose me të njëjtën rrethana ligjore me çështjen në gjykim.*...ç*) Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial, merr pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim.....g) Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni, kanë marrëdhënie të tilla të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim*.

Për të vërtetuar konfliktin e interesit të Komisioneres Pamela Qirko, (që në vlerësimin tim është në kushtet e zbatimit të nenit 30, shkronja "c" dhe "g" të ligjit 44/2015), por edhe për të vërtetuar cilësinë e lartë të arsyetimit të vendimit që kam dhënë unë me ekzekutim të përkohshëm për rastin e Kurum international sh.a, si dhe të vendimit shëmbull që po iu paraqes, me paditës Afrim Halluni, etj, kundër OShEE group sh.a, i kam kërkuar Komisionit të më pranojë thirrjen e dëshmitarëve të mëposhtëm:

1. Belinda Balluku, Zv/kryeministre e Republikës së Shqipërisë.
2. Ergys Vjerdho, administor i KESH sh.a.
3. Joana Bushi, Drejtoreshë e çështjeve të Përgjithshme në KESH sh.a (ish zv drejtoreshë e Shërbimit
të Aviacionit civil).
4. Luan Heta, përgjegjës i njësisë Vau i Dejës në KESh sh.a.
5. Sokol Shkreli, shef i burimeve njerëzore në njësinë Vau i Dejës në KESh sh.a.
6. Mirlind Hekuri, shef i drejtorisë së burimeve njerëzore në KESh sh.a.
7. Shefin e Kabinetit të Ministrisë së Energjitikës, infrastukturës dhe sipërmarrjes.

8. Alma Dyrmishi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Çështjeve të Përgjithshme në OST sh.a.
9. Armela Dervishi, juriste përfaqësuese e OST sh.a, në gjykimet kundër vëllait tim Gerti Ymeri.
10. Irida Selhanej, drejtuese e Zyrës Vendore të Avokaturës së shtetit Shkodër.
11. Afërjona Lohja, avokate shteti në Zyrën Vendore të Avokaturës së shtetit Shkodër.
12. Ilda Neziri, Drejtoreshë e Drejtorisë juridike në OST sh.a.
13. Ardit Halluni, vëllai i bashkëshortes time.
14. Gerti Ymeri, vëllai im.
15. Vangjel Kosta, Pedagog në Shkollën e Magjistraturës, ish ekspert i nivelit të lartë i Reformës në Drejtësi.
16. Ardian Kalia, pedagod i Shkollës së Magjistraturës, për të drejtën ndërkombëtare private.
17. Komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi.
18. Dy-tre gjyqtarë, zgjidhini vetë ku të doni, që mund të pyeten nëse vendimi i Kurum International, është apo jo i paarsyetuar në çdo pjesë të tij.
19. Adrian Çela, administrator i OSHEE group sh.a.
20. Drejtorisa e drejtorisë juridike në OSHEE group sh.a.
Pas pyetjes së dëshmitarëve, do iu paraqes edhe disa rregjistrimet audio, vendime gjyqësore dhe prova të tjera, (pasi radha e ekspozimit të provave i përket atij që kërkon marrjen e tyre).

<u>Së katërti</u>: Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Subjekti ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi sipas pretendimeve të denoncuesit ai ka patur njohje me avokatin e pales paditëse, është shprehur privatisht për themelin e çështjes si dhe ka biseduar me njërin prej ekspertëve në zyrën e tij", ka një vendim gjyqësor që e keni të administruar në dosjen time të rivlerësimit, që e hedh poshtë këtë pretendim. Ky vendim është ai i marrë nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka hedhur poshtë, pretendimet e kësaj natyre. Po ashtu, kjo "dukja" që thotë komisioni, hidhet poshtë edhe nga vendimet e ILD dhe KLGj-së të cituara më sipër, që i konsiderojnë të pabazuara këto shpifje dhe trillime. Gjithsesi, e vlerësoj me vend të bëj pjesë të këtij materiali, edhe mendimin me shkrim që i kam paraqitur gjyqtarit që ka shqyrtuar kërkesën time për përjashtim nga gjykimi, të parashiqur nga Kurum International sh.a.

"(E shkruar me shkrim dore nga unë, që do ua paraqes si provë)... ommisis...Pasi jam njohur me kërkesën, kam për të shprehur sa më poshtë;
<u>Lidhur me shkakun e parë të përjashtimit (takimi me avokatin Idlir Duhanxhi).</u>.ky ka ndodhur rreth një muaj më parë dhe ndryshe nga sa pretendohet, unë kurrë nuk kam dhënë ndonjë mendim për çështjen apo për gjykimin ose për ndonjë çështje tjetër. Duke qënë se avokati në fjalë, është pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, mbaj mend që kemi diskutuar në mënyrë të përgjithshme çështje të interpretimit të ligjit por jo rrethana të çështjeve që unë kam për gjykim. Takimi ka qënë jo vetëm ne të dy por ka qënë në prani edhe të një personi të tretë që është ish Rektori i Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër.
Madje, pikërisht prezenca e këtij të fundit ka përbërë shtysën që unë të pranoj të ulem për të pirë kafe me avokatin, të cilin ndonëse e njoh, kemi vetëm një matrrëdhënie kordiale por jo shoqëri. Pjesa tjetër e fakteve të pretenduara janë të pavërteta, të manipuluara, të shtrëmbëruara, të pasakta dhe me natyrë provokuese. Për rrjedhojë çmoj se nuk duhet të zgjatem më tej.

<u>Lidhur me shkakun e dytë, takimi me ekspertin</u>. Pas mbarimit të seancës, eksperti Tauland Muka, me profesion mjek ligjor, ka qënë në zyrën time për të marrë një datë për një çështje tjetër. Ndërkohë, në zyrën time ka ardhur edhe avokati Idlir Duhanxhi, me qëllim për të më takuar por

unë nuk kam pranuar që ta takoj sikurse ishte kërkesa e tij. Pasi unë i refuzova takimin ai më tha fjalët "bën mirë me dhanë dorëheqje". Kaq është fakti. Lidhur me takimin me ekspertin, në zyrë, ai nuk është i fshëhtë sikurse pretendohet, aq më shumë nuk është i ndaluar. Kjo pasi eksperti nuk është palë dhe as përfaqësues palësh ndërgjyqëse.
Duke iu rikthyer shkakut të parë, takimit me avokatin Idlir Duhanxhi, nënvizoj faktin se unë jo vetëm që nuk e kam ditur por as mund të dija se ky avokat ishte avokat i çështjes për palën e paditur Kurum International sh.a. Kjo pasi pala e paditur akoma nuk e kishte paraqitur dekleratën e mbrojtjes. Pra, përjashtohet mundësia që të kem diskutuar me të rrethana të çështjes.
<u>Në përfundim</u>: kërkesa është e pabazuar në prova, abuzive dhe sipas nenit 74 të KPC, kërkoj rrëzimin e saj në themel".

<u>Së pesti</u>: Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit", duke u treguar i përmbvajtur, pasi Komisioni më fyen me këtë konstatim dhe vlerësim arbitrar, vlerësoj se jo vetëm vendimi është i argumentuar mjaftueshëm, por është argumentuar shkelqyeshëm. Po citoj një pjesë të vendimit më poshtë:
I*. <u>"ommisis. Kam cituar paragrafët 137 - .183 të vendimit të dhënë nga unë për këtë çëështje</u>*. E vlerësoj të pavend që t'i citoj edhe një herë në këtë ankim.
I lutem Kolegjit që t'i lexojë këto paragrafë pasi nga përmbajtja e tyre vlerësoj se duket qartë cilësia e lartë e arsyetimit të vendimit, dhe indirekt edhe pabazueshmëria e vlerësimit të Komisionit, se masa dhe mënyra e përllogartijes së dëmit është e pargumentuar.

<u>Së gjashti</u>: Lidhur me Konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Subjekti ka gjykuar një padi e cila është parashkruar", duke u treguar i përmbajtur, vlerësoj se jo vetëm kjo pjesë e vendimit është i argumentuar mjaftueshëm, por është argumentuar shkëlqyeshëm. Po citoj një pjesë të vendimit më poshtë:
"*ommisis... <u>Kam cituar paragrafët 124 - .135 të vendimit të dhënë nga unë për këtë çëështje</u>*. E vlerësoj të pavend që t'i citoj edhe një herë në këtë ankim.
I lutem Kolegjit që t'i lexojë këto paragrafë pasi nga përmbajtja e tyre vlerësoj se duket qartë cilësia e shkëlqyer e arsyetimit të vendimit, dhe për rrjedhojë edhe pabazueshmëria e vlerësimit të Komisionit, se padia është e parashkruar. (Këtu qartësisht është e pamohueshme se Komisioni merr përsipër të shprehet për zgjidhjen e çështjes në themel duke kapërcyer target që i ka dhënë ligjvënësi vetëm si vlerësues).

<u>Së shtati</u>: Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Subjekti nuk ka argumentuar dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm", duke u treguar i përmbvajtur, vlerësoj se jo vetëm kjo pjesë e vendimit është i argumentuar mjaftueshëm, por është argumentuar shkëlqyeshëm. Po citoj një pjesë të vendimit më poshtë:
"*ommisis... <u>Kam cituar paragrafët 194 - 211 të vendimit të dhënë nga unë për këtë çëështje</u>*. E vlerësoj të pavend që t'i citoj edhe një herë në këtë ankim.
Edhe këto paragrafë I lutem Kolegjit t'i lexojë.

Natyrisht, unë e pres që Komisionerja Pamela Qirko, do t'a quajë këtë pjesë të vendimit të paarsyetuar. Kjo pritshmëri më krijohet pasi po kështu kam arsyetuar dhe vlerësuar edhe në vendimet e dhëna kundër OSHEE Group sh.a, ku kjo e fundit ka dalë gjyqhumbëse.

Por, besoj kam një rrethanë lehtësuese. Kjo rrethanë ka të bëjë me faktin se unë as e kam ditur dhe as kisha mundësi që t'a dija përpara se të jepja vendimin, mendimin që ka komisionerja Pamela Qirko, se si duken gjykuar çështjet ku palë e paditur janë OSHEE group sh.a, FSHU sh.a, KESH sh.a, OST sh.a, etj !! Në këto gjykime, këto shoqëri tregtare – a duhet të dalin gjyqhumbëse apo gjyqfituese, si duhen argumentuar vendimet në këto raste, si duhet të veprojnë gjyqtarët lidhur me intepretimin që duhet t'I bëjnë gjyqtarët nenit 317 të KPC, etj.

Unë edhe tek çështja për të cilën ka bërë ankesë Kurum International sh.a, kam zbatuar të njëjtin standart që kam ndjekur në gjykimet me OSHEE group sh.a, FSHU sh.a, etj. Kjo pasi kam besuar deri tani se parimi i gjykimit të drejtë nënkupton zbatimin e parimit të lashtë të së drejtës romake, "***in re eadem est eadem solutio***", në çështje të njëjta, jepen zgjidhje të njëjta.

Të njëjtin qëndrim me mua, duke u rikthyer tek ankesa e Kurum International sh.a, kanë patur edhe institucionet e drejtësisë së re si ILD dhe KLGj, që ndër të tjera janë shprehur se gjyqtari është i pavarur në mënyrën se si e bën intepretimin si të ligjit ashtu edhe të fakteve që kanë rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe se mospëlqimi ndaj këtyre vlerësimeve të gjyqtarit, mund të shtrohet vetëm në rrugën e ankimit gjyqësor në Gjykatat më të larta.

Në përfundim të shpjegimeve lidhur me ankesën e Kurum International sh.a, dua të theksoj se vlerësimet e Komisionit "lidhur me cilësinë e argumentimit të mënyrës se si unë kam përcaktuar në vendim, metodologjinë e përllogaritjes së dëmshpërblimeve, të faktit se sa janë këto dëmshpërblime, vlerësimi se padia është parashkruar si dhe vlerësimi se dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, është e gabuar", qartësisht kanë ka të bëjnë me meritën (themelin) e çështjes dhe KPK del jashtë kompetencës së saj po të shprehet për meritën e çështjes, duke shkelur kësisoj standartin e vendosur me vendimin 28/2020 JR të KPA, që u citua më sipër.

Nëse KPK, vijon t'a bëjë (sikurse e ka bërë deri tani), kjo ka vetëm një shpjegim. Konflikti i interesit që shpjegova më sipër. Pra, e bën: - se i pëlqen, - se do ta bëjë. Pra ka vetëm moment volitiv që e shtyn t'a bëjë dhe nuk ka moment intelektual.

Dihet botërisht se pyetjeve "pse do" ose "pse s'do", "pse të pëlqën" ose "pse nuk të pëlqen", është vështirë t'iu përgjigjesh me argumente logjike (ku futen edhe argumentet ligjore). Kjo pasi bie fjala, po të më pyesësh mua "pse kam rënë në dashuri me bashkëshorten time", pavarësisht nga fakti që unë do të them se ajo është më e bukura, më e zgjuara, më e devotshmja grua në gjithë rruzullin tokësor, përveç fëmijëve të mi dhe të saj, të tjerët, maksimumi do buzëqeshin në mënyrë domethënëse, me atë që unë e them si të vërtetë.

Lidhur me qëndrimin tim tim të mësipërm, Komisioni në vendim është shprehur se:

90.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me kërkesën e subjektit për të thirrur si palë të interesuara në procesin e tij të rivlerësimit edhe palët paditëse të vendimit objekt vlerësimi, Komisioni, vendosi ta refuzojë këtë kërkesë, pasi procesi i rivlerësimit është një proces që sjell pasojë vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe asnjë person tjetër.

*ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se KLGJ-ja dhe ILD-ja janë shprehur në lidhje me këtë ankesë, Komisioni vlerëson se kompetencat e ILD-së dhe KLGJ-së nuk lidhen me kompetencat që i përkasin Komisionit. Për më tepër, juridiksioni i Komisionit lidhet vetëm me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve dhe në këtë proces është i pavarur nga çdo vendimmarrje e organeve të tjera. KLGJ-ja, në vendimin nr. **, datë 7.11.2022, në faqen 5, pika 13.1, në lidhje me pretendimin e ankuesit se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Shkodër konfirmon zbatimin e gabuar të ligjit procedural nga ana e subjektit, shprehet se ky pretendim nuk është pjesë e vendimit objekt ankimimi të ILD-së, kjo edhe për faktin se dispozitivi i Gjykatës së Apelit Shkodër mban datën 14.7.2022.*

iii) Duke qenë se pas kalimit të barrës së provës subjekti nuk depozitoi dokumentacionin e kërkuar në lidhje me këtë çështje gjyqësore, Komisioni do të bazohet në një pjesë të konkluzioneve të vendimeve të ILD-së dhe KLGJ-së për të analizuar sa më drejt këtë çështje të subjektit. Refuzimi nga ana e subjektit për të depozituar dokumentacionin e kërkuar do të konsiderohet si mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, pasi duket se është bërë me qëllim arritjen e një rezultati në favor të subjektit.

90.9. Më konkretisht, nga ana e subjektit nuk është paraqitur dokumentacion provues për shortimin e kërkesëpadisë, numrin e kërkesëpadive të depozituara nga paditësi, si dhe dosjen gjyqësore të vendimit.

*i) Në lidhje me shortimin e çështjes, bazuar në faqen 4 të vendimit nr. ***, datë 20.7.2022, të ILD-së, rezulton se çështja civile është regjistruar në datën 3.6.2021 dhe po në këtë datë është shortuar elektronikisht, duke i kaluar me short subjektit I.K. Kjo çështje është rishortuar në datën 7.6.2021 për shkak të kërkesës për dorëheqje të gjyqtares, duke i kaluar me anë të shortit subjektit. Ndërkohë, nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e mundshëm të kërkesëpadive të paraqitura nga pala paditëse.*
*ii) Në po të njëjtën faqe të vendimit të ILD-së rezulton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur për përjashtimin e subjektit është rrëzuar me vendimin nr. ***, datë 28.7.2021. Komisioni nuk 113 mund të vijojë vlerësimin në lidhje me konfliktin e interesit, për sa kohë ka një vendim gjykate, i cili ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar dhe nuk konstatohet shkelje procedurale që nuk lidhen me themelin e çështjes.*
iii) Në faqen 5 të këtij vendimi deklarohet se subjekti ka rrëzuar kërkesat për konstatimin e parashkrimit të padisë. Komisioni nuk mund të vijojë vlerësimin në lidhje me rrëzimin e kërkesave për sa kohë ka një vendim gjykate, i cili ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar dhe nuk konstatohen shkelje procedurale që nuk lidhen me themelin.
iv) Në lidhje me barrën e provës, për sa i përket argumentimit të masës së dëmshpërblimit, si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka cituar pjesë të vendimit të tij, të cilat ishin analizuar nga Komisioni dhe për këtë arsye iu kalua barra e provës subjektit.
v) Për sa i përket aplikimit të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, ai është shterues, si dhe ka përcaktuar kritere për zbatimin e tij, të cilat në vendimin e subjektit nuk janë të argumentuara.
vi) Subjekti, në paragrafin 195/b të vendimit nr. 436, datë 8.6.2022, shprehet se: "Të gjitha rastet e tjera që nuk përfshihen në kategorinë e parë, vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm kur paditësi vërteton me prova se ekzekutimi i vendimit i dhënë nga gjykata e

shkallës së parë mund të bëhet i pamundur... Gjykata mund të ushtrojë diskrecionalitet për të vendosur nëse duhet dhënë apo jo vendimi me ekzekutim të përkohshëm vetëm kur paditësi paraqet prova...".
*vii) Në vendimin nr. ***, datë 8.6.2022, për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm për palën paditëse N.M, subjekti është referuar në nenin 317/1/b të Kodit të Procedurës Civile. Ky referim i subjektit nuk përputhet me parashikimin e kësaj dispozite, pasi paditësi në kërkesëpadi ka kërkuar shpërblim dëmi, i cili në një vendim tjetër (trajtuar në pikën 91.8 të këtij vendimi) të subjektit trajtohet si detyrim për ushqim. Nga ana e subjektit nuk referohet në asnjë provë të paraqitur nga ana e paditësve për të provuar, sikurse shprehet vetë ai, se ekzekutimi i dhënë nga gjykata mund të bëhet i pamundur.*

90.10. Komisioni nuk mund të analizojë vendimmarrjen e themelit të subjektit, e cila nga vendimi i KLGJ-së duket se është cenuar në Gjykatën e Apelit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vijojë më tej me analizimin e vendimit të subjektit për sa i përket caktimit të masës së shpërblimit apo të trajtimit të kësaj marrëdhënieje.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

Lidhur me arsyetimin e vendimit të Komisionit si më sipër, shpreh përpara Kolegjit konsideratat se:

Së pari: Urdhërimi që më ka bërë Komisioni për të depozituar tërësinë e fashikullit gjyqësor, (që për më tepër nuk ndodhej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër), dhunon parimin e proporcionalitetit të barrës së provës. Kjo pasi ky fashikull është mijëra faqe dhe vetëm koha fizike dhe shpenzimet monetare për riprodhimin përmes fotokopjimit të këtij fashikulli, zhvillimi i korrespondencës me Gjykatën e Apelit Shkodër me qëllim sigurimin e tij, do kompromentonin shumë rëndë si kohën fizike që unë kisha për të përgatitur mbrojtjen time përpara Komisionit, (që ishte e kufizuar 14 ditë). Po ashtu, edhe do më detyronin të bëja shpenzime ekonomike jo të pakonsiderueshme, pa asnjë qëllim të ligjshëm. Nga ana tjetër nuk kishte asnjë pengesë për Komisionin që ai t'a tërhiqte vetë kopjen e dosjes përmes korrespondencës me Gjykatën e Apelit Shkodër, ku ndodhej fashikulli gjyqësor (dosja), gjë që e ka bërë në raste të tjera. Bëj me dije Kolegjin se vetëm nga fotokopjimi i fashikujve gjyqësore që më ka ngarkuar si barrë prove për të sjellë Komisioni, unë kam kryer shpenzime ekonomike rreth 40.000 lekë dhe kam shpenzuar 3 ditë kohë.

Së dyti: Unë rikonfirmoj se qëndrimi im për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, është i ligjshëm. Kjo duket qartë nga vetë përmbajtja e vendimit. Komisioni me dashje, për të krijuar kakofoni dhe paqartësi shprehet se nuk janë rastet e parashikuara në nenin 317 të KPC për t'u dhënë vendimi me ekzekutim të përkohshëm. Unë kam arsyetuar në vendim, (dhe Komisioni me dashje bën se nuk e kupton), që dëmshpërblimi që kam dhënë përbëhet nga disa zëra. Një pjesë e këtyre zërave përfshihet në pikën "detyrim për ushqim", një pjesë tjetër në pikën "shpërblim nga puna" si dhe zërat që mbeten përfshihen "si shpenzimet e varrimit", apo "shpërblimi i dëmit jopasuror" përfshiheën në fushën e zbatimit të paragrafit të dytë të nenit 317 të KPC. Përveç kësaj, kam arsyetuar qartësisht dhe me nivel të lartë se intepretimi leksikor, teleologjik (qëllimor), sintetik dhe krahasimor që i bëj unë tërësisë së normës së parashikuar në

nenin 317 të KPC, të çon në kuptimin se kjo normë nuk është shteruese (sikurse shprehet komisioni) por rastet e përshkruara në të janë orientuese, ilustrative. Pa dashur të zgjatem, i lutem Kolegjit që të ketë parasysh edhe qëndrimin tim të shprehur në pjesën e ankimit "shkaqet e ankimit", të titulluar "së gjashtëmbëdhjeti", (shih faqet 46-48).

Së treti: Komisioni thotë të pavërtetën kur shprehet se "*Nga ana e subjektit nuk referohet në asnjë provë të paraqitur nga ana e paditësve për të provuar, sikurse shprehet vetë ai, se ekzekutimi i dhënë nga gjykata mund të bëhet i pamundur*". Vetë përmbajtja e vendimit, (tek pjesa ku arsyetohet dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm), e përjashton si të pavërtetë këtë konstatim të komisionit. Si prova të tilla mund të përmenden akti i ekspertimit psikologjik, akti i ekspertimit mjekoligjor që ka konstatuar dëmtime tek të gjithë paditësit, etj, (për me tepër i lutem Kolegjit të shohë përmbajtjen e vendimit).

Së katrërti: Komisioni përdor si argumentim në paragrafin 90.9, pika "iv", shprehje që ose janë të paqarta (e keqja më e vogël) ose që poërmes nënkuptiumit lënë shteg për intepretime të paligjshme. Konkretisht, Komisioni në këtë pjesë të vendimit shprehet në formë vlerësuese "*Në lidhje me barrën e provës, për sa i përket argumentimit të masës së dëmshpërblimit, si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka cituar pjesë të vendimit të tij, të cilat ishin analizuar nga Komisioni dhe për këtë arsye iu kalua barra e provës subjektit*". Po të jetë kjo shprehje e paqartë kemi të bëjmë me mungese arsyetimi, ndërsa por të merret kjo shprehje si nënkuptim i faktit se nuk kam përmbushur barrën e provës lidhur me argumentimin e masës së dëmshpërblimit dhe ekzekutimin e përkohshëm, kemi të bëjmë me shkelje të parimit të ligjshmërisë nga komisioni pasi ai merr përsipër të zëvendësojë logjikën time si gjyqtar, me logjikën e tij si dhe cënon kësisoj pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Përdorimi i kësaj shprehjeje nga Komisioni, duket se është në kontradiktë të hapur më paragrafin 90.10 të vendimit të tij, ku Komisioni shprehet se "*Komisioni nuk mund të analizojë vendimmarrjen e themelit të subjektit, e cila nga vendimi i KLGJ-së duket se është cenuar në Gjykatën e Apelit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vijojë më tej me analizimin e vendimit të subjektit për sa i përket caktimit të masës së shpërblimit apo të trajtimit të kësaj marrëdhënieje* ".

I lutem Kolegjit të mbajë qëndrimin e duhur ligjor lidhur me këtë kontradiksion në arsyetimin e vendimit të Komisionit, pasi përmes tij bëhet e pamundur të kuptohet qartë se si është arritur nga Komisioni në vlerësimin përmbledhës lidhur me çështjen, se "*Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016* ".

Së pesti: Në vlerësimin tim, për vendimin tim objekt analize që kritikohet pakuptueshmërisht përmes arsyetimit të shprehur në vendim nga Komisioni, nuk mund të thuhet se ai reflekton mangësitë e mia në aspektin e njohurive ligjore. Madje edhe pala ankuese në KPK, (ndryshe nga Komisioni), nuk pretendon se kam paaftësi/mangësi në njohjen e ligjit, por pretendon se "*ajo ka dyshime të arsyeshme se kërkesë padia është hartuar nga vetë subjekti duke u bazuar në faktin se: Kërkesa padia është 160 faqe dhe ka 151 prova bashkëngjitur ku bie në sy niveli i lartë i profesionalizimit dhe referencat e shumta në praktikat gjyqësore (pjesë prej të cilës janë marrë pikërisht nga vendimet e vetë subjektit të rivlerësimit*". Dukë lënë mënjanë shpifjet e palës ankuese se jam unë ai që kam hartuar padinë, i lutem Kolegjit të fokusohet tek mendimi i lartë që

ka pala për profesionalizimin tim si gjyqtar, (pavarësisht se në mënyrë abuzive mundohet që përmes këtij profesionalizimi të argumentojë shpifjen).

Nuk dua të zgjatem shumë për të kundërshtuar qëndrimin e Komisionit lidhur me njohuritë e mia ligjore pasi tek e fundit këtë qëndrim e ka mbajtur komisionerja Pamela Qirko, që në vlerësimin tim përbën shembullin flagrant të paralelizimit të procesit tim të rivlerësimit me atë fabulën e ariut dhe lepurit që tregova në pjesën hyrëse të këtij ankimi. (Këtu mjafton të kujtohet mesatarja 7,14 e notave të saj gjatë studimeve me korrespondencë, që edhe aq nuk do të ishte po të mos kishte marrë dy nota 10-ta në fiskulturë, pra në vrapim, kërcim, paralele, kapërcim, etj).

Së gjashti: I lutem Kolegjit që në vlerësimin e tij lidhur me këtë çështje, të konsiderojë si mendim të specializuar edhe qëndrimin që ka mbajtur një organ i drejtësisë së re sikurse është ILD lidhur me respektimin e pavarësisë së magjistratit në kryerjen e detyrës jo vetëm në këtë çështje por edhe në rastet e inspektimit që ka bërë në n jë raport të tij për disa magjistratë lidhur me rastet e dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm, që unë e kam dorëzuar si provë, (në favorin tim lidhur me ankesat e bëra nga BSSH ndaj disa magjistratëve, ndër të cilët bëj pjesë edhe unë). Po ashtu, të konsiderojë edhe qëndrimin që ka patur KLGj në rastin objekt ankese. Kjo pasi po të kishte të dhëna të mjaftueshme për të filluar procedim disiplinor, KLGJ do shprehej në vendim se ILD do duhej të rifillonte hetimin disiplinor ndaj meje. Fakti që KLGj ka hedhur poshtë ankesën disiplinore ndaj meje është tregues i qartë se kjo ankesë është gjetur e pabazuar. Gjithashtu, i lutem Kolegjit që të ketë parasysh sipas parimit të barazisë në trajtim edhe faktin që për subjektin e rivlerësimit Ramiz Lala, KPA nuk ka gjetur shkelje kur ka analizuar një çështje tek e cila kolegu im e kishte dhënë vendimin përfundimtar me ekzekutim të përkohshëm, (madje duke e arsyetuar këtë pjesë të vendimit shumë më dobët cilësisht nga sa e kam arsyetuar unë në vendimin tim, në çështjen objekt analize).

Së shtati: I lutem Kolegjit që në vlerësimin e tij lidhur me këtë çështje, të ketë parasysh veçanarisht parimin e proporcionalitetit. Kjo pasi edhe nëse pjesa e vendimit tim lidhur me ekzekutimin e përkohshëm konsiderohet e gabuar, (gjë që unë kam mendim të kundërt), kjo pjesë e vendimit, për shkak të natyrës së saj është vendim i ndërmjetëm dhe për rrjedhojë, nuk afekton fatin e përfundimit të gjykimit. Në vlerësimin tim nuk do të kishte aspak balancë ndërmjet ndështkimit tim për këtë pjesë të vendimit, me qëllimin që synohet të arrihet, nëse zgjidhja që i kam dhënë çështjes në themel mbetet në fuqi në gjykatat më të larta.

Në përfundim: Unë vlerësoj se pjesa objekt analize e vendimit të Komisionit nuk është në përputhje me parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit. Ajo dhunon pavarësinë e vendimarrjes së gjyqtarit pasi Komisioni merr përsipër të vlerësojë vendimin në themelin e tij, (lidhur me drejtësinë e dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm dhe masën e dëmshpërblimit). Ajo cënon rëndë parimin e ligjshmërisë pasi vlerësuesi (Komisioni) nuk mund të zëvendësojë logjikën e shprehur në arsyetimin e gjyqtarit me logjikën e tij lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Në përmbledhje, kjo pjesë e vendimit nuk është gjë tjetër veçse një qëndrim subjektiv i vetë Komisioneres Pamela Qirko, e cila synon të formësojë "një opinion ligjor" që i leverdis motrës së saj, Ministres Belinda Balluku lidhur me pyetjen: - nëse një vendim që cakton dëmshpërblim,

- A duhet apo jo të jepet me ekzekutim të përkohshëm[64] ? Për më tepër, kjo leverdi (interes) i ministres Belinda Balluku, është evident pasi ajo ka bërë ankesa në shumë institucione ndaj meje (përfshirë KPK) që janë rredhojë e qëndrimeve të njëjta që kam mbajtur gjithmonë, në gjykimet me OSHEE sh.a, që kanë patur objektivisht të njëjtat rrethana ligjore dhe fakti me çështjen objekt analize. Kjo nuk bën gjë tjetër veçse tregon qartë konfliktin e interesit që ka patur komisionerja Pamela Qirko, për të dhënë opinionin e saj për vlerësimin e kësaj çështjeje, në procesin tim të rivlerësimit[65].

Për më tepër, konsideratat e dhëna në këtë vendim nga komisionerja Pamela Qirko janë edhe tregues të "veprimit me dy standarte" që ka ndjekur Komisioni në vlerësimin e kësaj çështjeje në procesin tim të rivlerësimit[66].

8. OSHEE (nr.3615 datë 3.10.2022).

Nga raporti rezulton se:

Nga ana e denoncuesit pretendohet se subjekti ka vendosur që vendimi i tij të jepet me ekzekutim të përkohshëm në shkelje të nenit 317 të K.Pr.Civile.
Nga analizimi i ankesë konstatohet se objekti i padisë ka qënë dëmshpërblim dëmi i cili nuk klasifikohet në objekt e padisë të përfshira në nenin 317 të K.Pr.Civile.
Për sa më sipër duket se:
Subjekti nuk ka argumentuar vendimin për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe për të depozituar dosjen gjyqësore së bashku me vendimin.

Lidhur me këtë denoncim, përpara Komisionin kam mbajtur qëndirmin si më poshtë:

<u>Së pari</u>: Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "*objekti i padisë ka qënë dëmshpërblim dëmi i cili nuk klasifikohet në objekt e padisë të përfshira në nenin 317 të*

[64] Nuk duhet harruar se rastet më të shumta dhe më të rënda që janë bërë objekt i kontrollit gjyqësor kur pretendohet diskriminim në marrëdhëniet e punësimit dhe/apo dëmtimi i shëndetit ose jetës, janë pikërisht ato në të cilat si palë diskriminuese dhe/apo dëmtuese e shëndetit ose jetës, paraqiten organet e pushtetit ekzekutiv shtetëror dhe/apo shoqëritë aksionare me mazhorancë të kapitalit shtetëror. Pikërisht, pothuajse në majë të piramidës së këtyre organeve shteterore dhe/apo strukturës organizative të shoqërive aksionare me mazhorancë të kapitalit shtetëror, ushtron një funksion të lartë shtetëror, motra e komisioneres Pamela Qirko, që është zëvendës kryeministrja Belinda Balluku, që për shkak të funksionit të saj ka nën varësi edhe DSIK-në.

[65] Shih nenin 30 shkronja "c" të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", veçanarisht duke u përqëndruar në togfjalëshin "*personat e përmëndur në pikën* "b" si dhe togjalëshin "*një çështje objektivisht të njëjtë ose me të njëjtën rrethana ligjore me çështjen në gjykim* ".

[66] Këtu shih vendimin e përjashtimit të Komisionerit Roland Ilia, (që u përjashtua me kërkesën time pasi nuk mund të jepte vlerësim për një çështje ku ai kishte qënë avokat i palës së paditur). Gjithashtu, këtu shih edhe vendimin e përjashtimit të komisioneres Etleda Çiftja, (që u përjashtu me kërkesën time, pasi ekzistonte mundësia apo dukja e mundësisë që ajo të krahasonte dy çështje që ishin objektivisht me të njëjtat rrethana me njëra-tjetrën, dhe konkretisht, pozita e saj lidhur me hetimin e pasurisë nga SPAK me pozitën time ku kjo komisionere po më hetonte lidhur me kriterin e pasurisë).

K.Pr.Civile", është e qartë (sikurse u shpreha edhe tek ankesa e bërë nga Kurum International sh.a), se unë dhe Komisioni, bëjmë një intepretim të ndryshëm të përmbajtjes së normës të nenit 317 të KPC.

(Ju lutem shiheni edhe një herë, tek vendimi i Kurum International sh.a, vendimi i Afrim Hallunit[67] por edhe tek vendimi konkret për të cilin është ankuar OSHEE sh.a, mënyrën se si e intepretoj unë kuptimin e fjalëve "shpërblim nga puna", "detyrim për ushqim" si dhe shiheni edhe mënyrën se si e konsideroj unë "që përmbjatja e nenit 317 të KPC, duke iu referuar ratios së normës, nuk mund të konsiderohet si dispozitë taksative, (pra me raste të mbyllura), por si dispozitë indikative, orientuese, (pra e hapur dhe rastet që tregohen në të, kanë natyre ilustrative)".
Kjo mënyrë e kuptimit dhe intepretimit të normës juridike, duke bërë intepretim pajtues të tekstit të saj, me ration e përmbajtjes së saj, nuk është shpikje e imja, pra nuk e kam zbuluar vetëm unë këtë lloj intepretimi. (Edhe sikur të ishte shpikje, nuk ka gjë të keqe pasi besoj se gjyqtarëve në veprimtarinë e tyre, iu lejohet që t'a zhvillojnë praktikën gjyqësore, pra të guxojnë në hapjen e debateve juridike lidhur me mënyrën e intepretimit të normave të së drejtës, për të cilat nuk ka qëndrim të konsoliduar nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese).

Kjo mënyrë e intepretimit të normës, duke bërë intepretim pajtues të tekstit të saj, me ration e përmbajtjes së saj, është ndjekur nga shumë gjykata. P.sh, si më poshtë:

Neni 625: *Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:*
a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
c) është cenuar e drejta e emrit;
ç) është cenuar respektimi i jetës private;
d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.

Gjykata e Lartë, lidhur me nenin 625 të Kodit Civil, duke bërë një interpretim pajtues të tekstit të normës, me ration e ekzistencës së saj, ka arritur në përfundimin se rastet e cilësuara/treguara nga dispozita, nuk përbëjnë një listë shteruese dhe taksative të rasteve në të cilat gjen zbatim kjo normë, por këto raste kanë karaker indikativ/tregues dhe ilustrues se kush ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmin moral, ekzistencial, biologjik jopasuror, etj.

Të njëjtën metodë të intepretimit të nenit 317 të KPC, kam ndjekur edhe unë[68].

A mund të konsiderohem unë përgjegjës për këtë. A ka ndonjë vendim të Gjykatës së Lartë ose të Gjykatës Kushtetuese që është i detyrueshëm për zbatim nga ana ime, që të bjerë në kundërshtim me intepretimin që i bej unë normës !!!
Jo vetëm nuk ka të tillë, por njësoj sikurse unë, ka vendime të dhëna edhe nga gjyqtarë të tjerë, disa prej të cilëve kanë kaluar vetingun, p.sh Ramis Lala, Ornela Naqellari, etj. Për të vërtetuar

[67] Që e kam paraqitur si provë sipas kërkesës së Komisionit për të sjellë vendime të ngjashme.
[68] I lutem Kolegjit, të shohë këtu edhe argumentimin tim të shprehur në pjesën e "shkaqeve të ankimit", të titulluar "së gjashtëmbëdhjeti", veçanarisht të shohë faqet 46, 47 dhe 48 ku jap një shëmbull tjetër kur norma intepretohet kështu sikurse e kam intepretuar unë dhe këtë intepretim e ka bërë ONM, Avokati i Popullit dhe Kuvendi.

këtë, do iu paraqes si provë një vendim të ILD, që ka trajtuar problematikën e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, nga disa gjyqtarë, (ku bëj pjesë edhe unë).
ILD në këtë vendim, shprehet ndër të tjera se mospëlqimi ndaj vendimarrjeve të gjyqtarëve, lidhur me këtë tematikë, mund të adresohet vetëm në rrugën e ankimit gjyqësor në Gjykatat më të larta dhe jo përmes ankesave me natyrë disiplinore. Kjo pasi në të kundërt, kapërcehen kompetencat e ILD si dhe cënohet pavarësia e pushtetit gjyqësor e parashikuar në nenin 3 të ligjit 96/2016, që parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".

<u>Së dyti</u>: Lidhur me konfliktimin e interesit, të paktën në dukje, që ka komisionerja Pamela Qirko në trajtimin e këtij rasti, u shpreha edhe më sipër (tek ankesa e Kurum International sh.a). Pikërisht, ky konflikt interesi m'a minon, madje m'a asgjëson besimin se procesi im i rivlerësimit do të jetë një proces i drejtë dhe i paanshëm.
Kjo jo vetëm për sa përmënda më sipër (tek rasti in Kurum International sh.a, si dhe lidhur me sjelljen e papërshtatshme të kësaj komisionereje në seancën e datës 13.06.2022, që i evidentova tek kriteri i figurës).

Këtyre elementëve të mësipërm, që minojnë besimin tim në një gjykim të drejtë, iu shtohet edhe fakti që Komisionerja Qirko, nuk është vetëm pjesë e trupës time gjykuese, por njëkohësisht është edhe Kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Për rrjedhojë, për shkak të këtij funksioni të dytë, ka kontroll edhe mbi këshilltarët juridikë dhe ekonomikë, që kanë ushtruar dhe ushtrojnë veprimtari në rastin tim.

Madje, lidhur me këta këshilltare/ekspertë, sjell në vëmëndje të Komisionit, se për gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, mua nuk m'u tha se kush janë konkretisht këta këshilltarë apo ekspertë, (ndonëse e kërkova disa herë me kërkesa me shkrim). Po ashtu nuk m'u tha - a kanë ndryshuar apo jo ata pasi u largua komisioneri relator Roland Ilia, etj. Pra, nuk m'u dha asnjë lloj informacioni apo garancie, mbi rregullshmërinë e procesit të hetimit administrativ, duke parandaluar si minimumi i garancisë në favorin tim, që personat këshilltarë/ekspertë, që kanë dhënë mendim përpara se të ikte relatori Roland Ilia, të mos jepnin më përsëri, as këshilla dhe as vlerësime ekspertize, pasi ishin shprehur më parë dhe për rrjedhojë kanë ndalim ligjor për t'u shprehur për herë të dytë.

<u>Së treti</u>: Lidhur me konfliktin e interesit, që ka komisionerja Pamela Qirko për të trajtuar në kuadrin e procesit tim të rivlerësimit, ankesën e OSHEE sh.a, veç sa më sipër, kam për të thënë se nga përmbajtja e vetë ankesës rezulton se Administratori i OSHEE group sh.a, shprehet (shih rreshtat e fundit), <u>që i jemi drejtuar me ankesa KPK, për këtë gjyqtar edhe herë të tjera. Pra, provohet që paska edhe ankesa të tjera</u>.

Mbi ekzistencën e këtyre ankesave të tjera, ka referenca edhe në ankimet që ka depozituar OSHEE group sh.a, ndaj vendimeve që kam dhënë unë, në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Lartë.

Përse nuk përmënden në raport këto ankesa. Përse në materialet që m'u vunë në dijeni nga Komisioni për t'u njohur me rezultatet e hetimit administrativ, këto ankesa të tjera, të depozituara nga ana e OSHEE group sh.a, në KPK dhe ILD, nuk përmenden.

Përgjigjja, është e qartë.

Kjo ka të bëjë me faktin se vetë KPK e di se OSHEE group sh.a, është një shoqëri tregtare që po t'i referohesh ekstraktit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ka një ortak të vetëm. Ky ortak është Ministria e Infrastukturës dhe e Energjitikës.

Ky ortak, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, përbën edhe asamblenë e shoqërisë tregtare. Po në këtë ligj, parashikohet se administratori i shoqërisë aksionare emërohet dhe shkarkohet nga asambleja e shoqërisë. Pra, është njëfarësoj "përfaqësues i besuar i interesave të ortakut". Po kush është përfaqësuesi i vetë ortakut, në rastin objekt analize !!!!

Motra e Komisioneres Pamela Qirko=Ministrja Belinda Balluku.

Këtu lind pyetjet, - Në këndvështrim të zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe nenit 30 shkronjat "c" dhe "g" të ligjit 48/20 të Kodit të Procedurave Administrave,

- A mundet zyrtari të gjykojë ankesat e të besuarve/përfaqësuesve të të motrës së saj, të cilët sipas nenit 64 të Kodit Civil si dhe ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, prezumohet se veprojnë për llogari të kësaj të fundit ?
- A është e rastit sjellja jo e përshtatshme e Komisioneres Pamela Qirko, në seancën e dates 13.06.2022, që unë e përshkrova tek kriteri i figurës ?

- A mundet zyrtari të gjykojë çështje që janë objektivisht të njëjta me çështje të tjera, për të cilat kanë bërë ankesë ndaj subjektit, të besuarit/përfaqësuesit e të motrës së saj?, etj, etj.

Nuk po zgjatem se përgjigjet, dihen. Prandaj nuk kam aspak besim.

<u>Së katërti</u>: Lidhur me vlerësimin e Komisionit se "*Subjekti nuk ka argumentuar vendimin për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm*", vlejnë të njëjtat argumente sikurse ato që thashë të ankesa e Kurum International sh.a. Unë jo vetëm mendoj që pikërisht dhënia e këtij vlerësimi nga komisionerja Pamela Qirko e vendos atë në kushtet e konfliktit të interesit, por mendoj se edhe vlerësimi në tërësi i Komisionit, është i gabuar. Kjo pasi pjesa në fjalë e vendimit është argumentuar mirë. Po ua citoj edhe një herë më poshtë:

"*ommisis.... Kam cituar paragrafët 11.9.1 – 13.2 të vendimit <u>të dhënë nga unë për këtë çëëhtje</u>. E vlerësoj të pavend që t'i citoj edhe një herë në këtë ankim.*
I lutem Kolegjit që t'i lexojë këto paragrafë pasi nga përmbajtja e tyre vlerësoj se duket qartë cilësia e lartë e arsyetimit të vendimit, dhe indirekt edhe pabazueshmëria e vlerësimit të Komisionit, se masa dhe mënyra e përllogartijes së dëmit është e pargumentuar.

Përveçse kjo pjesë e vendimit është arsyetuar, çmoj se se vlerësimet e Komisionit "*lidhur me cilësinë e argumentimit të dhënies së e vendimit me ekzekutim të përkohshëm*,", qartësisht kanë të bëjnë me meritën (themelin) e çështjes dhe KPK del jashtë kompetencës së saj po të shprehet për meritën e çështjes, duke shkelur kësisoj standartin e vendosur me vendimin 28/2020 JR të KPA, që u citua më sipër.

Nëse KPK, vijon t'a bëjë (sikurse e ka bërë deri tani), kjo ka vetëm një shpjegim. Konflikti i interesit që shpjegova më sipër. Pra, e bën: - se i pëlqen, - se do ta bëjë. Pra ka vetëm moment volitiv që e shtyn t'a bëjë dhe nuk ka moment intelektual.

Unë jam i pambrojtur në këtë drejtim pasi nuk mund të mbrohesh kur je i pafuqishëm, ndaj të fuqishmit që do të të të bëj keq padrejtësisht.

Lidhur me këtë çështje, Komisioni në vendimin objekt ankimi ka mbajtur qëndirmin e mëposhtëm:

*94.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, konstaton se subjekti ka depozituar një vendim të ILD-së, duke pretenduar se ajo ka trajtuar ankesat në lidhje me aplikimin e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë vendim me nr. ***prot., datë 20.9.2022, të ILD-së, në faqen 10, shprehet se në rast konstatimi nga kontrolli gjyqësor të shkeljeve të ligjit procedural dhe material ato mund të jenë objekt shqyrtimi i mëtejshëm nga ana e ILD-së. Komisioni, në lidhje me aplikimin e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, mban të njëjtin qëndrim si më lartë.*

94.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka trajtuar themelin e çështjes, vlerësohet se Komisioni jo vetëm që nuk ka trajtuar themelin e çështjes, por as nuk ka interpretuar nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, pasi nga ana e tij nuk është zbatuar neni 317 i Kodit të Procedurës Civile. Në vendim, subjekti fillimisht deklaron se:
(i) dëmshpërblimi i palës paditëse konsiderohet si shpërblim nga puna që i jepet punëdhënësi punëmarrësit149;

(ii) me pas këtë dëmshpërblim e trajton në lidhje me të drejtën për ushqim;

(iii) subjekti vijon argumentimin e tij duke deklaruar se shpërblimet për varrim klasifikohen si e drejtë e përfitimit të shpërblimit nga puna dhe e detyrimit ushqimor; dhe në fund,

(iv) subjekti deklaron se për pjesën tjetër të padisë ajo përfshihet në paragrafin e dytë të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke e bërë të paqartë, për rrjedhojë të paargumentuar vendimin e tij në lidhje me pranimin e kërkesës për ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor, pasi nga ana e tij për çdo rast, përfshirë dhe shpenzimet e varrimit, ai konsideron se përfshihen në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

Në lidhje me qëndrimin e Komisionit kam për të shprehur sa më poshtë:

Së pari: Vlejnë po ato argumente që thashë tek ankesa e Kurum International sh.a, prandaj është e padobishme që të kaloj në përsëritje.

Së dyti: Qëndrimi që kam shprehur si në vendim ashtu edhe në shpjegimet përpara Komisionit jo vetëm që janë ligjore por njëkohësisht janë edhe tregues të dinjitetit tim si magjistrat. Kjo pasi ato tregojnë që pavarësisht nga dhuna ndaj të cilës jam ekspozuar[69], arbitrariteti, tentativa për të cënuar pavarësinë e gjykimit të magjistratit në zgjidhjen e çështjeve që ka manifestuar Komisioni, as jam përulur dhe as jam nënshtruar. Kam mbrojtur me forcë, këmbëngulje dhe vetmohim jo vetëm nderin tim por edhe madhështinë e pavarësisë dhe të dinjitetit të figurës së gjyqtarit të Republikës së Shqipërisë, përkundrejt sulmeve të padrejta nga Padrejtësia, Dhuna, Paligjshmëria dhe Arbitrariteti, pra nga vetë trupa gjykuese e Komisionit që ka dhënë vendimin që unë po ankimoj.

Së treti: Në dallim nga rasti i Kurum International sh.a, tek çështja objekt analize, cënimi i standartit të pananësisë së gjykatës në procesin tim të rivlerësimit, shpërfaqet më haptaz dhe madje me brutalitet. Kjo pasi i bie që të bëjë ankesë ndaj meje Belinda Balluku ose vartësit e kontrolluar prej kësaj të fundit dhe/ose që përgjigjen përpara kësaj, dhe këtë ankesë t'a gjykojë motra e ankueses, pra Komisionerja Pamela Qirko. Tamam si ai konflikti i interesit tek fabula e ariut me lepurin që tregova në pjesën hyrëse të këtij ankimi. Kjo është tragjikomedi. Është tragjike për vetë pasojat që më ka shkaktuar mua por është komike në këndvështrimin që po t'a pyesësh komisioneren Qirko, jam i sigurtë se ajo për shkak të mungesës së plotë të momentit intelektual të anës subjektive, nuk do të jetë në gjëndje të arsyetojë që ka qënë komisionere e paanshme në procesin tim të rivlerësimit.

9. Intersig Vienna Insurance Group sh.a (nr.3701 prot. datë 22.05.2020).

Nga raporti i barrës së provës që më ka dërguar Komisioni, rezulton se:

Denoncuesi bën me dije se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër po zhvillohen dy procese gjyqësore me objekt "shpërblim dëmi" kundër shoqërisë "Intersig Vig", të cilët po gjykohen nga subjekti. Denoncuesi shprehet se gjatë gjykimit të këtyre çështjeve, ka konstatuar veprime të kryera në kundërshtim me etikën profesionale e gjyqësore me qëllim dëmtimin e interesave të ligjshëm të shoqërisë "Intersig Vig". Në mënyrë të përmbledhur denoncuesi pretendon se:

1. Në çështjen e parë gjyqësore,

- subjekti ka kryer shkelje të rënda proceduriale dhe nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm konform nenit 14 të K.Pr.Civile, duke mos pranuar asnjë nga kërkesat e shoqërisë

[69] Shih tek pjesa shkaqet e ankimit, ku kam përshkruar ekspozimin tim ndaj poshtërimit, trajtimit ç'njerëzor, cënimit të të drejtës për gjykim të drejtë, cënimit e të drejtës për trajtim të barabare dhe mosdiskriminim, cënimin e të drejtës për moscënim të jetës private dhe familjare, konfliktin e interesit të anëtarëve të trupës gjykuese të komisionit, pengesat ligjore që kanë patur ata për të qënë anëtarë të kësaj trupe në procesin tim të rivlerësimit, etj.

“Intersig Vig” sh.a si palë e paditur në procesin civil, por ka pranuar tërësisht kërkesat e palës paditëse, gjë që ka sjellë humbjen e besimit për një gjykim të drejtë e të paanshëm.

- Në seancen përgatitore të datës 22.11.2020 kanë kërkuar nga gjykata kthimin e padisë me të meta për arsye se pala paditëse nuk ka plotësuar dokumentacionin ligjor mbi të cilin bazon të drejtën për dëmshpërblim si dhe pezullimin e gjykimit të kësaj çështje sipas parashikimeve te nenit 297/a te K.Pr.Civile.

- Në seancën e datës 11.12.2019 gjykata ka caktuar ekspert mjeko ligjor G.Myftarin. Denoncuesit kanë kërkuar përjashtimin e tij për shkak se ky ekspert ka qënë në marrëdhënie kontraktuale pune me shoqërinë “Intersig Vig” sh.a dhe ka bashkëpunuar me avokatin e palës paditëse në një tjetër gjykim. Gjykata, pa analizuar provat mbi të cilat mbështetej ankesa e shoqërisë, ka rrëzuar kërkesën.

- Në seancën e datës 07.02.2020, gjyqtari ka pranuar prova të cilat nuk janë dorëzuar conform parashikimeve të neneve 158 pika 6 dhe 186 të K.Pr. Civile pasi janë paraqitur gjatë gjykimit.

- Gjykata ka pranuar prova të marra në mënyrë të njëanshme nga eksperti.

- Pavaresisht kërkesës së shoqërisë “Intersig Vig” sh.a për përjashtimin e subjektit ai ka vazhduar gjykimin, duke orientuar avokatin e paditësit për saktësimin e objektit të padisë.

- Në kohën kur do të mbyllej hetimi gjyqësor gjyqtari pranoi kërkesën e palës paditëse për pyetje shtesë drejtuar ekspertit. Në përgjigjen e tij elektronike, eksperti njoftoi gjykatën se nuk mund të kryej detyrën shtesë të caktuar nga gjykata, duke dhënë argumentat ligjore përkatëse. Gjykata ka urdhëruar të kryhet detyra e caktuar, pasi në rast të kundërt do të paraqitet kallëzim penal.

Eksperti është detyruar të përgjigjet dhe vlera e rezultuar në aktin shtesë, përputhje me saktësimin e objektit të padisë që kishte bërë avokati i paditësit disa seanca më parë.

2. Në çështjen e dytë gjyqësore,

- denoncuesi ka kërkuar pezullimin e gjykimit duke qënë se mungonte vendimi penal i formës së prerë që shërben si provë për procesin civil. Kjo kërkesë është rrëzuar nga subjekti.

- Subjekti ka caktuar si ekspert në gjykim, dy vlerësues me të cilët shoqëria “Intersig Vig” sh.a ka patur konflikte të mëparshme. Njëri prej tyre ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie dhe ai është përjashtuar nga çdo proces gjyqësor. Subjekti ka rrëzuar kërkesën e të paditurit për përjashtimin e ekspertëve, pa analizuar provat mbi të cilat mbështetej kjo kërkesë.

- Duke marrë shkas shkeljet e mësipërme proceduriale, është kërkuar ndërprerja e seancës me qëllim paraqitjen e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit, por ai ka vazhduar gjykimin duke caktuar detyrat e ekspertëve. Po në këtë seancë gjyqësore ai urdhëroi sekretaren që të merrte dorazi dosjen penale të lidhur me çështjen në gjykim, e cila ndodhej në fashikullin gjyqësor pranë një tjetër gjyqtari. Me këtë veprim gjyqtari ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të K.Pr.Civile pasi është detyrim i palëve dhe jo i gjykatës për të bazuar pretendimet e saj me anë të provave.

Ky interesim personal nga gjyqtari, shfaq haptazi një qëndrim favorizues të avokatit të palës paditëse.

- Është konstatuar se çështjet me objekt "shpërblim dëmi" që përfaqësohen nga i njëjti avokat, gjykohen vetëm nga gjyqarit A.Ymeri. Dyshojmë se kemi të bëjmë me manipulime të shortit, duke marrë për gjykim ky gjyqtar të gjitha çështjet e kësaj natyre, me të njëjtin avokat, duke caktuar të njëjtët eksperte dhe duke dhënë vendime gjithnjë në favor të palëve paditëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e denoncuesit konstatohet se:

A. Në rastin e gjykimit të çështje me palë paditëse Gëzim Ahmetaj:

- Denoncuesi ka paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit pasi çështja civile nuk mund të zgjidhet pa përfunduar gjykimi i çështjes penale.

- Denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e ekspertit Evald Jaho, Hajri Grebi pasi ato kanë qënë më përpara në marrëdhënie me këtë shoqëri. Bashkëlidhur kërkesë gjendet:

• Vendim nr.30 datë 29.02.2009 i Asamblesë së Përgjithsme të Anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit ku z. Hajri Gërbi rezulton kryetar i Komisionit Mjekësor të trajtimit të praktikave të dëmeve shëndetësore. Ky vendim është nënshkruar dhe nga përfaqësues i shoqërisë Intersig.
• Akt vlerësimi datë 14.01.2010 demi shëndetësore me logo të shoqërisë Intersig firmosur nga z. Evald Jaho.
• Miratim praktike demi për pagesë datë 12.02.2010 firmosur në emër të intersig nga z. Evald Jaho.

- Bazuar në procesverbalin e seancës të datës 25.02.2020 konstatohet se subjekti ka urdhëruar sekretaren për të tërhequr fashikullin orgjinal penal tek një subjekt tjetër si dhe e ka administraur si provë.

B. Në rastin e gjykimit të çështje me palë paditëse Violeta Hoxha etj në vendim subjekti shprehet se ka tërhequr në cilësinë e provës kopje të vendimit gjyqësor penal me kërkesë të përfaqësuesit të ndërgjyqësve paditës dhe për të plotësuar kërkesat e nenit 14 të K.Pr.Civile. Në vendim subjekti ka pranuar dhe kërkesën për ekzekutim të përkohshëm të vendimit për palën paditëse Violeta Hoxha.

Nga analizimi i vendimit nr. 343, datë 19.06.2020 Komisioni, pa analizuar themelin e çështjes, konstaton se nga ana e subjektit nuk është argumentuar dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, pasi objekti i padisë nuk klasifikohet në një nga rastet e parashikuar nga nenin 317/a si dhe nuk vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm,kur është vendosur:a) detyrimi për ushqim; b) për shpërblimin nga puna; c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore. Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 317/b.

Në përfundim duket se:

 Subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr.343, datë 19.06.2020 për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
 Subjekti nuk ka vepruar sipas dispozitave të parashikuar nga K.Pr.Civile përkatësisht nenet 12 dhe 19 - 21 duke tërhequr dosje gjyqësore në cilësinë e provave për palën paditëse, për rrjedhojë, ka cënuar parimin e kontradiktoriaritetit.
 Tërheqja provave nga ana e gjykatës ka bërë të pamundur vendosjen në dispozicion të këtyre provave palëve ne proces pasi bazuar në parimin e kontradiktoritetit janë palët ata që paraqesin provat duke ia bërë të njohura njëra-tjetrës.
 Ekspertët Hajri Gërbi dhe Evald Jaho kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit.
 Subjekti nuk ka pezulluar gjykimin sipas parashikimeve të nenit 297/a të K.Pr.Civile në çështjen me palë paditëse Gëzim Ahmetaj pasi për procesin penal nuk kishte ende një vendim të forms së prerë.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Në lidhje me këtë ankesë, kam mbajtur qëndrimin e mëposhtëm përpara Komisionit:

<u>Së pari</u>: Unë vlerësoj se Komisionerja Pamela Qirko duke dhënë vlerësimet se "*tek çështja Violeta Hoxha, subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr. 343, datë 19.06.2020 për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Tek çështja Gëzim Ahmetaj, subjekti nuk ka pezulluar gjykimin sipas parashikimeve të nenit 297/a të K.Pr.Civile pasi për procesin penal nuk kishte ende një vendim të formës së prerë*", është qartësisht në kushtet e konfliktit të interesit, të ngritur nga unë kur dhashë shpjegimet e mia lidhur me denoncimet e Kurum International sh.a dhe OSHEE sh.a.

Kjo pasi kjo Komisionere nuk mund të shqyrtojë, vlerësojë dhe/apo të japë vendim për çështje që janë objektivisht të njëjta me ato për të cilat ka/kanë paraqitur ankesa ndaj meje në institucionet shtetërore kompetente, motra e saj dhe/apo përfaqësuesit/të besuarit e kësaj të fundit.

Kjo ndalohet nga neni 30 shkronjat "c" dhe "g" të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" si dhe ligji nr .9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Në këtë ligj të fundit parashikohet sa më poshtë:

Neni 3, paragrafi 1: *1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike*.

Lidhja familjare që ka Komisionerja Pamela Qirko me motrën e saj, (që sikurse u tha, kontrollon OSHEE sh.a, gjë që përbën edhe fakt të njohur publikisht, pasi mjafton të shihen spotet televizive ku shfaqet motra e Komisioneres duke iu bërë thirrje popullit për kursim energjie dhe/ose lajmet e medias ku po kjo zonjë merr përsipër të njoftojë publikun për fashat dhe çmimet e energjisë elektrike), qartësisht klasifikohet si interes privat i Komisioneres.

Kjo gjendje e konfliktit të interesit që ka komisionerja Pamela Qirko në trajtimin e rasteve objekt analize, është e qartë edhe në kuptim të nenit 3, paragrafi 11 dhe 5 paragrafi 1, shkronja "dh", pika "i" të po këtij ligji.

Komisionerja, ka vepruar në mënyrë të padrejtë në ushtrimin e detyrave, gjë që e evidentova më sipër (kur dhashë shpjegimet e mia tek kriteri i figurës, lidhur me shtetasin Lulzim Karini, në seancën e datës 13.06.2022) si dhe vazhdon të veprojë në mënyrë të padrejtë. Kjo pasi:

I. Bën konstatime dhe vlerësime që nuk janë në kompetencë të vlerësuesit (Komisionit), sipas nenit 74 të ligjit 96/2016, pasi kanë të bëjnë me meritat e çështjes,

II. Shkel standartin detyrues të përcaktuar me vendimin 28/2020 (JR) të KPA-së të dhënë për subjektin e rivlerësimit F.V, që ndalon dhënien e vlerësimeve për themelin (meritat) e çështjes.

III. Shkel nenin 36 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Civile, për sa kohë merr përsipër të bëjë vlerësime administrative për një çështje që është në gjykim në gjykatën e Apelit.

IV. Vepron duke dhënë opinione dhe vlerësime për çështje që janë objektivisht të njëjta me çështje të tjera, për të cilat ka apo duket sikur ka interes motra e saj dhe/ose të besuarit e motrës së saj (neni 30 "shkronja c" i ligjit ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave administrative").

Neni 3, paragrafët 2 dhe 3: "2. Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.
3. "Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive" është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.

Komisionerja ka vepruar dhe/ose mosvepruar me pandershmëri, pasi mjafton të kujtohet roli i avokatit mbrojtës që i bëri ajo në seancën e datës 13.06.2022, Komisionerit Roland Ilia, fakti që ajo nuk i fillon këtij të fundit procedim disiplinor sipas nenit 14 të ligjit 84/2016, pasi ky e ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit si dhe e ka bërë këtë me qëllim për të fshehur rrethana që jo vetëm e ulin po e diskretitojnë në opinionin publik, figurën e Komisionerit të KPK-së. Pra, të kujtohet e gjithë ajo çka evidentova tek kriteri i figurës, kur fola për bashkëpunimin e Komisioneres Pamela Qirko me Komisionerin Roland Ilia.

Komisionerja ka vepruar në kundërshtim me detyrën për të forcuar besueshmërinë dhe dinjitetin e institucionit ku punon. Këtu le të kujtohet kjo puna e Komisionerit Ilia si dhe të kihet parasysh guximi i Komisioneres për të hetuar dhe vlerësuar çështje për të cilat janë ankuar ndaj meje të besuarit e motrës së saj, (rasti i OSHEE group) si dhe çështje që janë objektivisht të njëjta me çështjet për të cilat kanë paraqitur ankim ndaj meje, vartësit/të besuarit/përfaqësuesit e motrës së saj, (rasti objekt analize në këtë pjesë të trajtimi, rasti Kurum International, rasti BSSh, rasti Daria Davidova, etj, pra pothuajse të gjitha rastet që përmenden tek kriteri i profesionalizmit).

Komisionerja ka shkelur parimin e paanësisë, pasi padrejtësisht më ka etiketuar (e rregjitruar audio) si zvarritës të procesit, në seancën e datës 13.06.2022, kur paraqita disa kërkesa paraprake, të cilat u provuan se ishin të drejta në pjesën më të madhe dhe kryesore të tyre.
(Kërkesa për legjitimimin e avokatit mbrojtës Gerti Ymeri, kërkesa për përjashtim të dy Komisionerëve, kërkesa për riçelje të hetimit gjyqësor si për kriterin e pasurisë ashtu edhe dy kriteret e tjera).

Komisionerja nuk ka vepruar me përgjegjshmëri. Këtu mjafton të rikujtohet marrja e kompetencave të komplet trupës gjykuese, vetëm prej saj, kur në seancën e datës 13.06.2022, ndërsa unë i kërkova trupës, informacion për shortin special dhe lidhur me arsyen se përse trupa kishte shkelur rregulloren për hapat e unifikuar procedural të vetë KPK-së, (pasi më kishte kaluar në seancë, pa marrë si dhe pa më njoftuar vendim nëse kishte pranuar apo jo provat dhe kërkesat e paraqitura nga unë), Komisionerja pa u këshilluar fare me trupën, më tha "nga ne nuk do të merrni asnjë informacion, por ama po tërhiqemi formalisht", (dëgjo regjistrimin audio).

Po këtu, mjafton të kujtohet mbushja e sallës me gardistë për të n'a bullizuar fizikisht dhe psikologjikisht. (shiko përshkrimin tek kriteri i figurës).

Komisionerja nuk ka vepruar në afat. Këtu mjafton të përmendet fakti i shkeljes nga Komisionerja të pikave 9 dhe 10 të Rregullores për hapat e unifikuar procedural të KPK-së, që detyrojnë trupën gjykuese që pas përfundimit të hetimit administrativ, të njoftojnë subjektin e rivlerësimit me raportin përkatës. Më pas subjektit i jepet afat për të paraqitur provat dhe shpjegimet dhe brënda 5 ditëve nga koha që subjekti jep shpjegimet, i njoftojnë me vendim të ndërmjetëm, se cilat prova janë pranuar dhe cilat janë refuzuar si dhe cilat kërkesa janë pranuar dhe cilat janë refuzuar. Vetëm më pas, subjektit i njoftohet data e seancës dëgjimore. Kjo radhë kohore e kryerjes së veprimeve, është bërë mish mash nga Komisionerja dhe dy kolegët e saj të larguar tashmë, (madje edhe trupi i ri gjykues) pasi më kanë njoftuar datën e seancës pa u shprehur as për provat dhe as për kërkesat ose duke u shprehur vetëm sa për dukje[70].,

Sipas paragrafit 3 të nenit 3 të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", mjafton një shkelje nga sa më sipër, dhe konsiderohet se zyrtari ka vepruar në kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive".

Neni 3, paragrafi 4: 4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) "konflikt faktik i interesit" është gjendja, ne të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare;

[70] (këtu shih vendimin e ndërmjetëm që m'u komunikua me email me datën 05.12.2022, që në përmbajtje thotë pasi shqyrtuam kërkesat tuaja por nuk jep asnjë arsyetim për pjesën më të madhe të këtyre kërkesave dhe as për provat, të cilat madje as i citon. Kjo gjë është bërë vetëm me vendimin përfundimar)

b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë:

c) “konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

ç) “konflikt rast për rast i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;

d) “konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

“Konflikti faktik i interesit”, ekziston pasi mjafton të sillet ndër mend marrëdhënia miqësore që duket se ekziston ndërmjet Komisioneres Pamela Qirko me Komisionerin Roland Ilia, (që e përshkrova kur dhashë shpjegimet tek kriteri i figurës) si dhe marrëdhënia armiqësore e Komisionerit Roland Ilia me mua, që ai e pohon vetë kur thotë “nuk mund të qëndroj indiferent pasi subjekti po hedh baltë përditë mbi mua”. (shih vendimin e përjashtimit të Rolandit). Këto dy marrëdhënie miqësore me njërin dhe armiqësore me tjetrin, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar që Komisionerja Pamela Qirko, të mos marrë asnjë masë për të vepruar në drejtim të përmbushjes së detyrës për të forcuar besueshmërinë dhe dinjitetin e institucionit ku punon, gjë që medeomos duhej bërë ose përmes fillimit të procedimit disiplinor ndaj Komisionerit Roland Ilia, ose ngarkimit tim me barrë prove, për të vërtetuar të kundërtën e pretendimit se “i paskam hedhur baltë një Komisioneri, (të cilin ajo e ka mik), madje përditë, dhe për më tepër, në mënyrë të pamerituar”.

Pra duhet që komisonerja të ushtronte kompetencën për të hetuar që:
ose
unë kam ulur figurën e gjyqtarit duke cënuar një Komisioner, përditë dhe në mënyrë të pamerituar,
ose
ky Komisioneri (që është mik i Komisioneres), ka ulur figurën e Komisionerit në mënyrë të meritуar.

Natyrisht, ky hetim do duhej të bëhej, madje në mënyrë transparente, (dhe ku ka më mirë se në seancën time dëgjimore, ku të japim shpjegime ballë për ballë unë dhe Komisioneri Ilia).

Fakti që nuk guxohet të gërmohet në këtë drejtim, nuk është gjë tjetër veçse tregues i faktit që Komisionerja do të hakmerret ose mund të hakmerret ndaj meje për turpërimin publik që pësoi miku i saj Roland Ilia, që u largua si frikacak nga procesi im i rivlerësimit.

Konflikti faktik i interesit, ekziston pasi Komisionerja mund të kryejë në mënyrë të padrejtë detyrën e saj, me qëllim për t’u hakmarrë, edhe për shkak të:

- vendimeve të mia që nuk i kanë pëlqyer OSHEE grup sh.a, që kontrollohet nga motra e saj, - ndaj faktit që vëllai im Gerti Ymeri, është gjyqfitues në disa gjykime me vlera të konsiderueshme ndaj OST sh.a, që kontrollohet po nga motra e saj.

- ndaj faktit që unë e kam paditur personalisht insitucionin që drejtohet nga motra e saj për shpifje.
- ndaj faktit që kunati im, është paditës në tre gjykime me KESH sh.a, që kontrollohet nga motra e saj, etj.

"Konflikti në dukje i interesit", ekziston pasi edhe nëse gjithçka thashë më sipër, nuk janë të vërteta, (faktikisht janë të vërteta), tek çdo vëzhgues i jashtëm duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive zyrtare të Komisioneres.

"Konflikti i mundshëm i interesit", prapë ekziston pasi po iu jap një shëmbull. Vetë trupa më ka kërkuar të paraqes vendime të ngjashme me vendimin e Kurum International. Po sikur unë t'iu sjell vendime me OSHEE sh.a, që janë të njëjta, gjë që do t'a bëj. A mund të vlerësohen këto nga Komisionerja? Padyshim që JO, nëse zbatohet ligji.

"Konflikti rast për rast i interesit", prapë ekziston. Kjo pasi Komisionerja, ka bërë konstatime/vlerësime, në mënyrë të përsëritur, në shkelje të ligjit, në njërën nga tri llojet e mësipërme të konfliktit të interesit, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë; Konkretisht, kur shprehet:

1- *Gjykimi i çështjes civile duhet pezulluar deri sa të gjykohet çështja penale. (Ky është kërkim i ngritur shpesh nga OSHEE sh.a, që kontrollohet nga motra e Komisioneres, që unë nuk e kam pranuar asnjëherë)*.

2- *Vendimi i dhënë me ekzekutim të përkohshëm është i paargumentuar, (Edhe ky është kërkim i ngritur shpesh nga OSHEE sh.a, që kontrollohet nga motra e Komisioneres, që unë nuk e kam pranuar asnjëherë*).

3- Masa e dëshshpërblimit, nuk është e argumentuar. (Edhe ky është kërkim i ngritur shpesh nga OSHEE sh.a, që kontrollohet nga motra e Komisioneres, që unë nuk e kam pranuar asnjëherë).

"Konflikti i vazhdueshëm i interesit", prapë ekziston. Kjo pasi nuk ka asnjë garanci (madje ka siguri) se konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen. Kjo siguri buron nga fakti që në çdo vendimarrje të veçantë të deritanishme, Komisionerja Pamela Qirko, ka gabuar duke shkelur ligjin. Madje, edhe kur ka deklaruar se nuk është në kushtet e konfliktit të interesave.

Unë mendoj se rasti i Komisioneres Qirko, është rasti tipik ku plotësohet jo njëra nga gjendjet e mësipërme të konfliktit të interesit, por të gjitha gjendjet e mësipërme të konfliktit të interesit njëherazi, madje në mënyrë të shumëfishtë.

Duke i rithyer tek rasti objekt analize në këtë pjesë të trajtimit, vlerësoj se pa u pastruar Komisionerja Qirko nga gjendja e konfliktit të interesit, unë është e kotë të kundërshtoj argumetimet e paligjshme që kjo Komisionere bën kur shprehet për këtë rast se "*tek çështja Violeta Hoxha, subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr.343, datë 19.06.2020 për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Tek çështja Gëzim Ahmetaj, subjekti nuk ka pezulluar gjykimin sipas parashikimeve të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile pasi për procesin penal nuk kishte ende një vendim të formës së prerë*".

Së dyti: Duke u rikthyer tek rasti objekt trajtimi, vlerësoj se konstatimi dhe vlerësimi i Komisionit se "tek çështja Violeta Hoxha, subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr.343, datë 19.06.2020 për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm", nuk është i vërtetë.

Më poshtë po ju citoj pjesën përkatëse të këtij vendimi:

"*....Kam cituar pjesën e arsyetimit të vendimit ku jam shprehur për ekzekutimin e përkohshëm*". E çmoj të pavend t'a përfshij në këtë ankim citimin në fjalë, por i lutem Kolegjit që t'i referohet atij.

Së treti: Ajo që më tërheq vëmëndjen nga pjesa e raportit ku trupa gjykuese shprehet se "tek çështja Violeta Hoxha, subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr. 343, datë 19.06.2020 për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm", është fakti që Komisioni merr përsipër që të shprehë mosdakortësi (mospëlqim) të mënyrës së si e intepretoj unë nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke u shprehur se rasti nuk përfshihet në fushën e zbatimit të normës juridike në fjalë.

Për këtë gjë u shpreha edhe më parë, por megjithatë po e përsëris vlerësimin tim si më poshtë.

Është e qartë (sikurse u shpreha edhe tek ankesa e bërë nga Kurum International sh.a), se unë dhe Komisioni, bëjmë një interpretim të ndryshëm të përmbajtjes së normës të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.

(Ju lutem shiheni edhe një herë, tek vendimi i Kurum International sh.a, vendimi i Afrim Hallunit por tek vendimi i OSHEE sh.a si dhe tek vendimi konkret për të cilin është ankuar Intersig vig sh.a, mënyrën se si e intepretoj unë kuptimin e fjalëve "shpërblim nga puna", "detyrim për ushqim" si dhe shiheni edhe mënyrën se si e konsideroj unë "që përmbjatja e nenit 317 të KPC, duke iu referuar ratios së normës, nuk mund të konsiderohet si dispozitë taksative, (pra me raste të mbyllura), por si dispozitë indikative, orientuese, (pra e hapur dhe rastet që tregohen në të, kanë natyre ilustrative)".

Kjo mënyrë e kuptimit dhe interpretimit të normës juridike, duke bërë interpretim pajtues të tekstit të saj, me ration e përmbajtjes së saj, nuk është shpikje e imja, pra nuk e kam zbuluar vetëm unë këtë lloj interpretimi. (Edhe sikur të ishte shpikje, nuk ka gjë të keqe pasi besoj se gjyqtarëve në veprimtarinë e tyre, iu lejohet që t'a zhvillojnë praktikën gjyqësore, pra të guxojnë në hapjen e debateve juridike lidhur me mënyrën e interpretimit të normave të së drejtës, për të

cilat nuk ka qëndrim të konsoliduar nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese).
Kjo mënyrë e interpretimit të normës, duke bërë interpretim pajtues të tekstit të saj, me ration e përmbajtjes së saj, është ndjekur nga shumë gjykata. P.sh, si më poshtë:

Neni 625: *Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:*
a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
c) është cenuar e drejta e emrit;
ç) është cenuar respektimi i jetës private;
d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.

Gjykata e Lartë, lidhur me nenin 625 të Kodit Civil, duke bërë një interpretim pajtues të tekstit të normës, me ration e ekzistencës së saj, ka arritur në përfundimin se rastet e cilësuara/treguara nga dispozita, nuk përbëjnë një listë shteruese dhe taksative të rasteve në të cilat gjen zbatim kjo normë, por këto raste kanë karaker indikativ/tregues dhe ilustrues se kush ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmin moral, ekzistencial, biologjik jopasuror, etj.

Të njëjtën metodë të interpretimit të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, kam ndjekur edhe unë[71].
A mund të konsiderohem unë përgjegjës për këtë. A ka ndonjë vendim të Gjykatës së Lartë ose të Gjykatës Kushtetuese që është i detyrueshëm për zbatim nga ana ime, që të bjerë në kundërshtim me interpretimin që i bëj unë normës?!!!

Jo vetëm nuk ka të tillë, por njësoj sikurse unë, ka vendime të dhëna edhe nga gjyqtarë të tjerë, disa prej të cilëve kanë kaluar vetingun, p.sh Ramis Lala, Ornela Naqellari, etj. Për të vërtetuar këtë, do iu paraqes si provë një vendim të ILD-së, që ka trajtuar problematikën e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, nga disa gjyqtarë, (ku bëj pjesë edhe unë).

ILD-ja në këtë vendim, shprehet ndër të tjera se mospëlqimi ndaj vendimarrjeve të gjyqtarëve, lidhur me këtë tematikë, mund të adresohet vetëm në rrugën e ankimit gjyqësor në Gjykatat më të larta dhe jo përmes ankesave me natyrë disiplinore. Kjo pasi në të kundërt, kapërcehen kompetencat e ILD-sa si dhe cënohet pavarësia e pushtetit gjyqësor e parashikuar në nenin 3 të ligjit 96/2016, që parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".

Gjithashtu, ftoj me mirësjellje Komisionin që në trajtimin e ankesës së Intersig Vig sh.a, të ketë parasysh edhe standartin detyrues të KPA-së, të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha. Sipas këtij standarti detyrues, rezulton se:

[71]I lutem Kolegjit, që edhe këtu të shohë këtu edhe argumentimin tim të shprehur në pjesën e "shkaqeve të ankimit", të titulluar "së gjashtëmbëdhjeti", veçanarisht të shohë faqet 46, 47 dhe 48 ku jap një shëmbull tjetër kur norma intepretohet kështu sikurse e kam intepretuar unë dhe këtë intepretim e ka bërë ONM, Avokati i Popullit dhe Kuvendi.

"...10.7. Në lidhje me çështjet e grupuara në grupin e parë, Kolegji konstaton se të gjitha vlerësimet e Komisionit lidhen dhe i adresohen zgjidhjes në themel të çështjes penale, duke tentuar të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes nga ajo që ka kryer vetë Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Në këto konkluzione të Komisionit, Kolegji verën se gjendemi para një tejkalimi të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Përpos pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se ky vlerësim i takon Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: "Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet", dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

10.8 Në këtë kuadër ligjor të zbatueshëm, Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

.....

... 12.4 Pasi shqyrtoi rrethanat e faktit, konstatimet e Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, Kolegji vëren sërish se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim të kryer nga Komisioni mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes së marrë në shqyrtim.

Nga natyra e çështjes dhe arsyetimi i përdorur edhe në këndvështrim të pretendimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, perceptohet qartë se evidentimi i problematikes që Komisioni ka konstatuar lidhet me gjykimin dhe vlerësimin nëse bindja e brendshme e krijuar prej trupës gjykuese mbi analizën e provave të marra gjatë procesit e në kuptim e zbatim të ligjit material, për më tepër mbi një çështje tejet të debatueshme e profesionale, siç është analiza mbi ekzistencën e lidhjes shkakësore në kryerjen e një vepre penale, se nuk ekziston lidhja shkakësore mes veprimeve të parregullta të të gjykuarve dhe pasojës së ardhur, është një konkluzion i gabuar e ka ardhur si pasojë e një analize sipërfaqësore të të gjitha fakteve. Kolegji çmon se edhe në këtë rast gjendemi përpara së njëjtës situatë si ajo e përshkruar më lart në këtë vendim, paragrafët 10.7-10.8, kur Komisioni tejkalon kompetencën e tij kushtetuese e ligjore duke vlerësuar vendimmarrjen dhe zgjidhjen në themel të një çështjeje gjyqësore, atribut vetëm i një gjykate më të lartë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se do të përdorej i njëjti arsyetim ligjor si ai i përdorur në arsyetimin më sipër, njësoj i vlefshëm dhe i zbatueshëm edhe për këtë qëndrim të Komisionit".

"...12.5 Gjithashtu, Kolegji vlerëson të nënvizojë qëndrimin se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë rast Gjykata e Lartë e vendit, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur gjykata ku është pjesë e vendimmarrjes magjistrati (subjekti i rivlerësimit), nuk mund të përdorej apriori si një argument për të vlerësuar negativisht aftësitë profesionale të magjistratit, veçanërisht ato që lidhen me zgjidhjen e çështjes, siç është rasti konkret. Në këtë arsyetim, vlen të sillet në vëmendje se edhe sistemi i vlerësimit periodik të magjistratëve, i parashikuar prej ligjit nr. 96/2016, nuk parashikon matjen e aftësive për gjykim apo arsyetimin ligjor të magjistratëve në varësi të qëndrimit që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet e tyre. Aq më shumë, ky kriter nuk mund të përdoret si determinant në procesin e rivlerësimit, në të cilin pasoja e vlerësimit profesional mund të ndikojë në mënyrë thelbësore fatin profesional të magjistratit, por edhe më tepër kur i gjithë ky proces ka pasur nën vlerësimin e tij edhe vetë aftësitë profesionale të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, të cilët në raste të caktuara, në varësi të shkallës ku kanë gjykuar, mund të kenë qenë përkatësisht, gjyqtarë më të lartë ose më të ulët. Në këtë kontekst, qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta mund të provokojnë një vlerësim apo hetim të mëtejshëm drejt sjelljes profesionale të magjistratit, por ato nuk mund të jenë kriteri matës determinant për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre. Përpos këtij arsyetimi, rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Lartë në Shqipëri, dhe parimet e gjithëpranuara të Bangalores mbi sjelljen e gjyqësorit, kanë qenë të qarta dhe eksplicite në këto raste për mospërdorimin e një vendimi të një gjykate më të lartë për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët".

Gjithashtu, kërkoj nga trupa gjykuese e Komisionit të ketë parasysh rekomandimin e Këshillit të Evropës, përkatësisht të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare [17 nëntor 2010 CM/Rec(2010)12], "Mbi pavarësinë e eficencën dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve", në Kreun VII ku trajtohet përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, ku përcaktohet se: "*Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose i provave të kryera nga gjyqtarët gjatë gjykimit të çështjeve nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë. Gjyqtarët nuk mund të jenë personalisht përgjegjës në rastet kur vendimet e tyre ndryshohen nga një gjykatë më e lartë* ".

<u>Së katërti</u>: Unë vlerësoj se konstatimi dhe vlerësimi i Komisionit se "*tek çështja Gëzim Ahmetaj, subjekti nuk ka pezulluar gjykimin sipas parashikimeve të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile pasi për procesin penal nuk kishte ende një vendim të formës së prerë*", nuk është i drejtë. Po përsëris edhe një herë ato që thashë më sipër, tek rasti Daria Davidova, rasti Stiven Kiri dhe rasti Ariana Muja, se ky lloj konstatimi, në thelbin e tij ka të bëjë me mënyrën se si e kam bërë unë si gjyqtar, hetimin gjyqësor të çështjes. Pra, ka të bëjë me interpretimin e fakteve që unë si gjyqtar kam vlerësuar se janë të mjaftueshme për të dhënë vendimin gjyqësor përfundimtar, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjyqësore.

Unë vlerësoj se Komisioni, nuk mund të japë vlerësime lidhur me çështjen se a kanë qënë apo jo të mjaftueshme faktet juridike, mbi të cilat gjyqtari ka dhënë vendimin gjyqësor përfundimtar. Po ashtu, nuk mund të japë vlerësim, lidhur me çështjet në çfarë kohe dhe në cilën mënyrë duhet t'i merrte Gjykata këto fakte juridike, drejtëpërdrejtë apo përmes veprimtarisë së një organi tjetër

shtetëror sikurse është prokuroria. Këto çështje, kanë të bëjnë me mënyrën se si e ka planifikuar, organizuar dhe zbatuar Gjykata hetimin gjyqësor të çështjes, dhe për rrjedhojë kanë të bëjnë me procesin e formimit të bindjes së brëndshme të gjyqtarit, të krijuar nga interpretimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit që ai vlerëson, në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga askush dhe për asnjë arsye, se kanë rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Këtu ftoj me mirësjellje Komisionin që të respektojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe të mos marrë përsipër që të gjykojë meritat e çështjes. Një veprim në të kundërt do të binte ndesh me
nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", që parashikon se "*Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye*".

Gjithashtu, ftoj Komisionin që të ketë parasysh standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë nga KPA-ja për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i përmenda më sipër. Në çmuarjen time, Komisioni shkel kompetencat e tij, kur në mënyrë të hapur ose të nënkuptuar merr përsipër të vlerësojë drejtësinë e vendimeve të ndërmjetme apo ndoshta edhe të vendimit përfundimtar. Po ashtu kur merr përsipër të japë vlerësim mbi mënyrën se si duhej të bëhej hetimi gjyqësor i çështjes. Ky kapërcim kompetencash është akoma më i qartë po të konsiderohet edhe neni 36/3 të Kodit të Procedurës Civile që parashikon se "Asnjë juridiksion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata". Çështja për të cilën më kërkohen shpjegime, është akoma në Gjykatën e Apelit Shkodër, prandaj si unë përmes këtij trajtimi ashtu edhe Komisioni, duhet të tregohemi të përmbajtur në trajtimin e rastit.

Lidhur me vlerësimin e Komisionit se do duhej të pezulloja gjykimin deri sa të zgjidhej çështja penale, nuk jam dakort. Kjo pasi, sikurse u shpreha edhe më sipër, vlerësoj se interpretimi që i bën Komisioni përmbajtjes së nenit 297 "a" të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se "Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: (a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative", është jo i drejtë. Ky interpretim është jo i drejtë pasi sikurse Komisioni e di, interpretimi primar i normës, është ai literal (gjuhësor). Me interpretim gjuhësor, vihet re qartësisht se në shkronjën "a" të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile, përdoret folja "mund". Kjo folje nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të Gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj, të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit.

Duke patur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit e Gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet deri sa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brëndshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes.
Unë mendoj se Komisioni, nuk mund të hyjë këtu pasi në të kundërt do vepronte në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repunlikën e Shqipërisë", që sikurse u tha parashikon se "Magjistrati i ushtron funksionet e tij, në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur duke vlerësuar dhe intepretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brëndshme, i liri nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i thërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye".

Në vlerësimin tim, ushtrimi i diskrecionalitetit gjyqësor për të vendosur se duhet të pezullohet gjykimi i një çështje civile, deri sa të zgjidhet një çështje penale, duhet të përbëjë jo rregull, por përjashtim nga rregulli. Kjo pasi në parim, Komisioni besoj bie dakort me mua, se pushteti gjyqësor i dhënies së drejtësisë, për shkak të natyrës së tij, si rregull, nuk ushtrohet me delegim tek pushtetet e tjera.

Në rastet përjashtimore kur Gjykata vendos t'a ushtrojë me delegim pushtetin shtetëror që i ka dhënë Kushtetuta dhe ligji, ajo duhet të tregohet e kujdesshme që t'a argumentojë këtë delegim subtancial kompetence për të dhënë drejtësi, sipas parimit të objektivitetit, pra me tregimin e rrethanave komplekse të faktit apo të ligjit, të cilat nuk e lejojnë atë që t'a zgjidhë vetë çështjen. Pra, Gjykata, në rastin që përbën objektin e shpjegimit tim, do duhet të tregonte konkretisht, se cili është apo janë veprimi/veprimet hetimore që nuk mund ti kryejë ajo, (Gjykata civile), por që mund t'i kryejnë vetëm organet e juridiksionit gjyqësor penal.

Në rastin konkret nuk ka asnjë veprim të tillë që nuk mund të kryhej nga vetë Gjykata civile. Unë vlerësoj se gjykimi i një çështje civile duhet të pezullohet deri sa të gjykohet një çështje tjetër, vetëm kur ekziston si domosdoshmëri për të respektuar parimin e sigurisë juridike, ose kur ekziston pamundësia faktike apo ligjore e zgjidhjes së çështjes, pa u zgjidhur paraprakisht çështja tjetër.

Në rastin konkret, unë kam vlerësuar dhe vlerësoj se nuk është cënuar nga zgjidhja që unë i kam dhënë çështjes, parimi i sigurisë juridike. Këtë bindje e kam patur dhe e kam edhe duke patur parasysh nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale që parashikon se "*1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përsa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. 2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër* ".

Në rastin objekt gjykimi, besoj se Komisioni e di që përgjegjësia penale dhe përgjegjësia civile për shpërblimin e dëmit, nuk janë e njëjta gjë. Ndërsa përgjegjësia penale është gjithmonë përgjegjësi me faj, dhe i pandehuri nuk është i detyruar që të provojë pafajësinë e tij, në rastin e përgjegjësisë civile për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, është i padituri që sipas neneve 608 dhe 609 të Kodit Civil, duhet të provojë pafajësinë e tij. Nëse nuk e provon pafajësinë e tij, i padituri konsiderohet përgjegjës. Kjo provueshmëri pafajësie nuk ka ndodhur në gjykimin për të cilin po jap shpjegim, dhe madje në këtë gjykim, pala e paditur as nuk kërkoi dhe aq më pak paraqiti prova për të përmbushur këtë barrë prove lidhur me fajësinë, që me ligj i ngarkohet asaj.

Përveç kësaj, rasti objekt për të cilin po jap shpjegim, nuk kishte lidhje me çështjen penale edhe për një fakt të thjeshtë. Ky rast, qartësisht, përfshihet në rastet e përgjegjësisë objektive, të parashikuar nga neni 622 i Kodit Civil, që ka këtë përmbajtje "*Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit*". Në kushtet kur pala e paditur nuk tentoi të kërkonte ajo vetë kryerjen e një ekspertimi autoteknik, për të vërtetuar pafajësinë në shkaktimin e aksidentit, është e qartë se përgjegjësia civile për shpërblimin e dëmit do t'i ngelej asaj, sido që të përfundonte procedimi penal.

Në rrethanat e mësipërme, vlerësoj se nuk ka qënë nevoja e delegimit substancial të kompetencës time si gjyqtar për të zgjidhur çështjen, tek organet e juridiksionit gjyqësor penal. Nëse Komisioni ka qëndrim të kundërt me këtë pjesë të arsyetimit të vendimit tim, kam vlerësimin se dakortësia ose mosdakortësia e Komisioni me këtë pjesë të arsyetimit, ka të bëjë me meritat e zgjidhjes së çështjes, dhe vlerësuesi (Komisioni), sipas ligjit 84/2016 por edhe sipas ligjit 96/2016, nuk mund të hyjë këtu pasi në të kundërt, cënon jo vetëm pavarësinë e pushtetit gjyqësor por edhe standartin detyrues të vendosur me vendimin nr. 28/2020 (JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4, të tij, që i
përmenda më sipër.

Së pesti: Nuk jam dakort me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "*Ekspertët Hajri Gërbi dhe Evald Jaho kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë konstatim, paraprakisht shpreh konsideratën se unë nuk mund të pretendoj nga Komisionerja Pamela Qirko që ajo t'a kuptojë në rastin tim, se çfarë është konflikti i interesit dhe aq më pak t'a vlerësojë drejtë dhe t'a zbatojë atë, duke filluar nga vetja e saj.

Natyrisht, ajo është e fuqishme ndërsa unë i dobët në procesin tim të rivlerësimit, dhe dihet botërisht që pamja e të fortit, në shoqëritë dystopike, e mbyt të vërtetën e të dobëtit.

Teksa më kujtohet Komedia Hyjnore e Dante Aligerit, më kujtohet njëkohësisht citati që Virgjili (që personifikon në vepër arsyen e njeriut), i tregon Dantes pasi e shoqëron për në ferr, "you have to abandon all the hope", dhe fjalët që i thotë pastaj, "guxim, pavarësisht se ty tashmë nuk të duhet, por ama i duhet nderit tënd".
Teksa më erdhi mend sa më sipër, po i shkruaj edhe këtu dy fjalë, me qëllim për të mbrojtur nderin tim.

Lidhur me rastin, unë vlerësoj se jo çdo paligjshmëri apo pandershmëri e ekspertit në kryerjen e detyrës së ngarkuar nga Gjykata, konsiderohet si konflikt interesi. Mund të mos jetë eksperti dhe/apo gjyqtari në konflikt interesi dhe prapë mund të jetë përgjegjës për veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin.

Unë për rastin kam vlerësuar se fakti që ekspertet kanë patur më parë marrëdhënie juridike me palën e paditur, që ka përfunduar kohë më parë nga koha kur është zhvilluar gjykimi, nuk përbën ndonjë arsye ligjore, për t'a konsideruar ekspertin në konflikt interesi apo në armiqësi me palën e paditur. Përkundrazi, që eksperti i caktuar nga Gjykata të "konsiderohet i njëanshëm" duhet që ai të jetë në raport me palët ndërgjyqëse, në po ato rrethana fakti që parashikohen në nenin 72 të KPC-së (njësoj sikurse gjyqtari), dhe/apo në rrethanat e faktit që parashikohen në nenet 3 dhe 5 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006; me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006; me ligjin nr. 86/2012 datë 18.09.2012 dhe me Ligjin nr. 44/2014 datë 24.04.2014.

Gjykata (pra, unë si gjyqtar) nuk konstatoi që ekspertët në fjalë të kenë në raport me palën e paditur, po ato rrethana fakti, që parashikohen si konflik interesi, në këto dispozita ligjore[72].

Gjithashtu, ftoj me mirësjellje Komisionin që të ketë parasysh, në lidhje me sa më sipër, edhe faktin që unë, sikurse shihet nga vetë vendimi, jo vetëm jam kujdesur që të parandalohet gjendja e konfliktit të interesit nga ekspertët por edhe çdo lloj paligjshmërie tjetër në kryerjen e detyrës së tyre. Këtu po citoj një pjesë të vendimit:

"Omissis... Gjykata në krijimin e bindjes se akti i ekspertimit mjekësor i kryer nga dr. Hajri Gërbi, nuk duhet të merret parasysh, vlerëson gjithashtu edhe faktin se ky ekspert nuk tregoi në kryerjen e detyrës, një ndërgjegje të lartë dhe kuptim të qartë të përgjegjësisë që ka si ekspert. Kjo pasi ai ndonëse është mjek, nuk ia bëri me dije Gjykatës që i ndjeri Gëzim Ahmetaj, në kohën që është ekzaminuar fizikisht prej tij si mjek, (gjatë gjykimit), ka qënë ndërkohë duke vuajtur nga sëmundja tumorale e lartëpërmendur, (e cila në më pak se dy muaj nga koha që dr. Hajri Gërbi e ka parë dhe ekzaminuar personalisht, të ndjerin Gëzim Ahmetaj, i ka shkaktuar këtij të fundit vdekjen)...

<u>Së gjashti</u>: Nuk jam dakort me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Subjekti nuk ka vepruar sipas dispozitave të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile përkatësisht nenet 8-12 dhe 19-21 duke tërhequr dosje gjyqësore në cilësinë e provave për palën paditëse, për rrjedhojë ka cënuar parimin e kontradiktoriaritetit". Këtu mesa duket Komisioni harron dy dispozita të Kodit të Procedurës Civile, që janë si më poshtë:

<u>Neni 14</u>: *Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin*.
<u>Neni 223</u>: *Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj*.

[72] I lutem Kolegjit që këtu të ketë parasysh qëndrimin me dy standarte të Komisionit në dy momente, që qartazi bien ndesh me qëndrimin që po vetë Komisioni ka shprehur si në raportin e barrës së provës që më ka dërguar ashtu edhe në vendimin e arsyetuar. Konkretisht:

<u>Së pari</u>: Në vendimin për përjashtimin e komisionerit Roland Ilia, të marrë nga një trup gjykues ku bënin pjesë edhe komisioneret Genta Bungo dhe Firdes Shuli, ky trup gjykues shprehet se: fakti që komisioneri Roland Ilia i ka dërguar sms subjektit para 10 viteve duke i shkruar "Andri si je" për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë nuk konsiderohet si shkak i arsyeshëm përjashtimi (për më tepër shih kërkesën për përjashtim dhe vendimin e komisionit), **ndërsa** në rastin kur komisioneret Genta Bungo dhe Firdes Shuli vlerësojnë nëse do duheshin përjashtuar nga unë ekspertët Gëzim Myftari dhe Hajri Gërbi, për rrethana të ndodhura 10 vjet përpara kohës kur m'u paraqit kërkesa për përjashtimin e tyre, japin vlerësimin se do duheshin përjashtuar (dhe fakti që nuk e kam bërë këtë tregon mangësi profesionale).

<u>Së dyti</u>: Meqënëse ndaj ekspertëve pala e paditur ka paraqitur kallzim penal, sipas trupës gjykuese të Komisionit, unë duhet t'i përjashtoja nga gjykimi ndërsa në rastin kur unë paraqita kallzim penal në SPAK ndaj anëtarëve të trupit gjykues, (shih kallzimin), ata nuk kanë shkaqe për t'u përjashtuar nga gjykimi. Kjo ndonëse për gjyqtarët/komisionerët vlejnë të njëjtat rregulla sikurse për ekspertët, lidhur me dorëheqjen apo përjashtimin e tyre nga gjykimi.

Në këtë rast gjykata jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument. Shpenzimet e nevojshme parapaguhen nga pala që ka bërë kërkesën.

Së shtati: Nuk jam dakort me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se "Tërheqja provave nga ana e gjykatës ka bërë të pamundur vendosjen në dispozicion të këtyre provave palëve në proces pasi bazuar në parimin e kontradiktoritetit janë palët ata që paraqesin provat duke ia bërë të njohura njëra-tjetrës". Këtu kam mendimin se lidhur me provat e marra nga Gjykata, kryesisht, por mbi bazën e kërkesës së palëve, sikurse ka ndodhur në rastin objekt analize, Gjykata ka detyrim pasiv dhe jo aktiv për t'i mundësuar palëve njohjen me provat e marra kryesisht. Në rastin objekt analize, Gjykata nuk i ka penguar asnjërën palë në këtë drejtim. Madje, pala e paditur është njohur me këto prova duke marrë kopje të tyre përmes fotografimit, (gjë për të cilën ajo ka dhënë vetë pëlqim).

Në përfundim: Mbi sa më sipër, vlerësoj se provohet që ankesa është e pabazuar.

Në lidhje me qëndrimin tim Komisioni shprehet në vendim si më poshtë:

91.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

i) Subjekti pretendon se neni 317 i Kodit të Procedurës Civile nuk është shterues, por orientues. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi neni 317 i këtij Kodi është shterues për sa u përket rasteve kur jemi përpara aplikimit të ekzekutimit të përkohshëm. Duke specifikuar të tria rastet dhe, më pas, në paragrafin e dytë, ky nen i jep diskrecion gjykatës për të marrë vendim në bazë të kritereve të përcaktuara. Rastet e përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c" janë shteruese dhe nuk mund të konsiderohen si orientuese, sikundër pretendon subjekti, pasi në këtë rast nuk do të kishte kuptim paragrafi i dytë i këtij neni, që përcakton kriteret në vlerësim të gjykatës për të vendosur edhe në raste të tjera dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka trajtuar themelin e çështjes (pretendim i ngritur vazhdimisht nga subjekti dhe është trajtuar gjerësisht më lart), vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron. Komisioni, jo vetëm që nuk ka trajtuar themelin e çështjes, por as nuk ka interpretuar nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, pasi nga ana e tij nuk është zbatuar neni 317 i Kodit të Procedurës Civile. Në vendim, subjekti fillimisht deklaron se dëmshpërblimi i palës paditëse lidhet me të drejtën për punë të saj, më pas subjekti pretendon se jemi në kushtet e paragrafit të dytë të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile dhe në fund këtë dëmshpërblim e trajton në lidhje me të drejtën për ushqim, duke e bërë të paqartë, për rrjedhojë të paargumentuar vendimin e tij në lidhje me pranimin e kërkesës për ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti ka pretenduar se provat e marra prej tij janë marrë bazuar në kërkesën e palëve. Ky pretendimi nuk qëndron, pasi në nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj. Pra, në këtë nen nuk parashikohet që vetë gjykata të administrojë provat kryesisht, por urdhëron palën ose një person të tretë, duke mos cenuar në këtë mënyrë parimin e kontradiktoritetit. Bazuar në procesverbalin e seancës të datës 25.2.2020 në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse G.A, konstatohet se subjekti ka urdhëruar sekretaren për të tërhequr fashikullin origjinal penal tek një gjyqtar tjetër, si dhe e ka administruar si provë pa u paraqitur kërkesë nga palët. Në rastin e gjykimit të çështjes me palë paditëse shtetasen V.H etj., në vendim subjekti shprehet se ka tërhequr në cilësinë e provës kopje të vendimit gjyqësor penal me kërkesë të përfaqësuesit të ndërgjyqësve paditës dhe për të plotësuar kërkesat e nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile. Në të dyja këto raste subjekti nuk ka zbatuar nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nuk ka vepruar sipas dispozitave të parashikuara nga ky Kod, përkatësisht nenet 8-12 dhe 19- 21, pasi ka tërhequr dosje gjyqësore në cilësinë e provave për palën paditëse, për rrjedhojë ka cenuar parimin e kontradiktoritetit. Tërheqja e provave nga ana e gjykatës ka bërë të pamundur vendosjen në dispozicion të këtyre provave palëve në proces, ndërkohë që janë palët ato që paraqesin provat, duke ia bërë të njohura njëra-tjetrës. Subjekti pretendoi se pala e paditur ishte njohur me këto prova, por nuk vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues.

Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe në aspektin e njohurive organizative parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, pasi ka cenuar të drejtat e palëve, duke mos zbatuar parimin e kontradiktoritetit.

*iv) Në lidhje me pezullimin e vendimit, subjekti, në vendimin nr. **/2020, në faqen 4 të tij, shprehet se vendimi gjyqësor penal i formës së prerë është detyrues dhe për këtë gjykatë, bazuar në nenin 70/1 të Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë ai në të gjitha parashtrimet e tij, përfshirë edhe në rastin objekt vlerësimi, është shprehur se është në diskrecion të gjykatës pezullimi ose jo i procesit.*

Në përfundim, Komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti ka përdorur akte të fashikullit penal në procesin e tij civil, ai nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje derisa të përfundonte procedimi penal. Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

Në lidhje më qëndrimin e shprehur nga Komisioni në vendimin e tij, arsyetoj si më poshtë:

<u>Së pari</u>: shpjegimet që i kam dhënë Komisionit në përmbysje të barrës së provës, janë të sakta, të ligjshme të qarta dhe shteruese. Përveç kësaj këto shpjegime ekspozojnë dhe bëjnë të qartë se komisionerja Pamela Qirko ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit, jo vetëm për këtë çështje por në tërësi për të gjitha aspektet e procesit tim të rivlerësimit. E çmoj të padobishme të kaloj në përsëritje pasi shpjegimeve që kam dhënë përpara Komisionit iu qëndroj edhe në këtë ankim.

Së dyti: Përsa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm dhe mospezullimit të gjykimit, jam shprehur tek rasti i OSHEE sh.a dhe Kurum International sh.a. Këtyre shpjegimeve iu qëndroj plotësisht.

Së treti: Përsa i përket "gjoja kontradiktës" që shpreh Komisioni në vendim ndërmjet shpjegimeve që kam dhënë përpara tij me vetë përmbajtjen e vendimit objekt analize, (lidhur me fuqinë juridike të një vendimi penal në një proces civil), kjo kontradiktë nuk ekziston. Komisioni e paraqet atë përmes pikës "iv" të paragrafit 91.8 të vendimit, duke u nisur nga premisa e pavërtetë se një vendim penal gjithmonë ka fuqi detyruese për një gjykim civil në të cilin vihen në bisedë fakte dhe rrethana që janë të përbashkëta si për gjykimin penal ashtu edhe për gjykimin civil. Komisioni e keqintepreton me dashje vendimin tim. Unë në vendim (përmes ometimit) kam qëndrimin se nenit 70 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ka dy paragrafë duhet t'i bëhet një intepretim qëllimor për t'i nxjerrë kuptimin normës. Pra, duke e intepretuar secilin paragraf duke patur parasysh edhe përmbajtjen e tjetrit. Konkretisht, një vendim penal që zgjidh rrethana që kanë të bëjnë me autorin e veprës dhe fajësinë e tij, qartësisht ka fuqi detyruese për gjykimin civil, (paragrafi i parë i normës), por nëse vendimi penal rastësisht zgjidh edhe rrethana që nuk ka të bëjnë me autorin e veprës dhe fajësinë e tij, ai nuk ka fuqi detyruese për gjykimin civil, (paragrafi i dytë i normës). Në rastin konkret, në vendim kam mbajtur qëndrimin se rrethanat e zgjidhura nga vendimi penal, lidhur me autorin e veprës dhe fajësinë e tij nuk ishin rastësore. Gjithashtu, po në të njëjtin vendim kam mbajtur qëndrimin se në kushtet kur rasti objekt gjykimi binte në fushën e veprimit të nenit 622 të Kodit Civil, që flet për përgjegjësinë objektive, edhe po të mos ekzistonte fare vendimi penal, prapë rezultati i gjykimit nuk do të ndryshonte[73].

Së katërti: Lidhur me arsyetimin e Komisionit se nuk kam paraqitur prova për të hedhur poshtë barrën e provës se që më është ngarkuar për të vërtetuar të kundërtën e pretendimit se duke tërhequr vendimet kryesisht, sipas nenit 223 të Kodit të Procedurës Civile, iu kam pamundësuar palëve të njihen me përmbajtjen e provave sipas parimit të kontradiktoritetit, vlerësoj se ky arsyetim është abuzim. Kjo pasi barra e provës më është ngarkuar në mënyrë të paarsyeshme. Kjo pasi vetë fakti që pala e paditur këto prova (për të cilat sipas komisionit ajo nuk ka marrë dijeni), i ka bërë pjesë të bisedimeve të saj përfundimtare, në seancën pasuese, tregon më së miri që ajo është njohur me këto prova.

Së pesti: I lutem Kolegjit që në vlerësimin e tij lidhur me këtë çështje, të ketë parasysh veçanarisht parimin e proporcionalitetit. Kjo pasi edhe nëse pjesa e vendimit tim lidhur me ekzekutimin e përkohshëm konsiderohet e gabuar, (gjë që unë kam mendim të kundërt), kjo pjesë e vendimit, për shkak të natyrës së saj është vendim i ndërmjetëm dhe për rrjedhojë, nuk afekton fatin e përfundimit të gjykimit. Në vlerësimin tim nuk do të kishte aspak balancë ndërmjet ndëshkimit tim për këtë pjesë të vendimit, me qëllimin që synohet të arrihet, nëse zgjidhja që i kam dhënë çështjes në themel mbetet në fuqi në gjykatat më të larta.

Në përfundim: Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se qëndrimi i Komisionit duhet hedhur poshtë nga Kolegji si i pabazuar në ligj.

[73] Kjo pasi neni 622 i Kodit Civil ka epërsi përkundrejt nenit 70 të Kodit të Procedurës Penale, sipas parimit "lex specialis derogate leggi generali".

10. Bashkësia Fetare Provinca Françeskane "Zoja Nunciate" (nr.4080 prot. datë 17.06.2019).

Nga raporti rezulton se:

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen gjyqësore ku Bashkësia Fetare ka patur cilësinë e paditësit, në kushtet e konfliktit të interesit. Në gjykimin e kësaj çështje me objekt "njohjen pronar të paditësit" gjyqtari ka lejuar pjesmarrjen në proces gjyqësor në cilësinë e ndërhyrësit dytësor të shtetasve Leonard dhe Persa Lulaj me arsyetimin se këta shtetas kanë patur interes për një kontratë të lidhur me të paditurin Bashkia Shkodër.

Denoncuesi pretendon se subjekti ka patur njohje të mëparshme me ndërhyrësin Leonard Lulaj, i cili është përfaqësues i shoqërisë "Sky 05 Construction" shpk që ka ndërtuar një pallat në kufi me pronën objekt gjykimi. Në këtë pallat, kjo shoqëri i ka shitur një apartament në katin e katërt, babait të gjyqtarit z.Faik Ymeri dhe në këtë pallat banon prej vitesh gjyqtari A.Ymeri. Dokumentacioni që lidhet me këtë pronë ndodhet pranë noteres Odeta Kerxhaliu, pranë ZVRPP Shkodër dhe ILDKPKI dhe daton në prill të vitit 2007. Denoncuesi shprehet se gjyqtari jo vetëm ka pranuar në mënyrë të kundraligjshme ndërhyrësin dytësor, edhe pse nuk kishte lidhje me çështjen objekt gjykimi, por ka gjykuar duke patur një konflikt të pastër interesi dhe për shkak të këtij konflikti ka marrë vendim në kundërshtim me ligjin.
 Subjekti duhet të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

Në lidhje me këtë ankesë, përpara Komisionit kam mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

<u>Së pari</u>: Kjo ankesë është shqyrtuar edhe nga ish inspektoriati i KLD-së dhe nuk është gjetur asnjë shkelje. Rezultatet e hetimit të kryer nga ky insitucion, Komisioni i ka në dosjen hetimore që po vetë më ka vënë në dispozicion, kur jam njohur mbi praktikën mbi bazën e të cilit është përgatitur raporti mbi rezultatet e hetimit administrativ. Në vlerësimin tim kjo përbën gjë të gjykuar.

<u>Së dyti</u>: Vendimi i dhënë nga unë, i është nënshtruar kontrollit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe është lënë në fuqi. Sipas nenit 102 të ligjit 96/2016, kur një vendim lihet në fuqi nga një Gjykatë me e lartë, nuk ka baza për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarit.

<u>Së treti</u>: Shkaqet e kësaj ankese, janë trajtuar edhe në rrugën e juridiksionit gjyqësor penal, dhe janë hedhur poshtë me vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Të gjitha këto vendime gjyqësore i keni në praktikën mbi bazën e të cilit është përgatitur raporti mbi rezultatet e hetimit administrativ.

<u>Së katërti</u>: Lidhur me marrëdhëniet e mia me shtetasin Leonard Lulaj, jam shprehur në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 që i kam dërguar komisionit. Këtyre deklarimeve unë i qëndroj dhe nuk kam çfarë t'i shtoj. Këto deklarime janë konsideruar të besueshme edhe nga trupi gjykues i mëparshëm, (që përfshinte dy komisionerët e larguar), pra edhe vetë ky fakt tregon se kam patur të drejtë në atë ç'ka kam shpjeguar.

<u>Në përfundim</u>: Vlerësoj se provohet që ankesa është e pabazuar.

Komisioni i ka gjetur bindëse shpjegimet e mia dhe për rrjedhojë është e padobishme që të zgjatem.

11. Byroja Shqiptare e Sigurimit (nr.7860 prot., datë 18.12.2019).

Nga raporti i Komisionit rezulton se:

Denoncuesi pretendon se është përballur me një shkelje të hapur të ligjit, pasi e njëjta çështje gjyqësore po zhvillohet në dy gjykata të ndryshme. Ai sqaron se paditesi F.Nikaj ka paditur Byronë Shqiptare të Sigurimit, në padinë me objekt "shpërblim dëmi". Gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë kryer të gjitha veprimet përgatitore si dhe është caktuar eksperti mjeko-ligjor. Në seancën ku eksperti do të dorëzonte aktin e ekspertimit, përfaqësuesi i palës paditëse paraqiti kërkesën për pushim pa dhënë ndonjë shkak të ligjshëm dhe pa u paraqitur në seancë. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga i padituri/denoncuesi pasi është paraqitur pasi është dorëzuar deklarata e mbrojtjes nga pala e paditur. Me vendimin datë 18.10.2019 gjykata ka vendosur pushimin e çështjes sipas kërkesës së palës paditëse. Kundër këtij vendimi denoncuesi ka paraqitur ankim pranë gjykatës së Apelit Tiranë. Më pas, pala paditëse ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe aktualisht çështja është duke u gjykuar nga subjekti. Denoncuesi pretendon se gjyqtari ka shkelur hapur ligjin pasi në kundërshtim me nenin 58 te K.Pr.Civile ka pranuar të vijoj gjykimin e kësaj çështje pavarsisht se është vënë në dijeni nga i padituri se kjo cështje me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt e bazë ligjore, po gjykohet pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioni pasi analizoi ankesën e denocuesit konstaton se:

 Subjekti duket se ka vepruar në kundërshtim me nenin 58 të K.pr.Civile, pasi ka vijuar gjykimin e një çështje e cila po gjykohej nga një gjykatë më e lartë.
 Subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 si dhe për të depozituar dosjen gjyqësore së bashku me vendimin.

Lidhur me këtë denoncim, kam mbajtur përpara Komisionit qëndrimin e mëposhtëm:

Së pari: Çështja është akoma në pritje të gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër. Sipas neneve 3 dhe 102/2 shkronja "a" të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenit 36 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Civile, (dispozita këto që i kam cituar më sipër dhe prandaj është e panevojshme që të kaloj në përsëritje), asnjë institucion shtetëror nuk mund të shprehet për meritat, themelin e çështjes, përpara se të shprehet Gjykata kompetente. Kjo pasi çdo veprim në të kundërt, vlerësoj se cënon pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Së dyti: Komisioni më ngarkon barrë prove për të vërtetuar se çështja nuk ka qënë në kushtet e litispendencës, sipas nenit 58 të KPC. Lidhur me këtë barrë prove unë nuk kam për të thënë asgjë më shumë se sa kam thënë në vetë vendimin e dhënë prej meje, lidhur me këtë çështje që është ngritur si prapësim nga pala e paditur. Më poshtë po citoj pjesën në fjalë të arsyetimit të vendimit:

"*Ommisis... 3. Prapësimi i tretë: Çështja objekt gjykimi është në kushtet e litispendencës me një çështje tjetër civile, ndërmjet po të njëjtave palë, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor. Për rrjedhojë gjykimi i saj, duhet të pushohet sipas nenit 58 të KPC-së që parashikon se "Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë". Konkretisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është rregjistruar çështja civile më paditës:Fatmir Nikaj, etj, me palë të paditur: Byroja Shqiptare e Sigurimit: me objekt: Detyrimin e palës së paditur që të dëmshpërblejë paditësit nga aksidenti i datës 02.08.2017, për dëmet pasurore dhe jopasurore". Lidhur me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka disponuar "Pushimin e gjykimit të çështjes".*

Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor në fjalë rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka disponuar pushimin e gjykimit pasi ndërgjyqësit paditës kanë hequr dorë nga gjykimi i padisë.

Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë në përputhje me nenin 201 të KPC-së, që përcakton: 1. Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të padituri nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes. 2. Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të padituri nuk ka shkak të ligjshëm.

Në lidhje me këtë prapësim, Gjykata, me kërkesën e përfaqësuesit të palës së paditur, administroi si provë, vendimin e lartëpërmëndur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kopje të ankimit që ka bërë pala e paditur ndaj këtij vendimi si dhe një vërtetim nga Gjykata e Apelit Tiranë, se çështja është në pritje të gjykimit në këtë Gjykatë.

Në lidhje me këtë prapësim, Gjykata vlerëson se ai është i pabazuar. Kjo pasi nga kqyrja e ankimit që pala e paditur ka paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, vihet re qartë se pala e paditur nuk ka pretenduar përmes tij, shkeljen prej vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, objekt ankimi, të ndonjë të drejte materiale konkrete, që të pretendohet nga pala e paditur ankimuese, që t'i përkasë asaj.

Ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, është paraqitur, pasi sipas palës së paditur, është vendosur pushimi i gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndonëse pala e paditur ka paraqitur deklaratën e mbrojtjes, por pa treguar ndonjë shkak të ligjshëm, apo arsye materiale fakti, se përse pala e paditur nuk ka qënë dakort me heqjen dorë nga gjykimi i padisë, nga paditësit. Sipas vlerësimit të Gjykatës që po shprehet përmes këtij vendimi, në rastin në gjykim, duket qartë se ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk ka shkak të ligjshëm, dhe është depozituar vetëm me synim që në të ardhmen të tentohet për t'u përdorur thjesht si instrument pengues për ndërgjyqësit paditës, për paraqitjen e një padie të re. Kjo bindje i krijohet Gjykatës pasi është parim i njohur i të drejtës që "nuk mund të përdoret një e drejtë procedurale, pa qënë nevoja për të njohur apo mbrojtur një të drejtë materiale". Në rastin objekt gjykimi, ankimi gjyqësor në fjalë, referuar përmbajtjes së tij, është në vlerësimin e kësaj Gjykatë, asgjë tjetër veçse

"përdorim abuziv i të drejtës së mbrojtjes", nga pala e paditur, me qëllim për t'ia vështirësuar ndërgjyqësve paditës, realizimin e të drejtave të tyre dëmshpërblimore.

Sipas nenit 100 të KPC-së "Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë detyrimin që gjatë procesit gjyqësor të sillen me mirëbesim dhe ndershmëri". Gjykata që po shprehet përmes këtij vendimi, vlerëson se si paraqitja e ankimit të lartëpërmëndur në Gjykatën e Apelit Tiranë ashtu edhe ngritja e prapësimit që përbën objektin e kësaj pjese të arsyetimit të vendimit, lidhur me litispendencën ndërmjet çështjes që është për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me çështjen që është për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk janë gjë tjetër veçse "shkelje nga pala e paditur të nenit 100 të KPC-së, që përcakton detyrimin e palëve për të qënë të ndershëm në gjykim".

Kjo pasi paraqitja e një ankimi, dukshëm pa shkak ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë, nga pala e paditur, pra pa pretenduar kjo pale ndonjë shkak të ligjshëm material se përse është cënuar nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë objekt ankimi, tregon qartë se pala e paditur nuk ka qënë e ndershme në përdorimin e mjetit procedural ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe as është e ndershme në ngritjen e prapësimit që përbën objektin e analizës në këtë pjesë të arsyetimit të vendimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, prapësimi objekt analize është i pabazuar, pasi në të kundërt, çdo vendimmarrje e Gjykatës, do të binte në kundërshtim me një nga parimet themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që është parimi i gjykimit të çështjes drejtësisht. Respektimi i këtij parimi, ka si gur themeli, sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë, pikërisht respektimin e ndershmërisë së sjelljes gjyqësore, si nga Gjykata ashtu edhe nga palët. Kjo Gjykatë vlerëson se përdorimi i prapësimeve procedurale me karakter sofist, (që në pamje të pare duken të drejta por nuk bazohen në të vërtetën apo ndershmërinë), dhe që në thelbin e tyre janë "freavolous" (prapësime që ngrihen vetëm për të vështirësuar proceduralisht zgjidhjen e mosmarrëveshjes, me qëllim për të fituar kohë, dhe/ose për të aktivizuar institutin e parashkrimit, për të shuar të drejtën e padisë, por pa synuar njohjen, mbrojtjen apo realizimin e një të drejtë material konkrete), duhet vlerësuar nga kjo Gjykatë, si një sjellje gjyqësore që bie në kundërshtim me nenin 100 të KPC-së, dhe kurrsesi nuk duhet t'i konsiderojë të pranueshme, këto prapësime, ngritja e të cilave bie në kundërshtim me parimin e ndershmërisë.

Gjykata vlerëson se pavarësisht se nuk përfshihet në detyrimin e saj funksional, lëndor dhe tokësor, kompetenca për t'u shprehur për drejtësinë dhe bazueshmërinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i shërben gjykimit të çështjes për të evidentuar faktin se "pushimi i gjykimit" i disponuar nga ajo Gjykatë, i referohet nenit 201 paragrafi i dytë i KPC-së, dhe në thelbin e tij, është vendimmarrje diskrecionale e asaj Gjykatë. Gjykata që po shprehet përmes këtij vendimi, vlerëson se si rregull i përgjithshëm, vendimarrjet diskrecionale të gjyqtarëve, nuk i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, përveç rasteve kur këto vendimmarrje, kanë tiparet e ushtrimit të pushtetit arbitrar, në kundërshtim me parimet e drejtësisë, ndershmërisë, paanësisë, etj. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dukshëm nuk është i tillë. Kjo pasi në vetë ankimin e paraqitur nga pala e paditur në Gjykatën e Apelit Tiranë, kjo palë as nuk e pretendon dhe aq më pak e provon këtë gjë. Për më tepër, sikurse u tha më lart, pala e paditur as gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe as në ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, "nuk ka parashtruar ndonjë shkak të ligjshëm fakti", (pra nuk ka treguar se ku, si

dhe në çfarë mënyre i cënon interesat e ligjshme materiale të kësaj palë), kërkesa e ndërgjyqësve paditës në atë gjykim, për të hequr dorë nga gjykimi i padisë.

Një arsyetim paralel që e çon Gjykatën në të njëjtin përfundim se prapësimi i ngritur nga pala e paditur lidhur me litispendencën, nuk duhet pranuar, ka të bëjë me intepretimin logjik të nenit 58 të KPC-së, që rregullon litispendencën. Sipas kësaj Gjykatë, çështja e rregjistruar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk ka shkak dhe objekt të njëjtë, nga pikpamja substanciale, me atë të rregjistruar për gjykim, në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo pasi objekti i gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, është "zgjidhja e mosmarrëveshjes materiale ndërmjet palëve, në themel", ndërsa shkaku i gjykimit është "mosdakortësia e palëve lidhur me vlerën e dëmshpërblimeve që duhen përfituar". Në Gjykatën e Apelit Tiranë, objekti i gjykimit të asaj Gjykatë, "nuk është zgjidhja e mosmarrëveshjes materiale ndërmjet palëve, në themel" dhe shkaku i gjykimit, nuk është i njëjtë, pasi nga kqyrja e ankimit objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, rezulton se "nuk parashtrohet ndonjë shkak material ankimi, që të tregojë nevojën faktike të palës që ka paraqitur ankimin, për të kërkuar mbrotjen gjyqësore nga Gjykata e Apelit Tiranë". Në përfundim të analizës lidhur me këtë prapësim, Gjykata krijon bindjen se ai është i pabazuar dhe se nuk duhet të merret parasysh në vendimin që do të japë kjo Gjykatë, për zgjidhjen e çështjes..."

<u>Së treti</u>: Edhe kjo ankesë është shqyrtuar nga ILD dhe nuk ka gjetur shkelje pasi sipas tij ka të bëjë me mënyrën e intepretimit të ligjit nga gjyqtari dhe se për sa kohë vendimi nuk është cënuar nga një gjykatë më e lartë, nuk mund të thuhet se ka shkelje disiplinore nga gjyqtari. Unë nuk e disponoj vendimin që ka marrë ILD me këtë rast, pasi ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe nuk e kam vlerësuar të nevojshme për t'a ruajtur, por i kërkoj KPK që të kërkojë sipas ligjit 84/2016 informacionin dhe dokumentacionin përkatës tek ILD.

<u>Së katërti</u>: Lidhur me barrën e provës që më ngarkohet për të sjellë dosjen së bashku me vendimin, unë vendimin po ua paraqes por dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjithsesi, unë do bëj përpjekje për t'a marrë por nuk e di nëse do ia arrij t'a realizoj këtë brënda kohës që më keni lënë për të dhënë shpjegimet dhe dokumentet provuese. Ndërkaq, më lejoni që t'iu shpreh konsideratën se ligji 84/2016 autorizon komisionin që të më ngarkojë barrë prove për të vërtetuar të kundërten e gjetjeve dhe vlerësimeve të tij, dhe jo ndonjë barrë me karakter fizik. Kjo pasi unë jam gjyqtar i Republikës së Shqipërisë dhe sipas ligjit 96/2016, e kam të ndaluar të ushtroj çdo veprimtari tjetër përveç mësimdhënies, (edhe këtë me lejen paraprake të KLGJsë). Pra, është e diskutueshme nëse unë lejohem të punoj korrier, hamall, postier, apo të ushtroj veprimtari të tilla, qoftë edhe në favor të interesit tim personal për të dalë fitimtar në procesin tim të rivlerësimit.

Unë mendoj se ngarkimi im me barrë prove të kësaj natyre nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të ligjshmërisë, pasi më detyron medeomos nën frikën e kërbaçit, të kryejë veprimtari që nuk lejohem me ligj që t'i kryej. Kjo bie në kundërshtim edhe me parimin e objektivitetit. Kjo pasi përderisa KPK që është një institucion i tërë dhe që ka autoritet ligjor për të marrë dosje në çdo Gjykatë dhe institucion, paska patur vështirësi për të marrë dosjen dhe vendimin në Gjykatën e Apelit Shkodër, atëherë i bie, që komisioni m'a paska ngarkuar barrën e provës për të vërtetuar mungesën e litispendencës sipas nenit 58 të KPC, pa e lexuar dosjen fare.

Ky fakt, është provë për sjelljen armiqësore që kanë dy komisioneret në raport me mua, në procesin tim të rivlerësimit.

Natyrisht, mua më shkon mendja se këtë e kanë bërë komisioneret në konflikt interesi me mua, që ndërkohë që nuk e kanë lexuar dosjen fare, dhe as vendimin për të cilin më ngarkojnë mua barrë prove për të vërtetuar të kundërtën e ankesës, dhe për më tepër, arrijnë deri aty sa të më fyejnë dhe më poshtërojnë duke më thënë, tani na e sill dosjen ti bashkë me vendimin sepse n'a nevojitet për të vërtetuar se ne kishim të drejtë. O tempora o mores, hajde gjeje drejtësinë.

Përveç kësaj, një sjellje e tillë nga Komisioni më cënon edhe të drejtën e mbrojtjes. Kjo pasi në vend që të harxhoj kohën e kufizuar që komisioni më ka caktuar për t'u mbrojtur, në mënyrë efektive, duke lexuar ligjin, provat që do paraqes dhe shkruar shpjegimet, detyrohem që një pjesë të mirë të kohës t'a harxhoj duke bërë punën që vetë komisioni duhet të bënte. Natyrisht, kjo sjellje e komisionit i mbivendoset sjelljeve të mëparshme që unë kam evidentuar për Komisioneren Pamela Qirko dhe që do evidentoj në vijim për komisioneren tjetër.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioni në vendim shprehet se:

93.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti gjatë gjithë parashtrimeve të tij në lidhje me vlerësimin profesional, shprehet se asnjë institucion shtetëror nuk mund të shprehet për meritat, themelin e çështjes, përpara se të shprehet gjykata kompetente. Kjo, pasi çdo veprim në të kundërt vlerëson se cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Ndërkohë, nga ana e tij në këtë vendim gjyqësor është analizuar ankimi i paraqitur nga pala në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra që nuk ka qenë në kompetencë të subjektit për t'u analizuar.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka vijuar gjykimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile147, duke shqyrtuar një çështje e cila ishte duke u gjykuar në një gjykatë më të lartë.

Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor në kuptim të nenit 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

Në lidhje me këtë vlerësim të Komisionit ka për të thënë si më poshtë:

<u>Së pari</u>: Unë i qëndroj dhe e konsideroj të ligjshëm arsyetimin që kam shprehur në vendim. I Lutem Kolegjit që të ketë në kmonsideratë veç këtij arsyetimi dhe shpjegimeve të mia në këtë pjesë të ankimit edhe ato që kam shprehur në pjesën e "shkaqet e ankimit", të titulluar "së nëntëmbëdhjeti", faqet 53, 53, 55.

<u>Së dyti</u>: Në shtim të argumenteve si më sipër, vlerësoj se mjetet e aksesimit në shërbimin gjyqësor sikurse janë kërkesëpaditë, kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit, kërkesat për shtyrje seance, kërkesat për marrje/revokim provash ankimet në gjykatat më të larta ndaj vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta, janë jo vetëm mjete procedurale, por njëherazi edhe veprime

juridiko-civile me pasojë lindjen, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave që kanë jo vetëm natyrë procedurale por njëherazi edhe natyrë juridiko-civile.

Duke qënë të tilla, vlerësoj se instituti i veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme mbulon edhe këto mjete procedurale përmes të cilave aksesohet shërbimi gjyqësor. (*P.sh një kërkesë padi pa nënshkrim, bie në kundërshtim jo vetëm me nenin 1543të KPC por edhe me nenin 92 të Kodit Civil, shkronja "a" pasi është një veprim juridik që është në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, dhe për rrjedhojë është veprim juridik absolutisht i pavlefshëm*).

Edhe ankimi që pala e paditur ka paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, në çmuarjen time ka vuajtur nga pavlefshmëria absolute. Kjo pasi është bërë në kundërshtim me nenin 100 të KPC, që rregullon parimin e mirëbesimit por edhe me normat juridike përkatëse të KPC që rregullojnë përmbajtjen e ankimit. Për më tepër, ky ankim është bërë me qëllim abuziv për të penguar dhënien e drejtësisë, sikurse e kam shprehur në arsyetimin e vendimit.

Një nga tiparet e veprimeve absolutisht të pavlefshme është nuliteti i tyre duke filluar nga koha që janë kryer. Pra konsiderohet se këto veprime nuk kanë ekzistuar kurrë. Këtë konstatim, pikërisht për shkak të mosekzistencës, mund t'a bëjë kushdo, pra përfshi edhe gjykatat jokompetente[74]. Kjo mënyrë arsyetimi të çon natyrshëm në vlerësimin se vendimi im objekt analize ka qënë i drejtë dhe për rrjedhojë, qëndrimi i Komisionit është i gabuar.

<u>Së treti</u>: Kam disa prova që qëndrimi i komisionit është i gabuar. Konkretisht, prova në favorin tim janë të gjitha vendimet e trupave gjykues të Komisionit, (3 vendime, nga një për secilin komisioner) që ndërsa shprehen "*sipas ligjit 84/2016 nuk kemi kompetencë juridiksionale për të shqyrtuar shkakun e e ngritur për përjashtim që komisionerët nuk plotësojnë standartin "gjykatë e krijuar me ligj", po nga ana tjetër thonë, (në rastin e komisioneres Genta Bungo, Pamela Qirko, Firdes Shuli), që këto shkaqe nuk janë të bazuara*". Tani, ose këto trupa gjykuese nuk kanë kompetencë ose kanë dhe i vlerësojnë shkaqet të pabazuara.

Një vendim tjetër që në kontekstin e analizës që po bëj në këtë pjesë të ankimit, mund të konsiderohet si provë e favorshme për mua, është vetë vendimi i Komisionit që po ankimoj përpara Kolegjit. Në këtë vendim***, ndërsa*** Komisioni arsyeton se përse nuk ka pranuar kërkesën time për pezullimin e procesit të rivlerësimit derisa të shprehet Gjykata Kushtetuese dhe/apo KPA për kërkesën për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e disa komisionerëve, po komisioni arsyeton që pretendimet e mia nuk janë të bazuara/ndërkohë që po vetë shprehet se këto pretendime janë në kompetencë të KPA.

Në përfundim të shpjegimeve lidhur me kriterin e profesionalizmit, (por edhe atë të figurës meqënëse gjetjet dhe vlerësimet Komisioni i pasqyron të gërshetuara), vlerësoj se të gjitha pa përjashtim vlerësimet/konstatimet e trupit gjykues të Komisionit janë:

1. Të paligjshme,
2. Janë hartuar në kushtet e konfliktit të interesit të dy prej anëtarëve të trupit gjykues,

[74] Shih shëmbullin që kam dhënë tek fq 54 e ankimit lidhur me dekretin e Presidentit të Republikës që u konsiderua nul nga një gjykatë jokompetente sikurse ishte Kolegji Zgjedhor në Gjykatën e Apelit Tiranë, i përbërë nga gjyqtarë që e kanë kaluar vetingun.

3. Po këto dy anëtarë të trupit gjykues, kanë thënë të pavërtetën kur kanë deklaruar mungesën e konfliktit të interesit në raport me mua,

4. Që hetimi ka qënë sipërfaqësor me qëllim për të mbuluar gjendjen e konfliktit të interesit të komisioneres Pamela Qirko,

5. Që hetimi është përfunduar ngutshëm duke nxituar Komisioni që të japë vlerësime edhe pa lexuar dosjen fare (si në rastin e ankesës së BSSH që përmendet tek kriteri i profesionalizmit si dhe rastit Hysen Temali dhe Hava Hasa, që përmendet tek kriteri i figurës).

6. Që vlerësimi është i paragjykuar, pasi është në kundërshtim flagrant me parimet e gjykimit të drejtë, gjykatës së paanshme, gjykatës së ndershme, gjykatës së ditur, sigurisë juridike, etj.

7. Unë nuk kam favorizuar askënd në veprimtarinë time si gjyqtar.

8. Unë nuk kam shkelur asnjëherë ligjin.

9. Veprimtaria ime gjyqësore, në pjesën që përmendet në raport në kriterin e profesionalizimit, në një pjesë të madhe është konfirmuar si pa shkelje disiplinore nga institucionet e drejtësisë së re si ILD dhe KLGj si dhe në rrugën e ankimit gjyqësor.

10. Që trupa gjykuese në pjesën e raportit që i referohet kriterit të profesionalizimit por edhe të figurës, rreket të marrë kompetencat e organeve gjyqësore, gjë që bie në kundërshtim me Kushtetutën, me nenet 3, 74, pika 4 dhe 102/2 shkronja "a" të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me nenin 36 paragrafi 3 dhe 451/a të Kodit të Procedurës Civile, (dispozita këto që i kam cituar më sipër dhe prandaj është e panevojshme që të kaloj në përsëritje).

11. Unë nuk kam qënë në konflikt interesi me askënd, as në kuptim të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" dhe as në zbatim të Kodit të Procedurës Civile apo Kodit të Procedurës Penale.

12. Që trupa gjykuese, në të gjitha konstatimet dhe vlerësimet që bën shkel standartin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020 (JR) të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për subjektin e Rivlerësimit Fuat Vjerdha, (sipas të cilit asnjë vlerësues, ku përfshihet edhe KPK, nuk mund të vlerësojë meritat e vendimarrjeve gjyqësore në themel).

13.Që trupa gjykuese, në shumë nga konstatimet dhe vlerësimet që bën tek kriteri i figurës por duke gërshetuar këto edhe me kriterin e profesionalizimit shkel standartin detyrues të përcaktuar me vendimin 20/20 (JR), datë 08.09.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit Fatmir Lushi, që përcakton ndër të tjera *"...ommisis .....është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kritereve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*

të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale. ..... Kolegji vlerëson se standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të këtij neni, por Komisioni, në vendim, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit dhe nuk arsyeton mbi asnjë nga parashikimet e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji arrin në përfundimin se rrethanat e analizuara nga Komisioni nuk plotësojnë standardet e kontrollit që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është plotësuar nga subjekti në mënyrë të plotë dhe të besueshme, të parashikuara nga neni 38, pikat 6 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016...".

KËRKIMI PËRFUNDIMTAR.

Përmes këtij ankimi i lutem gjyqtarëve të nderuar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit që ankimin tim t'a lexojnë dhe t'a trajtojnë me dituri, ndershmëri, humanizëm dhe drejtësi. Në përfundim, të vendosni sipas objektit te tij.

Duke vepruar kësisoj, kam bindjen se nga njëra anë, Ju të nderuar gjyqtarë, do lartësoni dinjitetin e funksionit të lartë shtetëror që ushtroni ndërsa nga ana tjetër do tregoni përmes një shëmbulli, edhe një herë, se sa e madhërueshme është kur e Vërteta dhe Drejtësia i njihen si të drejta më të dobëtit të dhunuar paligjshmërisht dhe arbitrarisht.

Me konsideratë dhe duke iu kërkuar ndjesë pasi, me siguri Ju kam lodhur.

Gjyqtar Andri YMERI